

PËRMBLEDHJE
LEGJISLACIONI PËR TË MITURIT

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2023

ISBN 9789928011558

Adresa

Rruga: "Nikolla Jorga"

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.qbz.gov.al

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

PËRMBAJTJA

Pjesa e parë	Akte ndërkombetare për të miturit	F.
Ligj nr. 7531 datë 11.12.1991	Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës	7
Ligj nr. 8624 datë 15.6.2000	Për aderimin në Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”	20
Ligj nr. 8774 datë 23.4.2001	Për ratifikimin e “Konventës nr.182 “Format më të këqia të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”	29
Ligj nr. 9359 datë 24.3.2005	Për ratifikimin e “Konventës Europiane” “Për marrëdhëniet me fëmijët”	32
Ligj nr. 9443 datë 16.11.2005	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”	41
Ligj nr. 9446 datë 24.11.2005	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”	53
Ligj nr. 9544 datë 29.5.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimat e trafikimit”	62
Ligj nr. 9833 datë 22.11.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura	70
Ligj nr. 9834, datë 22.11.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë	74
Ligj nr.10 071 datë 9.2.2009	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual	80
Ligj nr. 10 424 datë 2.6.2011	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”	95
Ligj nr. 10 425 datë 2.6.2011	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”	98
Ligj nr. 86/2013 datë 14.2.2013	Për ratifikimin e protokollit opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës “Për procedurën e komunikimit”	105
Pjesa e dytë	Të drejtat dhe mbrojtja	
Ligj nr. 9518 datë 18.4.2006	Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar <i>ndryshuar me ligjet:</i> - nr. 48/2013, datë 14.2.2013 - nr. 74/2018, datë 25.10.2018	112

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Ligj nr. 9669 datë 18.12.2006	Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare <i>ndryshuar me ligjet:</i> - nr. 9914, datë 12.5.2008 - nr. 10 329, datë 30.9.2010 - nr. 47/2018, datë 23.7.2018 - nr. 125/2020, datë 15.10.2020	116
Udhëzim i MB, MSHMS nr. 912, datë 27.12.2018	Për procedurat dhe modelin e urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme	131
Udhëzim i MD, KLGJ nr. 9, datë 17.6.2020	Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre <i>Ndryshuar me VKM-në nr. 7, datë 15.6.2021</i>	134
Ligj nr. 9695 datë 19.3.2007	Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit <i>ndryshuar me ligjet:</i> - nr. 10 358, datë 16.12.2010 - nr. 132/2015, datë 5.12.2015 - nr. 69/2019, datë 9.10.2019	137
Udhëzim i KMDP nr. 38, datë 5.8.2013	Për veprime të Komitetit Shqiptar të Birësimit, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale	148
Udhëzim i MD, MF nr. 383/8, datë 29.4.2013	Për përcaktimin e tarifave për Shërbimet e Komitetit Shqiptar të Birësimeve	149
Urdhër i MD nr. 284, datë 28.6.2013	Për krijimin e regjistrat për depozitimin e të dhënave për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit	149
Ligj nr. 18/2017 datë 23.2.2017	Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës	150
Vendim i KM nr. 399, datë 1.6.2011	Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja	180
Udhëzim MD, MF nr. 793/6, datë 26.3.2013	Për përcaktimin e tarifave për njohje dhe miratim të agjencive ndërmjetësuese të huaja	181
Vendim i KM nr. 54, datë 31.1.2018	Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës	182
Vendim i KM nr. 91, datë 14.2.2018	Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës	185
Vendim i KM nr. 148, datë 13.3.2018	Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionale, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës	188
Vendim i KM nr. 149, datë 13.3.2018	Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare	191
Vendim i KM nr. 565, datë 29.9.2018	Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionale dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës	196

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Vendim i KM nr. 578, datë 3.10.2018	Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes	197
Vendim nr. 635, datë 26.10.2018	Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet apo ka kryer veprë penale	222
Vendim i KM nr. 636, datë 26.10.2018	Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor <i>Ndryshuar me VKM-në nr. 471, datë 6.7.2022</i>	223
Vendim i KM nr. 740, datë 12.12.2018	Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij	231
Vendim i KM nr. 111, datë 6.3.2019	Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riadhesimin e fëmijës	232
Udhëzim i MB nr. 640, datë 20.12.2019	Për përcaktimin e rregullave të veçanta të kalimit të shtetasve shqiptarë të mitur në kufi	239
Vendim i KM nr. 186, datë 4.4.2019	Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët	241
Vendim i KM nr. 465, datë 3.7.2019	Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet	242
Udhëzim i MSR nr. 6, datë 21.5.2014	Për procedurat e sistemit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publike dhe jopublike	244
Udhëzim i MASR, MSHMS nr. 658, datë 23.9.2019	Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe /ose të dëmshme për moshën e tij	246
Vendim i KM nr. 551, datë 31.7.2019	Për miratimin e raportit të pestë dhe të gjashtë periodik kombëtar për zbatimin e konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijës” dhe të dy protokolleve opsionale të saj “Për përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur” dhe “Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë”	248
Udhëzim i MSHMS nr. 394, datë 9.5.2019	Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare	249
Udhëzim i MSHMS nr. 584, datë 31.7.2019	Për rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor	261
Udhëzim i MSHMS,MD nr. 650, datë 13.9.2019	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal	263
Udhëzim i MASR, MSHMS, MB nr. 651, datë 13.9.2019	Për procedurat e raportimit, të rasteve të fëmijëve në nevojë, për mbrojtje	265

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Udhëzim i MASR, MSHMS nr. 659, datë 23.9.2019	Për rregullat dhe procedurat për mbulimin e shpenzimeve në ofrimin e shërbimit arsimor, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme nga ajo ku fëmija me aftësi të kufizuara jeton	267
Udhëzim i MSHMS nr. 262, datë 26.5.2021	Për miratimin e metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës	271
Udhëzim i MSHMS nr. 564, datë 5.10.2022	Për miratimin e standardeve për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës	313
Udhëzim i MSHMS nr. 631, datë 21.11.2022	Për miratimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët 6–15 vjeç	350
Urdhër i MSHMS, MASR nr. 335, datë 14.7.2021	Për miratimin e rregullores “Për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë”	367
Urdhër i MSHMS, MASR, MZHBR nr. 336, datë 14.7.2021	Për miratimin e rregullores “Për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”	369
Pjesa e tretë		
Drejtësia penale për të mitur		
Ligj nr. 37/2017	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur	376
Vendim i KM nr. 149, datë 20.3.2019	Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikate përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur	420
Vendim i KM nr. 565, datë 29.9.2018	Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimore dhe koordinues institucionale dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës	423
Vendim i KM nr. 207, datë 10.4.2019	Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin	425
Vendim i KM nr. 233, datë 17.4.2019	Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjedisve, të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit e të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve	430
Vendim i KM nr. 314 datë 15.5.2019	Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve	437

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Pjesa e parë
Akte ndërkombetare për të miturit

LIGJ Nr. 7531, datë 11.12.1991 PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËS¹

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikimin e “Konventës për të drejtat e fëmijës”, nënshkruar në Nju-Jork, më 26 janar 1990.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr. 89, datë 20.12.1991, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia

KONVENTA
MBI TË DREJTAT E FËMIJËS
*Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e
Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989*

PREAMBULA

Shtetet Palë në këtë Konventë,

duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është baza e lirisë, drejtësisë dhe e paqes në botë;

duke pasur parasysh faktin se popujt e Kombeve të Bashkuara kanë ripohuar në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut dhe në dinjitetin dhe vlerën e njeriut dhe kanë vendosur të nxisin progresin shoqëror e standarde më të mira jetese, në një liri më të madhe;

duke pranuar se Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në paktet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdonjëri mund të përfitojë nga të gjitha të drejtat dhe të gjitha liritë e parashtruara në to, pa asnjë lloj dallimi, race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinionit politik ose çdo lloj opinionit tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, pasurie, prejardhjeje ose çdo lloj gjendjeje tjetër;

duke kujtuar se në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë;

të bindur se familja, si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht përgjegjësitë e saj në bashkësi;

duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të saj ose të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi,

duke pasur parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit;

duke pasur parasysh se domosdoshmëria për t'i dhënë një përkujdesje të veçantë fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare Ekstra nr. 89*. Tiranë 2013. f. 3.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës;

duke pasur parasysh se, siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës “fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë, duke përfshirë mbrojtje ligjore të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes”;

duke kujtuar dispozitat e Deklaratës mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ambientin birësues dhe birësimin e fëmijës brenda dhe jashtë vendit; me rregullat minimale standarde të kombeve të bashkuara mbi administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit); dhe të Deklaratës mbi Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Gjendje të Jashtëzakonshme dhe Konflikt të Armatosur;

duke pranuar se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t’u kushtohet një vëmendje e veçantë;

duke pasur parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe të vlerave kulturore të çdo populli për mbrojtjen dhe zhvillimin e harmonishëm të fëmijës;

duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve në të gjitha vendet, dhe veçanërisht në vendet në zhvillim,

ranë dakord për sa vijon:

PJESA I

Neni 1

Në këtë Konventë, me “fëmijë” kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç kur moshë madhore arrihet më përpara, sipas legjislacionit të cilit ai i nënshtrohet.

Neni 2

1. Shtetet palë duhet të respektojnë dhe të sigurojnë të drejtat e parashtruara në këtë Konventë të çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja apo çdo gjendje tjetër të fëmijës ose të prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose të ndëshkimit, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 3

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

2. Shtetet Palë angazhohen që t’i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, në numër dhe të aftësisë së personelit të tyre, si dhe të kontrollit të duhur.

Neni 4

Shtetet Palë angazhohen të marrin të gjitha masat legjislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore,

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Shtetet Palë marrin të gjitha masat maksimale të mundshme në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është e nevojshme, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 5

Shtetet Palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ligjorë ose persona të tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, për t'i dhënë këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që i njeh atij kjo Konventë.

Neni 6

1. Shtetet Palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.
2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat maksimale të mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 7

1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, për aq sa është e mundur, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.
2. Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetej pa shtetësi.

Neni 8

1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.
2. Në qoftë se një fëmijë i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjitha elementet e identitetit të tij, Shtetet Palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Neni 9

1. Shtetet Palë garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të mirë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit e keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.
2. Në të gjitha rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.
3. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe kontakte të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, përveç kur kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës.
4. Kur ndarja është rrjedhojë e ndonjë veprimi të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja (përfshirë këtu vdekjen si rrjedhojë e çdo shkakui, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendndodhjen e anëtarit ose anëtarëve të munguar të familjes, përveç kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkeje të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.

Neni 10

1. Në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë sipas paragrafit 1 të nenit 9, kërkesat e bëra nga një fëmijë ose nga prindërit e tij, me qëllim që të hyjnë në një Shtet Palë ose të largohen prej tij, për arsye ribashkimi të

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

familjes, trajtohen nga Shtetet Palë në një mënyrë pozitive, njerëzore dhe me shpejtësi. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë pasoja të dëmshme për autorët e kërkesës dhe anëtarët e familjes së tyre.

2. Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakte të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të veçanta. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Neni 11

1. Shtetet Palë marrin masa për të luftuar zhvendosjet dhe mosriktimet e paligjshme të fëmijëve në vend të huaj.

2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë nxisin përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 12

1. Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.

2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet në mënyrë të veçantë mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.

Neni 13

1. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kufijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër komunikimi të zgjedhur nga fëmija.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:

- a) respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; ose
- b) mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 14

1. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë.

2. Shtetet Palë respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, sipas rastit, të përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, për ta drejtuar atë në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.

3. Liria për të manifestuar fenë ose bindjet e tij mund t'u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik, ose liritë dhe të drejtat themelore të të tjerëve.

Neni 15

1. Shtetet Palë njohin të drejtat e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor.

2. Asnjë kufizim nuk mund të ketë në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, të sigurisë publike ose të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Neni 16

1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cenimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cenimeve të tilla.

Neni 17

Shtetet Palë njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor. Për këtë qëllim Shtetet Palë:

- a) inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv për të përhapur një informacion dhe materiale me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijën dhe në përputhje me frymën e nenit 29;
- b) inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në prodhimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të tilla informacioneve dhe materialeve nga burime të ndryshme kulturore, kombëtare e ndërkombëtare;
- c) inkurajojnë prodhimin dhe përhapjen e librave për fëmijë;
- d) inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv që t'u kushtojnë vëmendje, në mënyrë të veçantë nevojave gjuhësore, të fëmijës që i përket një grupi etnik ose është autokton;
- e) inkurajojnë zhvillimin e udhëzuesve të nevojshëm për mbrojtjen e fëmijës nga informacioni dhe materialet që dëmtojnë mirëqenien e tij, duke pasur parasysh dispozitat e neneve 13 dhe 18.

Neni 18

1. Shtetet Palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë shqetësimi i tyre kryesor.

2. Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e parashtruara në këtë Konventë, Shtetet Palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë, në përmbushjen e përgjegjësiave për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.

3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët, për të cilat janë ngritur.

Neni 19

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose abuzimi, braktisja apo mospërfillja, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën kujdesin e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

2. Këto masa mbrojtëse përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për sigurimin e përkrahjes së nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart dhe, kur duhet, të ndërhyrjes gjyqësore.

Neni 20

1. Një fëmijë, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti.

2. Shtetet Palë sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

3. Kjo përkujdesje mund të përfshijë, ndër të tjera, një ambient birësues "Kafalah" sipas të drejtës islamike, birësimin ose, në rast nevojë, sistemimin në institucione të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet pasur mirë parasysh dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 21

Shtetet Palë, të cilët pranojnë dhe/ose lejojnë sistemin e birësimit, garantojnë që interesi më i mirë i fëmijës të jetë në qendër të vëmendjes dhe:

a) Sigurojnë që birësimi i fëmijës të autorizohet vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e zbatueshme dhe mbi bazën e të gjitha të dhënave përkatëse dhe të besueshme, që birësimi të lejohet duke pasur parasysh gjendjen e fëmijës në raport me prindërit, të afërmit dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe, kur është e nevojshme, personat e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre të sigurt për birësimin, mbi bazën e këshillimit të nevojshëm;

b) Pranojnë se birësimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar kujdesin për fëmijën, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje birësuese ose adoptuese, ose nuk mund të ketë përkujdesjen në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme në vendin e tij të origjinës;

c) Sigurojnë që, në rast birësimi në një vend tjetër, fëmija të gëzojë mbrojtjen dhe norma të barasvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e birësimit në vendin e tij;

d) Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që, në rast birësimi në një vend tjetër, sistemimi i fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pahijshëm për personat e implikuar në të;

e) Mbështesin, sipas rastit, objektivat e këtij neni, duke bërë rregullime ose marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, dhe përpiqen në këtë kuadër të sigurojnë që sistemimi i fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.

Neni 22

1. Shtetet Palë marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si i tillë sipas procedurave dhe të drejtës ndërkombëtare ose të brendshme të zbatueshme, qoftë vetëm apo i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga çdo person tjetër, të përfitojë mbrojtjen e duhur dhe përkrahjen humanitare për të gëzuar të drejtat e zbatueshme që parashtrihen në këtë Konventë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose me karakter humanitar, në të cilat Shtetet janë Palë.

2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë bashkëpunojnë, kur e gjykojnë të nevojshme, në çdo përpjekje të Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare kompetente, që bashkëpunojnë me Kombet e Bashkuara për të mbrojtur dhe ndihmuar fëmijën dhe për të kërkuar prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes të çdo fëmije refugjat, me qëllim që të sigurojnë informacionin e nevojshëm për ribashkimin me familjen. Në rastet kur as prindërit, as anëtarët e tjerë të familjes nuk gjenden, fëmijës do t'i jepet e njëjta mbrojtje, si çdo fëmije tjetër që i mungon ngaherë ose përkohësisht mjedisi familjar, cilado qoftë arsyeja, sikundër parashikohet në këtë Konventë.

Neni 23

1. Shtetet Palë pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin vetëbesimin dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në bashkësi.

2. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë për fëmijën, i cili përmbush kushtet, si dhe për ata që kujdesen për të, në varësi të të ardhurave të disponueshme, dhënien e dihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.

3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe duhet të ketë për qëllim që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi reale për, dhe të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integritet shoqëror dhe zhvillim vetjak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

4. Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën të kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimit, të edukimit dhe të shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhen pasur parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 24

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

- a) për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijore;
 - b) për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin shëndetësor, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;
 - c) për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme, si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;
 - d) për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;
 - e) për të siguruar që të gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gj, higjienën dhe kushtet sanitare mjedisore dhe parandalimin e aksidenteve;
 - f) për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.
3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.
4. Shtetet Palë marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë vazhdimisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, duhen pasur parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 25

Shtetet Palë i njohin fëmijës, i cili është sistemuar nga autoritetet kompetente për të qenë nën kujdesie, mbrojtje ose trajtim të shëndetit fizik ose mendor, të drejtën e një ekzaminimi periodik të këtij trajtimi dhe të çdo rrethane tjetër lidhur me këtë sistemim.

Neni 26

1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmijë të drejtën për të përfituar përkrahje shoqërore, përfshirë sigurimet shoqërore dhe marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

2. Ndihmat, kur është e nevojshme, duhet të jepen duke pasur parasysh të ardhurat dhe kushtet e fëmijës dhe të personave përgjegjës për mbajtjen e tij, si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Neni 27

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e çdo fëmijë për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

2. Përgjegjësinë kryesore për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda aftësive dhe mundësive të tyre financiare, e kanë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për fëmijën.

3. Shtetet Palë marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të realizojnë këtë të drejtë dhe, në rast nevojë, për të siguruar një ndihmë ekonomike dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe strehimin.

4. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare ndaj tij, qoftë brenda ose jashtë vendit. Në veçanti, kur personi që ka një përgjegjësi financiare ndaj fëmijës jeton në një shtet tjetër nga ai i fëmijës, Shtetet Palë nxisin aderimin në marrëveshjet ndërkombëtare ose lidhjen e marrëveshjeve të tilla, si dhe marrjen e masave të tjera të duhura.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 28

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

- a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
- b) Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm, përfshirë arsimin e përgjithshëm dhe profesional, i bëjnë ato të vlefshme e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihmë financiare në rast nevojë;
- c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;
- d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional;
- e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore administrohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

3. Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, duhen pasur parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 29

1. Shtetet Palë ranë dakord që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

- a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;
- b) Të risë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;
- c) Të risë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, juhen dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;
- d) Ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë midis gjinive dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;
- e) T'i zhvillojë fëmijës respektin për mjedisin natyror.

2. Asnjë dispozitë e këtij neni ose e nenet 28 nuk do të interpretohet në mënyrë të tillë që të cenojë lirinë e personave fizikë ose organizmave për të krijuar e drejtuar institucione arsimore, gjithmonë me kusht që parimet e parashtruara në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimi që jepet në këto institucione të jetë në përputhje me normat minimale që përcaktohen nga Shteti.

Neni 30

Në shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmijë që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrisë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

Neni 31

1. Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe të argëtohet, të merret me lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

2. Shtetet Palë respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

Neni 32

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

2. Shtetet Palë marrin masa legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të siguruar zbatimin e këtij neni. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, Shtetet Palë në mënyrë të veçantë:

- a) Përcaktojnë një moshë minimale ose moshat minimale të pranimit në punë;
- b) Parashikojnë një rregullim të përshtatshëm të orarit të punës dhe të kushteve në punë;
- c) Parashikojnë dënime ose sanksione të tjera të përshtatshme për të siguruar zbatimin efektiv të këtij neni.

Neni 33

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen në konventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Neni 34

Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

- a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;
- b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;
- c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Neni 35

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Neni 36

Shtetet Palë mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqenien e tij.

Neni 37

Shtetet Palë sigurojnë që:

- a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm pa të drejtë lirimi nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;
- b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër të mundshme.
- c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që merr parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, përveç kur mendohet se është në interesin më të mirë të fëmijës që të mos veprohet kështu dhe të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me anë të korrespondencës dhe vizitave, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;
- d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm, si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 38

1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë dhe të garantojnë respektimin e rregullave të së drejtës humanitare ndërkombëtare, që janë të zbatueshme për ta në rast konflikti të armatosur dhe që kanë të bëjnë me fëmijën.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimet luftarake.

3. Shtetet Palë duhet të shmangin rekrutimin në forcat e tyre të armatosura të çdo personi që nuk ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Kur ata rekrutojnë persona që kanë mbushur 15 vjeç por janë më të vegjël se 18 vjeç, Shtetet Palë përpiqen të rekrutojnë më përpara më të mëdhenjtë në moshë.

4. Në përputhje me detyrimin që u takon në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, për të mbrojtur popullsinë civile në rast konflikti të armatosur, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur.

Neni 39

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të nxitur riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

Neni 40

1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose të cilësuar se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi në pajtueshmëri me zhvillimin e ndjenjës së dinjitetit dhe vlerës së fëmijës, që përforcon tek ai respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës, si dhe dëshirën për të nxitur riintegrimin e tij në shoqëri dhe marrjen e një roli konstruktiv në të.

2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë sigurojnë në veçanti që:

a) Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer;

b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë:

i) Të prezumohet i pafajshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht;

ii) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, dhe nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;

iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose organ gjyqësor kompetent, të pavarur dhe të paanshëm, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, përveç kur gjykohej se kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

iv) Të mos detyrohet të dëshmojë ose të deklarojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.

v) Në qoftë se gjykohej se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi, si dhe çdo mase të marrë si rrjedhojë e tij, para një autoriteti ose një organi më të lartë gjyqësor kompetent, të pavarur dhe të paanshëm, në përputhje me ligjin.

vi) T'i jepet ndihmë falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.

vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedimit.

3. Shtetet Palë përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, autoriteteve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që cilësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti:

a) Përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal;

b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

4. Parashikohen rregullime të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit dhe trajnimit profesional dhe alternativa të tjera, veç kujdesit institucional, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim të përshtatshëm për mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe shkeljen e ligjit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 41

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk cenon dispozitat më të favorshme për realizimin e të drejtave të fëmijës, që mund të parashikohen:

- a) në legjislacionin e një Shteti Palë; ose
- b) në të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë Shtet.

PJESA II

Neni 42

Shtetet Palë marrin përsipër t'ua bëjnë gjerësisht të njohura parimet dhe dispozitat e kësaj Konvente, si të rriturve ashtu edhe fëmijëve, me anë të mjeteve vepruese dhe të përshtatshme.

Neni 43

1. Me qëllim që të shqyrtohet progresi i arritur nga Shtetet Palë në përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër prej kësaj Konvente, krijohet një Komitet mbi të Drejtat e Fëmijës, i cili kryen funksionet e caktuara si më poshtë.

2. Komiteti përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe që njihen si kompetentë në fushën që trajton kjo Konventë. Anëtarët e Komitetit zgjidhen nga Shtetet Palë midis shtetasve të tyre dhe marrin pjesë me cilësinë e tyre personale, duke pasur parasysh një shpërndarje të drejtë gjeografike dhe sistemet juridike kryesore.

3. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me votë të fshehtë, nga një listë personash të caktuar nga Shtetet Palë. Çdo Shtet Palë mund të caktojë një kandidat nga shtetasit e tij.

4. Zgjedhja e parë për Komitetin bëhet jo më vonë se gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më pas zgjedhjet bëhen çdo dy vjet. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara me anë të një letre drejtuar Shteteve Palë i fton ata të paraqesin kandidatët e tyre brenda dy muajve. Sekretari i Përgjithshëm përgatit më pas listën alfabetike të kandidatëve të caktuar, duke cilësuar Shtetet Palë që i kanë caktuar dhe ua paraqit atë Shteteve Palë në këtë Konventë.

5. Zgjedhjet bëhen gjatë mbledhjeve të Shteteve Palë, të organizuara nga Sekretari i Përgjithshëm në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, për të cilat dy të tretat e Shteteve Palë duhet të formojnë një kuorum, kandidatët e zgjedhur në Komitet janë ata që fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të Shteteve Palë të pranishëm dhe votues.

6. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen në qoftë se kandidatura e tyre paraqitet përsëri. Mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë mbaron pas dy vjetësh. Emrat e këtyre pesë anëtarëve hidhen në short nga Kryetari i mbledhjes, menjëherë pas zgjedhjes së parë.

7. Në rast se një anëtar i Komitetit vdes ose jep dorëheqjen ose deklaron se për çdo arsye tjetër nuk mund t'i kryejë më funksionet e tij në Komitet, Shteti Palë, që kishte paraqitur kandidaturën e tij, emëron një tjetër ekspert nga shtetasit e vet, për të shërbyer deri në përfundim të mandatit korrespondues, gjë që i nënshtrohet miratimit të Komitetit.

8. Komiteti vendos rregullat e veta të brendshme.

9. Komiteti zgjedh nëpunësit e tij për një periudhë prej dy vjetësh.

10. Mbledhjet e Komitetit zakonisht mbahen në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose në çdo vend tjetër të përshtatshëm, të caktuar nga Komiteti. Komiteti mbledhet zakonisht çdo vit. Kohëzgjatja e mbledhjeve të Komitetit përcaktohet dhe rishikohet, në rast se është e nevojshme, në një mbledhje të Shteteve Palë në këtë Konventë, duke iu nënshtruar miratimit të Asamblesë së Përgjithshme.

11. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara siguron personelin dhe pajisjet e nevojshme, për të kryer me efektivitet funksionet e Komitetit në bazë të kësaj Konvente.

12. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Komitetit të krijuar në bazë të kësaj Konvente paguhet nga fondet e OKB-së, sipas afateve dhe kushteve të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 44

1. Shtetet Palë marrin përsipër t'i paraqesin Komitetit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raporte mbi masat e marra për të përmbushur të drejtat e njohura në këtë Konventë dhe mbi progresin e bërë për të gëzuar këto të drejta:

- a) Brenda dy vjetëve, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Shtetet Palë përkatëse;
- b) Në vazhdim, në çdo pesë vjet.

2. Raportet e përgatitura në zbatim të këtij neni duhet të paraqesin faktorët dhe vështirësitë, në rast se ka, që kanë ndikuar në shkallën e përmbushjes nga Shtetet Palë të detyrimeve të parashikuara në këtë Konventë. Raportet duhet të përmbajnë gjithashtu të dhëna të mjaftueshme për t'i dhënë Komitetit një vlerësim të plotë mbi zbatimin e Konventës në vendin përkatës.

3. Shtetet Palë, që kanë paraqitur në Komitet raportin e parë të plotë, nuk duhet të përsërisin në raportet pasuese të paraqitura sipas pikës (b) të paragrafit 1 të këtij neni, informacionin kryesor të dhënë më parë.

4. Komiteti mund t'u kërkojë Shteteve Palë të dhëna plotësuese, që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës.

5. Komiteti i paraqit çdo dy vjet Asamblesë së Përgjithshme, nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror, raporte mbi aktivitetet e tij.

6. Shtetet Palë sigurojnë një shpërndarje të gjerë të raporteve të tyre në vendet e tyre.

Neni 45

Për të arritur zbatimin efektiv të Konventës dhe për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën që mbulon kjo Konventë:

a) Agjencitë e specializuara, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organizma të tjera të Kombeve të Bashkuara, kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë shqyrtimit të zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente, që kanë të bëjnë me qëllimin e mandatit të tyre. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe të gjitha organet e tjera kompetente, që ai do ta gjykojë të përshtatshme, për të dhënë këshilla të specializuara mbi zbatimin e Konventës në fusha që kanë të bëjnë me qëllimin e mandatit të tyre përkatës. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organizma të tjera të Kombeve të Bashkuara për t'i paraqitur raporte mbi zbatimin e Konventës në sektorët që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së tyre;

b) Komiteti u transmeton agjencive të specializuara, Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organeve të tjera kompetente, në rast se e gjykon të përshtatshme, çdo raport të Shteteve Palë, që përmban një kërkesë ose që tregon një nevojë për këshilla ose ndihmë teknike, së bashku me vërejtjet dhe sugjerimet e Komitetit, në rast se ka të tilla, ndaj këtyre kërkesave dhe treguesve;

c) Komiteti mund t'i rekomandojë Asamblesë së Përgjithshme, që t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm, të ndërmarrë në emër të tij studime për çështje të veçanta, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës;

d) Komiteti mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme, të bazuara në të dhënat e marra në zbatim të neneve 44 dhe 45 të kësaj Konvente. Këto sugjerime dhe rekomandime të natyrës së përgjithshme i transmetohen çdo Shteti Palë të interesuar dhe i përcillen për dijeni Asamblesë së Përgjithshme, të shoqëruara, në rast se ka të tilla, me komentet e Shteteve Palë.

PJESA III

Neni 46

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjitha Shtetet.

Neni 47

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 48

Konventa do të qëndrojë e hapur për aderim nga çdo Shtet. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 49

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për secilin Shtet që ratifikon këtë Konventë ose aderon në të, pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit, Konventa hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky Shtet, të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 50

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe të depozitojë tekstin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua komunikon pastaj amendamentin e propozuar Shteteve Palë, duke kërkuar që t'i bëjnë të ditur nëse janë dakord për thirrjen e një konference të Shteteve Palë për shqyrtimin e propozimeve dhe të hedhjes në votë të tyre. Nëse brenda katër muajve pas datës së këtij komunikimi, të paktën një e treta e Shteteve Palë shprehen dakord për thirrjen e një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm thërret konferencën nën kujdesin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

2. Një amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe të jetë pranuar nga dy të tretat e Shteteve Palë.

3. Kur një amendament hyn në fuqi, ai bëhet i detyrueshëm për të gjithë Shtetet Palë, që e kanë pranuar dhe Shtetet e tjera që mbeten të lidhura me dispozitat e kësaj Konvente dhe me të gjitha amendamentet e mëparshme të pranuar prej tyre.

Neni 51

1. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara merr dhe ua dërgon të gjithë Shteteve tekstin e rezervave të bëra nga Shtetet në çastin e ratifikimit ose të aderimit.

2. Nuk lejohet asnjë rezervë e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

3. Rezervat mund të tërhiqen në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili informon për këtë të gjitha Shtetet. Njoftimi hyn në fuqi në datën kur ai është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 52

Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 53

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara caktohet si depozitues i kësaj Konvente.

Neni 54

Origjinali i kësaj Konvente, ku tekstet në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, janë njëllorj të barasvlershme, depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të Kësaj, të nënshkruarit, të plotfuqishëm e të autorizuar ligjërisht nga qeveritë e tyre përkatëse, nënshkruan këtë Konventë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

LIGJ
Nr. 8624, datë 15.6.2000

PËR ADERIMIN NË “KONVENTËN E HAGËS”, “PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE BASHKËPUNIMIN PËR BIRËSIMET JASHTË VENDIT”¹

Në mbështetje të neneve 78,83 pika 1 dhe 21 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2667, datë 24.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONVENTA MBI MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE BASHKËPUNIMIN PËR BIRËSIMET JASHTË VENDIT

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente;

Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi,

Duke rikujtuar se çdo Shtet duhet të marrë me përparësi masat e duhura për të mundësuar që fëmija të mbetet në kujdesin e familjes së tij të origjinës,

Duke pranuar se birësimi jashtë vendit mund të ofrojë avantazhin e një familjeje të përhershme për një fëmijë, për të cilin nuk mund të gjëndet një familje e përshtatshme në Shtetin e tij të origjinës,

Duke qenë të bindur për nevojën e marrjes së masave për të siguruar që birësimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore dhe që të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve,

Me dëshirën për të vendosur dispozitat të përgjithshme për këtë qëllim, duke patur parasysh parimet e shpallura në instrumentet ndërkombëtare, sidomos në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të 20 nëntorit 1989 dhe në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqënien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me Vendosjen në një Familje Ushqyese dhe Birësimin Brenda dhe Jashtë Vendit (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 41/85, e 3 dhjetorit 1986),

U morën vesh për dispozitat e mëposhtme:

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 18*. Tiranë 2000. f. 872.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

KAPITULLI I SFERA E KONVENTËS

Neni 1

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

- a) të merren masat mbrojtëse për të siguruar që birësimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tyre themelore, të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare;
- b) të krijohet një sistem bashkëpunimi midis Shteteve Kontraktuese, për të siguruar që këto masa të respektohen dhe në këtë mënyrë të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve;
- c) të sigurohet njohja në Shtetet Kontraktuese e birësimeve të bëra në përputhje me këtë Konventë.

Neni 2

1. Konventa zbatohet kur një fëmijë, i cili zakonisht banon në një Shtet Kontraktues ("Shteti i origjinës"), është shpërngulur, shpërngulet ose do të shpërngulet në një Shtet tjetër Kontraktues ("Shteti pritës"), ose pas birësimit të tij në Shtetin e origjinës, nga bashkëshortë ose nga një person që banon zakonisht në Shtetin pritës, ose për qëllime të një birësimi të tillë në Shtetin pritës ose në Shtetin e origjinës.

2. Konventa mbulon vetëm birësimet që krijojnë një marrëdhënie të përhershme prind-fëmijë.

Neni 3

Konventa nuk zbatohet më, në rast se pëlqimet e përmendura në Nenin 17 nënparagrafi c, nuk janë dhënë para se fëmija të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

KAPITULLI II KËRKESAT PËR BIRËSIME JASHTË VENDIT

Neni 4

Një birësim brenda sferës së kësaj Konvente kryhet vetëm në rast se autoritetet kompetente të Shtetit të origjinës:

- a) kanë përcaktuar se fëmija mund të birësohet;
- b) kanë vendosur, mbasi janë shqyrtuar si duhet mundësitë për vendosjen e fëmijës brenda Shtetit të origjinës, se birësimi jashtë vendit është në interesin më të lartë të fëmijës;
- c) kanë siguruar se
 - (1) personat, institucionet dhe autoritetet, pëlqimi i të cilëve për birësim është i domosdoshëm, janë këshilluar sipas nevojës dhe janë informuar siç duhet mbi pasojat e pëlqimit të tyre, pavarësisht nëse birësimi arrin ose jo në ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore midis fëmijës dhe familjes së tij të origjinës,
 - (2) të tillë persona, institucione dhe autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre në mënyrë të vullnetshme, në formën e kërkuar ligjore dhe e kanë shprehur ose evidentuar atë me shkrim,
 - (3) pëlqimet nuk janë dhënë me pagesë ose kompensim të çdo lloji dhe nuk janë tërhequr, dhe
 - (4) pëlqimi i nënës kur është kërkuar, është dhënë pas lindjes së fëmijës; dhe
- d) janë siguruar, në lidhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës se
 - 1) ai është këshilluar dhe informuar në mënyrën e duhur për pasojat e birësimit dhe të pëlqimit të dhënë prej tij për birësim, në rast se ky pëlqim kërkohet,
 - 2) janë pasur parasysh dëshirat dhe mendimet e fëmijës,
 - 3) pëlqimi i fëmijës për birësim, në rastet kur ky birësim kërkohet, është dhënë në mënyrë të vullnetshme, në formë ligjore të kërkuar dhe është shprehur ose evidentuar me shkrim, dhe
 - 4) një pëlqim i tillë nuk është bërë me pagesë apo kompensim të çdo lloji.

Neni 5

Birësimi në kuadrin e Konventës do të bëhet vetëm në rast se autoritetet kompetente të Shtetit pritës:

- a) kanë vendosur që prindërit e ardhshëm birësues kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- b) janë siguruar se prindërit e ardhshëm birësues janë këshilluar sipas nevojës; dhe
- c) kanë vendosur që fëmija është autorizuar ose do të autorizohet për të hyrë dhe për të banuar përgjithmonë në atë Shtet.

KAPITULLI III AUTORITETET QENDRORE DHE ORGANET E AKREDITUARA

Neni 6

(1) Një Shtet Kontraktues do të caktojë një Autoritet Qendror për t'i kaluar këtij autoriteti detyrimet që ka në bazë të Konventës.

(2) Shtetet Federativë, shtetet me më shumë se një sistem legjislacioni ose shtetet që kanë njësi territoriale autonome, janë të lira të caktojnë më shumë se një Autoritet Qendror dhe të përcaktojnë shtrirjen e funksioneve të tyre territoriale apo personale. Kur një Shtet ka caktuar më shumë se një Autoritet Qendror, ai cakton Autoritetin Qendror, të cilit mund t'i drejtohet njoftimi për transmetim Autoritetit Qendror përkatës brenda atij Shteti.

Neni 7

(1) Autoritetet Qendrore bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në Shtetet e tyre, për të mbrojtur fëmijët dhe për të arritur objektivat e tjera të Konventës.

(2) Ato marrin drejtpërdrejt të gjitha masat e duhura:

(a) për të siguruar informacion lidhur me ligjet e Shteteve të tyre për birësimin dhe informacion tjetër të përgjithshëm, si statistika dhe formularë standard;

(b) për të informuar njëri-tjetrin lidhur me funksionimin e Konventës dhe për të eliminuar sa më shumë çdo pengesë në zbatimin e saj.

Neni 8

Autoritetet Qendrore marrin të gjitha masat e nevojshme, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet autoriteteve publike, për të parandaluar përfitime financiare ose përfitime të tjera të parregullta në lidhje me një birësim dhe për të mos lejuar asnjë praktikë që bie në kundërshtim me qëllimet e kësaj Konvente.

Neni 9

Autoritetet Qendrore marrin të gjitha masat e nevojshme, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet organeve të tjera të akredituara rregullisht në Shtetin e tyre, sidomos:

a) për të mbledhur, ruajtur dhe shkëmbyer informacion lidhur me gjendjen e fëmijës dhe prindërit e ardhshëm birësues, për aq sa është e nevojshme për realizimin e birësimit;

b) për të lehtësuar, ndjekur dhe shpejtuar procedurat lidhur me sigurimin e birësimit ;

c) për të nxitur dhe zhvilluar këshillimin lidhur me birësimin dhe shërbimet pas birësimit në Shtetet e tyre;

d) për t'i dhënë njëri-tjetrit raporte vlerësimesh të përgjithshme mbi përvojën e birësimit në vende të tjera;

e) për t'iu përgjigjur kërkesave të Autoriteteve të tjera Qendrore ose autoriteteve të tjera publike, aq sa e lejon ligji i Shtetit të tyre, për informacione mbi gjendjen e një birësimi të veçantë.

Neni 10

Akreditimi u bëhet dhe mbahet vetëm nga organet që tregojnë kompetencë për të realizuar si duhet detyrat që u ngarkohen.

Neni 11

Një organ i akredituar

a) ndjek vetëm objektiva jofitimprurëse, sipas kushteve dhe caceve të përcaktuara nga autoritetet kompetente të Shtetit akreditues;

b) drejtohet dhe ka një personel me persona të kualifikuar në normat e sjelljes dhe që kanë kualifikim ose përvojë për të punuar në fushën e birësimit jashtë vendit; dhe

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) i nënshtrohet mbikqyrjes së autoriteteve kompetente të atij Shteti lidhur me përbërjen, funksionimin dhe gjendjen financiare.

Neni 12

Një organ i akredituar në një Shtet Kontraktues mund të veprojë në një Shtet tjetër Kontraktues vetëm në rast se autoritetet kompetente të të dy Shteteve kanë autorizuar një gjë të tillë.

Neni 13

Emërimi i autoriteteve Qendrore dhe, sipas rastit, shtrirja e funksioneve të tyre, si dhe emrat dhe adresat e organeve të akredituara do t'i komunikohen nga secili Shtet Kontraktues Zyres së Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

KAPITULLI IV KËRKESAT PROCEDURIALE NË BIRËSIMIN JASHTË VENDIT

Neni 14

Personat që zakonisht banojnë në një Shtet Kontraktues dhe që dëshirojnë të birësojnë një fëmijë, zakonisht banues në një Shtet tjetër Kontraktues, i drejtohen Autoritetit Qendror të Shtetit ku banojnë zakonisht.

Neni 15

(1) Në rast se për Autoritetin Qendror të Shtetit pritës përmbushen kërkesat që aplikuesit kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar, ai përgatit një raport, i cili përfshin informacion mbi identitetin e tyre, të drejtën dhe përshtatshmërinë për të birësuar, mbi biografinë e tyre, mbi familjen dhe gjendjen shëndetësore, mjedisin shoqëror, arsyet për birësim, mundësinë për të ndërmarrë një birësim jashtë vendit, si dhe karakteristikat e fëmijëve, për të cilët ata do të zgjidhen të kujdesen.

(2) Ai transmeton raportin e Autoritetit Qendror Shtetit të origjinës.

Neni 16

(1) Në rast se Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës përmbushen kërkesat që fëmija është i birësueshëm, ai:

a) përgatit një raport, i cili përfshin informacion mbi identitetin e tyre, përshtatshmërinë për t'u birësuar, biografinë e tyre, mjedisin shoqëror, historinë e familjes, gjendjen shëndetësore, përfshirë atë të familjes së fëmijës dhe çdo nevojë të veçantë të fëmijës;

b) i kushton vëmendjen e duhur edukimit të fëmijës dhe formimit të tij etnik, fetar dhe kulturor;

c) sigurohet që të jenë dhënë pëlqimet në përputhje me Nenin 4; dhe

d) përcakton, në bazë të raporteve të veçanta lidhur me fëmijën dhe prindërit e ardhshëm birësues, nëse vendosja është në interesat më të larta të fëmijës.

(2) Ai transmeton Autoritetin Qendror të Shtetit Pritës raportin e tij mbi fëmijën provën se janë marrë pëlqimet e nevojshme dhe arsyet e vendimit për vendosjen e fëmijës, duke treguar kujdes që të mos zbulojë identitetin e nënës dhe të babait, në rast se në shtetin e origjinës këto identitete nuk mund të deklarohen.

Neni 17

Çdo vendim në shtetin e origjinës se një fëmijë duhet t'u besohet prindërve të ardhshëm birësues, mund të merret vetëm në rast se:

a) Autoriteti Qendror i atij shteti ka dhënë sigurime se prindërit e ardhshëm birësues e pranojnë këtë;

b) Autoriteti Qendror i Shtetit pritës e ka miratuar një vendim të tillë, kur ky miratim kërkohej nga ligji i atij Shteti ose nga Autoriteti Qendror i shtetit të origjinës;

c) Autoritetet Qendrore të të dy shteteve janë marrë vesh që birësimi të kryhet dhe

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

d) në përputhje me Nenin 5 është vendosur që prindërit e ardhshëm birësues kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar dhe se fëmija është i autorizuar ose do të autorizohet për të hyrë dhe për të banuar përgjithmonë në Shtetin pritës.

Neni 18

Autoritetet Qendrore të të dy Shteteve ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar lejimin e fëmijës që të largohet nga Shteti i origjinës dhe të hyjë e të banojë përgjithmonë në Shtetin pritës.

Neni 19

(1) Transferimi i fëmijës në Shtetin pritës mund të kryhet në rast se janë përmbushur kërkesat e nenit 17.

(2) Autoritetet Qendrore të të dy Shteteve sigurohen që transferimi të bëhet në rrethana të sigurta dhe të përshtatshme dhe, në rast se është mundur, me shoqërimin e prindërve birësues ose të prindërve të ardhshëm birësues.

(3) Në rast se nuk bëhet transferimi i fëmijës, raportet e përmendura në Nenet 15 dhe 16 u kthehen mbrapsht autoriteteve që i kanë dërguar

Neni 20

Autoritetet Qendrore informojnë njëri-tjetrin lidhur me procesin e birësimit dhe masat e marra për realizimin e tij, si dhe mbi progresin e vendosjes së fëmijës, në rast se kërkohet një periudhë prove.

Neni 21

(1) Kur birësimi do të bëhet pas transferimit të fëmijës në Shtetin pritës dhe kur Autoritetit Qendror të Shtetit i duket se qëndrimi i vazhdueshëm i fëmijës me prindërit e ardhshëm birësues nuk është në interesat më të larta të fëmijës, Autoriteti Qendror merr masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, në mënyrë të veçantë:

(a) për të tërhequr fëmijën nga prindërit e ardhshëm birësues dhe për të gjetur një përkujdesje të përkohshme;

(b) për të siguruar pa vonesë, në konsultim me Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës një kujdes alternativ për birësim ose, kur kjo nuk është e përshtatshme, një përkujdesje të përkohshme; birësimi nuk bëhet pa njoftuar më parë, në mënyrën e duhur, Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës lidhur me prindërit e ardhshëm birësues .

(c) për të rregulluar, si zgjidhje të fundit kthimin e fëmijës, në rast se këtë e kërkojnë interesat e tij .

(2) Duke pasur parasysh sidomos moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës, me të duhet këshilluar dhe kur është rasti, të merret pëlqimi i tij në lidhje me masat që do të merren në bazë të këtij Neni.

Neni 22

(1) Funkcionet e Autoritetit Qendror në bazë të këtij Kapitulli mund të kryhen nga autoritetet publike ose nga organet publike e akredituara në bazë të Kapitullit III, në atë shkallë që e lejon legjislacioni i Shtetit të tij.

(2) Çdo Shtet Kontraktues mund t'i deklarojë organit ku është depozituar Konventa se funksionet e Autoritetit Qendror sipas neneve 15 deri 21, mund të kryhen në atë Shtet, në shkallën që lejon legjislacioni dhe duke iu nënshtruar mbikqyrjes të autoriteteve kompetente të atij Shteti edhe nga organe ose persona, të cilët:

a) plotësojnë kërkesat e integritetit, kompetencat profesionale, përvojës dhe përgjegjshmërinë të atij Shteti, dhe

b) janë të kualifikuar për normat e tyre morale dhe për kualifikimit ose përvojën në punë në fushën e birësimit jashtë vendit .

(3) Një shtet Kontraktues, i cili bën deklaratën e përmendur në paragrafin 2 informon Zyrën e Përhershme të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mbi emrat dhe adresat e këtyre organeve dhe personave.

(4) Çdo shtet kontraktues mund t'i deklarojë organit ku është depozituar Konventa se birësimet e Fëmijëve që zakonisht banojnë në territorin e tij mund të bëhen vetëm në rast se funksionet e Autoriteteve Qendrore kryen në përputhje me paragrafin 1.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

(5) Pavarësisht nga çdo deklaratë e bërë në bazë të paragrafit 2, raportet e dhëna për Nenit 15 dhe 16 përgatiten, në secilin rast, në përgjegjësinë e Autoritetit Qendror ose të autoriteteve apo organeve të tjera, në përputhje me paragrafin 1.

KAPITULLI V NJOHJA DHE PASOJAT E BIRËSIMIT

Neni 23

(1) Një birësim i vërtetuar nga Autoriteti Kompetent i Shtetit të birësimit, se është bërë në përputhje me Konventën, njihet nga veprimi i ligjit në Shtetet e tjerë Kontraktues. Vërtetimi përcakton si dhe kur është arritur marrëveshja, sipas Nenit 17, nënparagrafi (c).

(2) Secili Shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, njofton organun ku depozitohet Konventa mbi identitetin dhe funksionet e autoritetit ose autoriteteve, të cilët janë kompetentë në atë Shtet për të dhënë vërtetimin. Ai njofton gjithashtu organin ku depozitohet Konventa për çdo ndryshim në emërimin e këtyre autoriteteve.

Neni 24

Njohja e një birësimi mund të refuzohet në një Shtet Kontraktues vetëm në rast se birësimi bie në kundërshtim të hapur me politikën e tij publike, duke pasur parasysh interesat më të larta të fëmijës.

Neni 25

Çdo Palë Kontraktuese mund t'i daklorojë organit ku depozitohet Konventa se ai nuk është i detyruar sipas kësaj Konvente të njohë birësimet e bëra në përputhje me një marrëveshje të arritur në zbatim të Nenit 39, paragrafi 2.

Neni 26

- (1) Njohja e një birësimi përfshin njohjen e:
- a) marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë midis fëmijës dhe prindërve të tij birësues;
 - b) përgjegjësinë prindërore të prindërve birësues ndaj fëmijës;
 - c) ndërprerjen e marrëdhënieve të mëparshme midis fëmijës dhe nënës apo babait të tij, në rast se birësimi ka një pasojë të tillë në Shtetin Kontraktues, kur është bërë.
- (2) Në rastin e birësimit që ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë, fëmija gëzon në Shtetin pritës dhe në çdo Shtet tjetër Kontraktues ku birësimi njihet, të drejta të barabarta me ato që rrjedhin nga birësimet që kanë pasojë të tillë në secilin Shtet.
- (3) Paragrafet e mësipërm nuk paragjykojnë zbatimin e çdo dispozite, që është më e favorshme për fëmijën dhe që është në fuqi në Shtetin Kontraktues, i cili pranon birësimin.

Neni 27

- (1) Kur birësimi i lejuar në Shtetin e origjinës nuk ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë, ai mund të kthehet në një birësim të efektshëm në Shtetin, i cili njeh birësimin në bazë të Konventës:
- a) në rast se ligji i Shtetit pritës lejon një gjë të tillë, dhe
 - b) në rast se pëlqimet e përmendura në nenin 4, paragrafet c dhe d, janë dhënë për qëllim të një birësimi të tillë.
- (2) Neni 23 zbatohet ndaj vendimit që ndryshon birësimin.

KAPITULLI VI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 28

Konventa nuk prek asnjë ligj të një Shteti të origjinës, i cili kërkon që birësimi i fëmijës, zakonisht banues brenda këtij Shteti, të bëhet në këtë Shtet ose që ndalon vendosjen ose transferimin e fëmijës në Shtetin pritës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 29

Nuk ka asnjë kontakt midis prindërve të ardhshëm birësues dhe prindërve të fëmijës apo ndonjë personi tjetër që kujdeset për fëmijën, përderisa të mos jenë plotësuar kërkesat e nenit 4, nënparagrafet a) deri në c) dhe të Nenit 5, nënparagrafi a; me përjashtim të rastit kur birësimi bëhet brenda një familjeje ose kur kontakti bëhet në përputhje me kushtet e vendosura nga autoriteti kompetent i Shtetit të origjinës.

Neni 30

(1) Autoritetet Kompetente të një Shteti Kontraktues sigurojnë që të mos jepet informacioni i mbajtur prej tyre në lidhje me origjinën e fëmijës, veçanërisht informacioni në lidhje me identitetin e prindit ose prindërve të tij, si dhe mbi historikun shëndetësor.

(2) Ata sigurojnë që fëmija apo përfaqësuesi i tij të kenë mundësi të njihen me këtë informacion, nën kujdesin e duhur, në rast se këtë e lejon ligji i atij Shteti.

Neni 31

Pa paragjykuar Nenin 30, të dhënat personale të grumbulluara ose të transmetuara në bazë të kësaj Konvente, sidomos të dhënat e përmendura në Nenet 15 dhe 16 përdoren vetëm për qëllimet, për të cilat janë mbledhur ose transmetuar.

Neni 32

(1) Asnjëri nuk duhet të nxjerrë përfitime të parregullta financiare ose përfitime të tjera nga një veprimtari që lidhet me birësimin jashtë vendit.

(2) Mund të bëhen ngarkim ose të paguhën vetëm shpenzimet e bëra, përfshirë honorare të arsyeshme profesionale, për personat që janë marrë në birësim.

(3) Drejtorët, administratorët dhe nënpunësit që janë marrë me birësimin nuk marrin shpërblim që është në mënyrë të paarsyeshme i lartë, në raport me shërbimet e kryera.

Neni 33

Një autoritet kompetent, i cili konstaton se ndonjë dispozitë e Konventës nuk është respektuar apo se ka rrezik serioz që të mos respektohet, informon menjëherë Autoritetin Qendror të Shtetit. Autoriteti Qendror përgjigjet për të siguruar marrjen e masave të nevojshme.

Neni 34

Në rast se Autoriteti Kompetent i Shtetit të cilit i drejtohet një dokument e kërkon këtë, atij duhet t'i jepet një përkthim i vërtetuar se është në përputhje me origjinalin. Në rast se nuk është vendosur ndryshe, shpenzimet e këtij përkthimi përballohen nga prindërit e ardhshëm birësues.

Neni 35

Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të veprojnë me shpejtësi në procesin e birësimit.

Neni 36

Në lidhje me një Shtet, i cili ka dy ose më shumë sisteme legjislacioni për birësimin, të zbatuara në njësi të ndryshme territoriale:

a) çdo referencë për banesën e zakonshme në këtë Shtet interpretohet si referencë për banesën e zakonshme në njësinë territoriale të atij Shteti;

b) çdo referencë ndaj legjislacionit të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj legjislacionit në fuqi në njësinë territoriale përkatëse;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) çdo referencë ndaj autoriteteve kompetente ose ndaj autoriteteve publike të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj atyre që janë autorizuar për të vepruar në njësinë territoriale përkatëse;

d) çdo referencë ndaj organeve të akredituara të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj organeve të akredituara në njësinë territoriale përkatëse.

Neni 37

Në lidhje me një Shtet, i cili për birësimin ka një ose më shumë sisteme legjislacioni të zbatueshme në kategori të ndryshme personash, çdo referencë ndaj legjislacionit të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj sistemit të legjislacionit të përcaktuar me ligj nga ai Shtet.

Neni 38

Një Shtet, brenda të cilit njësi të ndryshme territoriale kanë rregullat e tyre ligjore për birësimin, është i detyruar të zbatojë Konventën, ndërsa një Shtet me sistem legjislacioni të unifikuar nuk është i detyruar ta bëjë këtë.

Neni 39

(1) Konventa nuk prek asnjë instrument ndërkombëtar, në të cilët Shtetet Kontraktues janë Palë dhe që përmban dispozita për çështje që rregullohen nga kjo Konventë, përveç rasteve kur Shtetet Palë në këtë instrument kanë bërë një deklaratë të kundërt.

(2) Çdo Shtet Kontraktues mund të hyjë në marrëveshje me një ose më shumë Shtete të tjerë Kontraktues për të përmirësuar zbatimin e Konventës në marrëdhëniet e tyre të ndërsjellta. Këto marrëveshje mund të prishen vetëm nga dispozitat e Neneve 14 deri 16 dhe 18 deri 21. Shtetet që kanë përfunduar një marrëveshje të tillë i transmetojnë një kopje organit ku depozitohet Konventa.

Neni 40

Nuk lejohen rezerva për Konventën.

Neni 41

Konventa zbatohet në çdo rast kur një kërkesë e bazuar në Nenin 14 është marrë mbasi Konventa ka hyrë në fuqi në Shtetin Pritës dhe në Shtetin e origjinës.

Neni 42

Sekretari i përgjithshëm i Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mbledh, në intervale të rregullta, një Komision të Posaçëm për të shqyrtuar funksionimin praktik të Konventës.

KAPITULLI VII KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

Neni 43

(1) Konventa është e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private në kohën e Sesionit të saj të Shtatëmbëdhjetë dhe nga Shtetet e tjera pjesëmarrëse në këtë Sesion.

(2) Ajo ratifikohet, pranohet ose miratohet dhe instrumentat e ratifikimit dhe pranimi ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës, organi ku depozitohet Konventa.

Neni 44

(1) Çdo Shtet mund të aderojë në Konventë mbasi ajo të ketë hyrë në fuqi, në përputhje me Nenin 46 paragrafi 1.

(2) Instrumenti i aderimit depozitohet pranë të njëjtut organ.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

(3) Ky aderim ka efekt vetëm për marrëdhëniet midis Shtetit aderues dhe atyre Shteteve Kontraktues, të cilit nuk kanë kundërshtim për aderimin e tij brenda gjashtë muajve pasi kanë marrë njoftimin e përmendur në paragrafin b) të Nenit 48. Ky kundërshtim mund të bëhet nga Shtetet edhe në kohën kur ata ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë Konventën mbas një aderimi. Çdo kundërshtim i njoftohet organit ku depozitohet Konventa.

Neni 45

(1) Në rast se një Shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme legjislacioni për çështje që trajton kjo Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit se kjo Konventë shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në njërën ose në më shumë prej tyre dhe kjo deklaratë mund të ndryshohet duke bërë në çdo kohë një deklaratë tjetër.

(2) Çdo deklaratë e tillë i njoftohet organit ku depozitohet Konventa dhe shpreh në mënyrë të qartë njësitë territoriale në të cilat zbatohet Konventa.

(3) Në rast se një Shtet nuk bën deklaratë në bazë të këtij Neni, Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të atij Shteti.

Neni 46

(1) Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar tre muaj nga depozitimi i instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit, që përmendet në Nenin 43.

(2) Pas kësaj Konventa hyn në fuqi:

a) për secilin Shtet që rrjedhimisht ratifikon, pranon ose miraton atë, në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar tre muaj nga depozitimi i instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

b) për një njësi territoriale, në të cilën është shtrirë Konventa, në përputhje me Nenin 45, në ditën e parë të muajit që vjen mbas mbarimit të tre muajve pas njoftimit që përmendet në këtë nen.

Neni 47

(1) Një Shtet Palë në këtë Konventë mund ta denoncojë atë me anën e një njoftimi me shkrim, drejtuar organit ku depozitohet Konventa.

(2) Denoncimi ka efekt në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar dymbëdhjetë muaj pas marrjes së njoftimit nga organi ku depozitohet Konventa. Kur në njoftim përcaktohet një periudhë më e gjatë për hyrjen në fuqi të denoncimit, denoncimi hyn në fuqi pas mbarimit të një periudhe të tillë më të gjatë, mbasi njoftimi të jetë marrë nga organi ku depozitohet Konventa.

Neni 48

Organi ku depozitohet Konventa njofton Shtetet Anëtarë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, Shtetet e tjera pjesëmarrëse në Sesionin e Shtatëmbëdhjetë dhe Shtetet që kanë aderuar, në përputhje me Nenin 44, përsa më poshtë:

a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e përmendura në Nenin 43;

b) aderimet dhe kundërshtimet ndaj aderimeve, që përmenden në Nenin 44;

c) datën kur Konventa hyn në fuqi, sipas Nenit 46;

d) deklaratat dhe emërimet e përmendura në Nenet 22, 23, 25 dhe 45;

e) marrëveshjet e përmendura në Nenin 39;

f) denoncimet e përmendura në Nenin 47.

Për vërtetim, të nënshkruarit, të autorizuar ligjërisht, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Hagë më 29 maj 1993, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, duke pasur të dy tekstet vlerë të barabartë, në një kopje të vemte, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Mbretërisë së Hollandës dhe një kopje e vërtetuar e së cilës i dërgohet, nëpërmjet kanaleve diplomatike, secilit Shtet Anëtar të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private në datën e Sesionit të saj të Shtatëmbëdhjetë dhe çdo Shteti tjetër që ka marrë pjesë në këtë Sesion.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

LIGJ
Nr.8774, datë 23.4.2001

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NR.182 “FORMAT MË TË KËQIA TË PUNËS SË FËMIJËVE, 1999” TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS”¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa nr.182 “Format më të këqia të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2997, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani

KONVENTA 182

Konventa lidhur me Ndalimin e Formave më të Këqia të Punës së Fëmijëve dhe veprimin e menjëhershëm për eliminimin e tyre.

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E thirrur në Gjenevë nga Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, dhe e mbledhur në sesionin e saj të 87-të më 1 Qershor 1999, dhe

Duke konsideruar nevojën e miratimit të instrumenteve të rinj për ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqia të punës së fëmijëve, si prioritetin kryesor për veprimin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë bashkëpunimin dhe ndihmën ndërkombëtare, për të plotësuar Konventën dhe Rekomandimin lidhur me moshën minimale për pranimin në punë, 1973, të cilat mbeten instrumentet themelore për punën e fëmijëve, dhe

Duke konsideruar se eliminimi efektiv i formave më të këqia të punës së fëmijëve kërkon veprim të menjëhershëm dhe të gjithanshëm, duke marrë në konsideratë rëndësinë e arsimitit falas dhe nevojën për të larguar fëmijët nga të gjitha këto lloje pune dhe të sigurojë rehabilitimin dhe integrimin e tyre social duke pasur parasysh nevojat e familjeve të tyre, dhe

Duke kujtuar rezolutën lidhur me eliminimin e punës së fëmijëve të miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në sesionin e saj të 83-të më 1996, dhe

Duke pranuar se puna e fëmijëve ekziston, në një masë të madhe, për shkak të varfërisë dhe se zgjidhja afatgjatë varet nga rritja e qëndrueshme ekonomike që çon në progresin social, veçanërisht në zbutjen e varfërisë dhe arësimin për të gjithë, dhe

Duke kujtuar Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 20 Nëntor 1989, dhe

Duke kujtuar Deklaratën e ILO-s mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore në Punë dhe Follow-up-in e saj, miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në sesionin e saj të 86-të më 1998, dhe

Duke kujtuar se disa nga format më të këqia të punës së fëmijëve trajtohen nga instrumente të tjerë ndërkombëtare, veçanërisht nga Konventa Puna e Detyruar, 1930, dhe nga Konventa Plotësuese e Kombeve të

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 23*. Tiranë 2001. f. 708.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Bashkuara mbi Eliminimin e Skllavërisë, Tregëtia e Skllavëve, dhe Institucionet dhe Praktikave të Ngjashme me Skllavërinë, 1956, dhe

Pasi vendosi mbi miratimin e disa propozimeve lidhur me punën e fëmijëve, e cila është pika e 4-të në rendin e ditës së sesionit, dhe

Pasi vendosi që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare:

miraton këtë ditë të shtatëmbëdhjetë të Qershorit të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë Konventën e mëposhteme, e cila mund të quhet Konventa Format më të Këqia të Punës së Fëmijëve, 1999.

Neni 1

Çdo anëtar i cili ratifikon këtë Konventë duhet të marrë masa të menjëhershme dhe efektive për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqia të punës së fëmijëve, si një çështje urgjente.

Neni 2

Në kuptim të kësaj Konvente, termi “fëmijë” nënkupton të gjithë personat nën moshën 18 vjeç.

Neni 3

Në kuptim të kësaj Konvente, termi “format më të këqia të punës së fëmijëve” nënkupton:

a - të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me të, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, robëria dhe bujkrobëria për shkak të borxheve dhe puna e detyruar apo e detyrueshme, duke përfshirë rekrutimin e detyruar apo të detyrueshëm të fëmijëve për t'i angazhuar në konflikt të armatosur;

b - përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për prostitucion, për prodhimin e materialeve pornografike ose për shfaqje pornografike;

c- përdorimi, sigurimi ose ofrimi i fëmijës për veprimtari të paligjshme, veçanërisht për prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, sipas përcaktimit në traktatet përkatëse ndërkombëtare;

d- puna e cila, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhet, mund të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

Neni 4

1. Llojet e punëve të përmendura në nenin 3 (d) duhet të përcaktohen nga aktet ligjore ose nënligjore të vendit ose nga autoritetet kompetente, pas konsultimit me organizatat e interesuara të punëtorëve dhe punëdhënësve, duke marrë në konsideratë standardet përkatëse ndërkombëtare, veçanërisht paragrafet 3 he 4 të Rekomandimit, 1999, Format më të Këqia të Punës së Fëmijëve.

Neni 5

Çdo anëtar duhet, pas konsultimit me organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, të krijojë ose përcaktojë mekanizmin e përshtatshëm për të monitoruar zbatimin e dispozitave që i japin fuqi kësaj Konvente.

Neni 6

1. Çdo anëtar duhet të hartojë dhe zbatojë programe veprimi për eliminimin, si prioritet, të formave më të këqia të punës së fëmijëve.

2. Këto programe veprimi duhet të hartohen dhe zbatohen në konsultim me institucionet përkatëse shtetërore dhe organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, duke marrë në konsideratë pikpamjet e grupeve të tjera të interesuara, kur paraqitet rasti.

Neni 7

1. Çdo anëtar duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv dhe hyrjen në fuqi të dispozitave që i japin efekt kësaj Konvente duke përfshirë dispozitat dhe zbatimin e sanksioneve penale ose, kur është e nevojshme, sanksione të tjera.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Çdo anëtar duhet, duke marrë në konsideratë rëndësinë e arsimit në eliminimin e punës së fëmijëve, të marrë masa efektive dhe në një afat të caktuar për:

- a- të ndaluar angazhimin e fëmijëve në format më të këqia të punës së fëmijëve;
- b- të siguruar ndihmën direkte të nevojshme dhe të përshtatshme për largimin e fëmijëve nga format më të këqia të punës së fëmijëve, si dhe për rehabilitimin e integrimin social të tyre;
- c- të siguruar akses në arsimin bazë falas, dhe, kur është e mundur dhe e nevojshme, kualifikimin profesional, për të gjithë fëmijët e larguar nga format më të këqia të punës së fëmijëve;
- d- të identifikuar dhe kontaktuar direkt me fëmijët që ndodhen në rrezik të veçantë; dhe
- e- të marrë në konsideratë situatën e veçantë të vajzave.

3. Çdo Anëtar duhet të caktojë autoritetin kompetent përgjegjës për zbatimin e dispozitave që i japin fuqi kësaj Konvente.

Neni 8

Anëtarët duhet të marrin masat e nevojshme që të ndihmojnë njeri-tjetrin për t'iu dhënë fuqi dispozitave të kësaj Konvente nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ose ndihmës, duke përfshirë mbështetjen për zhvillimin social dhe ekonomik, programet për eliminimin e varfërisë, si dhe të arsimit për të gjithë.

Neni 9

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente duhet t'i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 10

1. Kjo Konventë do të jetë e detyrueshme vetëm për ata Anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ratifikimet e të cilëve janë regjistruar te Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

2. Ajo do të hyjë në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën ratifikimet e dy Anëtarëve janë regjistruar tek Drejtori i Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 11

1. Anëtar i që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë, pas kalimit të dhjetë vjetëve nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi për herë të parë, me anën e një akti që i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Ky denoncim nuk do të hyjë në fuqi deri në një vit pas datës në të cilën ai është regjistruar.

2. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë dhe i cili nuk e ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen brenda një viti pas mbarimit të periudhës 10 vjeçare të parashikuar në paragrafin e mësipërm, nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë për një periudhë tjetër 10 vjeçare dhe, pas kësaj, mund ta denoncojë këtë Konventë në mbarim të çdo periudhe 10 vjeçare, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 12

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe akteve të denoncimit që komunikohen nga Anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton Anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë, Drejtori i Përgjithshëm duhet t'u kujtojë Anëtarëve të Organizatës datën në të cilën Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 13

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrimin, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të gjitha veçoritë e ratifikimeve dhe akteve të denoncimit që janë regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm, në përputhje me dispozitat e neneve të mësipërme.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

Neni 14

Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme, sa herë që e gjykon të nevojshme, një raport mbi zbatimin e kësaj Konvente, si dhe të shqyrtojë mundësinë e vendosjes në rendin e ditës së Konferencës të çështjes së ndryshimit të pjesshëm apo të plotë të saj.

Neni 15

1. Në rastin kur Konferenca miraton një konventë të re, që ndryshon pjesërisht ose plotësisht këtë konventë, përveç kur konventa e re parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një anëtar i konventës së re prezumon, pavarësisht nga kërkesa e nenit 11 më sipër denoncimin e menjëhershëm të kësaj konvente, nëse dhe kur konventa e re hyn në fuqi.

b) nga data e hyrjes në fuqi të konventës së re, kjo konventë do të pushojë së qeni e hapur për ratifikim nga Anëtarët.

2. Kjo Konventë, në çdo rast, do të mbetet në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj për të gjithë ata Anëtarë që kanë ratifikuar konventën e re.

Neni 16

Versionet frengjisht dhe anglisht të tekstit të kësaj Konvente kanë fuqi të barabartë.

LIGJ

Nr.9359, datë 24.3.2005

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS EUROPIANE “PËR MARRËDHËNIET ME FËMIJËT””¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa Europiane “Për marrëdhëniet me fëmijët””.

Neni 2

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 11 të Konventës, Republika e Shqipërisë cakton Ministrinë e Drejtësisë si organ qendror për të kryer funksionet e parashikuara nga kjo Konventë.

Neni 3

Në përputhje me pikën 3 të nenit 18 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se mund të kundërshtojë përdorimin e gjuhës angleze ose franceze, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni, në çdo kërkesë, korrespondencë ose dokument tjetër dërguar organeve qendrore.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 28*. Tiranë 2015. f. 1063.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4533, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

KONVENTË MBI MARRËDHËNIET ME FËMIJËT

Preambul

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe nënshkruesit e tjerë,

duke marrë parasysh Konventën europiane për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët, të 20 majit 1980 (ETS N0 105);

duke marrë parasysh Konventën e Hagës të 25 tetorit 1980 mbi aspektet civile të rrëmbimit të fëmijëve në nivel ndërkombëtar dhe Konventën e Hagës të 19 tetorit 1996 mbi juridiksionin, ligjin e zbatuar, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve;

duke marrë parasysh rregulloren e këshillit (EC) nr.1347/2000 të 29 majit 2000 mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet martesore dhe në çështjet e përgjegjësisë prindërore për fëmijët e të dy bashkëshortëve;

duke ditur se, sipas parashikimit të bërë në instrumente të ndryshme ligjore ndërkombëtare të Këshillit të Europës, si dhe në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve të 20 nëntorit 1989, interesat e fëmijëve janë të një rëndësie prioritare;

të ndërgjegjshëm për nevojën e dispozitave të mëtejshme për të garantuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, dhe prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët, sipas mbrojtjes së bërë nga neni 8 i Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të 4 nëntorit 1950 (ETS nr.5);

duke pasur parasysh nenin 9 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, i cili parashikon të drejtën e fëmijëve që është i ndarë nga një ose nga të dy prindërit të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me të dy prindërit, përveç kur një gjë e tillë është në dëm të interesave të fëmijës;

duke marrë parasysh paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, i cili parashikon të drejtën e fëmijëve, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, duke përjashtuar situatat e jashtëzakonshme, të mbajë rregullisht marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit;

të ndërgjegjshëm për dobinë e njohjes si mbajtës të të drejtave jo vetëm prindërit, por edhe fëmijët;

duke rënë dakord për zëvendësimin e konceptit “e drejta e vizitës tek fëmijët” me nocionin “marrëdhëniet me fëmijët”;

duke marrë parasysh Konventën europiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve (ETS nr.160) dhe dobinë e nxitjen në marrjen e masave për të ndihmuar fëmijët në çështjet në lidhje me marrëdhëniet me prindërit dhe personat e tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët;

duke rënë dakord për nevojën që fëmijët të kenë marrëdhënie jo vetëm me të dy prindërit, por edhe me persona të tjerë të caktuar që kanë lidhje familjare me fëmijët dhe rëndësinë për prindërit dhe personat e tjerë për të mbajtur marrëdhënie me fëmijët në përshtatje me interesat e fëmijëve;

duke vënë re nevojën për të nxitur adoptimin nga shtetet të parimeve të përbashkëta në lidhje me marrëdhëniet mbi fëmijët, sidomos për të lehtësuar zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë;

duke qenë të ndërgjegjshëm se mekanizmi për t'u dhënë fuqi vendimeve të huaja mbi marrëdhëniet me fëmijët ka më shumë mundësi të japë rezultate të kënaqshme kur parimet mbi të cilat mbështeten këto vendime janë të ngjashme me parimet e shtetit që u jep fuqi këtyre vendimeve të huaja;

duke njohur nevojën, kur fëmijët, prindërit dhe persona të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët banojnë në shtete të ndryshme, për të inkurajuar autoritetet gjyqësore për të përdorur më shpesh marrëdhëniet ndërkufitare dhe për të rritur besimin e të gjithë personave të interesuar se fëmijët do të kthehen në përfundim të kësaj marrëdhënieje;

duke vënë re se parashikimi i një sigurimi të efektshëm dhe i garancive shtesë është i mundur të sigurojë kthimin e fëmijëve, sidomos, në përfundim të marrëdhënies ndërkufitare;

Përmbledhje legjislativi për të miturit

duke vënë re se për parashikimin e zgjidhjeve që sidomos kanë të bëjnë me marrëdhënien ndërkufitare për fëmijët është i nevojshëm një instrument ndërkombëtar shtesë;

me dëshirën për të vendosur bashkëpunim ndërmjet të gjitha organeve qendrore ose organeve të tjera për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me këta fëmijë, dhe sidomos për të nxitur bashkëpunim gjyqësor në çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkufitare,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I

Objektet e Konventës dhe përkufizime

Neni 1

Objektet e Konventës

Objektet e kësaj Konvente janë:

- a) përcaktimi i parimeve të përgjithshme për t'u zbatuar me lidhje në vendimet mbi marrëdhëniet;
- b) rregullimi i garancive të përshtatshme për të siguruar ushtrimin e rregullt të marrëdhënieve dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në fund të afatit të marrëdhënies;
- c) vendosja e bashkëpunimit ndërmjet organeve qendrore, organeve gjyqësore dhe organeve të tjera për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- a) “marrëdhënie” do të thotë:
 - i) qëndrimi i fëmijës për një periudhë të caktuar kohe me ose në takim me një person të përmendur në nenet 4 ose 5 me të cilin ai ose ajo nuk banon zakonisht;
 - ii) çdo formë komunikimi ndërmjet fëmijës dhe një personi të tillë;
 - iii) dhënia e informacionit një personi të tillë për fëmijën ose fëmijët mbi këtë person;
- b) “vendim mbi marrëdhëniet” do të thotë një vendim i një organi gjyqësor në lidhje me marrëdhëniet duke përfshirë një marrëveshje mbi marrëdhëniet, e cila është konfirmuar nga një organ kompetent gjyqësor ose që është përpiluar formalisht ose regjistruar si një instrument autentik dhe është i ekzekutueshëm;
- c) “fëmijë” është një person nën 18 vjet në lidhje me të cilin mund të jepet ose të ekzekutohet një vendim mbi marrëdhëniet në një shtet palë;
- d) “lidhje familjare” do të thotë një lidhje e ngushtë si ndërmjet një fëmije dhe gjyshit/gjyshes, ose vëllezërve dhe motrave të tij ose të saj, në bazë të ligjit ose në bazë të një lidhjeje familjare de fakto;
- e) “organ gjyqësor” do të thotë një gjykatë ose organ administrativ i cili ka kompetenca ekuivalente.

KAPITULLI II

PARIME TË PËRGJITHSHME PËR TË ZBATUAR VENDIMET NË LIDHJE ME MARRËDHËNIET

Neni 3

Zbatimi i parimeve

Shtetet palë marrin ato masa legjislativë dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar zbatimin e parimeve të këtij kapitulli nga organet gjyqësore kur ata marrin, ndryshojnë, pezullojnë ose anulojnë vendime në lidhje me marrëdhëniet.

Neni 4

Marrëdhënia ndërmjet një fëmije dhe prindërve të tij ose të saj

1. Një fëmijë dhe prindërit e tij ose të saj kanë të drejtë të marrin dhe të mbajnë marrëdhënie të rregullta me njëri-tjetrin.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Këto marrëdhënie mund të kufizohen ose përjashtohen kur kjo kërkohet nga interesat e larta të fëmijës.
3. Kur nuk është në favor të interesave të larta të një fëmije që ky të mbajë marrëdhënie të pambikëqyrura me një nga prindërit e tij ose të saj, konsiderohet mundësia e marrëdhënieve personale të mbikëqyrura ose forma të tjera të marrëdhënieve me këtë prind.

Neni 5

Marrëdhëniet ndërmjet një fëmije dhe personave të tjerë, përveç prindërve të tij ose të saj

1. Në varësi të interesave të larta të fëmijës, mund të vendosen marrëdhënie ndërmjet atij ose asaj dhe personave të ndryshëm nga prindërit e tij ose të saj që kanë lidhje familjare me fëmijën.
2. Shtetet palë janë të lira ta shtrijnë këtë dispozitë për tek persona të tjerë nga ata të përmendur në paragrafin 1, dhe kur bëhet një shtrirje e tillë. Shtetet mund të vendosin lirisht se cilat aspekte të marrëdhënieve zbatohen sipas përkufizimit të nenit 2 germa a.

Neni 6

E drejta e fëmijës për t'u informuar, konsultuar dhe shprehur mendimet e tij ose të saj

1. Fëmija që në bazë të së drejtës ndërkombëtare konsiderohet me zhvillim të plotë mendor ka të drejtën, përveç kur një gjë e tillë do të ishte haptazi në dëm të interesave të larta të tij ose të saj:
 - të marrë të gjithë informacionin përkatës;
 - të konsultohet;
 - të shprehë mendimet e tij ose të saj.
2. Këtyre mendimeve, dëshirave dhe ndjenjave të konstatueshme të fëmijës u kushtohet vëmendja e duhur.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me marrëdhëniet

- Gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me marrëdhëniet, organet gjyqësore marrin të gjitha masat:
- a) për të siguruar që të dy prindërit të jenë informuar për rëndësinë e vendosjes dhe të mbajtjes së marrëdhënieve të rregullta me fëmijën e tyre, për fëmijën dhe për ata vetë;
 - b) për të nxitur prindërit dhe persona të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijën për të lidhur marrëveshje miqësore në lidhje me marrëdhëniet, sidomos duke përdorur ndërmjetësimin familjar ose ndonjë formë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
 - c) para marrjes së një vendimi, të sigurohen që disponojnë informacion të mjaftueshëm, sidomos nga ata që mbajnë përgjegjësinë familjare, me qëllim që të marrin një vendim në favor të interesave të larta të fëmijës, dhe, kur është e nevojshme, të marrin informacion shtesë nga organe ose personat e tjerë përkatës.

Neni 8

Marrëveshjet për marrëdhëniet

1. Shtetet palë nxisin, me anë të mjeteve që ata i konsiderojnë të përshtatshme, prindërit dhe personat e tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijën të repsektojnë parimet e parashikuara në nenet 4 deri 7 kur përpilojnë ose ndryshojnë marrëveshjet mbi marrëdhëniet në lidhje me një fëmijë. Këto marrëveshje duhet që mundësisht të bëhen me shkrim.
2. Me kërkesë, organet gjyqësore, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin e brendshëm, e konfirmojnë një marrëveshje mbi marrëdhëniet në lidhje me një fëmijë, përveç kur kjo është kundër interesave të larta të fëmijës.

Neni 9

Zbatimi i vendimeve në lidhje me marrëdhëniet

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që vendimet në lidhje me marrëdhëniet të zbatohen.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 10

Mbrojtja dhe garancitë që jepen në lidhje me marrëveshjet

1. Secili shtet palë parashikon dhe nxit zbatimin e mbrojtjes dhe garancive. Ai i komunikon, nëpërmjet organeve të tij qendrore, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, brenda tre muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet palë, të paktën tre kategori mbrojtjesh dhe garancish të parashikuara nga ligji i brendshëm përveç mbrojtjes dhe garancive të përmendura në paragrafin 3 të nenit 4 dhe në germën b të paragrafit 1 të nenit 14 të kësaj Konvente. Ndryshimi i mbrojtjes dhe garancive të dhëna komunikohet sa më parë që të jetë e mundur.

2. Kur e kërkojnë rrethanat e çështjes, organet gjyqësore në çdo kohë mund të marrin një vendim mbi marrëdhëniet që t'i nënshtrohet mbrojtjes dhe garancive për sigurimin e zbatimit të këtij vendimi, që fëmija të kthehet në fund të afatit të marrëdhënies në vendin ku ai ose ajo banon zakonisht, ose që ai ose ajo të mos lëvizet në mënyrë të parregullt.

a) Mbrojtja dhe garancitë për të siguruar që vendimi të zbatohet, mund të përfshijnë sidomos:

- mbikëqyrjen e marrëdhënies;
- detyrimin për një person të sigurojë shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të fëmijës dhe, nëse është e nevojshme, të çdo personi tjetër që e shoqëron fëmijën;
- një garanci, që depozitohet nga personi me të cilën fëmija banon rregullisht, për të siguruar që personi i cili kërkon marrëdhënie me fëmijën të mos pengohet për të hyrë në marrëdhënie;
- një gjobë që i vihet personit me të cilën fëmija banon zakonisht, nëse ky refuzon të përmbushë vendimin mbi marrëdhëniet.

b) Mbrojtja dhe garancitë për të siguruar kthimin e fëmijës ose parandalimin e kthimit të parregullt mund të përfshijnë sidomos:

- dorëzimin e pasaportave ose dokumenteve të identitetit dhe, kur është e nevojshme, një dokument që të tregojë se personi që kërkon të ketë marrëdhënie ka njoftuar organin kompetent konsullor për këtë dorëzim gjatë periudhës së marrëdhënies;

- garancitë financiare;
- barrët mbi pasurinë;
- detyrimet ose marrëveshjet para gjykatës;
- detyrimin e personit që ka marrëdhënie me fëmijën për t'u paraqitur së bashku me fëmijën rregullisht para një organi kompetent, si zyra për mirëqenien e rinisë ose një rajon policie, në vendin ku duhet të ushtrohet marrëdhënia;

- detyrimin e personit që kërkon të hyjë në marrëdhënie që të paraqesë një dokument të lëshuar nga shteti ku duhet të zhvillohet marrëdhënia, që të vërtetojë njohjen dhe deklarin e ekzekutueshmërisë së kujdestarisë ose të një vendimi mbi marrëdhëniet, ose të dyja, para se të merret vendimi për marrëdhëniet ose para se të fillojë marrëdhënia;

- caktimin e kushteve në lidhje me vendin ku duhet të zhvillohet marrëdhënia dhe, nëse është e nevojshme, regjistrimin në ndonjë sistem kombëtar ose ndërkufitar, të ndalimit që pengon fëmijën për t'u larguar nga shteti ku duhet të zhvillohet marrëdhënia.

3. Kjo mbrojtje dhe këto garanci janë të përcaktuara me shkrim ose të provuara me shkrim dhe janë pjesë e vendimit për marrëdhëniet ose marrëveshjes së konfirmuar.

4. Nëse mbrojtja dhe garancitë duhet të zbatohen në një shtet tjetër palë, organi gjyqësor mundësisht vendos mbrojtje dhe garanci të tilla të përshtatshme për t'u zbatuar në atë shtet palë.

KAPITULLI III

MASAT PËR TË NXITUR DHE PËRMIRËSUAR MARRËDHËNIET NDËRKUFITARE

Neni 11

Organet qendrore

1. Çdo shtet palë emëron një organ qendror për të kryer funksionet e parashikuara nga kjo Konventë në rastet e marrëdhënieve ndërkufitare.

2. Shtetet federale, shtetet me më shumë se një sistem ligjor ose shtetet që kanë pjesë territoriale autonome janë, të lira të emërojnë më shumë se një organ qendror dhe të përcaktojnë hapësirën territoriale dhe personale

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

të funksioneve të tyre. Kur një shtet ka emëruar më shumë se një organ qendror, ai emëron një organ qendror të cilit i dërgohet çdo korrespondencë për ta transmetuar tek organi përkatës qendror brenda atij shteti.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njoftohet për çdo emërim sipas këtij neni.

Neni 12

Detyrat e organeve qendrore

Organet qendrore të shteteve palë:

a) bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet organeve kompetente, duke përfshirë organet gjyqësore në vendet e tyre përkatëse për të arritur qëllimet e Konventës. Ata veprojnë me të gjithë shpejtësinë dhe efektivitetin e duhur;

b) me qëllim që të lehtësohet zbatimi i kësaj Konvente, pajisin, pas kërkesës përkatëse, njëri-tjetrin me informacion në lidhje me ligjet e brendshme që rregullojnë përgjegjësitë prindërore, duke përfshirë marrëdhëniet dhe me çdo informacion të detajuar në lidhje me mbrojtjen dhe garancitë përveç atyre të parashikuara sipas paragrafit 1 të nenit 10, dhe shërbimet e ofruara prej tyre (duke përfshirë shërbimet ligjore, të financuara me fonde publike ose të tjera), si dhe me informacione mbi çdo ndryshim në këto ligje dhe shërbime;

c) bëjnë të gjitha përpjekjet për të zbuluar vendndodhjen e fëmijës;

d) sigurojnë transmetimin e kërkesave për informacion që vijnë nga organet kompetente në lidhje me çështjet ligjore ose faktike mbi një gjykim të papërfunduar;

e) e mbajnë njëri-tjetrin të informuar për çdo vështirësi që mund të lindë gjatë zbatimit të Konventës dhe, nëse është e mundur, mënjanojnë pengesat për zbatimin e saj.

Neni 13

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Organet gjyqësore, organet qendrore dhe organet sociale dhe të tjera të shteteve palë përkatëse, duke vepruar brenda kompetencës së tyre, bashkëpunojnë në lidhje me gjykimet mbi marrëdhëniet ndërkufitare.

2. Organet qendrore ndihmojnë veçanërisht organet gjyqësore të shteteve palë për të komunikuar me njëri-tjetrin dhe në marrjen e informacionit dhe të ndihmës që është e nevojshme për të arritur objektivat e kësaj Konvente.

3. Në çështjet ndërkufitare, organet qendrore ndihmojnë fëmijët, prindërit dhe personat e tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijën sidomos për të filluar gjykimin në lidhje me marrëdhënien ndërkufitare.

Neni 14

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve për marrëdhëniet ndërkombëtare

1. Shtetet palë parashikojnë, duke përfshirë ato që kur është e mundur janë në përputhje me instrumentet ndërkombëtare:

a) një sistem për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të dhëna në shtetet e tjera palë në lidhje me marrëdhëniet dhe të drejtën e kujdestarisë;

b) një procedurë ku vendimet në lidhje me marrëdhëniet dhe të drejtën e kujdestarisë të dhënë në shtete të tjera palë të mund të njihen dhe të deklarohen të ekzekutueshme para se të ushtrohet marrëdhënia në shtetin pritës.

2. Nëse një shtet palë e kushtëzon një njohje apo ekzekutim ose të dyja bashkë për një vendim të huaj me ekzistencën e një marrëveshjeje ose të reciprocitetit, ai mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për njohjen ose ekzekutimin, apo të dyjave bashkë, të një vendimi të huaj për marrëdhëniet.

Neni 15

Kushtet për zbatimin e vendimeve për marrëdhëniet ndërkufitare

Organi gjyqësor i shtetit palë ku duhet të zbatohet një vendim mbi një marrëdhënie ndërkufitare të dhënë në një shtet tjetër palë, në momentin e njohjes ose të deklarimit të ekzekutueshmërisë së këtij vendimi për marrëdhëniet ose në një moment të mëvonshëm, mund të përcaktojë ose adoptojë kushtet për zbatimin e tij, si

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

dhe çdo mbrojtje ose garanci të lidhura me të, nëse kjo është e nevojshme për të lehtësuar ushtrimin e kësaj marrëdhënieje, me kusht që elementet thelbësore të vendimit të respektohen dhe të merren parasysh, sidomos ndryshimi i rrethanave dhe i marrëveshjeve të kryera nga personat e interesuar. Në asnjë rrethanë, vendimi i huaj nuk mund të rishikohet në themel.

Neni 16

Rikthimi i një fëmije

1. Kur një fëmijë nuk rikthehet në përfundim të një marrëdhënieje ndërkufitare në bazë të një vendimi mbi këtë marrëdhënie, organet kompetente, me kërkesë, sigurojnë rikthimin e menjëhershëm të fëmijës, dhe kur është e mundur duke zbatuar dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, të ligjit të brendshëm dhe, kur është e mundur, duke zbatuar mbrojtjen dhe garancitë sipas parashikimit të bërë në vendimin për marrëdhënien.

2. Një vendim për rikthimin e fëmijës merret, kur është e mundur, brenda gjashtë javëve nga data e bërjes së kërkesës për rikthimin.

Neni 17

Shpenzimet

Përveç shpenzimeve të riadhesimit, çdo shtet palë merr përsipër për të mos pretenduar ndonjë pagesë nga kërkesa në lidhje me çdo masë të marrë sipas kësaj Konvente nga vetë organet qendrore të atij shteti në emër të kërkuarit.

Neni 18

Kërkesat për gjuhën

1. Në varësi të çdo marrëveshjeje të veçantë të bërë ndërmjet organeve qendrore përkatëse:

a) korrespondenca e dërguar organit qendror të shtetit pritës përpilohet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të atij shteti, ose shoqërohet me një përkthim në këtë gjuhë.

b) organi qendror i shtetit pritës megjithatë pranon dhe korrespondencën në anglisht ose frëngjisht, ose të shoqëruar me një përkthim në një nga këto gjuhë.

2. Korrespondenca që del nga organi qendror i shtetit pritës, duke përfshirë edhe rezultatet e hetimeve të kryera, mund të bëhen në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të atij shteti, ose në anglisht apo frëngjisht.

3. Megjithatë, një shtet palë, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të kundërshtojë përdorimin e anglishtes ose të frëngjishtes sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni në çdo kërkesë, korrespondencë ose dokumente të tjera dërguar organeve qendrore.

KAPITULLI IV

RAPORTI ME INSTRUMENTET E TJERA

Neni 19

Raporti me Konventën europiane mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët

Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 11 të Konventës europiane të 20 majit 1980 (ETS nr.105) mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët nuk zbatohet në marrëdhëniet ndërmjet shteteve palë, të cilat janë gjithashtu shtete palë në këtë Konventë.

Neni 20

Raporti me instrumente të tjera

1. Kjo Konventë nuk cenon asnjë instrument tjetër ndërkombëtar në të cilën shtetet palë në këtë Konventë janë palë ose do të bëhen palë i cili përmban dispozita mbi çështje që janë rregulluar në këtë Konventë. Kjo Konventë nuk cenon sidomos zbatimin e instrumenteve të mëposhtme ligjore:

a) Konventën e Hagës të 5 tetorit 1961 mbi kompetencën e organeve dhe ligjin e zbatuar për mbrojtjen e të miturve.

b) Konventën europiane mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët të 20 majit 1980 sipas nenit 19 të mësipërm.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- c) Konventën e Hagës të 25 tetorit 1980 mbi aspektet civile të rrëmbimit të fëmijëve në nivel ndërkombëtar.
- d) Konventën e Hagës të 19 tetorit 1996 mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve.
2. Asgjë në këtë Konventë nuk i pengon palët të lidhin marrëveshje ndërkombëtare që plotësojnë ose zhvillojnë më tej dispozitat e kësaj Konvente apo që zgjerojnë sferën e zbatimit të tyre.
3. Në marrëdhëniet e tyre reciproke, shtetet palë që janë anëtare të Komunitetit Europian zbatojnë rregullat e Komunitetit dhe kështu nuk zbatojnë rregullat që rrjedhin nga kjo Konventë, përveç kur nuk ka rregull komunitar që të rregullojë lëndën në fjalë.

KAPITULLI V NDRYSHIMET E KONVENTËS

Neni 21 Ndryshimet

1. Çdo propozim për ndryshimin e kësaj Konvente të paraqitur nga një palë i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe ky i fundit ia paraqet këtë shteteve anëtare të Këshillit të Europës, çdo nënshkuresi, çdo shteti palë, Komunitetit Europian, çdo shteti të ftuar për ta nënshkruar këtë Konventë sipas dispozitave të nenit 22 dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë Konventë sipas dispozitave të nenit 23.
2. Çdo ndryshim i propozuar nga një palë i komunikohet Komitetit Europian për Bashkëpunimin Ligjor (KEBL), i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e tij mbi ndryshimin e propozuar.
3. Komiteti i Ministrave e merr në shqyrtim ndryshimin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga KEBL dhe, pas konsultimeve me palët e Konventës, të cilët nuk janë anëtarë të Këshillit të Europës, mund të miratojë ndryshimin.
4. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni u paraqitet për pranim palëve.
5. Çdo ndryshim i aprovuar në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmuor pas datës në të cilën të gjitha palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22 Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për t'u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e saj dhe nga Komuniteti Europian.
2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.
3. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës në të cilën tre shtete, duke përfshirë të paktën dy shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar Konventën në pajtim me dispozitat e paragrafit të mësipërm.
4. Në lidhje me çdo shtet të përmendur në paragrafin 1 ose me Komunitetin Europian i cili e shpreh më vonë pëlqimin e tij për të respektuar Konventën, kjo hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 23 Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimeve me palët, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në përpilimin e Konventës, të aderojë në këtë Konventë nëpërmjet një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20d të statutit të Këshillit të Europës dhe me votën unanime të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë drejtën e një vendi në Komitetin e Ministrave.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 24

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet ose Komunitet European, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose pjesët e territorit ku zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo palë në një datë të mëvonshme dhe nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës mund ta zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente për në çdo pjesë tjetër territori të përcaktuar në deklaratë dhe për ato marrëdhënie ndërkombëtare që ajo është e përgjegjshme dhe në emër të të cilit ajo është e autorizuar të marrë përsipër detyrime. Në lidhje me këtë pjesë territori, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo pjesë territori të përcaktuar në deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 25

Rezervat

Nuk mund të bëhet asnjë rezervë për dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 26

Denoncimi

1. Çdo Palë mund ta denoncojë këtë Konventë në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 27

Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës, çdo shtet nënshkrues, çdo shtet palë, Komunitetin European, çdo shtet të ftuar për të nënshkruar këtë Konventë sipas dispozitave të nenit 22 dhe çdo shtet të ftuar të aderojë në këtë Konventë në pajtim me dispozitat e nenit 23 për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas neneve 22 dhe 23;
- d) çdo ndryshim të miratuar sipas nenit 21 dhe datën në të cilën hyn në fuqi një ndryshim i tillë;
- e) çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të nenit 18;
- f) çdo denoncim të bërë sipas dispozitave të nenit 26;
- g) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër, sidomos ata që janë parashikuar në nenet 10 dhe 11 të kësaj Konvente.

Si dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në 15 maj 2003, në anglisht dhe frëngjisht të dyja tekstet njëloj të vlefshme në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e Konventës, Komunitetit European dhe çdo shteti që është ftuar të aderojë në këtë Konventë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

LIGJ

Nr.9443, datë 16.11.2005

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN "PËR JURIDIKSIONIN, LIGJIN E ZBATUESHËM, NJOHJEN, ZBATIMIN DHE BASHKËPUNIMIN, NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË PRINDËRORE DHE MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE"¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve", bërë në Hagë më 19 tetor 1996, me rezervat dhe deklaratimet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 29 të Konventës, autoriteti qendror për përmbushjen e detyrave të kësaj Konvente është Ministria e Drejtësisë.

Neni 3

Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 34 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se kërkesat, sipas paragrafit të parë të këtij neni, do t'u komunikohen autoriteteve të tij vetëm nëpërmjet autoritetit qendror.

Neni 4

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 60 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën e juridiksionit të autoriteteve të veta për të marrë masa për mbrojtjen e pasurisë së fëmijës në territorin e vet, si dhe rezervon të drejtën e mosnjohjes së një përgjegjësie prindërore apo të një mase për sa kohë nuk është në përputhje me ndonjë masë të marrë nga autoritetet e veta, në lidhje me këtë pasuri, siç është parashikuar në paragrafin e parë të nenit 55 të Konventës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4708, datë 30.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

KONVENTA

MBI JURIDIKSIONIN, LIGJIN E ZBATUESHËM, NJOHJEN, ZBATIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË PRINDËRORE DHE MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE
(lidhur më 19 tetor 1996)

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente, duke marrë në konsideratë nevojën për të përmirësuar mbrojtjen e fëmijëve në situatat ndërkombëtare;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 96*. Tiranë 2005. f. 3067.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

duke dëshiruar të shmangin konfliktet midis sistemeve të tyre ligjore në lidhje me juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijëve;

duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve;

duke konfirmuar se interesat e fëmijëve janë të një rëndësie parësore;

duke vërejtur se Konventa e 5 tetorit 1961, në lidhje me kompetencat e autoriteteve dhe ligjin e zbatueshëm për mbrojtjen e minoreneve, ka nevojë për rishikim;

duke dëshiruar të vendosin dispozita të përbashkëta për këtë qëllim, duke marrë në konsideratë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve të 20 nëntorit 1989, kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

KAPITULLI I FUSHA E VEPRIMIT TË KËSAJ KONVENTE

Neni 1

1. Objektivat e kësaj Konvente janë:

- a) të përcaktojë shtetin, autoritetet e të cilit kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve ose pasurisë së tyre;
- b) të përcaktojë se cili ligj duhet të zbatohet nga këto autoritete në ushtrimin e juridiksionit të tyre;
- c) të përcaktojë ligjin e zbatueshëm për përgjegjësinë prindërore;
- d) të parashikojë njohjen dhe zbatimin e këtyre masave mbrojtëse në të gjitha Shtetet Kontraktuese;
- e) të vendosë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të Shteteve Kontraktuese, sipas nevojës, në mënyrë që të përmbushen qëllimet e kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “përgjegjësi prindërore” nënkupton autoritetin prindëror ose çdo marrëdhënie të ngjashme të autoritetit që përcakton të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e prindërve, kujdestarëve ose përfaqësuesve të tjerë ligjorë në lidhje me fëmijën ose pasurinë e tij.

Neni 2

Kjo Konventë zbatohet për fëmijët nga momenti i lindjes deri në moshën 18 vjeç.

Neni 3

Masat e referuara në nenin 1 do të kenë lidhje, në veçanti, me:

- a) dhënien, ushtrimin, përfundimin ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore, si dhe delegimin e saj;
- b) të drejtat e kujdestarisë, duke përfshirë të drejtat në lidhje me kujdesin për fëmijën dhe, në veçanti, të drejtën për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës, si dhe të drejtat e hyrjes, duke përfshirë të drejtën për ta marrë fëmijën për një periudhë të kufizuar kohe, në një vend tjetër nga ai i banesës së përhershme të fëmijës;
- c) kujdestarinë dhe institucionet e ngjashme;
- d) planifikimin dhe funksionet e çdo personi apo organi që përfaqëson apo ndihmon fëmijën, që është përgjegjës për fëmijën ose pasurinë e tij;
- e) vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare nën kujdesin institucional, sigurimin e kujdesit *kafala* apo të një institucioni të ngjashëm;
- f) mbikëqyrjen nga një autoritet publik për kujdesin e treguar ndaj fëmijës nga çdo person që ka fëmijën nën përgjegjësinë e vet;
- g) administrimin, ruajtjen ose eliminimin e pasurisë së fëmijës.

Neni 4

Kjo Konventë nuk është e zbatueshme për:

- a) vendosjen ose kundërshtimin e marrëdhënies prind-fëmijë;
- b) vendimet mbi adoptimin, masat përgatitore për adoptim ose anulimin, apo revokimin e adoptimit;
- c) emrin dhe mbiemrin e fëmijës;
- d) emancipimin;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- e) detyrimet për mbajtjen;
- f) trustet apo vazhdimin e trashëgimisë;
- g) sigurimet shoqërore;
- h) masat publike të karakterit të përgjithshëm në çështjet e arsimit ose ato shëndetësore;
- i) masat e marra si rezultat i veprave penale të kryera nga fëmijët;
- j) vendimet mbi të drejtat e strehimit politik dhe ato mbi emigracionin.

KAPITULLI II JURIDIKSIONI

Neni 5

1. Autoritetet gjyqësore ose administrative të Shtetit Kontraktues, ku fëmija ka banesën e përhershme, kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës ose të pronës së tij.

2. Në bazë të nenit 7, në rast ndryshimi të banesës së përhershme të fëmijës në një Shtet tjetër Kontraktues, autoritetet e shtetit të banesës së re kanë juridiksion.

Neni 6

1. Për fëmijët emigrantë dhe fëmijët të cilët, për shkak të problemeve të ndodhura në vendin e tyre, janë zhvendosur në një shtet tjetër, autoritetet e Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit ndodhen këta fëmijë si rezultat i zhvendosjes së tyre, kanë juridiksionin e parashikuar në nenin 5 paragrafi 1.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm zbatohen gjithashtu për fëmijët, banesa e përhershme e të cilëve nuk mund të përcaktohet.

Neni 7

1. Në rast të ndonjë largimi apo mbajtjeje pa të drejtë të fëmijës, autoritetet e Shtetit Kontraktues në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm, menjëherë para largimit apo mbajtjes, ruajnë juridiksionin e tyre, derisa fëmija të ketë marrë një banesë të përhershme në çdo shtet tjetër:

a) çdo person, institut ose çdo organ tjetër që ka të drejtat e kujdestarisë, ka rënë dakord për largimin apo mbajtjen;

b) fëmija ka banuar në këtë shtet tjetër për një periudhë prej jo më pak se një vit pasi personi, instituti apo organi tjetër që ka të drejtat e kujdestarisë, ka ose duhet të ketë pasur dijeni për vendndodhjen e fëmijës, asnjë kërkesë për kthimin e bërë brenda kësaj periudhe nuk është pezull, dhe fëmija është vendosur në ambientin e ri të tij/të saj.

2. Largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohen të gabuara kur:

a) shkelin të drejtat e kujdestarisë që i jepen një personi, një institucioni apo ndonjë organi tjetër, kolektivisht ose individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm, menjëherë para largimit apo mbajtjes;

b) në kohën e largimit apo mbajtjes, kur këto të drejta ushtrohen, kolektivisht ose individualisht, ose duhet të ishin ushtruar në këtë mënyrë, me përjashtim të largimit apo mbajtjes.

Të drejtat e kujdestarisë të referuara në nënparagrafin “a” më sipër, mund të lindin veçanërisht përmes funksionimit të ligjit ose për shkak të një vendimi gjyqësor ose administrativ, apo për shkak të një marrëveshjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të këtij shteti.

3. Për sa kohë që autoritetet e përmendura së pari në paragrafin 1 e ruajnë juridiksionin e tyre, autoritetet e Shtetit Kontraktues, tek i cili fëmija është larguar ose në të cilin ai ose ajo është mbajtur, mund të marrin vetëm ato masa urgjente që, sipas nenit 11, janë të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës ose pronës së fëmijës.

Neni 8

1. Me anë të përjashtimit, autoriteti i Shtetit Kontraktues që ka juridiksion sipas nenit 5 ose 6, nëse gjykon se autoriteti i një Shteti tjetër Kontraktues do të vendosej më mirë në një rast të veçantë për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës:

- mund të kërkojë që autoriteti tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndihmën e autoritetit qendror të shtetit të tij, të marrë juridiksionin për të ndërmarrë këto masa mbrojtëse, si ta gjykojë të nevojshme;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- mund të pezullojë shqyrtimin e çështjes dhe të ftojë palët të paraqesin këtë kërkesë para autoritetit të këtij shteti tjetër.

2. Shtetet Kontraktuese, autoritetet e të cilëve mund të adresohen siç parashikohet në paragrafin e mësipërm, janë:

- a) një shtet, shtetas i të cilit është ky fëmijë;
- b) një shtet, në të cilin ndodhet pasuria e fëmijës;
- c) një shtet, autoritetet e të cilit janë në shqyrtim e sipër të një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të fëmijës ose për anulimin e martesës së tyre;
- d) një shtet, me të cilin fëmija ka lidhje të ngushta.

3. Autoritetet e interesuara mund të procedojnë për një shkëmbim mendimesh.

4. Autoriteti i adresuar, siç parashikohet në paragrafin 1, mund të marrë juridiksionin në vend të autoritetit që ka juridiksion sipas nenit 5 ose 6, nëse e gjykon se kjo është në të mirën e fëmijës.

Neni 9

1. Nëse autoritetet e një Shteti Kontraktues të referuara në nenin 8 paragrafi 2, në rastin e veçantë gjykojnë se janë në pozitë më të mirë për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës:

- mund t'i kërkojnë autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndihmën e autoritetit qendror të këtij shteti, që të autorizohen për të ushtruar juridiksionin për të marrë masa mbrojtëse, të cilat i gjykojnë të nevojshme;

- mund të ftojë palët të paraqesin këtë kërkesë para autoritetit të Shtetit Kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës.

2. Autoritetet e interesuara mund të procedojnë për një shkëmbim mendimesh.

3. Autoriteti që fillon bërjen e kërkesës mund të ushtrojë juridiksion në vend të Shtetit Kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës vetëm nëse ky autoritet e pranon kërkesën.

Neni 10

1. Pa asnjë paragjykim në lidhje me dispozitat e neneve 5-9, autoritetet e një Shteti Kontraktues, që ushtrojnë juridiksionin për të vendosur në lidhje me një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të një fëmije që është banor i përhershëm në një Shtet tjetër Kontraktues ose për anulimin e martesës së tyre, nëse e parashikon ligji i shtetit të tyre, mund të marrin masa për mbrojtjen e fëmijës apo të pasurisë së tij, nëse:

a) në kohën e fillimit të procedimit, njëri nga prindërit e tij ose të saj ka pasur banesë të përhershme në këtë shtet dhe njëri prej tyre ka përgjegjësi ligjore në lidhje me fëmijën;

b) juridiksioni i këtyre autoriteteve për të marrë këto masa është pranuar nga prindërit, si dhe nga ndonjë person tjetër i cili ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën dhe kur është në interes të fëmijës.

2. Juridiksioni i parashikuar në paragrafin 1 për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës ndërpritet nëse vendimi për të lejuar ose refuzuar kërkesën për divorc, ndarjen ligjore ose prishjen e martesës ka marrë formë të prerë, ose procedimi ka përfunduar për ndonjë arsye tjetër.

Neni 11

1. Në të gjitha rastet emergjente, autoritetet e ndonjë Shteti Kontraktues, në territorin e të cilit ndodhet fëmija ose prona që i përket fëmijës, ka juridiksion për të marrë masat e nevojshme mbrojtëse.

2. Masat e marra sipas paragrafit të mësipërm, për sa i përket një fëmije që është banor i përhershëm në Shtetin Kontraktues, do të shfuqizohen nëse autoritetet, të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5-10, kanë marrë masat që kërkojnë sipas rrethanave.

3. Masat e marra sipas paragrafit 1 në lidhje me fëmijën që është banor i përhershëm në një shtet jokontraktues, do të shfuqizohen në secilin Shtet Kontraktues, nëse masat e kërkuara sipas rrethanave dhe ato të marra nga autoritetet e një shteti tjetër njihen në Shtetin Kontraktues në fjalë.

Neni 12

1. Në bazë të nenit 7, autoritetet e një Shteti Kontraktues, në territorin e të cilit ndodhet fëmija ose prona që i përket fëmijës, kanë juridiksion për të marrë masa të një karakteri të përkohshëm për mbrojtjen e fëmijës ose

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

pronës së fëmijës, me efekt territorial të kufizuar në shtetin në fjalë, për sa kohë që këto masa nuk janë në mospërputhje me masat e marra tashmë nga autoritetet të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5-10.

2. Masat e marra sipas paragrafit të mësipërm, në lidhje me një fëmijë që është banor i përhershëm në një Shtet Kontraktues, do të shfuqizohen nëse autoritetet të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5-10 të kenë marrë një vendim në lidhje me masat mbrojtëse, të cilat mund të kërkojnë sipas rrethanave.

3. Masat e marra sipas paragrafit 1, në lidhje me një fëmijë i cili është banor i përhershëm në një shtet jokontraktues, do të shfuqizohen në Shtetin Kontraktues ku janë marrë masat, nëse masat e kërkuara nga rrethanat dhe të marra nga autoritetet e një shteti tjetër janë njohur në Shtetin Kontraktues në fjalë.

Neni 13

1. Autoritetet e një Shteti Kontraktues, të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5 deri në 10 për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së fëmijës, duhet të frenohen nga ushtrimi i këtij juridiksioni, nëse, në kohën e fillimit të procedimit, masat korresponduese janë kërkuar nga autoritetet e një Shteti tjetër Kontraktues që ka juridiksion sipas neneve 5-10 në kohën e kërkesës dhe janë akoma në proces shqyrtimi.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk do të zbatohen nëse autoritetet, para të cilave është paraqitur fillimisht kërkesa për marrjen e masave, nuk kanë juridiksion.

Neni 14

Masat e marra në zbatim të neneve 5-10 qëndrojnë në fuqi sipas afateve të tyre, edhe nëse një ndryshim rrethanash ka eliminuar bazën mbi të cilat është ngritur juridiksioni, për sa kohë që autoritetet, të cilat kanë juridiksion sipas Konventës, nuk kanë ndryshuar, zëvendësuar apo përfunduar këto masa.

KAPITULLI III LIGJI I ZBATUESHËM

Neni 15

1. Në ushtrimin e juridiksionit të tyre, sipas dispozitave të kapitullit II, autoritetet e Shteteve Kontraktuese do të zbatojnë ligjin e tyre.

2. Megjithatë, për sa kohë që mbrojtja e fëmijës ose e pasurisë së fëmijës e kërkon këtë, ato mund të zbatojnë përjashtimisht ose ta marrin në konsideratë ligjin e shtetit tjetër, me të cilin situata ka një lidhje thelbësore.

3. Nëse banesa e përhershme e fëmijës ndryshon në një Shtet tjetër Kontraktues, nga koha e ndryshimit, ligji i këtij shteti tjetër ka epërsi mbi kushtet e zbatimit të masave të marra në shtetin e ish-banesës së përhershme.

Neni 16

1. Dhënia ose shuarja e përgjegjësisë prindërore me anë të funksionimit të ligjit, pa ndërhyrjen e një autoriteti gjyqësor ose administrativ, udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së përhershme të fëmijës.

2. Dhënia ose shuarja e përgjegjësisë prindërore me anë të një marrëveshjeje ose akti të njëanshëm, pa ndërhyrjen e një autoriteti gjyqësor ose administrativ, udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së përhershme të fëmijës në kohën kur marrëveshja ose akti i njëanshëm bëhet i vlefshëm.

3. Përgjegjësia prindërore, e cila ekziston sipas ligjit të shtetit të banesës së përhershme të fëmijës, vazhdon të ekzistojë pas një ndryshimi të banesës së përhershme në një shtet tjetër.

4. Nëse banesa e përhershme e fëmijës ndryshon, dhënia e përgjegjësisë prindërore me anë të funksionimit të ligjit të një personi i cili tashmë nuk ka një përgjegjësi të tillë, udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së tij të re.

Neni 17

Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së përhershme të fëmijës. Nëse banesa e përhershme e fëmijës ndryshon, udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së re.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 18

Përgjegjësia prindërore e përmendur në nenin 16 mund të përfundojë, ose kushtet e ushtrimit të saj mund të modifikohen, me anë të masave të marra sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19

1. Vlefshmëria e një transaksioni midis një pale të tretë dhe një personi tjetër, i cili do të kishte të drejtë të vepronte si përfaqësuesi ligjor i fëmijës sipas ligjit të shtetit ku transaksioni është përfunduar, nuk mund të kundërshtohet dhe pala e tretë nuk mund të jetë përgjegjëse, për arsyen e vetme se personi tjetër nuk ka pasur të drejtë të vepronte si përfaqësuesi ligjor i fëmijës, sipas ligjit të përcaktuar nga dispozitat e këtij kapitulli, për sa kohë që pala e tretë e di ose duhet ta ketë ditur se përgjegjësia prindërore është udhëhequr nga ky ligj.

2. Paragrafi i mësipërm zbatohet vetëm nëse transaksioni është lidhur midis personave të pranishëm në territorin e të njëjtit shtet.

Neni 20

Dispozitat e këtij kapitulli zbatohen edhe nëse ligji i përcaktuar nga to është ligji i një shteti jokontraktues.

Neni 21

1. Në këtë kapitull, termi “ligj” nënkupton ligjin në fuqi në shtet, të ndryshëm nga zgjedhja e tij e dispozitave ligjore.

2. Megjithatë, nëse ligji i zbatueshëm sipas nenit 16 është ai i një shteti jokontraktues dhe nëse zgjedhja e dispozitave të ligjit të këtij shteti përcakton ligjin e një shteti tjetër jokontraktues, i cili do zbatonte ligjin e vet, zbatohet ligji i atij shteti. Nëse ky shtet tjetër jokontraktues nuk do të zbatonte ligjin e vet, ligji i zbatueshëm është ai i përcaktuar në nenin 16.

Neni 22

Zbatimi i ligjit të përcaktuar nga dispozitat e këtij kapitulli mund të refuzohet vetëm nëse ky zbatim do të ishte hapur kundër politikës publike, duke marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës.

KAPITULLI IV NJOHJA DHE ZBATIMI

Neni 23

1. Masat e marra nga autoritetet e një Shteti Kontraktues do të njihen nga funksionimi i ligjit në të gjitha Shtetet e tjera Kontraktuese.

2. Megjithatë, njohja mund të refuzohet:

a) nëse masa është marrë nga një autoritet, juridiksioni i të cilit nuk ishte bazuar në një nga kushtet e parashikuara në kapitullin II;

b) nëse është marrë masa, përveç ndonjë rasti urgjent, në kuptimin e një procedimi gjyqësor ose administrativ, pa iu dhënë mundësia fëmijës të dëgjohet, në shkelje të parimeve themelore të procedurës së shtetit të kërkuar;

c) me kërkesën e ndonjë personi që pretendon se masa e cenon përgjegjësinë prindërore të tij ose të saj, nëse kjo masë është marrë, përveç ndonjë rasti urgjent, pa iu dhënë mundësia personit të dëgjohet;

d) nëse kjo njohje është hapur kundër politikës publike të shtetit të kërkuar, duke marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës;

e) nëse masa nuk është në përputhje me një masë të mëvonshme të marrë në shtetin jokontraktues të banesës së përhershme të fëmijës, ku kjo masë e mëvonshme përmbush kërkesat për njohje në shtetin e kërkuar;

f) nëse procedura e parashikuar në nenin 33 nuk ka qenë në përputhje me to.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 24

Pa paragjykuar nenin 23 paragrafi 1, ndonjë person i interesuar mund të kërkojë nga autoritetet kompetente të një Shteti Kontraktues që ato të vendosin në lidhje me njohjen apo mosnjohjen e një mase të marrë në një Shtet tjetër Kontraktues. Procedura udhëhiqet nga ligji i shtetit të kërkuar.

Neni 25

Autoriteti i shtetit të kërkuar është i detyruar t'i bindet vendimeve në themel, mbi të cilat ka bazuar juridiksionin e tij autoriteti i shtetit ku është marrë masa.

Neni 26

1. Nëse masat e marra në një Shtet Kontraktues dhe të zbatueshme kërkojnë zbatim në një Shtet tjetër Kontraktues, ato do të deklarohen të zbatueshme ose të regjistruara për qëllim zbatimi në këtë shtet tjetër, sipas procedurës së parashikuar në ligjin e këtij shteti, me anë të kërkesës së një pale të interesuar.

2. Çdo Shtet Kontraktues do të zbatojë deklaratën e zbatueshmërisë ose të regjistrimit në një procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë.

3. Deklarata e zbatueshmërisë ose e regjistrimit mund të refuzohet vetëm për një nga arsyet e parashtruara në nenin 23 paragrafi 2.

Neni 27

Pa paragjykuar këtë rishikim, siç është i nevojshëm në zbatim të neneve të mësipërme, nuk do të ketë rishikim në themel të masave të marra.

Neni 28

Masat e marra në një Shtet Kontraktues dhe të deklaruara të zbatueshme ose të regjistruara për qëllim zbatimi në një Shtet tjetër Kontraktues, do të zbatohen në këtë shtet, sikur të ishin marrë nga autoritetet e këtij shteti. Zbatimi zhvillohet në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar në masën e parashikuar nga ky ligj, duke marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës.

KAPITULLI V BASHKËPUNIMI

Neni 29

1. Një Shtet Kontraktues do të caktojë një autoritet qendror për të kryer detyrat, të cilat janë vënë nga kjo Konventë për këto autoritete.

2. Shtetet federale, shtetet me më shumë se një sistem ligjor ose shtetet që kanë njësi autonome territoriale do të jenë të lira të caktojnë më shumë se një autoritet qendror dhe të përcaktojnë masën territoriale ose personale të funksioneve të tyre. Kur një shtet ka caktuar më shumë se një autoritet qendror, ai do të caktojë autoritetin qendror tek i cili mund të paraqitet ndonjë komunikim për transmetim tek autoriteti qendror përkatës brenda këtij shteti.

Neni 30

1. Autoritetet qendrore do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente në shtetet e tyre, për të përmbushur qëllimet e Konventës.

2. Ata, në lidhje me zbatimin e Konventës, do të marrin hapat e duhur për të siguruar informacion, sipas ligjeve dhe shërbimeve në dispozicion, në shtetet e tyre, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.

Neni 31

Autoriteti Qendror i një Shteti Kontraktues ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet autoriteteve publike apo organeve të tyre, duhet të marrin të gjithë hapat e nevojshëm:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) për të lehtësuar komunikimin dhe ofruar ndihmën e parashikuar në nenet 8 dhe 9 dhe në këtë kapitull;
- b) për të lehtësuar, me anë të ndërmjetësimit, pajtimit ose instrumenteve të tjera të ngjashme, zgjidhjet e miratuara për mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së fëmijës në situatat në të cilat zbatohet Konventa;
- c) me kërkesën e një autoriteti kompetent të një Shteti tjetër Kontraktues, të sigurojë asistencë për zbulimin e vendndodhjes, ku ka të ngjarë të jetë fëmija dhe për nevojën e mbrojtjes brenda territorit të shtetit të kërkuar.

Neni 32

Përmes një kërkesë të bërë me arsye të argumentuara përkatëse nga autoriteti qendror ose çdo autoritet tjetër kompetent i çdo Shteti Kontraktues, me të cilin fëmija ka lidhje të ngushtë, autoriteti qendror i Shtetit Kontraktues, në të cilin fëmija është banor i përhershëm dhe i pranishëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të autoriteteve publike apo organeve të tjera:

- a) mund të bëjë një raport në lidhje me situatën e fëmijës;
- b) mund t'i kërkojë autoritetit kompetent të shtetit të tij të marrë në konsideratë nevojën për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së fëmijës.

Neni 33

1. Nëse një autoritet që ka juridiksionin sipas neneve 5-10 e shqyrton me hollësi çështjen e vendosjes së fëmijës në një familje kujdestare ose nën kujdes institucional, apo në sigurimin e kujdesit *kafala* ose një institucion të ngjashëm dhe nëse kjo vendosje ose sigurim kujdesi zhvillohet në një Shtet tjetër Kontraktues, së pari do të konsultohet me autoritetin qendror ose çdo autoritet tjetër kompetent të këtij shteti. Për këtë qëllim, ai do të dërgojë një raport për fëmijën, së bashku me arsyet për vendosjen e propozuar ose sigurimin e kujdesit.

2. Vendimi në lidhje me vendosjen ose sigurimin e kujdesit mund të merret në shtetin kërkuar vetëm nëse autoriteti qendror ose autoriteti tjetër kompetent i shtetit të kërkuar ka miratuar vendosjen ose sigurimin e kujdesit, duke marrë në konsideratë interesat e fëmijës.

Neni 34

1. Kur reflektohet në lidhje me një masë mbrojtëse, nëse e kërkon situata e fëmijës, autoritetet kompetente sipas Konventës mund t'i kërkojnë çdo autoriteti ose ndonjë Shtet tjetër Kontraktues, i cili ka informacion mbi mbrojtjen e fëmijës, komunikimin e këtij informacioni.

2. Një Shtet Kontraktues mund të deklarojë se kërkesat sipas paragrafit 1 do t'i komunikohen autoriteteve të tij vetëm nëpërmjet autoritetit qendror të tij.

Neni 35

1. Autoritetet kompetente të një Shteti Kontraktues mund t'i kërkojnë autoriteteve të një Shteti tjetër Kontraktues të ndihmojnë në zbatimin e masave të mbrojtjes marrë sipas kësaj Konvente, veçanërisht në sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të hyrjes, si dhe të drejtën për të marrë kontakte të drejtpërdrejta dhe të rregullta.

2. Autoritetet e një Shteti Kontraktues, në të cilin fëmija nuk ka banesën e përhershme, me kërkesën e prindit që banon në atë shtet, i cili kërkon të krijojë apo mbajë lidhje me fëmijën, mund të mbledhin informacion ose të dhëna dhe të nxjerrin një përfundim mbi përshtatshmërinë e këtij prindi për të ushtruar të drejtat dhe mbi kushtet sipas të cilave duhet të ushtrohen këto të drejta. Një autoritet që ushtron juridiksionin, sipas neneve 5 deri në 10, për të përcaktuar një kërkesë në lidhje me të drejtat mbi fëmijën, duhet të deklarojë dhe ta marrë në konsideratë këtë informacion, këto fakte dhe këtë përfundim para se të marrë vendimin e saj.

3. Një autoritet që ka juridiksion, sipas neneve 5 deri në 10 për të vendosur mbi të drejtat, mund të shtyjë një procedim duke pezulluar rezultatin e një kërkesë të bërë sipas paragrafit 2, në veçanti, kur po merr në konsideratë një kërkesë për të kufizuar apo për t'i dhënë fund të drejtave të hyrjes të dhëna në shtetin e banesës së mëparshme të përhershme të fëmijës.

4. Asgjë në këtë nen nuk do ta ndalojë një autoritet që ka juridiksion, sipas neneve 5-10, të marrë masa të përkohshme duke pezulluar rezultatin e kërkesës së bërë sipas paragrafit 2.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 36

Në rast se fëmija është i ekspozuar ndaj një rreziku serioz, autoritetet kompetente të Shtetit Kontraktues, ku janë marrë masat për mbrojtjen e fëmijës ose janë në shqyrtim, nëse informohen se vendbanimi i fëmijës ka ndryshuar ose se fëmija ndodhet në një shtet tjetër, do të informojnë autoritetet e shtetit tjetër mbi rrezikun dhe masat e marra apo ato nën shqyrtim.

Neni 37

Një autoritet nuk do të kërkojë apo transmetojë ndonjë informacion sipas këtij kapitulli, nëse për këtë do t'i duhej, sipas gjykimit të saj, ta vinte fëmijën apo pasurinë e tij në rrezik apo të përbënte një kërcënim serioz të lirisë apo jetës së një anëtarit të familjes së fëmijës.

Neni 38

1. Pa paragjykuar mundësinë e vënies së tarifave të arsyeshme për sigurimin e shërbimeve, autoritetet qendrore dhe autoritetet e tjera publike të Shteteve Kontraktuese do të përballojnë shpenzimet e tyre në zbatimin e dispozitave të këtij kapitulli.

2. Një Shtet Kontraktues mund të hyjë në marrëveshje me një ose me shumë Shtete të tjera Kontraktuese në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë.

Neni 39

Çdo Shtet Kontraktues mund të hyjë në marrëveshje me një ose më shumë Shtete Kontraktuese, me qëllim përmirësimin e zbatimit të këtij kapitulli në marrëdhëniet e tyre reciproke. Shtetet të cilat kanë lidhur këtë marrëveshje, do t'i japin një kopje depozitarit të Konventës.

KAPITULLI VI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 40

1. Autoritetet e Shtetit Kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës ose të Shtetit Kontraktues ku është marrë masa e mbrojtjes, mund t'i japin personit që ka përgjegjësi prindërore ose personit të cilit i është besuar mbrojtja e fëmijës dhe e pasurisë së tij, një certifikatë, me kërkesën e tij apo të saj, që tregon cilësinë në të cilën ky person është i autorizuar të veprojë dhe kompetencat që i jepen atij apo asaj.

2. Cilësia dhe kompetencat e specifikuar në certifikatë supozohen t'i jepen këtij personi në mungesë të provës për rastin e kundërt.

3. Çdo Shtet Kontraktues do të caktojë autoritetet kompetente të bëjnë certifikatën.

Neni 41

Të dhënat personale të mbledhura ose të transmetuara sipas Konventës, do të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur apo transmetuar.

Neni 42

Autoritetet të cilat transmetohet informacioni do të sigurojnë konfidencialitet, në përputhje me ligjin e shtetit të tyre.

Neni 43

Të gjitha dokumentet e paraqitura apo të dorëzuara sipas kësaj Konvente do të përjashtohen nga legalizimi apo ndonjë formalitet i ngjashëm.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 44

Çdo Shtet Kontraktues mund të caktojë autoritetet të cilat paraqiten kërkesat sipas neneve 8, 9 dhe 33.

Neni 45

1. Përcaktimet e përmendura në nenet 29 dhe 44 do t'i komunikohen Zyrës së Përhershme të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.
2. Deklaratat e përmendura në nenin 34 paragrafi 2 do t'i bëhen depozitarit të Konventës.

Neni 46

Një Shtet Kontraktues, në të cilin sisteme të ndryshme ligjore ose kuadri ligjor zbatojnë mbrojtjen e fëmijës dhe të pasurisë së tij/saj, nuk do të jenë të detyruara të zbatojnë dispozitat e Konventës vetëm për konflikte midis këtyre sistemeve të ndryshme ose kuadrit ligjor.

Neni 47

Për sa i përket një shteti, në të cilin dy ose më shumë sisteme ligjore apo kuadër ligjor në lidhje me ndonjë çështje të trajtuar në këtë Konventë, zbatohen në njësi të ndryshme territoriale:

1. çdo referim për banesën e përhershme në këtë shtet do të interpretohet si referim për banesën e përhershme në një njësi territoriale;
2. çdo referim për praninë e fëmijës në këtë shtet do të interpretohet si referim për praninë në një njësi territoriale;
3. çdo referim për vendndodhjen e pasurisë së fëmijës në këtë shtet do të interpretohet si referim për vendndodhjen e pasurisë së fëmijës në një njësi territoriale;
4. çdo referim për shtetin nga i cili është fëmija do të interpretohet si referim ndaj njësisë territoriale të caktuar me ligjin e këtij shteti ose në mungesë të rregullave përkatëse, të njësive territoriale me të cilat fëmija ka pasur lidhje më të ngushtë;
5. çdo referim ndaj shtetit, autoritetet e të cilit janë në shqyrtim e sipër të një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të fëmijës ose për anulimin e martesës së tyre, do të interpretohet si referim ndaj njësive territoriale, autoritetet e të cilit janë në shqyrtim e sipër të kësaj kërkesë;
6. çdo referim ndaj shtetit me të cilin fëmija ka një lidhje thelbësore, do të interpretohet si referim ndaj njësive territoriale me të cilën fëmija ka këtë lidhje;
7. çdo referim ndaj shtetit tek i cili fëmija është larguar apo në të cilin ai apo ajo është mbajtur, do të interpretohet si referim ndaj njësive territoriale përkatëse tek e cila fëmija është larguar apo në të cilën ai apo ajo është mbajtur;
8. çdo referim ndaj organeve ose autoriteteve të këtij shteti, të tjera nga autoritetet qendrore, do të interpretohet si referim ndaj atyre të autorizuar për të vepruar në njësinë territoriale përkatëse;
9. çdo referim ndaj ligjit ose procedurës, ose autoritetit të shtetit në të cilin është marrë një masë, do të interpretohet si referim ndaj ligjit ose procedurës, ose autoritetit të njësive territoriale në të cilën është marrë kjo masë;
10. çdo referim ndaj ligjit ose procedurës, apo autoritetit të shtetit të kërkuar, do të interpretohet si referim ndaj ligjit ose procedurës, apo autoritetit të njësive territoriale në të cilën është kërkuar njohja apo zbatimi.

Neni 48

Për qëllime të identifikimit të ligjit të zbatueshëm sipas kapitullit III, në lidhje me një shtet i cili përfshin dy ose më shumë njësi territoriale, secila prej tyre ka sistemin e vet ligjor apo kuadrin ligjor, në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Konventë, zbatohen rregullat e mëposhtme:

- a) nëse ka rregulla në fuqi në këtë shtet, duke identifikuar se cili ligj i njësive territoriale është i zbatueshëm, zbatohet ligji i kësaj njësie;
- b) në mungesë të këtyre rregullave, zbatohet ligji i njësive territoriale përkatëse, siç përcaktohet në nenin 47.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 49

Për qëllim të identifikimit të ligjit të zbatueshëm sipas kapitullit III, në lidhje me një shtet i cili ka dy ose më shumë sisteme ligjore apo kuadër ligjor të ligjit të zbatueshëm për kategori të ndryshme personash në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Konventë, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

- a) nëse ka rregulla në fuqi në këtë shtet, duke identifikuar se cili nga këto ligje zbatohet, do të zbatohet ky ligj;
- b) në mungesë të këtyre rregullave, zbatohet ligji i sistemit ose kuadri ligjor, me të cilat fëmija ka lidhje më të afërt.

Neni 50

Kjo Konventë nuk do të cenojë zbatimin e Konventës së 25 tetorit 1980 mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës si midis palëve në të dyja konventat. Megjithatë, asgjë nuk përjashton dispozitat e kësaj Konvente nga nxitja për qëllime të sigurimit të kthimit të fëmijës, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë ose nga organizimi i të drejtave të hyrjes.

Neni 51

Për sa i përket Shteteve Kontraktuese, kjo Konventë zëvendëson Konventën e 5 tetorit të vitit 1961 mbi pushtetet e autoriteteve dhe të ligjit të zbatueshëm në lidhje me mbrojtjen e të miturve dhe Konventën që mbulon kujdestarinë e të miturve, nënshkruar në Hagë në 12 qershor 1902, pa paragjykim, për njohjen e masave të marra sipas Konventës së 5 tetorit 196, të përmendur më sipër.

Neni 52

1. Kjo Konventë nuk do të cenojë ndonjë instrument ndërkombëtar me të cilin Shtetet Kontraktuese janë palë dhe që përmbajnë dispozita në lidhje me çështjet e trajtuara nga Konventa, për sa kohë që është bërë një deklaratë tjetër nga Shtetet Palë në këtë instrument.

2. Kjo Konventë nuk cenon mundësinë për një apo më shumë Shtete Kontraktuese për të lidhur marrëveshje që përmbajnë dispozita mbi çështjet e trajtuara nga kjo Konventë, në lidhje me fëmijët që kanë banesë të përhershme në një nga Shtetet Palë në këto marrëveshje.

3. Marrëveshjet për t'u lidhur nga një apo më shumë Shtete Kontraktuese mbi çështje brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, nuk cenojnë zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente, në marrëdhëniet e këtyre shteteve me Shtete të tjera Kontraktuese.

4. Paragrafi i mësipërm zbatohet midis shteteve të interesuara edhe për ligjet uniformë të bazuara në lidhje të veçanta të natyrës rajonale apo të një natyre tjetër.

Neni 53

1. Kjo Konventë do të zbatohet masa vetëm nëse ato merren në një shtet pasi Konventa ka hyrë në fuqi për atë shtet.

2. Konventa do të zbatohet për njohjen dhe zbatimin e masave të marra pas hyrjes së saj në fuqi midis shtetit ku janë marrë masat dhe shtetit të kërkuar.

Neni 54

1. Ndonjë komunikim i dërguar autoritetit qendror apo ndonjë autoriteti tjetër të një Shteti Kontraktues do të jetë në gjuhën origjinale dhe do të shoqërohet me një përkthim në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit tjetër, ose, kur kjo nuk është e mundur, do të sigurohet një përkthim në gjuhën frenge ose angleze.

2. Megjithatë, një Shtet Kontraktues, duke bërë një rezervë në përputhje me nenin 60, mund të kundërshtojë përdorimin e gjuhës frënge ose angleze, por jo të të dyja gjuhëve.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 55

1. Në përputhje me nenin 60, një Shtet Kontraktues:
 - a) mund të rezervojë juridiksionin e autoriteteve të saj për të marrë masa mbi mbrojtjen e pasurisë së fëmijës të ndodhur në territorin e saj;
 - b) mund të rezervojë të drejtën e mosnjohjes së një përgjegjësie prindërore apo mase për sa kohë që nuk është në përputhje me ndonjë masë të marrë nga autoritetet e saj në lidhje me këtë pasuri.
2. Rezerva mund të kufizohet për kategori të caktuara të pasurisë.

Neni 56

Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private do të mbledhë rregullisht një komision special, me qëllim rishikimin e funksionimit praktik të Konventës.

KAPITULLI VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 57

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e tetëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private.
2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe instrumentet përkatëse të ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, që ka funksionin e depozitarit të kësaj Konvente.

Neni 58

1. Çdo Shtet tjetër mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 61 paragrafi i parë.
2. Instrumenti i aderimit depozitohet pranë depozitarit të kësaj Konvente.
3. Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe shteteve palë, të cilët nuk kanë paraqitur kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtë muajve nga marrja e njoftimit, parashikuar nga neni 63 pika b. Një kundërshtim i tillë mund të bëhet prej shteteve palë gjatë ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Konvente pas një aderimi. Për çdo kundërshtim do të njoftohet depozitari.

Neni 59

1. Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, miratimit ose aderimit, se Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale ose vetëm në një ose më shumë prej tyre. Ky shtet mund ta modifikojë këtë deklaratë duke dorëzuar një deklaratë tjetër në çdo kohë.
2. Çdo deklaratë e tillë do t'i njoftohet depozitarit duke deklaruar shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet kjo Konventë.
3. Nëse një shtet nuk bën asnjë deklaratë të tillë në përputhje me këte nen, kjo Konventë do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të këtij shteti.

Neni 60

1. Çdo shtet, në çastin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në kohën e paraqitjes së një deklarate në lidhje me nenin 59, mund të paraqesë një ose të dyja rezervat e parashikuara në nenin 54 paragrafi i dytë dhe nenin 55. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.
2. Çdo shtet palë në çdo kohë mund ta tërheqë këtë rezervë me një njoftim të drejtuar depozitarit.
3. Rezerva e humbet fuqinë dy muaj pas datës së dërgimit të njoftimit të referuar në paragrafin mësipërm.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 61

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit referuar në nenin 57.

2. Më pas ajo do të hyjë në fuqi:

a) për çdo shtet tjetër palë në proces ratifikimi, pranimi ose miratimi, tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit, të miratimit, ose të aderimit;

b) për çdo shtet aderues, tre muaj pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore parashikuar në paragrafin e tretë të nenit 58;

c) për një territor në të cilin Konventa është shtrirë në përputhje me nenin 59 tre muaj pas njoftimit të referuar në të njëjtin nen.

Neni 62

1. Çdo shtet palë në Konventë mund ta denoncojë atë përmes një njoftimi me shkrim të dërguar depozitarit. Ai mund të kufizohet për disa territore në të cilat zbatohet Konventa.

2. Denoncimi bëhet i efektshëm dymbëdhjetë muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit prej depozitarit. Në rast se hyrja në fuqi e denoncimit kërkon një periudhë më të gjatë kohe sipas specifikimit të bërë në njoftim, denoncimi bëhet i efektshëm pas përfundimit të kësaj periudhe.

Neni 63

Depozitari i njofton shtetet palë të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 58, sa më poshtë:

a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e parashikuara në nenin 57;

b) aderimet dhe kundërshtimet përkatëse të parashikuara në nenin 58;

c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 61;

d) deklaratimet e parashikuara në nenin 34 paragrafi i dytë dhe nenin 59;

e) marrëveshjet e parashikuara në nenin 39;

f) rezervat e parashikuara në nenin 54 paragrafi i dytë dhe nenin 55, si dhe tërheqjet e tyre të parashikuara në nenin 60 paragrafi i dytë;

g) denoncimet i referohen nenit 62.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 19 tetor 1996, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëllor të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Qeverisë holandeze, e cila, nëpërmjet kanaleve diplomatike, i dërgon një kopje të vërtetuar çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e tetëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën ndërkombëtare private.

LIGJ

Nr.9446, datë 24.11.2005

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR ASPEKTET CIVILE TË RRËMBIMIT NDËRKOMBËTAR TË FËMIJËS”¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 97*. Tiranë 2005. f. 3096.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”, bërë në Hagë më 25 tetor 1980, me rezervën e parashikuar në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 6 të Konventës, autoriteti qendror për përmbushjen e detyrave të kësaj Konvente është Ministria e Drejtësisë.

Neni 3

Në përputhje me nenin 42 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të mos jetë e detyruar të marrë përsipër ndonjë kosto, që parashikohet në paragrafin e tretë të nenit 26 të Konventës, si rezultat i pjesëmarrjes së konsulentit apo konsulentëve ligjorë ose nga procesi gjyqësor, vetëm deri në atë shkallë, që këto kosto mund të mbulohen nga sistemi i asistencës apo konsulencës ligjore.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4716, datë 8.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

KONVENTA

PËR ASPEKTET CIVILE TË RRËMBIMIT NDËRKOMBËTAR TË FËMIJËS

(lidhur në 25 tetor 1980)

Vendet nënshkruese të kësaj Konvente,
tërësisht të bindura se interesat e fëmijëve janë të një rëndësie të veçantë në çështjet që lidhen me kujdestarinë e tyre,

duke dëshiruar mbrojtjen ndërkombëtare të fëmijëve nga pasojat e dëmshme të largimit ose mbajtjes së tyre të padrejtë dhe për të krijuar procedura që sigurojnë kthimin e tyre të menjëhershëm në shtetin e banesës së tyre të përhershme, si dhe për të siguruar mbrojtje për të drejtat e kontaktit,

kanë vendosur të lidhin një Konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.

KAPITULLI I

FUSHA E VEPRIMIT TË KONVENTËS

Neni 1

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

- a) të sigurojë kthimin e shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në Shtetin Kontraktues;
- b) të sigurojë që të drejtat e kujdestarisë dhe të kontaktit sipas ligjit të një Shteti Kontraktues të respektohen efektivisht në Shtetet e tjera Kontraktuese.

Neni 2

Shtetet Kontraktuese duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar brenda territoreve të tyre përmbushjen e qëllimeve të Konventës. Për këtë qëllim, ato duhet të përdorin procedurat më të shpejta të mundshme.

Neni 3

Largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në rastet kur:

- a) konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë kolektivisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë kolektivisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes.

Të drejtat e kujdestarisë, të përmendura në nënparagrafin (a) më sipër, mund të lindin veçanërisht nga funksionimi i ligjit ose për shkak të një vendimi gjyqësor apo administrativ ose për shkak të një marrëveshjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të shtetit.

Neni 4

Konventa do të zbatohet për çdo fëmijë që ka qenë banor i përhershëm i Shtetit Kontraktues menjëherë para rastit të ndonjë shkeljeje kujdestarie apo të të drejtave të kontaktit. Konventa do të pushojë së zbatuari kur fëmija arrin moshën 16 vjeç.

Neni 5

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “të drejtat e kujdestarisë” do të përfshijnë të drejtat që lidhen me kujdesin e fëmijës dhe në veçanti, e drejta për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës;

b) “të drejtat e hyrjes” do të përfshijnë të drejtën për ta marrë fëmijën për një periudhë të kufizuar në një vend tjetër nga vendbanimi i tij i përhershëm.

KAPITULLI II AUTORITETET QENDRORE

Neni 6

Një Shtet Kontraktues do të autorizojë një autoritet qendror të përmbushë detyrat që Konventa u ka dhënë këtyre autoriteteve.

Shtetet federale, shtetet me më shumë se një sistem ligjor ose shtetet që kanë organizime territoriale autonome, do të jenë të lira të caktojnë më shumë se një autoritet qendror dhe të përcaktojnë shtrirjen territoriale të kompetencave të tyre.

Kur shteti ka caktuar më shumë se një autoritet qendror, do të autorizojë autoritetin qendror, tek i cili mund të dërgohen aplikimet për t’u përcjellë tek autoriteti i duhur qendror brenda këtij shteti.

Neni 7

Autoritetet qendrore do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe do të nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në shtetin e tyre përkatës, për të siguruar kthimin e shpejtë të fëmijëve dhe për të arritur objektivat e tjera të kësaj marrëveshjeje.

Në veçanti, qoftë në mënyrë direkte apo me anë të një ndërmjetësi, do të marrin të gjitha masat e duhura:

- a) për të zbuluar vendndodhjen e një fëmije, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë;
- b) për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm ndaj fëmijës ose paragjykimin të palët e interesuara duke marrë ose bërë që të merren masa të përkohshme;
- c) për të siguruar kthimin e vullnetshëm të fëmijës ose për të arritur një zgjidhje paqësore të çështjeve;
- d) për të shkëmbyer, aty ku duhet, informacion në lidhje me *backgroundin* social të fëmijës;
- e) për të siguruar informacion të karakterit të përgjithshëm sipas ligjit të shtetit të tyre, në lidhje me zbatimin e Konventës;
- f) për të filluar apo lehtësuar procedimin gjyqësor ose administrativ, me qëllim kthimin e fëmijës dhe në rastin e duhur, të bëjnë përgatitje për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit;
- g) siç e kërkojnë rrethanat, të sigurojnë ose lehtësojnë sigurimin e konsulencës dhe asistencës ligjore, duke përfshirë pjesëmarrjen e konsulentëve ligjorë;
- h) të marrin masat e nevojshme administrative, për të siguruar kthimin e sigurt të fëmijës;
- i) të informojnë njëri-tjetrin në lidhje me funksionimin e kësaj Konvente dhe sa të jetë e mundur, të eliminojnë pengesat ndaj zbatimit të saj.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

KAPITULLI III KTHIMI I FËMIJËVE

Neni 8

Çdo person, institucion apo organ tjetër që pretendon se një fëmijë është larguar apo mbajtur në shkelje të të drejtave të kujdestarisë, mund t'i drejtohet autoritetit qendror të vendbanimit të përhershëm të fëmijës ose autoritetit qendror të ndonjë Shteti tjetër Kontraktues për asistencë në sigurimin e kthimit të fëmijës.

Aplikimi do të përmbajë:

- a) informacion në lidhje me identitetin e aplikantit, të fëmijës dhe të personit që pretendon se ka larguar apo mbajtur fëmijën;
- b) kur kërkohet, data e lindjes së fëmijës;
- c) shkaqet mbi të cilat bazohet pretendimi i aplikantit për kthimin e fëmijës;
- d) një informacion të nevojshëm në lidhje me vendndodhjen e fëmijës dhe identitetin e personit me të cilin supozohet të jetë fëmija.

Aplikimi duhet të shoqërohet ose shtohet nga:

- e) një kopje e vërtetuar e ndonjë vendimi apo marrëveshjeje përkatëse;
- f) një certifikatë apo aktbetim që vjen nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës ose nga një person i kualifikuar, në lidhje me ligjin përkatës të këtij shteti;
- g) çdo dokument tjetër në interes të çështjes.

Neni 9

Nëse autoriteti qendror, i cili merr aplikimin e parashikuar në nenin 8, ka arsye të besojë se fëmija është në një Shtet tjetër Kontraktues, do t'ia transmetojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa vonesë aplikimin autoritetit qendror të këtij Shteti Kontraktues dhe do të informojë autoritetin qendror kërkues ose aplikantit, në vartësi të çështjes.

Neni 10

Autoriteti qendror i shtetit ku është fëmija do të marrë apo do të nxisë marrjen e masave të nevojshme, me qëllim sigurimin e kthimit të vullnetshëm të fëmijës.

Neni 11

Autoritetet gjyqësore apo administrative të Shteteve Kontraktuese do të shpejtojnë procedurat për kthimin e fëmijëve.

Nëse autoriteti përkatës administrativ apo gjyqësor nuk ka arritur një vendim brenda një periudhe gjashtë javore nga data e fillimit të procedimit, aplikanti ose autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, me iniciativën e vet ose nëse i kërkohet nga autoriteti qendror i shtetit kërkues, do të ketë të drejtën të kërkojë një deklaratë për shkaqet e vonesës. Nëse merret një përgjigje nga autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, ky autoritet do t'ia transmetojë, sipas rastit, përgjigjen autoritetit qendror të shtetit kërkues ose aplikantit.

Neni 12

Kur fëmija është larguar apo mbahet padrejtësisht, siç është parashikuar në nenin 3, dhe kur në datën e fillimit të procedimit para autoritetit gjyqësor apo administrativ të Shtetit Kontraktues ku është fëmija ka kaluar më pak se një vit nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë, autoriteti i interesuar do të urdhërojë kthimin e menjëhershëm të fëmijës.

Edhe kur procedimet kanë filluar pas mbarimit të periudhës së një viti, siç referohet në paragrafin e mësipërm, autoriteti gjyqësor apo administrativ do të urdhërojë kthimin e fëmijës, për sa kohë që nuk është provuar se fëmija tashmë është vendosur në një mjedis të ri të tij.

Nëse autoriteti gjyqësor apo administrativ në shtetin e kërkuar ka arsye të besojë se fëmija është çuar në një shtet tjetër, mund të shtyjë procedimet ose të pushojë aplikimin për kthimin e fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 13

Pavarësisht nga dispozitat e nenit të mësipërm, autoriteti gjyqësor apo administrativ i shtetit të kërkuar nuk është i detyruar të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse personi, institucioni apo organi tjetër që e kundërshton kthimin ose mbajtjen e tij, vendos që:

a) personi, institucioni apo organi tjetër që kujdeset për fëmijën nuk po ushtronin të drejtat e kujdestarisë në kohën e largimit apo mbajtjes ose kanë rënë dakord, ose si rrjedhojë të kenë pranuar në heshtje largimin apo mbajtjen;

b) ekziston rrezik serioz që kthimi i tij ose i saj ta ekspozojë fëmijën ndaj dëmit fizik ose psikologjik ose ta vërë fëmijën para një situatë të patolerueshme.

Autoriteti gjyqësor ose administrativ mund të refuzojë të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse zbulon se fëmija kundërshton të kthehet dhe ka arritur një moshë dhe një shkallë pjekurie, sipas së cilës është në gjendje të vendosë vetë për jetën e vet.

Në marrjen parasysh të rrethanave që i referohen këtij neni, autoritetet gjyqësore dhe administrative do të marrin në konsideratë informacionin në lidhje me bekgraundin social të fëmijës, të siguruar nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i vendbanimit të përhershëm të fëmijës.

Neni 14

Në përcaktimin nëse largimi apo mbajtja ka qenë e padrejtë brenda kuptimit të nenit 3, autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit të kërkuar, mund të marrin në konsideratë drejtpërsëdrejti ligjin dhe vendimet gjyqësore ose administrative, që njihen apo nuk njihen formalisht në shtetin e vendbanimit të përhershëm të fëmijës, pa rekurs ndaj procedurave specifike për provën e këtij ligji ose për njohjen e vendimeve të huaja, që do të zbatoheshin ndryshe.

Neni 15

Autoritetet gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues mund të kërkojnë para nxjerrjes së një urdhri për kthimin e fëmijës, që aplikanti të marrë nga autoritetet e shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës një vendim se largimi apo mbajtja ishte e padrejtë brenda kuptimit të nenit 3 të Konventës, kur një vendim i tillë mund të merret në këtë shtet. Autoritetet qendrore të Shteteve Kontraktuese do t'i ndihmojnë aplikantët të marrin praktikisht një vendim të tillë.

Neni 16

Pas marrjes së njoftimit për një largim apo mbajtje të padrejtë të fëmijës në kuptimin e nenit 3, autoritetet gjyqësore ose administrative të Shtetit Kontraktues, nga i cili fëmija është larguar apo mbajtur, nuk do të vendosin mbi thelbin e të drejtave të kujdestarisë, derisa të vendoset se fëmija nuk do të kthehet sipas kësaj Konvente ose nëse nuk bëhet një aplikim sipas kësaj Konvente, brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së njoftimit.

Neni 17

Fakti i vetëm që një vendim në lidhje me kujdestarinë është dhënë ose ka të drejtën e njohjes në shtetin e kërkuar, nuk do të përbëjë shkak për refuzimin e kthimit të fëmijës sipas kësaj Konvente, por autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit të kërkuar do të marrin parasysh shkaqet për këtë vendim në zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 18

Dispozitat e këtij kapitulli nuk do t'i kufizojnë kompetencat e një autoriteti gjyqësor ose administrativ për të urdhëruar kthimin e fëmijës në çdo kohë.

Neni 19

Një vendim sipas kësaj Konvente në lidhje me kthimin e fëmijës, nuk do të merret si vendim për thelbin e një çështjeje kujdestarie.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 20

Kthimi i fëmijës, sipas dispozitave të nenit 12, mund të refuzohet nëse nuk do lejohej nga parimet themelore të shtetit të kërkuar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

KAPITULLI IV TË DREJTAT E KONTAKTIT

Neni 21

Një aplikim për të marrë masa për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit, mund t'u paraqitet autoriteteve qendrore të Shteteve Kontraktuese, në të njëjtën mënyrë siç bëhet aplikimi për kthimin e fëmijës.

Autoritetet qendrore janë të detyruara nga detyrimet e bashkëpunimit, të cilat përcaktohen në nenin 7, të nxisin gëzimin paqësor të të drejtave të kontaktit dhe plotësimin e kushteve në të cilat mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave. Autoritetet qendrore do të ndërmarrin hapa për të shmangur, sa më shumë që të jetë e mundur, pengesat ndaj ushtrimit të këtyre të drejtave.

Autoritetet qendrore, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë me anë të ndërmjetësve, mund të iniciojnë ose ndihmojnë në fillimin e procedimit, me qëllim organizimin ose mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe sigurimin e respektimit të kushteve ndaj të cilave mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave.

KAPITULLI V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 22

Asnjë siguracion, obligacion apo depozitë, sido që të përshkruhen, nuk do të kërkojë garanci pagese kostosh dhe shpenzimesh në procedimin gjyqësor ose administrativ që janë brenda kompetencave të kësaj Konvente.

Neni 23

Asnjë legalizim apo formalitet i ngjashëm nuk do të kërkohet në kuptimin e kësaj Konvente.

Neni 24

Aplikimi, komunikimi apo ndonjë dokument tjetër i dërguar autoritetit qendror të shtetit të kërkuar do të jetë në gjuhën origjinale dhe do të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit të kërkuar ose, kur kjo nuk është e mundur, nga një përkthim në frëngjisht ose anglisht.

Megjithatë, një Shtet Kontraktues mundet, duke bërë një rezervë në përputhje me nenin 42, të kundërshtojë përdorimin e frëngjishtes apo të anglishtes, por jo të të dyjave, në ndonjë aplikim, komunikim apo dokument tjetër dërguar autoritetit të saj qendror.

Neni 25

Shtetasit e Shteteve Kontraktuese dhe personat që janë banorë të përhershëm të këtyre shteteve do t'u jepet e drejta për çështje që lidhen me zbatimin e kësaj Konvente për ndihmë dhe konsulencë ligjore në ndonjë Shtet tjetër Kontraktues në të njëjtat kushte sikur ata të ishin vetë shtetas dhe banorë të përhershëm të atij shteti.

Neni 26

Secili autoritet qendror do t'i përballojë vetë kostot për zbatimin e kësaj Konvente.

Autoritetet qendrore dhe shërbimet e tjera publike të Shteteve Kontraktuese nuk do të vënë tarifa në lidhje me aplikimet e dorëzuara sipas kësaj Konvente. Në veçanti, ato nuk mund të kërkojnë ndonjë pagesë nga aplikanti përkundrejt kostove dhe shpenzimeve të procedimit ose, kur është e zbatueshme, ato që rrjedhin nga pjesëmarrja e konsulentit ligjor. Megjithatë, ato mund të kërkojnë pagesën e shpenzimeve të rrjedhura ose që

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

rrjedhin nga mundësimi i kthimit të fëmijës.

Megjithatë, një Shtet Kontraktues mundet të deklarojë, duke bërë një rezervë në përputhje me nenin 42, se nuk do të jetë i detyruar të marrë përsipër ndonjë kosto që parashikohet në paragrafin e mësipërn, si rezultat i pjesëmarrjes së konsulentit apo konsulentëve ligjorë ose nga procesi gjyqësor, vetëm deri në atë shkallë që këto kosto të mund të mbulohen nga sistemi i tij i asistencës apo konsulencës ligjore.

Pas urdhërimit të kthimit të fëmijës ose daljes së urdhrit në lidhje me të drejtat e kontaktit sipas kësaj Konvente, autoritetet gjyqësore ose administrative munden, kur të jetë nevoja, të urdhërojnë personin që largoi apo mbajti fëmijën ose që pengoi ushtrimin e të drejtave të kontaktit, të paguajë shpenzimet e nevojshme që rrjedhin nga ose në emër të aplikantit, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit, ndonjë kosto rrjedhëse ose pagesa të bëra për vendosjen e fëmijës, kostot e përfaqësimit ligjor të aplikantit dhe ato të kthimit të fëmijës.

Neni 27

Kur provohet që kërkesat e kësaj Konvente nuk përmbushen ose që aplikimi nuk është i mirëbazuara, një autoritet qendror nuk është i detyruar të pranojë aplikimin. Në këtë rast, autoriteti qendror do ta informojë menjëherë, sipas rastit, aplikantin ose autoritetin qendror me anë të të cilit u dorëzua aplikimi, lidhur me shkaqet e tij.

Neni 28

Një autoritet qendror mund të kërkojë që aplikimi të shoqërohet nga një autorizim me shkrim duke e autorizuar atë të veprojë në emër të aplikantit ose duke caktuar një përfaqësues për të vepruar.

Neni 29

Kjo Konventë nuk do të pengojë asnjë person, institucion apo organ që pretendon se ka pasur shkelje të kujdestarisë apo të të drejtave të kontaktit brenda kuptimit të neneve 3 ose 21, të aplikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek autoritetet gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues, sipas apo në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 30

Aplikimi i dorëzuar autoriteteve qendrore ose drejtpërdrejt autoriteteve gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, së bashku me dokumentet dhe ndonjë informacion tjetër të bashkëngjitur ose të siguruar nga një autoritet qendror, do të ketë akses në gjykata ose tek autoritetet administrative të Shteteve Kontraktuese.

Neni 31

Përsa i përket një shteti, i cili në çështjet e kujdestarisë së fëmijëve ka dy ose më shumë sisteme të ligjit të zbatueshëm në njësi të ndryshme territoriale:

a) ndonjë referim ndaj banesës së përhershme në këtë shtet do të interpretohet sikur t'i referohej banesës së përhershme në një njësi territoriale të këtij shteti;

b) ndonjë referim ndaj ligjit të shtetit të banesës së përhershme do të interpretohet sikur t'i referohej ligjit të njësisë territoriale në atë shtet ku fëmija banon.

Neni 32

Përsa i përket një shteti, i cili në çështjet e kujdestarisë së fëmijëve ka dy ose më shumë sisteme të ligjit të zbatueshëm në kategori të ndryshme personash, ndonjë referim ndaj ligjit të këtij shteti do të interpretohet sikur t'i referohej sistemit ligjor të përcaktuar nga ligji i atij shteti.

Neni 33

Një shtet, brenda të cilit, njësi të ndryshme territoriale kanë legjislacionin e tyre në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve, nuk do të jetë i detyruar të zbatojë këtë Konventë, kur një shtet me sistem të unifikuar ligjor nuk do të ishte i detyruar ta bënte një gjë të tillë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 34

Kjo Konventë do t'u japë përparësi çështjeve brenda fushës së saj sipas konventës së 5 tetorit 1961, në lidhje me kompetencat e autoriteteve dhe ligjit të zbatueshëm mbi mbrojtjen e minorenëve, si ndërmjet palëve të të dyja konventave. Në rast të kundërt, kjo Konventë nuk do të kufizojë zbatimin e një instrumenti ndërkombëtar në fuqi midis shtetit të origjinës dhe shtetit të adresuar ose ligjit tjetër të shtetit të adresuar për qëllimet e sigurimit të kthimit të fëmijës që është larguar apo mbajtur pa të drejtë ose të organizimit të të drejtave të kontaktit.

Neni 35

Kjo Konventë do të zbatohet midis Shteteve Kontraktuese vetëm në rast largimesh apo mbajtjeve të padrejta që ndodhin pas hyrjes së saj në fuqi në ato shtete.

Kur një deklaram është bërë sipas neneve 39 ose 40, referimi ndaj një shteti kontraktues në paragrafin e mësipërm do t'i referohet njësisë ose njësive territoriale ndaj të cilave zbatohet kjo Konventë.

Neni 36

Asgjë në këtë Konventë nuk do të pengojë dy ose më shumë Shtete Kontraktuese, me qëllim ngushtimin e kufizimeve ndaj të cilave mund të jetë objekt kthimi i fëmijës, nga marrëveshja ndërmjet tyre për të hequr ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, e cila mund të nënkuptojë një kufizim të tillë.

KAPITULLI VI DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 37

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e katërmëbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe instrumentet përkatëse të ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 38

Çdo shtet tjetër mund të aderojë në këtë Konventë.

Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Konventa do të hyjë në fuqi për një shtet që e ka miratuar ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të saj të hyrjes.

Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe shteteve palë që do të kenë deklaruar pranimin e tyre në lidhje me këtë hyrje. Një deklaratë e tillë duhet të bëhet edhe nga çdo shtet anëtar që ratifikon, pranon apo miraton Konventën pas aderimit. Kjo deklaratë do të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës.

Kjo ministri do t'i dorëzojë secilit prej Shteteve Kontraktuese një kopje të vërtetuar nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Konventa do të hyjë në fuqi midis shtetit aderues dhe shtetit që ka deklaruar pranimin e aderimit të saj ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të deklaratës së pranimit.

Neni 39

Çdo shtet deklaron shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar, apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë bëhet efektive në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Çdo deklaratë, si dhe çdo shtrirje tjetër e mëvonshme, i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 40

Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, miratimit ose aderimit se Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale ose vetëm në një ose më shumë prej tyre. Ky shtet mund ta modifikojë këtë deklaratë duke dorëzuar një deklaratë tjetër në çdo kohë.

Çdo deklaratë e tillë do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, duke deklaruar shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet kjo Konventë.

Neni 41

Kur Shteti Kontraktues ka një sistem qeverisës, sipas të cilit, pushtetet ekzekutive, gjyqësore dhe legjislative shpërndahen midis autoriteteve qendrore dhe atyre të tjera brenda këtij shteti, nënshkrimi i tij, ratifikimi, pranimi, miratimi, hyrja në këtë Konventë ose bërja e ndonjë deklaratë në lidhje me nenin 40, nuk do të sjellë ndërlikime në shpërndarjen e brendshme të pushteteve brenda këtij shteti.

Neni 42

Çdo shtet mundet, në çastin e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në kohën e paraqitjes së një deklaratë në lidhje me nenet 39 ose 40, të paraqesë një ose të dyja rezervat e parashikuara në nenin 24 dhe nenin 26, paragrafi i tretë. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

Çdo shtet palë mundet në çdo kohë ta tërheqë këtë rezervë me një njoftim të drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Rezerva nuk do të ketë më efekt ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas njoftimit të referuar në paragrafin paraardhës.

Neni 43

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, të pranimi, të miratimit ose të aderimit, referuar në nenet 37 dhe 38.

Më pas ajo do të hyjë në fuqi:

1. Për çdo shtet tjetër palë në proces ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimi, të miratimit ose të aderimit.

2. Për një territor në të cilin Konventa është shtrirë në përputhje me nenet 39 dhe 40, ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas njoftimit të referuar në të njëjtin nen.

Neni 44

Kjo Konventë ka një kohëzgjatje 5-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 43, përfshi edhe shtetet që e kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Nëse nuk ka denoncime, Konventa rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës të paktën 6 muaj përpara përfundimit të periudhës prej 5 vjetësh. Ai mund të kufizohet për disa ose për të tëra territoret në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi ka efekt vetëm për shtetin që e paraqet. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera palë.

Neni 45

Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës u njofton shteteve palë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 38, sa më poshtë:

- a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e parashikuara në nenin 37;
- b) aderimet e parashikuara në nenin 38;
- c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 43;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- d) shtrirjet e parashikuara në nenin 39;
- e) deklaratimet e parashikuara në nenin 38 dhe nenin 40;
- f) rezervat e parashikuara në nenin 24 dhe nenin 26, paragrafi i tretë, si dhe tërheqjet e tyre të referuara në nenin 42;
- g) denoncimet e referuara në nenin 44.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 25.10.1980, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëloj të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Qeverisë Holandeze, prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në Sesionin e Katërmëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

LIGJ

Nr.9544, datë 29.5.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR MBROJTJEN DHE ASISTENCËN E FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT”¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktima të trafikimit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4935, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS GREKE PËR MBROJTJEN DHE ASISTENCËN E FËMIJËVE, VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Greke, më poshtë referuar si Palët Kontraktuese, të udhëhequr nga dëshira për të bashkëpunuar, zbatuar dhe respektuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare përkatëse, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, shprehin solidaritetin dhe përkushtimin e tyre për të luftuar trafikimin e fëmijëve dhe çdo formë të shfrytëzimit të fëmijëve;

duke marrë në konsideratë, që fëmijët e pashoqëruar, në parim janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj trafikimit dhe kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë;

duke kërkuar, në bazë të reciprocitetit dhe të një fryme bashkëpunimi të ndërsjellë, të merren me fenomenin e trafikimit të fëmijëve;

duke konsideruar prioritet mbrojtjen e viktimave fëmijë të trafikimit;

duke synuar, bazuar në reciprocitet dhe frymë bashkëpunimi, krijimin e kuadrit të duhur ligjor për zbatimin e

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 63*. Tiranë 2006. f. 1731.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

procedurave dhe strukturave të posaçme për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve të trafikuar;

duke pranuar që mënyra më efektive për të parandaluar trafikimin e fëmijëve është eliminimi i shkaqeve-origjinë;

duke pranuar që interesi më i lartë i viktimës fëmijë, të trafikimit do të jetë gjithmonë një konsideratë kyçe;

duke marrë në konsideratë, konventat përkatëse të ratifikuara nga të dyja Palët Kontraktuese dhe më specifikisht, Konventën Europiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950), Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër Grave (1979) dhe Konventën e ILO-s mbi ndalimin dhe veprimin e menjëhershëm për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijës nr.C182 (1999);

duke marrë në konsideratë, konventat ndërkombëtare specifike të nënshkruara nga të dyja Palët Kontraktuese, të tilla si Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (2000) dhe Protokollin mbi parandalimin, kontrollin dhe ndëshkimin e trafikimit në njerëz, veçanërisht gra dhe fëmijë, të cilat plotësohen nga Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (2000);

duke marrë në konsideratë protokollin jo të detyrueshëm të Konventës për të drejtat e fëmijës, për shitjen e fëmijës, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijës (2000), Konventën e Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës (1980),

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1.1 Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi, Palët bien dakord për përkufizimet e mëposhtme të termave të përdorur këtu:

“Trafikimi i fëmijëve” do të kuptojë rekrutimin, transportimin, transferimin, mbajtjen ose pranimin e një fëmije, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këtë person, me qëllim shfrytëzimin e këtij fëmije. Pëlqimi indirekt ose real i fëmijës është i papranueshëm.

“Trafikant” do të kuptojë personin përgjegjës për trafikimin e fëmijëve. Koncepti i trafikantit do të përfshijë gjithashtu persona juridikë, në përputhje me dispozitat e nenit 4 të vendimit kuadër të Këshillit të BE-së të 19 korrikut 2002, për luftën e trafikut të qenieve njerëzore (2002/629/JHA).

“Shfrytëzimi” do të përfshijë shfrytëzimin e prostitucionit të fëmijëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, punët ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen apo transferimin e organeve.

“Fëmijë viktimë e trafikimit” do të kuptojë çdo person nën moshën 18 vjeç, kundër të cilit është kryer akti i trafikimit siç përcaktohet në këtë nen. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, një fëmijë do të konsiderohet madhor në datën kur ai/ajo mbush 18 vjeç. Në rastin kur data e saktë e lindjes nuk është e ditur, fëmija konsiderohet madhor më 31 dhjetor të vitit të ditëlindjes së tij të 18-të. Në rast se mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet që personi është një fëmijë, ky person duhet të konsiderohet fëmijë dhe duhet të përfutojë nga kjo marrëveshje, derisa mosha e personit të jetë përcaktuar plotësisht.

“Fëmijë-viktimë potenciale e trafikimit” do t'i referohet fëmijës që ndodhet në një situatë serioze, konkrete dhe të pranishme, si rezultat i së cilës fëmija ballafaqohet me rrezikun e të kthyerit në fëmijë të trafikuar, siç përshkruhet më sipër.

Me “fëmijë të pashoqëruar” nënkuptojmë personin nën moshën 18 vjeç, i cili jeton në territorin e një prej Palëve Kontraktuese, i ndarë nga prindërit dhe jo nën kujdestarinë e një madhori. Fëmijët e pashoqëruar duhet të përfutojnë nga mbrojtja që ofrojnë nenet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje në rastin e kualifikimit si fëmijë-viktimë.

Me “personin që ka kujdestarinë e fëmijës” nënkuptojmë prindin ose personin që përfaqëson fëmijën, falë cilësive të veçanta që i jepen nga ligjet e vendit ku ka fituar kujdestarinë.

“Kujdesar i përkohshëm” do të kuptojë personin përgjegjës për fëmijën deri në zbatimin e një zgjidhjeje të përhershme.

“Rregulloret e emigracionit” do të kuptojnë dispozitat ligjore, të cilat lejojnë lëshimin e lejeve të qëndrimit për viktimat fëmijë, të cilët qëndrojnë në qendra sociale, për të ndjekur një program social integrim.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

I. NDJEKJA PENALE

Neni 2

Harmonizim efektiv i përkufizimit të krimeve dhe procedurave. Bashkëpunim bazuar në parimet dhe metodat e pranuar nga të dyja palët

2.1 Palët Kontraktuese bien dakord që, në kuadër të sistemeve të tyre ligjore kombëtare dhe kur të kërkohet:

- a) do të vendosen sanksione të veçanta për trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve,
- b) do të penalizohet tentativa, bashkëpunimi dhe nxitja morale, lidhur me krimin e trafikimit të fëmijëve,
- c) do të institucionalizohet përgjegjësia ligjore e personave juridikë të përfshirë në trafikimin e fëmijëve,
- d) do të hyjnë në fuqi dispozita që përligjin ndalimin, konfiskimin dhe masat administrative kundër trafikantëve,

e) do të miratohen dispozita që paracaktjnë konfiskimin e të gjitha objekteve në pronësi të trafikantëve, të cilat ishin përdorur për trafikim, pavarësisht nga fakti që trafikantët janë pronarët e tyre,

f) do të hartohen ligje, të cilat ndalojnë shfaqjen e neglizhencave të rënda nga ana e personit, i cili ka kujdestarinë e fëmijës, apo dhënien e fëmijës një personi tjetër në shkëmbim të parave ose për qëllime përfitimi, dhe do të merren masa kundër punëdhënësve që punësojnë fëmijë-viktima,

g) legjislacioni për mbrojtjen e dëshmitarëve fëmijë do të harmonizohet në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2.2 Palët Kontraktuese bien dakord të miratojnë rregullore të emigracionit në lidhje me lëshimin e lejeve të qëndrimit për fëmijët-viktima në përputhje me nenin 9.4.

Neni 3

Veprim dhe bashkëpunim ndërmjet autoriteteve policore

3.1 Palët Kontraktuese marrin përsipër të miratojnë masa efektive, nëse këto masa nuk ekzistojnë, për themelimin ose funksionimin e njësisë antitrafik në strukturën e autoriteteve të përshtatshme policore, të përbëra nga personel i trajnuar, që punon me kohë të plotë, për mbrojtjen e fëmijëve.

3.2 Pas marrjes në konsideratë të marrëveshjeve dypalëshe përkatëse për bashkëpunimin policor ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe më specifikisht, marrëveshjes së bashkëpunimit të Ministrive të Rendit Publik për çështje të kompetencave të tyre, të datës 17 korrik 1992, është rënë dakord që ky bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni do të azhurnohet me qëllim luftën ndaj trafikimit të fëmijëve, falë miratimit të protokolleve shtesë për zbatimin e Marrëveshjes.

Protokolle të tilla shtesë mund të përfshijnë:

a) hartimin e standardeve të përbashkëta për mbledhjen e rregullt dhe efçente të informacionit, si dhe shkëmbimet statistikore lidhur me trafikimin e fëmijëve dhe e të gjitha formave të shfrytëzimit, përsa i përket personit që kryen trafikimin, metodave dhe rrugëve të përdorura,

b) krijimin e bazave të dhënave të referencës në pikat e kalimit të kufirit, sipas dispozitave të garantimit të sigurisë së plotë të të dhënave personale që do të futen në bazën e të dhënave,

c) vendosjen e vlerësimeve dypalëshe në lidhje me përshtatshmërinë e masave të kontrollit të kufirit lidhur me fëmijët,

d) trajnimin dhe koordinimin e procedurave të përbashkëta që do të aplikohen në kalimet kufitare, duke synuar përmirësimin e aftësive të personelit të kontrollit të kufirit për të identifikuar fëmijët-viktima të mundshëm dhe trafikuesit, si dhe rregullimin e procedurave të trajtimit fillestar të fëmijëve nga personeli i kontrollit të kufirit,

e) forcimi i kontroleve të kufirit, deri në masën e nevojshme që kërkon parandalimi i trafikimit të fëmijëve, subjekt i angazhimeve ndërkombëtare në lidhje me lëvizjen e lirë të njerëzve,

f) miratimi i masave të kontrollit të kufirit, të tilla si ndalimi i hyrjes, revokimi i vizës dhe burgimi i përkohshëm i mundshëm, për persona të përfshirë në trafikimin e fëmijëve,

g) miratimi i rregulloreve për të cilat është rënë dakord nga të dyja palët lidhur me riatdhesimin në kufi dhe procedurat vepruese, në përputhje me nenin 11,

h) trajnime të mundshme të oficerëve të kontrollit të kufirit, oficerëve të policisë, prokurorëve, gjykatësve, oficerëve të emigracionit dhe të gjithë zyrtarëve kompetentë në të gjitha çështjet e trafikimit të fëmijëve, përfshirë identifikimin,

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

i) monitorimi i asistencës së dhënë fëmijëve-viktima pas riatdhesimit të tyre, përfshirë kushtet e tyre të jetesës dhe kushtet e ribashkimit të fëmijëve me familjet e tyre.

3.3 Palët Kontraktuese bien dakord të përdorin kanale komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve policore dhe ambasadave e konsullatave respektive, me qëllim garantimin e shpejtë të vlefshmërisë dhe të ligjshmërisë së dokumenteve të udhëtimit, provës së identitetit dhe të të dhënave personale, kur ka dyshime të arsyeshme rreth përdorimit të këtyre dokumenteve në trafikimin e fëmijëve.

3.4 Për zbatimin e duhur të këtij neni, të dyja Palët Kontraktuese do të krijojnë pika të posaçme kontakti brenda autoriteteve të tyre policore.

II. PARANDALIMI

Neni 4

Politikat financiare dhe sociale në trajtimin e shkaqeve të origjinës së trafikimit të fëmijëve

4.1 Palët Kontraktuese bien dakord të zbatojnë politika efektive ekonomike dhe sociale në lidhje me grupet më të ndjeshme, duke synuar eliminimin e varfërisë dhe krijimin e mundësive reale, të cilat do të parandalojnë shkaqet themelore të trafikimit të fëmijëve që në origjinën e tyre. Të tilla politika do të synojnë:

- a) përmirësimin e aksesit të fëmijëve në mundësitë për arsimim dhe trajnim profesional,
- b) rritjen e përqindjes së ndjekjes së shkollës dhe trajnimit profesional, veçanërisht për vajzat dhe fëmijët e huaj,
- c) trajtimi i problemit të punës së pambrojtur, informale dhe jo të ligjshme të fëmijëve.

4.2 Palët Kontraktuese marrin përsipër të informojnë njëra-tjetrën për masat e veçanta që merren dhe zbatohen duke synuar grupet shoqërore të mësipërme.

4.3 Palët Kontraktuese do të ekzaminojnë rregullisht efektivitetin e aplikimit të këtyre masave dhe do të bien dakord për të proceduar për përmirësimin e tyre të mëtejshëm.

Neni 5

Rritja e ndërgjegjësimit

5.1 Palët Kontraktuese bien dakord që, me qëllim parandalimin në mënyrë efektive të trafikimit të fëmijëve (në rast se mungojnë të tilla masa parandaluese), është e nevojshme që shoqëria në përgjithësi dhe grupet e synuara në veçanti, të ndërgjegjësohen për trafikimin e fëmijëve. Në këtë kuadër, Palët Kontraktuese marrin përsipër:

a) të ndërmarrin një fushatë informative për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me trafikimin e fëmijëve dhe për format e ndryshme të manifestimit të tij në Palët Kontraktuese, në bashkëpunim me shoqërinë civile, organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare të përfshira në aktivitete për mbrojtjen e fëmijëve dhe me aktorë joshkëllorë. Secila Palë Kontraktuese do të marrë përsipër koston e fushatës informative në territorin e vet;

b) të ndërgjegjësojnë grupe të tjera kompetente, si hartuesit e politikave, personelin e policisë dhe profesionistë të tjerë kompetentë, si p.sh. shërbimet mjekësore dhe sociale, shërbimet e punësimit dhe sektori publik për trafikimin e fëmijëve në mënyrë që të rritet gatishmëria e tyre për të trajtuar siç duhet trafikimin e fëmijëve dhe për të forcuar potencialin e tyre institucional me qëllim luftën kundër trafikimit të fëmijëve;

c) të ndërgjegjësojnë publikun për arsimin e detyruar, për sanksionet ndaj personave që kanë kujdestarinë e fëmijës dhe nuk e çojnë këtë fëmijë në shkollë, si dhe për ndalimin e punës së fëmijëve;

d) të trajtojnë nevojën për të reduktuar kërkesën për aktivitete që kanë lidhje me fëmijë të trafikuar, si p.sh. lypja, shfrytëzimi seksual, puna e detyruar, skllavëria ose praktika të ngjashme dhe të promovojnë parimin e tolerancës zero për të gjitha format e trafikimit të fëmijëve;

e) të krijojnë dhe të reklamojnë në mënyrë efektive linja telefonike emergjente, nëpërmjet të cilave fëmijëve-viktima t'u afrohet këshillim dhe udhëzime, dhe të cilat do të lehtësojnë kallëzimet anonime për trafikimin e fëmijëve.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 6

Masat institucionale për parandalimin e trafikimit të fëmijëve

6.1 Palët Kontraktuese marrin përsipër të vënë në jetë masat institucionale të mëposhtme për parandalimin më efektiv të trafikimit të fëmijëve, në varësi të nevojave:

a) krijimin e një grupi qendror koordinues, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të grupeve institucionale publike. Për palën shqiptare, ky organ do të jetë Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i drejtuar nga Ministri i Brendshëm. Për palën greke ky grup do të jetë Komiteti i Përhershëm Ndërmnistror me dekret presidencial 233/2003, neni 9;

b) sigurimin e burimeve njerëzore dhe financiare për të luftuar trafikimin e fëmijëve si një problem shoqëror dhe financiar;

c) sigurimin e asistencës për zhvillimin e një rrjeti të përshtatshëm shërbimesh sociale, funksioni i të cilit do të jetë, mes të tjerash, marrja me fenomenin e trafikimit të fëmijëve ndihmuar nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe aktorët joshetërorë;

d) sigurimi i regjistrimit të të gjitha lindjeve, pavarësisht nga vendi i lindjes.

III. MBROJTJA

Neni 7

Parime të përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve-viktima

7.1 Palët Kontraktuese bien dakord që të gjitha veprimet e ndërmarra në lidhje me fëmijët-viktima duhet të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës, parimi i mosdiskriminimit, respekti për mendimet e fëmijës, si edhe për të drejtat e tij apo të saj për informacion, privatësi, konfidencialitet dhe për mbrojtje.

7.2 Institucionet shtetërore përkatëse të të dyja Palëve Kontraktuese do të bashkëpunojnë për vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje. Për të siguruar vënien efektive në jetë të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e fëmijës, Palët Kontraktuese do të krijojnë një strukturë të posaçme shtetërore, këtua e më pas referuar si “Autoriteti Përgjegjës”. Për palën shqiptare, ky autoritet do të jetë Komisioni i Përbashkët për Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit. Për palën greke, ky autoritet do të jetë Qendra Kombëtare e Solidaritetit Social për Emergjencat e Sekretariatit të Përgjithshëm të Mirëqenies së Ministrisë së Shëndetësisë, Mirëqenies dhe Mbrojtjes Sociale.

7.3 Autoriteti Përgjegjës do të sigurojë bashkëpunimin ndërmjet organeve përkatëse institucionale në përpunje me standardet e kujdesit për fëmijët dhe do të respektojë dhe garantojë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së viktimës fëmijë, siç parashikohet në instrumentet përkatëse ndërkombëtare.

Neni 8

Identifikimi i viktimave fëmijë

8.1 Palët Kontraktuese do të miratojnë procedura efektive për identifikimin e menjëhershëm të viktimave fëmijë në territorin e tyre. Policia, shërbimet sociale, shërbimet e kujdesit mjekësor, institucionet arsimore, autoritetet lokale, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare menjëherë, sapo të vihen në dijeni të pranishëm të një viktime-fëmijë potenciale në territorin e Palëve Kontraktuese, do të njoftojnë menjëherë Autoritetin Përgjegjës të vendit të tyre, i cili do të koordinojë veprimet me strukturat kompetente dhe shërbimet sociale.

8.2 Kur fëmija identifikohet, Autoriteti Përgjegjës do ta regjistrojë fëmijën në një regjister të veçantë dhe do të hapë një dosje personale për fëmijën.

Neni 9

Referimi i një viktime fëmijë, te autoritetet kompetente

9.1 Autoritetet Përgjegjëse, në bashkëpunim me prokurorin publik për fëmijët, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare të përfshira në aktivitete për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe aktorë të tjerë joshetërorë, do të kërkojnë në mënyrë aktive identifikimin e viktimës fëmijë dhe, në bashkëpunim me shërbimin e policisë përkatëse, do të organizojnë transferimin sa më të shpejtë të fëmijës në një qendër të kujdesit. Qendrat e kujdesit duhet të jenë të mbrojtura, të sigurta dhe të përshtatshme për moshën dhe nevojat e fëmijës. Në çdo rast, palët garantojnë që qendrat do t'i ofrojnë fëmijës mbrojtje, ushqim, aktivitete zbavitëse.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Për këtë qëllim, grupi qendror koordinues dhe Autoriteti Përgjegjës i secilës Palë Kontraktuese mund të përfundojnë marrëveshje, direktiva dhe memorandume mirëkuptimi me organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare të përfshira në aktivitete për mbrojtjen e fëmijëve, si edhe me aktorë joshitetërorë me qëllimin e sigurimit të shërbimeve sociale dhe të qendrave të kujdesit.

9.3 Fëmijët e sëmurë, të paafte dhe fëmijët me probleme psikologjike, të miturat shtatzëna etj., do të marrin kujdes të veçantë në varësi të nevojave të tyre. Palët do të përdorin personel të aftë të komunikojë me fëmijën në gjuhën e kuptueshme prej fëmijës.

9.4 Çdo fëmijë i vendosur në një qendër të kujdesit do të marrë ose një leje qëndrimi si viktimë e trafikimit të fëmijëve, nëse autoriteti kompetent ka lëshuar një akt karakterizimi si të tillë, ose lejeqëndrimi për arsye humanitare, sipas rastit, në bazë të parashikimeve ligjore të vendit. Kujdestari i caktuar i fëmijës është përgjegjës për aplikimin e lëshimit të lejes nga autoritetet shtetërore përkatëse. Leja e qëndrimit do të jetë në forcë derisa fëmija vjen nën një status tjetër ligjor për shkak të vënies në zbatim të një zgjidhjeje të përhershme.

Neni 10

Caktimi i një kujdestari të përkohshëm

10.1 Pas transferimit të fëmijës në qendrën e kujdesit, Autoriteti Përgjegjës është i detyruar të kërkojë që fëmija të vendoset nën kujdestari, në përputhje me legjislacionin përkatës të vendit. Kujdestari i përkohshëm do të shoqërojë fëmijën dhe do të mbrojë interesat e fëmijës deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme, ashtu siç parashikohet në nenin 12-16. Kujdestaria mund t'i besohet Autoritetit Përgjegjës, qendrës së kujdesit ku është vendosur fëmija dhe/ose organizatave e institucioneve që njihen për kujdesin e fëmijëve. Numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari duhet të jetë brenda kufijve mbikëqyrës të njësisë së cilës i caktohet kujdestaria. Personat, të cilëve do t'u besohet kujdestaria e fëmijës, duhet të jenë të trajnuar dhe me eksperiencë në çështjet e kujdesit për fëmijët dhe për viktimat fëmijë. Përveç kësaj, ata duhet të jenë në gjendje të komunikojnë në një gjuhë të kuptueshme për fëmijën. Në rast se kujdestaria nuk i është besuar Autoritetit Përgjegjës, ky Autoritet do të nxjerrë rregulla dhe do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme ushtrimin e kujdestarisë.

10.2 Në përputhje me legjislacionin e Palëve Kontraktuese, kujdestari i përkohshëm do të ketë ndër të tjera, detyrat e mëposhtme:

- a) Ai/ajo do të garantojë që të gjitha veprimet do të mbrojnë interesat e fëmijës.
- b) Ai/ajo do të informojë vazhdimisht fëmijën për procedurat, lidhur me gjendjen aktuale të fëmijës dhe mundësitë për të ardhmen, në mënyrë që të vlerësohen rreziqet e sigurisë për të marrë një vendim të vlefshëm lidhur me të ardhmen e fëmijës.
- c) Ai/ajo do të asistojë në procesin e gjetjes së familjes së fëmijës ose personit që ka kujdestarinë e fëmijës në vendin e origjinës.
- d) Ai/ajo do të punojë si një ndërlidhës mes fëmijës dhe organizatave dhe shërbimeve të përfshira në proces dhe të ngarkuara për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës.
- e) Ai/ajo do të garantojë, në rast riatdhesimi, përgatitjen e duhur të kthimit të fëmijës, përgatitjen e familjes dhe të fëmijës, kthimin e sigurt dhe respektimin e interesave të fëmijës.
- f) Ai/ajo do të garantojë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të kujdestarisë. Në këtë kuadër, kujdestari i përkohshëm ka të drejtën e përjashtimit nga detyrimi për të dëshmuar në gjykatë, nëse kështu është në të mirën e fëmijës.

Neni 11

Vlerësimi i individualizuar i rasteve

11.1 Rastet e trafikimit të fëmijëve do të hetohen nga shërbimet policore kompetente të Ministrisë së Brendshme për Republikën e Shqipërisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës Greke, siç parashikohet në nenin 3.1 këtu. Gjatë hetimit, fëmija do të pyetet vetëm kur është e domosdoshme dhe do të bëhen përpjekje që intervista të tilla të minimizohen. Intervista do të bëhet vetëm me lejen e marrë paraprakisht nga personi që ka kujdestarinë e fëmijës, personi i cili duhet të jetë i pranishëm gjatë intervistës dhe mund ta ndërpresë atë kur ai mendon se intervista dëmton mirëqenien e fëmijës. Intervistuesi duhet të përpiqet të shmangë ushtrimin e presionit psikologjik dhe shkaktimin e traumave psikologjike të fëmija gjatë intervistës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 12

Gjetja e një zgjidhjeje të përhershme

12.1 Palët Kontraktuese duhet të përdorin masën e riatdhesimit të sigurt të fëmijës në rast se kjo kërkohet. Autoritetet Përgjegjëse të të dy vendeve do të studiojnë në bashkëpunim të ngushtë, çdo rast të trafikimit të fëmijëve dhe do të vendosin për një zgjidhje të përhershme që do të garantojë interesat e fëmijës.

12.2 Autoriteti Përgjegjës, duke konsideruar riintegrimin në familje si prioritet dhe bazuar vetëm në interesin më të lartë të fëmijës, mund të vendosin si zgjidhje të përhershme riatdhesimin e sigurt, integrimin e fëmijës në vendin pritës ose transferimin e fëmijës në një vend të tretë.

12.3 Në marrjen e këtij vendimi Autoritetet Përgjegjëse do të konsultojnë fëmijën dhe do të marrin parasysh vullnetin e fëmijës në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.

12.4 Në vendimmarrjen e tyre, Autoritetet Përgjegjëse të Palëve Kontraktuese do të marrin në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit dhe në veçanti rezultatet e vlerësimit të rrezikut, të kryer nën përgjegjësinë e përbashkët të Palëve Kontraktuese.

Neni 13

Vënia në zbatim e zgjidhjes së përhershme

13.1 Autoritetet Përgjegjëse të Palëve Kontraktuese do të përpunojnë procedura të përbashkëta për realizimin e një shkëmbimi të shpejtë informacioni lidhur me rastet e trafikimit të fëmijëve, të cilat do të përfshijnë procedura për pjesëmarrjen e ministrave përkatëse, ambasadave dhe/ose konsullatave.

13.2 Nëse nuk zgjidhet opsioni i bashkimit familjar dhe/ose riatdhesimi i fëmijës, kujdestari i përkohshëm do të mbetet përgjegjës për viktimën fëmijë, deri në caktimin e një përfaqësuesi ligjor/kujdestar i fëmijës nga gjykata.

Neni 14

Riatdhesimi i sigurt

14.1 Kthimi i fëmijës do të kryhet nëpërmjet një procedure vullnetare, legjitime, të asistuar, të mirëpërgatitur, të sigurt në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. Procedurat për transportin e fëmijës do të përshkruhen në një protokoll shtesë të kësaj Marrëveshjeje. Gjatë riatdhesimit të sigurt të fëmijës, Autoritetet Përgjegjëse mund të bashkëpunojnë me organizata ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare të përfshira në aktivitete të mbrojtjes së fëmijës.

14.2 Autoriteti Përgjegjës i vendit të origjinës do të përpunojë dhe vërë në jetë projekte të posaçme me qëllim riintegrimin e fëmijës në vendin e origjinës. Projekte të tilla do të mbulojnë mbrojtjen, mbështetjen psikologjike dhe mjekësore, riintegrimin në sistemin arsimor, dhënien e këshillimit ligjor dhe përfaqësimin, si dhe çdo formë tjetër të ndihmës siç e kërkon legjislacioni mbi mbrojtjen e fëmijëve në vendin e origjinës. Për këtë qëllim, ato do të bashkëveprojnë ngushtësisht me organizatat ndërkombëtare, institucionet joshitetërore dhe organizatat joqeveritare.

14.3 Autoriteti Përgjegjës i vendit të origjinës do të vlerësojë mirëqenien e viktimës fëmijë dhe do të monitorojë jetën e saj/e tij pas bashkimit me familjen dhe pas vendosjes së fëmijës në një kujdes alternativ në vendin e origjinës dhe do të paraqesë një raport dyvjetor tek Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës, derisa fëmija të mbushë 18 vjeç. Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës në bashkëpunim me organizatat joqeveritare të përfshira në aktivitete të mbrojtjes së fëmijëve dhe me aktorët joshitetërore, mund të vlerësojnë situatën nëpërmjet vizitave në vend, pas njoftimit të Autoritetit Përgjegjës të vendit të origjinës. Në rastin kur është përcaktuar me siguri se kushtet e jetesës së viktimës fëmijë mbartin rrezikun e rishfrytëzimit, do të hartohet një raport dhe të dyja palët do të konsultohen në mënyrë që ta zgjidhin menjëherë çështjen.

14.4 Në rastin, kur fëmija ndesh probleme me prindin/prindërit apo kujdestarin pas kthimit të saj/të tij, Autoriteti Përgjegjës i vendit të origjinës:

a) do të sigurojë interesat e fëmijës derisa fëmija të mbushë 18 vjeç, të drejtat e fëmijës dhe shërbimet e ndryshme në dispozicion të fëmijës, në përputhje me të drejtën për informim;

b) do të sigurojë që fëmija të marrë kujdesin e nevojshëm që do të përfshijë, në çdo rast akomodimin, ushqimin, mbështetjen psikologjike dhe mjekësore, si dhe arsimimin në një gjuhë të kuptueshme nga fëmija. Ky kujdes nuk duhet të jetë më i ulët se ai që Palët Kontraktuese u japin fëmijëve të nacionalitetit të tyre, në përputhje kjo me parimin e mosdiskriminimit;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) do të ndjekë intervistat e fëmijës me autoritetet policore dhe do të garantojë që intervistat të bëhen në përputhje me principet e përgjithshme të vendosura nga kjo Marrëveshje, si edhe nga ligji i vendit dhe ai ndërkombëtar;

d) do t'i garantojë fëmijës mundësinë për një mbështetje dhe përfaqësim ligjor të përshtatshëm, në përputhje me interesat më të larta të fëmijës;

e) do të konsultohet me fëmijën dhe do të marrë në konsideratë mendimet e tij, në varësi të moshës dhe shkallës së pjekurisë, dhe në përputhje me parimin e respektimit të perspektivës së fëmijës;

f) do të luajë një rol aktiv në gjetjen e zgjidhjeve më të mira të mundshme që do të garantojnë interesat e fëmijës.

Neni 15

Integrimi

15.1 Në rast se vendoset që fëmija do të integrohet në vendin pritës, Autoriteti Përgjegjës do të përpiqet të garantojë integrimin e plotë të fëmijës në vendin pritës. Në këtë kuadër, integrimi i fëmijës në familje ose ambient komunitar është më i preferueshëm se vendosja në institucione.

15.2 Një fëmijë, i cili është subjekt i legjislacionit për kujdestarinë, mund të birësohet. Në rast se fëmija ka probleme me kujdestarin/familjen kujdestare, Autoriteti Përgjegjës do të mbrojë interesat e fëmijës deri në moshën 18 vjeç.

15.3 Palët Kontraktuese bien dakord të miratojnë, kur është e nevojshme, legjislacionin që do të dënojë organizimin e birësimit të fëmijëve në shkelje me legjislacionin e vendit për birësimin, me sanksione që zbatohen për trafikimin e fëmijëve.

15.4 Palët Kontraktuese bien dakord të miratojnë, kur është e nevojshme, legjislacionin që do të dënojë organizimin e birësimit të fëmijëve në shkelje me legjislacionin e vendit për birësimin, me sanksione që zbatohen për trafikimin e fëmijëve.

Neni 16

Rivendosja e fëmijës në një vend të tretë

16.1 Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës mund të vendosë transferimin e fëmijës në një vend të tretë, në rast se në këtë vend sigurohet kujdestaria ligjore dhe një program integrimi, në përputhje me interesat më të larta të fëmijës, të drejtën e fëmijës për informim dhe duke marrë parasysh mendimin e saj/e tij për vendosjen në një vend të tretë.

16.2 Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës do të organizojë shoqërimin e fëmijës deri te pika hyrëse e vendit të tretë, në përputhje me rregullat e transportit të protokollit shtesë të kësaj Marrëveshjeje.

16.3 Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës do të monitorojë vendosjen dhe integrimin e fëmijës në vendin e tretë dhe do të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse për përgatitjen e raporteve vjetore mbi rastin, derisa fëmija të mbushë 18 vjeç.

Neni 17

17.1 Palët Kontraktuese marrin përsipër vënien në zbatim të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet takimeve të përbashkëta vjetore të autoriteteve të përfshira. Organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, dhe aktorët e tjerë joshitetërorë të përfshira në aktivitete për mbrojtjen e fëmijëve mund të ftohen nga Palët Kontraktuese në këto mbledhje. Për mbledhjet (datat, rendin e ditës etj.) Palët Kontraktuese do të bien dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 18

18.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të dalë në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve dhe/ose negociatave.

Neni 19

Rishikimi dhe/ose ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje

19.1 Kjo Marrëveshje mund të rishikohet ose të ndryshohet në çdo kohë me aprovim dypalësh me shkrim. Të tilla rishikime apo ndryshime do të hyjnë në fuqi, në datën e caktuar nga palët, dhe do të jenë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 20
Dispozita finale

20.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas njoftimit të dytë me shkrim nga Palët Kontraktuese, në të cilën ato do të shpallin përfundimin e procedurave përkatëse ligjore ndërkombëtare.

20.2 Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një kohë të pacaktuar.

20.3 Palët Kontraktuese mund ta denoncojnë këtë Marrëveshje nëpërmjet njoftimit me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Denoncimi do të jetë efektiv një muaj pas ditës së marrjes së njoftimit.

Nënshkruar në Tiranë, më 27 shkurt 2006, në dy kopje origjinale, në shqip, greqisht dhe anglisht, të gjitha tekstet njëlojtë të njëjta. Në rast ndryshimi në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të merret për bazë teksti anglisht.

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë
Iva Zajmi Për Qeverinë e Republikës Greke
Evripidis Styliandis

LIGJ
Nr.9833, datë 22.11.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN OPSIONAL TË KONVENTËS SË OKB-SË “PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE”, PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, bërë më 25.5.2000.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5529, datë 4.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLL OPSIONAL I KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE NË LIDHJE ME PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA

Shtetet Palë në këtë protokoll:

të shtrira nga mbështetja e gjerë për Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, që demonstroi përkushtimin e gjerë që ekziston për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

duke ripohuar se të drejtat e fëmijëve kërkojnë mbrojtje të veçantë, dhe duke bërë apel për përmirësimin e

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 165*. Tiranë 2007. f. 4929.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

vazhdueshëm të gjendjes së fëmijëve pa dallim, si dhe për zhvillimin dhe edukimin e tyre në kushte paqeje dhe sigurie;

të shqetësuara nga efekti i dëmshëm dhe i gjerë i konflikteve të armatosura mbi fëmijët dhe pasojat afatgjata që kjo ka për paqen, sigurinë dhe zhvillimin;

duke dënuar përfshirjen e fëmijëve në situata konfliktesh të armatosura dhe sulmet direkte mbi objektet e mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare, duke përfshirë përgjithësisht vendet që kanë prezencë të konsiderueshme fëmijësh, siç janë shkollat dhe spitalet;

duke vënë re miratimin e Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe, në veçanti, përfshirjen si krim lufte marrjen nën armë ose futjen në listë të fëmijëve nën moshën 15 vjeç ose përdorimin e tyre për pjesëmarrje aktive në operacione në konfliktet e armatosura, qofshin këto ndërkombëtare ose jondërkombëtare;

duke konsideruar, para së gjithash, se forcimi i mëtejshëm i zbatimit të të drejtave të njohura në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve është i nevojshëm për të rritur mbrojtjen e fëmijëve nga përfshirja në konflikte të armatosura;

duke vënë re se neni 1 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve përcakton se, për qëllimet e Konventës, fëmijë është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç kur, sipas ligjit që zbatohet mbi fëmijën, madhësia fitohet më herët;

të bindura se një protokoll opsional i Konventës që ngre moshën e rekrutimit të personave në forcat e armatosura dhe pjesëmarrjen e tyre në veprime do të kontribuojë efektivisht në zbatimin e parimit se interesat e lartë të fëmijës duhet të merren me përparësi në konsideratë në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët;

duke vënë re se Konferenca Ndërkombëtare e njëzetegjashtë e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në dhjetor 1995 rekomandojnë, ndërmjet të tjerash, që palët në konflikt të marrin çdo hap të mundshëm për të siguruar që fëmijët nën moshën 18 vjeç të mos marrin pjesë në veprime luftarake;

duke mirëpritur miratimin unanim, në qershor 1999, të Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr.182 mbi Ndalimin dhe Veprimin e Menjëhershëm për Eliminimin e Formave më të Këqija të Punës së Fëmijëve, e cila, ndërmjet të tjerash, ndalon rekrutimin nëpërmjet forcës ose detyrimit të fëmijëve për t'u përdorur në konflikte të armatosura;

duke dënuar me shqetësimin më të thellë rekrutimin, stërvitjen dhe përdorimin brenda ose përtej kufijve shtetërore të fëmijëve në veprime të grupeve të armatosura të ndara nga forcat e armatosura të një shteti, dhe duke njohur përgjegjësinë e atyre që rekrutojnë, stërvisin dhe përdorin fëmijët në këtë mënyrë;

duke kujtuar detyrimin e çdo Pale në një konflikt të armatosur për të respektuar dispozitat e ligjit humanitar ndërkombëtar;

duke theksuar se ky protokoll nuk cenon qëllimet dhe parimet që përmbahen në Kartën e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë nenin 51 dhe normat përkatëse të ligjit humanitar;

duke mos barruar se kushtet e paqes dhe sigurisë bazuar në respektimin e plotë të qëllimeve dhe parimeve që parashikohen në Kartë dhe respektimi i instrumenteve të zbatueshme për të drejtat e njeriut janë të domosdoshme për mbrojtjen e plotë të fëmijëve, sidomos gjatë konflikteve të armatosura dhe pushtimeve të huaja;

duke njohur nevojat e veçanta të atyre fëmijëve që janë veçanërisht të pambrojtur ndaj rekrutimit ose përdorimit në veprime luftarake në kundërshtim me këtë protokoll për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, shoqërore apo gjinore;

duke ditur domosdoshmërinë e marrjes në konsideratë të shkaqeve fillestare ekonomike, shoqërore dhe politike të përfshirjes së fëmijëve në konflikte të armatosura;

të bindura për nevojën e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatimin e këtij protokollit, si dhe rehabilitimin fizik dhe psikologjik dhe riintegrimin shoqëror të fëmijëve që janë viktimë të konflikteve të armatosura;

duke nxitur pjesëmarrjen e komunitetit dhe, sidomos, të fëmijëve ose fëmijëve viktimë në shpërndarjen e programeve edukative dhe informative në lidhje me zbatimin e protokollit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që të gjithë anëtarët e forcave të tyre të armatosura që nuk kanë mbushur 18 vjeç të mos marrin pjesë direkt në veprime luftarake.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 2

Shtetet Palë do të sigurojnë që personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç të mos jenë të detyruar të rekrutohen në forcat e tyre të armatosura.

Neni 3

1. Shtetet Palë do të ngrenë moshën minimale për rekrutimin vullnetar të personave në forcat e tyre të armatosura kombëtare nga ajo e parashikuar në nenin 38 paragrafi 3 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, duke marrë parasysh parimet e parashikuara në atë nen dhe duke pranuar se në bazë të Konventës personat nën 18 vjeç kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë.

2. Secili Shtet Palë do të depozitojë një deklaratë detyruese në momentin e ratifikimit ose anëtarësimit në këtë protokoll, e cila përcakton moshën minimale në të cilën ai lejon rekrutimin vullnetar në forcat kombëtare të armatosura dhe një përshkrim të garancive që ai ka adaptuar për të siguruar që një rekrutim i tillë nuk do të bëhet me forcë ose në formë të detyruar.

3. Shtetet Palë që lejojnë rekrutimin vullnetar në forcat kombëtare të armatosura nën moshën 18 vjeç caktojnë garanci për të siguruar, minimalisht që:

- a) një rekrutim i tillë është vërtet vullnetar;
- b) një rekrutim i tillë bëhet me pëlqimin e dhënë nga prindërit e personit ose kujdestarët e tij ligjorë;
- c) këta persona janë plotësisht të informuar në lidhje me detyrat në një shërbim të tillë ushtarak;
- d) këta persona paraqesin prova të besueshme për moshën para pranimit në shërbimin ushtarak kombëtar.

4. Secili Shtet Palë mund të përforcojë deklaratën e tij, në çdo kohë, duke bërë për këtë një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili informon të gjitha Shtetet Palë. Një njoftim i tillë bëhet i efektshëm në datën në të cilën ai merret nga Sekretari i Përgjithshëm.

5. Kërkesa për ngritjen e moshës në paragrafin 1 të këtij neni nuk zbatohet në lidhje me shkollat, që veprojnë ose kontrollohen nga forcat e armatosura të Shteteve Palë, në pajtim me nenet 28 dhe 29 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Neni 4

1. Në asnjë rrethanë grupet e armatosura, të ndara nga forcat e armatosura të një shteti, nuk do të rekrutojnë ose përdorin në veprime luftarake persona nën moshën 18 vjeç.

2. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e mundshme për të parandaluar një rekrutim dhe përdorim të tillë, duke përfshirë edhe masat ligjore të nevojshme për ndalimin dhe penalizimin e praktikave të tilla.

3. Zbatimi i këtij neni sipas këtij protokollit nuk prek asnjë status ligjor të ndonjë pale në konflikt të armatosur.

Neni 5

Asgjë në këtë protokoll nuk do të interpretohet si paragjykim i dispozitave të ligjeve të një Shteti Palë ose të instrumenteve ndërkombëtare, apo të së drejtës humanitare ndërkombëtare që janë më të favorshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Neni 6

1. Çdo Shtet Palë do të marrë të gjitha masat e duhura ligjore, administrative etj., për të siguruar zbatimin e efektshëm të dispozitave të këtij protokollit brenda juridiksionit të vet.

2. Çdo Shtet Palë do të marrë përsipër t'i bëjë parimet dhe dispozitat e këtij protokollit gjerësisht të njohura dhe t'i promovojë si duhet, si te të rriturit, ashtu edhe te fëmijët.

3. Çdo Shtet Palë do të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat brenda juridiksionit të tyre, të rekrutuar ose përdorur në veprime luftarake në kundërshtim me këtë protokoll, të demobilizohen ose të lirohen nga shërbimi. Shtetet Palë, kur është e nevojshme, do t'u japin këtyre personave të gjithë asistencën e duhur për shërimin e tyre fizik, psikologjik dhe riintegrimin e tyre shoqëror.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 7

1. Shtetet Palë do të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij protokollit, duke përfshirë ndalimin e çdo aktiviteti në kundërshtim me protokollin dhe rehabilitimin, dhe riintegrimin shoqëror të personave që janë viktimë të veprimeve në kundërshtim me këtë protokoll, duke përfshirë bashkëpunimin teknik dhe ndihmën financiare.

2. Shtetet Palë që janë në gjendje ta bëjnë këtë, do ta japin këtë asistencë nëpërmjet programeve ekzistuese shumëpalëshe, dypalëshe etj., ndërmjet të tjerash, ndërmjet një fondi vullnetar të krijuar në pajtim me rregullat e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 8

1. Çdo Shtet Palë, brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e protokollit për atë Shtet Palë, do t'i paraqesë Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve një raport me informacione të plota mbi masat që ai ka marrë për zbatimin e dispozitave të protokollit, duke përfshirë masat e marra për të zbatuar dispozitat mbi pjesëmarrjen dhe rekrutimin.

2. Pas paraqitjes së raportit të plotë, çdo Shtet Palë do të përfshijë në raportin që paraqet në Komitetin mbi të Drejtat e Fëmijëve, në pajtim me nenin 44 të Konventës, çdo informacion tjetër në lidhje me zbatimin e protokollit. Shtetet e tjera Palë në protokoll paraqesin një raport në çdo pesë vjet.

3. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve mund të kërkojë nga Shtetet e tjera Palë informacion shtesë që ka të bëjë me zbatimin e këtij protokollit.

Neni 9

1. Ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga çdo shtet që është palë në Konventë ose e ka nënshkruar atë.

2. Ky protokoll duhet të ratifikohet dhe është i hapur për anëtarësimin për çdo shtet. Instrumentet e ratifikimit ose anëtarësimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e Depozitarit të Konventës dhe të protokollit, informon të gjitha Shtetet Palë në Konventë dhe të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën për çdo instrument deklarimi në pajtim me nenin 13.

Neni 10

1. Ky protokoll hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose anëtarësimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë protokoll ose anëtarësohet në të pas hyrjes në fuqi, ky protokoll hyn në fuqi një muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose anëtarësimit.

Neni 11

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë protokoll në çdo kohë, me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili njofton Shtetet e tjera Palë në Konventë dhe të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm. Megjithatë, kur në momentin e kalimit të një viti Shteti Palë denoncues është i përfshirë në një konflikt të armatosur, denoncimi nuk bëhet i efektshëm para përfundimit të konfliktit të armatosur.

2. Një denoncim i tillë nuk ka efektin e lirimit të Shtetit Palë nga përgjegjësitë e tij, sipas këtij protokollit, në lidhje me ndonjë veprim që ndodh para datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm. Një denoncim i tillë nuk cenon as edhe vazhdimin e shqyrtimit të një çështjeje që ka filluar të shqyrtohet nga Komiteti para datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm.

Neni 12

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një ndryshim dhe ta depozitojë atë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm me këtë rast u komunikon ndryshimin e propozuar Shteteve Palë, me kërkesën që ata të tregojnë, nëse ata janë në favor të një konference të Shteteve Palë për qëllimin e shqyrtimit dhe votimit të propozimeve. Në rast se, brenda katër muajve që nga data e një komunikimi të tillë, të paktën një treta e Shteteve Palë janë në favor të një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm mbledh konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishme dhe votues në konferencë i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Ndryshimi i miratuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni hyn në fuqi, pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe pranuar nga një shumicë prej dy të tretash të Shteteve Palë.

3. Kur një ndryshim hyn në fuqi, ai është i detyrueshëm për ato Shtete Palë që e kanë pranuar atë, ose Shtetet e tjera Palë që janë të detyruara nga dispozitat e këtij protokoll apo nga ndryshime të pranuar më parë.

Neni 13

1. Ky protokoll, në gjuhët arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, tekstet e të cilave janë njësoj të vlefshme, depozitohet në arkivin e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u transmeton kopje të vërtetuara të këtij protokoll Shteteve Palë në Konventë dhe të gjitha shteteve që kanë nënshkruar Konvent

LIGJ

Nr.9834, datë 22.11.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN OPSIONAL TË KONVENTËS SË OKB-SË “PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE”, PËR SHITJEN E FËMIJËVE, PROSTITUCIONIN DHE PORNOGRAFINË ME FËMIJË¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë, bërë më 25.5.2000.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5530, datë 4.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLL OPSIONAL

I KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE NË LIDHJE ME SHITJEN E FËMIJËVE, PROSTITUCIONIN ME FËMIJË DHE PORNOGRAFINË ME FËMIJË

Shtetet Palë në këtë Konventë,

duke qenë se, për të arritur më tej qëllimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe zbatimin e dispozitave të saj, sidomos të neneve 1, 11, 21, 32, 33, 34, 35 dhe 36 do të ishte i nevojshëm zgjerimi i masave që Shtetet Palë duhej të ndërmerren me qëllim që të garantonin mbrojtjen e fëmijëve nga shitja, prostitucioni dhe pornografia me ta;

gjithashtu, duke qenë se Konventa për të drejtat e fëmijëve e njeh të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi fitimprurës ose kryerja e çdo pune që do të ishte e dëmshme, ose do të pengonte edukimin e fëmijëve, ose që do të ishte e dëmshme për shëndetin e fëmijëve, apo për zhvillimin fizik mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 165*. Tiranë 2007. f. 4933.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

thelësisht të shqetësuara për trafikimin e konsiderueshëm ndërkombëtar dhe në rritje të fëmijëve me qëllim shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë;

tepër të shqetësuara për praktikën tepër të përhapur dhe të vazhdueshme të turizmit seksual, i cili kërcënon veçanërisht fëmijët, pasi ai nxit shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë;

duke prannuar se një numër kategorish, veçanërisht të kërcënuara, duke përfshirë fëmijët vajza janë nën një rrezik më të madh për shfrytëzim seksual dhe se fëmijët vajza janë të përfaqësuara në mënyrë disproporcionale të fëmijët e shfrytëzuar seksualisht;

të shqetësuara rreth daljes së pornografisë së fëmijëve në internet dhe teknologji të tjera që shfaqen dhe duke kujtuar Konferencën Ndërkombëtare për Luftën kundër Pornografisë së Fëmijëve në Internet (Vjenë 1999) dhe sidomos përfundimin e saj duke bërë apel për penalizimin mbarëbotëror të prodhimit të shpërndarjes, eksportimit, transmetimit, mbajtjes së qëllimshme dhe reklamës me pornografi fëmijësh, dhe duke theksuar rëndësinë e një partneriteti dhe bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet qeverive dhe industrisë së internetit;

duke besuar që shitja e fëmijëve, prostitucioni me fëmijë dhe pornografia me fëmijë nxitet, kur nuk zbatohet rreptësia e duhur, duke shqyrtuar faktorët kontribues, duke përfshirë prapambetjen, varfërinë, pabarazinë ekonomike, strukturën e papërshtatshme social-ekonomike, keqfunksionimin e familjeve, mungesën e arsimit, migrimin nga qyteti në fshat, diskriminimin për shkak të gjinisë, sjelljen e papërgjegjshme seksuale të të rriturve, praktikatat e dëmshme tradicionale, konfliktet e armatosura dhe trafikimin e fëmijëve;

duke besuar që përpjekjet për forcimin e sensibilizimit publik janë të nevojshme për uljen e kërkesës së konsumatorit për shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë dhe, gjithashtu duke besuar në rëndësinë e partneritetit global ndërmjet të gjithë aktorëve dhe të përmirësimit të zbatimit të ligjit në nivel kombëtar;

duke vënë re dispozitat e instrumenteve ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë Konventën e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në lidhje me miratimin ndërshtetëror, Konventën e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, Konventën e Hagës mbi juridiksionin, ligjin e zbatuar, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve, dhe Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr.182 mbi ndalimin dhe veprimin e menjëhershëm për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve;

të nxitura nga mbështetja e gjerë për Konventën për të drejtat e fëmijëve, duke treguar përkushtimin e gjerë që ekziston për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

duke njohur rëndësinë e zbatimit të dispozitave e programit të veprimit për parandalimin e shitjes së fëmijëve, prostitucionit të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve dhe deklarimin e axhendës për veprim të miratuar në Kongresin Botëror kundër shfrytëzimit seksual për qëllime fitimi të fëmijëve mbajtur në Stokholm, më 27-31 gusht 1996, dhe vendimet e tjera të rëndësishme dhe rekomandimet e organeve përkatëse ndërkombëtare;

duke marrë parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe vlerave kulturore të çdo populli për mbrojtjen dhe zhvillimin harmonik të fëmijëve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetet Palë do të ndalojnë shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë, siç është parashikuar në këtë protokoll.

Neni 2

Për qëllimin e këtij protokoll:

a) Shitje e fëmijëve është çdo veprim ose transaksion me anë të të cilit një fëmijë transferohet prej një personi ose grupi personash te një tjetër me pagesë ose në çdo mënyrë tjetër.

b) Prostitucion me fëmijë është përdorimi i fëmijës në aktivitetet seksuale me pagesë ose çdo mënyrë tjetër.

c) Pornografia me fëmijë është çdo formë përfaqësimi, me çfarëdo mjeti, i një fëmije të përfshirë në aktivitete të qarta seksuale, të vërteta ose të simuluar, ose çdo demonstrim i pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale.

Neni 3

1. Çdo Shtet Palë do të garantojë të paktën mbulimin plotësisht nga ligji i tij penal, të veprimeve dhe aktiviteteve të mëposhtme pavarësisht se këto vepra penale janë kryer brenda apo jashtë vendit nga një individ apo grup individësh të organizuar:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) Në kontekstin e shitjes së fëmijëve sipas nenit 2:
 - i) Ofrimi, dorëzimi ose pranimi me çfarëdo mjeti i një fëmije për qëllimin e:
 - a) shfrytëzimit seksual të fëmijëve;
 - b) transferimit të organeve të një fëmije për qëllime fitimi;
 - c) përfshirjes së fëmijëve në punë të detyruara.
 - ii) Marrja e pëlqimit në mënyrë të papërshtatshme, si ndërmjetës për adoptimin e një fëmije duke shkelur instrumentet e zbatueshme ligjore ndërkombëtare për miratimin.
 - b) Ofrimi, marrja, gjetja ose dorëzimi i një fëmije për prostitucion me fëmijë, sipas përcaktimit të nenit 2.
 - c) prodhimi, shpërndarja, importimi, eksportimi, ofrimi, shitja ose mbajtja e pornografisë me fëmijë për qëllimet e sipërsënuara, sipas përcaktimit të nenit 2.
2. Në pajtim me dispozitat e ligjit vendas të çdo Shteti Palë, e njëjta gjë zbatohet në lidhje me përpjekjet për kryerjen e ndonjërit prej këtyre veprimeve, me bashkëveprimin ose pjesëmarrjen në ndonjë prej këtyre veprimeve.
3. Çdo Shtet Palë i bën këto vepra penale të dënueshme nëpërmjet dënimeve të përshtatshme në varësi të natyrës së rëndë të tyre.
4. Në pajtim me dispozitat e ligjit kombëtar, çdo Shtet Palë do të marrë masa, kurdo që është e nevojshme, për të përcaktuar përgjegjësinë e personave juridikë të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni. Në pajtim me parimet ligjore të Shtetit Palë, kjo përgjegjësi e personave juridikë, mund të jetë penale, civile ose administrative.
5. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura ligjore dhe administrative për të siguruar që të gjithë personat e përfshirë në adoptimin e një fëmije të veprojnë në përputhje me instrumentet ligjore ndërkombëtare të zbatueshme.

Neni 4

1. Çdo Shtet Palë do të marrë të gjitha masat që janë të nevojshme për të caktuar juridiksionin e tij në lidhje me veprat penale të përmendura në nenin 3, paragrafi 1, kur këto vepra janë kryer në territorin e tij ose në bordin e një anijeje, ose avioni të regjistruar në këto shtete.
2. Çdo Shtet Palë mund të marrë të gjitha masat që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar juridiksionin e tij në lidhje me veprat penale të përmendura në nenin 3, paragrafi 1, për rastet e mëposhtme:
 - a) kur kryerësi i prezumuar i veprës penale është shtetas i atij shteti ose një person që ka vendqëndrimin e zakonshëm në territorin e tij;
 - b) kur viktimë është shtetas i atij shteti.
3. Çdo Shtet Palë do të marrë, gjithashtu të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar juridiksionin e tij në lidhje me veprat penale të përmendura më sipër, kur kryerësi i prezumuar i veprës është i pranishëm në territorin e tij dhe ky nuk e ekstradon atë në një Shtet tjetër Palë me arsyen se vepra penale është kryer nga njëri prej shtetasve të tij.
4. Ky protokoll nuk përjashton asnjë juridiksion penal që ushtrohet në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 5

1. Veprat penale të përmendura në nenin 3, paragrafi 1, konsiderohen se përfshihen në veprat penale të ekstradueshme në të gjitha marrëveshjet e ekstradimit që ekzistojnë ndërmjet Shteteve Palë dhe përfshihen si vepra penale të ekstradueshme në çdo Marrëveshje ekstradimi që lidhet më vonë ndërmjet tyre, në pajtim me dispozitat e parashikuara në këto Marrëveshje.
2. Kur një Shtet Palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje do të marrë një kërkesë për ekstradimin nga një Shtet tjetër Palë, me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi, ai mund ta konsiderojë këtë protokoll si bazë ligjore për ekstradim në lidhje me këto vepra penale. Ekstradimi u nënshtrohet dispozitave të parashikuara në ligjin e shtetit pritës.
3. Shtetet Palë që nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje i njohin këto vepra penale si vepra të ekstradueshme ndërmjet tyre në pajtim me dispozitat e parashikuara në ligjin e shtetit pritës.
4. Këto vepra penale, për qëllimet e ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë trajtohen sikur të ishin kryer jo vetëm në vendin ku ato kanë ndodhur, por gjithashtu edhe në territoret e shteteve që duhet të caktojnë juridiksionin e tyre në pajtim me nenin 4.
5. Kur një kërkesë për ekstradim bëhet në lidhje me një vepër penale të përmendur në nenin 3, paragrafi 1 dhe, kur Shteti i Palës pritës, nuk e ekstradon ose nuk do ta bëjë këtë mbi bazën e shtetësisë së personit që ka

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

kryer veprën, ai shtet do të marrë masat e përshtatshme për t'ua dorëzuar këtë çështje organeve të veta kompetente për të bërë ndjekjen penale.

Neni 6

1. Shtetet Palë i ofrojnë njëra-tjetres masën më të lartë të asistencës në lidhje me hetimet për proceset penale ose të ekstradimit, që janë në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenin 3, paragrafi 1, duke përfshirë asistencën në marrjen e provave të nevojshme për gjykim.

2. Shtetet Palë përmbushin detyrimet e tyre sipas paragrafit 1 të këtij neni në përputhje me marrëveshjet ose masat e tjera për ndihmë të ndërsjellë ligjore që mund të ekzistojnë ndërmjet tyre. Në mungesë të këtyre marrëveshjeve ose masave, Shtetet Palë i ofrojnë njëra-tjetres ndihmë në pajtim me ligjin e vendit të tyre.

Neni 7

Shtetet Palë, në pajtim me dispozitat e ligjit vendas:

- a) do të marrin masa për të bërë bllokimin ose konfiskimin sipas rastit të:
 - i) mallrave siç janë materiale, sende me vlerë dhe mjete të tjera që përdoren për të kryer ose ndihmuar kryerjen e veprave penale të parashikuara në këtë protokoll;
 - ii) të ardhurave që rrjedhin nga këto vepra penale;
- b) plotësojnë kërkesa nga një Shtet tjetër Palë për bllokimin ose konfiskimin e mallrave, ose të ardhurat e përmendura në nënparagrafin (a) (i);
- c) do të marrin masat që kanë për qëllim mbylljen, përkohësisht ose përgjithmonë të ambienteve që përdoren për kryerjen e veprave të tilla.

Neni 8

1. Shtetet Palë do të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e fëmijëve viktimë të praktikave të ndaluara nga ky protokoll në të gjitha fazat e procedimit penal, sidomos duke:

- a) njohur ekspozimin e fëmijëve viktimë dhe duke miratuar procedura për njohjen e nevojave të tyre të veçanta, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë;
- b) informuar fëmijët viktimë për të drejtat e tyre, rolin e tyre dhe objektin, kohën dhe ecurinë e gjyqimit, si dhe disponimin e çështjeve të tyre;
- c) lejuar mendime, nevoja dhe shqetësime të fëmijëve viktimë të parashtrihen dhe shqyrtohen në gjykimet që kanë të bëjnë me interesat e tyre personale, në një mënyrë që të jetë në pajtim me rregullat procedurale të ligjit kombëtar;
- d) dhënë mbështetje të përshtatshme fëmijëve viktimë gjatë gjithë procesit gjyqësor;
- e) mbrojtur, si duhet, sferën private dhe identitetin e fëmijëve viktimë, duke marrë masa në përputhje me ligjin e tyre kombëtar për të mënjeluar shpërndarjen e papërshtatshme të informacionit që mund të çonte në identifikimin e fëmijëve viktimë;
- f) mënjeluar, në mënyrë të përshtatshme për sigurinë e fëmijëve, familjeve të tyre dhe dëshmitarëve nga ana e tyre, kërcënimet dhe hakmarrjet;
- g) mënjeluar vonesa të panevojshme në disponimin e çështjeve dhe zbatimin e vendimeve ose dekreteve që japin kompensim për fëmijët viktimë.

2. Shtetet Palë do të sigurojnë që pasiguria në lidhje me moshën e viktimës të mos pengojë fillimin e hetimit penal, duke përfshirë hetimet që kanë për qëllim përcaktimin e moshës së viktimës.

3. Shtetet Palë do të sigurojnë që në trajtimin që procedura penale u bën fëmijëve që janë viktimë të veprave penale, të parashikuara në këtë protokoll, interesat e larta të fëmijës të kenë shqyrtim prioritar.

4. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat për të siguruar trajnimin e duhur, sidomos trajnimin ligjor dhe psikologjik, për personat që punojnë me viktimat e veprave penale të ndaluara nga ky protokoll.

5. Shtetet Palë, në rastet e duhura, do të marrin masa për të mbrojtur sigurinë dhe dinjitetin e atyre personave dhe/ose organizatave që janë të përfshira në parandalimin dhe/ose mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të këtyre veprave penale.

6. Asgjë në këtë nen nuk mund të interpretohet si e dëmshme ose e papërpunueshme me të drejtat e personit të akuzuar në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 9

1. Shtetet Palë miratojnë, përforcojnë, zbatojnë dhe publikojnë ligje, masa administrative, politika sociale dhe programe për parandalimin e veprave penale të parashikuara në këtë protokoll. Vëmendje e veçantë i kushtohet mbrojtjes së fëmijëve që janë tepër të ekspozuar ndaj këtyre praktikave.

2. Shtetet Palë nxisin sensibilizimin e publikut të gjerë, duke përfshirë fëmijët, nëpërmjet informimit me të gjitha mjetet e përshtatshme, edukimin dhe trajnimin, në lidhje me masat parandaluese dhe efektet e dëmshme të veprave penale të përmendura në këtë protokoll. Në përmbytjen e detyrimeve të tyre, sipas këtij neni, Shtetet Palë nxisin pjesëmarrjen e komunitetit dhe, veçanërisht, të fëmijëve dhe fëmijëve viktimë, në programe të tilla informimi, edukimi dhe trajnimi, duke u bërë edhe në nivel ndërkombëtar.

3. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e mundshme me qëllim që të sigurojnë të gjithë asistencën e nevojshme për viktimat e këtyre veprave, duke përfshirë riintegrimin e tyre të plotë shoqëror dhe shërimin e tyre të plotë fizik dhe psikologjik.

4. Shtetet Palë sigurojnë që të gjithë fëmijët viktimë të veprave penale të përmendura në këtë protokoll të kenë mundësi t'u drejtohen procedurave të përshtatshme për të kërkuar, pa u diskriminuar, kompensim për dëmet e shkaktuara nga personat që kanë përgjegjësi ligjore.

5. Shtetet Palë do të marrin masa të përshtatshme, që kanë për qëllim të ndalojnë efektivisht prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve që ekspozojnë veprat penale të parashikuara në këtë protokoll.

Neni 10

1. Shtetet Palë do të marrin të gjitha hapat e duhur për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar shumëpalësh, rajonal ose dypalësh për parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e personave përgjegjës për veprime që përfshijnë shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë, pornografinë me fëmijë dhe turizmin seksual me fëmijë. Shtetet Palë nxisin, gjithashtu bashkëpunimin ndërkombëtar dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve, organizatave joqeveritare vendase ose ndërkombëtare dhe organizatave ndërkombëtare.

2. Shtetet Palë nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar për të ndihmuar fëmijët viktimë në shërimin e tyre fizik dhe psikologjik, riintegrimin shoqëror, riatdhesimin.

3. Shtetet Palë nxisin forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim që të trajtohen shkaqet bazë, siç është varfëria dhe prapambetja, të cilat ndikojnë në ekspozimin e fëmijëve kundrejt shitjes së fëmijëve, prostitucionit me fëmijë, pornografisë me fëmijë dhe turizmit me seks me fëmijë.

4. Shtetet Palë që janë në gjendje të bëjnë një gjë të tillë japin asistencë financiare, teknike etj., nëpërmjet programeve shumëpalëshe, rajonale, dypalëshe ose të tjera.

Neni 11

Asgjë në këtë protokoll nuk cenon ndonjë dispozitë tjetër që është më e favorshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe që mund të ndodhet në:

- a) ligjin e Shtetit Palë;
- b) të drejtën ndërkombëtare që është në fuqi në shtetin përkatës.

Neni 12

1. Çdo Shtet Palë, brenda dy vjetëve që nga hyrja në fuqi e protokollit për atë Shtet Palë, i paraqet Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve një raport me informacione të plota mbi masat që ai ka marrë për zbatimin e protokollit.

2. Pas paraqitjes së raportit të plotë, çdo Shtet Palë përfshin në raportin që paraqet në Komitetin mbi të Drejtat e Fëmijëve, në pajtim me nenin 44 të Konventës, çdo informacion tjetër në lidhje me zbatimin e protokollit. Shtetet e tjera Palë në protokoll paraqesin një raport në çdo pesë vjet.

3. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, mund të kërkojë nga Shtetet e tjera Palë informacion shtesë që ka të bëjë me zbatimin e këtij protokoll.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 13

1. Ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga çdo Shtet që është Palë në Konventë ose e ka nënshkruar atë.

2. Ky protokoll duhet të ratifikohet dhe është i hapur për anëtarësim për çdo Shtet që është Palë në Konventë ose e ka nënshkruar atë. Instrumentet e ratifikimit ose anëtarësimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 14

1. Ky protokoll hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose anëtarësimit.

2. Për çdo Shtet që ratifikon këtë protokoll ose anëtarësohet në të pas hyrjes në fuqi, ky protokoll hyn në fuqi një muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose anëtarësimit.

Neni 15

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili njofton shtetet e tjera Palë në Konventë dhe të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Një denoncim i tillë nuk ka efektin e lirimit të Shtetit Palë nga përgjegjësitë e tij, sipas këtij protokoll, në lidhje me ndonjë veprim që ndodh para datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm. Një denoncim i tillë nuk cenon as edhe vazhdimin e shqyrtimit të një çështjeje që ka filluar të shqyrtohet nga Komiteti para datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm.

Neni 16

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë në ndryshim dhe ta depozitojë atë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm me këtë rast u komunikon ndryshimin e propozuar Shteteve Palë, me kërkesën që ata të tregojnë, nëse ata janë në favor të një konference të Shteteve Palë për qëllimin e shqyrtimit dhe votimit të propozimeve. Në rast se brenda katër muajve që nga data e një komunikimi të tillë të paktën një e treta e Shteteve Palë janë në favor të një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm mbledh konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

2. Ndryshimi i miratuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni hyn në fuqi, pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe pranuar nga një shumicë prej dy të tretash të Shteteve Palë.

3. Kur një ndryshim hyn në fuqi, ai është i detyrueshëm për ato Shtete Palë që e kanë pranuar atë ose Shtetet e tjera Palë, që janë të detyruara nga dispozitat e këtij protokoll apo nga ndryshimet të pranura më parë.

Neni 17

1. Ky protokoll në gjuhët arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht tekstet e të cilave janë njësoj të vlefshme, depozitohet në arkivin e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u transmeton kopje të vërtetuara të këtij protokoll Shteteve Palë në Konventë dhe të gjitha shteteve që kanë nënshkruar Konventën.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

LIGJ
Nr. 10 071, datë 9.2.2009

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA SHFRYTËZIMI DHE ABUZIMI SEKSUAL¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6072, datë 27.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KËSHILLI I EUROPËS
Seria e Traktateve të Këshillit të Europës – Nr.201

KONVENTA E KËSHILLIT TË EUROPËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA SHFRYTËZIMI SEKSUAL DHE ABUZIMI SEKSUAL

Lanzarote, 25.10.2007
Preambulë

Vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe vende të tjera që e firmosin këtë Konventë,
duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është që të arrijë një unitet më të madh midis anëtarëve të tij;

duke pasur parasysh se çdo fëmijë ka të drejtë për masa të tilla mbrojtëse siç i kërkon statusi i tij /e saj si i/e mitur, nga ana e familjes së tij ose të saj, nga shoqëria dhe shteti;

duke konstatuar se shfrytëzimi seksual i fëmijëve, në veçanti pornografia dhe prostitucioni i fëmijëve në të gjitha format e abuzimit seksual me fëmijët, duke përfshirë dhe aktet, që kryhen jashtë shtetit, janë shkatërruese për shëndetin e fëmijës dhe zhvillimin e tij psikosocial;

duke konstatuar se shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual i fëmijëve janë rritur në përmasa shqetësuese si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në veçanti në lidhje me përdorimin në rritje si nga fëmijët, dhe nga personat të cilët kanë kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT) dhe që parandalimi kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve kërkon bashkëpunim ndërkombëtar;

duke pasur parasysh se mirëqenia dhe interesat më të mira të fëmijëve janë vlerat themelore, që ndajnë të gjitha vendet anëtare dhe që duhet të promovohen pa asnjë diskriminim;

duke rikujtuar planin e veprimit, të miratuar mbledhjen e tretë nivelit të lartë të krerëve të shteteve dhe qeverive të Këshillit të Europës (Varshavë, 16-17 maj 2005), që bëri thirrje për marrjen masave për të ndaluar shfrytëzimin seksual të fëmijëve;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 21. Tiranë 2009. f. 1353.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

duke rikujtuar në veçanti rekomandimin e Komitetit të Ministrave nr.R (91)11, në lidhje me shfrytëzimin seksual, pornografinë dhe prostitucionin, dhe trafikimin e fëmijëve dhe të adoleshentëve, rekomandimin Rec (2001)16 për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual, dhe Konventën për krimin kibernetik (ETS nr.185), veçanërisht nenin 9 të saj si dhe Konventën e Këshillit të Europës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore (CETS nr.197);

duke pasur parasysh Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (1950, ETS Nr.5), kartën europiane sociale të rishikuar (1996, ETS nr.163), dhe Konventën Europiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve (1996, ETS nr.160);

duke pasur parasysh gjithashtu Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, veçanërisht nenin 34 të saj, protokollin me opsion për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve, protokollin për të parandaluar, për të shtypur trafikimin e personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, si dhe Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me ndalimin dhe veprimin imediat për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve;

duke pasur parasysh vendimin kuadër të Këshillit të Bashkimit Europian për luftën ndaj shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve (2004/68/JHA), vendimin kuadër të Këshilli të Bashkimit Europian për objektivat aktuale në procedimet kriminale (2001/220/JHA) dhe vendimin kuadër të Këshillit të Bashkimit Europian për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2002/629/JHA);

duke marrë mirë parasysh instrumentet dhe programet e tjera përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, veçanërisht deklaratën e Stokholmit dhe agjendën për veprim e miratuar në Kongresin e Parë Botëror kundër Shfrytëzimit Seksual Komercial të Fëmijëve (27-31 gusht 1996), angazhimin global të Jokohamas, miratuar në Kongresin e Dytë Botëror kundër Shfrytëzimit Seksual Komercial të Fëmijëve (17-20 dhjetor 2001), angazhimin e Budapestit dhe planin e veprimit, miratuar në konferencën përgatitore për Kongresin e Dytë Botëror Kundër Shfrytëzimit Komercial Seksual të Fëmijëve (20-21 nëntor 2001), rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara S-27/2 “Një botë e përshtatshme për fëmijët” dhe programin trevjeçar “Ndërtimi i një Europe për dhe me fëmijët”, miratuar pas samitit të tretë dhe i shpallur në Konferencën e Monakos (4-5 prill 2006);

të vendosur për të kontribuar efektivisht për një qëllim të përbashkët për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual, kushdo qoftë personi i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, dhe për t’u dhënë asistencë viktimave;

duke marrë parasysh nevojën për të përgatitur instrumentet ndërkombëtare që të përqendrohet në aspekte ligjore parandaluese, mbrojtëse dhe të legjislacionit penal për luftën kundër të gjitha formave të shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual të fëmijëve duke ndërtuar një mekanizëm specifik monitorimi,

ranë dakord si më poshtë:

Kapitulli I

Qëllimet, parimet dhe përkufizimet e mosdiskriminimit

Neni 1

Qëllimet

1. Qëllimet e kësaj Konvente janë:
 - a) të parandalojë dhe të luftojë shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve;
 - b) të mbrojë të drejtat e fëmijëve viktimë të shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual;
 - c) të promovojë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve.
2. Në mënyrë që të sigurohet zbatimi efektiv i dispozitave të saj nga palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm specifik monitorimi.

Neni 2

Parimi i mosdiskriminimit

Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga palët, në veçanti marrja e masave për të mbrojtur të drejtat e viktimave, do të sigurohet pa diskriminim për çfarëdolloj arsyeje si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik i një lloji tjetër, origjina kombëtare apo sociale, shoqërimi me një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar apo ndonjë status tjetër.

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- a) “fëmijë” do të thotë çdo person nën moshën 18 vjeç”;
- b) “shfrytëzim seksual dhe abuzim seksual i fëmijëve” do të përfshijë sjelljen siç përmendet në nenet 18- 28 të kësaj Konvente;
- c) “viktimë” do të thotë çdo fëmijë që i nënshtrohet shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual.

Kapitulli II

Masat parandaluese

Neni 4

Parimet

Çdo palë do të marrë masat e domosdoshme ligjore apo të llojit tjetër për të parandaluar të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për të mbrojtur fëmijët.

Neni 5

Rekrutimi ose trajnimi dhe rritja e njohurive të personave në kontakt me fëmijët

1. Secila palë do të marrë masa të domosdoshme legjislative dhe masa të tjera për të inkurajuar rritjen e njohurive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve midis personave që kanë kontakte të rregullta me fëmijët në arsim, shëndetësi, mbrojtjen sociale, në sektorët gjyqësorë të zbatimit të ligjit dhe në fusha që lidhen me sportin, kulturën dhe pikat e argëtimit.

2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative dhe masat e tjera për të siguruar se personat, që përmenden në paragrafin 1, të kenë njohuri të përshtatshme për shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve, të mjekteve për të identifikuar ato dhe mundësinë përmendur në nenin 12, paragrafi 1.

3. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme ligjore dhe masa të tjera, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, për të garantuar se kushtet për t'u futur në këto profesione, ushtrimi i të cilave nënkupton kontakte të shumta me fëmijët garantojnë që kandidatët për këto profesione të mos kenë qenë të dënuar për akte të shfrytëzimit seksual apo abuzimit seksual të fëmijëve.

Neni 6

Arsimi për fëmijët

Secila palë duhet të marrë masat e domosdoshme për të siguruar që fëmijët gjatë arsimit fillor dhe të mesëm të marrin informacion për rreziqet e shfrytëzimit seksual të abuzimit seksual, si dhe për mjetet për të mbrojtur vetveten, të përshtatura sipas kapaciteteve të tyre zhvillimore. Ky informacion do të jepet në bashkëpunim me prindërit, ku është e mundur, do të jepet brenda një konteksti më të përgjithshëm të informacionit për seksualitetin dhe do t'u kushtojë vëmendje të veçantë situatave të rrezikut, veçanërisht atyre që përfshijnë përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe të komunikimit.

Neni 7

Programet ose masat e ndërhyrjes parandaluese

Secila palë do të garantojë që personat të cilët kanë frikë se mund të kryejnë ndonjë prej veprave penale të përcaktuara sipas kësaj Konvente të zhvillojnë, aty ku është e mundur, programe ose masa të ndërhyrjes efektive të planifikuara për të vlerësuar dhe parandaluar rrezikun e veprave penale, si dhe rrezikun që të mos kryhen vepra penale.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 8

Masat për publikun në përgjithësi

1. Secila palë do të promovojë ose do të kryejë fushata për rritjen e sensibilitetit drejtuar publikut të gjerë duke dhënë informacion për fenomenin e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual dhe për masat parandaluese që mund të ndërmerren.
2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të parandaluar ose ndaluar përhapjen e materialeve, që reklamojnë veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

Neni 9

Pjesëmarrja e fëmijëve, sektori privat, media dhe shoqëria civile

1. Secila palë do të inkurajojë pjesëmarrjen e fëmijëve, në përputhje me kapacitetin e tyre zhvillimor, në zhvillimin dhe implementimin e politikave, programeve ose iniciativave të tjera shtetërore në lidhje me luftën kundër shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual të fëmijëve.
2. Secila palë do të inkurajojë sektorin privat, në veçanti sektorin e teknologjisë së informacionit të komunikimit, industrinë e turizmit dhe të udhëtimit, dhe sektorin bankar e financiar, si dhe shoqërinë civile, që të marrin pjesë në përpunimin dhe zbatimin e politikave për parandalimin e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për të implementuar normat e brendshme nëpërmjet vetërregullimit ose bashkërregulloreve.
3. Secila palë do të inkurajojë mediat që të japë informacionin e duhur në lidhje me të gjitha aspektet e abuzimit seksual të fëmijëve, duke respektuar plotësisht pavarësinë e medias dhe lirinë e shtypit.
4. Secila palë do të inkurajojë financimin, duke përfshirë, ku është e mundur, duke krijuar fonde, projekte dhe programe, që kryhen nga shoqëria civile, me synimin për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual.

Kapitulli III

Autoritetet e specializuara dhe organet bashkërenduese

Neni 10

Masa kombëtare të bashkërendimit dhe të bashkëpunimit

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme për të siguruar bashkërendimin në nivel kombëtar ose vendor midis agjencive të ndryshme që përgjigjen për mbrojtjen nga; parandalimin dhe luftën kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve, përkatësisht sektori i arsimit, sektori i shëndetësisë, shërbimet sociale dhe autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore.
2. Secila palë duhet të marrë masat e domosdoshme legjislative apo masa të tjera për të ngritur ose planifikuar:
3. institucione kombëtare ose vendore të pavarura për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, duke siguruar që atyre t'u jepen burimet dhe përgjegjësitë specifike;
4. mekanizmat për mbledhjen e të dhënave ose pikave të fokusit në nivel kombëtar dhe ose vendor në bashkëpunim me shoqërinë civile, me qëllim që të vëzhgohet dhe vlerësohet fenomeni i shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve, duke respektuar plotësisht kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Secila palë do të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente shtetërore, të shoqërisë civile, të sektorit privat, në mënyrë që të parandalohet e të luftohet më mirë shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual i fëmijëve.

Kapitulli IV

Masat mbrojtëse dhe asistencë e projektimit

Neni 11

Parimet

1. Secila palë do të krijojë programe efektive sociale dhe do të ngrejë struktura shumëdisiplinore për të dhënë mbështetjen e domosdoshme për viktimat, të afërmit e tyre të afërt dhe për ndonjë person, që përgjigjet për kujdesin e tyre.

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative dhe masa të tjera për të garantuar që kur mosha e viktimës është jo e sigurt dhe ka arsye për të besuar se viktimë është fëmijë, masat e mbrojtjes dhe të asistencës, dhënë fëmijëve, të jenë në përputhje me verifikimin në pritje të moshës së tij ose të saj.

Neni 12

Raportimi i dyshimit për shfrytëzim seksual ose abuzim seksual

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që konfidencialiteti i imponuar nga ligji i brendshëm për profesionistë të caktuar që thirren për të punuar në kontakt me fëmijët nuk do të përbëjë ndonjë pengesë për mundësinë e këtyre profesionistëve, që t'u raportojnë shërbimeve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në çdo situatë kur ata kanë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një fëmijë është viktimë e shfrytëzimit seksual ose e abuzimit seksual.

2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të inkurajuar çdo person që di ose dyshon, në mirëbesim, shfrytëzimin seksual ose abuzimin seksual të fëmijëve për t'ua raportuar këto fakte shërbimeve kompetente.

Neni 13

Linjat e ndihmës

Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera, për të inkurajuar dhe mbështetur ngritjen e shërbimeve të informacionit, të tilla si: linjat e ndihmës telefonike apo internetit për t'u dhënë këshilla telefonuesve, edhe në mënyrë konfidenciale ose duke respektuar plotësisht anonimitetin e tyre.

Neni 14

Asistenca për viktimat

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të asistuar viktimat për një afat të shkurtër dhe të gjatë, për shërimin e tyre fizik dhe psikosocial. Masat e marra sipas këtij paragrafi do të marrin parasysh plotësisht pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijës.

2. Secila palë do të marrë masat, sipas kushteve që parashikon ligji i brendshëm, për të bashkëpunuar me organizata joqeveritare, organizata të tjera përkatëse ose elemente të tjera të shoqërisë civile të përfshira për asistencën e viktimave.

3. Kur prindërit ose personat, që kujdesen për fëmijët, janë përfshirë në shfrytëzimin ose abuzimin e tij ose të saj seksual, procedurat e ndërhyrjes që merren me zbatimin e nenit 11, paragrafi 1, do të përfshijnë:

a) mundësinë e largimit të personit i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, të pretenduar;

b) mundësinë e largimit të viktimës nga mjedisi i familjes së tij ose të saj. Kushtet dhe kohëzgjatja e këtij largimi do të përcaktohet në përputhje me interesat më të mira të fëmijës.

4. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që personat, të cilët janë të afërm me viktimën, të mund të përfitojnë, kur mundet, nga asistenca terapeutike, përkatësisht kujdesi psikologjik i emergjencës.

Kapitulli V

Programet dhe masat e ndërhyrjes

Neni 15

Parime të përgjithshme

1. Secila palë do të sigurojë ose promovojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, programet ose masat efektive të ndërhyrjes për personat që përmenden në nenin 16, paragrafi 1 dhe 2, me synimin për të parandaluar dhe minimizuar rreziqet e veprave penale të përsëritura të një natyre seksuale kundër fëmijëve. Këto programe ose masa do të merren në çdo kohë gjatë procedimeve, brenda dhe jashtë burgut, sipas kushteve të parashtruara në ligjin e brendshëm.

2. Secila palë do të sigurojë ose promovojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, zhvillimin e partneritetit ose formave të tjera të bashkëpunimit midis autoriteteve kompetente, në veçanti shërbimeve të

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale dhe autoriteteve gjyqësore dhe organeve të tjera përgjegjëse për ndjekjen e personave që përmenden në nenin 16, paragrafi 1 dhe 2.

3. Secila palë do të parashikojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, vlerësimin e rrezikshmërisë dhe rreziqeve të mundshme të përsëritjes së veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë nga personat që përmenden në nenin 16, paragrafi 1 dhe 2, me synimin e identifikimit të programeve dhe masave të përshtatshme.

4. Secila palë do të parashikojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, vlerësimin e efektivitetit të programeve dhe masave të implementuara.

Neni 16

Përfituesit e programeve dhe masave të ndërhyrjes

1. Secila palë do të sigurojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, që personat, të cilët u nënshtrohen procedimeve kriminale për ndonjë nga shkeljet e përcaktuara, sipas kësaj Konvente, të mund të kenë akses për programet ose masat e përmendura në nenin 15, paragrafi 1, sipas kushteve të cilat të mos jenë as dëmtuese as në kundërshtim me të drejtat e mbrojtjes dhe me kërkesat e një gjyqi të paanshëm dhe objektiv e veçanërisht duke respektuar plotësisht rregullat që sundojnë parimin e prezumimit të pafajësisë.

2. Secila palë do të sigurojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, që personat e dënuar për një nga shkeljet e përcaktuara sipas kësaj Konvente, të mund të kenë akses për programet ose masat e përmendura në nenin 15, paragrafi 1.

3. Secila palë do të sigurojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, që të zhvillohen ose përshtaten programet ose masat e ndërhyrjes për të plotësuar nevojat zhvillimore të fëmijëve ndaj të cilëve është bërë shkelje seksuale, duke përfshirë ata që janë poshtë moshës së përgjegjësisë penale, me synimin për të adresuar problemet e sjelljes së tyre seksuale.

Neni 17

Informacioni dhe miratimi

1. Secila palë do të sigurojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, që personat, që përmenden në nenin 16, të cilëve u janë propozuar programet ose masat e ndërhyrjes, të informohen plotësisht për arsyet e propozimit dhe miratimin për programin ose masën duke i njohur plotësisht faktet.

2. Mund t'i refuzojnë ato dhe në rastin e personave të dënuar, ata të informohen për pasojat e mundshme, që mund të ketë refuzimi.

Kapitulli VI

Ligji substantiv penal

Neni 18

Abuzimi seksual

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme:

a) Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, i cili, sipas dispozitave përkatëse të ligjit kombëtar, nuk e ka arritur moshën ligjore për aktivitete seksuale;

b) Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë kur:

a. përdoret shtrëngimi, forca ose kërcënimet; ose

b. abuzimi bëhet nga një pozicion i njohur i besimit, autoritetit ose influencës mbi fëmijën, duke përfshirë dhe brenda familjes; ose

c. abuzimi bëhet nga një situatë veçanërisht e cënueshme e fëmijës, përkatësisht për shkak të aftësisë së kufizuar mendore ose fizike ose të një situatë të varësisë.

2. Për qëllimin e paragrafit 1 më sipër, secila palë do të vendosë moshën, poshtë së cilës ndalohet angazhimi në aktivitete seksuale me një fëmijë. Dispozitat e paragrafit 1.a nuk synojnë të rregullojnë aktivitetet seksuale konsensuale midis të miturve.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

Neni 19

Veprat penale që kanë të bëjnë me prostitucionin e fëmijës

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme:

- a) rekrutimi i fëmijës në prostitucion ose bërja e një fëmije që të marrë pjesë në prostitucion;
- b) shtrëngimi i një fëmije për të bërë prostitucion ose për të përfituar nga kjo ose në raste të tjera shfrytëzimi i fëmijës për qëllime të tilla;
- c) përdorimi i prostitucionit të fëmijëve.

2. Për qëllimin këtij neni, termi “prostitucion fëmije” do të thotë fakti i përdorimit të fëmijës për aktivitete seksuale kur jepen para ose ndonjë formë shpërblimi ose konsiderate ose premtohet si pagesë, pavarësisht nëse kjo pagesë, ky premtim ose konsiderim bëhet për fëmijën apo për një person të tretë.

Neni 20

Krimet në lidhje me pornografinë e fëmijës

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme, kur kryhet pa të drejtë:

- a) prodhimi i pornografisë së fëmijëve;
- b) ofrimi ose vënia në dispozicion e pornografisë së fëmijëve;
- c) shpërndarja ose transmetimi i pornografisë së fëmijëve;
- d) përdorimi i pornografisë së fëmijëve për vete ose për ndonjë person tjetër;
- e) posedimi i pornografisë së fëmijës;
- f) krijimin e aksesit në mënyrë të vetëdijshme për pornografinë e fëmijës, nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

2. Për qëllimin e këtij neni, termi “pornografi fëmije” do të thotë çdo material që vizualisht pasqyron një fëmijë të angazhuar në një sjellje eksplicite reale ose të simuluar seksuale ose ndonjë pasqyrim i organeve seksuale të fëmijës për qëllimet seksuale parësore.

3. Secila palë mund të rezervojë të drejtën të mos e aplikojë tërësisht ose pjesërisht paragrafin 1.a dhe e për prodhimin dhe posedimin e materialeve pornografike:

- a) që përbëhet ekskluzivisht nga pasqyrimet të simuluar ose imazhe realiste të një fëmije joekzistent;
- b) që përfshijnë fëmijë, që kanë arritur moshën e përcaktuar në aplikimin e nenit 18, paragrafi 2, ku këto imazhe posedohen prej tyre, me pëlqimin e tyre dhe vetëm për përdorimin e tyre privat.

4. Secila palë mund të rezervojë të drejtën të mos aplikojë, tërësisht ose pjesërisht paragrafin 1.f.

Neni 21

Veprat penale që lidhen me pjesëmarrjen e një fëmije në performanca pornografike

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme:

- a) rekrutimin e fëmijës për të marrë pjesë në performanca pornografike ose bërjen e një fëmije që të marrë pjesë në të tilla performanca;
- b) shtrëngimi i një fëmije që të marrë pjesë në performanca pornografike ose përfitimi nga shfrytëzimi ose në raste të tjera prej shfrytëzimit të fëmijës për këto qëllime;
- c) marrja pjesë me vetëdije në performancat pornografike, që përfshijnë pjesëmarrjen e fëmijëve.

2. Secila palë mund të rezervojë të drejtën që të kufizojë aplikimin e paragrafit 1.c për rastet kur fëmijët janë rekrutuar ose shtrënguar në përputhje me paragrafin 1.a ose b.

Neni 22

Korrupsioni i fëmijëve

Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e shkakut të qëllimshëm, për qëllime seksuale, të një fëmije që nuk ka arritur moshën e përcaktuar në zbatimin

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

e nenit 18, paragrafi 2, që të jetë dëshmitar i abuzimit seksual ose aktiviteteve seksuale, edhe pa qenë pjesëmarrës.

Neni 23

Tundimi i fëmijëve për qëllime seksuale

Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e propozimit të qëllimshëm, nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, të një të rrituri për të takuar një fëmijë, që nuk e ka mbushur moshën e përcaktuar në zbatim të nenit 18, paragrafi 2, për qëllimin e kryerjes së ndonjërës prej veprave penale të përcaktuara, në përputhje me nenin 18, paragrafi 1.a, ose nenin 20, paragrafi 1.a, kundër tij ose saj, kur ky propozim pasohet nga akte materiale që çojnë në një takim të tillë.

Neni 24

Ndihma ose shtytja dhe tentativa

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim, ndihma ose shtytja për të kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim, tentativat për të kryer një nga veprat penale, të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

3. Secila palë mund të rezervojë të drejtën të mos e aplikojë tërësisht ose pjesërisht paragrafin 2 për shkeljet në përputhje me nenin 20, paragrafi 1.b, d, e, dhe f, neni 21, paragrafi 1.c, neni 22 dhe neni 23.

Neni 25

Juridiksioni

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të vendosur juridiksionin mbi veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, kur vepra penale kryhet:

- a) në territorin e saj; ose
- b) në bordin e një anijeje që mban flamurin e asaj pale; ose
- c) në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të asaj pale; ose
- d) prej një nga shtetasit e saj; ose
- e) prej një personi që banon rregullisht në territorin saj.

2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të vendosur juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, kur vepra penale kryhet kundër njërit prej shtetasve të saj ose një personi, që banon rregullisht në territorin saj.

3. Secila palë mundet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose aderimit, me një deklaratë të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë se ajo rezervon të drejtën për të mos i aplikuar ose për t'i aplikuar vetëm në raste ose kushte specifike rregullat e juridiksionit të parashtruara në paragrafin 1.e të këtij neni.

4. Për ndjekjen e veprave penale të përcaktuara në përputhje me nenet 18, 19, 20, paragrafi 1.a dhe 21, paragrafi 1.a dhe b të kësaj Konvente, secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që juridiksioni në lidhje me paragrafin 1.d të mos varet nga kushti që aktet kriminalizohen në vendin ku kryhen.

5. Secila palë mundet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose aderimit, me një deklaratë të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë se ajo rezervon të drejtën për ta kufizuar aplikimin e paragrafit 4 të këtij neni, në lidhje me nenin 18, paragrafi 1.b, pika e dytë dhe e tretë, në rastet shtetasit e saj banojnë rregullisht në territorin saj.

6. Për ndjekjen e veprave penale të përcaktuara në përputhje me nenet 18, 19, 20, paragrafi 1.a dhe 21, paragrafi 1.a dhe b të kësaj Konvente, secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që juridiksioni në lidhje me paragrafin 1.d të mos varet nga kushti që ndjekja mund të iniciohet pas një raporti për viktimën ose një denoncimi nga shteti në vendin e të cilit u krye vepra penale.

7. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të vendosur juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, në rastet kur një person i cili

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ka kryer veprën penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, të pretenduar, është i pranishëm në territorin e saj dhe ajo nuk e ekstradon atë tek një palë tjetër, vetëm bazuar në kombësinë e tij ose të saj.

8. Kur juridiksionin mbi veprën penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë e pretendojnë më tepër se një palë, palët e përfshira, kur është e mundur, do të konsultohen me synimin për të përcaktuar juridiksionin më të përshtatshëm për ndjekjen.

9. Pa paragjykuar rregullat e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar, kjo Konventë nuk përjashton ndonjë juridiksion penal të ushtruar nga një palë në përputhje me ligjet e saj të brendshme.

Neni 26

Përgjegjësia shoqërore

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që një person juridik të mund të përgjigjet për një veprë penale të kryer në përputhje me këtë Konventë, e kryer për përfitimin e një personi fizik, që vepron ose individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, i cili ka një pozitë drejtuese brenda personit juridik, bazuar në:

- a) të drejtën e përfaqësimit të personit juridik;
- b) një autoritet për të marrë vendime në emër të personit juridik;
- c) një autoritet për të ushtruar kontroll brenda personit juridik.

2. Përveç rasteve tashmë të parashikuara në paragrafin 1, secila Palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që një person juridik të mund të përgjigjet kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person fizik, përmendur në paragrafin 1, ka bërë të mundur kryerjen e një veprë penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, në përfundim të personit juridik nga ana e personit fizik, që vepron me autoritetin e tij.

4. Duke iu nënshtruar parimeve ligjore të palës, përgjegjësia e personit ligjor mund të jetë penale, civile ose administrative.

5. Kjo përgjegjësi do të jetë pa paragjykim për përgjegjësinë penale të personave fizike që kanë kryer veprën penale.

Neni 27

Sanksionet dhe mjetet

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar se veprat penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë të ndëshkohen me sanksione efektive, proporcionale dhe penguese, duke marrë parasysh seriozitetin e tyre. Këto sanksione do të përfshijnë penalitetet që përfshijnë privimin e lirisë, e cilat mund të çojë në ekstradim.

2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera që personat juridike, që përgjigjen sipas nenit 26, t'u nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale dhe penguese, që do të përfshijnë gjoka monetare penale ose jo penale dhe mund të përfshijë në masat e tjera, në veçanti:

- a) përjashtimin nga e drejta për përfitime ose ndihmë publike;
- b) skualifikimi i përkohshëm ose i përhershëm nga praktikatat e aktivitetëve komerciale;
- c) vënia nën mbikëqyrje gjyqësore;
- d) një urdhër gjyqësor përfundimtar.

3. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera:

a) për të siguruar kapjen dhe konfiskimin e:

- mallrave, dokumenteve dhe instrumenteve të tjera të përdoruar për kryerjen e veprës penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë ose për të lehtësuar kryerjen e tyre.

- të ardhurat, që rrjedhin nga këto vepra penale ose pasuria vlera e së cilës korrespondon me këto të ardhura;

b) për të mundësuar mbylljen e përkohshme të ndonjë biznesi, që përdoret për të kryer ndonjë prej veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, pa paragjykuar të drejtën e palëve të treta për mirëbesim, ose për t'i mohuar personit i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, përkohësisht ose përgjithmonë ushtrimin e aktivitetit vullnetar, që përfshin kontakte me fëmijët, gjatë të cilit është kryer vepra penale.

4. Secila palë do të përpiqet të marrë masa të tjera në lidhje me personin, i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, si heqja e të drejtës prindërore ose monitorimi ose mbikëqyrja e personave të dënuar.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

5. Secila Palë mund të përcaktojë që të ardhurat e krimit ose të pasurisë, të konfiskuara në përputhje me këtë nen, të mund të alokohen për një fond të veçantë në mënyrë që të financojë programet e parandalimit dhe të asistencës për viktimat e ndonjëres prej veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

Neni 28

Rrethanat rënduese

Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që rrethana e mëposhtme, për aq kohë sa ato nuk formojnë pjesë të elementeve përbërëse të një veprave penale, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, mund të merren në konsideratë si rrethana rënduese për përcaktimin e sanksioneve në lidhje me shkeljet të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë:

- a) vepra penale ka dëmtuar seriozisht shëndetin fizik ose mendor të viktimës;
- b) vepra penale është paraprirë ose shoqëruar me akte torture ose të dhunës serioze;
- c) vepra penale është kryer kundër një viktime veçanërisht e cënueshme;
- d) vepra penale është kryer nga një pjesëtar i familjes, një person që bashkëjeton me fëmijën ose një person që ka abuzuar me autoritetin e tij ose të saj;
- e) vepra penale është kryer nga njerëz të ndryshëm që veprojnë së bashku;
- f) vepra penale është kryer brenda kuadrit të një organizate kriminale;
- g) personi, i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, ka qenë i dënuar më parë për vepra penale të së njëjtës natyrë.

Neni 29

Dënimet e mëparshme

Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar mundësinë për të marrë parasysh dënimet e formës së prerë të dhëna nga një palë tjetër në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë kur vendosen sanksionet.

Kapitulli VII

Hetimi, ndjekja dhe ligji procedural

Neni 30

Parimet

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar hetimet dhe procedimet penale kryhen me interesat më të mira dhe respektimin e të drejtave të fëmijës.

2. Secila palë do të adoptojë një trajtim mbrojtës ndaj viktimave, duke siguruar që hetimet dhe procedimet penale të mos përkeqësojnë traumën e përjetuar nga fëmija dhe që përgjigja e drejtësisë penale të pasohet nga asistenca, kur është e mundur.

3. Secila palë do të sigurojë që hetimet dhe procedimet penale të trajtohen si përparësi dhe të kryhen pas asnjë vonesë të pajustificuar.

4. Secila palë do të sigurojë masat e aplikueshme sipas këtij kapitulli nuk paragjykojnë të drejtat e mbrojtjes dhe kërkesat për një gjyq të paanshëm dhe objektiv, në përputhje me nenin 6 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

5. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar, në përputhje me parimet themelore të ligjit të saj të brendshëm:

a) për të siguruar një hetim dhe ndjekje efektive të veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë duke lejuar, kur mundet, mundësinë e operacioneve të fshehta;

b) për t'u mundësuar shërbimeve investigative që të identifikojnë viktimat e shkeljeve, në veçanti duke analizuar materialet e pornografisë me fëmijët, të tilla si fotografitë, regjistrimet audio-vizuale të transmetuara ose të vëna në dispozicion përdorimit të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

Neni 31

Masa të përgjithshme të mbrojtjes

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve penale, në veçanti:

a) duke i informuar ata për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe, vetëm nëse ata nuk kanë dëshirë ta marrin një informacion të tillë, me ecimin e ankesës së tyre, akuzat, progresin e përgjithshëm të hetimit ose procedimeve dhe rolin tyre në to si dhe rezultatit e çështjeve të tyre;

b) duke siguruar të paktën, në rastet kur viktimat dhe familjet e tyre mund të jenë në rrezik, që ata mund të informohen, nëse e është e domosdoshme, kur personi i proceduar ose i dënuar lirohet përkohësisht ose përfundimisht;

c) duke u mundësuar atyre në një mënyrë që të përputhet me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, që të dëgjohen, të paraqesin prova dhe të zgjedhin mjetet e paraqitjes së pikëpamjeve, nevojave dhe shqetësimeve të tyre drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi dhe të konsiderohen;

d) duke u dhënë atyre shërbimet e përshtatshme të përkrahjes, në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh;

e) duke mbrojtur jetën e tyre private, identitetin e tyre dhe imazhin tyre dhe duke marrë masa në përputhje me ligjin e brendshëm për të parandaluar përhapjen publike të ndonjë informacioni që mund të çonte në identifikimin e tyre;

f) duke garantuar sigurinë e tyre, si dhe të familjeve dhe dëshmitarëve në emër të tyre, nga frikësimi, hakmarrja dhe viktimizimi i përsëritur;

g) duke siguruar që kontakti midis viktimave dhe personave, të cilët kanë kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, brenda gjykatës dhe mjediseve të agjencisë së zbatimit të ligjit, të shmanget, me përjashtim të rastit kur autoritete kompetente vendosin ndryshe për interesin më të mirë të fëmijës ose ku hetimet ose procedimet e kërkojnë këtë kontakt.

2. Secila palë do të sigurojë që viktimat të kenë të drejtë që në kontaktin e parë të tyre me autoritete kompetente për informacion, për procedimet përkatëse gjyqësore dhe administrative.

3. Secila palë do të sigurojë që viktimat të kenë të drejtë që do t'u garantohet falas, kur autorizohet, ndihmë ligjore, kur është e mundur për ta, që të kenë statusin palëve në procedimet penale.

4. Secila palë do të parashikojë mundësinë e autoriteteve gjyqësore për të emëruar një përfaqësuesit të veçantë për viktimën kur, me ligjin e brendshëm, ai ose ajo mund të ketë statusin e palës në procedimet penale dhe kur mbajtësit e përgjegjësisë prindërore përjashtohen nga përfaqësimi i fëmijës në këto procedime si rezultat i një konflikti të interesit midis tyre dhe viktimës.

5. Secila palë do të sigurojë me anë të masave të parashikuara në ligjin e brendshëm, mundësinë për grupet, fondacionet, shoqatat ose organizatat qeveritare ose joqeveritare dhe/ose të mbështetnin viktimat me pëlqimin e tyre gjatë procedimeve penale në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

6. Secila palë do të sigurojë që informacioni që u jepet viktimave, në përputhje me dispozitat e këtij neni, të jepet në një mënyrë të përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e tyre dhe në një gjuhë që ata ta kuptojnë.

Neni 32

Fillimi i procedimeve

Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera, për të siguruar që hetimet ose procedimet e veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë nuk do të varen nga raporti ose akuza e bërë nga viktimat dhe që procedimet mund të vazhdojnë edhe në qoftë se viktimat i ka tërhequr deklaratat e tij ose të saj.

Neni 33

Statuti i kufizimit

Për fillimin e procedimeve në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenet 18, 19, paragrafi 1.a, dhe d, dhe 21, paragrafi 1.a dhe b, do të vazhdojnë për një periudhë kohe të mjaftueshme që të lejojë fillimin eficient të procedimeve pasi viktimat ka mbushur moshën madhore dhe e cila është proporcionale me gravitetin e krimit në fjalë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 34

Hetimet

Secila palë do të marrë të tilla masa që mund të jenë të domosdoshme për të siguruar që personat, njësitë ose shërbimet që përgjigjen për hetimet të jenë të specializuar në fushën e luftës kundër shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual të fëmijëve ose që personat të jenë të trajnuar për këtë qëllim. Këto njësi ose shërbime do të kenë burime të përshtatshme financiare, pasiguria për moshën faktike të viktimës nuk do të pengojë fillimin e hetimeve penale.

Neni 35

Intervistat me fëmijët

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që:
 - a) intervistat me fëmijën do të kryhen pa vonesë të pajustificuar pasi të jenë raportuar faktet tek autoritetet kompetente;
 - b) intervistat me fëmijën do të kryhen, kur është e domosdoshme, në mjediset e përcaktuara ose të adaptuara për këtë qëllim;
 - c) intervistat me fëmijën do të kryhen nga profesionistë të trajnuar për këtë qëllim;
 - d) të njëjtët njerëz në qoftë se është e mundur dhe kur është e përshtatshme, kryejnë të gjitha intervistat me fëmijën;
 - e) numri i intervistave është i kufizuar sa të jetë e mundur dhe vetëm dhe në mënyrë të rreptë aq sa është e domosdoshme për qëllimin e procedimeve penale;
 - f) fëmija mund të shoqërohet nga përfaqësuesi i tij ose i saj ligjor, ose, ku është e përshtatshme, një i rritur që ai ose ajo e ka zgjedhur vetë, me përjashtim kur ka një vendim të arsyetuar që interesohet për të kundërtën duke respektuar atë person.
2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që të gjitha intervistat me viktimën ose, kur është e përshtatshme, ato me një fëmijë dëshmitar, mund të regjistrohen në video dhe këto intervista të regjistruara mund të pranohen si prova gjatë procedimeve në gjykatë, në përputhje me rregullat që parashikon ligji i brendshëm.
3. Kur moshë e viktimës nuk është e sigurt dhe ka arsye për të besuar që viktima është fëmijë, masat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 do të aplikohen në pritje të verifikimit të moshës së tij ose të saj.

Neni 36

Procedimet penale të gjykatës

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera duke respektuar plotësisht rregullat që sundojnë autonominë e profesioneve ligjore të garantojë që trajnimi për të drejtat e fëmijëve dhe shfrytëzimi seksual e abuzimi seksual i fëmijëve të jetë i disponueshëm për të përfutur nga të gjithë personat e përfshirë në procedime, tek gjykatës të veçantë, prokurorë dhe avokatë.
2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar, sipas rregullave të ligjit të brendshëm, që:
 - a) gjykatësi të mund të urdhërojë që seanca të kryhet pa praninë e publikut;
 - b) viktima të mund të dëgjohet në sallën e gjyqit pa qenë i pranishëm, përkatësisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit.

Kapitulli XIII

Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave

Neni 37

Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave kombëtare për personat e dënuar për veprën penale seksuale

1. Për qëllimet e parandalimit e ndjekjes së veprave penale në përputhje me dispozitat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave personale, për të mbledhur dhe ruajtur dhe rregullat e tjera të përshtatshme dhe siç përshkruhen nga ligji i brendshëm, të dhënat që lidhen me identitetin dhe profilin gjenetik (ADN) të personave të dënuar për veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Secila palë në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, i komunikon emrin dhe adresën e autoritetit të vetëm kombëtar që përgjigjet për qëllimet e paragrafit 1.

3. Secila palë do të përpaket të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera, për të siguruar që informacioni që përmendet në paragrafin 1 mund t'i transmetohet autoritetit kompetent të secilës palë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligjin e saj të brendshëm dhe në instrumentet përkatëse ndërkombëtare.

Kapitulli IX

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Neni 38

Parimet dhe masat e përgjithshme për bashkëpunimin ndërkombëtar

1. Palët duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe nëpërmjet aplikimit të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale të aplikueshme, rregullimet për të cilat është rënë dakord mbi bazën e një legjislacioni uniform ose reciprok dhe ligjeve të brendshme, deri në gamën më të gjerë të mundshme, për qëllimin e:

- a) parandalimit dhe luftës kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve;
- b) mbrojtjes dhe dhënien e asistencës për viktimat;
- c) hetimit ose procedimit në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

2. Secila palë do të përpaket të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që viktimat e një vepre penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë në territorin e një pale, që është i ndryshëm nga ai ku ata banojnë mund të bëjë një ankesë para autoriteteve kompetente për shtetin e tyre të banimit.

3. Nëse pala që e bën asistencën reciproke ligjore në çështjet penale apo ekstradimin të kushtëzuar nga ekzistenca e një traktati merr një kërkesë për asistencë ligjore ose ekstradim nga një palë me të cilën ajo nuk ka firmosur një traktat të tillë, ajo mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazën ligjore për asistencën reciproke ligjore në çështje penale ose për ekstradimin në lidhje me veprat penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë.

4. Secila palë do të përpaket që ta integrojë, aty ku është përshtatshme, parandalimin e luftës kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve në programet e asistencës për zhvillimin të parashikuara për përfitimin e shteteve të treta.

Kapitulli X

Mekanizmi i monitorimit

Neni 39

Komiteti i Palëve

1. Komiteti i Palëve do të përbëhet nga përfaqësues të palëve në Konventë.
2. Komiteti i Palëve do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Mbledhja e tij e parë do të mbahet brenda një periudhe njëvjeçare, pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, pasi ta ketë ratifikuar atë pala e dhjetë nënshkruese. Pas kësaj ai do të mbledhet sa herë që të paktën një e treta e palëve ose sekretari i përgjithshëm e kërkon atë.
3. Komiteti i Palëve do të miratojë rregullat e tij të procedurës.

Neni 40

Përfaqësues të tjerë

1. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, Komisionieri për të Drejtat e Njeriut, Komiteti European për Problemet e Krimit (CDPC), si dhe komitetet përkatëse të tjera ndërqeveritare të Këshillit të Europës, secili, do të emërojë një përfaqësues në Komitetin e Palëve.

2. Komiteti i Ministrave mund të ftojë organe të tjera të Këshillit të Europës për të emëruar një përfaqësues në Komitetin e Palëve pasi të jetë konsultuar me këtë të fundit.

3. Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe në veçanti organizatat joqeveritare mund të pranohen si vëzhgues në Komitetin e Palëve sipas procedurës së përcaktuar nga rregullat përkatëse të Këshillit të Europës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

4. Përfaqësuesit e emëruar sipas paragrafëve 1-3 më sipër do të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Palëve pa të drejtë vote.

Neni 41

Funksionet e Komitetit të Palëve

1. Komiteti i Palëve do të monitorojë implementimin e kësaj Konvente; rregullat e procedurës së Komitetit të Palëve do të përcaktojnë procedurën për vlerësimin e implementimit të kësaj Konvente.

2. Komiteti i Palëve do të lehtësojë mbledhjen, analizimin dhe shkëmbimin e informacionit, përvojën dhe praktikën e mirë midis shteteve për të përmirësuar kapacitetet e tyre për të parandaluar e luftuar shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve.

3. Komiteti i Palëve, ku të jetë e përshtatshme:

a) do të lehtësojë dhe përdorimin efektiv dhe implementimin e kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e ndonjë problemi dhe efekteve të ndonjë deklarate apo rezerve të bërë sipas kësaj Konvente.

b) do të shprehë një mendim për ndonjë çështje në lidhje me aplikimin e kësaj Konvente dhe do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit për zhvillimet e rëndësishme ligjor, të politikës ose të teknologjisë.

4. Komiteti i Palëve do të ndihmohet nga Sekretariati i Këshillit të Europës në kryerjen e funksioneve të tij sipas këtij neni.

5. Komiteti Europian për Problemet e Krimit (CDPC) do të informohet në mënyrë periodike në lidhje me aktivitetet e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Kapitulli XI

Marrëdhëniet me instrumente të tjera ndërkombëtare

Neni 42

Marrëdhëniet me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës dhe protokollin me zgjedhje për shitjen e fëmijës, prostitucionin e fëmijës dhe pornografinë e fëmijës

Konventa nuk do të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin nga dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës dhe protokollin me zgjedhje për shitjen e fëmijës, prostitucionin e fëmijës dhe pornografinë e fëmijës dhe synon që të rritë mbrojtjen që i japin ato dhe të zhvillojë e plotësojë standardet që përmbajnë ato.

Neni 43

Marrëdhëniet me instrumente të tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë nuk mund të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet që dilnin nga dispozita e instrumenteve të tjera ndërkombëtare, ndër të cilat palët e kësaj Konvente janë palë ose do të bëhen palë dhe të cilat përmbajnë dispozita për çështje që sundohen nga kjo Konventë dhe të cilat garantojnë një mbrojtje dhe asistencë më të madhe për fëmijën viktimë të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual.

2. Palët e kësaj Konvente mund të konkludojnë marrëveshje shumëpalëshe me njëra-tjetrën, për çështje që trajtohen në këtë Konventë, për qëllimet e plotësimit ose forcimit të dispozitave të saj, ose për lehtësimin e aplikimit të parimeve që ajo mishëron.

3. Palët që janë anëtare të Bashkimit Europian, në marrëdhëniet e tyre reciproke do të aplikojnë rregullat e Komunitetit dhe Bashkimit Europian kur ka rregulla të Komunitetit ose të Bashkimit Europian, që rregullojnë lëndën e veçantë në fjalë dhe janë të aplikueshme për çështjen specifike, pa paragykuar objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente dhe pa paragykuar aplikimin e saj të plotë me palët e tjera.

Kapitulli XII

Amendamentet e Konventës

Neni 44

Amendamentet

1. Çdo propozim për një amendament të kësaj Konventë i paraqitur nga një palë do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit dhe do të paraqitet prej tij ose prej saj para vendeve anëtare të Këshillit të

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Europës, çdo nënshkruesi, çdo shteti palë, Komunitetit European, çdo shteti të ftuar për të nënshkruar këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 45, paragrafi 1 dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në përputhje me dispozitat e nenit 46, paragrafi 1.

2. Çdo amendament i propozuar nga një palë do t'i komunikohet Komitetit European për Problemet e Krimit (CDPC), i cili do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave opinionin e vet për amendamentin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave do të konsiderojë amendamentin e propozuar nga CDPC dhe pas konsultimeve me palët shtetet jo anëtare në këtë Konventë mund të miratojë amendamentin. Teksti i një amendamenti, të miratuar nga Komiteti i Ministrave në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, do t'i paraqitet palëve për pranim.

4. Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason skadimin e periudhës së një muaji pas datës në të cilën palë e kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm që ata e kanë pranuar atë.

Kapitulli XIII Klauzola përfundimtare

Neni 45

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Konventa do të jetë e hapur për t'u nënshkruar nga vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtete jo anëtare, që kanë marrë pjesë në hartimin e saj si dhe Komuniteti European.

2. Konventa i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen tek Sekretari Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason skadimi i periudhës prej tre muajsh nga data në të cilën 5 nënshkrues, duke përfshirë të paktën tre vende anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë të detyruar nga Konventa në përputhje me dispozitat paragrafit të mësipërm.

4. Në lidhje me ndonjë shtet, që përmendet në paragrafin 1, ose Komunitetin European, i cili më pas shpreh pëlqimin e vet për të qenë i ligjuar prej tij Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit, që pason skadimin e periudhës prej 3 muajsh pas datës së depozitimit të këtij instrumenti, ratifikimi, pranimi ose miratimi.

Neni 46

Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës, pas konsultimit me Palët e kësaj Konvente dhe marrjes së miratimit të tyre unianim, mund të ftojë çdo Shtet joanëtar të Këshillit të Europës që nuk ka marrë pjesë në rishikimin e Konventës, të aderojë në këtë Konventë me anë të një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të statutit të Këshillit të Europës dhe me votë unanime të përfaqësuesve të shteteve kontraktues të autorizuar për të qenë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 47

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet ose Komuniteti European, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Në çdo datë të mëvonshme, çdo palë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në ndonjë territor tjetër të përcaktuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës ose në emër të të cilit është i autorizuar të bëjë marrëveshje. Në lidhje me një territor të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve pararendës, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 48

Rezervat

Nuk mund të bëhet asnjë rezervë në lidhje me ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, me përjashtim të rezervave të vendosura shprehimisht. Çdo rezervë mund të tërhiqet në çdo kohë.

Neni 49

Denoncimi

Çdo palë mundet në çdo kohë të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Ky denoncim do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 50

Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Europës, çdo shtet nënshkrues, çdo shtet palë, Komunitetin European, çdo shtet të ftuar për të nënshkruar këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 45 dhe çdo shtet të ftuar për të aderuar në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 46, në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitim të çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 45 dhe 46;
- d) çdo amendim të miratuar në përputhje me nenin 44 dhe datën në të cilën ky amendim hyn në fuqi;
- e) çdo rezervë të bërë sipas nenit 48;
- f) çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të nenit 49;
- g) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Lanzarote, më 25 tetor 2007, në gjuhën angleze dhe frënge, të dyja tekstet njëlloj autentike, në një kopje të vetme e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i dërgojë kopje të vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në rishikimin e kësaj Konvente, Komunitetit European dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë Konventë.

LIGJ

Nr.10 424, datë 2.6.2011

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR STATUSIN JURIDIK TË FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË MARTESËS”¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 77*. Tiranë 2011. f. 3123.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.7013, datë 13.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA EUROPIANE MBI STATUSIN LIGJOR TË FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË MARTESE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të saj,
duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti sa më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, në veçanti me miratimin e rregullave të përbashkëta në fushën e ligjit;
duke vënë re se në një numër të madh të shteteve anëtare janë bërë ose po bëhen përpjekje për të përmirësuar statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese, duke zvogëluar dallimet ndërmjet statusit të tyre ligjor dhe atij të fëmijëve të lindur në martesë të cilat janë në disavantazh juridik ose social të të parëve;
duke njohur se ende ekzistojnë mospërputhje të mëdha në ligjet e shteteve anëtare në këtë fushë;
duke besuar se situata e fëmijëve të lindur jashtë martese duhet të përmirësohet dhe se hartimi i disa rregullave të përbashkëta në lidhje me statusin e tyre ligjor do të ndihmojë këtë objektiv dhe në të njëjtën kohë do të kontribuojë për një harmonizim të ligjeve të shteteve anëtare në këtë fushë;
megjithatë, duke pasur parasysh se është e nevojshme të pranohen etapa progresive për ato shtete të cilat nuk e konsiderojnë veten në gjendje të miratojnë menjëherë disa rregulla të kësaj konvente;
kanë rëndë dakord si më poshtë

Neni 1

Çdo palë kontraktuese merr përsipër të sigurojë përputhshmërinë e ligjit të saj me dispozitat e kësaj konvente dhe të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për masat e marra për këtë qëllim.

Neni 2

Njohja e mëmësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese do të bazohet vetëm në faktin e lindjes së fëmijës.

Neni 3

Njohja e atësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese mund të provohet ose përcaktohet nga njohja vullnetare ose me vendim gjykatë.

Neni 4

Njohja vullnetare e atësisë nuk mund të kundërshtohet ose të kontestohet për aq sa parashikon ligji i brendshëm për këto procedura, përveç kur personi që kërkon të njohë ose që ka njohur fëmijën nuk është babai biologjik.

Neni 5

Veprimet që lidhen me provat shkencore të përkatësisë së atësisë, që mund të ndihmojnë për të vendosur ose kundërshtuar atësinë, janë të pranueshme.

Neni 6

1. Babai dhe nëna e një fëmije të lindur jashtë martese kanë të njëjtin detyrim për t'u kujdesur për fëmijën sikur të ishte lindur në martesë.

2. Kur detyrimi ligjor për t'u kujdesur për një fëmijë të lindur në martesë bie mbi anëtarë të caktuar të familjes së babait ose nënës, ky detyrim zbatohet gjithashtu në interes të fëmijës së lindur jashtë martese.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 7

1. Kur njohja e një fëmije të lindur jashtë martese është përcaktuar për të dy prindërit, autoriteti prindëror nuk mund t'i atribuohet automatikisht vetëm babait.
2. Ekziston mundësia për të transferuar autoritetin prindëror, rastet e transferimit rregullohen me ligj të brendshëm.

Neni 8

Kur babai apo nëna e një fëmije të lindur jashtë martese nuk ka përgjegjësinë prindërore ose kujdestarinë e fëmijës, ky prind mund të përfitojë të drejtën e aksesit të fëmija në rastet e duhura.

Neni 9

Një fëmijë i lindur jashtë martese ka të njëjtën të drejtë të trashëgimisë në pasurinë e babait dhe nënës së tij dhe të një anëtari të familjes së babait ose nënës së tij, sikur të kishte qenë i lindur në martesë.

Neni 10

Martesa ndërmjet babait dhe nënës së një fëmije të lindur jashtë martese i jep fëmijës statusin ligjor të fëmijës të lindur në martesë.

Neni 11

1. Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose të miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
2. Kjo konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimi ose miratimit.
3. Në lidhje me një shtet nënshkrues që e ratifikon, e pranon ose e aprovon më pas, konventa hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi apo miratimit.

Neni 12

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në këtë konventë.
2. Ky aderim bëhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të instrumentit të aderimit, i cili hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 13

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, specifikon territorin ose territoret, në të cilat zbatohet kjo konventë.
2. Çdo shtet, gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, ose në çdo datë të mëvonshme, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë këtë konventë në çdo territor ose territore të tjera të specifikuara në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilave është e autorizuar për të vepruar.
3. Çdo deklaratë e bërë në zbatim të paragrafit të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përmendur në këtë deklaratë, mund të tërhiqet në pajtim me procedurat e përcaktuara në nenin 15 të kësaj konvente.

Neni 14

1. Çdo shtet në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, ose kur bën një deklaratë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 të kësaj konvente, nuk mund të bëjë më shumë se tre rezerva në lidhje me parashikimet e neneve 2 deri 10 të konventës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Rezerva të natyrës së përgjithshme nuk do të lejohen; çdo rezervë nuk mund të veprojë në më shumë se një dispozitë.

2. Një rezervë do të jetë e vlefshme për pesë vjet nga hyrja në fuqi e kësaj konvente për palën kontraktuese në fjalë. Ajo mund të rinovohet për periudha pasuese për pesë vjet me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës përpara skadimit të çdo periudhe.

3. Çdo palë kontraktuese mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë që ka bërë në pajtim me paragrafët e mësipërm me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj.

Neni 15

1. Çdo palë kontraktuese, për aq sa është e interesuar, mund të denoncojë këtë konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes të këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet i cili ka aderuar në këtë konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
 - b) çdo depozitim të një instrumenti të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit;
 - c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenin 11 të saj;
 - d) çdo njoftim të marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 1;
 - e) çdo deklaratë të marrë në zbatim të parashikimeve të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 13;
 - f) çdo rezervë të bërë në zbatim të parashikimeve të paragrafit 1 të nenit 14;
 - g) rivendosja e çdo rezerve të kryer në zbatim të parashikimeve të paragrafit 2 të nenit 14;
 - h) tërheqja e çdo rezerve të kryer në zbatim të parashikimeve të paragrafit 3 të nenit 14;
 - i) çdo njoftim të marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 15 dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi.
- Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Strasburg, më 15 tetor 1975, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet kanë të njëjtën fuqi, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve nënshkruese dhe aderuese.

LIGJ

Nr.10 425, datë 2.6.2011

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE”¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Këshillit të Europës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7014, datë 13.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 77*. Tiranë 2011. f. 3126.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

KONVENTA EUROPIANE MBI USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE STRASBURG, 25.1.1996

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese,
duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;
duke pasur parasysh konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve dhe në veçanti, neni nr.4, i cili i kërkon shteteve palë të marrin të gjitha masat e duhura legjislative, administrative dhe të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura në këtë konventë;

duke vërejtur përmbajtjen e rekomandimit 1121 (1990) të Asamblesë Parlamentare mbi të drejtat e fëmijëve;
të bindur se të drejtat dhe interesat më të mira të fëmijëve duhet të promovohen dhe për këtë qëllim fëmijët duhet të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtat e tyre, në veçanti në procedurat familjare që ndikojnë tek ata;

duke konfirmuar se fëmijëve duhet t'u sigurohet informacion përkatës për të mundësuar promovimin e këtyre të drejtave dhe interesave më të mira dhe që pikëpamjeve të fëmijëve duhet t'u jepet rëndësia e duhur;

duke njohur rëndësinë e rolit të prindërve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave më të mira të fëmijëve dhe duke pasur parasysh se, kur është e nevojshme, shtetet duhet të angazhohen në një mbrojtje dhe promovim të tillë;

duke pasur parasysh, megjithatë, se në rast të konfliktit është e dëshirueshme për familjet që të përpiqen të arrijnë një marrëveshje para se ta paraqesin çështjen para një autoriteti gjyqësor,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I

FUSHA E VEPRIMIT, OBJEKTI I KONVENTËS DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Fusha e veprimit dhe objekti i konventës

1. Kjo konventë zbatohet për fëmijët që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç.
2. Objekti i kësaj konvente është, në interesat më të mira të fëmijëve, që të promovojë të drejtat e tyre, t'u japë atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor.
3. Për qëllime të kësaj konvente, procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë fëmijët janë procedimet familjare, në veçanti ato që përfshijnë ushtrimin e përgjegjësive prindërore, si vendbanimi dhe aksesit te fëmijët.
4. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, përcakton të paktën tri kategori të çështjeve familjare para një autoriteti gjyqësor, për të cilat duhet të zbatohet kjo konventë.
5. Çdo palë, me anë të një deklarate të mëtejshme, mund të përcaktojë kategori shtesë të çështjeve familjare për të cilën duhet të zbatohet kjo konventë ose të japë informacion në lidhje me zbatimin e nenit 5, paragrafi 2 të nenit 9, paragrafin 2 të nenit 10 dhe nenin 11.
6. Asgjë në këtë konventë nuk pengon palët që të zbatojnë rregulla më të favorshme për promovimin dhe ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj konvente:

- a) termi "autoritet gjyqësor" nënkupton një gjykatë ose autoritet administrativ që ka kompetenca të barasvlershme;
- b) termi "mbajtësit e përgjegjësive prindërore" nënkupton prindërit dhe persona të tjerë ose organe, të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë disa ose të gjitha përgjegjësitë prindërore;
- c) termi "përfaqësues" nënkupton një person, si për shembull një avokat apo organ i caktuar për të vepruar para një autoriteti gjyqësor në emër të një fëmije;
- d) termi "informacion përkatës" nënkupton një informacion që është i përshtatshëm për moshën dhe arsyetimin e fëmijës dhe që do të jepet për t'i mundësuar fëmijës të ushtrojë plotësisht të drejtat e tij apo të saj, përveçse kur dhënia e këtij informacioni është në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

KREU II

MASAT PROCEDURALE PËR TË PROMOVUAR USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE A. TË DREJTAT PROCEDURALE TË FËMIJËVE

Neni 3

E drejta për t'u informuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij ose të saj në procedim

Një fëmijë, që sipas ligjit të brendshëm konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm, në rast të procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ai/ajo, i jepet dhe ka të drejtë të kërkojë të drejtat e mëposhtme:

- a) të marrë të gjithë informacionin përkatës;
- b) të konsultohet dhe të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj;
- c) të informohet për pasojat e mundshme të përputhshmërisë me këto pikëpamje dhe pasojat e mundshme të çdo vendimi.

Neni 4

E drejta për të aplikuar për emërimin e një përfaqësuesi të veçantë

1. Në bazë të nenit 9, fëmija ka të drejtë të kërkojë, personalisht ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, një përfaqësues të posaçëm në procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë te fëmija, ku ligji i brendshëm përjashton mbajtësit e përgjegjësive prindërore nga përfaqësimi i fëmijës si rezultat i konfliktit të interesit me këtë të fundit.

2. Shtetet janë të lira të kufizojnë të drejtën në paragrafin 1, të fëmijëve të cilët sipas ligjit të brendshëm, konsiderohen se kanë arsyetim të mjaftueshëm.

Neni 5

Të drejta të tjera të mundshme procedurale

Palët shqyrtojnë mundësinë e dhënies së të drejtave procedurale shtesë fëmijëve në lidhje me procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ata, në veçanti:

- a) të drejtën që të kërkojnë ndihmë nga një person i përshtatshëm i zgjedhur prej tyre, me qëllim që t'i ndihmojë ata për të shprehur pikëpamjet e tyre;
- b) të drejtën që të kërkojnë vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, emërimin e një përfaqësuesi të veçantë, në raste të caktuara, një avokat;
- c) të drejtën për të emëruar përfaqësuesit e tyre;
- d) të drejtën për të ushtruar disa ose të gjitha të drejtat e palëve në këtë procedim.

B. ROLI I AUTORITETEVE GJYQËSORE

Neni 6

Procesi i vendimmarrjes

Në procedimet që ndikojnë te fëmija, para se të marrë një vendim, autoriteti gjyqësor:

- a) shqyrton nëse ka informacione të mjaftueshme në dispozicion, me qëllim që të marrë një vendim në interesat më të mira të fëmijës dhe, kur është e nevojshme, të marrë informacione të mëtejshme, në veçanti nga mbajtësit e përgjegjësive prindërore;
- b) në rastin kur fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet të ketë arsyetim të mjaftueshëm:
 - garanton që fëmija ka marrë të gjithë informacionin përkatës;
 - këshillohet me fëmijën drejtpërdrejt në raste të caktuara, nëse është e nevojshme privatisht, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, në një mënyrë që përshtatet me arsyetimin e tij ose të saj, nëse kjo do të ishte haptazi në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës;
 - lejon fëmijën të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj;
- c) i jep rëndësinë e duhur pikëpamjeve të shprehura nga fëmija.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 7

Detyrimi për të vepruar shpejt

Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor vepron shpejt për të shmangur çdo vonesë të panevojshme dhe vihen në dispozicion procedura për të garantuar që vendimet e tij të zbatohen me shpejtësi. Në raste urgjente, sipas rastit, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të marrë vendime, të cilat janë menjëherë të zbatueshme.

Neni 8

Detyrimi për të vetëvepruar

Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të vepruar sipas kërkesës së vet, në rastet e përcaktuara nga ligji i brendshëm, kur mirëqenia e një fëmije është në rrezik serioz.

Neni 9

Emërimi i një përfaqësuesi

1. Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, ku sipas ligjit të brendshëm mbajtësit e përgjegjësive prindërore përjashtohen nga përfaqësimi i fëmijës, si rezultat i një konflikti interesi ndërmjet tyre dhe fëmijës, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të caktuar një përfaqësues të posaçëm për fëmijën në këto procedime.

2. Palët veprojnë me kusht që, në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor do të ketë kompetencën për të caktuar një përfaqësues të veçantë, në raste të caktuara, një avokat për të përfaqësuar fëmijën.

C. ROLI I PËRFAQËSUESVE

Neni 10

1. Në rastin e procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikon te një fëmijë, përveç nëse kjo do të ishte haptazi në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës, përfaqësuesi:

a) siguron të gjithë informacionin përkatës për fëmijën, nëse fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm;

b) jep shpjegime për fëmijën nëse fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me pasojat e mundshme të përputhshmërisë me pikëpamjet e tij ose të saj dhe pasojat e mundshme të ndonjë veprimi nga ana e përfaqësuesit;

c) përcakton pikëpamjet e fëmijës dhe ia paraqet këto pikëpamje autoritetit gjyqësor.

2. Palët shqyrtojnë shtrirjen e dispozitave të paragrafit 1 për mbajtësit e përgjegjësive prindërore.

D. ZGJERIMI I DISPOZITAVE TË CAKTUARA

Neni 11

Palët shqyrtojnë shtrirjen e dispozitave të neneve 3, 4 dhe 9 në procedimet që ndikojnë te fëmijët para organeve të tjera dhe për çështjet që ndikojnë te fëmijët të cilët nuk janë objekt i procedimeve.

E. ORGANET KOMBËTARE

Neni 12

1. Palët nxisin, nëpërmjet organeve që përmbushin, ndër të tjera, funksionet e përcaktuara në paragrafin 2, promovimin dhe ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

2. Funksionet janë si më poshtë:

a) të bëjnë propozime për të forcuar ligjin në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;

b) të japin mendime në lidhje me projektlegjislacinin mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;

Përmbledhje legjislativi për të miturit

- c) të sigurojnë informacione të përgjithshme në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve në media, publik dhe personave e organeve që merren me çështje që lidhen me fëmijët;
- d) të kërkojnë pikëpamjet e fëmijëve dhe t'i pajisin ata me informacione përkatëse.

F. ÇËSHTJE TË TJERA

Neni 13

Ndërmjetësimi ose proceset e tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Me qëllim parandalimin ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo shmangien e procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë te fëmijët, palët inkurajojnë ofrimin e ndërmjetësimit ose proceseve të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përdorimin e këtyre proceseve për të arritur marrëveshje në rastet e caktuara që duhet të përcaktohen nga palët.

Neni 14

Ndihma dhe këshillimi ligjor

Kur ligji i brendshëm parashikon ndihmë apo këshillim ligjor për përfaqësimin e fëmijëve në procedime para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ata, këto dispozita zbatohen në lidhje me çështjet e mbuluara nga nenet 4 dhe 9.

Neni 15

Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Kjo konventë nuk kufizon aplikimin e çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar që merret me çështjet e veçanta, të cilat dalin në kontekstin e mbrojtjes së fëmijëve dhe familjeve, dhe në të cilin një palë e kësaj konvente është ose bëhet palë.

KREU III

KOMITETI I PËRHERSHËM

Neni 16

Themelimi dhe funksionet e Komitetit të Përherëshëm

1. Komiteti i Përherëshëm është ngritur për qëllimet e kësaj konvente.
2. Komiteti i Përherëshëm mban nën shqyrtim problemet në lidhje me këtë konventë. Ai në veçanti:
 - a) mund të shqyrtojë ndonjë çështje të rëndësishme që lidhet me interpretimin ose zbatimin e konventës. Konkluzionet e Komitetit të Përherëshëm në lidhje me zbatimin e konventës mund të marrin formën e një rekomandimi; rekomandimet miratohen me një shumicë prej tre të katërtat e votave;
 - b) mund të propozojë amendamente të konventës dhe të shqyrtojë ato të propozuara në përputhje me nenin 20;
 - c) mund të ofrojë këshillim dhe ndihmë ndaj organeve kombëtare që funksionojnë në bazë të paragrafit 2 të nenit 12 dhe nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar midis tyre.

Neni 17

Përbërja

1. Çdo palë mund të përfaqësohet në Komitetin e Përherëshëm nga një ose më shumë delegatë. Çdo palë ka një votë.
2. Çdo shtet i përmendur në nenin 21, i cili nuk është palë në këtë konventë, mund të përfaqësohet në Komisionin e Përherëshëm nga një vëzhgues. E njëjta gjë vlen edhe për ndonjë shtet tjetër ose të Komunitetit Europian, pasi të jetë ftuar për të aderuar në konventë në përputhje me dispozitat e nenit 22.
3. Nëse një palë nuk ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm për kundërshtimin e saj, të paktën një muaj para mbledhjes, Komiteti i Përherëshëm mund të ftojë sa më poshtë për të marrë pjesë si vëzhgues në të gjitha takimet e tij ose në një takim apo pjesë të një takimi:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- cilindo shtet që nuk është përmendur në paragrafin 2 më lart;
- Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Komunitetin Europian;
- ndonjë organ ndërkombëtar qeveritar;
- ndonjë organ ndërkombëtar joqeveritar me një ose më shumë funksione të përmendura në paragrafin 2 të nenit 12;
- ndonjë organ kombëtar qeveritar ose joqeveritar me një ose më shumë funksione të përmendura në paragrafin 2 të nenit 12;
- Komiteti i Përhershëm mund të shkëmbejë informacion me organizatat përkatëse që merren me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

Neni 18

Takimet

1. Në fund të vitit të tretë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj konvente dhe me nismën e vet, në çdo kohë, pas kësaj date, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të ftojë Komisionin e Përhershëm për t'u takuar.
2. Vendimet mund të merren vetëm në Komisionin e Përhershëm nëse të paktën gjysma e palëve janë të pranishme.
3. Sipas neneve 16 dhe 20, vendimet e Komitetit të Përhershëm do të merren nga shumica e anëtarëve të pranishëm.
4. Në bazë të dispozitave të kësaj konvente, Komiteti i Përhershëm harton rregullat e veta të procedurës dhe rregullat e procedurës të ndonjë pale pune që mund të jetë ngritur për të kryer të gjitha detyrat e caktuara sipas konventës.

Neni 19

Raportet e Komisionit të Përhershëm

Pas çdo takimi, Komiteti i Përhershëm i përcjell palëve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një raport mbi diskutimet e tij dhe çdo vendim të marrë.

KREU IV

AMENDAMENTET E KONVENTËS

Neni 20

1. Çdo ndryshim në nenet e kësaj konvente i propozuar nga një palë ose nga Komiteti i Përhershëm i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe përcillet nga ai apo ajo, të paktën dy muaj para takimit të ardhshëm të Komitetit të Përhershëm, për shtetet anëtare të Këshillit të Europës, çdo nënshkrues, çdo palë, çdo shtet të ftuar për të nënshkruar këtë konventë në përputhje me dispozitat e nenit 21 dhe çdo shtet apo komunitet europian, ftohen për të aderuar në të në përputhje me dispozitat e nenit 22.
2. Çdo ndryshim i propozuar në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm shqyrtohet nga Komiteti i Përhershëm, i cili dorëzon tekstin e miratuar me një shumicë prej tre të katërtat e votave të hedhura të Komitetit të Ministrave për miratim. Pas miratimit të tij, ky tekst i përcillet palëve për pranim.
3. Çdo ndryshim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të periudhës prej një muaji pas datës në të cilën të gjitha palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se ata e kanë pranuar atë.

KREU V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Nënshkrimi, ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në përpunimin e saj.
2. Kjo konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose të miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

3. Kjo konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tre shtete, duke përfshirë të paktën dy shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me konventën në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm.

4. Në lidhje me çdo nënshkrues që shpreh më pas pëlqimin e tij për t'u lidhur me të, konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 22

Shtetet joanëtare dhe Komuniteti European

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, me nismën e vet ose me propozim të Komitetit të Përhershëm dhe pas konsultimit të palëve, fton çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e konventës, si dhe Komitetin European për të aderuar në këtë konventë me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20, nënparagrafi (d) të Statutit të Këshillit të Europës, dhe me votim unanim të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese të autorizuar për të marrë pjesë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues ose Komunitetin European, konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 23

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo konventë.

2. Çdo palë, në çdo datë të mëvonshme, me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta shtrijë zbatimin e kësaj konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilit ajo është e autorizuar për të vepruar. Për sa i përket këtij territori, konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit, pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, mund të tërhiqet nga një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 24

Rezervat

Në konventë nuk mund të bëhet asnjë rezervë.

Neni 25

Denoncimet

1. Çdo palë mund të denoncojë në çdo kohë këtë konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 26

Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit, çdo nënshkrues, çdo palë dhe çdo shtet tjetër ose Komunitetin European që është ftuar të aderojë në këtë konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenet 21 ose 22;
- d) çdo ndryshim të miratuar në përputhje me nenin 20, dhe datën në të cilën ky amendament hyn në fuqi;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- e) çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të neneve 1 dhe 23;
- f) çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të nenit 25;
- g) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim në lidhje me këtë konventë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Strasburg, më 25 janar 1996, në gjuhën angleze dhe frënge ku të dyja tekstet janë njëloj të barasvlershme, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj konvente, Komunitetit European dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë konventë.

LIGJ Nr. 86/2013

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT OPSIONAL TË KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËS “PËR PROCEDURËN E KOMUNIKIMIT”¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin opsional i konventës për të drejtat e fëmijës “Për procedurën e komunikimit”.

Neni 2

Në përputhje me nenin 12 paragrafi 1 të protokollit opsional, Republika e Shqipërisë deklaron se pranon kompetencën e komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet, në të cilat një shtet palë pretendon se një shtet tjetër palë nuk përmbush detyrimet e tij, sipas instrumenteve të renditura në këtë paragraf, në të cilat shteti është palë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7960, datë 25.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

PROTOKOLLI OPSIONAL I KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËS “MBI PROCEDURËN E KOMUNIKIMIT”

Shtetet palë të këtij protokollit,

duke marrë në konsideratë se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë;

duke vërejtur se shtetet palë të Konventës për të drejtat e fëmijës (më poshtë e quajtur Konventa) njohin të drejtat e përcaktuara në të për çdo fëmijë brenda juridiksionit të tyre, pa diskriminim të ndonjë lloji, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose opinione të tjera, origjina kombëtare, etnike ose sociale,

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 20*. Tiranë 2013. f. 811.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

prona, aftësia e kufizuar, lindja ose një status tjetër i fëmijës ose i prindërve, ose i kujdestarëve të tij ose të saj ligjorë;

duke rikonfirmuar karakterin universal, pandashmërinë, ndërvarësinë dhe lidhjen midis të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

duke rikonfirmuar, gjithashtu, statusin e fëmijës si subjekt i të drejtave dhe si qenie njerëzore me dinjitet dhe kapacitete zhvilluese;

duke pranuar se statusi i varur dhe i veçantë i fëmijëve mund të krijojë vështirësi reale për ta në ushtrim të mjeteve ligjore për shkeljen e të drejtave të tyre;

duke marrë në konsideratë se ky protokoll do të forcojë dhe do të plotësojë mekanizmat kombëtarë dhe rajonalë që lejojnë fëmijët të paraqesin ankesa për shkeljet e të drejtave të tyre;

duke pranuar se interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë faktorë parësorë që duhen të respektohen në ushtrimin e mjeteve ligjore për shkeljet e të drejtave të fëmijës dhe se këto mjete ligjore duhet të marrin në konsideratë nevojën për procedura në mbrojtje të fëmijëve të të gjitha niveleve;

duke inkurajuar shtetet palë të zhvillojnë mekanizma të përshtatshëm kombëtarë për t'i dhënë mundësinë një fëmije, të drejtat e të cilit janë shkelur, që të ketë akses ndaj mjeteve ligjore efektive në nivel kombëtar;

duke rikujtuar rolin e rëndësishëm që institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe institucione të tjera të specializuara përkatëse të ngarkuara për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, mund të luajnë në këtë drejtim;

duke marrë në konsideratë se, me qëllim forcimin dhe plotësimin e këtyre mekanizmave kombëtare dhe përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të Konventës dhe sipas rastit, protokolleve opsionale të saj mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë dhe mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur, do të ishte e përshtatshme që Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (më poshtë i quajtur Komiteti), t'i jepet mundësia të kryente funksionet e parashikuara në këtë protokoll,

kanë rënë dakord i më poshtë:

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kompetenca e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës

1. Një shtet palë i këtij protokollit pranon kompetencën e Komitetit të parashikuar nga ky protokoll.
2. Komiteti nuk ushtron kompetencën e tij në lidhje me një shtet palë të këtij protokollit për çështje mbi shkeljen e të drejtave të përcaktuara në një instrument në të cilin shteti nuk është palë.
3. Asnjë komunikim nuk merret nga Komiteti nëse ka lidhje me një shtet që nuk është palë e këtij protokollit.

Neni 2

Parimi i përgjithshëm që udhëheq funksionet e Komitetit

Në përmbushjen e funksioneve të dhëna atij nga ky protokoll, Komiteti udhëhiqet nga parimi interesave më të mira të fëmijës. Ai, gjithashtu, merr në konsideratë të drejtat dhe pikëpamjet e fëmijës, duke i dhënë rëndësinë e duhur pikëpamjeve të fëmijës në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.

Neni 3

Rregullat e procedurës

1. Komiteti miraton rregullat e procedurës që duhet të ndiqen gjatë ushtrimit të funksioneve të dhëna atij nga ky protokoll. Për këtë ai duhet të marrë në konsideratë veçanërisht nenin 2 të këtij protokollit, me qëllim garantimin e procedurave për mbrojtjen e fëmijëve.
2. Komiteti përfshin në rregullat e tij të procedurës, garancitë për parandalimin e manipulimit të fëmijës nga ata që veprojnë në emër të tij ose të saj dhe mund të refuzojë të shqyrtojë ndonjë komunikim që e konsideron të mos jetë në interesat më të mira të fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 4

Masat mbrojtëse

1. Një shtet palë merr të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar që individët nën juridiksionin e tij të mos i nënshtrohen asnjë shkeljeje të të drejtave të njeriut, keqtrajtimit ose kërcënimit si pasojë e komunikimeve ose bashkëpunimit me Komitetin sipas këtij protokoll.

2. Identiteti i çdo individi ose grupi individësh të interesuar nuk zbulohet publikisht pa pëlqimin e tyre të shprehur.

PJESA II

PROCEDURA E KOMUNIKIMIT

Neni 5

Komunikimet individuale

1. Komunikimet mund të paraqiten nga ose në emër të një individi ose grupi individësh brenda juridiksionit të një shteti palë, që pretendojnë të jenë viktimë të një shkeljeje nga ai shtet palë, të ndonjë prej të drejtave të përcaktuara në ndonjë prej instrumenteve të mëposhtme, në të cilat ai shtet është palë:

- a) Konventa;
- b) Protokoli opsional i Konventës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë;
- c) Protokoli opsional i Konventës mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur.

2. Kur një komunikim paraqitet në emër të një individi ose grupi individësh, ky do të jetë me pëlqimin e tyre nëse autori nuk e justifikon, duke vepruar në emër të tyre pa një pëlqim të tillë.

Neni 6

Masat e përkohshme

1. Në çdo kohë pas marrjes së një komunikimi dhe para se të jetë arritur një përcaktim në themel, Komiteti mund t'i transmetojë shtetit palë të interesuar për shqyrtimin e tij urgjent, një kërkesë që shteti palë të marrë ato masa të përkohshme që mund të jenë të nevojshme në rrethana të jashtëzakonshme për të shmangur dëmin e mundshëm, të pariparueshëm ndaj viktimës ose viktimave të shkeljeve të dyshuara.

2. Nëse Komiteti ushtron diskrecionin e tij sipas paragrafit 1 të këtij neni, kjo nuk nënkupton një përcaktim mbi pranueshmërinë ose mbi themelin e komunikimit.

Neni 7

Pranueshmëria

1. Komiteti e konsideron një komunikim të papranueshëm kur:
 - a) komunikimi është anonim;
 - b) komunikimi nuk është me shkrim;
 - c) komunikimi përbën abuzim me të drejtën e paraqitjes së këtyre komunikimeve ose është i papajtueshëm me dispozitat e Konventës dhe/ose protokolleve opsionale të saj;
 - d) e njëjta çështje është shqyrtuar tashmë nga Komiteti ose është shqyrtuar, ose po shqyrtohet sipas një procedure tjetër hetimore ose të zgjidhjes ndërkombëtare;
 - e) të gjitha mjetet e brendshme ligjore në dispozicion nuk janë shteruar. Ky nuk do të jetë rregull kur zbatimi i mjeteve ligjore vonohet në mënyrë të paarsyeshme ose nuk mund të sjellë ndihmë efektive.
 - f) komunikimi është haptazi i pabazuar ose nuk është bazuar në nivel të mjaftueshëm.
 - g) faktet që i nënshtrohen komunikimit të bërë përpara hyrjes në fuqi të këtij protokoll për shtetin palë të interesuar, nëse ato fakte nuk kanë vazhduar pas asaj date.
 - h) komunikimi nuk paraqitet brenda një viti pas shterimit të mjeteve të brendshme ligjore, me përjashtim të rasteve kur autori mund të vërtetojë se komunikimi nuk mund të paraqitet brenda atij afati kohor.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 8

Transmetimi i komunikimit

1. Nëse Komiteti nuk e konsideron një komunikim të papranueshëm pa iu referuar shtetit palë të interesuar, Komiteti do të sjellë sa më shpejt që të jetë e mundur në vëmendjen e shtetit palë të interesuar, çdo komunikim të paraqitur atij sipas fshehtësisë së këtij protokoll.

2. Shteti palë i jep Komitetit shpjegime ose deklarata me shkrim, që qartësojnë çështjen dhe mjetin ligjor, nëse ka, të cilat mund të ketë ofruar. Shteti palë paraqet përgjigjen e tij sa më shpejt që të jetë e mundur dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh.

Neni 9

Zgjidhja miqësore

1. Komiteti vë në dispozicion zyra të përshtatshme për palët e interesuara, me synim arritjen e një zgjidhjeje miqësore të çështjes mbi bazën e respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Konventë dhe/ose protokollet opsionale të saj.

2. Një marrëveshje e një zgjidhjeje miqësore, e arritur nën kujdesin e Komitetit, mbyll shqyrtimin e komunikimit sipas këtij protokoll.

Neni 10

Shqyrtimi i komunikimeve

1. Komiteti shqyrton komunikimet e marra sipas këtij protokoll sa më shpejt që të jetë e mundur, duke marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin e paraqitur atij, me kusht që ky dokumentacion t'i transmetohet palëve të interesuara.

2. Komiteti kryen takime me dyer të mbyllura gjatë shqyrtimit të komunikimeve të marra sipas këtij protokoll.

3. Nëse Komiteti ka kërkuar masa të përkohshme, ai do të përshpejtojë shqyrtimin e komunikimit.

4. Gjatë shqyrtimit të komunikimeve që pretendojnë shkelje të të drejtave ekonomike, sociale ose kulturore, Komiteti do të shqyrtojë arsyetueshmërinë e hapave të marrë nga shteti palë në përputhje me nenin 4 të Konventës. Për këtë Komiteti do të ketë parasysh që shteti palë të mund të miratojë një sërë masash të mundshme politikash për zbatimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Konventë.

5. Pas shqyrtimit të një komunikimi, Komiteti do të transmetojë pa vonesë pikëpamjet e tij mbi komunikimin, së bashku me rekomandimet e tij, nëse ka, për palët e interesuara.

Neni 11

Zbatimi

1. Shteti palë shqyrton me kujdes pikëpamjet e Komitetit, së bashku me rekomandimet e tij, nëse ka, dhe i paraqet Komitetit një përgjigje me shkrim, përfshirë informacionin mbi masat e marra dhe të parashikuara, duke marrë parasysh pikëpamjet dhe rekomandimet e Komitetit. Shteti palë paraqet përgjigjen e tij sa më shpejt që të jetë e mundur dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh.

2. Komiteti mund të ftojë shtetin palë të paraqesë informacion të mëtejshëm rreth masave që shteti palë ka marrë në përgjigje të pikëpamjeve ose rekomandimeve të tij ose zbatimin e një marrëveshjeje për zgjidhje miqësore, nëse ka, duke përfshirë, siç mund të çmohet e nevojshme nga Komiteti, në raportet e mëtejshme të shtetit palë sipas nenit 44 të Konventës, nenin 12 të protokollit opsional mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë ose nenin 8 të protokollit opsional mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur, nëse është e zbatueshme.

Neni 12

Komunikimet ndërshtetërore

1. Një shtet palë i këtij protokoll mund të deklarojë në çdo kohë se pranon kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet, në të cilat një shtet palë pretendon se një shtet tjetër palë nuk përbush detyrimet e tij, sipas ndonjë prej instrumenteve të mëposhtme, në të cilat shteti është palë:

a) Konventa;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) Protokoll i opsional i Konventës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë;

c) Protokoll opsional i Konventës mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur.

2. Komiteti nuk merr komunikime në lidhje me një shtet palë që nuk ka bërë këtë deklaratë ose komunikim nga një shtet palë, i cili nuk ka bërë një deklaratë të tillë.

3. Komiteti i vë në dispozicion zyra të përshtatshme shteteve palë të interesuara, me synim një zgjidhje miqësore të çështjes mbi bazën e respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Konventë dhe protokollet opsionale të saj.

4. Një deklaratë sipas paragrafit 1 të këtij neni depozitohet nga shtetet palë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'i transmetojë kopje të tyre shteteve të tjera palë. Një deklaratë mund të tërhiqet në çdo kohë, me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo tërheqje nuk cenon shqyrtimin e ndonjë çështjeje që i nënshtrohet një komunikimi tashmë të transmetuar sipas këtij neni; asnjë komunikim i mëtejshëm nga ndonjë shtet palë nuk merret sipas këtij neni, pasi njoftimi i tërheqjes së deklaratës të jetë marrë nga Sekretari i Përgjithshëm, nëse shteti palë i interesuar nuk ka bërë një deklaratë të re.

PJESA III

PROCEDURAT HETIMORE

Neni 13

Procedurat hetimore për shkelje të rënda dhe sistematike

1. Nëse Komiteti merr informacion të besueshëm që tregon shkelje të rënda ose sistematike nga një shtet palë të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet opsionale të saj për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve ose për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, Komiteti fton shtetin palë të bashkëpunojë në shqyrtimin e informacionit dhe për këtë qëllim, të paraqesë vërejtjet pa vonesë në lidhje me informacionin në fjalë.

2. Duke marrë parasysh të gjitha vërejtjet që mund të jenë paraqitur nga shteti palë i interesuar, si dhe çdo informacion tjetër të besueshëm në dispozicion të tij, Komiteti mund të caktojë një ose më shumë nga anëtarët e tij për të kryer një hetim dhe për t'i raportuar urgjentisht Komitetit. Kur autorizohet dhe me pëlqimin e shtetit palë, hetimi mund të përfshijë një vizitë në territorin e tij.

3. Një hetim i tillë kryhet në fshehtësi dhe bashkëpunimi i shtetit palë do të kërkohet në të gjitha fazat e procedimit.

4. Pas shqyrtimit të rezultateve të një hetimi të tillë, Komiteti ia transmeton pa vonesë këto rezultate shtetit palë të interesuar, së bashku me komentet dhe rekomandimet.

5. Shteti palë i interesuar duhet, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe brenda gjashtë muajve nga marrja e rezultateve, komenteve dhe rekomandimeve të transmetuara nga Komiteti, t'i paraqesë Komitetit vërejtjet e tij.

6. Pasi të kenë përfunduar këto procedura në lidhje me një hetim të bërë në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, Komiteti mund, pas konsultimit me shtetin palë të interesuar, të vendosë të përfshijë një përmbledhje të rezultateve të procedimit në raportin e tij të parashikuar në nenin 16 të këtij protokoll.

7. Çdo shtet palë, në kohën e nënshkrimit ose të ratifikimit të këtij protokoll ose të aderimit, të deklarojë se ai nuk e njeh kompetencën e Komitetit të parashikuar në këtë nen në respektim të të drejtave të parashtruara në disa ose të gjitha instrumentet e renditura në paragrafin 1.

8. Çdo shtet palë që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 7 të këtij neni mund, në çdo kohë, ta tërheqë këtë deklaratë me anë të njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 14

Zbatimi i procedurave hetimore

1. Komiteti mund, nëse është e nevojshme, pas përfundimit të periudhës gjashtëmuajore të referuar në nenin 13, paragrafi 5, të ftojë shtetin palë të interesuar ta informojë atë për masat e marra dhe të parashikuara, në përgjigje të një hetimi të kryer sipas nenit 13 të këtij protokoll.

2. Komiteti mund të ftojë shtetin palë të paraqesë informacion të mëtejshëm në lidhje me ndonjë masë që shteti palë ka marrë në përgjigje të një hetimi të kryer sipas nenit 13, duke përfshirë, siç çmohet e përshtatshme nga Komiteti, në raportet pasuese të shtetit palë sipas nenit 44 të Konventës, nenin 12 të protokollit opsional të

Përmbledhje legjislativi për të miturit

Konventës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve ose nenin 8 të protokollit opsional të Konventës mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, nëse është e zbatueshme.

PJESA IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Ndihma dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Komiteti mund t'i transmetojë, me pëlqimin e shtetit palë të interesuar, agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara, fonde dhe programe dhe organeve të tjera kompetente pikëpamjet ose rekomandimet të tij lidhur me komunikimet dhe hetimet që tregojnë një nevojë për këshillim ose ndihmë teknike, së bashku me vërejtjet dhe sugjerimet e shtetit palë, nëse ka, në këto pikëpamje apo rekomandime.

2. Komiteti mund të sjellë në vëmendjen e këtyre organeve, me pëlqimin e shtetit palë të interesuar, çdo çështje që lind nga komunikimet e shqyrtuara nën këtë protokoll që mund t'i ndihmojë ata të vendosin, secili brenda fushës së tij të kompetencës, mbi këshillueshmërinë e masave ndërkombëtare që mund të kontribuojnë për të ndihmuar shtetet palë në arritjen e progresit në zbatim të të drejtave të njohura në Konventë dhe/ose protokollin opsional të saj.

Neni 16

Raportimi tek Asambleja e Përgjithshme

Komiteti përfshin, në raportin e tij të paraqitur çdo dy vjet Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me nenin 44 (5) të Konventës, një përmbledhje të aktiviteteve të tij, sipas këtij protokoll.

Neni 17

Shpërndarja dhe informimi i protokollit opsional

Çdo shtet palë ndërmerr ta bëjë të ditur gjerësisht dhe ta shpërndajë këtë protokoll dhe të lehtësojë aksesin në informacionin për pikëpamjet dhe rekomandimet e Komitetit, në veçanti në lidhje me çështje që përfshijnë shtetit palë, me mjetet e duhura dhe aktive dhe në formate të aksesueshme si për të rriturit, ashtu edhe për fëmijët, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara.

Neni 18

Nënshkrimi, ratifikimi dhe aderimi

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga çdo shtet që ka nënshkruar, ratifikuar ose aderuar në Konventë ose në secilin prej dy protokolleve opsionale të para të saj.

2. Ky protokoll është subjekt i ratifikimit nga çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Konventë ose në secilin prej dy protokolleve opsionale të para të saj. Instrumentet e ratifikimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Ky protokoll është i hapur për aderim nga çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Konventë ose në secilin prej dy protokolleve opsionale të para të saj.

4. Aderimi hyn në fuqi me depozitimin e një instrumenti të aderimit te Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 19

Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë protokoll ose që aderon në të, pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose instrumenti të aderimit, ky protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të vet të ratifikimit ose aderimit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 20

Shkeljet që ndodhin pas hyrjes në fuqi

1. Komiteti ka kompetenca vetëm në lidhje me shkeljet nga shteti palë të çdo të drejte të parashikuar në Konventë dhe/ose dy protokollet opsionale të para të saj që ndodhin pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll.

2. Nëse një shtet bëhet palë në këtë protokoll pas hyrjes në fuqi të tij, detyrimet e atij shteti ndaj Komitetit lidhen vetëm me shkeljet e të drejtave të parashikuara në Konventë dhe/ose në dy protokollet opsionale të para të saj që ndodhin pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll për shtetin e interesuar.

Neni 21

Ndryshimet

1. Çdo shtet palë mund të propozojë një ndryshim të këtij protokoll dhe ta paraqesë atë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ia komunikon çdo ndryshim të propozuar shteteve palë, me një kërkesë që të njoftohet nëse ata e miratojnë një takim të shteteve palë me qëllim shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për propozimet. Në rast se, brenda katër muajve nga data e një komunikimi të tillë, të paktën një e treta e shteteve palë e miratojnë një takim të tillë, Sekretari i Përgjithshëm i thërret në takim nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar nga një shumicë prej dy të tretave të shteteve palë të pranishme dhe që votojnë, paraqitet nga Sekretari i Përgjithshëm tek Asambleja e Përgjithshme për miratim dhe, pas kësaj, të të gjitha shtetet palë për pranim.

2. Një ndryshim i miratuar dhe i aprovuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, hyn në fuqi në ditën e tridhjetë, pasi numri i instrumenteve të pranimit të depozituara arrin dy të tretat e numrit të shteteve palë në datën e miratimit të ndryshimit. Pas kësaj, ndryshimi hyn në fuqi për çdo shtet palë në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të pranimit. Një ndryshim është detyrues vetëm për ato shtete palë që e kanë pranuar atë.

Neni 22

Denoncimi

1. Çdo shtet palë mund ta denoncojë këtë protokoll në çdo kohë me anë të njoftimit me shkrim të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Denoncimi nuk cenon zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave të këtij protokoll për çdo komunikim të paraqitur, sipas neneve 5 ose 12 ose çdo hetim i nisur sipas nenit 13 para datës efektive të denoncimit.

Neni 23

Depozitari dhe njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është depozitari i këtij protokoll.

2. Sekretari i Përgjithshëm informon të gjitha shtetet për:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas këtij protokoll;
- b) datën e hyrjes në fuqi të këtij protokoll dhe të çdo ndryshimi të tij sipas nenit 21;
- c) çdo denoncim sipas nenit 22.

Neni 24

Gjuhët

1. Ky protokoll, tekstet e të cilit, në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, janë njëloj autentike, depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u përcjell të gjitha shteteve kopje të vërtetuara të këtij protokoll.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Pjesa e dytë
Të drejtat dhe mbrojtja

LIGJ
Nr.9518, datë 18.4.2006

**PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA PËRDORIMI I ALKOOLIT, PIJEVE ENERGJIKE
DHE PIJEVE TË GAZUARA QË PËRMBAJNË SHEQER TË SHTUAR¹**
(ndryshuar me ligjin nr. 48/2013, datë 14.2.2013, nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit
(ndryshuar me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

Ky ligj ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar nëpërmjet përdorimit të tyre nga të miturit.

Neni 2
Objekti i ligjit
(shtuar fjalë në paragrafin e parë dhe shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

Objekti i ligjit është ndalimi i përdorimit të pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga të miturit.

Në kuptimin e këtij ligji, pije alkoolike konsiderohen ato pije, që në volumen e tyre kanë përqindje të alkoolit të barabartë ose më të lartë se 1,2 për qind.

Në këtë ligj, “pije energjike” konsiderohen ato pije joalkoolike, në të cilat përmbajtja totale e kafeinës tejkalon sasinë 150 mg/l dhe që në përbërje të tyre kanë të paktën një ose më shumë substanca stimuluese ose tonike, të tilla si: taurinë, D-glukuronon y-lakton, guaranë, maltodekstrin, xhensen, karnitinë, kreatinë dhe ginkgo biloba.

Në këtë ligj, “pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar” konsiderohen ato pije joalkoolike, të gazuara, që përmbajnë sheqer, agjentë të tjerë ëmbëlsues apo aromatizues, natyral apo artificial, si dhe acid ushqimor, përjashtojnë ujë mineral dhe ujërat e gazuara, lëngjet e frutave dhe pijet e bëra me qumësht ose produktet e qumështit.

Neni 3
**Reklama e pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve
të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar**
(shtuar fjalë me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

Konsiderohet reklamë e pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, çdo formë komunikimi, udhëzimi apo veprimi tregtar i ngjashëm me to dhe që në mënyrë të

¹Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 46. Tiranë 2006. f. 1390.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

drejtpërdrejtë ose jo ndikon në nxitjen e përdorimit të alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.

Neni 4

Ndalime për përdorimin e alkoolit dhe pijeve energjike

(shtuar fjalë dhe një paragraf me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

Ndalohet shitja ose ofrimi falas i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike të miturve apo konsumimi i tyre në vende publike nga të miturit.

Ndalohet ofrimi i pijeve alkoolike dhe energjike të miturve nga personi madhor që e shoqëron atë në vende publike.

Në kuptimin e këtij ligji, vendi publik përfshin çdo njësi tregtare, bar, restorant, kinema ose klub nate.

Neni 5

Frekuentimi i lokaleve të natës

(shtuar fjalë me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

Përveç rasteve kur është i shoqëruar nga prindi ose kujdestari i tij, një i mitur nuk mund të frekuentojë, nga ora 2200 deri në orën 600, një bar apo lokal nate, në të cilin tregtohet pije alkoolike dhe pije energjike. Personi që shoqëron të miturin paraqet në hyrje të lokalit dokumentin e identifikimit të vet, si dhe dokumente që vërtetojnë lidhjen e tij si prind ose si kujdestar i të miturit.

Pronarët e lokaleve të natës, në të cilat tregtohen pije alkoolike, pije energjike ose personeli i punësuar nuk lejojnë hyrjen në lokal të personave që nuk janë dukshëm madhorë, pa kërkuar më parë dokumentin e identifikimit.

Neni 6

Dokumenti i identifikimit

1. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, si dokument identifikimi, për të vërtetuar që personi nuk është i mitur, shërben njëri nga këto dokumente:

- a) certifikata e lindjes me fotografi;
- b) pasaporta për udhëtim jashtë shtetit;
- c) dëshmia e aftësisë për drejtim automjesh;
- ç) karta e identitetit të nxënësit;
- d) çdo dokument tjetër zyrtar i njëvlefshëm me to.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, si dokument identifikimi, për të vërtetuar lidhjen e personit madhor me të miturin, të cilin ai po shoqëron, shërbejnë:

- a) certifikata e lindjes së të miturit me fotografi, së bashku me dokumentin identifikues të personit madhor, sipas përcaktimit të dhënë në pikën 1 të këtij neni;
- b) pasaporta për udhëtim jashtë shtetit e të miturit, së bashku me dokumentin identifikues të personit madhor, sipas përcaktimit të dhënë në pikën 1 të këtij neni.

Neni 7

Detyrimi për kontroll të dokumentit identifikues

(shtuar fjalë me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

1. Subjektet që tregtojnë pije alkoolike dhe pije energjike në tregje dhe lokale ose personeli i punësuar prej tyre kontrollojnë dokumentin identifikues për personat që nuk janë dukshëm madhorë.

2. Në rast të mungesës së dokumentit identifikues, personat që nuk janë dukshëm madhorë nuk pranohen në lokale nate e nuk u shërbehet në tregje.

3. Subjektet që tregtojnë pije alkoolike dhe pije energjike janë të detyruar të vendosin në hyrje të lokaleve tabela treguese me shënimin “Ndalohet shitja e alkoolit personave nën 18 vjeç” dhe “Ndalohet shitja e pijeve energjike personave nën 18 vjeç”.

4. Tabelat treguese duhet të jetë e dallueshme me një format minimumi A4.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 8

Ndalimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike në institucionet arsimore parauniversitare dhe qendrat e mbrojtjes sociale për fëmijë/qendrat e përkujdesjes për fëmijë

(shtuar fjalë dhe një paragraf me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

Ndalohet përdorimi dhe çdo lloj reklamimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike në institucionet arsimore parauniversitare dhe qendrat e mbrojtjes sociale për fëmijë/qendrat e përkujdesjes për fëmijë për të mitur.

Ndalohet çdo lloj reklamimi i pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në institucionet arsimore për të mitur.

Neni 9

Ndalimi i publicitetit për pijet alkoolike, pije energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në median vizive

(shtuar fjalë, ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

1. Ndalohet transmetimi i publicitetit për pijet alkoolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në brendësi të këtij programi drejtuar të miturve, si dhe 60 minuta para dhe pas këtij programi.

2. Ndalohet prodhimi dhe transmetimi i publicitetit që përmban skena me të mitur, të cilët konsumojnë pije alkoolike, pije energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.

Neni 10

Reklamat e pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar

(shtuar fjalë me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

1. Ndalohet çdo formë reklame e pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, që u drejtohet të miturve.

2. Ndalohet çdo reklamë e pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në sallat e kinemave apo teatrove gjatë shfaqjes për të mitur.

KREU II

MASAT DETYRUESE

Neni 11

Kundërvajtjet administrative

(shtuar pika 6 me ligjin nr. 48/2013, datë 14.2.2013, shtuar fjalë pikat 2/1, 2/2 me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

1. Tregtimi nga njësitë tregtare i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike të miturve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 20 mijë lekë.

2. Tregtimi apo ofrimi falas i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga baret, restorantet ose klubet e natës të miturve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 mijë deri në 30 mijë lekë.

2/1 Ofrimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në njësi tregtare, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 20 mijë lekë.

2/2 Ofrimi i pijeve alkoolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në baret, restorantet, kinematë apo klubet e natës përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 mijë deri në 30 mijë lekë.

3. Frekuentimi nga të miturit i klubeve të natës, në të cilat tregtohen pije alkoolike dhe pijeve energjike, përbën kundërvajtje administrative dhe subjekti dënohet me gjobë nga 30 mijë deri në 50 mijë lekë.

4. Mungesa e tabelave treguese me shënimin “Ndalohet shitja e alkoolit personave nën 18 vjeç” dhe “Ndalohet shitja e pijeve energjike personave nën 18 vjeç” në njësitë tregtare, bare, restorante ose klube nate përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10 mijë lekë;

5. Reklamimi drejtpërdrejt ose tërthorazi i pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar drejtuar të miturve në të gjitha mjediset e tjera, përjashtuar ato arsimore, si rrugë, parqe etj., përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 mijë deri në 200 mijë lekë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

6. Dënimi me gjobë është dënim kryesor.

Neni 12

Dispozita për mediat vizive

(shtuar fjalë me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

1. Transmetimi i publicitetit për pijet alkoolike në brendësi të një programi drejtuar të miturve, si dhe 15 minuta para dhe pas këtij programi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 200 mijë lekë.
2. Prodhimi dhe transmetimi i publicitetit që përmban skena me të mitur, të cilët konsumojnë pije alkoolike, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 300 mijë lekë.
3. Çdo lloj reklame e pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në sallat e kinemasë apo teatrove gjatë shfaqjes për të mitur përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 mijë lekë.

KREU III

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

1. Radiotelevizionet, mediat e shkruara publike ose private, si edhe agjencitë publicitare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miratojnë rregulla për përmbajtjen e mesazheve publicitare që kanë të bëjnë me pijet alkoolike.
2. KKRT-ja është organi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji nga personat e licencuar prej tij.

Neni 14

(ndryshuar me ligjin nr. 48/2013, datë 14.2.2013)

1. Për zbatimin e nenit 11 pikat 1, 2, 3 dhe 4 ngarkohet inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.
2. Për zbatimin e nenit 11 pika 5 ngarkohet Policia Bashkiake.
3. Organet e kontrollit, sipas përcaktimit të këtij neni, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. Ndaj vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.
5. Ndaj vendimit të Policisë Bashkiake mund të bëhet ankim sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ekzekutimi i gjobave bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Dispozitë kalimtare

(me ligjin nr. 48/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Dispozitë kalimtare

(me ligjin nr. 74/2018, datë 25.10.2018)

1. Radiotelevizionet, mediat e shkruara publike ose private, si edhe agjencitë publicitare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miratojnë rregulla për përmbajtjen e mesazheve publicitare që kanë të bëjnë me pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.
2. Për zbatimin e nenit 11, pikat 2/1 dhe 2/2, ngarkohet inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4860, datë 10.5.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

LIGJ
Nr.9669, datë 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE¹

(ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë zgjedhësve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3 të tij.

Neni 2

Objekti

(ndryshuar fjalë në shkronjën "e" me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

Ky ligj ka si objekt:

- a) krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- b) orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- c) fuqizimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
- ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 3

Përkufizimet

(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

Në këtë ligj, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Dhunë" është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 150*. Tiranë 2006. f. 6113.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

3. “Dhunues” është çdo person i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.

4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi “i mitur”, i përdorur në këtë ligj, ka të njëjtin kuptim.

5. “Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

6. “Njësi shtëpiake” është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes.

7. “Pjesëtarë të familjes” janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;
b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake;

c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimi;

ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtin/ thjeshtren, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi;

d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit /es ose bashkëjetuesit/es;

dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es;

e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;

ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;

f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes.”.

8. “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional.

9. “Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

10. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykatë, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.

11. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar për kohësisht me vendim gjykatë, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykatë.

12. “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme” është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

Neni 3/1

Legjislacioni i zbatueshëm

(shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

3. Masat e veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe në nenin 13/1, të këtij ligji, që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kritereve të parashikuar në këtë ligj.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 4

Subjektet

(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji, që janë shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekte që mbrohen nga ky ligj janë edhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacioni në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacioni në fuqi për të huajt, që përfshihen në kategorinë e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji.

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5

Autoritetet përgjegjëse

(shtuar shkronja “d” me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:

- a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- b) ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
- ç) ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
- d) ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
- dh) ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit;
- e) ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional;
- ë) njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Lista e autoriteteve të tjera përgjegjëse të linjës, të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, ndryshon nëse njëri prej tyre merr rolin e autoritetit kryesor përgjegjës. Në këtë rast, ky autoritet ka edhe rol kryesor përgjegjës dhe mbulon çështjet në fushën përkatëse.

Neni 6

Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës

(shtuar shkronjat “f” dhe “g” me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, shtuar shkronja “g” me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronjat “i”, “ç”, “d”, “g”, “g” dhe shtuar shkronjat “b” dhe “i” me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

a) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

b) financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”, që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacioni në fuqi;

ç) organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit, stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Trajnimet mund të organizohen në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me Shkollën e

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Magjistraturës, me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social ose me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhen me çështje të dhunës në marrëdhëniet familjare, për të gjitha autoritetet përgjegjëse administrative, ligjzbatuese dhe gjyqësore;

d) bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.

Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Botimi i tyre bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.

dh) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;

e) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;

ë) licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit;

f) marrjen e masave për edukimin e brezit të ri me mendësitë dhe rregullat e sjelljes së mirë, si dhe të ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;

g) harton politikën dhe mbikëqyr marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet vendosjes në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

gj) ofrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për viktimat e dhunës në familje.

h) hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me vlerësimin e riskut dhe planin e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

i) koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Neni 7

Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës

(shtuar pika 3/1 me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ka këto detyra:

a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;

b) trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe me aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj;

b/1) miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje.

2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron ndihmën mjekësore në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore:

a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje;

b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;

c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;

ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;

d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

2/1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen edhe këto detyra:

a) organizon trajnime dhe specializime për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve sociale në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi;

b) monitoron përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj, nga ana e personelit mjekësor;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku viktimat trajtohet. Standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka këto detyra:

a) të trajnojë ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;

b) merr masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbartuesve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;

b/1) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje;

c) mbikëqyr funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

ç) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve;

d) harton formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor;

dh) nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.

3/1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, kanë këto detyra:

a) harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje;

b) përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;

c) parashikon programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktimat, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:

a) angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

c) ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

ç) marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;

d) marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;

dh) bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

5. Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit, mbështet me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 7/1

Garancia për mbrojtjen

(shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Çdo organ ose autoritet, që është përgjegjës për të trajtuar dhunën në familje, pranë të cilit drejtohet viktimë, garanton mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës.

2. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Neni 8

Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse

(shtuar pikat 7 dhe 8 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, shtuar shkronja "dh"
e pikës 3 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

2. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimë apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrat të mbrojtjes apo urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj.

3. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:

a) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet;

b) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimin në qendrat dhe institucionet përkatëse;

c) sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale;

ç) vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.

dh) hartimit nga punonjësi social për çështjet e dhunës në familje pranë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe njësive të vlerësimit të nevojave të referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të një plani individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psikosociale të viktimës.

4. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje apo ka thyer urdhrat e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, organet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.

5. Personat të cilët marrin dënim për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.

6. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktimë vihet në dënim nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.

7. Punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, si dhe avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktimë jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktimë.

8. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 9

Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse

(ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Në rast të dhunës në familje, viktimë mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë stacionit të policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit, për të marrë masat e nevojshme.

2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

KREU III MASAT MBROJTËSE

Neni 10

Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje

(ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe pika 4 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronjat "j", "k", "m", shtuar shkronja "m/1" dhe pikat 3/1 dhe 3/2 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1, zëvendësuar fjalë në shkronjat "a", "b", "ç", "d", "e", "f", "g", "h", "i", "dh", shfuqizuar shkronjat "c", "m" dhe "m/1, ndryshuar pika 2 dhe pika 3 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuara dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna.

Përveç masës së largimit të dhunuesit nga banesa, mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, sigurohet dhe në këto mënyra:

a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprë të dhunës në familje ndaj paditësit (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

c) shfuqizuar;

ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

d) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimë, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

dh) duke vendosur menjëherë viktimën ose viktimat dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

e) duke kufizuar ose duke të paditurin (dhunuesin) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

ë) duke i ndaluar paditurin (dhunuesin) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;

f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbaues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin (dhunuesin) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;

g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të sekuestrojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojnë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

gj) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimë dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj;

h) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;

j) duke i hequr dhunuesit, përkohësisht, përgjegjësinë prindërore ose, nëse është rasti, kujdestarinë mbi të miturin, kujdestarinë për personin me aftësi të kufizuara, ose për personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Kur gjykata vendos të heqë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga të dy prindërit ose nga prindi i vetëm, ajo cakton kujdestarinë e përkohshme mbi fëmijët, duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Familjes dhe legjislacionin procedural në fuqi;

k) duke urdhëruar organet kompetente, shërbimet sociale të njëjsteve përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe/ose organizatat që ofrojnë shërbime, që, sipas rastit, të mbështesin me ndihmë psikosociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe të monitorojnë respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët, duke paraqitur raportet përkatëse përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;

l) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët, për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën, gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfuturit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;

ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;

m) shfuqizuar

m/1) shfuqizuar

2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, përveç masës që parashikohet në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni, në varësi të rrethanave të çështjes, mund të vendoset dhe një ose disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në shkronjat “a” deri në “ll” të pikës 1 të këtij neni.

3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, përveç masës që parashikohet në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni, në varësi të rrethanave të çështjes, mund të vendoset dhe një ose disa nga masat e parashikuara në shkronjat “a” deri në “g” të pikës 1 të këtij neni.

3/1 Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.

3/2 Vendimi për zgjidhjen e martesës, i shpallur nga gjykata gjatë kohës së zbatimit të UMM/UM-së për pasojat e njëkohshme, fillon të zbatohet nga dita e përfundimit të UMM/UM-së. Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.

4. Në rastin e zbatimit të shkronjës “g”, vendimi i gjykatës parashikon:

a) pezullimin e lejes së armës deri në plotësimin e afatit të urdhrin të mbrojtjes, si dhe njoftimin e autoritetit përkatës administrativ, nëse arma është sekuestruar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje;

b) kthimin e armës së sekuestruar, nëse personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar në urdhrat e mbrojtjes.

Neni 10/1

Rehabilitimi i dhunuesit

(shtuar me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, urdhërohet dhunuesi të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimit prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private.

2. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij në mënyrë periodike dhe rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Nëse dhunuesi nuk merr pjesë në program, përveç rasteve kur ka

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

arsye objektive dhe shkaqe të përligjura për mospjesëmarrjen, me kërkesë të mbledhjes *ad-hoc* të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje ose të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për urdhrat e mbrojtjes.

3. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, urdhërohet i padituri ose dhunuesi, nëse është rasti, të marrë pjesë në programe rehabilitimi pranë qendrave spitalore, qendrave ambulatorie ose qendrave komunitare, që japin shërbime të shëndetit mendor, shërbime të alkoologjisë ose shërbime të toksikologjisë.

4. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit vënë në dijeni koordinatorin vendor pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje për pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij.

5. Një dhunues, i dënuar me vendim gjykatë për të kryer dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, mund të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale. Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi në program mbahet parasysh në vlerësimin e rrezikut të të dënuarit në rastet e lirimit me kusht, lejeve shpërblyese ose të veçanta, të vizitave.

Neni 11

Efektet e urdhrin të mbrojtjes

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji do të nxirret me vendim gjykatë për rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykatë, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

KREU IV

GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRIT TË MBROJTJES

Neni 12

Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë.

Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

2. Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës, sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës, siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës përkatës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 13

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes

(shtuar shkronjat "dh" dhe "e" të pikës 2 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010)

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:

- a) vetë viktimë;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) policia / prokuroria.

2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:

- a) prindi ose kujdestari i të miturit;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) të afërmit;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

dh) policia/prokuroria;

e) personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët.

3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:

a) vetë viktimë;

b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;

c) policia/prokuroria;

ç) personi me të cilin viktimë ka marrëdhënie familjare;

d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

4. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 13/1

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

(shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në pikën 1, ndryshuar paragrafi i parë i pikës 2, zëvendësuar fjalë në shkronjat "a", "b", "c" të pikës 2, shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktimës ose viktimave dhe për ndalimin e dhunës.

2. Në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, sipas pikës 1 të këtij neni, derisa gjykata të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes, urdhërohet largimi i menjëhershëm i dhunuesit nga banesa, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara, si dhe/ose përcaktohen një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) urdhërimi i dhunuesit që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

b) urdhërimi i dhunuesit që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;

c) ndalimi menjëherë i dhunuesit, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimë, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;

d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës "ç", të kësaj pike;

dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;

e) bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

3. Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna sipas procedurës dhe modelit, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

Një kopje e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme i njoftohet menjëherë koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

3/1. Kur në të gjithë vendin ose në një pjesë të territorit të tij janë vendosur masat e jashtëzakonshme, përkatësisht, titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit detyrohet të lëshojë urdhrin për masat

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

paraprake për mbrojtjen e menjëhershme, sipas pikës 2 të këtij neni, në çdo rast kur konstaton se është ushtruar dhunë. Gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së masave të jashtëzakonshme, në kërkesën drejtuar gjykatës për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes, të marra përmes urdhrit për masat paraprake për mbrojtjen e menjëhershme të lëshuar, policia duhet t'i kërkojë gjykatës lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

4. Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

5. Brenda 48 orëve nga marrja e masave, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

6. Të drejtën për të kërkuar vlerësimin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme përpara gjykatës e ka edhe viktima dhe subjektet e parashikuara nga neni 13, pika 3, e këtij ligji, brenda 48 orëve, nga data e lëshimit të tij.

7. Gjykata, 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos:

a) vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) anulimin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar.

8. Gjykata, për nevoja të gjykimit, mund të thërrasë përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime.

Neni 14

Forma e kërkesëpadisë

(shtuar një fjalë në fund të pikës 3 dhe ndryshuar pika 4 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar pikat 3, 4, 5 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shëronja "b" të pikës 1, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Kërkesëpadija për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes duhet të përmbajë edhe:

a) të dhëna personale rreth familjes ose marrëdhënieve farefisnore mes viktimës dhe dhunuesit;

b) përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cenimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga i padituri (dhunuesi) të parashikuara në nenin 3 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji;

c) masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;

ç) nënshkrimin e kërkuesit.

2. Kërkesëpadija për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisarit me të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin "Për Policinë e Shtetit".

3. Për hartimin e kërkesëpadisë, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin në procesin gjyqësor, kërkuesi asistohet nga një avokat që ofron ndihmën juridike dytësore, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

4. Kërkuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPM-së përjashtohen nga:

a) pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

b) detyrimi për të parapaguar tarifen e vënies në ekzekutim të urdhrit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

c) pagimi i akteve të ekspertimit psikosocial, të interpretit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër.

Pas lëshimit të UMM/UM-së, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

5. Kërkesëpadia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevojat të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.

6. Gjykata, në vendimin e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, vendos edhe për rastet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni.

Neni 15

Provat në procesin gjyqësor

(ndryshuar fjalia e fundit e pikës 2 dhe shtuar pika 2/1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.

2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisaritet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të parashikuar në këtë pikë, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të viktimës, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës publike, që e disponojnë atë.

2/1 Moslëshimi i dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personit përgjegjës, bazuar në dispozitat e legjislacionit të posaçëm.

3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Neni 16

Gjykimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shkronja "b" të pikës 2, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata vendos për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.
2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:
 - a) viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
 - b) të paditurin (dhunuesin), përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;
 - c) prokurorin, nëse ky ka paraqitur kërkesën;
 - ç) përfaqësuesit e policisë;
 - d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;
 - dh) punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;
 - e) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.
3. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 17

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes

(zëvendësuar fjalë në shkronja "b" të pikës 1, hequr toqfjalësh në shkronjën "ç" të pikës 3, shtuar pika 6 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhër mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërtetohet se:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje;

b) lëshimi i urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës ose viktimave, urdhër në të cilin, përveç kërkuarit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuari ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrit të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, i cili, përveçse përmbush kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;

c) njoftimin se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.

4. Urdhri i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njërive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

6. Vendimi për urdhrin e mbrojtjes dhe urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes regjistrohet në një regjister të veçantë, i cili administrohet pranë çdo gjykate sipas modelit, rregullave dhe procedurave që miratohen me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 18

Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronja "b" e pikës 2 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:

a) të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës;

b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.

2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjohen personat në vijim:

a) viktimat, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;

b) dhunuesi, përfaqësuesi apo avokati i tij;

c) prokurori, nëse merr pjesë;

ç) kërkuarit e tjerë, të parashikuar në nenin 13 të këtij ligji;

d) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Neni 19

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

(shtuar shkronja "d" në pikën 5 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, shtuar pika 2/1, shfuqizuar shkronja "ç" e pikës 3 dhe ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

a) ekzistojnë bazat për të besuar se i padituri (dhunuesi) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë veprë të dhunës në familje; ose

b) i padituri (dhunuesi) paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose

c) lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykatë është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, që mbrohen me anë të urdhrin të mbrojtjes.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

2/1 Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtim ose ndërmjetësim.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;

c) njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën veprë penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) Shfuqizuar;

d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykatë.

4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykatë, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile.

Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) kërkuesve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njërive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisarariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

d) zyrave përbarimore të vendit të ekzekutimit.

6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktima dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.

Neni 20

Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes

(ndryshuar fjalia hyrëse me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Gjykata kryen seancën, sipas nenit 16, të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata:

a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykatë, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;

b) refuzon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykatë, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykatë;

c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykatë në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykatë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 21

Ankimi

(shfuqizuar pika 1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe moslëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Gjykata e apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankim nga viktimat, përveç rastit kur viktimat pretendon se masat e vendosura nuk garantojnë mbrojtje.

2. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose të urdhrit të mbrojtjes.

Neni 22

Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktimat (përfaqësuesi i saj), dhunuesi ose prokurori, nëse ka marrë pjesë në proces, mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes.

2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

- a) lënien në fuqi të urdhrit të mbrojtjes;
- b) ndryshimin e urdhrit të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht; ose
- c) ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 10 pika1 të këtij ligji nuk vlejnë më, për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.

4. Viktimat ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, mund të parashtrorë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrorët kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.

5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

- a) vërtetimin e ndërprerjes së urdhrit të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij; ose
- b) vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, nëse vlejnë kriteret e përcaktuara në nenin 17 pika1 të këtij ligji.

Neni 23

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor

(ndryshuar pika 1 dhe 6, shtuar pika 3/1 dhe shfuqizuar pikat 2 dhe 5 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

2. Shfuqizuar.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.

3/1 Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të

Përmbledhje legjislativi për të miturit

mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.

4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojnë masat e parashikuara në vendimin gjyqësor dhe koordinojnë punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.

5. Shfuqizuar.

6. Në rast të moszekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Procedimi penal

(shtuar fjali në fund të paragrafit me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

Lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykatë nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale. Në çdo rast, punonjësi i policisë, ku paraqitet për mbrojtje viktimë, e referon rastin në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 25

Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 26

Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Shpallur me dekretin nr.5182, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 912, datë 27.12.2018

PËR PROCEDURAT DHE MODELIN E URDHRIT PËR MASAT PARAPRAKE TË MBROJTJES SË MENJËHERSHME¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, si dhe të neneve 13/1, pika 3 e 25 pika 2, e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, ministri i Brendshëm dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

UDHËZOJNË:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim ka qëllim të përcaktojë procedurat, që ndiqen nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit për nxjerrjen e "Urdhrin për masa paraprake të mbrojtjes së menjëhershme", si dhe modelin e tij.

2. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi, për referencë do të përdoren përkufizimet dhe shkurtimet si më poshtë:

a) Koordinatori vendor – koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011.

b) Mekanizmi i referimit – mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 204*. Tiranë 2018. f. 15593.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) Punonjësi i policisë – punonjësi i policisë, që do të kryejë vlerësimin e riskut dhe procedurat për lëshimin e UMPMM-së.

ç) Raporti – raporti për vlerësimin e riskut i hartuar nga Policia e Shtetit.

d) Struktura përgjegjëse – struktura përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit në bazë të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

dh) UMPMM – urdhri i lëshuar nga Policia e Shtetit në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

e) UMM – Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes i lëshuar me vendim të gjykatës në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

ë) UM – Urdhri i Mbrojtjes i lëshuar me vendim të gjykatës në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

II. Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

3. UMPMM-ja nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna.

4. Pas përfundimit të vlerësimit paraprak të riskut, raporti i hartuar dhe të gjitha materialet e dosjes i kalojnë titullarit ose punonjësit të autorizuar prej tij, i cili nëse është rasti, nxjerr menjëherë UMPMM-në, sipas modelit të përcaktuar në aneksin e këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.

5. UMPMM-ja urdhëron një ose disa nga masat e parashikuara në nenin 13/1, pika 2, të ligjit 9669/2006 dhe përcakton strukturat, që do të zbatojnë UMPMM-në me afatet përkatëse. Titullari ose personi i autorizuar prej tij mban parasysh sugjerimet e raportit të vlerësimit të riskut, por ai mund të vendosë edhe masa të tjera të parashikuara nga ligji, që nuk janë përmendur në këtë raport, nëse i çmon të nevojshme për ndalimin e dhunës ose të përshkallëzimit të saj.

6. Në rastin kur i dhunuari është i mitur, UMPMM-ja që lëshohet ndaj dhunuesit/es së mitur ose që vendos në mbrojtje të miturin, nxirret pasi është vënë në dijeni Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki.

7. UMPMM-ja mund të vendosë viktimën në një qendër rezidenciale ose emergjente për viktimat e dhunës në familje, vetëm në rastin e rrezikut për jetën, duke marrë parasysh vullnetin e saj, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi për standardet e këtyre qendrave.

8. Brenda 48 orëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri struktura përgjegjëse që trajton rastin e dhunës paraqet kërkesën për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme pranë gjykatës kompetente.

9. Zbatimi i UMPMM-së ndërpritet pas lëshimit të vendimit të gjykatës për vlerësimin tij.

III. Zbatimi i urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

10. Zbatimi i UMPMM-së kryhet nga e njëjta strukturë e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me koordinatorin vendor të njësive të vetëqeverisjes vendore përkatëse.

11. Nëse vendi i raportimit të dhunës është i ndryshëm nga vendi i banimit të anëtarëve të familjes ku ka ndodhur dhuna, zbatimi i UMPMM-së kryhet nga struktura përgjegjëse, që ka nxjerrë urdhrin në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në vendin e banimit, si dhe koordinatorin vendor përkatës.

12. Struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit ka detyrë të informojë personin ndaj të cilit është dhënë urdhri, në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja dhe detyrimin e tij për ta zbatuar atë vullnetarisht. Në rastin e mosekzekutimit vullnetar nga dhunuesi, struktura përgjegjëse e evidenton këtë fakt në kërkesën, që i drejton gjykatës KOMPETENTE për vlerësimin e UMPMM-së.

13. Struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit ka detyrë të informojë viktimën e dhunës në familje në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja.

14. Zbatimi i masave që vendos UMPMM-ja, monitorohet nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit ose punonjësi i autorizuar prej tij, në bashkëpunim me koordinatorin vendor.

15. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor për personat përgjegjës, sipas legjislacionit përkatës.

IV. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSSHËM
Sandër Lleshaj

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

ANEKS MODEL I URDHRIT PËR MASAT PARAPRAKE TË MBROJTJES SË MENJËHERSHME



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË
KOMISARIATI I POLICISË _____

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____

URDHËR

Nr. _____, datë _____

Për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nga dhuna në familje

Në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, të nenit 29, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 750, datë 16.9.2015, "Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit", Nisur nga fakti që (përshkruaj shkurt ngjarjen/et): _____

Në datën, orën: _____

Vendi ku ka ndodhur ngjarja _____

Përshkrimi i shkurtimisht mënyrës se si është identifikuar/raportuar dhuna: _____

P.sh., shtetasi/ja (gjeneralitetet) është paraqitur/ka telefonuar në komisariatit e policisë _____ dhe ka denoncuar për dhunën ndaj tij/saj/fëmijëve (gjeneralitetet) _____, të ushtruar nga shtetasi/ja (gjeneralitetet) plotë të dhunuesit/es) _____.

Në bazë të raportit për vlerësimin e riskut, datë _____._____, rezulton se të dëmtuarit/es mund t'i rrezikohet jeta dhe shëndeti... etj. Me qëllim ndalimin e dhunës nga shtetasi/ja/ _____ dhe sigurimin e mbrojtjes së menjëhershme për shtetasin/shtetasen z/znj. _____/të miturit/ve (nëse ka fëmijë të përfshirë) _____,

URDHËROJ:

1. Marrjen e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme:

a) _____

b) _____ etj.

2. Një kopje e këtij urdhri u njoftohet menjëherë subjektit që ka ushtruar dhunën (dhunuesit/ses), subjektit të dhunuar (viktimës së dhunës), së bashku me informacionin e nevojshëm për vijimin e procedurave të mëtejshme; koordinatori vendor të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, në njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore (nëse ka fëmijë të përfshirë).

3. Brenda 48 orëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, struktura përgjegjëse/punonjësi i Policisë së Shtetit që trajton rastin e dhunës, paraqet kërkesën për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë _____.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet specialisti për krimet dhe ndihmës specialisti i policisë së zonës ku ka ndodhur ngjarja/ku ka vendbanimin i/e dhunuara (viktima e dhunës) _____.

5. Punonjësit e policisë që neglizhojnë zbatimin dhe monitorimin masave të parashikuara nga ky urdhër, kur sjellja e tyre nuk përbën veprë penale, ngarkohen me përgjegjësi disiplinore. Ky urdhër hyj në fuqi menjëherë.

Shefi i Komisarariatit
Emër mbiemër
Firma dhe vula e institucionit

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 9, datë 17.6.2020

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMIN E NJË BAZE TË DHËNASH TË POSAÇME PËR ÇËSHTJET E DHUNËS NË FAMILJE NË GJYKATA DHE UNIFIKIMIN E REGJISTRIMIT TË TYRE¹

(ndryshuar me VKM-në nr. 7, datë 15.6.2021)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të germës “ç”, të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor

UDHËZOJNË:

1. Ky udhëzim përcakton rregulla për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata, subjektet që kanë detyrimin e popullimit të kësaj baze të dhënash, unifikimin e regjistrimit të tyre, si dhe mënyrën e përdorimit dhe të aksesit në to.

2. Baza e të dhënave të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata ka për qëllim:

a) pasqyrimin dhe gjenerimin e të dhënave për çështjet e dhunës në familje, si dhe për ekzekutimin e tyre;

b) unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave, me qëllim krijimin e një baze statistikore që ndihmon harmonizimin e të dhënave gjyqësore me ato të gjeneruara nga institucionet e tjera të parashikuara nga ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;

c) përmirësimin periodik të bazës së të dhënave për të siguruar zbatimin e kërkesave që burojnë nga ndryshimi i legjislacioni përkatës ose nga ndryshimet në institucionet, që në bazë të ligjit në fuqi bashkërendojnë veprimtarinë e tyre kundër dhunës në familje;

ç) ofrimi i informacionit në kohën më të shpejtë për rastet me objekt gjykimi nga baza e të dhënave sipas këtij udhëzimi.

3. Të dhënat e ofruara nga gjykatat gjenerohen në përputhje me elementet që vendosen në këtë udhëzim, duke respektuar legjislacinin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Baza e të dhënave përmban këto elemente:

a) gjinia;

b) mosha;

c) statusi civil;

ç) niveli arsimor;

d) statusi i punësimit;

dh) lidhja familjare me dhunuesin;

e) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje nga vetë viktimat;

ë) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje nga përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;

f) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/ urdhër mbrojtjeje nga prokuroria;

g) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje nga policia;

gj) kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nga policia;

h) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje nga subjekte të tjera (personi me të cilin viktimat ka marrëdhënie familjare; përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë bashkisë, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimat, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje etj.); kërkesë për urdhër mbrojtjeje të të miturit nga policia/prokuroria;

i) kërkesë për urdhër mbrojtjeje të të miturit nga subjekte të tjera (prindi ose kujdestari i të miturit; përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; të afërmit; përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë bashkisë, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimat, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

¹Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 140*. Tiranë 2020. f. 8600.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje; personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët etj.);

j) kërkesa për ndryshimin, ndërprerjen ose vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes;

k) urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, së viktimës të lëshuar me vendim gjykatë (gjykata e rrethit gjyqësor);

l) ankim ndaj urdhrit të mbrojtjes/urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;

ll) vendim i gjykatës së apelit për lënien në fuqi/ndryshimin e vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes/urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;

m) urdhra të mbartur; vendime të mëparshme të gjykatës lidhur me viktimën apo vendime për ndryshimin apo pezullimin e urdhrit të mbrojtjes;

n) kallëzim penal ndaj dhunuesit/es ndaj të/së cilit/ës është kërkuar ose është lëshuar urdhri i mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, për vepra penale në lidhje me dhunën në familje;

nj) vendim i gjykatës penale për dhunuesin/en ndaj të/së cilit/ës është kërkuar ose është lëshuar urdhri i mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes për vepra penale, në lidhje me dhunën në familje;

o) kallëzim penal ndaj dhunuesit/es, ndaj të/së cilit/ës është kërkuar ose është lëshuar urdhri i mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës;

p) vendim i gjykatës penale për dhunuesin/en ndaj të/së cilit/ës është kërkuar ose është lëshuar urdhri i mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, për vepra penale, në lidhje me veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës;

q) gjendja e ekzekutimit të urdhrit të mbrojtjes/urdhrit të menjëhershëm i mbrojtjes nga zyra e përmbartimit/zyra e përmbartimit në bashkëpunim me organe të tjera shtetërore (policia, bashkia etj.).

5. Subjektet, që kanë detyrimin e popullimit të kësaj baze të dhënash, janë:

a) kancelarët e gjykatave të rretheve gjyqësore;

b) kancelarët e gjykatave të apelit.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës:

a) për gjenerimin e informacioneve statistikore të marra nga sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit për të dhënat e dhunës në familje. Krijon akses të plotë për Ministrinë e Drejtësisë në të dhënat statistikore që rezultojnë nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të dhunës në familje, të trajtuara nga gjykatat nëpërmjet kancelarëve;

b) për saktësinë e sigurinë e të dhënave, për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura dhe të ruajtura nga sistemi, si dhe për përmbushjen e detyrave të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

c) Nxitjen e sekretarëve gjyqësorë në plotësimin e të gjithë informacionit të nevojshëm.

7. Detyrat e gjykatave dhe të kancelarit:

a) gjykatat e rretheve gjyqësore dhe ato të apelit japin të gjithë informacionin e nevojshëm për këtë bazë të dhënash;

b) kancelari i gjykatës i siguron Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore, sipas formularëve, brenda datës 20 të muajit të dytë pasardhës për periudhën 3-mujore (tremujore), si dhe brenda datës 20 shkurt për të dhënat vjetore;

c) Kancelari koordinon punën me sekretarët gjyqësorë për të siguruar që të dhënat të jenë të plota dhe të sakta dhe i përcjell ato pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë në format elektronik dhe shkresor.

8. Detyrat e Ministrisë së Drejtësisë:

a) harton një formular të posaçëm dhe të unifikuar me të dhëna që shërbejnë për regjistrimin e çështjeve të dhunës në familje, sipas modelit të formularëve që gjenden bashkëlidhur;

b) kryen përpunimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje mbi bazën e formularëve që dërgohen nga kancelari i gjykatave;

c) analizon të dhënat statistikore për dhunën në familje dhe i publikon në vjetarin statistikor;

ç) bashkëpunon me institucionet e tjera përgjegjëse për harmonizimin e këtyre të dhënave me të dhëna që gjenerohen prej tyre, në zbatim të legjislacionit në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

9. Autoritetet përgjegjëse për monitorimin dhe për zbatimin e këtij udhëzimi janë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

10. Deri në krijimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit, grumbullimi dhe plotësimi i të dhënave për dhunën në familje do të plotësohen në format *Excel*, sipas formularëve bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Ngarkohet Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor për njoftimin dhe për komunikimin e këtij udhëzimi pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË

Etilda Gjonaj (Saliu)

KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Naureda Llagami

Formulari nr. 1

Ligi 9669	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershme mbrojtje	Gjithësej	Prania i kërkesës	Pushimi i gjyqimit	Krëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërve të mbrojtjes
Nëntë 10, pikë 1	1	2	3	4	5	6	7
Vendime sipas Nenit 10							
Subjekte sipas Nenit 13							
Ligi 9669	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershme mbrojtje	Gjithësej	Prania i kërkesës	Pushimi i gjyqimit	Krëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërve të mbrojtjes
Nëntë 10, pikë 1	1	2	3	4	5	6	7
Pika 1.a							
Pika 1.b							
Pika 1.c							
Pika 1.g							
Pika 1.d							
Pika 1.dh							
Pika 1.e							
Pika 1.f							
Pika 1.gg							
Pika 1.gg1							
Pika 1.h							
Pika 1.i							
Pika 1.j							
Pika 1.k							
Pika 1.l							
Pika 1.m							
Pika 1.m/1							
Pika 1.m/2							
Pika 1.m							
Pika 1.b							
Pika 1.c							
Pika 1.d							
Pika 2.a							
Pika 2.b							
Pika 2.c							
Pika 2.g							
Pika 2.d							
Pika 2.dh							
Pika 2.e							
Pika 3.a							
Pika 3.b							
Pika 3.c							
Pika 3.g							
Pika 3.d							
Pika 3.dh							

Formular nr. 2

TE DHËNAT STATISTIKORE PËR DHUNËN NË FAMILJE PËR VITIN 20

VENDBANIMI	Qytet	Periferi	Fshat				
MOSHA	0-15	16-18	19-25	26-35	36-45	46-55	55+
GJINIA	Femër	Mashkull					
STATUSI CIVIL	Beqar/e	Martuar	Divorcuar	Bashkëjetesë	i/e ve		
NUMRI I FËMIJËVE	Asnjë	1 fëmijë	2 fëmijë	3 fëmijë	4+		
NIVELI ARSIMOR	Pa shkollë	Filllore (1-4 klasë)	9-vjeçare (1-9 klasë)	I mesëm	I lartë		
STATUSI I PUNËSIMIT	I papunë	I punësuar në sektorin publik	I punësuar në sektorin privat	I vetëpunësuar	Studente	Nxënese	Pensionist
KËRKESË PËR URDHËR MBROJTJEJE	Pranuar	Hedhur poshtë	Pushuar				
LIDHJA FAMILJARE ME DHUNUESIN	Bashkëshorti/ja	Motra	Vëllai	Fëmija	Prindi	Të tjerë	
KËRKESË NGA PËRFAQËSUESI LIGJOR							
KËRKESË NGA PROKURORIA							
KËRKESË NGA POLICIA							
KËRKESË NGA BASHKITË, QËNDRAT SOCIALE etj.							
KËRKESË PËR NDRYSHIM OSE NDËRPRERJE TË URDHËRIT TË MBROJTJES							
Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor							

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

LIGJ
Nr.9695, datë 19.3.2007

PËR PROCEDURAT E BIRËSIMIT DHE KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMIT¹

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010; nr. 132/2015,
datë 5.12.2015; nr. 69/2019, datë 9.10.2019)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton procedurat e birësimit, si dhe organizimin, funksionimin e detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet vendosjes së përhershme në një familje birësuese;
- b) marrjen e masave, që birësimet, vendase dhe ndërvendase, të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës, i cili është mbizotërues ndaj çdo interesi tjetër;
- c) krijimin e një sistemi bashkëpunimi, brenda dhe jashtë vendit, për marrjen dhe respektimin e masave mbrojtëse, që parandalojnë dështimin e birësimit, rrëmbimin, shitjen ose trafikimin e fëmijëve;
- ç) sigurimin e bashkëpunimit me autoritetet vendore, autoritetet qendrore të vendeve të tjera apo organizatave të miratuara prej tyre, për mbarëvajtjen e periudhës pasbirësuese.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Birësim” është procedura administrative dhe gjyqësore, nëpërmjet së cilës fëmijës, që i është privuar ose jo mjedisi familjar, i sigurohet një familje alternative, me të drejta dhe detyrime të njëjta me prindërit biologjikë.
2. “Birësues” është personi/personat që, nëpërmjet birësimit, marrin fëmijë, të privuar ose jo nga mjedisi familjar, duke i trajtuar si fëmijë të lindur prej tyre.
3. “I birësuar” është fëmija i privuar ose jo nga mjedisi familjar, i cili, nëpërmjet birësimit, vendoset në një familje tjetër, për t’u rritur dhe edukuar nga birësuesit, si të ishte fëmija i tyre biologjik.
4. “Familje biologjike” janë prindërit, që e kanë lindur fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar.
5. “Përshtatshmëri” është aftësia e aplikantit për të qenë birësues, e vlerësuar nga Komiteti Shqiptar i Birësimit.
6. “Ndërmjetësim” është veprimtaria e agjencive të licencuara për vendosjen e kontakteve ndërmjet aplikantëve birësues dhe organeve kompetente të birësimit.
7. “Agjenci ndërmjetësuese” janë organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, të licencuara ose të miratuara nga organet kompetente të birësimit.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 36*. Tiranë 2006. f. 690.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

8. “Periudhë e provës” është procesi i bashkimit të aplikantit birësues dhe të fëmijës, pas pëlqimit të dhënë nga Komiteti, për një periudhë kohe deri në 3 muaj, gjatë së cilës verifikohet përshtatshmëria e kësaj marrëdhënieje.

9. “Konventa e Hagës” është konventa nr.33 “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”.

KREU II KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMIT

Neni 4

Detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësimit

1. Komiteti Shqiptar i Birësimit (më poshtë Komiteti) është autoriteti qendror në fushën e birësimit, vendas dhe ndërvendas.

2. Komiteti shqyrton dhe vendos për përshtatshmërinë e aplikantit birësues dhe jep pëlqimin për realizimin e çdo birësimi.

3. Komiteti mbikëqyr periodikisht të gjitha rastet e birësimeve dhe, në rastet e birësimeve ndërvendase, bashkëpunon me autoritetet qendrore të vendeve të tjera, ku është kryer birësimi.

Neni 5

Organizimi

(shtuar fjaltë në pikën 3 me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

1. Komiteti funksionon në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me këtë ligj, Kodin e Familjes, konventën “Për të drejtat e fëmijës” dhe Konventën e Hagës.

2. Komiteti përbëhet nga:

a) këshilli drejtues;

b) kryetari;

c) sekretariati ekzekutiv.

3. Këshilli drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Komitetit dhe përbëhet nga kryetari, si dhe nga një përfaqësues të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil i Ministrisë së Drejtësisë, i ministrisë që mbulon fushën e shëndetësisë, i ministrisë që mbulon fushën e arsimit dhe shkencës, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i ministrisë që mbulon fushën e rendit publik, i ministrisë që mbulon fushën e financave, i ministrisë që mbulon fushën e çështjeve sociale, një pedagog i së drejtës familjare nga universitetet publike dhe një përfaqësues i shoqatës së jetimëve.

4. Kryetari i Komitetit drejton këshillin drejtues dhe sekretariatit ekzekutiv.

5. Sekretariati ekzekutiv i Komitetit përbëhet nga specialistë të fushave të ndryshme dhe personeli i shërbimit, të cilët ndihmojnë këshillin drejtues në ushtrimin e funksioneve të veta. Veprimtaria e sekretariatit përcaktohet në këtë ligj dhe në rregulloren e brendshme të Komitetit.

6. Struktura dhe organika e Komitetit miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Rregullorja e brendshme e Komitetit miratohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e këshillit drejtues të Komitetit.

Neni 6

Statusi i Komitetit

1. Kryetari i Komitetit emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

2. Këshilli drejtues funksionon si organ kolegjal, në bazë të legjislacionit shqiptar.

3. Specialistët e sekretariatit ekzekutiv gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil.

4. Personeli i shërbimit emërohet nga kryetari i Komitetit dhe gëzon të drejtat e detyrimit e parashikuara në Kodin e Punës.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

Neni 7

Të ardhurat e Komitetit

(ndryshuar me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

1. Burimet e financimit të Komitetit janë:
 - a) Buxheti i Shtetit;
 - b) dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike;
 - c) financime të tjera të ligjshme, të marra nga burime të ndryshme.
2. Tarifa për shërbimet, ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurave të administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë e të Ministrisë të Financave.

Neni 8

Marrëdhëniet e Komitetit

(zëvendësuar fjalë në shkronjën "i" të pikës 1, riformuluar fjalë e dytë e pikës 2 me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

1. Komiteti, në zbatim të Kodit të Familjes dhe të këtij ligji, bashkëpunon me:
 - a) ministrinë që mbulojnë çështjet sociale dhe shëndetësinë për shkëmbime informacioni për respektimin e aktëve ligjore dhe nënligjore në fushën e birësimit;
 - b) Inspektoratin e Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe me shërbimet shoqërore, si autoritet i ngritur për kontrollin e zbatimit të legjislativit dhe të standardeve të shërbimeve shoqërore;
 - c) organet e institucioneve të mësipërme pranë njësive të qeverisjes vendore, si më poshtë:
 - i) sektorin e shërbimit social, i cili dërgon në Komitet raporte periodike 6-mujore për fëmijët e vendosur në kujdestari jashtë institucioneve;
 - ii) institucionet e përkujdesjes sociale të fëmijëve, publike dhe private, të cilat dërgojnë në Komitet raporte periodike 3-mujore për fëmijët që kanë në institucionet e tyre, për afatet dhe arsyet e qëndrimit në institucion.
2. Komiteti ushtron kontrole të vazhdueshme në institucionet e përkujdesjes për fëmijët, për të njohur gjendjen e fëmijëve që plotësojnë kushtet për t'u birësuar. Kur vihen re shkelje të detyrimeve ligjore në procedurën e birësimit, kryetari i Komitetit i propozon:
 - a) autoritetit shtetëror përgjegjës masa disiplinore për drejtuesit apo punonjësit e institucionit shtetëror të përkujdesjes sociale;
 - b) Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike dhe Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar heqjen e licencës për institucionet private të përkujdesjes shtetërore.

Neni 9

Detyrat e këshillit drejtues të Komitetit

(shfuqizuar pika 12, zëvendësuar fjalë në pikën 16 me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

- Këshilli drejtues i Komitetit ka këto detyra:
1. Vendos për përshtatshmërinë e aplikantëve birësues.
 2. Jep pëlqimin, me shkrim dhe në mënyrë kolegjiale, për birësimin e fëmijës nga aplikantët birësues, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.
 3. Merr masat e nevojshme për të shmangur dështimin e birësimeve, përfitimet e padrejta, si dhe çdo lloj veprimtarie, që synon trafikimin e fëmijëve.
 4. Cakton kohëzgjatjen, mënyrën dhe vendin ku do të realizohet periudha e provës për përshtatshmërinë e birësuesve me të birësuarin.
 5. Miraton projektbuxhetin e Komitetit dhe propozon strukturën organike të tij.
 6. Miraton programet e punës së Komitetit dhe politikat përkatëse për përmirësimin e procedurave të birësimit.
 7. Analizon, në fund të çdo viti, veprimtarinë financiare dhe administrative të Komitetit.
 8. Propozon për miratim, me urdhër të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të Financave, tarifat për shërbimet e kryera për birësim.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

9. Përmbush detyrimet që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara për të drejtat e fëmijëve në birësim.

10. Bën propozime për përmirësimin e legjislacioni në fushën e birësimit, në interes të fëmijës.

11. Vlerëson për çdo rast përfundimet për bashkimin birësues - i birësuar, që ka miratuar dhe mbikëqyr nëse birësimi i përgjigjet interesit më të lartë të fëmijës.

12. Shfuqizuar.

13. U kërkon agjencive, vendase dhe të huaja, informacion për gjendjen e fëmijës së birësuar, në afate të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar me to.

14. Nxist bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve qendrore të vendeve të tjera, si dhe hartimin e marrëveshjeve dypalëshe me agjencitë e huaja ndërmjetëse.

15. Miraton veprimtarinë e agjencive të huaja, që punojnë në fushën e birësimit në Shqipëri.

16. Informohet për veprimtarinë e agjencive të licencuara, pas kontrolleve të ushtruara nga strukturat e Komitetit dhe, kur vëren se ato kanë kryer shkelje të detyrimeve ligjore, propozon masa administrative deri në heqjen e licencës.

Neni 10

Kriteret e emërimit të kryetarit të Komitetit

(ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 132/2015, datë 5.12.2015; ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 69/2019, datë 9.10.2019)

Kryetar i Komitetit emërohet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

1. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të ketë përfunduar studimet në shkencat humane, shkencat juridike ose shkencat sociale, me nivelin e diplomës “master shkencor”.
3. Të ketë përvojë pune prej jo më pak se 5 vjetësh në fushën e të drejtave të fëmijëve.
4. Të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale dhe të gëzojë reputacion të mirë.

Neni 11

Detyrat e kryetarit të Komitetit

Kryetari i Komitetit drejton veprimtarinë e këshillit drejtues dhe të sekretariatit ekzekutiv dhe ka këto detyra:

- a) thërret këshillin drejtues në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme dhe përcakton rendin e ditës;
- b) drejton mbledhjet e këshillit drejtues;
- c) nënshkruan vendimet e marra në emër të këshillit drejtues dhe të institucionit që përfaqëson;
- ç) vërteton përputhjen e birësimit ndërvendas me dispozitat e konventës;
- d) nënshkruan marrëveshje me institucione analoge jashtë vendit, me agjenci vendase dhe të huaja, që ndërmjetësojnë në fushën e birësimit;
- dh) raporton për veprimtarinë e sekretariatit ekzekutiv përpara këshillit drejtues dhe për veprimtarinë e Komitetit përpara Ministrit të Drejtësisë;
- e) përfaqëson Komitetin në marrëdhënie me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit;
- ë) emëron ose largon nga detyra personelin e sekretariatit ekzekutiv, në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil dhe Kodin e Punës.

Neni 12

Largimi nga detyra i kryetarit të Komitetit

Kryetari i Komitetit largohet nga detyra kur:

- a) shkel kompetencat e parashikuara në këtë ligj;
- b) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- c) bëhet i paafte për të kryer detyrën për shkak sëmundjeje;
- ç) jep dorëheqjen.

Neni 13

Detyrat e sekretariatit ekzekutiv të Komitetit

Sekretariati ekzekutiv i Komitetit kryen këto detyra:

1. Harton dhe administron listat e fëmijëve që mund të birësohen brenda ose jashtë vendit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Pranon kërkesat e paraqitura nga shtetas shqiptarë ose të huaj, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që dëshirojnë të birësojnë fëmijë dhe ndihmon në plotësimin e dokumentacionit.
3. Kujdeset për t'u dhënë këshillat e nevojshme personave, pëlqimi i të cilëve kërkohet për birësim dhe jep të dhëna në kohë për pasojat e pëlqimit të tyre dhe të birësimit.
4. Bashkëpunon me institucionet e përkujdesit social për fëmijët, publike dhe private, brenda vendit, për të siguruar mbrojtjen e interesave të fëmijëve që janë në këto institucione.
5. Shqyrton, verifikon dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët birësues dhe dokumentacionin e fëmijës për t'u birësuar.
6. Siguron informacion të hollësishëm për prejardhjen e fëmijës, përfshirë prejardhjen kombëtare, fetare, kulturore dhe gjuhësore.
7. Realizon intervista me aplikantët birësues dhe përgatit studimin për ta.
8. Organizon këshillime, seminare dhe veprimtari të tjera në fushën e birësimit.
9. I kërkon sektorit të shërbimit social pranë njërive të qeverisjes vendore dhe agjencive ndërmjetësuese të dhëna për gjendjen e fëmijës së birësuar.
10. Realizon intervista për marrjen e mendimit/pëlqimit të fëmijës për birësimin, sipas parashikimeve të nenit 15 të këtij ligji.
11. Ushtron kontrolle në institucionet e përkujdesjes publike dhe private për fëmijët që plotësojnë kushtet për t'u birësuar dhe verifikon raportet periodike, të paraqitura prej tyre në Komitet për gjendjen e fëmijëve.
12. Mbikëqyr veprimtarinë e agjencive ndërmjetësuese për përbërjen, funksionimin dhe gjendjen financiare të tyre.

KREU III

PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT BIRËSUES

Neni 14

Paraqitja e kërkesës

(shtuar fjali në fund të pikes 4 me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

1. Shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të birësojnë fëmijë shqiptarë, i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit. Ata mund të birësojnë vetëm fëmijë, emrat e të cilëve janë në listat e Komitetit.
2. Shtetasit e huaj mund t'i drejtohen Komitetit vetëm nëpërmjet autoriteteve qendrore kompetente ose agjencive ndërmjetësuese të vendit të tyre, të njohura si të tilla nga Komiteti.
3. Shtetasit e huaj, rezidentë prej dy vjetësh në Republikën e Shqipërisë, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit, vetëm nëse legjislacioni i tyre kombëtar e lejon birësimin.
4. Shtetasit shqiptarë, rezidentë jashtë Republikës së Shqipërisë, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit, me kusht që vendimi gjyqësor shqiptar i birësimit të sjellë pasoja juridike në vendin e tyre të rezidencës. Ky rregull zbatohet edhe kur shtetasi shqiptar ka lidhur martesë me një shtetas të huaj apo person pa shtetësi.

Neni 15

Mendimi/pëlqimi i fëmijës që birësohet

1. Kur fëmija ka mbushur moshën 10 vjeç, birësimi kryhet vetëm kur Komiteti ka marrë mendimin e tij dhe pasi siguron se:
 - a) fëmija është këshilluar dhe informuar për pasojat e birësimit dhe të dhënies së mendimit të tij për birësimin;
 - b) janë marrë parasysh mendimet dhe dëshirat e fëmijës, kur ato janë në interes të tij;
 - c) mendimi i fëmijës është dhënë në mënyrë të vullnetshme dhe është dokumentuar apo evidentuar me shkrim, sipas formës së përcaktuar nga Komiteti;
 - ç) mendimi nuk është dhënë kundrejt pagesës apo çdo lloj kompensimi tjetër.
2. Kur fëmija ka mbushur moshën 12 vjeç, për birësim kërkohet pëlqimi i tij, në përputhje me kërkesat e tjera të pikës 1 të këtij neni.

Neni 16

Legjislacioni që zbatohet

1. Për fëmijën e huaj, që ndodhet në Republikën e Shqipërisë, në gjendje faktike braktisjeje, për të cilin kërkohet një ndërhyrje emergjente ligjore, zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Shtetasi shqiptar, që dëshiron të birësojë një fëmijë me shtetësi të huaj, duhet të përmbushë kërkesat e Kodit të Familjes, të këtij ligji, si dhe ato të ligjit të vendbanimit të fëmijës. Kërkesa i drejtohet Komitetit.

3. Shtetasi shqiptar, që ka dhe një shtetësi tjetër të huaj dhe banon në mënyrë të përhershme jashtë Republikës së Shqipërisë, në rast birësimi të një fëmije shqiptar, duhet të përmbushë kërkesat përkatëse ligjore të birësimit të vendbanimit të përhershëm.

Neni 17

Birësimi i fëmijës refugjat

1. Nuk mund të kryhet birësimi i një fëmije refugjat nëse:

a) ka shpresë të arsyeshme për gjetjen e familjes së tij dhe për bashkimin familjar, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;

b) nuk ka kaluar dy vjet nga data e marrjes së azilit, kohë gjatë së cilës janë ndërmarrë të gjitha masat për gjetjen e prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes së fëmijës;

c) është në kundërshtim me interesin e fëmijës;

ç) është i mundshëm në një të ardhme të afërt rikthimi i sigurt dhe me dinjitet në vendin e origjinës dhe nëse mundësitë e fëmijës në vendin e origjinës janë më të mira sesa birësimi në vendin e azilit ose në një vend të tretë.

2. Në procesin e birësimit të fëmijëve refugjatë, Komiteti bashkëpunon me strukturën përkatëse shtetërore që mbulon çështjet e refugjatëve.

Neni 18

Dokumentacioni i aplikantit birësues

(zëvendësuar fjalë në pikën 3, ndryshuar pika 5 dhe 9, shtuar paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

Aplikanti birësues paraqet në Komitet dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën me motivimin e birësimit.

2. Të dhënat personale për marrëdhëniet ndërpersonale të anëtarëve të familjes, informacione për pjesëtarët e familjes dhe qëndrimin e tyre ndaj birësimit.

3. Të dhënat për gjendjen civile, si kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e martesës, certifikatën e zgjidhjes së martesës ose të vdekjes së bashkëshortit.

4. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

5. Deklaratën për fëmijërinë, mënyrën e rritjes, edukimin dhe profesionin.

6. Raportin mjekësor dhe historinë mjekësore të familjes.

7. Vërtetime të punësimit, të të ardhurave dhe të pasurisë së paluajtshme.

8. Vërtetimin e pronësisë së banesës dhe të dhëna për kushtet e banimit.

9. Deklaratën me të dhënat për gjendjen ekonomike dhe sociale.

10. Vërtetimin, nga organet e njesisë së qeverisjes vendore të vendbanimit, për sjelljen dhe figurën morale.

11. Deklaratën e gatishmërisë së familjarëve dhe të miqve në mbështetje të aplikantit birësues.

Të dhënat, që do të përfshihen në deklaratat e parashikuara në pikat 5, 9 dhe 11 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë, me propozim të Komitetit Shqiptar të Birësimit. Deklaratat përpilohen përpara noterit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", të ndryshuar. Në rastin e përpilimit të këtyre deklaratave jashtë shtetit, ato paraqiten të legalizuara.

Neni 19

Studimi i aplikantit birësues

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumenteve përkatëse nga sekretariati ekzekutiv për të drejtën e aplikantit birësues për të birësuar, bëhet studimi i aftësisë së tij birësuese. Studimi i përgatitur i paraqitet këshillit drejtues për shqyrtim në mbledhjen e tij të radhës.

Neni 20

Regjistrimi në listat e Komitetit

Në listat e Komitetit regjistrohen ata fëmijë shqiptarë, për të cilët:

a) është deklaruar braktisja me një vendim gjyqësor të formës së prerë;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- b) është dhënë pëlqimi nga prindërit biologjikë;
- c) është dhënë pëlqimi nga gjykata për fëmijët që ndodhen në përkujdesje, sipas paragrafit të tretë të nenit 246 të Kodit të Familjes.

Neni 21

Heqja nga listat e Komitetit

Hiqen nga listat e Komitetit dhe nuk mund të birësohen fëmijët kur:

- a) është tërhequr pëlqimi i prindërve biologjikë për birësim, sipas Kodit të Familjes;
- b) është vendosur nga gjykata, që fëmija të qëndrojë pranë prindërve biologjikë, me ndërhyrjen në proces të prindërve, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës;
- c) janë bërë madhorë;
- ç) fëmija vdes;
- d) fëmija mbi 12 vjeç kundërshton birësimin.

Neni 22

Dokumentacioni i fëmijës që do të birësohet

(zëvendësuar fjalë në shkronjën “d” të pikës 2 me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

1. Sekretariati ekzekutiv verifikon dhe vlerëson dokumentacionin për çdo fëmijë që do të birësohet, të përgatitur nga institucionet e përkujdesjes sociale ose të shërbimit social pranë njësive të qeverisjes vendore. Vlerësimi i këtij dokumentacioni shërben për gjetjen e familjeve të përshtatshme, për të përballuar nevojat e fëmijës.

2. Dokumentacioni i fëmijës që do të birësohet përmban:

- a) certifikatën e lindjes;
- b) raportin për gjendjen psikologjike, fizike dhe sociale të tij;
- c) raportin për gjendjen shëndetësore ekzistuese dhe historikun mjekësor;
- ç) mendimin e fëmijës, nëse ai ka mbushur 10 vjeç, duke pasur parasysh aftësinë e tij për të arsyetuar. Kur fëmija ka mbushur moshën 12 vjeç paraqitet pëlqimi i vet;
- d) kopje të letërnjoftimit të prindërve të tij biologjikë, nëse ata njihen;
- dh) raportin me të dhëna mbi historikun mjekësor të prindërve, nëse ato dihen, informacion për shtatzaninë dhe lindjen;
- e) deklaratën me shkrim të prindit biologjik për pëlqimin ose vendimin gjyqësor, që ka dhënë pëlqimin për birësimin e fëmijës, ose vendimin gjyqësor që e ka deklaruar fëmijën të braktisur;
- ë) historikun e kalimit në kujdestari të fëmijës, nëse ka dhe të dhëna për kushtet në të cilat ka jetuar;
- f) hollësi rreth jetës dhe zakoneve të tij.

3. Data e lëshimit të raportit, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, duhet të jetë jo më parë se dy javë nga data e dorëzimit në Komitet e dokumentacionit për birësim.

KREU IV

PROCEDURAT E BIRËSIMIT

Neni 23

Përparësia në birësim

1. Sekretariati ekzekutiv, për fëmijën, emri i të cilit është në listat e tij, propozon një familje birësuese shqiptare të përshtatshme. Nëse kjo nuk është e mundur dhe kur emri i fëmijës ka qenë në listat e Komitetit që prej 6 muajve, aplikant birësues mund të jetë edhe një familje e huaj.

2. Në raste të veçanta, kur nga plotësimi i afatit të sipërpërmendur mund të dëmtohet shëndeti i fëmijës, nisur nga interesi më i lartë i tij, Komiteti mund të japë pëlqimin për birësim edhe pa u përmbushur ky afat, duke e motivuar këtë pëlqim.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 24

Shqyrtimi nga këshilli drejtues

(shtuar shkronja "c" me ligjin nr. 132/2015, datë 5.12.2015)

Dokumentacioni i përgatitur nga aplikanti birësues për procedurën e birësimit të fëmijës dhe dokumentacioni i fëmijës që do të birësohet, i propozuar nga sekretariati ekzekutiv, shqyrtohet nga këshilli drejtues, i cili:

- a) vendos nëse aplikanti birësues është i përshtatshëm ose jo për të birësuar;
- b) jep pëlqimin me shkrim për birësimin e fëmijës nga aplikanti birësues;
- c) afati i konsiderimit i përshtatshëm, i aplikantit birësues, është 2 vjet nga data e dhënies së vendimit nga Këshilli Drejtues. Në rastet kur ky afat përfundon, sekretariati ekzekutiv i Komitetit Shqiptar të Birësimit i kërkon aplikantit rifreskimin e dokumentacionit dhe bën rivlerësim të situatës aktuale të tij, duke paraqitur edhe propozimet konkrete për rinovim të afatit të përshtatshmërisë ose heqje të tij. Rishqyrtimi i dosjes dhe kushteve të aplikantit bëhet brenda 2 muajve nga dita e përfundimit të afatit të përshtatshmërisë.

Neni 25

Periudha e provës

1. Me dhënien e pëlqimit për çdo birësim, me propozimin e sekretariatit ekzekutiv, këshilli drejtues përcakton periudhën e provës, e cila nuk mund të jetë më shumë se 3 muaj.
2. Në përfundim të periudhës së provës, sekretariati ekzekutiv përgatit raportin për përshtatshmërinë e aplikantëve birësues me fëmijën dhe dokumentacionin e përgatitur ia dërgon gjykatës.
3. Në rast se aplikantët birësues e kanë pasur fëmijën në kujdestari familjare për një periudhë më të gjatë se tre muaj dhe vërtetohet se kjo marrëdhënie ka qenë afektive, periudha e provës nuk është e domosdoshme.

Neni 26

Përmbajtja e dokumentacionit

Dosja që i dërgohet gjykatës nga Komiteti përmban:

- a) dokumentacionin e përgatitur për aplikantin birësues;
- b) dokumentacionin e përgatitur për fëmijën që do të birësohet;
- c) vendimin për përshtatshmërinë e aplikantëve;
- ç) pëlqimin e këshillit drejtues për birësimin e fëmijës nga aplikantët;
- d) raportin e përshtatshmërisë së aplikantit me fëmijën.

KREU V

BIRËSIMI NDËRVENDAS

Neni 27

Kushtet

Për birësimet ndërvendase, që do të shpallen në Republikën e Shqipërisë, këshilli drejtues i Komitetit verifikon:

- a) vlefshmërinë e dokumentacionit të aplikantëve birësues;
- b) miratimin, nga organi kompetent i huaj, i përshtatshmërisë së aplikantëve birësues;
- c) dokumentacionin e plotë dhe të saktë të aplikantëve;
- ç) përputhjen e parimeve të legjislacionit shqiptar me atë të shtetit të birësuesit;
- d) bashkëpunimin me autoritetet e vendit pritës, që birësimi të mos dështojë dhe fëmija të autorizohet të hyjë për të banuar përgjithmonë në shtetin pritës.

Neni 28

Dokumentacioni plotësues

Në birësimin ndërvendas, veç dokumenteve të parashikuara në nenin 27 të këtij ligji, Komiteti i dërgon gjykatës:

- a) vërtetimin se fëmija nuk ka pasur mundësi të birësohet në Shqipëri për një afat prej 6 muajsh, me përjashtimin e parashikuar në pikën 2 të nenit 23 të këtij ligji;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) vërtetimin se në vendin e aplikantëve fëmija do të gëzojë të njëjtat të drejta si në Shqipëri dhe se birësimi është i parevokueshëm.

Neni 29

Birësimi i fëmijës rezident jashtë vendit

Mund të birësohen nga shtetas shqiptarë ose rezidentë të huaj në Shqipëri fëmijë, shqiptarë ose të huaj, rezidentë në shtete të tjera, që e kanë ratifikuar Konventën e Hagës ose kanë lidhur marrëveshje dypalëshe me autoritetet kompetente apo agjencitë, në përputhje me parimet e kësaj konvente, me kusht që:

a) fëmija të jetë deklaruar i birësueshëm nga organi kompetent i huaj dhe të jenë ndërprerë marrëdhëniet prindër-fëmijë;

b) të jetë dhënë autorizimi ose pëlqimi i nevojshëm nga autoriteti qendror i huaj ose nga ndonjë organ tjetër që barazohet me të.

Neni 30

Procedura e birësimit ndërvendas

Shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të birësojnë fëmijë të huaj ose shqiptarë, rezidentë jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet t'i drejtohen Komitetit me kërkesë, së cilës t'i bashkëlidhin të gjithë dokumentacionin e parashikuar në nenin 18 të këtij ligji.

Këshilli drejtues, pasi verifikon nëse ekzistojnë kushtet, vendos për:

a) përshtatshmërinë e aplikantëve birësues, duke pasur parasysh të gjithë informacionin për identitetin e tyre, për familjen, gjendjen shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndryshimet kulturore ose fetare të fëmijës;

b) dërgimin tek autoriteti kompetent i huaj të dokumentacionit, të vendimit të përshtatshmërisë dhe të karakteristikave të fëmijës, që aplikanti dëshiron të birësojë.

Neni 31

Njohja e vendimit të huaj

Birësimi i shpallur në një vend të huaj, me kërkesën e shtetasve shqiptarë, do të prodhojë pasoja juridike në Republikën e Shqipërisë nëse gjykata, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Komiteti, vëren se janë zbatuar kriteret e parashikuara në nenin 4 të Konventës së Hagës dhe parimet e legjislacionit shqiptar në fuqi.

KREU VI

AGJENCITË NDËRMJETËSUESE

Neni 32

Fusha e veprimtarisë

1. Agjencitë ndërmjetësuese ushtrojnë veprimtarinë e tyre ndërmjet Komitetit dhe autoriteteve kompetente të huaja në birësimet ndërvendase.

2. Agjencitë ndërmjetësuese mund të jenë vendase ose të huaja.

3. Veprimtaria e tyre rregullohet me këtë ligj.

Neni 33

Agjencitë ndërmjetësuese në fushën e birësimit

(ndryshuar me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

1. Agjencitë ndërmjetësuese vendase licencohen sipas legjislacionit për licencat, për një afat 5-vjeçar, dhe në licencë përcaktohen territori dhe shtetet, për të cilat do të ndërmjetësojnë. Veprimtaria e këtyre subjekteve përfshihet në kategorinë XI.3 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

2. Agjencitë ndërmjetësuese të huaja njihen dhe miratohen nga komisioni i miratimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për një afat 5-vjeçar për ushtrimin e veprimtarisë në këtë fushë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Përbërja dhe rregullat e funksionimit të komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i komisionit për njohjen dhe miratimin e ushtrimit

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

të veprimtarisë dërgohet për publikim në Qendrën Kombëtare të Licencimit brenda 10 ditëve. Nëse komisioni rrëzon kërkesën, agjencia ndërmjetësuese ka të drejtë që, brenda 10 ditëve, të paraqesë ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, i cili shprehet me vendim brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

3. Agjencitë ndërmjetësuese, vendase ose të huaja, duhet:

- a) të ndjekin vetëm qëllime jofitimprurëse, sipas kushteve të përcaktuara nga Komiteti;
- b) të drejtohen dhe të kenë personel me integritet moral dhe të kualifikuar në fushën e birësimit, me punonjës socialë, psikologë dhe juristë;
- c) të sigurojnë një administrim kontabël, transparent, për kostot e domosdoshme për realizimin e procedurës së birësimit;
- ç) të mos paragjykojnë dhe të mos diskriminojnë aplikantët birësues, për shkaqe të tilla, si raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike e filozofike apo shkaqe të tjera diskriminuese;
- d) të jenë regjistruar në gjykatë.

Neni 34

Detyrat e agjencive ndërmjetësuese

(shtuar shkronja "g" me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

Agjencitë ndërmjetësuese kryejnë këto detyra:

- a) përgatisin dokumentacionin dhe studimin e aplikantëve birësues për birësimet ndërvendase dhe ia paraqesin atë Komitetit;
- b) realizojnë këshillime për aplikantët birësues për birësimin dhe pasojat e tij, si dhe i informojnë ata për të drejtat dhe detyrimet e tyre;
- c) ndjekin procedurën e birësimit pas marrjes së vendimit të përshtatshmërisë, të dhënë nga Komiteti, duke ia dërguar të gjithë dokumentacionin autoriteteve ose agjencive kompetente të vendeve me të cilat kanë marrëdhënie;
- ç) marrin nga autoriteti i huaj propozimin për realizimin e takimit ndërmjet aplikantëve për birësim dhe fëmijës që do të birësohet. Gjatë takimit duhet të paraqiten të gjitha informacionet e nevojshme për gjendjen shëndetësore të fëmijës, familjen biologjike dhe për përvojat e tij të jetës;
- d) u japin shtetasve shqiptarë informacionin e nevojshëm për fëmijën që do të birësojnë;
- dh) realizojnë takimin ndërmjet aplikantit birësues dhe fëmijës që do të birësohet, duke ndërmjetësuar në këtë veprimtari;
- e) informojnë me shkrim Komitetin për rezultatin e takimit;
- ë) përgatisin raportin pas birësimit dhe japin informacione të hollësishme edhe për birësimet të veçanta;
- f) ndërmjetësojnë për transferimin e fëmijës nga vendi i origjinës në vendin pritës dhe ndjekin procedurën për njohjen e vendimit;
- g) të paraqesin pranë Komitetit raporte me shkrim çdo 6 muaj për veprimtarinë e tyre dhe në çdo rast që Komiteti i kërkon një raport të tillë.

Neni 35

Mbarimi i veprimtarisë së agjencisë

Veprimtaria e agjencisë ndërmjetësuese mbaron:

- a) kur mbaron afati, për të cilin është dhënë licenca ose miratimi;
- b) kur hiqet licenca ose miratimi, për shkak se ka shkelur kërkesat e ligjit ose kur kërkohet nga vetë agjencia;
- c) kur ka kryer vepër penale;
- ç) kur shteti i huaj i ka hequr autorizimin si agjenci ndërmjetësuese.

KREU VII

ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE PERSONALE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

(zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

Neni 36

Mbrojtja e të dhënave personale

(ndryshuar me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

1. Komiteti respekton dhe përgjigjet për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës në procedurat e birësimit. Ai merr masat organizative dhe teknike të domosdoshme për mbrojtjen e të dhënave personale, duke

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

zbatuar kushtet, kriteret dhe procedurat për përpunimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Nëse gjatë procedurave të birësimit lind nevoja për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për një veprim të caktuar, kryetari i Komitetit paraqet kërkesë me shkrim.

3. Agjencitë ndërmjetësuese vendase, në cilësinë e kontrolluesit, detyrohen të zbatojnë të gjitha kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Punonjësit publikë dhe privatë që, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, vihen në dijeni për të dhënat e përpunuara dhe kanë informacion për birësim, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të detyrës. Këto të dhëna nuk mund të përhapen apo bëhen të ditura, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 37

E drejta për informim

1. Prindërit birësues dhe i birësuari, që ka arritur moshën madhore, mund t'i kërkojnë Komitetit të dhëna për origjinën e të birësuarit dhe historinë e tij.

2. Ky informacion mund të kufizohet ose të refuzohet në raste të veçanta, kur ka arsye se prej tij vijnë pasoja të rënda.

Neni 38

Dispozitë kalimtare

(shtuar paragrafë me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010)

Punonjësit ekzistues, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji punojnë në vende pune që vlerësohen si pjesë e shërbimit civil, janë nëpunës në periudhë prove tremujore dhe për ta zbatohen përcaktimet e bëra në nenin 14 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Komiteti, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, merr masat për:

a) paraqitjen pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit të informacionit të nevojshëm të agjencive ndërmjetësuese të licencuara prej tij përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) depozitimin pranë Ministrit të Drejtësisë të kërkesave për licencë dhe të dokumentacionit shoqërues, të paraqitura nga agjencitë ndërmjetësuese përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilat Komiteti nuk ka vendosur ende;

c) depozitimin e të dhënave të agjencive ndërmjetësuese të licencuara, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për qëllime të regjistrimit, sipas pikës 4 të nenit 33 të këtij ligji.

Ministri, që përfaqësohet në këshillin drejtues të Komitetit Shqiptar të Birësimit, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, merr masa për caktimin e përfaqësuesit, në përputhje me pikën 3 të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 39

Shfuqizime

Ligji nr.7650, datë 17.12.1992 "Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5245, datë 30.3.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

UDHËZIM
Nr. 38, datë 5.8.2013

PËR VEPRIME TË KOMITETIT SHQIPTAR TË BIRËSIMIT, PËRPARA FILLIMIT TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE¹

Mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

1. Në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe qëllimin e këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Subjekt i të dhënave personale” janë birësuesi/t dhe i/e birësuar/a;
- b) “Kontrollues i të dhënave personale” është Komiteti Shqiptar i Birësimit dhe agjencitë e ndërmjetësimit.

2. Kontrolluesit mund të përpunojnë të dhëna personale të birësuesve dhe të birësuarve vetëm:

- a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin me shkrim, veprim, i cili për përpunimin e të dhënave sensitive mund të revokohet në çdo moment;
- b) për të mbrojtur interesat jetike të të birësuarit;
- c) për përmbushjen e veprimtarisë së punës të Komitetit Shqiptar të Birësimit;
- d) nëse është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të Komitetit Shqiptar të Birësimit.

3. Kontrolluesit në kryerjen e procedurave të birësimit:

- a) përpunojnë të dhëna personale në përputhje me ligjet respektive;
- b) grumbullojnë të dhëna vetëm për qëllime të birësimit të fëmijës;
- c) mbledhin të dhëna të sakta dhe në përputhje me qëllimin e caktuar pa e tejkaluar atë;
- d) bëjnë përditësimin e të dhënave;
- e) bëjnë fshirjen apo korigjimin e të dhënave që i identifikojnë të pasakta apo të paplota ose kur i kërkohet nga subjektet e të dhënave paraprakisht vlerësojnë nëse duhen kryer këto veprime;
- f) mbajnë të dhënat në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një afat kohor të caktuar deri në përmbushjen e qëllimit për të cilin ato janë mbledhur ose përpunuar.

4. Kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale marrin masa organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat në dokumentacionin birësues në përputhje me ligjet respektive dhe udhëzimet nr. 21 dhe nr. 22, datë 24.9.2012, respektivisht “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj” dhe “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël”, të ndryshuar.

5. Punonjësit e kontrolluesit, që për shkak të detyrës kanë informacion për birësimin, për të dhënat që identifikojnë fëmijën, prindërit biologjikë dhe birësuesit, nënshkruajnë deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe besueshmërisë gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit.

6. Kontrolluesit, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, detyrohen të zbatojnë të drejtat e subjektit të të dhënave në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim dënohet sipas nenit 39 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndryshuar.

8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Komiteti Shqiptar i Birësimit dhe agjencitë e ndërmjetësimit.

Udhëzimi nr. 8, datë 31.8.2010 “Për veprime të kontrolluesit, Komiteti Shqiptar i Birësimit, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 134*. Tiranë 2013. f. 5897.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

UDHËZIM

Nr. 383/8, datë 29.4.2013

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E KOMITETIT SHQIPTAR TË BIRËSIMEVE¹

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Për procedurat e birësimit të të miturve nëpërmjet Komitetit Shqiptar të Birësimeve, paguhet tarifa shërbimi, si më poshtë:
 - a) Nga shtetas shqiptarë, 20 000 (njëzet mijë) lekë;
 - b) Birësim me pëlqim, 10 000 (dhjetë mijë) lekë;
 - c) Nga shtetas të huaj, 1 000 (një mijë) dollarë për shtetasit që vijnë nga vendet jashtë Bashkimit Europian; ose 700 (shtatëqind) euro për shtetasit që vijnë nga vendet e Bashkimit Europian.
 2. Tarifa e shërbimit të paguhet në momentin e miratimit të kërkesës për birësim.
 3. Të ardhurat e siguruar nga tarifat për shërbimet e birësimeve derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.
 4. Ngarkohet Komiteti Shqiptar i Birësimeve për zbatimin e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR

Nr. 284, datë 28.6.2013

PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT PËR DEPOZITIMIN E TË DHËNAVE PËR AGJENCITË NDËRMJETËSUESE TË HUAJA, TË LICENCUARA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË FUSHËN E BIRËSIMIT²

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 1.6.2011 “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja”,

URDHËROJ:

1. Krijimin e regjistrit për depozitimin e të dhënave për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit (më poshtë “Regjistri”).
2. Personi i autorizuar përgjegjës për administrimin e regjistrit, regjistron të dhënat për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara, të paraqitura nga Komisioni për Miratimin të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, pas miratimit për dhënien e licencës.
3. Regjistri mbahet në formë elektronike (digjitale).
4. Faqet e regjistrit ndahen në 9 kolona, sipas modelit të paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij urdhri. Kolonat kanë emërtimet e mëposhtme:

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 69*. Tiranë 2013. f. 3057.

² Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 125*. Tiranë 2013. f. 5347.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) nr. (numri rendor i kërkesës që do të regjistrohet);
- b) data e depozitimit të kërkesës;
- c) identiteti i personit të autorizuar për të paraqitur kërkesën (emri, atësia, mbiemri, vendlindja dhe vendbanimi);
- d) numri i licencës;
- e) data e fillimit të veprimtarisë nga shteti përkatës për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimeve;
- f) emri/emrat e drejtuesve të agjencisë ndërmjetësuese të huaj (emri, atësia, mbiemri, vendlindja dhe vendbanimi);
- g) emërtimi dhe lloji i shoqërisë;
- h) selia e shoqërisë;
- i) shënime (pasqyrohen të dhënat që nuk përfshihen në rubrikat e tjera dhe që çmohen se janë të rëndësishme për t'u pasqyruar).

5. Të dhënat e pasqyruara në Regjistrë hartohen edhe në formatin shkresor, i cili, pasi nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit, vulloset dhe ruhet në sektorin e arkiv protokollit.

6. Personi i autorizuar përgjegjës, i caktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, për administrimin e Regjistrit për depozitimin e të dhënave për agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të licencuara përditëson të paktën një herë në vit Regjistrin dhe siguron publikimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

LIGJ

Nr. 18/2017

PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacioni në fuqi;

b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 43*. Tiranë 2013. f. 2855.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;

ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;

d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;

dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;

e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Agjencia" nënkupton Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

2. "Autoritet përgjegjës" është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat, brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/jnë politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, kryen/jnë dhe mbulon/jnë shërbime të specializuara e profesionale për fëmijën.

3. "Dhunë ndaj fëmijës" është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

4. "Fëmijë" është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. "Fëmijë i pashoqëruar" është fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji.

6. "Fëmijë në nevojë për mbrojtje" është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një veprë penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

7. "Këshilli" nënkupton Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

8. "Mbrojtje e fëmijës" është parandalimi dhe përgjigja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

9. "Ndëshkimi trupor" është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim të fëmijës, nga çdo person ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja, shtytja, djegia, goditja, pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, tërheqja e flokëve, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, si dhe çdo veprim i ngjashëm me të.

10. "Neglizhimi i fëmijës" është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

11. "Përmbajtje të dëmshme për fëmijën" janë çdo pamje, imazh dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cenon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.

12. "Përfaqësues procedural" është personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.

13. "Pjesëmarrje e fëmijës" është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes aktive të fëmijës dhe i respektimit të së drejtës së tij për t'u shprehur e për t'u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me të.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

14. "Prind" është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

15. "Sistemi i integruar i mbrojtjes" është tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme, në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete, me qëllim bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësisë dhe koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.

16. "Shërbimi psiko-social shkollor" është shërbimi që u ofron mbështetje nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore për identifikimin dhe trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale të komunitetit shkollor, i cili sigurohet nga njësitë arsimore vendore.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- a) fëmijën me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) fëmijën me shtetësi shqiptare, i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Parime të përgjithshme

Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.
2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
3. Barazia dhe mosdiskriminimi.
4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirëritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
5. Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj.
8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.
9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

Neni 6

Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatesinë në një familje;
- b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- c) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirëritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
- d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

KREU II TË DREJTAT E FËMIJËS

Neni 7

E drejta e jetës

1. Mbrojtja e jetës së fëmijës është e garantuar me ligj. Fëmija gëzon standardet më të larta të mundshme të shëndetit, trajtimit e rehabilitimit.
2. E drejta e aksesit të fëmijës tek institucionet e kujdesit shëndetësor garantohet pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, racës, etnisë dhe aftësisë ose situatës ekonomike, sociale e ligjore të prindërve apo kujdestarit.
3. Çdo fëmijë që ka nevojë për shërbim shëndetësor ose trajtim mjekësor apo rehabilitues në situata emergjence, vetë ose nëpërmjet prindërve apo kujdestarit, ka të drejtë t'u drejtohet institucioneve të kujdesit shëndetësor ose social për këtë qëllim. Personi ose autoriteti përgjegjës, brenda fushës së kompetencave që ka, i ofron fëmijës ndihmën e menjëhershme dhe e referon atë në institucionin e kujdesit shëndetësor ose rehabilitues më të përshtatshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prindit ose kujdestarit.
4. Në raste përjashtimore, kur jeta e fëmijës rrezikohet ose ka një rrezik për pasoja serioze në jetën dhe shëndetin e fëmijës, mjeku ka të drejtë të kryejë ekzaminimin dhe të japë ndihmën mjekësore, si nevojë imediate për të shpëtuar jetën e fëmijës, edhe nëse prindërit ose kujdestari nuk japin pëlqimin.

Neni 8

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:
 - a) të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
 - b) të ketë një emër;
 - c) të fitojë shtetësinë;
 - c) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur.
2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.
3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihma mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:
 - a) gjetjen e prindërve;
 - b) gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkues, me qëllim bashkimin familjar;
 - c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.
4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.
5. Nëse nuk është i mundur përcaktimi i identitetit të një fëmije të gjetur ose të braktisur në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor ose identiteti i prindërve të fëmijës, punonjësi i strukturës së mbrojtjes së fëmijës, kryesisht ose pas marrjes së mendimit të strukturave përgjegjëse të shërbimeve sociale, cakton menjëherë një ose disa punonjës të institucionit ku është gjetur ose braktisur fëmija, për t'u kujdesur për fëmijën deri në marrjen e masave të nevojshme, sipas këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

6. Kur fëmija braktiset nga nëna në maternitetet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, personeli social dhe mjekësor i tyre, brenda 24 orëve nga zhdukja e nënës, njofton me telefon dhe me shkrim njësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor dhe policinë, në të njëjtën kohë e mënyrë. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor, në bashkëpunim me punonjësin e policisë, përgatit raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Nëse gjendja shëndetësore e fëmijës është e mirë, bazuar në raportin e hartuar, njësia e mbrojtjes së fëmijës, pranë pushtetit vendor, merr masa për vendosjen e fëmijës, përkujdesje alternative, sipas nenit 57 të këtij ligji.

7. Në rast se identifikohet njëri nga prindërit, njësia e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor ofron këshillim, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e fëmijës pranë familjes biologjike dhe lëshimin e certifikatës së lindjes. Nëse nëna nuk identifikohet pas hetimit të policisë, punonjësi i njësive të mbrojtjes së fëmijës pranë njësive vendore ku ka lindur fëmija, përgatit dosjen që përmban aktin e lindjes, raportin e përgatitur, sipas pikës 6, të këtij neni, vendimin për masën e mbrojtjes së fëmijës dhe informacionin e dërguar nga policia për rezultatin e hetimeve të kryera.

8. Institucionet e kujdesit shëndetësor, të shërbimit social, shërbimet rezidenciale, si dhe të gjithë personat juridikë e fizikë që identifikojnë gra shtatzëna ose fëmijë që nuk kanë dokumente identifikimi, njoftojnë me shkrim punonjësin e njësive të mbrojtjes së fëmijës pranë njësive vendore ku ushtrojnë aktivitetin, i cili, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të pushtetit vendor, ndërmer veprime konkrete për përcaktimin e identitetit të gruas shtatzënë ose të fëmijës.

9. Rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor, parashikohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 9

E drejta për të qëndruar me prindërit

1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore.

2. Fëmija, në çdo rast, ka të drejtë të dëgjohet dhe t'i merret mendimi ose pëlqimi nga gjykata, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

3. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.

4. Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

5. Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet prindërve, lidhur me mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tyre për të mbajtur kontakte me fëmijën, gjykata vendos një ditë të përcaktuar me orare, sipas moshës së fëmijës, intensitetit të lidhjes emocionale që fëmija ka me prindin, me të cilin nuk bashkëjeton, sjelljen e këtij të fundit, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme për vendimmarrjen e gjykatës në secilin rast. Ky kriter ndiqet nga gjykata edhe në përcaktimin e kontakteve të fëmijës me persona të tjerë të afërt me të.

6. Për qëllime të këtij ligji, marrëdhëniet personale mund të ndërtohen nëpërmjet:

a) takimeve ndërmjet fëmijës dhe prindit ose një personi tjetër, i cili, sipas ligjit, ka të drejtë të mbajë kontakte me fëmijën;

b) vizitave të fëmijës në mjedisin e banimit;

c) banimit të përkohshëm të fëmijës te një i afërm ose person, i cili nuk jeton rregullisht me fëmijën;

d) korrespondencës ose çdo forme tjetër komunikimi me fëmijën;

e) dërgimit të informacionit fëmijës, lidhur me prindërit e tij ose personat e tjerë që, sipas ligjit, kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën;

dh) transmetimit, nga personi që jeton me fëmijën, të informacionit lidhur me të, duke përfshirë foto të fundit të tij, raporte mjekësore ose psikologjike tek i afërmi tjetër që ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

e) takimeve të fëmijës me të afërmit e tij ose me persona të tjerë, me të cilët fëmija është i lidhur emocionalisht, në një mjedis neutral për fëmijën, me ose pa mbikëqyrje, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.

7. Për të siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve personale të fëmijës me prindërit ose me persona të tjerë, me të cilët ai gëzon një jetë familjare, si dhe me qëllim kthimin e fëmijës në banesën e tij pas përfundimit të vizitës ose lejinin e fëmijës për t'u takuar me prindin tjetër, sipas vendimit të gjykatës, kjo e fundit, me kërkesë të prindit të interesuar ose të personit të ngarkuar me mirërritjen e fëmijës, mund të vendosë marrjen e këtyre masave ose garancive:

a) gjobë për vonesë ndaj personit që refuzon të zbatojë orarin e caktuar për mbajtjen e kontakteve me fëmijën;

b) garanci pasurore ndaj prindit që nuk respekton vendimin e gjykatës, kur është e mundur, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

8. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtar i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, arrestuar, burgosur, internuar, dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkak, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij.

9. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendqëndrimin e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur një gjë e tillë dëmton mirëqenien e fëmijës. Në rast të mosdhënies së informacionit, prindi ose anëtarë të tjerë të familjes kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, e cila vendos nëse mosdhënia e informacionit është e bazuar.

10. Në rast se prindërit nuk bien dakord për vendbanimin e fëmijës, gjykata vendos për vendbanimin e tij, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, si dhe mban në konsideratë:

a) vullnetin e secilit prind për të përfshirë prindin tjetër në vendime që lidhen me fëmijën dhe të mbikëqyrë të drejtat prindërore të tjetrit;

b) historikun e marrëdhënieve ndërmjet fëmijës dhe secilit prind, duke përfshirë masën dhe mënyrën se si i kanë plotësuar detyrimet prindërore secili prej tyre kundrejt fëmijës;

c) vullnetin e secilit prind për të lejuar tjetrin të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

ç) statusin e banesës të secilit prind në 3 vitet e fundit;

d) historikun e veprimeve të dhunshme ndaj fëmijës ose ndaj personave të tjerë;

dh) distancën ndërmjet banesës së secilit prind dhe institucioneve të edukimit që ndjek fëmija;

e) mendimin e fëmijës;

ë) vendbanimin e motrave dhe vëllezërve të fëmijës.

11. Këto aspekte mbahen parasysh edhe në rastet kur vendbanimi i fëmijës caktohet pranë institucioneve të tjera të rritjes dhe edukimit ose në rast të mbrojtjes që i ofrohet fëmijës në nevojë për mbrojtje.

Neni 10

E drejta për ribashkim familjar

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të hyrë ose për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë për arsye të ribashkimit familjar me prindërit e tij. Kjo kërkesë trajtohet në një frymë pozitive, njerëzore e të shpejtë dhe refuzohet vetëm në rastin kur ka arsye për të dyshuar se hyrja ose largimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Në rast se prindërit janë migrantë të paligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe fëmija ka fituar shtetësinë shqiptare, prindërit lejohen të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë e të mos largohen nga vendi.

Neni 11

E drejta për t'u zhvendosur nga vendbanimi ose për të siguruar kthimin në vendin e origjinës

1. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, me vendim gjykate, pasi të jetë marrë mendimi ose pëlqimi i fëmijës.

2. Mendimi ose pëlqimi i fëmijës merret në konsideratë për çështje që lidhen me kthimin e tij në vendin e origjinës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Me qëllim që fëmija të shprehë mendimin e tij, atij i ofrohet informacion i plotë lidhur me situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që mund t'i ofrohen në vendin e origjinës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

3. Fëmija i pashoqëruar nga prindi ose kujdestari ka të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë pranë tyre. Kthimi në vendin e origjinës bëhet vetëm nëse është në interesin më të lartë të fëmijës, parim, i cili mbahet parasysh gjatë të gjithë procesit. Në këto raste vlerësohen aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integritimin e tij në vendin ku do të kthehet, si dhe mundësitë e tij për të ruajtur identitetin, kombësinë, emrin dhe lidhjet familjare, duke marrë parasysh mendimin ose pëlqimin e fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

4. Prindi, kujdestari i fëmijës, ose çdo person që merr dijeni për humbjen e tij, duhet të njoftojë, brenda 24 orëve, autoritetin shtetëror përgjegjës për të bërë të mundur kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës.

5. Për rastet që përfshijnë fëmijët e pashoqëruar, shërbimi diplomatik i Republikës së Shqipërisë jashtë vendit njofton ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, ndërsa, për rastet që përfshijnë fëmijët e shoqëruar vetëm nga njëri prind dhe pa pëlqimin e prindit tjetër, njoftohet Ministria e Drejtësisë. Këto organe marrin masa të menjëhershme për kthimin e fëmijës në Shqipëri, sipas rregullave të ligjit nr. 9446, datë 24.11.2005, "Për ratifikimin e Konventës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës".

6. Procedurat dhe rregullat për kthimin e riadhesimin e fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 12

Liria e shprehjes

1. Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtëpërsëdrejti ose me familjen e tij apo komunitetin, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

2. Fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të përcjellë informacione e ide të çdo lloji, në çdo formë ose me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur cenohet një interes publik, siguria kombëtare ose nderi e dinjiteti apo të drejtat e të tjerëve.

Neni 13

E drejta për t'u dëgjuar

1. Fëmijës i garantohet e drejta për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Nëse autoritetet refuzojnë të marrin mendimin e fëmijës, në çdo rast duhet dhënë vendim i arsyetuar për shkaqet e refuzimit.

2. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar respektohet nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse që lidhen me hartimin e zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

3. Fëmija, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, ka të drejtë të ankohet vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit të tij kundër vendimeve apo masave të marra nga autoritetet shtetërore lidhur me të, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kur fëmija e ushtron vetë këtë të drejtë, punonjësit e administratës së shërbimit civil ose të administratës gjyqësore kanë detyrimin t'i japin këshillimin e nevojshëm.

Neni 14

E drejta e informimit

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë ose të marrë çdo lloj informacioni në lidhje me mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e tij fizik e psikologjik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Fëmija ka akses në të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për të.

Neni 15

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Fëmijës i garantohet liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.

2. Prindi ose kujdestari i fëmijës e drejton atë në ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në zgjedhjen e një besimi fetar, pasi ka marrë në konsideratë mendimin e tij dhe pa ushtruar forcë në zgjedhjen e fëmijës, në përputhje me zhvillimin e aftësitë e tij.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

3. Nëse fëmija ndodhet në kushtet e mbrojtjes, personat që janë ligjërisht përgjegjës për të ndalohen të marrin masa të tilla, që ndikojnë në besimin fetar të fëmijës.

Neni 16

Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore

1. Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore. Ndalohet detyrimi i fëmijës për tubim në kundërshtim me vullnetin e tij.

2. Ushtrimi i kësaj lirie bëhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

3. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe çdo institucion tjetër publik apo privat mbikëqyrin nëse kjo e drejtë garantohet nga institucionet përgjegjëse, sipas këtij ligji dhe, në rast mosrespektimi, njoftojnë organet e policisë për marrjen e masave konkrete, sipas legjislacionit në fuqi, duke mbajtur në vëmendje sigurinë e fëmijës gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.

4. Mosrespektimi i detyrimit të parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

Neni 17

Liria e jetës private

1. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.

2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institucioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

3. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.

4. Pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në debate publike, si dhe në programe audiovizive bëhet vetëm me miratimin e prindit ose kujdestarit të fëmijës.

5. Fëmijët nuk mund të përdoren apo të ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike apo private për qëllime të përfitimit personal apo për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike.

6. Mosrespektimi i këtij ndalimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

7. Transmetuesit audiovizivë mbajnë përgjegjësi për rastet e mosrespektimit të lirive dhe të drejtave të fëmijës gjatë transmetimit të programeve të tyre, në përputhje me këtë ligj, si dhe me legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

8. Rastet përjashtimore nga mbrojtja e privatësisë bëhen vetëm nëse i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 18

E drejta për arsimim

1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.

2. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:

a) të mundësojnë aksesin e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;

b) të zhvillojnë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, programe edukimi për prindërit, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrin nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;

ç) të organizojnë plane mësimore të veçanta edukimi për fëmijët që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, ose pranë institucioneve joshkolllore, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;

d) të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;

dh) të marrin masa konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;

e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;

ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;

f) të ndërmarrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimimit të fëmijës që i përket grupeve ose rajoneve me mangësi të konsiderueshme edukimi ose që është në situata të vështira sociale, ekonomike ose gjendje fizike apo mendore të veçantë, ose që lidhen me aspekte të gjinisë, besimit fetar ose praktikave kulturore, ose që janë pjesë e një grupi kulturor etnik ose vijnë nga një situatë migratore;

g) të ngrenë mekanizma efikasë për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi);

gj) të parashikojnë dhe zbatojnë sanksione të përshtatshme për personelin arsimor, në rastet kur ai lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme ose ngacmimi të fëmijës në institucionet e edukimit, sipas këtij ligji.

h) të marrin masa për identifikimin e fëmijës në rrezik për të braktisur shkollën ose të atij që e ka braktisur atë, duke koordinuar veprimet me autoritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbajtjen ose kthimin e tij në shkollë.

4. Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mosregjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, pranë pushtetit vendor merr masa të menjëhershme për regjistrimin të fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës gjatë procesit të edukimit janë të ndaluara.

6. Fëmija ka të drejtë të ankohet ndaj vlerësimeve të dijeve të tij, sipas kritereve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar.

Neni 19

E drejta për pushim dhe argëtime kulturore e sportive

1. Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore, artistike e sportive, në përshtatje me moshën e tij.

2. Autoritetet publike qendrore e vendore, brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për ushtrimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët. Ato krijojnë hapësira të nevojshme, brenda mundësive, për lojërat e fëmijës. Këto masa përfshijnë:

a) miratimin e kuadrit rregullues urbanistik, si dhe të akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për të garantuar hapësira urbane të përshtatshme dhe aksesin e sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike;

b) vendosjen e standardeve të sigurisë dhe aksesimit për të gjitha mjediset çlodhëse e këndet e lojërave, me qëllim mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimet e mundshme të shëndetit;

c) krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore e dëfryese në mjediset shkolllore dhe komunitare;

ç) hartimin e kurrikulave shkolllore, të cilat krijojnë mundësi që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për lojëra, çlodhje dhe veprimtari sportive.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 20

E drejta për nivel jetese të përshtatshëm

1. Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

2. Prindi ose kujdestari kanë detyrimin dhe përgjegjësinë parësore për t'i siguruar, brenda aftësive dhe mundësive financiare që ata kanë, kushtet më të mira të jetesës, të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

3. Çdo fëmijë gëzon të drejtën e aksesit në programe për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, duke përfshirë aksesin në çerdhe, kopshte ose programe të tjera zhvillimi, si dhe të drejtën e ushqimit gjatë ndjekjes së këtyre programeve, sipas standardeve të parashikuara në akte nënligjore.

4. Organet e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet përgjegjëse në varësi të tyre marrin masat e nevojshme për të ndihmuar prindin ose kujdestarin të ushtrojë këtë të drejtë, në rast se ka nevojë për asistencë materiale ose programe mbështetëse.

Neni 21

E drejta për kujdes shëndetësor

1. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor falas dhe e standardit më të lartë, si dhe përfitimi nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet, pavarësisht nëse fëmija është i regjistruar ose jo në regjistrin e gjendjes civile ose nëse prindërit e fëmijës kanë paguar ose jo taksat.

2. Garantimi i kësaj të drejte bëhet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, e cila merr masa:

a) për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;

b) për t'u siguruar të gjithë fëmijëve kujdesin shëndetësor falas e cilësor, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;

c) për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të sigurimit, ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe të ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

c) për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;

d) për të mundësuar, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, që të gjitha grupet shoqërore dhe, në veçanti, prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi e të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gj, higjienën dhe përmirësimin e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;

dh) për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues dhe për të nxitur jetesën e shëndetshme të fëmijët, këshillimin e prindërve dhe fëmijës, edukimin dhe shërbimet në fushën e shëndetit riprodhues për prindërit dhe fëmijët, në varësi të moshës dhe aftësisë së tyre për të kuptuar;

e) për verifikimin periodik të trajtimit që i bëhet fëmijës së vendosur në institucione të kujdesit shëndetësor ose në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme, me vendim të gjykatës;

ë) për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë dhe pas ekzaminimit mjekësor të fëmijës, ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur rrezikohet shëndeti ose jeta e fëmijës, sipas nenit 67 të këtij ligji;

f) për ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor për fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim riaftësimin dhe përfshirjen sociale të tyre, si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë si të gjithë fëmijët.

3. E drejta e fëmijës për të pasur akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe të rehabilitimit, si dhe marrja e mjekimit të përshtatshëm për sëmundjen që ka garantohet nga shteti dhe shpenzimet mbulohen nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Prindërit kanë detyrimin të kërkojnë kujdes mjekësor, me qëllim që fëmija të gëzojë standardin më të lartë shëndetësor, si dhe për të parandaluar situata që mund të jenë të rrezikshme për jetën, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

5. Vizitat periodike të punonjësve të konsultores së nënës dhe fëmijës në banesën e gruas shtatzënë dhe fëmijës deri në moshën 1 vjeç janë të detyrueshme. Ato kryhen sipas paketës bazë të shërbimeve të kujdesit parësor e protokolleve standarde për këto shërbime dhe bëhen me qëllim mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës, duke përfshirë këshillimin për mirërritjen e fëmijës, parandalimin dhe shmangien e braktisjes së fëmijës, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhimin ose çdo lloj tjetër dhune ndaj fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 22

E drejta për të përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror

1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë nga shërbimi i kujdesit shoqëror, drejtpërdrejt apo nëpërmjet prindit ose kujdestarit të tij, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.

2. Në rast se prindi/prindërit ose personi/ personat që kujdesen për fëmijën nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, për shkaqe që nuk varen prej vullnetit të tyre, nevojat minimale të fëmijës për strehim, ushqim, veshmbathje dhe edukim, ofrohen nga shteti, kur kjo kërkohet prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror.

3. Çdo institucion publik ose jopublik që ushtron aktivitet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës ka detyrimin t'u japë prindërve të gjithë informacionin e nevojshëm për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës

1. Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Fëmija mbrohet edhe nga të gjitha format e migracionit të paligjshëm, sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

2. Prindërit e fëmijës ose kujdestari, në bashkëpunim me institucionet e kujdesit shëndetësor, të edukimit, strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik e emocional, si dhe integrimin social të fëmijës viktimë e dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit ose abuzimit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Subjektet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme, me qëllim integrimin e fëmijës në një jetë normale dhe duke respektuar dinjitetin e vetëvendosjen e fëmijës, në përputhje me moshën e tij.

4. Ndalohet ndëshkimi trupor ose i ndonjë forme tjetër, që sjell pasoja në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

Neni 24

Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik

1. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që:

- a) paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor;
- b) cenon edukimin;
- c) është e detyruar.

2. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës.

3. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune të detyruar brenda familjes së tij, në shkollë, institucione të rehabilitimit dhe dënimit, ose në aktivitete kulturore, artistike, sportive, modelimi ose për qëllime reklamuese, që paraqet rrezik, cenon edukimin, dëmton shëndetin ose zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

4. Ndalohet çdo praktikë, nëpërmjet së cilës fëmija detyrohet të kryejë veprime të përmendura në pikat 2 e 3, të këtij neni, pavarësisht dijenisë ose jo të prindit ose kujdestarit, si dhe pavarësisht faktit nëse është apo jo kundrejt shpërblimit.

5. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimi i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.

Neni 25

Mbrojtja nga përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope

1. Fëmija mbrohet nga:

- a) përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- b) prodhimi dhe trafiku i paligjshëm i këtyre substancave.
2. Ndalohet shitja e përzierësve ose tretësve për prodhimin ose përdorimin e substancave narkotike e psikotrope, duhanit, si dhe pijeve alkoolike të fëmijët.
3. Policia e Shtetit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, brenda kompetencave, marrin masa, me qëllim:
 - a) parandalimin e përfshirjes së fëmijës në prodhimin, shpërndarjen dhe trafikimin e substancave narkotike;
 - b) rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe të fëmijës për këtë çështje, përfshirë edhe hartimin e kurrikulave të nevojshme për këtë qëllim;
 - c) përkrahjen e fëmijës dhe familjeve të tyre nëpërmjet këshillimit;
 - d) hartimin e politikave, strategjive dhe shërbimeve që garantojnë rehabilitimin fizik, mendor dhe social të fëmijës që përdor alkool, duhan ose substanca narkotike e psikotrope.
4. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e qeverisjes vendore mbështesin fëmijën dhe familjen nëpërmjet referimit të çështjes të shërbimet e specializuara për këtë qëllim.

Neni 26

Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual

Fëmija mbrohet nga trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe akteve të tjera në fuqi.

Neni 27

Mbrojtja e fëmijës nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet

1. Prindi, kujdestari ose çdo person tjetër, i cili është në kontakt me fëmijën është përgjegjës për të mbrojtur fëmijën nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet.
2. Qendrat e ofrimit të internetit, institucionet e edukimit, si dhe çdo institucion tjetër publik ose privat, i cili ofron akses në internet, aplikojnë instrumente teknike dhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe ose të dëmshme, sipas legjislationit në fuqi.
3. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, kur konstaton se në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit, në faqet e internetit apo në mjedise ku ka fëmijë, qarkullojnë materiale me përmbajtje të dëmshme për fëmijën, sipas këtij ligji dhe ligjit për sigurinë kibernetike, i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masat për bllokimin e aksesit në këto rrjete ose faqe.
4. Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Mbrojtja nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe në situata të emergjencave civile

1. Fëmija nuk lejohet të përfshihet drejtpërdrejt dhe tërthorazi në një konflikt të armatosur.
2. Në rast konflikti të armatosur ose në situata emergjence civile, fëmijës i garantohet një respekt i veçantë dhe mbrojtje nga çdo formë sulmi të paligjshëm. Gjatë konfliktit fëmijës i sigurohet kujdes e ndihmë e veçantë, në përputhje me moshën dhe për çdo arsye tjetër.
3. Nëse fëmija arrestohet ose ndalohet për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur, ai mbahet në mjedise të veçanta nga të rriturit, përveç rasteve kur është ndaluar me familjen e tij.
4. Njësia e mbrojtjes së fëmijës në çdo njësi të qeverisjes vendore, brenda 24 orëve nga nisja e një konflikti të armatosur ose emergjence civile, harton një listë me të gjithë fëmijët që ndodhen në territorin e njësive përkatëse administrative dhe ia dërgon atë Drejtorisë për Emergjencat Civile, me qëllim mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e posaçme të tyre gjatë konfliktit.
5. Në raste të evakuimit të popullsisë gjatë një konflikti të armatosur ose emergjence civile, fëmijës i jepet prioritet. Drejtoria për Emergjencat Civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës marrin masa të nevojshme për evakuimin e sigurt të fëmijës. Në çdo rast, fëmija nuk ndahet nga prindërit ose familja e tij.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 29

E drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor

1. Fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij.
2. Ndihma juridike dhe psikologjike i ofrohet fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës.
3. Ndihma juridike ndaj fëmijës përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacioni në fuqi, gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor.
4. Ndihma psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacioni në fuqi.
5. Fëmija, vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit të tij, bën kërkesë për ndihmë juridike tek institucionet përgjegjëse, të cilat informojnë fëmijën, kujdestarin ose përfaqësuesin e tij për procedurat sipas legjislacioni në fuqi.
6. Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike.

Neni 30

Ushtrimi i kujdesit prindëror

1. Prindi ose kujdestari ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale e materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.
2. Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për të ndihmuar prindin në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës. Në rast se edhe pas ndihmës së dhënë rezulton se qëndrimi i mëtejshëm i fëmijës me prindin nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, njësia e mbrojtjes së fëmijës merr masa për largimin e përkohshëm të fëmijës nga prindi dhe e vendos fëmijën në kujdes të përkohshëm alternativ, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes dhe në këtë ligj.
3. Prindërit e fëmijës, pavarësisht faktit se cili prej tyre ushtron përgjegjësinë prindërore, kanë të drejtë të marrin informacion dhe asistencën e nevojshme për mirëritjen, kujdesin dhe edukimin e fëmijës, të marrin informacion për fëmijën nga shkolla, njësitë e shërbimit shëndetësor ose çdo institucion tjetër në kontakt me fëmijën.
4. Në rast se të dy prindërit ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, por nuk bashkëjetojnë me njëri-tjetrin, vendimet lidhur me zgjedhjen e edukimit ose trajnimit profesional, trajtimet mjekësore komplekse ose ndërhyrjet kirurgjikale, vendbanimin e fëmijës ose administrimin e pasurisë së tij, merren me pëlqimin e të dy prindërve.
5. Në rast se njëri nga prindërit nuk jep pëlqimin e tij për të marrë vendim, lidhur me çështjet e parashikuara në pikën 4, të këtij neni, ose kur ai nuk mund të kontaktohet për shkak të vendndodhjes së panjohur ose për shkak të nevojës urgjente për të marrë vendim lidhur me fëmijën, vendimet merren nga prindi që jeton me fëmijën, përveç rasteve kur vendimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.
6. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet prindërve lidhur me ushtrimin e të drejtave prindërore dhe realizimin e detyrimeve të tyre ndaj fëmijës, cildo prej tyre mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente. Pasi të jenë dëgjuar të dy prindërit, si dhe të jetë marrë mendimi i fëmijës, gjykata vendos në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 31

Përkujdesja alternative

1. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis për shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative. Në zbatimin e kësaj mase i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar, sipas interesit më të lartë të fëmijës.
2. Përkujdesja alternative mund të jetë:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës;
 - b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën;
 - c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe.
3. Fëmija në nevojë për mbrojtje mund të vendoset në një nga format e mësipërme të përkujdesjes alternative për shkak të një mase mbrojtjeje, sipas nenit 55 të këtij ligji.
4. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.

Neni 32

Fëmija me aftësi të kufizuar

1. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.
2. Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për të përfutur nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që këto shërbime të ofrohen sa më pranë fëmijës dhe falas sa herë të jetë e mundur dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të prindit ose kujdestarit.
3. Prindi ose kujdestari ka detyrimin të ndjekë procedurat e detyrueshme, sipas këtij ligji, për t'i siguruar fëmijës aksesin në të gjitha shërbimet nga të cilat përfiton sipas legjislacioni në fuqi. Për këtë qëllim, prindi ose kujdestari asistohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve sipas nevojës.
4. Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t'i ofrohet shërbimi edukativ, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme nga ajo ku jeton dhe që përmbush kriteret për këtë qëllim. Shpenzimet, në këtë rast, mbulohen nga buxheti i të dyja njësive të qeverisjes vendore. Rregullat dhe procedurat për mbulimin e këtyre shpenzimeve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.
5. Autoritetet përgjegjëse, sipas këtij ligji, eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive, që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.
6. Autoritetet përgjegjëse garantojnë përshtatjen e arsyeshme rast pas rasti.
7. Autoritetet përgjegjëse garantojnë pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e politikëbërjes dhe legjislacioni përmes informacionit të përshtatur, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe aftësisë së fëmijët për të kuptuar.

Neni 33

Fëmija që i përket pakicave kombëtare

1. Fëmija që i përket një pakice etnike, fetare ose gjuhësore ka të drejtë të ushtrojë jetën e tij kulturore, të deklarojë përkatësinë e tij etnike e fetare, të ushtrojë besimin e tij fetar, si dhe të përdorë gjuhën e tij me anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilit i përket.
2. Fëmija që i përket një pakice kombëtare ka të drejtë të shprehet në gjuhën e tij amtare gjatë procedurave që lidhen me çështjet e tij.
3. Mënyrat e ushtrimit të të drejtave të parashikuara në këtë nen garantohen duke mbajtur parasysh respektimin edhe të të drejtave të fëmijëve të tjerë.

KREU III
MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Neni 34

Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

1. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.
2. Mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë janë:
 - a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në nivel qendror;
 - b) grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative në nivel vendor.
3. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror janë:
 - a) ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;
 - b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
 - c) çdo ministër përgjegjës, sipas fushës që mbulon, në lidhje me të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.
4. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë:
 - a) bashkia;
 - b) struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
 - c) njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
 - d) njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative;
 - e) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.
5. Mekanizmat dhe strukturat në nivel qendror e vendor bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacioni të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Këta mekanizma dhe struktura bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar.

Neni 35

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

1. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
2. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës.
3. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përbëhet nga 9 anëtarë, përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe 5 përfaqësues nga shoqëria civile. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh.
4. Përfaqësuesit nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës duhet të jenë shtetas shqiptarë, të cilët të kenë njohuri dhe të kenë marrë pjesë në veprimtari të shquara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Përfaqësuesit nga shoqëria civile zgjidhen nga Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile.
5. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

githë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë ndalohet.

6. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka të drejtë të ngrejë komitete teknike këshilluese për çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe të përcaktojë përbërjen e rregulloret e tyre.

7. Zgjedhja e përfaqësuesve të fëmijës dhe të shoqërisë civile realizohet sipas udhëzimeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

8. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e këtij këshilli, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Detyrat e Këshillit Kombëtar në lidhje me të drejtat e fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me të drejtat e fëmijës, ka këto detyra:

a) vlerëson gjendjen konkrete të respektimit të të drejtave të fëmijës në Shqipëri, duke marrë në konsideratë angazhimet shtetërore, në kuadër të Konventës së të Drejtave të Fëmijës dhe traktateve të tjera në fushën e të drejtave të njeriut;

b) vlerëson planifikimin e buxhetit nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve;

c) jep rekomandime të posaçme për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

c) bën propozime dhe jep rekomandime për Këshillin e Ministrave, për përmirësimin e legjislacioni në fushat përkatëse të zbatimit të të drejtave të fëmijës.

Neni 37

Detyrat e Këshillit Kombëtar në lidhje me mbrojtjen e fëmijës

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, ka këto detyra:

a) vlerëson dhe analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për mbrojtjen e fëmijës;

b) i propozon ministrit përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës programet kryesore shtetërore për mbrojtjen e fëmijës dhe drejtimin e politikave shtetërore për përmirësimin e gjendjes së trajtimit të tyre;

c) rekomandon shërbime dhe programe të orientuara për fëmijët dhe familjet e tyre;

c) rekomandon shërbime dhe programe parandaluese ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijës;

d) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacioni në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 38

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse realizon këto detyra:

1. Në lidhje me orientimin e monitorimin e politikave shtetërore dhe situatës së të drejtave të fëmijës:

a) koordinon dhe monitoron zhvillimin e zbatimin e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për fëmijët si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe përgatit raportet përkatëse;

b) kontrollon veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe miraton raportin vjetor të saj për ecurinë e realizimit të të drejtave e të mbrojtjes së fëmijës;

c) orienton mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët;

c) ofron mbështetje për organizatat jofitim-prurëse në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacinin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile;

d) bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

dh) analizon të dhënat e raporteve statistikore e të raporteve të tjera dhe koordinon me ministrat e tjerë, me qëllim që të përshtatë në mënyrë dinamike politikat e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, realizon këto detyra:

a) merr masa, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, për ngritjen dhe mirëfunksionimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase për mbrojtjen e tyre, nëpërmjet shërbimeve shumëdisiplinore, ndërsektoriale, të koordinuara, me në qendër fëmijën.

b) harton politika, programe shtetërore dhe strategji në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe shërbimeve për fëmijët, si dhe planifikon shpërndarjen e buxhetit për arritjen e tyre;

c) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës, si dhe ndërmarjen e masave të tjera për garantimin e të drejtave të tyre, kryesisht dhe në bazë të rekomandimeve të propozuara nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

ç) nxjerr udhëzime metodologjike për veprimtarinë e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore;

d) bashkërendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

dh) siguron ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, sipas këtij ligji dhe standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

e) siguron ngritjen e një sistemi për akreditimin, kontrollin e cilësisë dhe ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës;

ë) është përgjegjës për ngritjen e një regjistri elektronik kombëtar për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe merr masa për miratimin e akteve nënligjore për ta bërë të detyrueshëm përdorimin e këtij regjistri.

3. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për bashkëpunim me ministrin që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

4. Mënyra e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Detyrat e ministrave

Ministrat, brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore, nëpërmjet strukturave të tyre politikëbërëse, kanë për detyrë:

a) të sigurojnë zbatimin e plotë të këtij ligji dhe realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, të njohura nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

b) të hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore të nevojshme për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndërsektoriale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të fëmijës;

c) të shoqërojnë çdo projektligj apo projektakt normativ që hartojnë me një analizë të ndikimit të tij te fëmijët, djem dhe vajza;

ç) të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të fëmijës dhe për mbrojtjen e fëmijës;

d) të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar që punonjësit dhe strukturat në varësi të tyre, që merren me mbrojtjen e fëmijës, të përgatiten me njohuritë e duhura dhe të specializohen në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Neni 40

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është person juridik në varësi të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, financuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe burime të tjera, sipas ligjit.

2. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas legjislacioni për nëpunësin civil.

3. Struktura dhe organika e agjencisë miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

4. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen në rregulloren e agjencisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 41

Detyra e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me ngritjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës

1. Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për paranda-limin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

2. Agjencia ka për detyrë t'u ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me:

- a) koordinimin me agjenci të tjera shtetërore dhe private;
- b) zhvillimin e aktiviteteve profesionale, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës;
- c) asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si edhe supervizionin, në raste të caktuara; bashkërendim të punës për raste ndërshtetërore të mbrojtjes së fëmijës;
- ç) këshillimin e agjencive shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të punonjësve që punojnë në institucione publike e private për ndihmën e fëmijës në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, për të cilën agjencia nxjerr një urdhër të brendshëm për mënyrën e funksionimit.

3. Agjencia ka për detyrë gjithashtu:

- a) të mbledhë të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe të menaxhojë regjistrin elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- b) të analizojë nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë të parandalimit;
- c) të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes;
- ç) të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje;
- d) në zbatim të nenit 11, pika 6, e këtij ligji, të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për realizimin e procesit të mbrojtjes dhe marrjes së masave për menaxhimin e rasteve të fëmijës në situatë migrimi, në situatë ndërkufitare dhe në nevojë për mbrojtje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të fëmijës së pashoqëruar.

Neni 42

Detyrat e agjencisë në lidhje me bashkërendimin e punës me ministrin përgjegjës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës.

2. Përgatit dhe i propozon ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës udhëzime metodologjike për strukturat e mbrojtjes së fëmijës në organet e vetëqeverisjes vendore dhe koordinimin ndërsektorial në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

3. Bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

4. I paraqet ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Neni 43

Detyrat e agjencisë në lidhje me politikat dhe veprimtaritë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

European, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

2. Ndërton dhe realizon vetë apo në bashkëpunim me institucione të tjera veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit të drejtësisë.

3. Koordinon ose realizon fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete konkrete për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijës në të gjitha fushat.

4. Inicion dhe zbaton projekte pilot, në bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe u jep mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

5. Organizon dhe bashkërendon kërkime shkencore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

6. Realizon mbledhjen, analizën e të dhënave dhe raportimin e zbatimit të dokumenteve strategjike me fokus fëmijët, si dhe të situatës së të drejtave të fëmijës.

7. Zhvillon dhe mirëmban një sistem informacioni me fokus institucionet e specializuara për fëmijët, organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të dhëna të tjera, që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.

8. Bashkërendon veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera.

Neni 44

Mbështetja e agjencisë nga autoritetet shtetërore

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me agjencinë, për realizimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave të nevojshme, në kuadër të ngritjes dhe zbatimit të standardeve për një sistem funksional të integruar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të dhënave të tjera, të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

2. Llojet, mënyra e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga agjencia pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 45

Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe ata që punojnë me fëmijët

1. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, nuk mund të punësohen dhe, kur janë të punësuar, përfundojnë marrëdhënien e punës në rast se:

- a) janë dënuar me dënim të formës së prerë për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje;
- b) ndaj tyre është marrë, me vendim gjykatë, një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje.

2. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit që punojnë me fëmijët pezullohen nga detyra kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj të miturve ose kur ata akuzohen për kryerjen e një vepre penale në bashkëpunim me të mitur.

3. Kriteret për punësimin e punonjësit të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46

Roli i bashkisë

Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në varësi të tyre të strukturave përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në zbatim të standardeve dhe, nëpërmjet tyre, të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës, duke siguruar, ndërmjet të tjerash:

a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në planet e zhvillimit vendor, në programet dhe projektet, në përputhje me politikat kombëtare;

b) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës;

c) zhvillimin e programeve dhe projekteve për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës;

ç) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera vendore,

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

për situatën e të drejtave të fëmijës dhe familjeve, me qëllim hartimin e programeve që krijojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin optimal të fëmijës;

d) zbatimin e politikave kombëtare të mbrojtjes së fëmijës dhe masave të mbrojtjes, siç parashi-kohen në këtë ligj;

dh) ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës, sipas këtij ligji, duke krijuar kushtet për funksionimin e tyre, në përmbushje të funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, përfshirë edhe shpërndarjen e fondeve përkatëse, në mënyrë që strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor të funksionojnë në mënyrë efektive;

e) zbatimin e procedurës për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si dhe për ngritjen e koordinimit të sistemit të referimit, raportimit, të marrjes në mbrojtje dhe të ndjekjes së rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje nëpërmjet strukturave të saj;

ë) organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje, shërbimeve me bazë komunitare për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe shërbimeve mbështetëse për familjet e shërbime të përkujdesjes alternative për fëmijët;

f) ngritjen e programeve dhe të shërbimeve rehabilituese e riintegruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje, me një fokus të veçantë për fëmijët viktimë të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit dhe fëmijët që dyshohen apo kanë kryer vepra penale, të cilët janë nën moshën për përgjegjësi penale;

g) kontributin për ngritjen dhe menaxhimin e sistemit kombëtar të informacionit për mbrojtjen e fëmijës, brenda kompetencave të tyre;

gj) financimin e shpenzimeve për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe të Planit për Aftësim Prindëror.

Neni 47

Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki

1. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore pranë bashkisë është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ajo, nëpërmjet strukturave në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendorë të mbrojtjes dhe institucionet e tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë.

2. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore i raporton kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak për ecurinë e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

3. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore ngre grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie dhe, kur është e nevojshme, në nivel njësie administrative, si dhe koordinon e mbikëqyr punën dhe aktivitetin e tij, sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 48

Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore

1. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore është përgjegjës për:

a) marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në propozimin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe të grupit teknik ndërsektorial;

b) miratimin dhe koordinimin e veprimeve ndërsektoriale me institucionet shtetërore për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes;

c) marrjen e masave për koordinimin me njësitë përkatëse brenda bashkisë për realizimin e prokurimit të shërbimeve të nevojshme për realizimin e Planit Individual të Mbrojtjes, kur ato nuk mbulohen dot nga strukturat shtetërore;

ç) marrjen e masave për organizimin dhe planifikimin e një shërbimi mbrojtjeje emergjente 24-orësh, i cili i njoftohet edhe strukturave të Policisë së Shtetit;

d) monitorimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve për mbrojtjen e garantimin e aksesit në të drejtat e fëmijës në territorin e bashkisë;

dh) raportimin për ecurinë e veprimtarisë së njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe për situatën e fëmijës në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë.

2. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës miraton, me udhëzim, mënyrën e vendosjes, në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën, ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 49

Njësia për mbrojtjen e fëmijës

1. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

2. Punonjësit e njësive për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë drejtuesin e saj, janë punonjës për mbrojtjen e fëmijës, me formim punonjës socialë.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësive për mbrojtjen e fëmijës, përveç detyrave të parashikuara në nenin 51, të këtij ligji, është përgjegjës dhe ka për detyrë:

a) të mbështesë punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në nivel njësie administrative, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje;

b) të hedhë informacionin për fëmijët në nevojë për mbrojtje, masat e mbrojtjes dhe planet individuale të mbrojtjes në bazën e të dhënave përkatëse, të miratuar nga ministri përgjegjës që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, në nivel bashkie dhe njësie administrative;

c) të mbikëqyrë mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës në nevojë për mbrojtje në njësitë administrative të bashkive, për të cilin është marrë masë mbrojtjeje ose është hartuar Plan Individual Mbrojtjeje;

ç) të raportojë, periodikisht, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësive administrative përkatëse;

d) të identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor, punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore;

dh) të koordinojë funksionimin e grupit ndërsektorial në nivel bashkie dhe/ose njësie administrative, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe referimin e ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve për masat e mbrojtjes dhe të dhunës në familje;

e) të ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/ komunës;

ë) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë.

4. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ia dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve proceduralë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe Ministrit të Drejtësisë.

5. Njësia për mbrojtjen e fëmijës ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 50

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkisë

1. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në njësitë administrative të bashkive janë pjesë e njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijës.

2. Çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka, minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit. Në rastet kur njësia administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit, i cili ka të përcaktuar në përshkrimin e punës funksionin si punonjës për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 51

Detyrat e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë:

a) të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët;

b) të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje;

c) të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;

ç) të informojë drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës dhe t'i propozojë drejtorit të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore marrjen e masave të mbrojtjes mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të koordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;

d) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës;

dh) të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes. Profesionistët e tjerë, të përfshirë në zbatimin e masës së mbrojtjes apo të Planit Individual të Mbrojtjes, janë të detyruar ta mbajnë të informuar punonjësin e mbrojtjes së fëmijës në lidhje me progresin, sfidat dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të tyre;

e) të propozojë ndryshimin apo heqjen e masës së mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes nëse nuk ekzistojnë më kushtet, për shkak të të cilave është vendosur masa dhe plani, apo kur një gjë e tillë i shërben fëmijës dhe/ose është në interesin më të lartë të tij;

ë) të lehtësojë dhe të mbështesë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në përmbushjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes;

f) të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planet individuale të mbrojtjes së fëmijës, për të cilët ai është menaxher rasti;

g) t'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.

gj) të ndihmojë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.

Neni 52

Grupi teknik ndërsektorial

1. Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet ad-hoc, grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

2. Grupi teknik ndërsektorial thirret nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në nivel bashkie, ose nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në nivel njësie administrative.

3. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial.

4. Në takimet e grupit teknik ndërsektorial thirren të marrin pjesë:

a) anëtarët e njëjshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik;

b) prindërit apo anëtarët e familjes ose kujdestarët e fëmijës;

c) fëmija, bazuar në moshën dhe në aftësinë e tij për të kuptuar dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij.

5. Grupi teknik ndërsektorial mbështet punonjësin e mbrojtjes së fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për vlerësimin e rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

6. Funksionimi i grupit teknik ndërsektorial rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

KREU IV MASAT E MBROJTJES SË FËMIJËS

Neni 53

Mbrojtja e fëmijës

Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të përhershme nga përkujdesja e mbrojtja e prindërve ose kur, për shkak të interesit të tij më të lartë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.

Neni 54

Plani Individual i Mbrojtjes

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me njësitë e vlerësimit dhe të Referimit të Rasteve dhe grupin teknik ndërsektorial, që funksion në nivel bashkie ose pranë njësisë administrative të bashkisë, duhet të hartojë një Plan Individual Mbrojtjeje, i cili përmban edhe propozimin për masën e mbrojtjes, kur është e nevojshme.

2. Plani Individual i Mbrojtjes përmban, përveç masave të mbrojtjes, edhe ndërhyrjet e tjera të nevojshme, që realizojnë respektimin dhe lehtësojnë aksesin e fëmijës në të drejtat e tij, si dhe shërbimet shoqërore apo shërbime të tjera të nevojshme, sipas nevojave që janë identifikuar gjatë vlerësimit të rastit.

3. Plani Individual i Mbrojtjes përmban, sipas rastit, masat për hetimin dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rastet kur fëmija është në rrezik për abuzim, dhunë, neglizhim e shfrytëzim dhe ndihmën mjekësore, shërbimin psikologjik, ligjor, shoqëror apo çdo shërbim tjetër të nevojshëm rehabilitues apo riintegruues, sipas nevojave që janë identifikuar gjatë vlerësimit të rastit, si edhe aktivitete edukative, mësimore e argëtuese për fëmijën, masat për riaftësim prindëror, programet e mbështetjes dhe ndihmës për prindërit, kujdestarin dhe anëtarët e familjes së gjerë.

4. Të gjitha ndërhyrjet dhe shërbimet e parashikuara në Planin Individual të Mbrojtjes ofrohen falas.

5. Procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimi e përmbajtja e Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 55

Masat e mbrojtjes

1. Masat e mbrojtjes janë:

a) masa emergjente e mbrojtjes, e cila është një masë e përkohshme mbrojtjeje për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative;

b) masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative;

c) masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

2. Masat e mbrojtjes vendosen për fëmijën:

a) prindërit e të cilit kanë vdekur ose janë shpallur të vdekur nga gjykata, janë të panjohur, u është hequr përgjegjësia prindërore dhe janë në kushte nevojë për mbrojtje;

b) prindi ose kujdestari ligjor i të cilit është shoqëruar, ndaluar, arrestuar ose dënuar me heqje lirie dhe fëmija është në nevojë emergjente mbrojtjeje;

c) kur, në interesin e tij më të lartë, nuk mund të lihet në kujdesin prindëror, për shkak se rrezikohet integriteti i tij fizik, moral, psikologjik e emocional;

ç) i cili është abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar ose neglizhuar;

d) i cili është braktisur nga prindërit që në lindje ose është nën moshën 16 vjeç dhe askush nuk është duke u kujdesur për të;

dh) i cili ka kryer një vepër penale dhe, për shkak të moshës, nuk ka përgjegjësi penale;

e) i cili ka, dyshohet ose akuzohet ose është dënuar se ka kryer një vepër penale, është në gjendje të lirë dhe ka nevojë për mbrojtje.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 56

Masa emergjente e mbrojtjes

1. Masa emergjente e mbrojtjes për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen e tij në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje, e cila vendoset për fëmijën që ndodhet në situatat e mëposhtme:

a) kur fëmija vlerësohet të jetë në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo formë dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku fëmija qëndron nuk është e sigurt për fëmijën;

b) është braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;

c) është pa përkujdes prindëror, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situata të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

2. Gjatë kohës së vlefshmërisë së një mase emergjente mbrojtjeje, dhënë nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, apo të vendimit të gjykatës për konfirmimin e saj, prindërit nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

3. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

Neni 57

Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative

1. Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje për fëmijën pa përkujdesje prindërore dhe kur për mbrojtjen e tij është e nevojshme strehimi apo vendosja e tij në përkujdesje alternative, duke ndjekur këtë radhë:

a) pranë një të afërmi të fëmijës;

b) pranë një familjeje kujdestare;

c) në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e mësipërme.

2. Marrja e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative merr parasysh mosndarjen e motrave dhe vëllezërve.

3. Vendimi për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata për konfirmimin ose jo të saj dhe ka të njëjtat efekte si vendimi i gjyqësor për kujdestarinë.

4. Personat apo institucioni, pranë të cilit vendoset fëmija në përkujdesje alternative, ka të njëjtat detyra, përgjegjësi dhe të drejta si ato të kujdestarit, të parashikuara në Kodin e Familjes, ndërsa prindërit e fëmijës, gjatë kohës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes, nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

5. Gjatë zbatimit të kësaj mase mbrojtëse, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek me përparësi këto çështje:

a) trajtimin dhe gjendjen psiko-emocionale të fëmijës së vendosur në përkujdesje alternative;

b) ndihmën dhe krijimin e mundësive për prindërit për të mbajtur kontakte e marrëdhënie personale me fëmijët e tyre;

c) përgatitjen e dokumenteve përkatëse, të kërkuara nga gjykata në procesin gjyqësor, të konfirmimit ose jo të masës së mbrojtjes dhe të vendosjes së fëmijës në kujdestari;

ç) nevojën për ndryshimin apo heqjen e masës mbrojtëse, në varësi të progresit, kushteve dhe rrethanave të rastit.

6. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës së mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 58

Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar

1. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

2. Kjo masë vendoset edhe në rastet kur fëmija mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësitë dhe mundësitë për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, i cili dyshohet ose provohet se ka abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën dhe i cili nuk banon apo i cili, për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo një urdhri mbrojtjeje nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje.

3. Plan Individual i Mbrojtjes, i cili përmban edhe masën e mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar, hartohet në bashkëpunim me prindërit ose njërin nga prindërit. Në rast se prindërit nuk bashkëpunojnë apo nuk japin miratimin e tyre për ndjekjen e fëmijës me këtë masë mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes së fëmijës vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes.

Neni 59

Vendimarrja për masat e mbrojtjes

1. Masat e mbrojtjes, ndërhyrjet për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe shërbimet e nevojshme për fëmijën vendosen dhe zbatohen bazuar në Planin Individual të Mbrojtjes.

2. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie apo njësie administrative ose drejtori i njësisë së mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie i dërgon Planin Individual të Mbrojtjes, së bashku me propozimin për masën e mbrojtjes, drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie, i cili merr vendimin e masës së mbrojtjes brenda 24 orëve. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij. Në rastin e masave emergjente të mbrojtjes apo masave të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative vendimi ka fuqi deri në marrjen e vendimit gjyqësor përkatës. Vendimi për dhënien e masës së mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar ka fuqi deri në shfuqizimin e masës nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, bazuar në propozimin e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës, dhe nuk dërgohet për shqyrtim gjyqësor.

3. Masat e mbrojtjes për fëmijët mbi moshën 14 vjeç vendosen vetëm pasi është marrë pëlqimi i fëmijës. Në rast se fëmija nuk jep pëlqimin, atëherë marrja e masës së mbrojtjes merret nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, vendim, i cili është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi gjyqësor nga gjykata për lënien në fuqi, kur për këtë masë përkatëse parashikohet shqyrtimi gjyqësor, sipas këtij ligji.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Vendimi i gjykatës për dhënien e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi. Gjykata vlerëson si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës dhe vendosjen e tyre në kujdestari.

6. Gjykata vendos për heqjen e masës së mbrojtjes mbi bazën e kërkesës së punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, kur gjatë shqyrtimit gjyqësor verifikohet se kanë pushuar shkaqet që kanë çuar në vendosjen e saj.

7. Gjykata kompetente në lidhje me masat e mbrojtjes dhe vendosjen në kujdestari për shkak të këtij ligji është gjykata e rrethit gjyqësor.

8. Veprimtaria e punonjësve të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, në lidhje me marrjen dhe zbatimin e masave të mbrojtjes dhe planeve individuale të mbrojtjes është objekt kontrolli nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 60

Monitorimi i masave të mbrojtjes

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për monitorimin e masave të mbrojtjes së fëmijës. Ai duhet të raportojë te drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, të paktën një herë në muaj, për mbarëvajtjen, progresin e masës dhe/ose për nevojën e ndryshimit apo heqjen e saj.

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës i dërgon propozimin për heqjen e masës së mbrojtjes dhe kthimin e fëmijës në familjen e tij drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, duke e shoqëruar atë edhe me dokumentacionin përkatës, që vërteton se prindërit janë në gjendje të kujdesen për fëmijën dhe kthimi i fëmijës në familje nuk do ta ekspozojë atë në ndonjë rrezik të mundshëm për jetën dhe integritetin e tij fizik, psikologjik moral apo emocional.

3. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, nëse e miraton propozimin për heqjen e masës mbrojtëse, autorizon punonjësën për mbrojtjen e fëmijës për të paraqitur kërkesën për heqjen e masës mbrojtëse, nëse ajo është konfirmuar nga gjykata kompetente.

4. Në rast se, në kuadër të Planit Individual të Mbrojtjes, prindërit kanë qenë të detyruar të ndjekin kurse prindërimi apo të kryejnë ndonjë veprim tjetër, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës verifikon përfundimin me sukses të këtyre detyrimeve për prindërit dhe përfshin informacionin përkatës në propozimin për heqjen e masës mbrojtëse.

Neni 61

Masat për aftësim prindëror

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë ose me njësinë për vlerësimin dhe referimin e rastit në nivel njësie administrative, ka për detyrë të vlerësojë situatën familjare të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe të synojnë në çdo rast, me përparësi, realizimin e mbrojtjes së tij pranë familjes.

2. Në rastet kur për fëmijën merren masa mbrojtëse të vendosjes në përkujdesje alternative, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, kur është e mundur, harton një plan për aftësim prindëror, i cili është pjesë e Planit Individual të Mbrojtjes së fëmijës dhe synon të përgatisë prindërit për rikthimin e fëmijës në familje pas përfundimit të masës mbrojtëse.

3. Plan i për aftësim prindëror mund të përmbajë masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror, këshillim psikologjik, për menaxhimin e zemërimit, trajtim mjekësor kundër alkoolizimit apo përdorimit të substancave narkotike e psikotrope, trajtim të shëndetit mendor, si dhe ndërhyrje për mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile, në skemën e ndihmës ekonomike, në shërbimet e punësimit, pranë shërbimit shëndetësor, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, e cila do të përmirësonte situatën familjare dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.

4. Zbatimi i planit për aftësimin prindëror ndiqet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me punonjësit e njësisë së vlerësimit dhe referimit të rasteve.

KREU V

MBROJTJA E POSAÇME PËR KATEGORI TË ÇAKTUARA FËMIJËSH

Neni 62

Mbrojtja e fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës janë përgjegjëse për të verifikuar dhe trajtuar, duke ofruar mbrojtjen e nevojshme për çdo rast të identifikuar apo raportuar të fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe dhunuar. Këto struktura, në bashkëpunim me strukturat dhe autoritetet e tjera përgjegjëse vendore, duhet të realizojnë zbatimin e masave të mbrojtjes, ndërhyrjeve dhe shërbimeve të nevojshme të specializuara për të përmbushur të gjitha nevojat e fëmijës viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të tij, kanë të drejtë të kenë akses në banesën e prindit apo të personit fizik, si dhe në rezidencën e personit juridik, të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijës së identifikuar apo të raportuar si viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Kur, në bazë të rrethanave dhe fakteve është e nevojshme, strukturat e mbrojtjes së fëmijës kërkojnë mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

3. Prindi, personi ligjërishit përgjegjës, qoftë person fizik apo juridik, ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe t'u ofrojë atyre informacionin e nevojshëm për adresimin e situatës apo të rastit. Në rast se personat e mësipërm refuzojnë të bashkëpunojnë apo ndalojnë strukturat e mbrojtjes të bëjnë verifikimet e nevojshme, atëherë verifikimi bëhet forcërisht, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit. Mosbashkëpunimi ose ndalimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijës për verifikim, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

4. Në rast se strukturat e mbrojtjes së fëmijës, pas vlerësimeve të bëra, arrijnë në konkluzionin se ka arsye të qenësishme, të cilat mbështesin ekzistencën e një situatë të rrezikut të lartë/të menjëhershëm për fëmijën, atëherë ato kanë të drejtë të marrin masën emergjente të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative.

5. Në rast se nga vlerësimi i rastit të fëmijës rezulton se abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi apo dhunimi është kryer nga persona ligjërishit përgjegjës për përkujdesjen e fëmijës, si punonjës të institucioneve publike apo private të përkujdesjes, kujdestare, familje kujdestare, të afërm, tek të cilët është vendosur fëmija për shkak të një mase mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes marrin masa të menjëhershme për veçimin e fëmijës nga këta persona dhe njoftojnë menjëherë organet e policisë dhe të prokurorisë.

6. Në rastet e dhunës në familje, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, i cili shërben edhe si menaxher rasti, përveç kërkesës për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes, sipas nenit 59, të këtij ligji, mund të iniciojë procesin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes pranë gjykatës kompetente. Në këtë rast, të dyja kërkimet gjykojnë nga i njëjti gjyqtar.

7. Në çdo rast, pas vlerësimeve të mësipërmeve, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës, i cili përmban masën e mbrojtjes përkatëse, ndërhyrjet e nevojshme dhe shërbimet për të cilat ka nevojë fëmija, me qëllim trajtimin e tij në aspektin shëndetësor e psiko-emocional, si dhe rehabilitimin e riintegrimin e tij. Po kështu, kur është i mundur qëndrimi i fëmijës pranë familjes apo kur fëmija presupozohet se do të kthehet pranë familjes, pavarësisht marrjes së masës së mbrojtjes për vendosje në përkujdesje alternative, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton dhe merr masa për zbatimin e një plani për aftësim prindëror.

8. Të dhënat në lidhje me vlerësimin, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijës së abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar, dhunuar mbahen konfidenciale, përveç rastit kur ato përdoren përpara organeve të drejtësisë.

9. Fëmija shoqërohet, në çdo rast, nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ose një psikolog i caktuar nga ky i fundit, sipas Planit Individual të Mbrojtjes, në çdo procedurë përpara organeve të policisë, të prokurorisë apo gjykatës.

10. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr masa për monitorimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes.

Neni 63

Deklarata e fëmijës

1. Gjatë procesit të verifikimit të situatës së fëmijës nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, deklarata e dhënë nga fëmija mund të administrohet ex-officio si një provë. Deklarata e fëmijës do të konsiderohet e vlefshme pavarësisht mënyrës së regjistrimit të saj, me shkrim apo me mjete audio-vizive, gjithmonë në prani të një psikologu dhe me pëlqimin e fëmijës mbi 10 vjeç.

2. Gjyqtari konsideron si provë deklaratën e dhënë nga fëmija gjatë procesit gjyqësor për vlefshmërinë dhe dhënien e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes për vendosje të fëmijës në përkujdesje alternative. Në rast se fëmija kërkon të dëgjohet, gjykata merr parasysh kërkesën e tij, e cila mund të rrëzohet veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim të motivuar.

Neni 64

Mbrojtja e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës kanë për të detyrë të identifikojnë në mënyrë aktive dhe të trajtojnë me përparësi çdo rast të raportuar të fëmijës së shfrytëzuar, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Këto struktura janë përgjegjëse dhe kanë të drejtë të ndërmarrin veprime konkrete, me mbështetjen e organeve të Policisë së Shtetit, për largimin e fëmijës nga situata e shfrytëzimit ekonomik apo situata e rrugës. Procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Pas vlerësimit të secilit rast, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin teknik ndërsektorial përfshin në Planin Individual të Mbrojtjes, por pa u kufizuar në to:

- a) marrjen e njëres nga masat e mbrojtjes së parashikuara në këtë ligj;
- b) regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe/ose ndjekjen e rregullt të programit mësimor;
- c) mbështetje mësimore, nëpërmjet mësuesve të posaçëm apo klasave të integruara;
- ç) mosfrekuentimin e vendeve të caktuara;
- d) këshillim psikologjik;
- dh) trajtim shëndetësor, nëse është i nevojshëm.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në situatën familjare të fëmijës, mund të raportojë prindërit tek organet e policisë dhe të prokurorisë ose të përcaktojë një plan për aftësimin prindëror të prindërve të fëmijës, i cili përmban, por nuk kufizohet në:

- a) ndjekjen e kurseve për aftësim prindëror;
- b) ndjekjen e kurseve kundër alkoolizmit apo programeve kundër lëndëve narkotike e psikotrope;
- c) mbështetjen për t'u regjistruar në njësinë vendore përkatëse dhe regjistrimin e gjithë anëtarëve të familjes në gjendjen civile;
- ç) ndihmën për t'u integruar në skemën e ndihmës ekonomike;
- d) ndihmën për aksesimin e tregut të punës;
- dh) çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme, e cila ndihmon në përmirësimin e situatës familjare, duke krijuar premisa për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e mbarëvajtjes së Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës, si dhe për ndryshimin e tij, duke përshtatur ose hequr çdo masë apo ndërhyrje nëse situata që ka çuar në vendosjen e tyre ka ndryshuar. Në çdo rast, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës vë në dijeni drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në lidhje me zbatimin apo nevojën për ndryshimin e Planit Individual të Mbrojtjes.

Neni 65

Mbrojtja e fëmijës nën moshën për përgjegjësi penale

1. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e rastit të fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, duke angazhuar njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin shumëdisiplinor për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, i cili përmban një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndërhyrjet e shërbimet e tjera të nevojshme për riintegrimin e tij, duke marrë në konsideratë:

- a) kushtet, të cilat lehtësuan përfshirjen e fëmijës në krim;
- b) nivelin e rrezikshmërisë shoqërore dhe veprën e kryer;
- c) mjedisin, në të cilin është rritur dhe ka jetuar fëmija;
- ç) rrezikun apo mundësinë që fëmija të kryejë një vepër tjetër penale;
- d) çdo faktor tjetër, i cili mund të ndihmojë për të kuptuar situatën e fëmijës.

2. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të përhijnë në Planin Individual të Mbrojtjes edhe seanca këshillimi për prindërit e fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, të cilët nuk janë subjekt i një procedimi penal apo nuk janë dënuar penalisht për këtë gjë.

3. Veprimtaria e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 66

Masa e mbikëqyrjes së specializuar për fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale

1. Masa e mbikëqyrjes së specializuar për fëmijën që dyshohet ose ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, zbatohet duke lejuar qëndrimin e fëmijës pranë familjes, me kusht që të mbikëqyrën aktivitetet e mëposhtme:

- a) shkuarja në shkollë në mënyrë të rregullt;
- b) pjesëmarrja në aktivitete të shërbimeve parashoqërore;
- c) ndjekja e një trajtimi mjekësor apo këshillimi psikologjik;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) ndalimet për të shkuar apo frekuentuar vende të caktuara.

2. Në rast se është e pamundur që fëmija të lihet pranë familjes ose kur fëmija nuk përmbush kushtet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes, strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të propozojnë dhe të vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes, përfshirë edhe vendosjen e fëmijës te një nga të afërmit dhe duke i kërkuar fëmijës, në çdo rast, të respektojë kushtet e vendosura në Planin Individual të Mbrojtjes.

KREU VI

RAPORTIMI I RASTEVE TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

Neni 67

Detyrimi për raportim

1. Çdo person fizik ose juridik që ka informacion, ose vetë fëmija, duhet të njoftojë për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës institucionet qendrore dhe strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës ose Policinë e Shtetit.

2. Çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

3. Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportimin te strukturat për mbrojtjen e fëmijës.

4. Punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private, kanë për detyrë të raportojnë menjëherë te drejtori i institucionit, organet e Policisë së Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes, neglizhimit apo dhunës te fëmijët.

5. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha institucionet publike apo private të përkujdesjes së fëmijës, të arsimit e të shëndetësisë, për të lehtësuar raportimin.

6. Të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim, sipas këtij ligji, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të minis-trave përkatës.

Neni 68

Linja e telefonit për fëmijë

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse, vendos në dispozicion një linjë telefoni pa pagesë, me numër të publikuar gjerësisht, e cila është e detyruar të verifikojë dhe të referojë pranë njësive për mbrojtjen e fëmijës apo strukturave të tjera kompetente çdo rast të raportuar.

KREU VII

SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 69

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 32 e 33, të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

- a) personi fizik, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;
- b) personi juridik, nga 60 000 deri në 100 000 lekë;

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen, nga 40 000 deri në 80 000 lekë;

ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 60 000 deri në 80 000 lekë.

2. Çdo mospërmbushje e detyrimeve ligjore nga strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës konsiderohet kundërvajtje administrative, sipas neneve 38, 39, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 57, 59, 60, 62, 64, 65, 66 e 67 të këtij ligji.

3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organi, i cili konstaton kundërvajtjen administrative, vendos dhe ekzekuton sanksionet administrative.

4. Vendimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është titull ekzekutiv. Procedura për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimin e gjobave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundër-vajtjet administrative.

5. Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 70

Ankimi

Kundër vendimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas nenit 69, të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 71

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 6; 27, pika 4; 34, pikat 5 e 6; 35, pika 8; 38, pika 4; 40, pika 4; 44, pika 2; 45, pika 3; 52, pika 6; 54, pika 5; 64, pika 1; 65, pika 3; dhe 69, pika 5, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 40, pika 3, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministrat përgjegjës që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim neneve 8, pika 9; 32, pika 4; 48, pika 2; 49, pika 4; dhe 67, pika 7, të këtij ligji.

Neni 72

Shfuqizime

Ligji nr. 10 347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 73

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.2.2017

Shpallur me dekretin nr. 10060, datë 6.3.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM
Nr.399, datë 1.6.2011

**PËR PËRBËRJEN DHE RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË
MIRATIMIT TË AGJENCIVE NDËRMJETËSUESE TË HUAJA ¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 081 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 2 të nenit 33 të ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ngritjen e Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, me qëllim njohjen dhe miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit (më poshtë Komisioni).

2. Komisioni funksionon si organ kolegjal, vendimmarrës, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

II. PËRBËRJA E KOMISIONIT

1. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve tre janë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë (zëvendësministër, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit, përgjegjës i strukturës që mbulon çështjet për të mitur), dhe dy janë përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Birësimeve.

2. Komisioni, përmes votimit nga anëtarët e tij, zgjedh kryetarin dhe sekretarin.

III. RREGULLAT PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT

1. Komisioni mblidhet, me kërkesë të kryetarit, sa herë informohet nga sekretari, për paraqitjen pranë Ministrisë së Drejtësisë të, maksimumi, 5 (pesë) kërkesave të reja nga agjencitë ndërmjetësuese të huaja, për njohje dhe miratim, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së tyre në fushën e birësimit. Data e mbledhjes u njoftohet anëtarëve të komisionit të paktën 2 (dy) ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj.

2. Agjencitë ndërmjetësuese të huaja paraqesin kërkesën e tyre, për njohje dhe miratim, pranë komisionit.

3. Kërkesa plotësohet sipas formularit tip, i cili miratohet nga komisioni me propozimin e kryetarit. Ajo shoqërohet me dokumentet e nevojshme, të cilat vërtetojnë përmbushjen e kriterëve të parashikuara në ligj dhe depozitohet pranë komisionit.

4. Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqiten nga agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të interesuara, janë këto:

- a) formulari tip, i plotësuar;
- b) jetëshkrimi i drejtuesit dhe i stafit të agjencisë ndërmjetësuese të huaj;
- c) dokumenti që vërteton identitetin e personit të autorizuar për të paraqitur kërkesën (pasaportë apo letërnjoftim);
- ç) kopje e noterizuar e vendimit të regjistrimit në gjykatë si person juridik në Shqipëri;
- d) formulari i plotësuar i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- dh) kopje e autorizimit, nga shteti përkatës, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit;
- e) kopje e noterizuar e statutit dhe aktit të themelimit të agjencisë ndërmjetësuese të huaj;
- ë) vërtetimi, nga organet tatimore, për shlyerjen e rregullt të detyrimeve tatimore, në përputhje me legjislationin në fuqi;

f) përshkrimi i veprimtarisë së agjencisë ndërmjetësuese të huaj;

g) dokumenti që provon pagesën e tarifës së licencimit;

gj) dokumente të tjera që vlerësohen të nevojshme nga komisioni.

5. Komisioni merr në shqyrtim kërkesat e depozituara dhe, pasi verifikon përmbushjen e kriterëve të parashikuara në ligj, merr vendim brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës.

6. Mbledhja e komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë votash. Në rast barazie votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

7. Komisioni refuzon kërkesën në rast se:

- a) kërkuesi nuk është i autorizuar për të paraqitur kërkesën;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 87*. Tiranë 2011. f. 8615.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) formulari i plotësuar nuk është i plotë apo përmban korrigjime dhe përmbajtja e tij nuk duket qartë apo është e palexueshme;

c) nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme;

ç) kërkuesi nuk përmbush kriteret e parashikuara në ligjin nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, të ndryshuar;

d) nuk është kryer pagesa e tarifës së licencimit.

8. Komisioni mund t’ia heqë licencën agjencisë ndërmjetësuese të huaj, që ushtron veprimtarinë në fushën e birësimit, në këto raste:

a) me kërkesë të agjencisë ndërmjetësuese të huaj;

b) kur vërtetohet se shteti përkatës ia ka hequr autorizimin si agjenci ndërmjetësuese e huaj në fushën e birësimit;

c) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale, të kryer me dashje;

ç) kur vërtetohet shkelja e dispozitave të ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, të ndryshuar;

d) në çdo rast tjetër, kur parashikohet shprehimisht në ligj.

9. Kundër vendimit të komisionit, agjencia ndërmjetësuese e huaj ka të drejtë të paraqesë, brenda 10 ditëve, ankim pranë Ministrisë së Drejtësisë, i cili shprehet me vendim brenda 10 ditëve nga data e marrjes së ankimit.

10. Vendimi i komisionit i përcillet strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për ta regjistruar në regjistrin e krijuar për këtë qëllim pranë kësaj ministrie dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Komisioni, në mbledhjen e parë, zgjedh kryetarin dhe sekretarin e tij.

2. Komisioni, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, merr në shqyrtim kërkesat dhe dokumentacionin shoqërues, për njohje dhe miratim, të paraqitura nga agjencitë ndërmjetësuese të huaja, për të cilat Komiteti Shqiptar i Birësimeve nuk ka vendosur ende.

3. Pranë Ministrisë së Drejtësisë, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, krijohet regjistri, me urdhër të ministrit, sipas pikës 11 kreu III të këtij vendimi, ku depozitohen gjitha të dhënat e agjencive ndërmjetësuese të huaja, të licencuara, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përcjella nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve.

4. Ministri i Drejtësisë, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, cakton personin e autorizuar përgjegjës për të pasur akses në sistem dhe për të publikuar të dhënat e nevojshme për licencat sipas këtij vendimi, në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Komiteti Shqiptar i Birësimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

UDHËZIM

Nr. 793/6, datë 26.3.2013

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR NJOHJE DHE MIRATIM TË AGJENCIVE NDËRMJETËSUESE TË HUAJA¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, të ndryshuar, paragrafit 2 të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 399, datë 1.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja”, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 51*. Tiranë 2013. f. 2263.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

UDHËZONË:

1. Tarifat për veprimet dhe shërbimet që kryen Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, për njohjen dhe miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja, caktohet në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
 2. Për vjeljen e tarifave për veprimet dhe shërbimet për njohjen dhe miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja, ngarkohet nga Ministria e Drejtësisë.
 3. Tarifa për njohjen dhe miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës. Kërkesa duhet të shoqërohet edhe me dokumentin bankar që vërteton pagesën.
 4. Tarifa e paguar nuk kthehet kur agjencisë ndërmjetësuese të huaj i refuzohet kërkesa për njohje dhe miratim.
 5. Mbi tarifën për veprimet dhe shërbimet që kryen Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, për miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja, nuk aplikohet TVSH.
 6. Tarifat e arkëtuara derdhen në llogarinë e të ardhurave përkatëse të thesarit të Ministrisë së Drejtësisë dhe kalojnë 100 % (një qind për qind) në Buxhetin e Shtetit.
 7. Ngarkohet Komisioni i Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, si dhe strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM Nr. 54, datë 31.1.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 35, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Vendimi nr. 201, datë 16.3.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore së funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ministri i Shtetit për Diasporën, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shoqata për Autonomi Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 134*. Tiranë 2013. f. 5897.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ushtron veprimtarinë e tij bazuar në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e OKB-së Mbi të Drejtat e Fëmijës, marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, si dhe në parimet e parashikuara në nenet 5 e 6, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

1.2 Kjo rregullore përcakton rregullat në lidhje me funksionimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

1.3 Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi, për referencë do të përdoren përkufizimet edhe shkurtimet e mëposhtme:

- “Këshilli” - Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- “Agjencia” - Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- “Sekretariati” - Sekretariati teknik i këshillit;
- “OJF” - Organizatë jofitimprurëse;
- “Ligji” - Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- “Ministri bashkërendues” - Ministri përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

II. Emërimi i anëtarit dhe mandati i tij

2.1 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në përbërje të tij ka si anëtarë ministrat e përcaktuar nga Kryeministri, në përputhje me pikën 3, të nenit 35, të ligjit, Avokatën e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 përfaqësues nga Shoqata për Autonomi vendore dhe 5 përfaqësues të shoqërisë civile.

2.2 Mandati i anëtarëve të Këshillit përfundon:

- a) me plotësimin e afatit 4-vjeçar;
- b) me lirim nga detyra, për shkak të së cilës ishte anëtar i Këshillit sipas ligjit;
- c) në rast dorëheqjeje të përfaqësuesit të Shoqatës për Autonomi Vendore ose të shoqërisë civile. Në këtë rast njoftohet nga sekretariati teknik Shoqata për Autonomi Vendore ose Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile, të cilët marrin masa për emërimin e përfaqësuesit/ve të ri/rinj në Këshill, brenda 1 (një) muaji, duke ia komunikuar këtë ministrit bashkërendues;
- ç) në rast të mospjesëmarrjes së personit përfaqësues të Shoqatës për Autonomi Vendore dhe të shoqërisë civile në dy mbledhje të Këshillit në një vit kalendarik.

2.3 Ministri bashkërendues merr masat e nevojshme për ripërtëritjen e anëtarësisë së Këshillit, në rastin e përfundimit të mandatit të anëtarit.

III. MBLEDHJET E KËSHILLIT

3.1 Këshilli mbledhet të paktën 2 herë në vit, me qëllim realizimin e detyrave të përcaktuara në nenet 36 e 37, të ligjit.

3.2 Mbledhja e parë e Këshillit realizohet pa pjesëmarrjen e anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile. Në këtë mbledhje, Këshilli miraton udhëzimin për zgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, sipas pikës 7, të nenit 35, të ligjit.

3.3 Këshilli Kombëtar ka të drejtë të ngrejë komitete teknike këshilluese për çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të përcaktojë me udhëzim përbërjen dhe rregulloret e tyre.

3.4 Në mbledhjet e Këshillit marrin pjesë fëmijë me statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverisë së nxënësve, organizatave, forumeve, apo çdo grupimi tjetër fëmijësh. Zgjedhja e përfaqësuesve të fëmijës bëhet me udhëzim të Këshillit.

3.5 Këshilli, në një nga mbledhjet e tij, diskuton lidhur edhe me:

- a) raportin e zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020;
- b) planifikimin e aktiviteteve dhe të buxhetit për zbatimin e agjendës;
- c) financimin nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera nga donatorët.

3.6 Ministri bashkërendues është kryetar i Këshillit, i cili e kryeson dhe e drejton mbledhjen e Këshillit. Ai ka të drejtë të mbledhë Këshillin:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

a) në çdo rast që e sheh të arsyeshme, bazuar në situata që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre;

b) kur ka nevojë për ndryshime në politika, në legjislacion, apo për koordinim ndërinstitucional;

c) në rastet e rishikimit/pranimit të raporteve të veçanta për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, të hartuara nga institucionet që janë anëtarë të Këshillit.

3.7 Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e Këshillit me një kërkesë të argumentuar me shkrim drejtuar kryetarit të Këshillit, ku propozon dhe afatin kohor për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit. Kryetari, pasi shqyrton kërkesën, merr vendimin për mbledhjen ose jo të Këshillit dhe njofton anëtarin që ka kërkuar mbledhjen e Këshillit.

3.8 Kryetari i Këshillit miraton rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit, e cila u dërgohet 15 ditë më parë anëtarëve, përfaqësuesve të Këshillit. Ndryshimi i kohës dhe i vendit të mbledhjes së Këshillit iu njoftohet anëtarëve, jo më vonë se 5 ditë përpara mbledhjes.

3.9 Struktura politikëbërëse në ministrinë bashkërenduese për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe secili anëtar i Këshillit, i propozon ministrit bashkërendues përfshirjen e një çështjeje në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit, të paktën 7 ditë dhe jo më vonë se 2 ditë për çështjet urgjente, përpara datës së mbledhjes. Anëtar i bashkëlidh propozimit të tij edhe argumentimin shpjegues për nevojën e diskutimit të çështjes, si dhe dokumentet mbështetëse, nëse ka.

Mbledhja e Këshillit mbahet kur janë prezentë të paktën 2/3 e anëtarëve. Nëse në mbledhjet e Këshillit nuk janë prezentë 2/3 e anëtarëve, mbledhja nuk zhvillohet dhe kryetari vendos të thërrasë mbledhjen brenda 10 ditëve.

3.10 Propozimet dhe rekomandimet votohen në formë të hapur dhe miratohen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve prezent në mbledhje. Vota e kryetarit të Këshillit është vendimtare, nëse rezultati i votimit është i barabartë.

3.11 Anëtarët e Këshillit marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit duke ushtruar detyrën e tyre funksionale pa pagesë/shpërblim.

3.12 Kryetari i Këshillit ka të drejtë t'u tërheqë vëmendjen anëtarëve për ruajtjen e etikës, kur krijohen situata të cilat pengojnë vijueshmërinë e mbledhjes së Këshillit. Në rastet kur bëhet e pamundur zhvillimi i mbledhjes, Kryetari vendos për mbylljen e saj.

IV. SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT

4.1 Sekretariati i Këshillit përbëhet nga 1 (një) nëpunës që mbulon çështjet e fëmijëve në strukturën përkatëse politikëbërëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 2 (dy) nëpunës nga agjencia.

Sekretariati mbështet funksionimin dhe realizimin e detyrave të Këshillit për:

a) organizimin e mbledhjeve;

b) dërgimin e rendit të ditës, së bashku me dokumentet mbështetëse tek anëtarët dhe vëzhguesit;

c) përfshirjen e çështjeve të propozuara nga anëtarët në rendin e ditës së mbledhjes së radhës të Këshillit;

ç) njoftimin e anëtarit propozues, nëse nuk përfshin një çështje në rendin e ditës, së bashku me argumentimin përkatës;

d) përfshirjen në rendin e ditës të çështjeve urgjente të propozuara nga anëtarët dhe bën shpjegimin përkatës për këto çështje në fillim të mbledhjes;

dh) mbajtjen e procesverbalit - dokumentimin e diskutimeve, votimeve, rekomandimeve dhe propozimeve të Këshillit gjatë mbledhjeve. Procesverbalet e mbledhjeve dhe vendimet për rekomandime e propozime firmosen nga kryetari i Këshillit;

e) mbajtjen e regjistrit të mandateve të anëtarëve;

ë) përgatitjen, koordinimin e hartimit të dokumenteve me institucionet dhe strukturat përgjegjëse për çështjet që do të diskutohen në rendin e ditës;

f) garantimin e pjesëmarrjes së fëmijëve, sipas udhëzimit të Këshillit, bazuar në pikën 7, të nenit 35, të ligjit;

g) raportimin e progresit, të rezultateve apo të produkteve të punës së Komitetit Teknik të Përhershëm për çështje të caktuara;

gj) raportimin e statusit të zbatimit të propozimeve dhe të rekomandimeve të marra nga Këshilli në mbledhjet paraardhëse.

4.2 Sekretariati teknik dokumenton në një regjistër të posaçëm emërimin, zëvendësimin, kohën e mandatit të secilit anëtar dhe pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Këshillit. Sekretariati i informon anëtarët e Këshillit 6 muaj përpara përfundimit të mandatit.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

V. NDJEKJA DHE ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE PROPOZIMEVE TË KËSHILLIT

5.1 Ministri bashkërendues, me ndihmën e strukturës së politikëbërjes në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe agjenci, merr masa për monitorimin, ndjekjen apo/dhe zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, në periudhën mes dy mbledhjeve të Këshillit.

5.2 Ministri bashkërendues ose agjencia, me delegimin e ministrit bashkërendues, raportojnë në mbledhjen e radhës së Këshillit për ecurinë, progresin, sfidat e hasura apo nevojën për ndryshim në lidhje me progresin e zbatimit të rekomandimeve apo të propozimeve të bëra nga Këshilli në mbledhjen paraardhëse.

VENDIM

Nr. 91, datë 14.2.2018

PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT DHE VENDOSJES SË SANKSIONEVE NGA AGJENCIA SHETËTËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 69, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrolli i shkeljes të të drejtave të fëmijës, mospërbushja e detyrimeve ligjore nga strukturat përkatëse të mbrojtjes së fëmijës dhe vendosja e sanksioneve organizohen dhe kryhen nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në bazë të procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës fillon procedurën e kryerjes së kontrollit për raste të ndodhura, kur janë në dijeni apo kanë dyshime të argumentuara të shkeljes të të drejtave të fëmijës dhe të mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga strukturat përkatëse, në bazë të:

a) ankesës apo kërkesës së fëmijës së interesuar, prindit, kujdestarit ligjor, përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit procedural të fëmijës;

b) çdo ankese, kërkesë të ardhur apo të paraqitur, në mënyrë anonime ose jo, nga çdo person fizik apo juridik, publik apo privat.

3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka të drejtë të fillojë procedurën e kryerjes së kontrollit me nismën e vet, në rastet kur:

a) ka informacion, konstaton ose ka një dyshim të argumentuar se ka ndodhur një shkelje e të drejtave të fëmijës;

b) konstaton moszbatim të detyrimeve ligjore nga strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës gjatë kontrolleve për monitorimin e zbatimit të ligjit;

c) bëhen raste publike në organet e medias apo të shtypit.

4. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me vënien në dijeni ose me marrjen e informacionit të ardhur, nis menjëherë procesin e verifikimit dhe të kontrollit.

5. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës bashkëpunon me strukturat përkatëse shtetërore, organet e medias e të shtypit dhe, brenda kuadrit ligjor përkatës, me strukturat e policisë dhe të prokurorisë, për mbledhjen e informacionit dhe kryerjen e kontrollit.

6. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në rastet e parashikuara në pikat 2 e 3, të këtij vendimi, edhe kur provat apo argumentet paraqiten me gojë, mban një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe dy punonjës të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

7. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës miraton dhe publikon në faqen e saj zyrtare elektronike formularin “tip” të ankesës/kërkesës. Agjencia ose një nga strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës asiston subjektet në plotësimin e formularit.

8. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka të drejtë të refuzojë kërkesën/ankesën dhe fillimin e procedurës së kontrollit në rastet kur:

a) e njëjta çështje është në shqyrtim nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 22. Tiranë 2018. f. 1392.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) informacioni është i pabazuar në prova apo në dyshime të argumentuara ose nuk është i mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;

c) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e shkeljes ose më vonë se një vit nga marrja dijeni për këtë fakt.

9. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës garanton interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha procedurat e ndërmarra dhe ka për detyrë mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës, sipas legjislacionit në fuqi.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës respekton të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe merr pëlqimin e fëmijës, duke vlerësuar moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës së dëmtuar, të prindit, të kujdestarit ose të përfaqësuesit ligjor të fëmijës për fillimin e procedurës, në çdo rast kur fëmijët përfshihen drejtpërdrejt, përveç rasteve kur me gjithë mungesën e pëlqimit nga fëmija dhe personat e mësipërm përligjet ndërhyrja në interesin më të lartë të fëmijës.

10. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, brenda 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së ankesës/kërkesës, njofton me shkrim subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa/kërkesa. Në rastet kur procedura administrative fillohet nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, njoftohen brenda 10 (dhjetë) ditëve të gjitha palët në proces për fillimin e veprimeve.

11. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i shqyrton ankesat, kërkesat dhe informacionet pa pagesë.

12. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës verifikon faktet në çdo rast, sipas përcaktimeve të pikave 2 e 3, të këtij vendimi. Subjektet palë, si dhe çdo person fizik, juridik, publik apo privat, institucione të administratës publike apo çdo strukturë e pushtetit vendor, të cilët kanë dijeni apo mund të ndihmojnë në procesin administrativ të shqyrtimit, kanë të drejtë të paraqesin informacione, dokumente, dëshmi apo prova të tjera në çdo fazë të kryerjes së kontrollit, deri në momentin e marrjes së vendimit.

Subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesë, ka të drejtë që gjatë procedimit administrativ të pyetet dhe të mbrojë veten e tij, përfshirë edhe të drejtën për të paraqitur prova dhe për të thirrur dëshmitarë.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kërkon paraqitjen e parashtrimeve me shkrim nga subjektet palë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit.

13. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në çdo rast të shqyrtimit të ankesës, kërkesës apo kontrollit të iniciuar nga vetë ajo, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) Kryen kontrole dhe vizita në vend, duke gëzuar të drejtën e hyrjes në çdo zyrë të administratës publike qendrore e vendore, të personave fizikë ose juridikë privatë, si dhe këqyrjen e akteve dhe/ose të dokumenteve që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim, duke respektuar kërkesat procedurale, sipas legjislacionit në fuqi;

b) Kërkon informacione, shpjegime apo çdo material që ka lidhje me çështjen nga çdo organ i administratës publike, qendrore e vendore, çdo person fizik ose juridik privat, që ka lidhje me çështjen, duke vendosur edhe afate për dërgimin e këtyre informacioneve, me përjashtim të rasteve kur informacioni, aktet dhe/ose dokumentet e kërkuara përbëjnë "sekret shtetëror" dhe/ose "sekret hetimor";

c) Merr në pyetje çdo person, që, sipas saj, është i lidhur me çështjen në shqyrtim dhe mund të thërrasë të gjithë personat pa imunitet, me përjashtim të rasteve kur informacioni, aktet dhe/ose dokumentet e kërkuara përbëjnë "sekret shtetëror" dhe/ose "sekret hetimor";

ç) Kërkon ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta;

d) Zhvillon një seancë dëgjimore me fëmijën, nëse fëmija pranon ose e kërkon një gjë të tillë vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor, duke konsideruar moshën dhe aftësinë e fëmijës për të kuptuar. Në këtë rast, fëmija pyetet, mundësisht, në prani të punonjësit të mbrojtjes së fëmijës ose të psikologut të caktuar në kuadër të menaxhimit të rastit. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nuk lejon konfrontimin e fëmijës me personin/subjektin ndaj të cilit është paraqitur ankesë;

dh) Konsideron deklaratën e dhënë nga fëmija te punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në procesin e shqyrtimit të ankimit;

e) Zhvillon një seancë dëgjimore dhe fton palët e çdo person tjetër të interesuar, përpara marrjes së vendimit përfundimtar;

ë) Ndërmjetëson marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa, duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

14. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 12, të këtij vendimi, fillon procedurën e vendosjes së sanksionit për mospërmbushje të detyrimeve ligjore në rast se subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk i paraqet parashtrimet e tij me shkrim.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

15. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dokumenton në një relacion përmbledhës, i cili nënshkruhet nga kryetari, të gjitha veprimet e kryera në kuadër të verifikimit dhe të kontrollit të çdo ankese, kërkesë apo të kontrollit të iniciuar nga vetë agjencia.

16. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dokumenton në procesverbal të gjitha veprimet e kryera në kuadër të verifikimit dhe të kontrollit të çdo ankese, kërkesë për informacion apo të kontrollit të iniciuar nga vetë ajo dhe i pasqyron ato në një relacion përmbledhës lidhur me çështjen, i cili bëhet pjesë e dosjes përkatëse, e cila arkivohet.

17. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përfundon procedurat e parashikuara në pikën 13, të këtij vendimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së ankesës, kërkesës apo informacionit.

18. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në marrjen e vendimit bazohet në:

- a) efektshmërinë e tij dhe rolin parandalues;
- b) rrethanat e kryerjes së shkeljes;
- c) faktin nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
- ç) rëndësinë e kundërvajtjes;
- d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

19. Vendimi i kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për të vendosur gjobë dhe/ose rregullime apo masa, merret ndaj:

- a) organit të administratës publike qendrore ose strukturave të pushtetit vendor;
- b) personit juridik publik ose privat;
- c) personit në funksione publike;
- ç) personit fizik, brenda personit juridik, publik ose privat.

20. Vendimi për përcaktimin e masës së gjobës nga kryetari Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës bazohet në:

- a) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën apo fëmijën e rrezikuar;
- b) rrethanat e rastit, formimin dhe edukimin e kryerësit të shkeljes;
- c) përsëritjen e shkeljes dhe nëse, sipas saj, ka pasur më shumë se një viktимë apo fëmijë të rrezikuar;
- ç) nivelin e bashkëpunimit të personit fizik, juridik, publik apo privat, institucionit të administratës publike, strukturave të pushtetit vendor, pas paraqitjes dhe gjatë shqyrtimit të ankesës.

21. Vendimi i kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përmban:

- a) identitetin e kundërvajtësit;
- b) shpjegimin e përmbledhur të fakteve dhe të provave ku mbështetet vendimi;
- c) shkeljen e kryer, duke referuar dispozitën ligjore ku mbështetet vendimi;
- ç) urdhërimin për rregullimet apo masat që duhet të ndërmerren dhe/ose për vendosjen e gjobës;
- d) cilësimin si titull ekzekutiv për masën e gjobës;
- dh) të drejtën për ankim dhe afat;
- e) organin i cili ka nxjerrë aktin.

22. Vendimi i kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës hartohet në tri kopje, nga të cilat një kopje u dërgohet subjekteve të përcaktuara në pikën 19, të këtij vendimi, ndaj të cilave është vendosur gjoba, një kopje mbahet e protokolluar në arkivin e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe një kopje i dërgohet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

23. Vendimi i kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për vendosjen e gjobës u njoftohet palëve, si dhe personit i cili ka paraqitur ankesë apo kërkesë dhe, në çdo rast, fëmijës, prindërve, kujdestarit apo përfaqësuesit të tij ligjor, brenda 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së tij.

24. Kundër vendimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

25. Të ardhurat nga gjobat, të mbledhura në zbatim të dispozitave të këtij vendimi, kalojnë në buxhetin e shtetit.

26. Vendimi nr. 264, datë 12.4.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, shfuqizohet.

27. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 148, datë 13.3 2018

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
MEKANIZMAVE KËSHILLIMORË E KOORDINUES INSTITUCIONALË, STRUKTURAVE
PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS DHE ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE, PËR REALIZIMIN E POLITIKAVE KOMBËTARE E VENDORE, SI
DHE PËR SHËRBIMET E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E FËMIJËS¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 34, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
**FUSHAT E BASHKËPUNIMIT DHE ANGAZHIMI I MEKANIZMAVE INSTITUCIONALË DHE
STRUKTURAVE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS DHE I ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE**

1. Bashkëpunimi ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe ofrimi i shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Mekanizmat institucionalë, strukturat për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës dhe organizatat jofitimprurëse bashkëpunojnë, me qëllim:

a) Hartimin, zbatimin dhe monitorimin e ligjeve, të strategjive kombëtare, planeve të veprimit, kombëtare apo vendore, programeve dhe projekteve që kanë në fokus fëmijët, realizimin dhe respektimin e të drejtave të tyre, mbrojtjen, si dhe ofrimin e shërbimeve për ta;

b) Ngritjen dhe koordinimin e shërbimeve sociale, rehabilituese, riintegruese e ligjore për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe të fëmijëve të tjerë vulnerabël, me fokus të veçantë parandalimin;

c) Gjenerimin e të dhënave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet analizave, studimeve e vrojtimeve apo kërkimeve shkencore, të kryera në nivel qendror dhe vendor, për aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës dhe kategorive të tyre;

ç) Ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor;

d) Mirëfunksionimin e mekanizmave institucionale lokale për mbrojtjen e fëmijës dhe menaxhimin efektiv të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

dh) Përfundimin e kapaciteteve të profesionistëve të strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të mekanizmave institucionalë, puna e të cilëve lidhet me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

e) Promovimin dhe realizimin e mekanizmave efektivë për pjesëmarrjen e fëmijëve në të gjitha proceset që ndikojnë në të drejtat dhe mirëqenien e tyre;

ë) Sensibilizimin e publikut, të profesionistëve dhe fëmijëve për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

3. Mekanizmat institucionalë dhe strukturat për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor, në kuadër të këtij bashkëpunimi, angazhohen:

a) Të lehtësojnë procesin e koordinimit ndërmjet organizatave jofitimprurëse me institucionet shtetërore në nivel qendror e vendor, për realizimin e projekteve dhe programeve të përbashkëta në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, me fokus të veçantë fëmijët dhe grupet vulnerabël;

b) Të orientojnë dhe të koordinojnë nismat e ndërmarra nga organizatat jofitimprurëse me iniciativë të tjera, në kuadër të zbatimit të dokumenteve strategjike kombëtare me fokus fëmijët ose të programeve të tjera;

c) Të koordinojnë dhe harmonizojnë përpjekjet institucionale dhe të organizatave jofitimprurëse në veprimtaritë dhe shërbimet e munguara ose që nuk plotësohen nga institucionet shtetërore;

ç) Të nxisin dhe të krijojnë mundësi efektive të bashkëpunimit, duke përfshirë ato për pjesëmarrjen e fëmijëve;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 37*. Tiranë 2018. f. 2332.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

d) Të zhvillojnë dhe të zbatojnë kritere e procese transparente për angazhimin dhe konsultimin me organizatat jofitimprurëse në procese të ndryshme, sipas kapaciteteve dhe mandatit të tyre;

dh) Të marrin pjesë në takime të rregullta konsultative, trajnime, konferenca dhe aktivitete të tjera të planifikuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

e) Të ndajnë informacione dhe të dhëna që disponojnë mbi situatën e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës;

ë) Të mbështesin organizatat jofitimprurëse, nëpërmjet orientimit të donatorëve vendës e ndërkombëtarë, për zbatimin në nivel vendor të objektivave të dokumenteve strategjike kombëtare me fokus fëmijët apo për plotësimin e shërbimeve, të programeve ose nevojave të tjera në përgjithësi, me qëllim ngritjen dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor;

f) Të ndërgjegjësojnë komunitetin në lidhje me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, duke organizuar takime informuese, edukuese e trajnuese në territorin e bashkisë/komunës/qarkut;

g) Të mbështesin dhe të marrin përsipër menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të referuara nga organizatat jofitimprurëse, pas identifikimit dhe vlerësimit të nevojave për shërbime, ndërhyrje apo masa mbrojtjeje;

gj) Të mbështesin, kur është e mundur, financimin e shërbimeve e të nismave të organizatave jofitimprurëse në mbështetje të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

h) Të nxisin monitorimin e pavarur të organizatave jofitimprurëse, duke respektuar dhe synuar interesin më të lartë të fëmijës.

4. Organizatat jofitimprurëse, sipas legjislacionit në fuqi në kuadër të këtij bashkëpunimi, angazhohen:

a) Të mbështesin dhe të bashkëpunojnë me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, për zbatimin e programeve dhe projekteve, duke mbështetur fëmijët apo grupet e fëmijëve në situata rreziku, dhune, abuzimi, shfrytëzimi apo neglizhimi ose rreziku të përjashtimit social, me fokus të veçantë parandalimin;

b) Të ndajnë me institucionet shtetërore në nivel vendor praktikat më të mira dhe ekspertizën e tyre në drejtim të krijimit të shërbimeve parandaluese apo reaguese të mbrojtjes së fëmijës;

c) Të marrin pjesë aktivisht në proceset e diskutimeve e të konsultimeve për standardet, politikat, legjislacionin që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve në shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, ligjore dhe shërbime të tjera;

ç) Të zbatojnë qasje që bazohen mbi të drejtat e fëmijës dhe mbi barazinë gjinore, si dhe të respektojnë standardet etike në proceset e planifikimit e zbatimit të programeve dhe projekteve të tyre;

d) Të marrin pjesë në veprimtarinë e grupeve teknike ndërsektoriale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, duke përfshirë vlerësimin, hartimin dhe zbatimin e planit individual të mbrojtjes;

dh) Të kontribuojnë në vlerësimet për nevojat sociale të komuniteteve rurale, ndërrurbane dhe urbane, duke përfshirë në vlerësim ekspertë dhe duke lehtësuar procesin e vlerësimit nëpërmjet vrojtimeve, grupeve të fokusuara apo intervistave;

e) Të ndihmojnë në ngritjen e shërbimeve komunitare alternative, të emergjencës apo shërbime të tjera të nevojshme për fëmijët vulnerabël dhe për fëmijët në nevojë për mbrojtje, si dhe në angazhimin e komuniteteve në procesin e vlerësimit të nevojave, planifikimit dhe zbatimit;

ë) Të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve e të strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor;

f) Të dokumentojnë dhe të ndajnë informacione me strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me mbështetjen e ofruar gjatë menaxhimit të rasteve;

g) Të kryejnë monitorime mbi situatën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës në vend, të realizojnë raporte dhe të bëjnë publike gjetjet, duke respektuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

KREU II

BASHKËPUNIMI NDËRMJET AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS DHE ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

5. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, përveç fushave të bashkëpunimit, të parashikuara në pikën 1, të kreut I, bashkëpunon me organizatat jofitimprurëse në fushat si:

a) Koordinimi i punës me organizatat jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, me qëllim orientimin e duhur dhe shmangien e mbivendosjeve të projekteve, programeve e burimeve financiare dhe/ose njerëzore;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- b) Zbatimi i ligjit dhe formalizimi i ndihmës së ndërsjellë për realizimin e detyrimeve ligjore të saj;
 - c) Zbatimi i modeleve dhe praktikave të reja, duke zbatuar projekte e programe të përbashkëta pilot;
 - ç) Konsultimi i iniciativave të reja, në kuadër të zbatimit të ligjit, me organizatat jofitimprurëse, që kanë ekspertizë në fusha të ndryshme të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;
 - d) Shkëmbimi i informacionit të ndërsjellë me organizatat jofitimprurëse dhe informimi i tyre, në veçanti, për përditësimin e legjislacionit që rregullon mbrojtjen e fëmijës, kapacitetet dhe shërbimet e ofruara, si dhe çdo informacion tjetër të prodhuar nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, që nuk përbën sekret.
6. Organizatat jofitimprurëse informojnë Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, për:
- a) Gjendjen e respektimit dhe të të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjes së tyre, problematikat e reja lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, bazuar në studimet apo çdolloj tjetër iniciative të ndërmarrë, duke dërguar të dhëna apo çdolloj informacioni tjetër;
 - b) Projektet, programet në fushën e të drejtave të fëmijës dhe të mbrojtjes së tij, rezultatet e arritura, hapat e ndërmarrë, kontributin, si edhe përfituesit e tyre;
 - c) Fëmijët që janë asistuar, shërbimet e ofruara, problematikat e hasura, me qëllim që Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të përditësojë informacionin në Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe të ndërmarrë nisma për të përmirësuar situatën.

KREU III FORMAT E BASHKËPUNIMIT

7. Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, mekanizmeve institucionale dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel qendror e vendor me organizatat jofitimprurëse realizohet duke synuar ndihmën dhe angazhimin e ndërsjellë, me qëllim promovimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre.

8. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel qendror e vendor krijojnë dhe mirëmbajnë instrumente, të cilat lehtësojnë bashkëpunimin e ndërsjellë, por pa u kufizuar në, si më poshtë vijon:

- a) Ngritjen e bazave të të dhënave me informacionin e organizatave jofitimprurëse në nivel kombëtar e lokal;
- b) Hartëzimin e shërbimeve të ofruara nga organizatat jofitimprurëse në nivel lokal;
- c) Listimin e organizatave jofitimprurëse, të profesionistëve apo grupeve të profesionistëve të tyre, të cilët mund të angazhohen e të kontraktohen në lidhje me trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje.

9. Mekanizmat institucionale në nivel qendror e vendor, institucionet qendrore e vendore në nivel lokal hartojnë dhe zbatojnë marrëveshje bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse në fushat e parashikuara në kreun I të këtij vendimi.

10. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, përveç formave të bashkëpunimit të parashikuara në pikën 7 të këtij vendimi, mund të bashkëpunojë me organizatat jofitimprurëse nëpërmjet:

- a) Ngritjes së grupeve teknike, me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, për çështje të caktuara, që lidhen me zbatimin e ligjit ose të dokumenteve strategjike apo çdo çështje tjetër, e cila kërkon angazhimin e ekspertëve të organizatave jofitimprurëse dhe sjelljen e praktikave më të mira nga projektet apo programet e tyre;
- b) Ngritjes së grupeve të punës të përbashkëta, me qëllim realizimin e ndërhyrjeve në situata të caktuara apo në raste të caktuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
- c) Krijimit të bordeve këshillimore, me qëllim mbështetjen e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të komiteteve teknike të tij, mekanizmeve institucionale apo strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor.

11. Vendimi nr. 263, datë 12.4.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për bashkëpunimin midis mekanizmeve institucionale dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, shfuqizohet.

12. Ngarkohen mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionale dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor, sipas pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 34, të ligjit nr. 18/2017, “Për të

Përmbledhje legjislativi për të miturit

drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe organizatat jofitimprurëse për zbatimin e këtij vendimi.

13. Ngarkohet ministri përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 149, datë 13.3.2018

PËR KRITERET, DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR EVIDENTIMIN E FAMILJES KUJDESTARE PËR FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR DHE MASËS SË FINANCIMIT PËR SHPENZIMET E FËMIJËS SË VENDOSUR NË FAMILJE KUJDESTARE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton:

a) Kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror;

b) Masën e financimit për fëmijën e vendosur në familje kujdestare.

2. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare përfshin:

a) Identifikimin e familjes kujdestare;

b) Informimin dhe trajnimin e familjes kujdestare;

c) Vlerësimin e familjes kujdestare, të fëmijës që do të vendoset në familjen kujdestare dhe të familjes së tij biologjike;

ç) Vendimmarrjen për familjen kujdestare dhe vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare;

d) Monitorimin e fëmijës dhe të familjes kujdestare gjatë periudhës që është vendosur në këtë shërbim.

3. Struktura përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare (në vijim “struktura përgjegjëse”) është:

a) Struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë ku banon fëmija;

b) Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë administrative të bashkisë, ku banon fëmija;

c) Subjekti publik ose jopublik, ofrues i shërbimeve të kujdesit shoqëror ku është vendosur përkohësisht fëmija; apo

ç) Organizatat jofitimprurëse që ushtrojnë aktivitet në fushën e shërbimeve të përkujdesjes alternative për fëmijë.

II. KRITERET, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI PËR EVIDENTIMIN E FAMILJES KUJDESTARE

4. Bashkia është përgjegjëse për evidentimin e familjeve të gatshme për të qenë familje kujdestare në territorin e bashkisë përkatëse, në zbatim të Kodit të Familjes.

5. Për t’u përcaktuar si familje e gatshme për të qenë familje kujdestare, një familje duhet të plotësojë këto kriteret:

a) Të ketë shfaqur interesin për të ofruar shërbimin e përkujdesjes alternative;

b) Anëtarët e familjes të jenë të motivuar për të qenë familje kujdestare;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 37*. Tiranë 2018. f. 2336.

Formularët bashkëlidhur vendimit gjenden në linkun:

<https://qzbz.gov.al/cli/vendim/2018/03/13/149/fd96fb93-770f-4f0c-87d0-347a46b604a0;q=149>

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) Anëtarët e familjes të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;

ç) Prindërit kujdestarë të kenë aftësi për të kryer detyrën e kujdestarit;

d) Prindërit kujdestarë dhe të gjithë anëtarët e familjes të vërtetojnë me raport mjekësor nga komisioni mjekoligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe se nuk mbartin sëmundje të transmetueshme;

dh) Të strehojnë dhe të garantojnë mjedis familjar të sigurt për fëmijën;

e) Anëtarët e familjes të mos kenë qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;

ë) Të respektojnë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve apo të gjitha gjendjet e fëmijës sipas njërës apo disa prej shkaqeve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi;

f) Prindërit kujdestarë të kenë kuptim të qartë dhe të jenë të gatshëm të zbatojnë parimin e veprimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;

g) Prindërit kujdestarë të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;

gj) Prindërit kujdestarë nuk kanë humbur, nuk u është hequr përgjegjësia prindërore ose nuk u është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;

h) Prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç;

i) Prindërit kujdestarë të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në jo më shumë se tre fëmijë.

6. Çdo familje e interesuar për të qenë familje kujdestare duhet të shprehë interesin, duke paraqitur një kërkesë pranë strukturës përgjegjëse. Kërkesa përmban informacion për familjen sipas formularit nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kërkesës i bashkëlidhet/n dokumenti/et e identifikimit të prindërve të familjes.

7. Punonjësi social i strukturës përgjegjëse (në vijim “punonjësi social përgjegjës”) bën vlerësimin paraprak të familjeve të interesuara, në bazë të kriterëve të vlerësimit të parashikuara në pikën 5, të këtij vendimi, dhe fton familjet e përzgjedhura të ndjekin seksionin e informimit mbi shërbimin e kujdestarisë.

8. Seksioni informues konsiston në dhënien e informacionit të hollësishëm për përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e familjes kujdestare.

9. Në përfundim të seksionit informues, punonjësi social përgjegjës fton familjen kujdestare të konfirmojë me shkrim interesin për të vijuar me procedurën e regjistrimit si familje kujdestare.

10. Prindërit kujdestarë të interesuar ftohen nga punonjësi social përgjegjës dhe zhvillojnë një intervistë të strukturuar sipas formularit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Intervista synon të marrë informacion të detajuar mbi kontekstin familjar, edukativ dhe social të familjes aplikuese, si dhe të kushteve e të mundësive që ka familja për të krijuar një mjedis të përshtatshëm familjar për mirërritjen e fëmijës.

11. Familjes së interesuar i kërkohet të paraqesë pranë punonjësit social përgjegjës këto dokumente plotësuese:

a) Raportin mjekoligjor, që vërteton se prindërit e familjes janë të aftë fizikisht dhe mendërisht;

b) Referencat për familjen nga 2 persona (njëri prej të cilëve duhet të jetë një përfaqësues i komunitetit në të cilin jeton familja).

12. Punonjësi social përgjegjës mbledh informacion shtesë të nevojshëm dhe siguron dokumentet e mëposhtme, nëpërmjet portalit unik *e-Albania*, mbi familjen e interesuar:

a) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010;

b) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore për anëtarët e familjes mbi 18 vjeç;

c) Të ardhurat e familjes;

ç) Pasuritë e paluajtshme të familjes;

d) Vërtetim nga strukturat e policisë, nëse ka pasur denoncime për dhunë në familje apo probleme të tjera me komunitetin;

dh) Verifikim social-ekonomik i familjes nga administratori shoqëror i njësisë administrative.

13. Dokumentet e parashikuara në pikën 12 të këtij vendimi mbledhen nga punonjësi social përgjegjës nëpërmjet paraqitjes së kërkesës në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik për llogari të personave fizikë, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Pas plotësimit të dokumentacionit, punonjësi social përgjegjës, në bashkëpunim me psikologun, kryen vlerësimin e mëtejshëm të familjes kujdestare të interesuar. Për kryerjen e vlerësimit, punonjësi social përgjegjës dhe psikologu mbështeten të të dhënat e mbledhura sipas pikave 10, 11 dhe 12 të këtij vendimi, si dhe informacionet që marrin nga:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

a) Vizitat në banesën e aplikantit për të verifikuar kushtet e jetesës së familjes kërkuese;
b) Takimet individuale dhe në grup me të gjithë anëtarët e familjes së aplikantit;
c) Intervistat e personave të paraqitur nga aplikanti, si referencë;
ç) Intervistat e specialistëve të tjerë, si: psikologë, punonjës të policisë, përfaqësues të organeve të pushtetit vendor në vendbanimin e familjes kërkuese, punëdhënësin e bashkëshortit/es, përfaqësues të institucioneve arsimore, përfaqësues të komunitetit.

15. Nëse, sipas vlerësimit, gjykohet se familja është e përshtatshme për të qenë familje kujdestare, prindërit kujdestarë të interesuar i nënshtrohen trajnimit për prindër kujdestarë, të organizuar nga struktura përgjegjëse dhe gjatë këtij procesi vlerësohen kapacitetet, aftësitë dhe shprehitë e tyre si prind kujdestar. Kryerja e trajnimit dokumentohet me një procesverbal ose me certifikatën e trajnimit.

16. Pas përfundimit të trajnimit, punonjësi social përgjegjës dhe psikologu përgatisin raportin e vlerësimit të familjes kujdestare.

17. Dokumentet e mbledhura sipas pikave 6, 7, 10, 11, 12, 14, 15 dhe 16 të këtij vendimi sistemohen nga punonjësi social përgjegjës në dosjen e familjes kujdestare të interesuar dhe dërgohen nga struktura përgjegjëse për vendim-marrje në komisionin multidisiplinar në bashkinë përkatëse.

18. Komisioni multidisiplinar mblidhet për të shqyrtuar rastin, bën vlerësimin nëse familja plotëson ose jo kushtet për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror në familje, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe merr vendimin për miratimin e familjes kujdestare brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së dosjes, sipas pikës 17 të këtij vendimi.

19. Vendimi i komisionit multidisiplinar i përcillet strukturës përgjegjëse që ka paraqitur dokumentacionin pranë saj, si dhe strukturës së shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë administrative ku banon familja kujdestare.

20. Struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki regjistron familjen në regjistrin e familjeve kujdestare që ngre dhe administron.

III. PROCEDURA E VENDOSJES SË FËMIJËS PA KUJDES PRINDËROR NË FAMILJEN KUJDESTARE

21. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, në rastet e emergjencës, vepron në mënyrë të menjëhershme, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, duke siguruar shërbim përkujdesjeje të menjëhershme.

22. Pas sigurimit të përkujdesjes së menjëhershme, sipas pikës 21 të këtij vendimi, njësia e mbrojtjes të fëmijëve i referon rastin strukturës përgjegjëse të bashkisë, ku ka vendbanimin fëmija.

23. Struktura përgjegjëse, me marrjen e referimit, sipas pikës 22, të këtij vendimi, mbledh të dhënat për fëmijën pa kujdes prindëror dhe familjen biologjike të tij. Informacioni mblidhet dhe evidentohet, sipas formularit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

24. Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit, punonjësi social përgjegjës harton raportin e vlerësimit të rastit, i cili përfshin vlerësimin e fëmijës pa kujdes prindëror dhe vlerësimin e familjes së tij biologjike dhe përmban këto informacione:

- a) Përbërësit e gjendjes civile individuale dhe familjare të fëmijës;
- b) Marrëdhëniet familjare dhe sociale të fëmijës;
- c) Gjendjen shëndetësore të fëmijës;
- ç) Nivelin e arsimimit të fëmijës;
- d) Temperamentin dhe interesat e shfaqur të fëmijës;
- dh) Nevoja të veçanta, probleme të shfaqura të fëmijës;
- e) Arsytet për të cilat fëmija duhet të vendoset në shërbim kujdestarie;
- ë) Moshën e prindërve biologjikë;
- f) Vendbanimin e prindërve biologjikë;
- g) Punësimin dhe të ardhurat financiare të prindërve biologjikë;
- gj) Nivelin e arsimimit të pjesëtarëve të familjes biologjike;
- h) Kushtet e strehimit të familjes biologjike;
- i) Gjendjen shëndetësore të anëtarëve të familjes biologjike;
- j) Gjendjen psikosociale dhe ligjore të pjesëtarëve të familjes biologjike;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

k) Deklaratën e prindit/prindërve biologjikë kur prindi/prindërit jetojnë, në të cilën shprehet aprovimi për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare, me përjashtim të rasteve kur për fëmijën është marrë një nga masat e mbrojtjes, të parashikuara në nenin 55, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

25. Punonjësi social përgjegjës plotëson dosjen e fëmijës, duke mbledhur informacion shtesë të nevojshëm dhe siguron dokumentet e mëposhtme, nëpërmjet portalit unik *e-Albania*:

- a) certifikatën personale të fëmijës me fotografi;
- b) 4 fotografi të fëmijës;
- c) certifikatën familjare të fëmijës;
- ç) raportin mjekoligjor për gjendjen shëndetësore dhe mendore të fëmijës;
- d) kopjen e fletës së fëmijës për vaksinimet e kryera;
- dh) dëftesën shkollore për fëmijën, nëse fëmija frekuenton një të tillë;
- e) vërtetimin nga institucioni i përkujdesjes shoqërore, nëse fëmija është vendosur në një të tillë.

26. Plotësimi i dosjes, përveç parashikimit në shkronjën “b”, të pikës 25, të këtij vendimi, sigurohet nëpërmjet kërkimit të dokumentacionit në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik, për llogari të personave fizikë, sipas legjislacioni në fuqi.

27. Punonjësi social përgjegjës informon fëmijën për mundësinë e vendosjes në një familje kujdestare, i merr atij mendim mbi preferencat e tij për familjen e ardhshme kujdestare. Mendimi i fëmijës merret:

- a) Në mënyrë verbale, në prani të tij, për fëmijën nga moshë 6–10 vjeç;
- b) Me shkrim, në prani të tij, për fëmijën mbi 10 vjeç.

28. Dosja e rastit, që përfshin dokumentet e mbledhura sipas pikave 23, 24, 25 dhe 27 të këtij vendimi, i dërgohet, nga struktura përgjegjëse, komisionit multidisiplinar të kujdestarisë në bashkinë që ka bërë referimin, brenda një afati 15-ditor nga momenti i referimit.

29. Komisioni multidisiplinar, brenda një jave nga paraqitja e dosjes, sipas pikës 28 të këtij vendimi, përzgjedh dhe propozon një nga familjet kujdestare nga regjistri i familjeve kujdestare, krijuar sipas pikës 20 të këtij vendimi.

30. Komisioni multidisiplinar përzgjedh familjen kujdestare, sipas pikës 29 të këtij vendimi, duke gjykuar mbi përshtatshmërinë sa më të mirë të nevojave të fëmijës me familjen që propozohet si familje kujdestare. Përshtatshmëria ndërmjet familjes kujdestare dhe fëmijës bazohet në vlerësimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës, në kontekstin familjar edukativ e social dhe vlerësimin e kushteve dhe të përshtatshmërisë së fëmijës me familjen kujdestare të ardhshme, si dhe në kriteret e mëposhtme:

- a) Për fëmijën: moshë, temperament, interesat, marrëdhëniet me fëmijët e tjerë dhe nevoja të veçanta që mund të ketë;
- b) Për familjen biologjike: moshë, temperament, profesioni/punësimi, strehimi, interesat, niveli i edukimit;
- c) Për familjen kujdestare: moshë, temperament, punësimi/profesioni, aftësitë, interesat, niveli edukativ, qëndrimet kundrejt kulturave të tjera, statusi ligjor, kompetencat profesionale, preferencat ndaj fëmijëve potencialë për shërbim kujdestarë, gatishmëria, banimi (distanca nga familja biologjike), fëmijët e tjerë të familjes.

31. Me marrjen e njoftimit nga komisioni multidisiplinar, sipas pikës 30 të këtij vendimi, struktura përgjegjëse njofton familjen kujdestare për vendimin që ka marrë për përzgjedhjen si familje kujdestare dhe kjo e fundit i paraqet deklaratën e gatishmërisë për të marrë fëmijën në përkujdesje.

32. Struktura përgjegjëse paraqet kërkesën në gjykatë, sipas nenit 264 të Kodit të Familjes.

33. Gjykata vendos, sipas dispozitave të Kodit të Familjes, për vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare.

34. Struktura përgjegjëse, që ka ndjekur procedurën përkatëse në gjykatë, depoziton një kopje të vendimit të gjykatës pranë njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ku banon familja kujdestare.

35. Me marrjen e vendimit, sipas pikës 34 të këtij vendimi, punonjësi social përgjegjës bën përgatitjen paraprake të fëmijës, që përfshin:

- a) Informimin e fëmijës (bazuar në nivelin e të kuptuarit dhe moshën);
- b) Përshtatjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare, nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta të fëmijës me familjen kujdestare, vizitave dhe takimeve, numri i të cilave përcaktohet dhe realizohet rast pas rasti dhe është i kushtëzuar nga ritmi individual i përshtatjes së çdo fëmije;
- c) Sistemimin e fëmijës në familjen kujdestare;
- ç) Hartimin e një plani individual për fëmijën;
- d) Hartimin e një plani për fuqizimin e familjes biologjike, për mundësimin e rikthimit të fëmijës.

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

IV. MONITORIMI I FËMIJËS DHE I FAMILJES KUJDESTARE

36. Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ose struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për bashkitë që nuk kanë njësi të vlerësimit dhe referimit të rastit, monitoron në vazhdimësi familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari, nëpërmjet kryerjes së vizitave të monitorimit në shtëpi apo gjatë veprimtarisë normale të familjes.

37. Vizitat e monitorimit, sipas pikës 36 të këtij vendimi, bëhen çdo 2 javë në 3 muajt e parë për familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari dhe, më pas, çdo muaj. Rezultatet e çdo vizite dokumentohen dhe përfshihen në dosjen përkatëse të fëmijës.

38. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror monitorojnë çdo 3 muaj proceset e punës së punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore dhe bëjnë monitorimin e fëmijëve të vendosur në familje kujdestare.

39. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale inspekton 2 herë në vit familjen kujdestare dhe fëmijën, për të siguruar respektimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë, si dhe për të siguruar mirëqenien e fëmijës, sipas procedurave për zbatimin e standardeve të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

40. Monitorimi nga drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe inspektimi nga inspektorati përgjegjës për shërbimet shoqërore koordinohen dhe realizohen në ditët e monitorimit të familjes nga struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror të bashkisë ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit të njësisë administrative.

41. Në rastet kur punonjësit e strukturave monitoruese apo inspektuese, informohen ose besojnë në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në situatë emergjence, procedojnë menjëherë, duke referuar rastin te njësitë e mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

V. MASA E FINANCIMIT PËR SHËRBIMIN

42. Masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet ushqimore për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj, ndërsa për shpenzimet e ushqimit të një fëmije me aftësi të kufizuara është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

43. Masa e financimit për familjen kujdestare, për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është si vijon:

- a) shpenzime për veshmbathje: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit;
- b) shpenzime për shkollimin: 5 000 (pesë mijë) lekë në vit; dhe
- c) shpenzime të tjera: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit.

44. Pagesa e familjes kujdestare bëhet një herë në muaj, pranë njësisë administrative, ku ka vendbanimin e përhershëm familja kujdestare.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

45. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale, strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe e referimit të rastit për zbatimin e këtij vendimi.

46. Vendimi nr. 89, datë 26.1.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurave të shërbimit të kujdestarisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

47. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë brenda fondeve të miratuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, planifikuar në programin buxhetor “Përkujdesja sociale”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 565, datë 29.9.2018

**PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMTARISË NDËRMJET MEKANIZMAVE
KËSHILLIMORË DHE KOORDINUES INSTITUCIONALË DHE STRUKTURAVE NË
NIVEL QENDROR E VENDOR, PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME TË DREJTAT DHE
MBROJTJEN E FËMIJËS¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, pika 5, e 38, pika 4, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton rregullat për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmeve këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

2. Procesi i bashkërendimit të veprimtarisë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bazohet në:

a) Parimin e informimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të autoriteteve dhe mekanizmeve shtetërore të çdo informacioni, studimi, të dhënë apo iniciative në fushën e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

b) Parimin e konsultimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

c) Parimin e angazhimit të çdo organi shtetëror në nivel qendror e vendor të përfshirë sipas ligjit në çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

ç) Parimin e bashkëpunimit dhe të dialogut konstruktiv.

3. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, përmes:

a) Hartimit e koordinimit të politikave, të akteve ligjore dhe nënligjore, studimeve, vlerësimeve, raportimeve, si dhe realizimit të projekteve të përbashkëta për monitorimin e raportimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

b) Hartimit të udhëzimeve përkatëse lidhur me referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mënyrat e format e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve në nivel qendror dhe strukturave në nivel rajonal ose vendor me strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor; c) Ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

4. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës bashkëpunon me bashkitë, lidhur me:

a) Ngritjen e kapaciteteve për monitorimin dhe raportimin e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor, me pjesëmarrjen e organizatave jofitimprurëse dhe të fëmijëve;

b) Organizimin e aktiviteteve dhe të trajnimeve që synojnë rritjen e kapaciteteve lidhur me zbatimin, monitorimin dhe raportimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve;

c) Hartimin, buxhetimin dhe zbatimin e planeve lokale për mbrojtjen e fëmijëve si pjesë e planeve sociale vendore;

ç) Vendosjen dhe formalizimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe organizatave jofitimprurëse me qëllim ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

d) Planifikimin, hartimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve.

5. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në bashki dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në nivel njësie administrative lidhur me:

a) Monitorimin e zbatimit të detyrave të këtyre strukturave, të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 143*. Tiranë 2018. f. 9600.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) Mbështetjen teknike lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe lehtësimin e koordinimit ndërinstitucional për zbatimin e planit individual të mbrojtjes;

c) Rritjen e kapaciteteve lidhur me zbatimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve;

ç) Mbledhjen periodike të të dhënave statistikore për mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë/njësisë administrative, të përcaktuara në aktet nënligjore, si dhe informacionit lidhur me aktivitetin e tyre, procesin, mënyrën e menaxhimit të rasteve dhe problematikave të hasura.

6. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në nivel qendror e vendor bashkë-punojnë ndërmjet tyre për:

a) Identifikimin e adresimin institucional të problematikave lidhur me shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, ligjore, kulturore, regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile, si dhe çdo problematikë tjetër lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor;

b) Referimin, raportimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

c) Funkcionimin efektiv të grupeve teknike ndërsektoriale në nivel bashkie/njësie administrative dhe përmbushjen e detyrimeve institucionale në kuadër të planit individual të mbrojtjes;

ç) Kryerjen e trajnimeve dhe programeve të përbashkëta për kualifikimin e personave përgjegjës në këto struktura për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe, në veçanti, lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të tyre, për:

i. realizimin, monitorimin e raportimin e të drejtave të fëmijëve;

ii. funksionimin në mënyrë efektive të grupit teknik ndërsektorial;

iii. zbatimin e planeve individuale të mbrojtjes së fëmijëve në nevojë për mbrojtjen dhe realizimin efektiv të mbrojtjes së fëmijëve.

d) Shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve me qëllim monitorimin dhe raportimin e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor.

7. Vendimi nr. 266, datë 12.4.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për bashkërendimin e veprim-tarisë së mekanizmave në nivel qendror e vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në nivel qendror e vendor, të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, si edhe institucionet qendrore, që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështjet e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 578, datë 3.10.2018

PËR PROCEDURAT E REFERIMIT E TË MENAXHIMIT TË RASTIT, HARTIMIN DHE PËRMBAJTJEN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES, FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZBATIMIN E TIJ, SI DHE ZBATIMIN E MASAVE TË MBROJTJES¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 54, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave të referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes, sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionale dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor, sipas pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 34, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 144*. Tiranë 2018. f. 9647.

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

PROCEDURAT E REFERIMIT E TË MENAXHIMIT TË RASTIT; HARTIMI DHE PËRMBAJTJA E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES; FINANCIMI I SHPENZIMEVE PËR ZBATIMIN E TIJ, SI DHE ZBATIMI I MASAVE TË MBROJTJES

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë rregullat dhe procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, mënyrën e hartimit dhe përmbajtjen e Planit Individual të Mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Përcaktimet e këtij vendimi janë të detyrueshme për të gjitha autoritetet shtetërore, mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionale, strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, institucionet publike apo private, organizatat jofitimprurëse dhe të gjithë personat e tjerë, të cilët kanë për detyrë funksionale, profesionale, kontraktuale apo ligjore të kryejnë referim, menaxhim, koordinim apo të ofrojnë një shërbim, në kuadër të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Neni 3

Parimet udhëheqëse në menaxhimin e rastit

Procedura për identifikimin dhe menaxhimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje, hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes bazohet në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të respektimit të nderit, dinjitetit e personalitetit të fëmijës, konfidencialitetin, promovimin e së drejtës së fëmijës për mbrojtje dhe përkujdesje, respektimin e së drejtës për t’u dëgjuar, informuar, në lirinë e shprehjes, mosdiskriminimin, partneritetin e bashkëpunimin, si dhe në respektimin e përgjegjësiave.

Neni 4

Përkufizime

Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi, për referencë do të përdoren përkufizimet dhe shkurtime të më poshtë vijnë:

1. “Agjencia”, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
2. “NJMF” Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës;
3. “PMF”, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve pranë njësisë së mbrojtjes së fëmijëve ose pranë njësisë administrative;
4. “PIM”, Plani Individual i Mbrojtjes;
5. “GTN”, Grupi Teknik Ndërsektorial;
6. “NJVRN”, Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave;
7. “Rrezik i menjëhershëm”, situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, në momentin e identifikimit nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe, nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, mund të abuzohet seksualisht, të trafikohet apo të jetë pre e keqtrajtimit të tjera, të konsideruara vepër penale, sipas Kodit Penal. Ndërhyrja, në këtë rast, duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata e rrezikut.
8. “Rrezik i lartë”, situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, për shkak të faktorëve të ndryshëm rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet në mënyrë të tillë që të vuajë nga paaftësi të përhershme ose t’i rrezikohet seriozisht mirëqenia, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

9. “Rrezik i mesëm”, situata në të cilën gjendet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë në rrezik për të pësuar dëmtime të rënda apo të ketë pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia që të dëmtohet apo të abuzohet nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë. Ndërhyrja për të mbrojtur fëmijën dhe për të ofruar shërbime është e domosdoshme.

10. “Rrezik i ulët”, situata në të cilën gjendet fëmija, i cili është relativisht i sigurt, nuk vuan nga dëmtime që kanë ardhur si rrjedhojë e abuzimit dhe ka aftësi për të mbrojtur veten. Vlerësohet se ka prezencë të faktorëve të rrezikut dhe se fëmija mund të bëhet pre e abuzimit, dhunës, neglizhimit apo shfrytëzimit nëse nuk realizohen ndërhyrje për t’i ofruar respektimin dhe aksesin në të drejta apo nëse nuk i ofrohen shërbimet, për të cilat fëmija ka nevojë.

11. “Menaxhimi i rastit”, metodologjia që siguron, hap pas hapi, ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për fëmijën në nevojë për mbrojtje dhe që synon të promovojë e të nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e tij.

12. “Plan individual i mbrojtjes”, plani me veprime të caktuara, me qëllim mbrojtjen e fëmijës dhe parandalimin e cenimit të integritetit të tij, garantimin e të drejtave, mirëqenies, shëndetit dhe zhvillimit të tij, duke mbështetur familjen e fëmijës në realizimin e këtij plani, kur kjo është në interesin me të lartë të fëmijës.

KREU II

PROCEDURAT E REFERIMIT DHE TË MENAXHIMIT TË RASTIT

Neni 5

Hapat e menaxhimit të rastit

Procesi i menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm:

1. Identifikimin;
2. Raportimin;
3. Vlerësimin fillestar;
4. Vlerësimin e plotë;
5. Hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes;
6. Zbatimin, ndjekjen dhe monitorimin e PIM-it;
7. Mbylljen e rastit.

Neni 6

Identifikimi

1. Identifikimi i një fëmijë në nevojë për mbrojtje bëhet nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, mësuesit, ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor, strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Azilin dhe Antitrafikimin, Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuesit, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, si dhe vetë fëmijët.

2. NJMF-të dhe PMF-të kanë për detyrë të kryejnë identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet planifikimit të punës në terren, verifikimit të njoftimit të marrë nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijën, si dhe verifikimit të informacionit për rastet që vijnë në dijeni nëpërmjet medias së shkruar, elektronike apo medias sociale. (Formulari i identifikimit proaktiv - aneksi nr. 1.)

Neni 7

Raportimi

1. Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.

2. Çdo mësues, ofrues i shërbimit psikosocial shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë njësisë arsimore vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

3. Raportimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje bëhet me çdo mjet komunikimi, me telefon, e-mail, me postë, në formë shkresore, duke kontaktuar punonjësën e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës.

4. Profesionistët e përmendur në pikat 1 e 2 të këtij neni, ose struktura përgjegjëse pranë institucionit/ve raportojnë menjëherë, me çdo mjet komunikimi, rastet që identifikohen si në rrezik të menjëhershëm apo të lartë, ndërsa, rastet e tjera të rrezikut, të mesëm apo të ulët, raportohen brenda 24 orëve nga identifikimi. Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje (aneksi nr. 2).

5. Formulari i plotësuar dërgohet në mënyrë elektronike apo me postë te punonjësi/njësia përgjegjëse e mbrojtjes së fëmijëve. Në formular hidhet i gjithë informacioni dhe të gjitha detajet e ditura nga personi/personat, të cilët janë në dijeni dhe kanë raportuar rastin.

6. Rasti raportohet te PMF-ja përgjegjëse për territorin ku është bërë identifikimi. Në rast se është e pamundur të kontaktohen këto struktura, njoftohet Agjencia, e cila merr masa për ndjekjen e rastit nga ana e strukturave vendore të mbrojtjes.

7. Me marrjen e raportimit, NJMF-ja/PMF-ja ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat e veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin ose jo të vlerësimit fillestar të rastit.

8. Procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzime të përbashkët të ministrave përkatës, sipas pikës 7, të nenit 67, të ligjit.

Neni 8

Vlerësimi fillestar

1. Vlerësimi fillestar është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut, bazuar në informacionin e disponueshëm nga identifikimi ose raportimi, si dhe nga informacioni që mund të merret nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën.

2. Vlerësimi fillestar kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit.

3. PMF-ja, gjatë vlerësimit fillestar, vlerëson:

a) Nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër, duke mbajtur në konsideratë sigurinë, mbrojtjen fizike, shëndetin e fëmijës dhe nevojën për masë emergjente të mbrojtjes;

b) Nevojat bazë, për sa u përket ushqimit, higjienës, strehimit dhe kujdesit shëndetësor;

c) Shërbimet e domosdoshme, me qëllim përmbushjen e nevojave të identifikuar në kushtet e emergjencës.

4. Vlerësimi fillestar bëhet nga PMF-ja/NJMF-ja në territorin ku gjendet fëmija. Pas intervistimit fillestar të fëmijës apo verifikimit të gjendjes së tij, nëse fëmija nuk është në gjendje të flasë apo të intervistohet, të dhënat e marra nga PMF-ja dokumentohen menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 orë, në vlerësimin fillestar (aneksi nr. 3).

5. Nëse pas vlerësimit fillestar rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje, atëherë PMF-ja nuk hap dosje, por e referon atë pranë institucioneve përgjegjëse për ndjekje të situatës apo ofrimin e shërbimit të nevojshëm. PMF-ja mban një regjistër të posaçëm për veprimet e kryera për këto raste.

6. Nëse pas vlerësimit fillestar PMF-ja konstaton ekzistencën e rrezikut edhe pasi i ka siguruar fëmijës shërbimet e nevojshme, për shkak të kushteve të emergjencës, ajo hap një dosje specifike (në letër dhe në format elektronik) për fëmijën.

7. Fëmijës i caktohet një numër, i cili do të jetë numri identifikues për të gjatë gjithë procesit të menaxhimit. Ky numër do të përdoret gjatë të gjitha komunikimeve, përveç rastit kur është e nevojshme të përdoret emri i fëmijës, për efekt të referimit apo ndërhyrjeve për mbrojtjen e tij.

8. Drejtuesi i NJMF-së cakton një nga PMF-të e kësaj njësie si menaxher rasti për secilin fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë përkatëse. Drejtuesi i NJMF-së, kur përcakton një PMF si menaxher rasti, merr parasysh ngarkesën e punës të secilës PMF dhe faktin nëse PMF-ja është përfshirë aktivisht në identifikimin apo kontaktin paraprak me fëmijën.

9. Në njësitë administrative ku ka vetëm një PMF, ajo shërben si menaxher rasti për të gjithë fëmijët në nevojë për mbrojtje. Në rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në nivel rreziku të lartë ose të menjëhershëm, PMF-ja e njësive administrative, në menaxhimin e këtyre rasteve, do të mbështetet nga PMF-ja e bashkisë, i cila do të caktohet nga drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 9

Vlerësimi i plotë

1. Vlerësimi i plotë kryhet për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes.

2. PMF-ja, gjatë vlerësimit të plotë, vlerëson:

a) Nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, si dhe faktorët e rrezikut;

b) Nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij/saj dhe nevojat e familjes;

c) Faktorët mbrojtës, në veçanti pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e fëmijës, të familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë;

ç) Në rastet kur për fëmijën është marrë një masë emergjente mbrojtjeje, vlerësimi përfshin edhe rezultatin e procesit të konfirmimit të masës nga gjykata, vlerësimin e kushteve të institucionit, të personit apo familjes kujdestare pranë të cilit është vendosur fëmija, në kuadër të masës.

3. Për realizimin e vlerësimit të plotë, PMF-ja duhet të kryejë, të paktën:

a) Një vizitë në shtëpinë e fëmijës dhe të dhënat/informacionin e marrë gjatë vizitës i hedh në formularin për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime (aneksi nr. 4);

b) Një intervistë me fëmijën, motrat/ vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, siç tregohet në formularin e intervistimit (aneksi nr. 5).

4. Për realizimin e vizitave në familje, në rastet kur është e nevojshme për arsye sigurie apo kur prindi nuk është bashkëpunues dhe nuk lejon vizitën apo takimin e PMF-së me fëmijën/fëmijët e tjerë të familjes, PMF-ja kërkon që gjatë kryerjes së vizitës në familje të shoqërohet nga strukturat e Policisë së Shtetit.

5. Pas mbledhjes së informacioneve për rastin, PMF-ja plotëson formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6).

6. Vlerësimi i plotë kryhet brenda 20 ditëve pune nga vlerësimi fillestar. Gjatë kësaj periudhe PMF-ja ka detyrimin të mbledhë GTN-në, në rastet kur fëmija në nevojë për mbrojtje është në nivel rreziku të mesëm dhe të lartë. Në rastet e rrezikut të ulët, PMF-ja mbledh GTN-në vetëm nëse e vlerëson të nevojshme.

7. Vlerësimi i plotë për rastet e rrezikut të menjëhershëm kryhet nga PMF-ja brenda 5 ditëve, nga miratimi i masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i sektorit të shërbimeve shoqërore në bashki. Vendimi për masën e mbrojtjes dhe vlerësimi i plotë i kalojnë për miratim gjykatës.

Neni 10

Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes

1. Pas plotësimit të formularit të vlerësimit dhe analizës së rrezikut, PMF-ja harton Projektplanin Individual të Mbrojtjes, sipas formularit të PIM-it (aneksi nr. 7).

2. Projektplanin Individual të Mbrojtjes hartohet mbi bazën e nevojave të identifikuara të rastit dhe përmban veprimet, ndërhyrjet dhe shërbimet e nevojshme për të ulur nivelin e rrezikut. PIM-i përmban:

a) Listën e nevojave të fëmijës dhe familjes;

b) Veprimet apo ndërhyrjet konkrete për aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijës;

c) Shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat;

ç) Vendimin për masën e mbrojtjes;

d) Autoritetet dhe aktorët përgjegjës;

dh) Afatet kohore;

e) Ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike.

3. PMF-ja ose drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki u dërgon anëtarëve të GTN-së formularin e PIM-it, projektin e PIM-it, formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut, së bashku me kërkesën për mbledhjen e GTN-së. Në këtë mbledhje anëtarët e GTN-së:

a) Finalizojnë vlerësimin e plotë, duke shqyrtuar e plotësuar, sipas rastit, informacionin e hedhur në formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6);

b) Shqyrtojnë projektin e PIM-it dhe bëjnë rekomandimet përkatëse për ndërhyrjet apo shërbimet e nevojshme për rastin, duke caktuar detyrat për secilin anëtar të GTN-së, me afatet përkatëse, si dhe cilat shërbime apo ndërhyrje kanë nevojë të mbulohen me shpenzime nga ana e bashkisë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

4. Brenda dy ditëve pune nga mbledhja e GTN-së, PMF-ja reflekton në formularin e vlerësimit, analizën e rrezikut dhe në PIM ndryshimet, për të cilat bien dakord anëtarët e GTN-së.

5. PMF-ja i paraqet për miratim drejtorit të strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki PIM-in, së bashku me formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6) dhe rekomandimet e GTN-së.

6. Drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki, brenda dy ditëve pune, miraton PIM-in, bazuar në propozimin e bërë nga PMF-ja e GTN-ja dhe merr masat për prokurimin e shërbimeve, shpenzimet e të cilave rezultojnë të pambuluara në PIM-in e propozuar nga PMF-ja.

Një kopje e PIM-it duhet të mbahet në dosjen individuale të fëmijës. Nëse drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki nuk e miraton PIM-in e propozuar, rasti i njoftohet Agjencisë, e cila merr masat e nevojshme, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

7. Pas miratimit nga drejtori, PMF-ja ndan zyrtarisht, me të gjithë anëtarët e GTN-së, PIM-in përfundimtar.

8. Në rastin kur ka më shumë se një fëmijë në familje, hartohet një plan individual për secilin fëmijë, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre individuale.

9. PMF-ja bën të gjitha përpjekjet për të siguruar bashkëpunimin e familjes e të fëmijës në realizimin e PIM-it dhe diskuton e u shpjegon fëmijës dhe anëtarëve të familjes përmbajtjen e PIM-it.

10. Kur fëmija është mbi 14 vjeç, PMF-ja merr, në çdo rast, miratimin e fëmijës për masat e mbrojtjes të përfshira në PIM, kur kjo nuk prek interesin më të lartë të fëmijës.

11. Punonjësit të tjerë të NJMF-së, NJVNR-së apo të ofruesve të shërbimeve shoqërore publike e private bashkëpunojnë dhe mbështesin PMF-në, nëse fëmija dhe/ose anëtarët e familjes së tij paraqesin vështirësi në të kuptuarin, shprehjen apo ndërveprimin e nevojshëm për zbatimin e PIM-it.

Neni 11

Zbatimi, monitorimi dhe rishqyrtimi i PIM-it

1. Çdo institucion, autoritet apo ofrues shërbimi i përcaktuar në PIM është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve, të veprimeve, ndërhyrjeve apo ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në PIM për fëmijën, prindërit apo anëtarët e familjes së tij.

2. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës:

a) Referon zyrtarisht, me shkresë, të shërbimet e përcaktuara në PIM, rastin kur autoriteti përgjegjës nuk ishte prezent në mbledhjen e GTN-së;

b) Kërkon informacion, sipas afateve të përcaktuara në PIM, për realizimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve e detyrave të tjera të anëtarëve të GTN-së dhe autoriteteve të tjera, të të cilat është referuar rasti;

c) Njofton drejtorin e strukturës përgjegjëse, në nivel vendor, në rastet kur koordinimi dhe ndërveprimi institucional në nivel vendor është i vështirë;

ç) Referon te Agjencia rastet kur autoritetet shtetërore nuk bashkëpunojnë e ndihmojnë në aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, me qëllim zbatimin e sanksioneve të parashikuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";

d) Kryen rishqyrtimin formal të PIM-it, jo më vonë se 6 javë pas hartimit të PIM-it të parë dhe, më pas, çdo 3 muaj, por sipas nevojave të rastit ose kërkesës së njërit prej anëtarëve të GTN-së. Rishqyrtimi mund të bëhet më shpesh;

dh) Kryen vizita të rregullta në familje ose, në kuadër të masës së mbrojtjes, pranë institucionit, kujdestarit apo te personi pranë të cilit është vendosur fëmija, me qëllimin për të vlerësuar ecurinë dhe efikasitetin e ndërhyrjeve, të masave dhe shërbimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës.

3. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës merr informacion, në lidhje me:

a) Fëmijën dhe marrëdhëniet e tij me familjen e origjinës, vëllezërit, motrat;

b) Zbatimin e veprimeve dhe të detyrave të PIM-it dhe sa efektive kanë qenë ato;

c) Rivlerësimin e nivelit të rrezikut dhe të nevojave të fëmijës dhe familjes;

ç) Hartimin e PIM-it të rishikuar.

4. PIM-i i rishikuar diskutohet në mbledhjen e radhës së GTN-së, e cila zhvillohet në të njëjtën mënyrë si mbledhja e parë. Anëtarët e GTN-së raportojnë lidhur me ofrimin e shërbimeve apo të ndërhyrjeve sipas PIM-it. PMF-ja, për rastet me rrezikshmëri të lartë, ka të drejtë të thërrasë GTN-në në takim të jashtëzakonshëm, pavarësisht takimit periodik të radhës.

5. PMF-ja përditëson të dhënat, në lidhje me rastin në formularin e shqyrtimit të progresit (aneksi nr. 8) dhe bën ndryshimet përkatëse në Planin Individual për Mbrojtjen e Fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

6. Plan Individual i Mbrojtjes së Fëmijës, i rishikuar, miratohet brenda 2 ditëve pune nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. PIM-i i rishikuar i dërgohet drejtorit, së bashku me formularin e shqyrtimit të progresit.

Neni 12

Monitorimi i PMF-i për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes

1. Drejtuesi i NJMF-së është përgjegjës për monitorimin e punës së PMF-së, në lidhje me zbatimin e PIM-it, përfshirë PMF-në pranë NJMF-së apo PMF-në pranë njësisë administrative.

2. Drejtuesi i NJMF-së, i mbështetur nga PMF-ja përgjegjëse për ecurinë e PIM-it, realizon vizita monitoruese për të verifikuar situatën e fëmijës dhe të familjes së tij, me qëllim verifikimin e progresit në zbatimin e PIM-it.

Neni 13

Bashkëpunimi në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje

1. Bashkëpunimi në menaxhimin e rastit të një fëmije në nevojë për mbrojtje kryhet kur është i nevojshëm koordinimi i veprimeve, ndërhyrjeve dhe ofrimi i shërbimeve në territorin e më shumë se një bashkie apo njësie administrative, për shkak të lëvizjes së vazhdueshme të fëmijës ose kur vendbanimi dhe vendqëndrimi i fëmijës janë të ndryshëm.

2. Nëse, gjatë procesit të vlerësimit fillestar, rezulton se fëmija apo familja e fëmijës banon në një bashki apo njësi administrative tjetër, të ndryshme nga ajo ku është identifikuar fëmija, atëherë PMF-ja, në rastet e rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, ndërmerr të gjithë hapat për ofrimin e shërbimit të emergjencës e të vendosjes së masës emergjente të mbrojtjes dhe më pas referon rastin në bashkinë apo njësinë administrative ku ka vendbanimin fëmija, duke i dërguar edhe gjithë dokumentacionin e rastit, të administruar deri në atë kohë. PMF-ja e bashkisë apo njësisë administrative ku ka vendbanimin fëmija do të shërbejë më tej si menaxher rasti për fëmijën në nevojë për mbrojtje.

3. PMF-ja/NJMF-ja bëjnë referimin e rastit të PMF-ja/NJMF-ja përkatëse, ku do të ketë vendqëndrimin fëmija kur, gjatë procesit të identifikimit, vlerësimit të plotë dhe marrjes së një mase mbrojtjeje fëmija vendoset në përkujdesje alternative në një institucion, të afërm apo person, të cilët ndodhen në një territor të ndryshëm nga ai i bashkisë apo njësisë administrative nga ajo ku është identifikuar fëmija.

Në çdo rast, së bashku me referimin e rastit, PMF-ja dërgon edhe një kopje të dokumentacionit përkatës të vlerësimit fillestar dhe të identifikimit. PMF-ja e bashkisë apo njësisë administrative ku ka vendqëndrimin fëmija do të shërbejë, më tej, si menaxher rasti për fëmijën në nevojë për mbrojtje.

4. Pas referimit të rasteve të përmendura në pikat 2 e 3, PMF-ja/NJMF-ja, e cila shërben si menaxher rasti, merr masat e duhura për vazhdimin e procesit për mbrojtjen e fëmijës, sipas këtij vendimi, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga PMF-ja/NJMF-ja referuese. Në çdo rast, PMF-ja kontakton fëmijën brenda 5 ditëve, pas referimit të rastit nga PMF-ja/NJMF-ja referuese.

5. PMF-ja/NJMF-ja referuese bashkëpunon me PMF-në/NJMF-në ku ka vendbanimin apo vendqëndrimin fëmija, në lidhje me ndjekjen e procedurave gjyqësore për konfirmimin e masës së mbrojtjes apo të vendosjes në kujdestari, si edhe për çdo informacion apo dokumentacion që kërkohet nga PMF-ja/NJMF-ja, e cila menaxhon rastin pas referimit.

6. Nëse, për arsye të ndryshme, fëmija kalon një pjesë të kohës ose kryen aktivitete të ndryshme në territorin e bashkisë apo të njësisë administrative ku është identifikuar ose në një bashki apo njësi administrative tjetër, atëherë PMF-ja/NJMF-ja e bashkisë/njësisë administrative ku ka vendbanimin apo vendqëndrimin fëmija, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, bashkëpunon me PMF-në/NJMF-në përkatëse për të realizuar një Plan Individual Mbrojtjeje të përbashkët.

Në këto raste, PMF-ja/NJMF-ja fton në mbledhjen e GTN-së edhe PMF-në/NJMF-në e bashkisë apo njësisë administrative tjetër, me qëllim koordinimin dhe ndarjen e detyrave për zbatimin e PIM-it.

Neni 14

Transferimi i rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje

1. PMF-të/NJMF-të transferojnë rastin të PMF-të/NJMF-të e një bashkie apo njësie administrative tjetër kur prezumohet se fëmija do të zhvendoset apo është zhvendosur me vendbanim apo vendqëndrim në territorin e një bashkie apo njësie administrative të ndryshme nga ajo që ka bërë identifikimin e rastit dhe

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ekzistojnë premiset që fëmija të qëndrojë në mënyrë të përhershme apo për një kohë relativisht të gjatë në të. Në këto raste PMF-ja/NJMF-ja referuese dërgon kopje të dosjes së fëmijës te PMF-ja/NJMF-ja pritëse dhe e konsideron rastin të mbyllur.

2. Në çdo rast, nëse fëmija kthehet përsëri në bashkinë apo njësinë administrative të mëparshme, atëherë PMF-ja/NJMF-ja pritëse referon rastin sërish për transferim ose kërkon bashkëpunim në menaxhim në bashkinë/njësinë administrative ku ndodhet fëmija, duke përcjellë edhe dosjen e dokumentacionin e administruar për fëmijën.

Neni 15

Mbyllja e rastit

1. PMF-ja raporton te GTN-ja për mbylljen e rastit nëse, pas rishqyrtimit të PIM-it, rezulton se:

a) Veprimet, ndërhyrjet e ndërmarra dhe shërbimet e ofruara sipas planit janë kryer, fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera për fëmijën;

b) Individët kanë mbushur moshën 18 vjeç. Nëse PMF-ja vlerëson se fëmija, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç, ka ende nevojë për shërbime, rasti do të referohet për marrjen e shërbimeve të përshtatshme të strukturat që mbulojnë shërbime për këtë grup-moshë dhe në përputhje me nevojat e individit;

c) Fëmija vdes;

ç) Fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim dhe dosja e tij është transferuar.

2. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki miraton mbylljen e rasteve të mësipërme, bazuar në rekomandimin përkatës të PMF-së.

3. PMF-ja, në çdo rast, plotëson formularin për mbylljen e rastit (aneksi nr. 9), i cili bëhet pjesë e dosjes individuale të rastit.

Neni 16

Mbajtja dhe raportimi i të dhënave

1. Të gjitha të dhënat, informacioni, veprimet, ndërhyrjet e ndërmarra, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë procesit të menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje dokumentohen nga strukturat përkatëse në nivel vendor dhe qendror.

Të gjitha të dhënat dhe informacioni i përfutur ruhen, përpunohen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore përkatëse, duke zbatuar detyrat dhe procedurat e parashikuara në këtë vendim.

Detyrimi për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale shtrihet për të gjithë personat dhe institucionet e përfshira në procesin e menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

2. PMF-ja u shpjegon fëmijës dhe anëtarëve të familjes që informacioni që ajo merr, lidhur me identifikimin dhe trajtimin e rastit, nuk mbahet sekret, por regjistrohet në dosjen individuale të fëmijës. Informacioni i marrë përdoret për ndërmarrjen e veprimeve, të ndërhyrjeve dhe dhënien e shërbimeve për fëmijën në nevojë dhe për anëtarët e familjes, duke ruajtur konfidencialitetin ndaj personave të tjerë dhe ndaj publikut në përgjithësi, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. PMF-ja u shpjegon atyre se informacioni do të ndahet vetëm kur dhe në masën që është e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës dhe pasi të jetë informuar fëmija dhe familja.

3. Çdo anëtar i GTN-së, i përfshirë në menaxhimin e rastit, nënshkruan një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit në mbledhjen e parë të GTN-së.

4. PMF-ja krijon, për të gjitha rastet në menaxhim, dosjen individuale të fëmijës, e cila mbahet, administrohet dhe ruhet në dosjen individuale:

a) Të fëmijës, e cila është në format letre dhe përmban nënshkrimet origjinale në dokumentet përkatëse;

b) Në format elektronik, e cila përmban të dhëna dhe informacion të përditësuar në formularët elektronikë (Regjistrin Elektronik të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror), sipas formularëve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe dokumentet me nënshkrime origjinale të skanuara.

5. PMF-ja do të hapë dhe do të administrojë dosjen individuale të fëmijës për të gjitha rastet kur fëmija rezulton në nevojë për mbrojtje dhe është në rrezik të mesëm, të lartë apo të menjëhershëm.

6. PMF-ja nuk do të hapë dosje individuale të fëmijës në rast se, pas vlerësimit fillestar, rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje. Në këto raste, PMF-ja do të marrë masa për referimin e fëmijës pranë institucioneve përgjegjëse për ndjekje të situatës apo ofrimin e shërbimit të nevojshëm. Informacioni dhe të dhënat e rastit do të hidhen në regjistrin elektronik të posaçëm.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

7. NJMF-ja merr masa dhe mbikëqyr PMF-në, në lidhje me hedhjen e të dhënave dhe të informacionit për fëmijët në nevojë për mbrojtje në dosjet individuale përkatëse.

8. NJMF-ja i raporton dy herë në vit, më 30 maj dhe 30 nëntor, drejtorit të strukturës së shërbimeve shoqërore, në lidhje me të dhënat statistikore për situatën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, bazuar në rezultatet e nxjerra nga regjistri elektronik për fëmijët në nevojë për mbrojtje. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki i paraqet këto rezultate në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, ku diskutohet buxheti dhe kërkon përditësimin e fondit për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, nëse kjo është e nevojshme.

Neni 17

Dosja individuale e fëmijës

1. Dosjes individuale të fëmijës në nevojë për mbrojtje i caktohet numri individual, i cili është numri identifikues i fëmijës përgjatë gjithë procesit të menaxhimit të rastit.

2. Dosja individuale përmban:

- Aneksin 1. Formulari për identifikimin proaktiv;
- Aneksin 2. Formulari i raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- Aneksin 3. Formulari i vlerësimit fillestar;
- Aneksin 4. Formulari për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime;
- Aneksin 5. Formulari i intervistimit;
- Aneksin 6. Formulari i vlerësimit dhe analiza e rrezikut;
- Aneksin 7. Formulari i PIM-it;
- Aneksin 8. Formulari i shqyrtimit të progresit dhe PIM-i i rishikuar;
- Aneksin 9. Formulari i mbylljes së rastit;
- Aneksin 10. Procesverbali për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme;
- Aneksin 11. Formulari i miratimit për ndarjen e informacionit;
- Aneksin 12. Formulari "Fletë të ditari", në të cilin pasqyrohen në mënyrë të detajuar datat dhe orët e të gjitha kontakteve me familjen/ fëmijën ose me anëtarët e GTN-së, përfshirë përmbledhjet e diskutimeve, të takimeve dhe vizitave në shtëpi;

- Informacione të tjera të rëndësishme, si certifikata e lindjes, vendimet gjyqësore etj.;

- Procesverbale të shërbimeve, procesverbale të marrjes në mbrojtje dhe kthimit të fëmijës në familje.

3. Të dhënat në format letre ruhen në një mjedis të sigurt, të aksesueshëm vetëm nga PMF-ja. Të gjithë formularët e plotësuar me dorë duhet të plotësohen me stëlolaps dhe jo me laps, duke përdorur shkrim të qartë e të kuptueshëm për një lexues tjetër.

4. PMF-ja merr masa të plotësojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë, dosjen individuale të fëmijës.

KREU III

ZBATIMI I MASAVE TË MBROJTJES

Neni 18

Masa emergjente e mbrojtjes

1. PMF-ja njofton menjëherë drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, inicion procesin për mbrojtjen e menjëhershme të fëmijës dhe vendosjen e masës emergjente të mbrojtjes nëse, pas referimit apo gjatë vlerësimit fillestar, rezultojnë se fëmija është:

a) Në situatë të rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo forme tjetër dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo të prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku qëndron fëmija nuk është i sigurt për të;

b) Braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;

c) Pa përkujdesje prindërore, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situata të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

2. Në rastet kur përmbushen kushtet e pikës 1, PMF-ja, fillimisht, merr masa për garantimin e sigurisë fizike të fëmijës dhe vendosjen e tij në përkujdesje alternative. Për këtë, PMF-ja vlerëson, së pari, mundësinë për

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

vendosjen e fëmijës pranë një të afërmi ose një familjeje kujdestare dhe, nëse kjo nuk është e mundur, identifikon e njofton shërbimin e strehimit emergjent më të përshtatshëm për fëmijën.

3. PMF-ja merr masa për të shoqëruar fëmijën te personi i afërm, familja kujdestare apo shërbimi i strehimit emergjent për fëmijë. Në çdo rast, PMF-ja dhe personi apo përfaqësuesi i institucionit ku vendoset fëmija nënshkruajnë procesverbalin për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme (aneksi nr. 10), i cili përmban arsyet për marrjen e këtij vendimi. PMF-ja i shpjegon personit/institucionit detyrat që ai ka për të garantuar sigurinë dhe përkujdesjen për mirëqenien e fëmijës. Në rastet kur vlerësohet e nevojshme dhe rrethanat e rastit e kërkojnë për shkak të kushteve të emergjencës, PMF-ja shoqërohet nga punonjësi i policisë.

4. PMF-ja, pasi ka garantuar fillimisht sigurinë fizike të fëmijës, i propozon drejtorit të strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki marrjen e masës emergjente të mbrojtjes. PMF-ja bazohet në të dhënat e administruara në formularin e referimit për mbrojtjen e fëmijës, intervistën e kryer me fëmijën dhe/ose persona të tjerë, të cilët kanë dijeni për ngjarjen, procesverbalin për marrjen në mbrojtje të fëmijës në rrezik të menjëhershëm dhe dërgon kopje të këtyre dokumenteve bashkëngjitur propozimit për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes. Në rast se fëmija është mbi 14 vjeç, PMF-ja dërgon edhe miratimin me shkrim të fëmijës, sipas aneksit nr. 10, për masën emergjente të mbrojtjes. Në rastet kur fëmija nuk është në gjendje të shkruajë, për shkak të aftësisë së kufizuar apo nivelit arsimor, atëherë miratimi i fëmijës bëhet nëpërmjet regjistrimit audio.

5. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore miraton masën emergjente të mbrojtjes brenda 24 orëve nga identifikimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje. Drejtori nuk e miraton masën emergjente nëse gjatë kësaj kohe janë verifikuar kushtet për rikthimin e fëmijës në familje dhe rrethanat që çuan në vlerësimin e rrezikut emergjent nuk janë më të vlefshme.

6. PMF-ja lajmëron prindin apo kujdestarin, në lidhje me vendimin për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes dhe pasojën e saj për mosushtimin e përgjegjësisë prindërore nga ana e tyre, për sa kohë zgjat masa e mbrojtjes. PMF-ja nuk i tregon prindit vendndodhjen e fëmijës.

PMF-ja informon fëmijën, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm për të drejtën e tyre për të paraqitur ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës së mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore.

7. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës:

a) Merr masa për thirrjen e GTN-së në një mbledhje të jashtëzakonshme, brenda 5 ditëve pune nga marrja e masës emergjente të mbrojtjes, me qëllim realizimin e vlerësimit të plotë të rastit dhe hartimin e PIM-it;

b) Viziton dhe bisedon me fëmijën të paktën 1 herë, brenda 5 ditëve të para pasi është vendosur te personi apo institucioni i përcaktuar në masën emergjente të mbrojtjes;

c) Interviston, gjithashtu, personin, të cilit i është besuar fëmija, me qëllim marrjen e informacionit për fëmijën dhe hedh të dhënat e mbledhura në formularin e shqyrtimit të progresit (aneksi nr. 8);

ç) Harton dhe depoziton në gjykatën e rrethit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit për masën, kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, në të cilën përfshin edhe kërkimin për vendosjen e fëmijës në kujdestari, bazuar në vlerësimin e plotë. PMF-ja i bashkëngjit kërkesës të gjitha dokumentet e administruara deri atëherë për rastin, përfshirë edhe dokumente të marra nga strukturat e Policisë së Shtetit.

8. Në çdo rast, nëse PMF-ja nuk i disponon këto dokumente, i përshkruan ato dhe vë në dijeni gjykatën se ato mund të vihen në dispozicion nga strukturat e policisë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nëse fëmija është vendosur pranë një personi të afërm apo një personi të përfshirë në listën e familjeve kujdestare, atëherë PMF-ja i bashkëngjit kërkesës edhe të dhënat që disponon për këta persona. PMF-ja bashkëngjit, në çdo rast, procesverbalin e marrjes në përkujdesje të fëmijës, të nënshkruar nga personi apo institucioni pranë të cilit qëndron fëmija dhe kopje të masës së mbrojtjes, të miratuar nga drejtori.

9. PMF-ja merr pjesë dhe ndjek të gjitha seancat gjyqësore, në lidhje me konfirmimin e masës emergjente të mbrojtjes dhe vendosjen e fëmijës në kujdestari, si dhe përgatit dokumentet e kërkuara nga gjykata në procesin gjyqësor.

10. PMF-ja lehtëson zbatimin e vendimit përfundimtar të gjykatës, në lidhje me masën e mbrojtjes dhe vendosjen në kujdestari të fëmijës, nën drejtimin e drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. Strukturat e shërbimit social shtetëror, rajonal, kanë detyrimin të ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë zbatimin e këtij vendimi.

11. Nëse gjykata e vendos fëmijën në kujdestari të një personi apo institucioni të ndryshëm nga ai i caktuar në masën emergjente të mbrojtjes, drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore/Shërbimi Social

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Shtetëror marrin masa për zbatimin e vendimit të gjykatës.

12. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes, të konfirmuar nga gjykata, PMF-ja vazhdon të monitorojë e të marrë masa për zbatimin e PIM-it për fëmijën.

13. PMF-ja, bazuar në ecurinë e rastit, vlerësimin e rrezikut dhe rishqyrtimin e PIM-it, i propozon GTN-së mbylljen e rastit, bazuar në të dhënat e hedhura dhe të administruara në formularin për mbylljen e rastit (aneksi nr. 9). Nëse GTN-ja e miraton propozimin për mbylljen e rastit, PMF-ja i paraqet propozimin drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, të cilit i bashkëngjit formularin për mbylljen e rastit dhe dokumentacionin që tregon se prindërit janë në gjendje të kujdesen vetë për fëmijën.

14. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, nëse e miraton propozimin, pajis me autorizim PMF-në për të paraqitur në Gjykatën e Rrethit kërkesën për heqjen e masës së mbrojtjes, nëse kanë pushuar shkaqet e vendosjes së saj. Gjykata shprehet në të njëjtin vendim edhe në lidhje me kthimin e fëmijës pranë prindërve, duke sjellë si pasojë përfundimin e kujdestarisë.

Neni 19

Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative

1. PMF-ja, bazuar në vlerësimin e plotë të rastit, harton projektin e PIM-it për fëmijën në nevojë për mbrojtje, i cili përfshin edhe propozimin për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative.

2. Projekti i PIM-it dhe masa e propozuar e mbrojtjes diskutohet dhe miratohet nga anëtarët e GTN-së. Masa e mbrojtjes, e propozuar, përcakton, si personin, ashtu edhe institucionin pranë të cilit do të vendoset fëmija, duke ndjekur radhën e përcaktuar në pikën 1, të nenit 57, të ligjit nr. 18/2017.

3. PMF-ja shoqëron propozimin për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative me informacionin nëse është e mundur vendosja dhe strehimi i fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij dhe kjo nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës. PMF-ja rekomandon, në rastin kur kjo nuk është e mundur, vendosjen e fëmijës te një nga personat e përfshirë në listën e familjeve kujdestare, i cili rezulton i përshtatshëm për fëmijën.

PMF-ja propozon si alternativë të fundit vendosjen e fëmijës në institucion të përkujdesjes për fëmijë.

4. Projekti i PIM-it përfshin edhe ndërhyrjet apo shërbimet që duhet të ndërmerren për të riaftësuar familjen, me qëllim kthimin e fëmijës në familje brenda një periudhe sa më të shkurtër të mundshme, si dhe rekomandimin për kalendarin e takimeve të fëmijës me prindin apo të afërm të tjerë gjatë periudhës së masës së mbrojtjes.

5. PMF-ja i propozon drejtorit të strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, nëse konstatohet se, megjithë ndërhyrjet dhe shërbimet e ofruara në kuadër të PIM-it, niveli i rrezikut nuk është ulur dhe vlerësohet se është në interesin më të lartë të fëmijës të largohet nga mjedisi familjar.

6. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki miraton masën e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative brenda 24 orëve.

7. PMF-ja harton dhe depoziton në gjykatën e rrethit gjyqësor kërkesën për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative. PMF-ja i bashkëngjit kërkesës të gjitha dokumentet e administruara deri në atë moment për rastin. Kërkesës, nëse ka, i bashkëlidhen edhe dokumente të marra nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Neni 20

Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar

1. Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar vendoset për fëmijën, i cili:

a) Ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes;

b) Mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësinë dhe mundësitë për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, që dyshohet ose provohet se e ka dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën. Prindi nuk banon apo, për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo urdhri mbrojtjeje, nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje;

c) Dyshohet ose ka kryer veprë penale dhe është nën moshën e përgjegjësisë penale.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. PMF-ja, në çdo rast, vlerëson nëse rrethanat e lejojnë që fëmija të trajtohet dhe të mbrohet pranë familjes.
3. PMF-ja, gjatë vlerësimit të plotë lidhur me vendosjen e masës së mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar, merr parasysh, por pa u kufizuar në, informacionin për:
 - a) Situatën, për të cilën kërkohet dhe është e nevojshme marrja në mbrojtje e fëmijës;
 - b) Marrëdhënien prindërore;
 - c) Qasjen e prindërve ndaj fëmijës;
 - ç) Aftësinë e tyre për të marrë përgjegjësi dhe për të ofruar kujdesin e duhur për fëmijën;
 - d) Sigurinë e fëmijës, nëse familja përbën rrezik për fëmijën.
4. MASA e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar përfshin:
 - a) Objektiva konkrete që duhet të përmbushin familja dhe fëmija gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj mase;
 - b) Aktivitete specifike apo shërbime që duhet të kryejë apo marrë fëmija dhe familja, me qëllim arritjen e këtyre objektivave;
 - c) Caktimin e personave përgjegjës, që do të mbikëqyrin fëmijën bashkë me PMF-në.
5. PMF-ja i propozon GTN-së marrjen e masës së mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar, si pjesë e PIM-it, duke përcaktuar edhe anëtarët e GTN-së që do të mbështesin PMF-në në zbatimin e tij. Masa i dërgohet për miratim drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, së bashku me projektin e PIM-it, i cili merr vendim brenda 24 orëve për këtë masë.
6. PMF-ja njofton fëmijën dhe prindin, në lidhje me masën e mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar dhe detyrimet gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj mase.

PMF-ja nënshkruan me prindërit/prindin e fëmijës apo kujdestarin ligjor dhënien e miratimit për caktimin e kësaj mase sipas formularit X. Nëse prindi nuk jep miratimin për këtë masë, PMF-ja merr në konsideratë propozimin e një mase tjetër mbrojtjeje në kuadër të PIM-it.
7. PMF-ja, e shoqëruar nga një punonjës tjetër i NJMF-së/NJVNR-së/drejtorisë përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki ose një anëtar i GTN-së, viziton në mënyrë periodike dhe sporadike, me ose pa njoftim dhe në orare të ndryshme gjatë ditës fëmijën e vendosur në masën e mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar. Të dhënat e mbledhura gjatë vizitave në familje hidhen në fletët e ditarit, pjesë e dosjes individuale të fëmijës.
8. PMF-ja e bën më të lehtë dhe monitoron zbatimin e PIM-it për fëmijën lidhur me këtë masë mbrojtjeje.
9. PMF-ja raporton për ecurinë e PIM-it të fëmijës te GTN-ja dhe, nëse nuk ekzistojnë më shkaqet, të cilat çuan në vendosjen e kësaj mase, i propozon drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore marrjen e vendimit për përfundimin e masës së mbrojtjes.

KREU IV ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE E TË STRUKTURAVE PËR MENAXHIMIN E RASTIT

Neni 21

Roli dhe përgjegjësitë e PMF-së në menaxhimin e rastit

- Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka këto përgjegjësi:
- a) Bën identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo si rrjedhojë e raportimeve / referimeve të marra nga institucionet e tjera, OJF-të, anëtarët e komunitetit, publiku, vetë fëmijës/ëve dhe medias;
 - b) Bashkëpunon me policinë, Shërbimin Social Shtetëror dhe aktorë të tjerë të nevojshëm në menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
 - c) Inicion dhe kryen vlerësimin fillestar për të gjithë rastet e fëmijëve të referuar në NJMF-të, në nivel bashkie apo te PMF-të, në nivel njësie administrative;
 - ç) Organizon dhe koordinon takimet e GTN-së për vlerësimin e plotë të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe bën ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve për menaxhimin e tij;
 - d) Harton projektplanin individual të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe ia paraqet ato për diskutim GTN-së;
 - dh) Bën denoncimin në polici të rasteve të abuzimit, të ndodhura apo të dyshuara, që përbëjnë vepër penale, me qëllim parandalimin dhe garantimin e një mbrojtjeje sa më efektive;
 - e) Përgatit dhe zbaton një plan për të punuar drejtpërdrejt me fëmijët dhe familjet;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- e) Ofron këshillim psikosocial dhe mbështetje për fëmijët dhe familjet, duke vlerësuar rrethanat e nevojat e rastit;
- f) Vepron si menaxher i rastit dhe është përgjegjës për zbatimin e monitorimin e Planit Individual të Mbrojtjes, shërben si person kontakti për fëmijën, për të cilin është dhënë një masë mbrojtjeje, pavarësisht nëse fëmija është lënë në përkujdesje të prindit apo është vendosur në përkujdesje alternative;
- g) Ndërmerr dhe ndjek procedurat ligjore për konfirmimin e masës emergjente apo të masës së mbrojtjes në gjykatën kompetente;
- gj) Kryen detyrat e lëna nga gjykata, lidhur me vendosjen e fëmijës në kujdestari pas konfirmimit të masës emergjente apo të masës së mbrojtjes;
- h) Harton dhe paraqet në gjykatë kërkesën për lëshimin e “Urdhrit të mbrojtjes” nga dhuna në familje, në situata kur kjo është e nevojshme për fëmijën apo për njërin prind;
- i) Merr masa dhe kërkon nga strukturat përgjegjëse caktimin e përfaqësuesit procedural për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të përfshirë në një proces penal;
- j) Administron të dhëna të sakta dhe faktike për të gjitha rastet e menaxhuara e të referuara të fëmijëve pranë NJMF-së në bashki ose pranë PMF-së në njësinë administrative.

Neni 22

Roli dhe përgjegjësitë e strukturave të Policisë së Shtetit

Punonjësi i strukturave të policisë ka këto përgjegjësi:

- a) Bën identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative;
- b) Merr masa, në rastet e fëmijëve në rrezik të menjëhershëm, për mbrojtjen e fëmijëve dhe referimin e tyre pranë NJMF-së ose PMF-së;
- c) Bashkëpunon me NJMF-në ose PMF-në për plotësimin e kërkesëpadisë, për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes nga dhuna në familje, kur fëmijët janë në rrezik të lartë ose të menjëhershëm, pavarësisht marrjes së masës emergjente të mbrojtjes nga ana e drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;
- ç) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet zhvillimin e zbatimin e PIM-it për fëmijën;
- d) Bashkëpunon me PMF-në, sipas nevojave të rastit, e shoqëron PMF-në gjatë kryerjes së vizitave në familje, si dhe gjatë identifikimit të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik të lartë ose të menjëhershëm;
- dh) Mbështet dhe bashkëpunon me PMF-në për zhvillimin e aktiviteteve informuese, me qëllim parandalimin e dhunës dhe/ose abuzimin ndaj fëmijëve;
- e) Cakton personin përgjegjës, i cili do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuar dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.

Neni 23

Roli dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, Drejtorisë së Antitrafikut dhe Migracionit dhe Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit

Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit dhe Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit kanë këto përgjegjësi:

- a) U kushtojnë vëmendje të veçantë identifikimit të fëmijëve refugjatë ose azilkërkues, që janë në nevojë për mbrojtje;
- b) Njoftojnë menjëherë Policinë e Shtetit dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor në rast identifikimi të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
- c) Veçojnë fëmijën nga abuzuesi apo nga abuzuesi i mundshëm, duke lejuar hyrjen në mjediset ku mbahet fëmija vetëm të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe mundësuar atyre që të takohen me fëmijën;
- ç) Bashkëpunojnë me NJMF-në/PMF-në dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës gjatë gjithë procesit të menaxhimit dhe marrjes në mbrojtje të fëmijës;
- d) Ofronjë mbështetje të drejtpërdrejtë për këtë kategori fëmijësh, duke përfshirë koordinimin me agjenci/institucione publike dhe /ose private.

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

Neni 24

Roli dhe përgjegjësitë e Shërbimit Social Shtetëror Rajonal

1. Shërbimi Social Shtetëror Rajonal ka përgjegjësitë, si më poshtë vijojnë:
 - a) Bën identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë;
 - b) U kërkon institucioneve të përkujdesjes për fëmijë të pranojnë e të ofrojnë përkujdesje alternative për fëmijët, për të cilët është dhënë masa emergjente e mbrojtjes apo masa e mbrojtjes për vendosjen në përkujdesje alternative.
2. Drejtuesi i Shërbimit Social Shtetëror Rajonal cakton personin përgjegjës që do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuar dhe do të bëjë koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit, si dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.
3. Personi përgjegjës, i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, ka këto detyra:
 - a) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet për zhvillimin dhe zbatimin e PIM-it për fëmijën;
 - b) Merr masa për koordinimin dhe bashkëpunimin e PMF-së e të institucioneve të përkujdesjes për të siguruar pranimin në kohë dhe pa vonesa të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
 - c) Asiston, në bashkëpunim me policinë dhe aktorë të tjerë të nevojshëm, PMF-në në menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve, edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

Neni 25

Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore

1. Punonjësit e institucioneve arsimore, çdo mësues dhe çdo ofrues i shërbimit psikosocial në shkollë, bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë.
2. Drejtuesi i institucionit arsimor cakton personin përgjegjës që do të asistojë punonjësit e institucionit, për raportimin e rasteve të identifikuar dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.
3. Personi përfaqësues i institucionit arsimor, i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni:
 - a) Është përgjegjës për lehtësimin dhe mbështetjen e zbatimit të PIM-it, i cili parashikon ndjekjen e shkollës nga fëmijët në nevojë për mbrojtje;
 - b) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet zhvillimin e zbatimit të PIM-it për fëmijën;
 - c) Merr masa që fëmijës në nevojë për mbrojtje t'i sigurohen tekste dhe mjete shkollore falas.

Neni 26

Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve shëndetësore, publike dhe private

1. Punonjësit e institucioneve shëndetësore, publike apo private, kanë këto përgjegjësi:
 - a) Bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë;
 - b) Përgatisin raportin mjekësor mbi gjendjen shëndetësore të fëmijës, në rastin e identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
 - c) Marrin masa për ofrimin e ndihmës mjekësore, duke përfshirë kontrollet mjekësore, analizat e zhvillimit të fëmijës, ofrimin e barnave falas.
2. Drejtuesi i institucionit shëndetësor cakton personin përgjegjës, që do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuar dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.
3. Personi përgjegjës, i caktuar sipas pikës 2, të këtij neni:
 - a) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet zhvillimin dhe zbatimin e PIM-it për fëmijën;
 - b) Mbështetet dhe bashkëpunon me NJMF-në për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme informuese, me qëllim parandalimin e dhunës dhe/ ose abuzimit ndaj fëmijëve.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 27

Roli dhe përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve për fëmijë, publike dhe private

1. Punonjësit e ofruesit të shërbimeve për fëmijë, publike ose private, bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë.

2. Drejtuesi i ofruesit të shërbimeve cakton personin përgjegjës, që do të asistojë punonjësit e institucionit për raportimin e rasteve të identifikuara dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.

3. Personi përgjegjës, i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni:

a) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet për zhvillimin e zbatimin e PIM-it për fëmijën, si dhe në ofrimin e shërbimeve për fëmijën dhe familjen;

b) Mban kontakte të vazhdueshme me PMF-në, i cili shërben si menaxher rasti për fëmijën, ndaj të cilit ofrohen shërbimet në kuadër të PIM-it, si dhe njofton PMF-në në lidhje me çdo situatë që ndikon në mirëqenien, zhvillimin apo rrezikon sigurinë e fëmijës.

Neni 28

Roli dhe përgjegjësitë e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve është përgjegjëse për:

a) Koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim garantimin e mbrojtjes së fëmijëve;

b) Marrjen në konsideratë të çdo rasti fëmije në nevojë për mbrojtje, si dhe vlerësimin e çdo indicieje, që përbën dyshim të bazuar, për të verifikuar e shqyrtuar çdo rrethanë apo situatë të caktuar, e cila mund të jetë apo të ekspozojë fëmijën në një rrezik për mbrojtjen e tij;

c) Ofrimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, në lidhje me menaxhimin e rasteve të caktuara, si dhe ofrimin e asistencës në menaxhimin e trajtimit e këtyre rasteve, përfshirë koordinimin me agjenci të tjera publike ose private, si dhe/ose ofrues të shërbimeve.

KREU V

FINANCIMI I SHPENZIMEVE PËR ZBATIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES

Neni 29

Financimi i shpenzimeve

Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për hartimin e kërkesës buxhetore për fondin për mbrojtjen e fëmijëve, i cili është i nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

2. Parashikimi dhe krijimi i këtij fondi është pjesë e buxhetit dhe e programit buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe merr në konsideratë:

a) Fondin e shpenzuar për trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të menaxhuara nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës apo PMF-ja, në njësitë administrative, në vitin paraardhës;

b) Parashikimin për fondin e nevojshëm për menaxhimin e rasteve të reja që mund të identifikohen, të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

c) Fondin e nevojshëm për ofrimin e shërbimit të emergjencës.

3. Këshilli Bashkiak miraton fondin për mbrojtjen e fëmijëve, bazuar në propozimin e ardhur nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

4. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki është përgjegjës për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të emergjencës, i cili organizohet me personel dhe struktura (qendra) të vetë bashkisë ose duke i kërkuar kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore prokurimin e këtij shërbimi dhe kontraktimin e OJF-ve apo entitete të tjera private, në kuadër të zbatimit të linjës buxhetore të fondit të mbrojtjes së fëmijëve.

Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki vë në dijeni, zyrtarisht, strukturat e Policisë së Shtetit për shërbimin e emergjencës për mbrojtjen e fëmijëve, duke u komunikuar edhe kontaktet dhe listën e personelit përkatës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

5. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki, në rast se shërbimi i emergjencës nuk mbulon trajtimin dhe mbulimin e shpenzimeve për zbatimin e PIM-it, i dërgon strukturës përkatëse në bashki kërkesën për prokurimin e shërbimeve për rastet individuale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në kuadër të zbatimit të PIM-it dhe mbulimin e këtyre shpenzimeve nga fondi i mbrojtjes së fëmijës.

6. Struktura përkatëse në bashki, në varësi të situatës, mund të bëjë prokurim për raste individuale (ad-hoc) ose prokurim për trajtim të një numri të caktuar rastesh gjatë një viti kalendarik, duke kontraktuar një OJF ose entitet privat, i cili do të shërbejë si lehtësues i zbatimit të PIM-it, duke mbuluar shpenzimet për shërbimet dhe ndërhyrjet e nevojshme për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe/ose për familjen e tyre.

7. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki merr masa, së bashku me NJMF-në dhe PMF-në, të monitorojnë ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e PIM-it nga OJF-të apo ofruesit privatë të kontraktuar për dhënien e shërbimit të emergjencës apo të trajtimit të rasteve të tjera të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

ANEKSET

ANEKSI 1

FORMULARI PËR IDENTIFIKIMIN PROAKTIV

Formulari për identifikimin proaktiv		
DATA:	ORA:	PUNONJËSI I NJMF-së:
Njësia Bashkiake nr. _____		
Bashkia/qyteti: _____		
VENDNDODHJA:		
FORMA PËRMES SË CILËS ËSHTË BËRË IDENTIFIKIMI: Vizita në terren (data dhe anëtarët e skuadrës së terrenit): _____ Njoftim nga: person fizik ose juridik punonjës i institucioneve publike dhe private medias së shkruar, elektronike apo medias sociale		
EMRI I FËMIJËS/I PRINDËRVE/I KUJDESTARËVE/I SHOQËRUESVE		
MOSHA E FËMIJËS _____	FËMIJË TË TJERË (që ndodhen me fëmijën)	
GJINIA E FËMIJËS _____		
TË DHËNA PARAPRAKE MBI SITUATËN NË TË CILËN GJENDET FËMIJA, NEVOJA PËR MBROJTJE DHE MASAT QË DUHET TË MERREN		

ANEKSI 2

FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJEN		
Emri /identiteti i fëmijës:	Data e lindjes:	Gjinia
Emri dhe adresa e prindit/e kujdestarit:	Vendndodhja e fëmijës/adresa ku po qëndron fëmija:	
Shenjat e abuzimit/neglizhimit/dhunës së mundshme (shenja fizike, sjellja e fëmijës, informacione të tjera mbi gjendjen e fëmijës):	Lloji i abuzimit i dyshuar/konstatuar: dhunë fizike dhunë seksuale dhunë psikologjike shfrytëzim ekonomik trafikim fëmijën në situatë rruge neglizhim	

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Të dhëna të tjera mbi situatën e fëmijës:

Përmbledh informacione të tjera që sugjerojnë se fëmija është në situatë rreziku dhe burimin e rrezikut.

Arsyet për raportim: Shqetësimi për mbrojtjen e fëmijës:

Emri dhe detajet e kontaktit të personit që ka bërë identifikimin: Emri dhe detajet e kontaktit të personit që bën raportimin

Firma

Emri dhe kontaktet e personit/institucionit, të cilit i dërgohet formulari:

Formulari është dërguar:

- Email: nga adresa

- Postë:

Data

ANEKSI 3 FORMULARI I VLERËSIMIT FILLESTAR

Formulari i vlerësimit fillestar	
Emri i fëmijës:	Nr. i regjistrimit (kodi):
Mosha/data e lindjes:	Gjinia:
Data kur është bërë raportimi i rastit:	Vlerësimi është bërë nga:
Personi fizik juridik që ka bërë raportimin:	
Arsyeja përse është bërë raportimi:	
Shërbimet/strukturat në kontakt me fëmijën:	Shkolla:

ARSYEJA PËRSE ËSHTË BËRË REFERIMI

Sfondi familjar /përmbledhje e historive të fundit/ngjarje kritike:

Vlerësimi i nivelit të rrezikut:

Rrezik i menjëhershëm

Shpjegim. Në rrezik të menjëhershëm konsiderohet situata në të cilën gjendet fëmija, i cili në momentin e identifikimit, nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, të abuzohet seksualisht, trafikohet apo të jetë pre e keqtrajtimit të tjera të konsideruara vepër penale sipas Kodit Penal. Ndërhyrja në këtë rast duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata e rrezikut.

Rrezik i lartë

Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, i cili për shkak të faktorëve të ndryshëm, rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet në mënyrë të tillë që të vuajë nga paaftësi të përhershme apo t'i rrezikohet seriozisht mirëqenia nëse nuk merren masa për të mbrojtur fëmijën.

Rrezik i mesëm

Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë në rrezik për të pësuar dëmtime të rënda apo të ketë pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia që fëmija të dëmtohet apo të abuzohet, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë. Ndërhyrja për të mbrojtur fëmijën dhe për të ofruar shërbime është e domosdoshme.

Rrezik i ulët

Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, i cili është relativisht i sigurt, nuk vuan nga dëmtime që kanë ardhur si rrjedhojë e abuzimit dhe ka aftësi për të mbrojtur veten. Megjithatë, vlerësohet se ka prezencë të faktorëve të rrezikut dhe se fëmija mund të bëhet pre e abuzimit, dhunës, neglizhimit apo shfrytëzimit, nëse nuk realizohen ndërhyrje për t'i ofruar respektimin dhe aksesin në të drejta apo nëse nuk i ofrohen shërbimet për të cilat fëmija ka nevojë

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

MASAT E MBROJTJES NË VARËSI TË NIVELIT TË RREZIKUT	
Masa emergjente e mbrojtjes	Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative
Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në ambientin familjar	
Firma e PMF-së Data:	Firma e drejtorit të shërbimeve shoqërore në bashki Data

ANEKSI 4

FORMULARIN PËR VIZITAT NË SHITËPI DHE VËZHGIME

Formulari për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime

DATA/ORÄ:

MBIEMRI I FAMILJES:

PUNONJËSI

Kush është i pranishëm:

	Nuk ka shqetësim	Ka pak shqetësim	Ka shumë shqetësime	Komente/ shënime
Mjedisi fizik				
A është e përshtatshme shtëpia? Për shembull, ka hapësira të mjaftueshme? A ka ujë pa ndërprerje/tualet? A është mjaftueshëm e ngrohtë?				
A është shtëpia e pastër dhe e rregullt? A ka ndonjë tregues që mund të ketë rreziqe për shëndetin e fëmijës?				
A ka një vend të përshtatshëm për fëmijën ku të flejë?				
A ka rreziqe fizike të dukshme? Për shembull, xhama, thika dhe objekte të mprehta që gjenden rrotull ose pranë një rrugë të ngarkuar?				
A ka lodra të disponueshme që përshtaten me moshën e fëmijës?				
Vëzhgimi dhe sjellja e fëmijës				
A është i veshur fëmija në mënyrën e duhur?				
A është i pastër fëmija?				
Duke mbajtur parasysh moshën e fëmijës, a i përmbushin ata etapat e një zhvillimi normal?				
A është ndërveprimi i fëmijës me ju i përshtatshëm, duke mbajtur parasysh moshën e tyre?				
A është e folura dhe gjuha në përputhje me moshën e tyre?				
A luan fëmija/a e mbush kohën e tij/ saj në mënyrën e duhur?				
A i ndjek fëmija udhëzimet/kërkesat?				

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

A ka shenja abuzimi, si p.sh., ka nxirje ose dëmtime të pashpjegueshme?			
A ka ndonjë sjellje e cila mund të përbëjë shqetësim ose e cila mund të mos duket “normale”?			
Ndërveprimi prind-fëmijë			
A ka ndonjë veprim fizik/të përzemërt ndërmjet prindit dhe fëmijës?			
A bën prindi komente pozitive për fëmijën në prani të fëmijës?			
A është ndërveprimi prind-fëmijë udhëzues (kontrollues) apo ata i lënë fëmijës mundësi zgjedhjeje?			
A shihet prindi dhe fëmija në sy?			
A duket se ka një marrëdhënie të ngrohtë dhe të natyrshme ndërmjet prindit dhe fëmijës (apo fëmija duket i frikësuar/i kujdesur)?			
A duket i lumtur fëmija?			
A duket se ka një dallim të dukshëm në sjellje ose qëndrim ndaj fëmijëve të ndryshëm në familje?			
Nëse ka fëmijë të tjerë në shtëpi, a duket se marrëdhënia mes fëmijëve është e përshtatshme? Ndonjëri nga fëmijët a po dominon ose po ushtron bullizëm ndaj të tjerëve?			
Prezantimi i prindërve/adultëve			
A paraqet prindi pritshmëri jorealiste për fëmijën / sjelljen e tyre?			
A flet prindi me negativitet për fëmijën/duket shumë kritik?			
A duket sikur prindi kontrollon tërësisht sjelljen e tyre ose a duken ata sikur janë nën ndikimin e drogës, alkoolit etj.?			
A ka ndonjë shenjë të dhunës në familje brenda familjes?			
A ka ndonjë shenjë ose a përmendet ndonjë vështirësi në marrëdhëniet ndërmjet adultëve në shtëpi?			
A përmend prindi ndonjë sjellje për kujdesin e fëmijës që mund të jetë shkak për një shqetësim? Për shembull, ndëshkimi trupor.			
A ka ndonjë gjë të “çuditshme”, ose shqetësuese mbi sjelljen e prindërve që mund të sugjerojë praninë e problematikave të rëndësishme, si p.sh., probleme me shëndetin mendor?			
A ishte prindi agresiv/mbrojtës gjatë vizitës?			
PAS VIZITËS/Vëzhgime			

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

Cilat ishin dinamikat gjatë vizitës?

A patët mundësi të flisnit me fëmijën në mënyrë individuale? Nëse po, a keni ndonjë element që do të donit ta trajtonit?

A ka ndonjë çështje/problematikë që ka nevojë të ndiqet?

Duke menduar për vizitën në shtëpi, a jeni të shqetësuar për mirëqenien/sigurinë e fëmijës? A mendoni që ata janë përballë ndonjë risku? Nëse po, atëherë ju lutem përmendi përse.

ANEKSI 5

FORMULARI I INTERVISTIMIT

Formulari i intervistimit për fëmijët ose personat e tjerë të familjes

Formulari përdoret në intervistat individuale me fëmijën ose personat e tjerë të familjes

Data/ora:

Mbimri i familjes:

Punonjësi:

Personi/at e pranishëm gjatë intervistës:

Arsyeja e intervistës me anëtarin/ët e familjes:

Marrëdhënia e të intervistuarit me fëmijën:

Përshkrimi i të dhënave të marra gjatë intervistës:

Identifikimi i problemeve/çështjeve për adresim nga intervista:

ANEKSI 6

FORMULARI I VLERËSIMIT DHE ANALIZA E RREZIKUT

Formulari i vlerësimit dhe analiza e rrezikut	
Emri i fëmijës:	Nr. i regjistrimit (kodi):
Sfondi familjar/përmbledhje e historive të fundit/ngjarje kritike: Zhvillimi dhe mirëqenia e fëmijës (fizike, emocionale, njohëse, shpirtërore etj. dhe çdo nevojë tjetër e veçantë, p.sh., aftësia e kufizuar): Prezantimi dhe marrëdhënia e fëmijës me të tjerët (përfshirë familjen dhe miqtë): Arsimimi: Kapaciteti i prindërimit dhe aftësia për ta përballuar: Funksionet familjare (marrëdhëniet dhe dinamikat): Kushtet e jetesës dhe situata ekonomike/e punësimit: Mbështetje nga familja/komuniteti i gjerë: Histori të mëparshme abuzimi: RISQET DHE RREZIQE PËR FËMIJËN: Opinionet e prindërve/kujdestarëve: Këndvështrimet/dëshirat e fëmijës: Burime shitesë/mbështetja e disponueshme: Pikat e forta të fëmijës dhe familjes:	
Faktorët e identifikuar të rrezikut	

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

FËMIJA			
ABUZIMI/DHUNA			
Fizike	i dyshuar	abuzim i konfirmuar	në rrezik
	i dokumentuar	në familje	nga i huaj
	në institucion		
Seksuale	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
	i dokumentuar	në familje	nga i huaj
	në institucion		
Psikologjike/ emocionale	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
	i dokumentuar	në familje	nga i huaj
	në institucion		
Neglizhimi	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
	i dokumentuar	në familje	nga i huaj
	në institucion		
Situata shoqërore	punë joformale	e dëmshme	në rrezik shfrytëzimi
	punon në biznesin e familjes_____	shëgert	numri i orëve të punës në javë
Arsimimi	shkon rregullisht	frekuentim i çrregullt	mungesa të shpeshta
	nuk ka shkuar asnjëherë në shkollë	e ka lënë shkollën	analfabet
	pjesërisht analfabet	arsimimi në distancë	mungesa e mësuesit ndihmës për fëmijët me AK
Mbarëvajtja në shkollë	arritje të mira akademike	arritje mesatare	niveli i dobët arritjesh
	përparim i çrregullt		
Trajnimi profesional	skemë e qeverisë	kurs nga OJF-të	pret për një vend
	nuk ka kurse të përshtatshme ekzistuese		
Trafikimi	i dyshuar	në rrezik	i trafikuar më parë
	i kthyer në familje më parë	anëtarët e përfshirë të familjes	palët e treta të angazhuara
	hetim nga policia		
Të miturit e pashoqëruar	nga jashtë	brenda Shqipërisë	
Migrimi	nga jashtë	brenda Shqipërisë	i përgjigjitur në vendndodhjen aktuale
Abuzimi i alkoolit/ drogës ose substancave	çfarë substance	i dyshuar	përdorues i konfirmuar
	shpeshtësi apo nivel përdorimi		
SHËNDETI			
Fizik	i shëndetshëm	të prera, të nxira të dukshme	gjymtyrë ose kocka të thyera
	probleme me zemrën	diabet	azëm
	gjendje kronike	merr ilaçe rregullisht	i pakzaminuar
Mendor	nuk ka probleme	i pakzaminuar	çrregullim i shëndetit mendor: gjendja, lloji
Aftësitë e kufizuara	fizike	probleme dëgjimi	probleme shikimi

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	aftësitë në të nxënë: lloji	lëvizshmëri: e pavarur	lëvizshmëri: ka nevojë për ndihmë me nevojat e përditshme të jetesës
ÇËSHTJET PSIKOLOGJIKE			
Sjellja	agresive	i tërhequr	hiperaktive
	largohet nga shtëpia ose shkolla	i shkakton dëm vetes	
Emocionale	ankth	ka frikë (nga çfarë)	xheloz
	mungesë vlerësimi për veten	i trishtuar/me depresion	lag ose ndot shtratin
	çrregullime në ngrënie	çrregullime gjumi	përqendrim i dobët apo i kufizuar
Trauma	pikëllim nga humbja	aksident madhor	fatkeqësi natyrore
Faktorë të tjerë zhvillimi	zhvillim në shkallë mesatare për moshën	vonesë në të folur	vonesë në zhvillimin fizik
	vonesë në zhvillimin emocional		
Marrëdhëniet mësues–nxënës	të mira	fushat e konfliktit: llojet	diskriminim
	dhunë fizike	abuzim emocional	
Marrëdhëniet shokë me shokë	i detyruar nga “të fortët”	dhunë fizike	kërcënime si fizike ashtu dhe/ose psikologjike
	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
FAMILJA			
Prindërit/ kujdestarët	të martuar dhe jetojnë bashkë	të ndarë	duke u divorcuar
	të divorcuar	[prind] i vetëm	i/e ve
	një nga prindërit ka vdekur	të dy prindërit kanë vdekur	mama dhe njerë
	baba dhe njerë	kushërinj të tjerë: marrëdhënia	
Motrat dhe vëllezërit	fëmijë i vetëm	fëmija më i madh	fëmija më i vogël
	vëllezër, sa?	motra, sa?	fëmijë të tjerë që jetojnë në familje: marrëdhënia
	të adoptuar	të birësuar	
Shëndeti	prindërit kanë sëmundje mendore	të dy apo njëri nga prindërit kanë një aftësi të kufizuar fizike ose të mësuar	të dy apo njëri nga prindërit kanë një problem me alkoolin ose drogat
Dhuna në familje	i dyshuar	niveli dhe shpeshtësi e lartë	raporte të policisë
	trajtim spitalor	raportimi i dhunës i tërhequr	në pritje akuze
Të ardhurat	varfëri ekstreme	varfëri afatgjatë kronike	marrin vetëm ndihmë ekonomike
	mbështetur nga OJF-të	lutet	të ardhura nga familjarët jashtë vendit
	mbajnë kafshë dhe rrisin kafshë		
Punësimi	i rregullt	i pjesshëm	rastësor/joformal
	asnjë	i rrituri ka një aftësi të kufizuar dhe nuk mund të punojë	merr pension ose pension pa aftësi

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Strehimi	shtëpi e sigurt	me qira	pa shtëpi
	jeton në rrugë	strehim i papërshtatshëm ose i pasigurt	godinë me shumë njerëz
Hakmarrje gjakësie	i ekspozuar ndaj gjakmarrjes	i ngujuar	të afërm të familjes së zgjeruar të përfshirë në gjakmarrje
	fëmijë që nuk shkojnë në shkollë dhe nuk marrin kujdes shëndetësor		
Diskriminimi (etnik, gjinor, aftësitë e kufizuara)	i dyshuar	i konfirmuar	në rrezik
	shumë i shpeshtë	i kufizuar	
BURIMET MJEDISORE OSE KOMUNITARE			
Aktivitetet e kohës së lirë	pranë shtëpisë së familjes	jo të pranishme në komunitet	prani e kufizuar
	salla bilardoje	kafene	bibliotekë
	fusha sportive	qendra kulturore	kinema
Rrjetet e besimit ose rrjetet e mbështetjes	asnjë	OJF	kishë
	xhami	shoqata grash	grupe të rinjsh

ANEKSI 7

FORMULARI I PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES

Formulari i planit individual të mbrojtjes				
Nr. i regjistrimit (kodi): _____				
Data e miratimit të Planit Individual të Mbrojtjes: _____				
Data e rishikimit të Planit Individual të Mbrojtjes: _____				
Veprimet e nevojshme	Nevojat për mbrojtje që adresojnë këto veprime	Personi përgjegjës	Afati kohor	Komente mbi progresin e arritur (datat)
Persona të përfshirë në hartimin e PIM-it (firmat)				
Personat të cilët nuk bien dakord me PIM-in dhe arsyet pse:				
Rishikimi dhe aprovimi nga drejtori i strukturës së shërbimeve sociale në bashki:				

ANEKSI 8

FORMULARI I SHQYRTIMIT TË PROGRESIT/PLANIT INDIVIDUAL PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

FORMULARI I SHQYRTIMIT TË PROGRESIT/PLANIT INDIVIDUAL PËR MBROJTJEN E FËMIJËS		
Nr. i regjistrimit (kodi):	Data kur është bërë plani:	Data e shqyrtimit të radhës të progresit:

Ju lutemi konfirmoni nëse prindërit/fëmija ishte i pranishëm (nëse jo si u morën në konsideratë mendimet e tyre gjatë hartimit të planit?).

Datat e shqyrtimeve të mëparshme:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Dimensionet: nevojat e veçanta janë të identifikuar	Shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat	Institucioni/struktura përgjegjëse dhe afati kohor	Përditësim gjatë shqyrtimit/ndryshim i planit
Nevojat për siguri:			
Strehimi/akomodimi dhe nevojat bazë:			
Shëndeti dhe nevoja për zhvillim (duke përfshirë nevojat fizike, emocionale dhe psikologjike):			
Arsimi dhe aftësitë e jetës:			
Marrëdhëniet sociale:			
Marrëdhëniet familjare (përfshirë si do të mbahen kontaktet nëse fëmija do të shkëputet nga familja):			
Kulturor/identiteti:			
Nevojat për aktivitete shlodhëse:			
Çdo lloj tjetër i veçantë nevojë (p.sh., konsultime etj. për të ndihmuar në përmirësimin e situatës):			
Persona të përfshirë në rishqyrtimin e PIM-it (firmat)			
Personat të cilët nuk bien dakord rishqyrtimin e PIM-it dhe arsyet pse:			
Rishikimi dhe aprovimi nga drejtori i strukturës së shërbimeve sociale në bashki:			

ANEKSI 9 MBYLLJA E RASTIT

MBYLLJA E RASTIT	
Data	Nr. i regjistrimit (kodi)

Arsyet për referimin e parë dhe data e referimit:

Përse po mbyllet rasti? Si ka ndryshuar situata (jepni specifikat):

Këndvështrimet e fëmijës/prindërit lidhur me mbylljen:

Emrat e anëtarëve të grupit teknik ndërsektorial që morën pjesë në vendimin për mbylljen e rastit (firmë):

Data e mbylljes së rastit:

Firma e PMF-it: _____

Firma e drejtuesit të strukturës së shërbimeve sociale në bashki

ANEKSI 10 PROCESVERBALI PËR MARRJEN E FËMIJËS NË MBROJTJE TË MENJËHERSHME

Vendi: _____, datë _____. _____. _____,

Të dhënat e fëmijës: (emër/mbiemër) _____, gjinia: _____, data e lindjes (mosha): _____

Vendbanimi _____, nr. i dokumentit identifikues (nëse ka) _____

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

Emër i prindërit/i kujdestarit nëse dihet: _____

Përshkrim i shkurtër i arsyeve/i shkaqeve që çojnë në nevojën për marrje në mbrojtje të menjëhershme:

Vendi ku vendoset fëmija i marrë në mbrojtje të menjëhershme:

I afërm i fëmijës: _____

Familje kujdestare: _____

Institucioni i përkujdesjes/shërbimi i emergjencës: _____

Punonjësi i Policisë Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës

(emër/mbiemër/firmë) (emër/mbiemër/firmë)

I afërm i fëmijës/familja kujdestare/personi përgjegjës pranë institucionit ose shërbimit të emergjencës
(emër, mbiemër, firmë)

ANEKSI 11

FORMULAR MIRATIMI PËR NDARJEN E INFORMACIONIT

Miratimi për ndarjen e informacionit

..... është përgjegjëse për sigurimin e mirëqenies dhe të drejtave të të gjithë fëmijëve që janë të regjistruar në këtë zonë.

Për të garantuar se çdo fëmijë i ofrohet shërbimi i përshtatshëm është shpesh e nevojshme të ndahet informacion personal i mbledhur nga fëmija dhe pjesëtarët e familjes me autoritete/organizata të tjera.

Kjo formë kërkon miratimin tuaj, për ndarjen e informacionit thelbësor të mbledhur nga punonjësi/ja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, së cilës i është caktuar rasti i fëmijës suaj, me specialistë të cilët mund të jenë në gjendje të ndihmojnë në punën për Mbrojtjen e Fëmijës.

Unë..... (emri mbiemri i fëmijës dhe/ose prindit/i kujdestarit) bie dakord që punonjësi/ja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, e caktuar në, mund të ndajë informacionin thelbësor, në lidhje me(emri mbiemri i fëmijës), me autoritetet e administratës publike, policinë ose organizatat jofitimprurëse, siç konsiderohet e nevojshme, për të mbrojtur mirëqenien dhe të drejtat e fëmijës së përmendur.

Firma:

Fëmija/prindi/kujdestari/kujdestari

Firma:

Punonjësja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve

Data:

ANEKSI 12

FLETA E DITARIT

Ky formular duhet të përdoret për të regjistruar TË GJITHA veprimet dhe kontaktet që bëhen në lidhje me një rast dhe mbahet në dosjen e fëmijës. Kur përdoret një bllok shënimesh, informacioni nga blloku i shënimeve DUHET të pasqyrohet në këtë formular.

FLETA E DITARIT				
Nr. i regjistrimit (kodi)	Data/ora	Metoda e komunikimit (p.sh., përmes telefonit, vizitës, takimit)	Përmbledhje e kontaktit	Veprime të ndërmarra ose të sugjeruara

VENDIM

Nr. 635, datë 26.10.2018

PËR VEPRIMTARINË E STRUKTURAVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS, NË LIDHJE ME FËMIJËN NËN MOSHËN PËR PËRGJEGJËSI PENALE, QË DYSHOHET APO KA KRYER VEPËR PENALE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim rregullon veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, për trajtimin e fëmijës, që është nën moshën për përgjegjësi penale dhe që dyshohet apo ka kryer një vepër penale.

2. Parashikimet e këtij vendimi janë të detyrueshme për të gjithë mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionale dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në nivel qendror dhe vendor, sipas paragrafëve 2, 3 dhe 4, të nenit 34, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, institucionet publike apo private, organizatat jofitimprurëse dhe të gjithë personat e tjerë, të cilët kanë për detyrë funksionale, profesionale, kontraktuale apo ligjore të kryejnë referim, menaxhim, koordinim apo të ofrojnë një shërbim për fëmijët në nevojë për mbrojtje.

3. Në zbatim të këtij vendimi, termat “fëmijë, i cili nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale”, “fëmijë nën moshën për përgjegjësi penale” dhe “fëmijë nën moshën për përgjegjësi penale në konflikt me ligjin” kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar nga legjislacioni penal dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

4. Strukturat dhe mekanizmat e përfshirë për mbrojtjen e fëmijës nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet apo ka kryer vepër penale, janë, si më poshtë vijon:

a) Bashkia;

b) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashki dhe Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit;

c) Policia;

ç) Prokuroria;

d) Grupi teknik ndërsektorial;

dh) Autoritete apo shërbime të tjera në nivel lokal.

5. Punonjësit e policisë/prokuroria janë të detyruar që të referojnë menjëherë rastin te punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki ose në njësinë administrative ku është konstatuar vepra penale, për kryerjen e së cilës dyshohet fëmija nën moshën 14 vjeç, si autor apo bashkëpunëtor. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki apo në njësinë administrative, pas marrjes së masave të menjëhershme, e referon rastin në bashkinë apo në njësinë administrative ku ka vendbanimin fëmija.

6. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki/ njësi administrative, për çdo rast të referuar për fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, i cili dyshohet apo është në konflikt me ligjin, hap dosjen përkatëse dhe e plotëson atë sipas legjislacionit në fuqi.

7. Për fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, i cili dyshohet apo është në konflikt me ligjin, pas referimit nga prokurori/punonjësi i policisë, ofrohet mbrojtja dhe trajtimi i përshtatshëm nga strukturat për mbrojtjen e fëmijës pranë bashkisë ose njesisë administrative ku ka vendbanimin fëmija.

8. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me grupin teknik ndërsektorial, për fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, harton Planin Individual të Mbrojtjes, i cili përmban, sipas rastit, një prej masave të mbrojtjes të parashikuara në ligjin nr. 18/2017, ndërhyrjet dhe shërbimet e tjera të nevojshme për riintegrimin e tij.

9. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me Njësinë e Vlerësimit e Referimit të Rasteve dhe grupin teknik ndërsektorial, vlerësojnë rastin, duke marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 18/2017. Në rastin kur vlerësohet se janë të pamjaftueshme seancat e këshillimit ndaj prindërve të fëmijës, ato mund të marrin masa për aftësim prindëror sipas përcaktimeve ligjore.

10. Pas vlerësimit të rastit, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës bashkëpunon me strukturat publike dhe private,

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 156*. Tiranë 2018. f. 10321.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

që ofrojnë shërbime apo programe të posaçme mbrojtjeje për këtë kategori fëmijësh, me qëllim krijimin e mundësive dhe të alternativave të ndryshme për mbrojtje dhe për trajtim të fëmijës. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës kërkon në rrugë zyrtare nga organizata jofitimprurëse informacion të detajuar me shkrim, lidhur me:

- a) Shërbimet konkrete të ofruara për fëmijën nga organizata;
- b) Licencimin;
- c) Statusin ligjor të organizatës dhe mënyrën e organizimit të saj.

11. Bashkia mbështet krijimin e programeve rehabilituese dhe integruese për fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet ose kanë kryer vepër penale. Bashkia lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin me subjektet publike apo private lidhur me detyrimet që ky vendim u cakton punonjësve të mbrojtjes së fëmijës për këtë kategori.

12. Ngarkohen mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe vendor, sipas paragrafëve 2, 3 dhe 4, të nenit 34, të ligjit 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, institucionet publike apo private, organizatat jofitimprurëse dhe të gjithë personat e tjerë, të cilët kanë për detyrë funksionale, profesionale, kontraktuale apo ligjore të kryejnë referim, menaxhim, koordinim apo të ofrojnë një shërbim për fëmijët në nevojë për mbrojtje, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 636, datë 26.10.2018

PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE, TË MËNYRËS SË SHKËMBIMIT E TË PËRPUNIMIT TË INFORMACIONIT DHE TË TË DHËNAVE STATISTIKORE, TË KËRKUARA NGA AGJENCIA SHETËTËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS, PRANË STRUKTURAVE SHETËTËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL QENDROR E VENDOR¹

(ndryshuar me VKM-në nr. 471, datë 6.7.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton llojet, mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor.

2. Në kuptim të këtij vendimi, struktura shtetërore përgjegjëse janë të gjitha institucionet në nivel vendor e qendror, si dhe INSTAT-i, që kanë detyrimin të dërgojnë çdo vit pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës informacionin dhe të dhënat statistikore për treguesit e përcaktuar në këtë vendim.

3. Informacioni dhe të dhënat statistikore, të përcaktuara në këtë vendim, do të përdoren me qëllim:

a) Monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në kuadër të zbatimit të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe dokumenteve strategjike me fokus fëmijët;

b) Hartimin e politikave, të strategjive, programeve e masave konkrete në fushën e promovimit, të mbrojtjes dhe pëmbushjes së të drejtave të fëmijëve.

4. Informacioni dhe të dhënat statistikore përfshijnë:

a) Të dhëna numerike për treguesit e përcaktuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Informacion shoqërues, përshkrues, sipas kërkesave të shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, lidhur me treguesit e përcaktuar në këtë vendim.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 156*. Tiranë 2018. f. 10322.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

5. Brenda 3-mujorit të parë të çdo viti, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës kërkon informacionin dhe të dhënat statistikore vjetore për vitin paraardhës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor, sipas shtojcave të këtij vendimi. Agjencia publikon informacionin dhe të dhënat statistikore çdo vit, në faqen e saj zyrtare.

6. Njësitë për mbrojtjen e fëmijës raportojnë periodikisht, çdo 3 muaj, dhe në fund të vitit me një raport vjetor pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të dhënat statistikore dhe narrative që kanë mbledhur për fëmijët, të cilët jetojnë brenda dhe jashtë vendit, që janë në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe të njësive administrative përkatëse brenda vendit, dhe për fëmijët me shtetësi shqiptare, që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i përpunon këto të dhëna, duke realizuar strukturimin e të dhënave në nivel kombëtar.

7. Shkëmbimi i informacionit dhe i të dhënave statistikore nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor, si dhe publikimi i informacionit, sipas pikës 5 të këtij vendimi, bëhen në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe garantimin e konfidencialitetit.

8. Vendimi nr. 267, datë 12.4.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

10. Ngarkohen strukturat përgjegjëse, në nivel qendror e vendor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA 1 LISTA E TREGUESVE

Nr.	Treguesi	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave
1	Numri dhe përqindja e fëmijëve , sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër, %	INSTAT
2	Numri dhe përqindja e martesave deri 18 vjeç , sipas: - Gjinisë; - Moshës.	Numër, %	INSTAT/Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)
3	Numri dhe përqindja e vajzave deri 18 vjeç që kanë lindur/regjistruar fëmijë , sipas moshës.	Numër, %	INSTAT/DPGJC
4	Përqindja/numri i fëmijëve që jetojnë në nivel varfërie relative, disagregimi sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Numrit të fëmijëve në familje; - Ndarjes gjeografike.	% /numër	INSTAT/anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri
5	Numri i fëmijëve që jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike , sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës (0-18 vjeç) - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror (DPSHSSH)/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) njësitë e vetëqeverisjes vendore.
6	Numri i fëmijëve që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar , sipas: - Gjinisë; - Grup-moshave; - Regjistrimi në sistemin parashkollor dhe në sistemin e arsimit bazë;	Numër	DPSHSSH/MSHMS

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	- Qarqeve.		
7	Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale (në fund të vitit), sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës (0–6 vjeç, 6–18 vjeç); - Lloji të shërbimit; - Sektorit të shërbimit (privat/publik/jopublik); - Qarqeve.	Numër	DPSHSSH
8	Numri i fëmijëve në familje kujdestare në fund të vitit raportuar nga Shërbimi Social Shtetëror, sipas: - Statusit të Aftësisë së Kufizuar.	Numër	DPSHSSH
9	Numri i fëmijëve të shpallur “të braktisur”, me vendim gjykatë.	Numër	Ministria e Drejtësisë (MD)
10	Numri i fëmijëve të birësuar gjatë vitit, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare - Aftësisë së kufizuar/probleme shëndetësore; - Brenda apo jashtë vendit; - Strukturës së familjes; - Qarqeve.	Numër	Komiteti i birësimit/MD
11	Niveli i vdekshmërisë neonatale (deri ditën e 27 të jetës) për 1000 lindje të gjalla, sipas gjinisë.	Numër / 1000	INSTAT
12	Vdekshmëria foshnjore (vdekjet e fëmijëve nën moshën 1 vjeç/1000 lindje gjallë), sipas gjinisë.	Numër / 1000	INSTAT
13	Numri i vdekjeve të fëmijëve deri 1 vjeç, sipas shkakut të vdekjes.	Numër	MSHMS
14	Niveli i vdekshmërisë nën 5 vjeç për 1000 lindje të gjalla, sipas gjinisë.	Numër / 1000	INSTAT
15	Niveli i vdekshmërisë amtare në 100,000 lindje të gjalla, sipas grup-moshës.	Numër / 100000	INSTAT/MSHMS
16	Përqindja e lindjeve të asistuar nga staf profesional.	%	MSHMS
17	Numri dhe përqindja e fëmijëve të lindur nën peshë sipas gjinisë.	Numër dhe %	MSHMS
18	Incidenca e sëmundjeve tek fëmijët, 0-14 vjeç, sipas: - Sëmundjeve; - Gjinisë; - Grup-moshës.	Numër	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
19	Numri dhe përqindja e grave shtatzëna diagnostikuar me HIV-pozitiv gjatë vitit që përdorin terapi antiretrovirale.	Numër dhe %	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
20	Numri dhe përqindja e fëmijëve HIV-pozitiv që përdorin TAR (terapi antiretrovirale), sipas: - Grup-moshës; - Gjinisë.	Numër dhe %	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
21	Përqindja e fëmijëve target që vaksinohen siç rekomandohet në kalendarin kombëtar të vaksinimit deri në moshën 1 vjeç, sipas vaksinave përkatëse.	%	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
22	Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç nën peshë, sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	%	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
23	Përqindja e fëmijëve që ushqehen ekskluzivisht me qumësht gjiri deri 6 muaj, sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	%	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
24	Përqindja e foshnjave (6–24 muaj) që ushqehen me gji edhe pas muajit 6, sipas:	%	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	- Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).		
25	Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç me rritje të prapambetur për moshën, sipas: - Kategorive të prapambetjes; - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	%	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
26	Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç mbipeshë, sipas: - Gjinisë; - Qarqeve; - Rezidencës (urbane/rurale).	%	Instituti i Shëndetit Publik/MSHMS
27	Numri i vetëvrasjeve të fëmijëve, të regjistruar nga policia, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
28	Numri i tentativave për vetëvrasje të fëmijëve të regjistruar nga policia, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
29	Numri i fëmijëve viktime të trafikimit gjatë vitit, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Kategorisë së regjistrimit të rastit; - Qarqet ku janë identifikuar rastet. Numri i fëmijëve të identifikuar si viktime trafikimi sipas formave të shfrytëzimit: - Shfrytëzim seksual; - Shfrytëzim për punë dhe shërbime të detyruara; - Prostitucion; - Pornografi; - Aktivitet kriminal si shpërndarje narkotikësh ose vjedhje; - Lypje e detyruar,	Numër	Ministria e Brendshme MB
30	Numri i fëmijëve viktime të mundshme trafikimi, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Kategorisë së regjistrimit të rastit; - Qarqet ku janë identifikuar rastet. Numri i fëmijëve të identifikuar si viktime të mundshme trafikimi sipas formave të shfrytëzimit: - Shfrytëzim seksual; - Shfrytëzim për punë dhe shërbime të detyruara; - Prostitucion; - Pornografi; - Aktivitet kriminal si shpërndarje narkotikësh ose vjedhje; - Lypje e detyruar.	Numër	MB
31	Numri i fëmijëve me status refugjatë, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; Vendit të origjinës; - Llojit të mbrojtjes; - Statusit të shoqërimit (shoqëruar/ndarë/të pashoqëruar). Numri i fëmijëve me status mbrojtjeje plotësuese sipas:	Numër	Ministria e Brendshme

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	- Gjinisë; - Grup-moshës; - Vendit të origjinës; - Llojit të mbrojtjes; - Statusit të shoqërimit (shoqëruar/ndarë/të pashoqëruar.		
32	Numri i fëmijëve që kanë kërkuar azil në Shqipëri, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Vendit të origjinës; - Statusit të shoqërimit (shoqëruar/ndarë/të pashoqëruar);	Numër	Ministria e Brendshme
33	Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtuar/mbështetur nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshave; - Shtetësisë; - Llojit të rastit të menaxhuar; - Statusit të menaxhimit të rastit; - Niveli i rrezikut të rastit; - Bashkive.	Numër	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës/njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, bashkitë
34	Numri i fëmijëve për të cilët është marrë masë mbrojtjeje, sipas: - Llojit të masës; - Statusit të aprovimit të masës.	Numër	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës/njësitë për mbrojtjen e fëmijëve - bashkitë
35	Numri i fëmijëve të riadhesuar, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Bashkive.	Numër	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
36	Numri i fëmijëve viktimë të dhunës të regjistruar nga institucionet shëndetësore sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Llojit të dhunës; - Ndarjes gjeografike.	Numër	MSHMS
37	Numri i fëmijëve viktimë të veprave penale regjistruar nga policia, sipas: - Gjinisë; - Veprës penale; - Përfunduar në vdekje; - Ndarjes gjeografike.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
38	Numri i fëmijëve autorë të dyshuar të veprës penale regjistruar nga policia, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Veprës penale; - Ndarjes gjeografike.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
39	Numri i fëmijëve (14–17 vjeç) në paraburgim, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës/ave penale; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim (po/jo); - Statusi i recidivimit (po/jo); - Kategoritë e masave alternative të marra; - Aftësisë së kufizuar (po/jo); - Ndarjes gjeografike.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
40	Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) në burg, sipas:	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	- Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës/ave penale; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim (po/jo); - Statusi i recidivimit (po/jo); - Aftësisë së kufizuar (po/jo); - Ndarjes gjeografike.		Burgjeve
41	Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të trajtuar nga shërbimi i provës, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Veprës penale; - Kategorive të masave të marra; - Statusit të referimit të rastit për ndërmjetësim; - Statusi menaxhimit të rastit (i ri, i mbartur/në proces, i mbyllur).	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
42	Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të pandehur nën hetim të raportuar nga prokuroria, sipas: - Gjinisë; - Shtetësisë; - Veprës penale; - Kategorive të vendimeve të marra; - Masave të sigurisë së marra.	Numër	Prokuroria e Përgjithshme
43	Numri i fëmijëve viktimë të veprave penale të raportuar nga prokuroria, sipas: - Gjinisë; - Shtetësisë; - Kategorive të dëmit (plagosje lehtë/rëndë/vdekje); - Veprës penale.	Numër	Prokuroria e Përgjithshme
44	Numri i fëmijëve autorë të dyshuar të veprave penale të trajtuar në gjykatë, sipas: - Gjinisë; - Procedimeve penale; - Kategorive të vendimeve të marra.	Numër	Ministria e Drejtësisë
45	Numri i fëmijëve viktimë të veprave penale të trajtuara në gjykatë, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Veprës penale;	Numër	Ministria e Drejtësisë
46	Numri i fëmijëve të trajtuar me urdhër mbrojtje në gjykatë si viktimë të dhunës në familje, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Shtetësisë; - Kategorisë së urdhrit të mbrojtjes (urdhër mbrojtje/urdhër menjëhershëm mbrojtje).	Numër	Ministria e Drejtësisë
47	Numri i fëmijëve që kanë përfituar ndihmë ligjore falas, sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare - Shtetësisë; - Aftësisë së kufizuar; - Kategorisë së rastit (penale, civile, familjare, administrative).	Numër	Ministria e Drejtësisë

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

48	Numri i ankesave të vlefshme për fëmijët të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas: - Shkakut të diskriminimit; - Kategorisë së rastit (nga fëmija/ët, në emër të fëmijës/ve, nga Komisioneri); - Statusi i menaxhimit të rastit (i ri/proces/mbyllur sipas kategorive); - Fusha ku pretendohet diskriminimi (punësim, arsim, të mira dhe shërbime).	Numër	Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi
49	Numri i ankesave të vlefshme për fëmijët të trajtuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas: - Kategorisë së rastit (nga fëmija/ët, në emër të fëmijës/ve, nga komisioneri); - Statusi i menaxhimit të rastit (i ri/proces/mbyllur sipas kategorive).	Numër	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
50	Numri i ankesave, kërkesave, njoftimeve dhe rasteve me iniciativë, të trajtuara nga Avokati i Popullit me objekt të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, sipas: - Ankesa/kërkesa nga vetë fëmijët; - Ankesa/kërkesa në emër të fëmijëve; - Raste me iniciativë të trajtuara dhe inspektime; - Statusi i trajtimit të rastit (i ri/proces/mbyllur sipas kategorive).	Numër	Avokati i Popullit
51	Numri i fëmijëve (16–18 vjeç) të punësuar që kanë pësuar aksidente në punë sipas: - Gjinisë; - Grup-moshës; - Industrisë; - Llojit të punës që punonin.	Numër	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
52	Numri i fëmijëve punëmarrës raportuar nga Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, sipas - Grup-moshës; - Gjinisë; - Shtetësisë; - Nivelit arsimor; - Përshkrimit të proceseve të punës; - Kohëzgjatjes së pushimit vjetor (ditë); - Kohëzgjatjes ditore e punës; - Kohëzgjatjes javore të punës; - Numri i fëmijëve të punësuar me kontrata individuale të punës; - Numri i fëmijëve të siguruar. Numri i fëmijëve nën 18 vjeç të konstatuar në punë të vështira dhe të rrezikshme. Numri i fëmijëve nën 18 vjeç të konstatuar në punë nate.		Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
53	Numri i fëmijëve 0–3 vjeç që shkojnë në çerdhe, sipas: - Gjinisë; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Sektor publik/privat; - Bashkive.	Numër	Bashkitë
54	Përqindja e fëmijëve 3–6 vjeç të regjistruar në kopsht në krahasim me numrin total të fëmijëve 3–6 vjeç, sipas: - Gjinisë; - Moshës.	%	INSTAT/Ministria e Arsimit dhe Sportit
55	Përqindja e fëmijëve që janë regjistruar në klasën e parë në krahasim me numrin total të fëmijëve 6 vjeç sipas gjinisë.	%	INSTAT/Ministria e Arsimit dhe Sportit/ njësitë arsimore vendore përgjegjëse për

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

			arsimin parauniversitar
56	GER dhe NER sipas ciklit të studimit/arsimit dhe gjinisë (indeksi i barazisë gjinore).	%	INSTAT/MAS
57	Përqindja e braktisjes shkollore , sipas: - Gjinisë; - Nivelit arsimor; - Qarqeve; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare.	%	MAS/Njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar
58	Përqindja e nxënësve përsëritës , sipas nivelit: - Nivelit arsimor; - Gjinisë; - Aftësisë së kufizuar; - Qarqeve; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare.	%	MAS/Njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar
59	Numri i fëmijëve viktime të mundshme trafikimi sipas: - Bashkisë ku është identifikuar rasti; - Bashkisë ku jeton rasti i identifikuar (nëse është ndryshe nga bashkia ku rasti është identifikuar); - Moshës; - Gjinisë; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; Numri i fëmijëve viktime të mundshme trafikimi sipas formave të shfrytëzimit: - Shfrytëzim seksual; - Shfrytëzim për punë dhe shërbime të detyruara; - Prostitucion; - Pornografi; - Aktivitet kriminal si shpërndarje narkotikësh ose vjedhje; - Lypje e detyruar. Numri i fëmijëve sipas nivelit të rrezikut - I menjëhershëm; - I lartë; - Mesatar; - I ulët. Numri i fëmijëve, për të cilët është marrë një masë mbrojtjeje: - Masë emergjente mbrojtjeje; - Mbikëqyrje e specializuar në mjedisin familjar; - Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative (të afërm; institucione rezidenciale/strehëz).	Numër	Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki
60	Numri i fëmijëve viktime trafikimi sipas: - Bashkisë ku është identifikuar rasti/ - Bashkisë ku jeton rasti i identifikuar (nëse është ndryshe nga bashkia ku rasti është identifikuar); - Moshës; - Gjinisë; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare. Formave të shfrytëzimit: - Shfrytëzim seksual; - Shfrytëzim për punë dhe shërbime të detyruara; - Prostitucion; - Pornografi; - Aktivitet kriminal si shpërndarje narkotikësh ose vjedhje; - Lypje e detyruar. Numri i fëmijëve, për të cilët është marrë një masë mbrojtjeje: - Masë emergjente mbrojtjeje; - Mbikëqyrje e specializuar në mjedisin familjar; - Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative (të afërm;	Numër	Njësitë për mbrojtjen e fëmijës në bashki

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	institucione rezidenciale/strehëz).		
61	Numri i fëmijëve të pashoqëruar sipas: - Gjinisë, - Grup-moshës; - Përkatësisë në një pakicë kombëtare; - Shtetësisë; - Qarqeve.	Numër	Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, Ministria e Brendshme.

SHTOJCA 2 INFORMACIONI SHOQËRUES MBI TREGUESIT

Përshkrimi i treguesit	Treguesi	
	Përshkrimi i treguesit dhe i variablave	
Metodologjia	Institucioni/et përgjegjëse (mbledhje, përpunim, raportim)	
	Sistemi i mbledhjes së informacionit	
	Përlogaritja (përshkrim)	
Informacioni i shtesë	Mbulimi kohor	
	Komente (përfshirë kufizimet, interpretimet)	

VENDIM Nr. 740, datë 12.12.2018

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE (BONUSI) PËR NËNAT ME FOSHËNJA TË PORSALINDURA DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË TIJ¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 38, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij, si më poshtë vijon:

- a) Në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë për lindjen e fëmijës së parë;
- b) Në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për lindjen e fëmijës së dytë;
- c) Në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për lindjen e fëmijës së tretë dhe fëmijëve të tjerë në vijim;
- ç) Për nënat që lindin binjakë, masa e përfitimit do të jetë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për secilin fëmijë;
- d) Për nënat që lindin trinjakë dhe më shumë, masa e përfitimit do të jetë në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për secilin fëmijë.

2. Ndihmën e menjëhershme financiare (bonusi) sipas pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe nënat shtetase shqiptare për fëmijë të lindur jashtë vendit dhe të regjistruar sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile.

3. Nëpunësi i gjendjes civile, i atashuar pranë institucioneve të shërbimit spitalor ku kryhet lindja, kryen veprimet e verifikimit *on-line* të statusit të nënës dhe regjistron fëmijën e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010.

¹Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 176*. Tiranë 2018. f. 12164.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

Pas regjistrimit kryen verifikimet e nevojshme për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) sipas pikës 1, të këtij vendimi. Procedura e verifikimit *on-line* për identifikimin e nënës së fëmijës së lindur dhe statusit të saj, si dhe mënyra e përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Brendshëm.

4. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi) sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, i jepet nënës, menjëherë, pas lëshimit të dokumentit “certifikatë asistence në lindje”, në përfundim të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

5. Masa e ndihmës së menjëhershme financiare jepet në formën e një çeku, të emetuar në emër të nënës, dhe ose sipas rasteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, dhe të pagueshëm:

a) 35 (tridhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “certifikatë asistence në lindje”;

b) 75 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “certifikatë asistence në lindje”;

c) 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “certifikatë asistence në lindje”;

ç) Diferenca e mbetur prej 5 (pesë mijë) lekësh, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

6. Vlera e përcaktuar në çek tërhiqet në bankat e nivelit të dytë me të cilat Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

7. Në rast se strukturat përgjegjëse konstatojnë përfitimin pa të drejtë të ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr masa, sipas legjislativës në fuqi, për kthimin e shumës së përfituar pa të drejtë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet më 1 janar 2019.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 111, datë 6.3.2019

PËR PROCEDURAT DHE RREGULLAT PËR KTHIMIN E RIATDHESIMIN E FËMIJËS¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 11, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Ky vendim ka për objekt të përcaktojë procedurat dhe rregullat e detajuara mbi procesin:

a) e kthimit të fëmijëve të pashoqëruar, të huaj apo pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë fëmijët e pashoqëruar, në zbatim të marrëveshjes së ripranimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian apo marrëveshjeve të tjera të ripranimit, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) e riatdhesisë të fëmijëve të pashoqëruar shqiptarë, përfshirë fëmijët shqiptarë të deklaruar të humbur, që ndodhen në territorin e një shteti të huaj;

c) e ripranimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të fëmijëve të pashoqëruar nga vendet e treta apo pa shtetësi, si rrjedhojë e zbatimit të marrëveshjes së ripranimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian apo marrëveshjeve të tjera të ripranimit, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Ky vendim nuk zbatohet për:

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 32. Tiranë 2019. f. 1416.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

a) fëmijët e pashoqëruar që janë subjekte të kthimit apo të riatdhesimit në zbatim të ligjit penal apo si pasojë e zbatimit të një procedure ekstradimi;

b) fëmijët e shoqëruar vetëm nga njëri prind dhe pa pëlqimin e prindit tjetër, për të cilët, nga Ministria e Drejtësisë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore zbatohen rregullat dhe procedurat e parashikuara nga ligji nr. 9446, datë 24.11.2005, "Për ratifikimin e Konventës mbi Aspekte Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës". Rregullat e detajuara për procedurën e riatdhesimit në këtë rast përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Brendshëm.

3. "Fëmijë i pashoqëruar" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

4. Qëllimi i këtij vendimi është të garantojë të drejtat e fëmijëve të pashoqëruar dhe t'u ofrojë atyre mbrojtjen më të lartë të mundshme, nëpërmjet përcaktimit të parimeve, procedurave dhe mekanizmave përgjegjës për fëmijët e pashoqëruar, sipas një sistemi të integruar mbrojtjeje dhe koordinimit efikas të të gjitha institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

5. Autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procesin e mbrojtjes, është Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

6. Mekanizmi i trajtimit dhe mbrojtjes së fëmijëve të pashoqëruar, si dhe procedurat e kthimit e riatdhesimit të tyre udhëhiqen nga parimet e parashikuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

7. Kthimi apo riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar bëhet vetëm nëse është në interesin më të lartë të tyre, ku veçanërisht duhet të vlerësohen elementet e mëposhtme:

a) nevojat individuale të fëmijës, në funksion të garantimit të mirërritjes së tij dhe gëzimit të të drejtave të fëmijës;

b) historia e fëmijës dhe gjendja e tij familjare, psikologjike, sociale apo kulturore;

c) dëshira dhe mendimi i fëmijës, në varësi të moshës biologjike dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

ç) situata familjare dhe mundësia e saj për t'u përgjigjur nevojave të fëmijës, si dhe ruajtja e marrëdhënieve familjare e shoqërore;

d) garantimi i interesit më të lartë të fëmijës, i bashkimit me familjen e tij apo vendosja e fëmijës nën përgjegjësinë e një kujdestari ligjor;

dh) siguria e dhënë nga autoritetet e vendit që aplikon kthimin, se fëmija do të bashkohet me familjen e tij, do të vendoset nën përgjegjësinë e një kujdestari ligjor apo në mjediset të përshtatshme priteje në shtetin drejt të cilit do të kthehet. Kthimi apo riatdhesimi i fëmijëve të pashoqëruar, pa shtetësi apo nga vendet e treta bëhet duke mbajtur parasysh dhe duke respektuar parimin e moskthimit.

8. Rregullat e parashikuara në këtë vendim do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe në këtë fushë, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, si dhe për aq sa janë më të favorshme për interesin e fëmijës.

II. Procedurat dhe rregullat e kthimit të fëmijëve të pashoqëruar, të huaj apo pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë

9. Fëmija i pashoqëruar nuk mund të jetë në asnjë rast subjekt i ndonjë vendimi kthimi në pikat e kalimit të kufirit. Në rastet e tjera, kthimi është alternativa e fundit dhe vetëm në raste kur është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

10. Punonjësit e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, punonjësit e Policisë së Shtetit apo të strukturave përgjegjëse për azilin ose refugjatët, brenda 12 orëve nga konstatimi apo njoftimi se në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur apo qëndron një fëmijë i pashoqëruar, referojnë rastin te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (në vijim, PMF) në territorin e së cilës është konstatuar fëmija, duke informuar zyrtarisht, në çdo rast, Agjencinë për Gjenealitetet dhe Shtetësinë e Fëmijës, nëse ato njihen, vendndodhjen e saktë të fëmijës, si dhe çdo të dhënë tjetër që tregon mënyrën e trajtimit e gjendjen e tij. Ata bëjnë verifikimin e menjëhershëm të moshës së fëmijës dhe, derisa moshë të përcaktohet saktësisht sipas legjislacionit në fuqi, ai prezumohet se është fëmijë dhe trajtohet si i tillë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

11. Në rastin e fëmijëve pa shtetësi, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Policia e Shtetit bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur vendbanimin e zakonshëm të fëmijës së pashoqëruar. Për këtë kategori, si pjesë e përcaktimit të interesit më të lartë të fëmijës, do të shqyrtohen të gjitha mundësitë për dhënien e një lejeje qëndrimi mbi baza humanitare nëse nuk plotësohen kushtet e tjera.

12. PMF-ja, në territorin e të cilit ndodhet fëmija, bën vlerësimin fillestar të rastit, nëpërmjet verifikimit të gjenealiteteve, të vendbanimit dhe të shtetësisë së tij, të gjendjes e trajtimit që po i bëhet, si dhe përgatit një raport të hollësishëm informues mbi arsyet e hyrjes dhe qëndrimit të pashoqëruar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky raport përgatitet brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i raportimit të rastit dhe i përcillet agjencisë, sipas pikës 14, të këtij vendimi. PMF-ja ndjek hapat për caktimin që në fillim të një kujdestari ligjor për fëmijën e pashoqëruar, sipas legjislacionit në fuqi. Format i tip i referimit të rastit dhe raportit që përgatit PMF-ja miratohet me urdhër të drejtorit të agjencisë.

13. Marrja e informacioneve nga fëmija bëhet me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, që njeh mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij, dhe në gjuhën që ai kupton, nëpërmjet ofrimit të përkthyesit, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Agjencia i njofton listën e plotë të përkthyesve dhe psikologëve, që janë në dispozicion të PMF-së në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

14. Menaxhimi i rasteve për fëmijët e huaj të pashoqëruar, që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, PMF-ja, në territorin e të cilit ndodhet fëmija, merr të gjithë hapat për ofrimin e shërbimit të emergjencës dhe vendosjen e masës emergjente të mbrojtjes e më pas referon rastin në bashkinë apo nësinë administrative ku ndodhet institucioni i përkujdesjes sociale ku do të vendoset fëmija. Plani individual për mbrojtjen e fëmijës duhet të përfshijë shqyrtimin e rrezikut për trafikimin e fëmijës ose sigurimin e regjistrimit nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin të kërkesës për azil e referimin përkatës tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët apo edhe të dy së bashku, nëse është rasti. PMF-ja, menaxher i rastit, i dërgon agjencisë një raport të hollësishëm lidhur me rastin, ku, përveç informacionit të përcaktuar në pikën 12, të këtij vendimi, pasqyrohet edhe mendimi i fëmijës lidhur me kthimin ose jo të tij.

15. Me udhëzimin e ministrit përgjegjës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës përcaktohen institucionet dhe mënyra e ofrimit të shërbimit për fëmijët e huaj të pashoqëruar, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rastin e fëmijëve të pashoqëruar azilkërkues, ata do të strehohen në Qendrën Kombëtare të Pritjes për Azilkërkues, kurse, në rastin e fëmijëve të pashoqëruar, që janë njëkohësisht edhe azilkërkues, edhe viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit, ata do të vendosen në Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, ku do të vazhdojnë edhe procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit.

16. Agjencia, pas marrjes dijeni zyrtarisht për rastin, nëpërmjet shërbimit diplomatik të vendit të origjinës së fëmijës, vendit ku ndodhet familja e tij, vendit nga ai ka ardhur apo vendit ku ka vendbanimin e tij, informon autoritetet përgjegjëse të atij shteti për vendndodhjen e fëmijës dhe arsyet e hyrjes dhe qëndrimit të tij të pashoqëruar. Agjencia u kërkon autoriteteve përgjegjëse të atij shteti që, brenda një afati të arsyeshëm, të bëjnë një vlerësim të thelluar dhe të paraqesin një informacion të hollësishëm për fëmijën, veçanërisht për prindërit apo kujdestarin ligjor të fëmijës, si dhe aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integritimin e tij në vendin e origjinës, kushtet e jetesës pas kthimit të mundshëm në vendin e origjinës, si dhe mundësitë e tij për të ruajtur identitetin, kombësinë dhe lidhjet familjare.

17. Raporti i paraqitur nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës i përcillet menjëherë autoritetit që ka njoftuar identifikimin e fëmijës, PMF-së, institucionit të përkujdesjes sociale, ku po qëndron fëmija i pashoqëruar, si dhe institucionit që po trajton kërkesat ligjore të paraqitura nga fëmija i pashoqëruar. Raporti i vihet në dispozicionin edhe kujdestarit ligjor që i është caktuar fëmijës për periudhën e qëndrimit në Shqipëri. Përgjithësisht, në rastin e fëmijës së pashoqëruar që ka paraqitur kërkesë për azil, informacioni sipas pikës 16, të këtij vendimi, kërkohet vetëm pasi ka marrë formë të prerë vendimi për mospranimin/refuzimin ose revokimin e statusit mbrojtje ndërkombëtare.

18. Agjencia, pas shqyrtimit të këtij raporti, si dhe të raportit të dërguar nga PMF-ja, përgjegjëse për menaxhimin e rastit, paraqet në formë shkresore mendimin për autoritetet përgjegjëse që po trajtojnë kërkesa të fëmijës për mundësinë e qëndrimit ose jo të tij në Shqipëri, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

19. Struktura pranë ministrit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, gjatë vendimarrjes së tyre për aplikimin për azil, statusin e refugjatit apo për të përfutur të drejtën e qëndrimit në Shqipëri, mbajnë në konsideratë, për aq sa është e mundur, mendimin e

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

paraqitur nga agjencia, si dhe informacione të tjera të marra nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës, në vijim të kërkesave të tyre, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

20. Vendimmarrja për kthimin ose jo të fëmijës nuk mund të merret në asnjë rast pa u paraqitur më parë mendimi i arsyetuar i agjencisë. Ky mendim duhet të mbahet në konsideratë nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, me përjashtim të rasteve kur ka arsye të argumentuara e të përligjura, që bëjnë të pamundur zbatimin e tij, ku përfshihen, por pa u kufizuar, rreziku ndaj sigurisë kombëtare apo rendit publik apo rrezikimi i jetës së fëmijës.

21. Vendimi për kthimin ose jo të fëmijës merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e mendimit të arsyetuar nga agjencia.

22. Nëse autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin vlerëson se fëmija i pashoqëruar duhet të kthehet, atëherë lëshon urdhrin e largimit dhe kthimit të fëmijës së pashoqëruar, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe në çdo rast duhet të përcaktojë afatin maksimal brenda të cilit duhet të zbatohet.

23. Në rast dhe vetëm nëse fëmijës së pashoqëruar i është refuzuar ose nuk i është pranuar aplikimi për azil, leje qëndrimi apo i është revokuar vendimi i statusit të refugjatit, si rregull, mund të bëhet subjekt i kthimit dhe largimit nga territori shqiptar, sipas përcaktimeve në ligjin për të huajt.

24. Urdhri i largimit dhe kthimit të fëmijës së pashoqëruar u njoftohet menjëherë agjencisë dhe PMF-së që ka ndjekur zbatimin e planit individual të mbrojtjes së fëmijës.

25. PMF-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e njohjes me urdhrin e largimit dhe të kthimit të fëmijës, me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, informon fëmijën, në gjuhën që ai kupton, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, për urdhrin e largimit dhe të kthimit të tij.

26. Fëmija i pashoqëruar, nëpërmjet kujdestarit ligjor të caktuar, ka të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi. Ai përfiton ndihmë juridike falas nga shteti, nëse e kërkon një gjë të tillë, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

27. Urdhri i largimit nuk ekzekutohet deri në përfundimin e procesit të ankimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në ligjin për të huajt.

28. Autoritetet përgjegjëse, bazuar në rrethanat specifike të fëmijës, si kohëzgjatja e qëndrimit, vijimi i shkollës apo çështje të tjera me karakter social apo familjar, mund të urdhërojnë zgjatjen e periudhës për realizimin e procedurës së kthimit.

29. Brenda 3 (tri) ditëve nga momenti i nxjerrjes së urdhrin për largimin e fëmijës së pashoqëruar dhe kthimin e tij, autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin përgatit planin e kthimit të fëmijës, si dhe bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet fëmija, për të përcaktuar në mënyrë përfundimtare, si më poshtë vijon:

- a) mënyrën e kthimit dhe rrugën më të përshtatshme për transportin e fëmijës;
 - b) kohën e kthimit, ku përfshihet orari i mundshëm i nisjes nga territori i Shqipërisë dhe të mbërritjes në vendin e kthimit;
 - c) personat përgjegjës për shoqërimin e dorëzimin e fëmijës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm që nevojitet të përgatitet për dorëzimin e tij;
 - ç) pikat e kontaktit ndërmjet autoriteteve, me qëllim lehtësimin e procedurës së kthimit dhe të dorëzimit të fëmijës;
 - d) nevojën për marrjen e masave paraprake për të garantuar të drejtat e fëmijës, çka mund të çojë në mbajtjen e ndaluar të fëmijës vetëm si një mjet i fundit;
 - dh) mundësinë e mbulimit të shpenzimeve përkatëse të procedurës së kthimit dhe të dorëzimit.
30. Plani i kthimit të fëmijës përfshin, por pa u kufizuar, si më poshtë vijon:
- a) Rregullat për përgatitjen e kthimit të fëmijës, duke përfshirë mënyrën e transportit të tij nga vendqëndrimi deri në pikën e kalimit të kufirit;
 - b) Garantimin e ushqimit dhe të higjienës së fëmijës gjatë gjithë udhëtimit deri në momentin e dorëzimit tek autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet;
 - c) Personin përgjegjës për shoqërimin e fëmijës nga vendqëndrimi i tij deri në dorëzimin tek autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet;
 - ç) Detyrat dhe përgjegjësitë e personit përgjegjës për shoqërimin e fëmijës;
 - d) Përgjegjësitë e të gjitha autoriteteve përgjegjëse të përfshira në procedurën e kthimit të fëmijës, për të mundësuar kthimin e përshtatshëm të tij;
 - dh) Mënyrën e kalimit të kufirit dhe rregullat për dorëzimin e fëmijës;
 - e) Dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Një kopje e planit të kthimit të fëmijës i dërgohet agjencisë.

31. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin njofton autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në vendin, ku fëmija do të kthehet, për planin e kthimit të fëmijës, me qëllim marrjen e masave prej tyre për të siguruar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijës.

32. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin merr menjëherë masat për të pajisur fëmijën me dokument identifikimi të vlefshëm, nëse fëmija nuk e disponon, si dhe me dokumentet e vlefshme të udhëtimit.

33. Në përcaktimin e mënyrës së kthimit dhe rrugës më të përshtatshme për transportin e fëmijës mbahet në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës dhe mundësia për të siguruar kthimin më të lehtë, të shpejtë dhe të përshtatshëm të tij, në përputhje me moshën dhe mundësinë për të përballuar pa asnjë vështirësi kthimin, duke garantuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës.

34. PMF-ja, me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, informon fëmijën në gjuhën që ai kupton dhe në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar me planin e kthimit të fëmijës, situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që do t'i ofrohen në vendin e origjinës.

35. Si rregull, fëmija shoqërohet nga kujdestari i tij ligjor gjatë udhëtimit e deri në dorëzimin tek autoritetet përgjegjëse. Nëse kjo është e pamundur, fëmija shoqërohet nga një psikolog apo një i rritur, që njeh mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij.

36. Dorëzimi i fëmijës tek autoritetet përgjegjëse të vendit të kthimit dokumentohet rregullisht, nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit të fëmijës, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar ecuria e udhëtimit dhe personat përgjegjës që po marrin në dorëzim fëmijën. Procesverbali nënshkruhet në tri kopje nga personat përgjegjës që kanë marrë në dorëzim fëmijën dhe personi përgjegjës për shoqërimin e tij. Një kopje e procesverbalit i dërgohet agjencisë.

37. Shpenzimet për kthimin e fëmijës dhe garantimin e të drejtave deri në momentin e dorëzimit, në rast se nuk mbulohen nga vendi ku do të kthehet fëmija ose nga familja e fëmijës përballohen nga buxhetet e miratuara të institucioneve përgjegjëse. Në përputhje me parimin e reciprocitetit apo të marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, mund të kërkohej rimbursimi i shpenzimeve nga vendi ku fëmija kthehet apo nga familja e tij.

III. Procedurat dhe rregullat për riatdhesimin e fëmijëve të pashoqëruar shqiptarë, që ndodhen në territorin e një shteti të huaj

38. Për rastet që përfshijnë fëmijët e pashoqëruar, si dhe fëmijët e pashoqëruar të deklaruar të humbur, shërbimi diplomatik i Republikës së Shqipërisë jashtë vendit njofton menjëherë Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Kjo ministri apo çdo autoritet tjetër shtetëror, duke përfshirë edhe Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, që merr njoftim nga autoritetet e huaja për vendndodhjen e një fëmije të pashoqëruar shqiptar në territorin e një vendi të huaj, brenda 24 orëve, njofton zyrtarisht Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

39. Njoftimi duhet të përmbajë gjenealogjetet e fëmijës, nëse ato njihen, vendndodhjen e saktë të fëmijës, historikun e fëmijës në vendin ku ndodhet, nëse njihet, vendbanimin e familjes, emrat e të afërmeve apo emrin e shkollës, si dhe çdo të dhënë tjetër që tregon mënyrën e trajtimit dhe gjendjen e tij, sipas informacionit të përcjellë nga autoritetet përgjegjëse të vendit ku ndodhet fëmija.

40. Agjencia, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Policinë e Shtetit dhe organet e pushtetit vendor, brenda 10 (dhjetë) ditëve, verifikon gjenealogjetet e sakta të fëmijës dhe vendbanimin e familjes së tij, prindin apo kujdestarin ligjor të fëmijës, adresën e saktë të tyre, periudhën dhe mënyrën e kalimit të kufirit, si dhe konfirmon në mënyrë përfundimtare se kemi të bëjmë me një shtetas shqiptar.

41. Agjencia referon rastin te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në territorin e së cilës ka vendbanimin fëmija apo vendqëndrimin familja e tij.

42. PMF-ja, në bashkëpunim me administratorin shoqëror, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit nga agjencia, bëjnë një vlerësim të thelluar, përgatitin dhe dërgojnë pranë agjencisë një raport të hollësishëm informues për:

- a) gjendjen familjare të fëmijës dhe gjenealogjetet e plota të prindit apo kujdestarit ligjor të tij;
- b) qëndrimin e familjes dhe të të afërmeve të tyre për fëmijën;
- c) historikun e fëmijës e të familjes së tij, si dhe gjendjen ekonomike e sociale të familjes së fëmijës;
- ç) aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integritetin e tij në Shqipëri pas riatdhesimit të mundshëm apo mundësinë e familjes së tij për t'u përkujdesur për fëmijën pas riatdhesimit, me qëllim ruajtjen e identitetit, kombësisë dhe lidhjeve familjare.

43. Marrja e informacioneve për përgatitjen e raportit bëhet nëpërmjet:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) verifikimit në terren të gjendjes dhe kushteve të jetesës së familjes;
 - b) pyetjes së prindërve apo kujdestarit ligjor të fëmijës, të afërmeve të tij, apo institucioneve apo personave që kanë ofruar shërbime ndaj fëmijës;
 - c) shqyrtimit të informacioneve zyrtare që ekzistojnë për familjen apo fëmijën, veçanërisht për sa u përket rasteve të raportuara më parë të dhunës në familje, shfrytëzimit të paligjshëm në çdo formë të fëmijës apo përfshirjes së fëmijës a familjarëve të tij në veprimtari kriminale;
 - ç) verifikimeve nëse familja e fëmijës është përfutuese e ndihmës ekonomike apo e shërbimeve sociale, sipas legjislacionit në fuqi;
 - d) verifikimit nëse fëmija është trajtuar më parë me ndonjë nga format e shërbimeve sociale apo të përkujdesjes alternative;
 - dh) çdo forme tjetër që mundëson mbledhjen e informacioneve të vlefshme për të përcaktuar çështjet që do të përfshihen në raportin informues.
44. Agjencia, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e raportit informues, ia përcjell atë zyrtarisht autoritetit njoftues, duke i kërkuar që raporti t'i njoftohet edhe:
- a) organit përgjegjës që ka bërë njoftimin dhe po kujdeset për trajtimin e fëmijës shqiptar të pashoqëruar;
 - b) kujdestarit ligjor që mund t'i jetë caktuar fëmijës;
 - c) organeve përgjegjëse që po trajtojnë ndonjë kërkesë ligjore të paraqitur nga fëmija në atë vend.
45. Nëse autoritetet shtetërore marrin njoftim për një vendim për kthimin e një fëmije shqiptar të pashoqëruar nga një vend i huaj, menjëherë ia komunikojnë atë agjencisë, e cila i përcjell njoftimin PMF-së, që ka përgatitur raportin informues.
46. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, që i paraqitet për zbatim vendimi i autoritetit kompetent të huaj, për të kthyer një fëmijë të pashoqëruar shqiptar, apo në rastet e paraqitjes së kërkesave për ripranimin e fëmijëve të pashoqëruar, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian ose të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit, dakordësojnë me autoritetet përgjegjëse të atij vendi:
- a) rregullat për përgatitjen e riatdhesimit të fëmijës, duke përfshirë mënyrën e transportit të tij nga vendqëndrimi deri në pikën e kalimit të kufirit në Shqipëri;
 - b) personin përgjegjës për shoqërimin e fëmijës dhe dorëzimin e tij tek autoritetet shqiptare;
 - c) kohën e kthimit, ku përfshihet orari i mundshëm i nisjes dhe i mbërritjes në territorin e Shqipërisë;
 - ç) mënyrën e kalimit të kufirit, si dhe rregullat e dokumentacionin e nevojshëm për riatdhesimin dhe dorëzimin e fëmijës;
 - d) mbulimin ose jo të shpenzimeve të riatdhesimit.
47. Rregullat e dakordësuara ndërmjet autoriteteve i njoftohen menjëherë agjencisë, e cila ia përcjell për njohje PMF-së që ka përgatitur raportin informues, me qëllim që, së bashku me punonjësën e sektorit të Migracionit në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, ato t'i bëhen me dije edhe familjes së fëmijës së pashoqëruar apo kujdestarit të tij ligjor.
48. PMF-ja përgatit planin individual të mbrojtjes së fëmijës për zbatim pas riatdhesimit të tij.
49. Në rast se në të njëjtën periudhë janë paraqitur më shumë se një vendim i autoritetit kompetent të huaj, për të kthyer një fëmijë të pashoqëruar shqiptar nga i njëjti shtet, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin organizon dhe komunikon me autoritetet përgjegjëse të huaja, që riatdhesimi i tyre të bëhet në mënyrë të njëkohshme.
50. Punonjësi i sektorit të migracionit në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, së bashku me PMF-në, njoftojnë prindërit ose kujdestarin ligjor të fëmijës për detajet e riatdhesimit të fëmijës. Prindërit ose kujdestari ligjor i fëmijës plotësojnë “Deklaratën e marrjes dijeni për riatdhesimin”, ku shprehen në mënyrë përfundimtare, nëse:
- a) marrin përsipër ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, të strehimit dhe mirërritjen e fëmijës në kushte normale jetese;
 - b) bëhet pritja e fëmijës në momentin e mbërritjes në territorin shqiptar;
 - c) mundësohet mbulimi i shpenzimeve për transportin e fëmijës.
51. Deklarata e marrjes dijeni për riatdhesimin plotësohet në katër kopje dhe i dorëzohet punonjësit të sektorit të migracionit në Drejtorinë Rajonale për Kufirin, PMF-së përgjegjëse, i cili ia përcjell një kopje agjencisë.
52. Plani individual i riatdhesimit dhe trajtimit të fëmijës, i hartuar nga shteti njoftues, u njoftohet menjëherë prindërve apo kujdestarit ligjor të fëmijës, nëse ata kanë shprehur vullnetin për pritjen e fëmijës, Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, që ka në juridiksion pikën e kalimit të kufirit, ku do të dorëzohet fëmija, dhe PMF-së.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

53. Në përcaktimin e mënyrës më të përshtatshme për transportin e fëmijës, mbahet në konsideratë interesi i tij dhe mundësia për të siguruar transportin më të lehtë, të shpejtë dhe të përshtatshëm të fëmijës, në përputhje me moshën dhe mundësinë për të përballuar pa asnjë vështirësi atë, duke garantuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës.

54. Fëmija i pashoqëruar pritët në pikën e kalimit të kufirit nga prindi ose kujdestari i tij ligjor, nëse kanë shprehur dakordësinë e tyre paraprakisht nga një psikolog dhe nga PMF-ja që ka koordinuar të gjithë procedurën e vlerësimit.

55. Fëmija shoqërohet në familje menjëherë pas mbërritjes në territorin shqiptar. Nëse fëmija do të vendoset në një institucion përkujdesjeje, atëherë PMF-ja e territorit ku është pika e kalimit të kufirit bën shoqërimin e fëmijës për në institucionin e përkujdesjes, pasi është bërë kërkesa më parë në Shërbimin Social Shtetëror, ku janë dhënë arsyet e vendosjes së fëmijës në institucionin e përkujdesjes.

56. Brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga mbërritja e fëmijës në familje, PMF-ja, i shoqëruar nga një psikolog apo administratori shoqëror, bën një vlerësim për gjendjen psikosociale, shëndetësore, duke identifikuar dhe nevojat e fëmijës për riintegrim në jetën sociale.

57. Fëmija i riadhesuar është fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe trajtohet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi. PMF-ja fillon procedurën për vendosjen e masës së mbrojtjes kur:

a) nëse nga vlerësimi i thelluar i bërë nga PMF-ja dhe administratori shoqëror rezulton se nuk është në interesin më të lartë të fëmijës të qëndrojë në familje;

b) në rastin kur prindërit apo kujdestari i fëmijës nuk pranon që fëmija i tyre të kthehet në familje, edhe pse nga vlerësimi i thelluar ka rezultuar se familja i plotëson kushtet për t'u kujdesur për fëmijën, duke përfshirë edhe ofrimin e ndihmës për përmirësimin e kushteve të jetesës.

58. Në çdo rast të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 57, të këtij vendimi, PMF-ja raporton rastin pranë Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit për kryerjen e verifikimeve të nevojshme dhe sipas rrethanave të rastit, fillimin e procedimit penal ndaj prindit ose kujdestarit ligjor të fëmijës, bazuar në nenin 124, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, "Braktisja e fëmijëve të mitur".

59. Nëse autoritetet shtetërore marrin njoftim për një vendim për kthimin e një fëmije shqiptar të pashoqëruar nga një vend i huaj, pa njoftim paraprak dhe brenda një kohe të shkurtër, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin apo çdo autoritet tjetër shtetëror, që i paraqitet për zbatim vendimi i autoritetit kompetent të huaj, për të kthyer një fëmijë të pashoqëruar shqiptar, njofton menjëherë agjencinë, e cila referon për ndjekje rastin pranë PMF-së ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin fëmija dhe familja e tij.

60. Nëse afati i përcaktuar për kthimin e fëmijës nuk mundëson që fëmija të pritët në pikën e kalimit të kufirit, nga subjektet e përcaktuara në pikën 54, të këtij vendimi, atëherë fëmija, menjëherë pas mbërritjes në territorin shqiptar dhe marrjes në dorëzim, shoqërohet për në qendrën e emergjencës, në qendrën ditore ose në qendrën rezidenciale të shërbimit social, që ndodhet në territorin e bashkisë më të afërt, ku qëndron përkohësisht deri në vlerësimin e plotë të gjendjes së tij psikosociale dhe shëndetësore dhe marrjen e vendimit për kthimin ose jo të fëmijës në familje.

61. Marrja në dorëzim i fëmijës së pashoqëruar shqiptar që i nënshtrohet procedurës së riadhesimit dokumentohet rregullisht, nëpërmjet procesverbalit të marrjes në dorëzim të fëmijës, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar procedura e pritjes, gjendja e tij e dukshme në momentin e marrjes në dorëzim dhe personat përgjegjës që po marrin në dorëzim fëmijën.

62. Procesverbali nënshkruhet në 4 (katër) kopje nga personat përgjegjës që kanë marrë në dorëzim fëmijën dhe personi përgjegjës për shoqërimin e tij. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet agjencisë.

63. PMF-ja, brenda një periudhë gjashtëmujore, dërgon pranë agjencisë raporte periodike dymujore për ecurinë e menaxhimit të rasteve të fëmijëve të riadhesuar.

64. Shpenzimet për kthimin e fëmijës dhe garantimin e të drejtave, në rast se nuk mbulohen nga vendi nga i cili kthehet fëmija dhe për aq sa nuk mbulohen nga familja e fëmijës, përballohen nga buxhetet e miratuara të institucioneve përgjegjëse.

IV. Ruajtja dhe administrimi i të dhënave

65. Agjencia mban të dhëna statistikore për fëmijët e pashoqëruar që i nënshtrohen procedurës së kthimit apo riadhesimit. Të dhënat statistikore përpunohen në format elektronik dhe përfshijnë, si më poshtë vijon:

a) në rastin e kthimit, përveç gjenealiteteve të fëmijës dhe vendit të tij të origjinës apo vendit nga ka ardhur dhe ku ka vendbanimin, edhe mënyrën e trajtimit të tij në Shqipëri dhe procedurën e ndjekur për kthimin e tij;

b) në rastin e riadhesimit, gjenealitetet e fëmijës, vendin nga ku është kthyer, situatën e familjes, procedurat e ndjekura për riadhesim, si dhe mënyrën e trajtimit të tij nga mbërritja në Shqipëri.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

66. Autoritetet përgjegjëse që ushtrojnë detyrat sipas këtij vendimi, të cilat mbledhin dhe administrojnë të dhënat për fëmijën e pashoqëruar, i ruajnë ato për një periudhë 5-vjeçare, nga momenti i dorëzimit të fëmijës tek autoritetet përgjegjëse të vendit ku është kthyer apo nga momenti i marrjes në dorëzim të fëmijës së riadhesuar.

67. Autoritetet që mbledhin dhe administrojnë të dhëna personale për fëmijët e pashoqëruar marrin masat e duhura organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi i jashtëligjshëm ose aksidental, humbja aksidentale, aksesit ose përhapja të persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër përpunimi të jashtëligjshëm.

68. Punonjësit e autoritetit përgjegjës të përfshira në procedurën e trajtimit dhe kthimit apo riadhesimit të fëmijëve të pashoqëruar i nënshtrohen detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe mospërhapjes së informacionit të marrë, për shkak të detyrës gjatë mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale për trajtimin e tyre, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre edhe pas përfundimit të funksioneve, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

V. Dispozita të fundit

69. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda 1 (një) muaji nga miratimi i këtij vendimi, komunikon me autoritetet përgjegjëse të shteteve të tjera që, menjëherë sapo konstatojnë gjetjen e një fëmije me shtetësi shqiptare të pashoqëruar në territorin e tyre, të njoftojnë misionin diplomatik postin konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në vendin e tyre.

70. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, bashkëpunon edhe me organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

71. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Erion Braçe

UDHËZIM

Nr. 640, datë 20.12.2019

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË VEÇANTA TË KALIMIT TË SHTETASVE SHQIPTARË TË MITUR NË KUFİ¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të shkronjës “e”, të pikës 5, të kreut I, të vendimit nr. 806, datë 16.11.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të verifikimit kufitar që përcaktohen për kategori të caktuara të personave dhe mjeteve”,

UDHËZOJ:

1. Shtetasi shqiptar i mitur (në vijim referuar “i mituri”) që kalon në kufi, i nënshtrohet të gjitha verifikimeve, në hyrje dhe në dalje, si të rriturit.

2. Në rastet kur i mituri udhëton në shoqërinë e njërit prej prindërve, prindi që e shoqëron duhet të jetë i pajisur me deklaratë noteriale të prindit tjetër, ku autorizohet udhëtimi i të miturit në shoqërinë e prindit, ose me vendim gjyqësor që e lejon të udhëtojë të miturin me njërin nga prindërit.

3. Në mungesë të prindërve, i mituri nën moshën 16 vjeç lejohet të udhëtojë i shoqëruar nga vëllai ose motra në moshë madhore, gjyshi, daja, xhaxhai, halla, teza, vetëm në rast se paraqet një deklaratë noteriale të vlefshme, të lëshuar nga të dy prindërit në emër të personit që e shoqëron, ose në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, duhet të paraqitet vendimi gjyqësor që lejon udhëtimin e të miturit.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 187*. Tiranë 2019. f. 16897.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

4. I mituri nga mosha 16 vjeç deri në 18 vjeç lejohet të udhëtojë në mungesë të prindërve, i shoqëruar me persona të tjerë madhorë, vetëm në rast se paraqet një deklaratë noteriale të vlefshme, të lëshuar nga të dy prindërit në emër të personit që e shoqëron, ose në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, duhet të paraqitet vendimi gjyqësor që lejon udhëtimin e të miturit.

5. Në rast se prindërve u është hequr përgjegjësia prindërore dhe fëmijës i është caktuar kujdestar me vendim gjyqësor, deklarata noteriale lëshohet nga kujdestari.

6. Në rastin e të miturit të shoqëruar, roja kufitare verifikon nëse personi që shoqëron të miturin është kujdestari i tij, në veçanti kur i mituri shoqërohet vetëm nga një person madhor dhe ka arsye serioze për të dyshuar se mund të jetë hequr në mënyrë të paligjshme nga kujdestaria e personave që ushtrojnë ligjërisht kujdesin prindëror ndaj tij.

7. Roja kufitare që kryen procedurën e verifikimit të të miturit, krahas verifikimit të dokumenteve të udhëtimit, duhet të konsultohet me bazën e të dhënave, të intervistojë të miturin në prani të personit që e shoqëron dhe të kontrollojë deklaratën noteriale të lëshuar për udhëtimin e të miturit të pashoqëruar nga prindërit, por nga persona të autorizuar prej tyre.

8. Në rastet kur të miturit udhëtojnë të organizuar në grupe, duhet të shoqërohen nga një përfaqësues i autorizuar i institucionit përkatës të njohur në Republikën e Shqipërisë, i cili duhet të disponojë listën emërore të nënshkruar nga titullari i institucionit dhe deklaratat noteriale të prindërve apo kujdestarëve ligjorë të të miturve.

9. Në të gjitha rastet, deklarata noteriale që lëshohet për të miturit e pashoqëruar, përmban elementët e mëposhtëm:

a) deklarin e prindit që autorizon udhëtimin me prindin tjetër, apo personin që e shoqëron, me kusht për të mos e braktisur të miturin në vendet e destinacionit;

b) emrin, mbiemrin dhe datëlindjen e të miturit, si dhe numrin e dokumentit të udhëtimit;

c) deklarin nga prindi i të miturit të destinacionit të saktë të udhëtimit, deklarin që nuk do të braktisë fëmijën, adresën e saktë të destinacionit ku do të shkojë, afatin e qëndrimit (datën e nisjes dhe datën e kthimit);

d) deklarin e adresës së saktë, gjenealogjetet dhe numrin e telefonit të pritësit, nëse udhëton për tek të afërmit;

e) deklarin për përgjegjësinë penale të prindit ose të kujdestarit, në rastet e braktisjes së të miturit;

f) përcaktimin e periudhës së vlefshmërisë së deklaratës noteriale.

10. Në rastet kur prindërit janë të divorcuar, i mituri lejohet të udhëtojë jashtë vendit në shoqërinë e njërit prej prindërve, vetëm nëse është lëshuar një deklaratë noteriale nga prindi tjetër, pavarësisht se cili prej tyre ka përgjegjësinë prindërore me vendim gjyqësor. Përgjegjësinë nga ky rregull bëhet në ato raste kur në vendimin e gjykatës që ka përcaktuar përgjegjësinë prindërore, janë përcaktuar edhe masa apo të drejta për zhvendosjen e të miturit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga njëri apo të dy prindërit.

11. Në rastet kur i mituri udhëton në shoqërinë e njërit prind dhe prindi tjetër ka ndërruar jetë, roja kufitare kryen verifikimet në Sistem, dhe në bazë të statusit të prindit shoqërues(i/e ve), lejon kalimin e kufirit të të miturit.

12. Regjistrimi në dalje në Sistem i të miturit të kryhet duke pasqyruar në rubrikën “Shënime” numrin rendor dhe datën e deklaratës noteriale, emrin dhe mbiemrin e personit shoqërues (prindit, kujdestarit ligjor ose shoqëruesit e tjerë të autorizuar), emrin dhe mbiemrin e noterit që ka nënshkruar deklaratën noteriale, kohën e qëndrimit, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me të miturin. Një kopje e deklaratës noteriale, për efekte kontrolli dhe verifikimi, administrohet në Pikën e Kalimit Kufitar. Në rastet kur paraqitet vendim gjyqësor, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, në Sistem regjistrohet numri dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë, si dhe gjykata që ka dhënë vendimin. Një kopje origjinale ose kopje e njësuar me origjinalin e vendimit gjyqësor administrohet në Pikën e Kalimit Kufitar.

13. Kur ka arsye serioze për të dyshuar se i mituri mund të jetë shkëputur në mënyrë të paligjshme nga kujdestaria e personit që ushtron ligjërisht përgjegjësinë prindërore apo nga kujdestari i tij, roja kufitare duhet të kryejë edhe verifikime të mëtejshme, duke vlerësuar e zbuluar mospërputhjet apo kontradiktat në informacionin e dhënë.

14. Në rast dyshimi, roja kufitare i bën një intervistë shoqëruesit, kryen verifikime të detajuara të dokumenteve të udhëtimit dhe dokumenteve mbështetëse për t’u siguruar që i mituri nuk po largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë kundër dëshirës së personave që ushtrojnë kujdesin prindëror ndaj tij, në mënyrë që të parandalojë rrëmbimin ose trafikimin e të miturit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

15. Roja kufitare vlerëson të dhënat dhe informacionin e mbledhur gjatë verifikimit kufitar të të miturit që kalon kufirin. Në rast nevojë për një verifikim të plotë të rrethanave dhe të situatës, përgjegjësi i turnit komunikon me strukturën përgjegjëse vendore për mbrojtjen e fëmijës, sipas parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

16. Në rastet e konstatimit të braktisjes së të miturve apo moskthimit në afat të tyre, kryhen të gjitha veprimet e nevojshme, me qëllim referimin në prokurori të veprës penale braktisja e fëmijëve të mitur, sipas përcaktimit të bërë në Kodin Penal.

17. Për minimizimin dhe zbulimin e rasteve të braktisjes së fëmijëve të mitur dhe të abuzimit me të miturit nga trafikantë apo persona të tjerë përfitues, të bashkëpunohet ngushtësisht edhe me institucionet homologe ligjzbatuese të vendeve fqinje dhe ato ndërkombëtare.

18. Të gjitha dokumentet që administrohen në Pikat e Kalimit të Kufitar në zbatim të këtij udhëzimi, ruhen për një afat një vjeçar dhe në përfundim të këtij afati asgjësohen nga një komision i ngritur me urdhër të drejtorit të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin. Për procedurën e asgjësimit mbahet një procesverbal, ku shënohet lloji i dokumentit, numri dhe data e tij.

19. Në të gjitha rastet kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim, roja kufitare informon personin që shoqëron të miturin mbi dokumentacionin që duhet të paraqesë sipas këtij udhëzimi, për t'i mundësuar kalimin e kufirit dhe nuk lejon daljen e të miturit nga kufiri shtetëror deri në paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm.

20. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

21. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Sandër Lleshaj

VENDIM

Nr. 186, datë 4.4.2019

PËR KRITERET PËR PUNËSIMIN E PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS DHE TË PUNONJËSVE QË PUNOJNË ME FËMIJËT¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 45, të ligjit nr.18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

a) punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës;

b) punonjësit që punojnë me fëmijët;

c) ata që kanë të drejtën të ushtrojnë profesionin e "punonjësit social" apo të "psikologut".

2. Në kuptim të këtij vendimi, punonjësit që punojnë me fëmijët janë ata punonjës, të cilët punojnë në institucione dhe struktura të tjera publike ose private, puna e të cilëve, e paguar ose vullnetare, përfshin kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët. Kontakti i drejtpërdrejtë mund të jetë fizik (ndarja e hapësirave të përbashkëta me fëmijët) apo nëpërmjet komunikimit verbal (i shkruar apo elektronik).

3. Punonjësit që punojnë në strukturat për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësit që punojnë me fëmijët duhet të plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

a) Të mos jenë të dënuar me vendim të gjykatave shqiptare dhe/ose të huaja për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje, sipas përcaktimeve në kreun II, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal;

b) Të mos jetë marrë ndaj tyre, nga gjykatat shqiptare dhe/ose të huaja, asnjë vendim që lidhet me masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje;

c) Të kenë trajnimin dhe certifikimin në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, përveç kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 45*. Tiranë 2019. f. 3811.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) Të ketë formim universitar si punonjës social;
- b) Të ketë formim pasuniversitar ose përvojë pune në profesionin përkatës, jo më pak se dy vjet.
5. Për punonjësit që punojnë në strukturat për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit që punojnë me fëmijët, të cilët përfshihen në fushën e veprimit të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, kriteret e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi, janë kriteret shtesë, përveç atyre të përcaktuara sipas legjislacionit të nëpunësit civil.
6. Për qëllime të vërtetimit të kriterëve të përcaktuara nga nenet 45, pika 1, e 49, pika 2, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, punonjësit përkatës të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit që punojnë me fëmijët duhet të plotësojnë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) Dëshmi të gjendjes gjyqësore, në rastin kur struktura, ku kjo dëshmi duhet të dorëzohet, nuk ka akses në sistemin e institucionit që e lëshon atë;
- b) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, në rastin kur dëshmia e gjendjes gjyqësore duhet të dorëzohet në struktura, të cilat kanë akses në sistemin e institucionit që e lëshon atë;
- c) Fotokopje të noterizuar të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës e noterizuar;
- d) Dëshmi për trajnimet e kandidatit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe/ose për trajnimin dhe certifikatën në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
- dh) Rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm.
7. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, punëdhënësit përkatës bëjnë verifikimin e plotësimit të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim për punonjësit, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë të punësuar në strukturat përkatëse dhe për ata, të cilët punojnë me fëmijët.
8. Në rast se nga verifikimi i bërë nga punëdhënësit përkatës rezulton që punonjës të caktuar nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, punëdhënësit, brenda 3 (tre) vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, marrin masa për të siguruar plotësimin e kriterëve nga punonjësit, të cilët punojnë në strukturat për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët.
9. Në rast se punonjësit, të cilët punojnë në strukturat për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, edhe pas marrjes së masave nga punëdhënësi, marrëdhënia e punës ndërmjet tyre ndërpritet sipas legjislacionit në fuqi.
10. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijës, në nivel qendror e vendor, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 465, datë 3.7.2019

PËR MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA AKSESI NË PËRMBAJTJE TË PALIGJSHME DHE/OSE TË DËMSHME NË INTERNET¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme dhe/ose të paligjshme në internet, sipas përcaktimeve të nenit 27, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
2. Në zbatim të këtij vendimi, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:
- **“Kontroll i aksesit”**, metoda për të parandaluar aksesin e pakufizuar ndaj përmbajtjes së paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet nga përdoruesit nën moshën 18 vjeç;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 97*. Tiranë 2019. f. 7084.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- **“Sipërmarrës”**, çdo person fizik, juridik, i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike sipas përcaktimit të bërë në legjislacionin për komunikimet elektronike;

- **“Përmbajtje e paligjshme”**, çdo pamje, imazh dhe material tjetër, që qarkullon në internet, dhe që, sipas legjislacionit në fuqi, është i ndaluar dhe pasi përbën vepër penale;

- **“Përmbajtje e dëmshme për fëmijën”**, sipas përkufizimit të bërë në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

- **“Ofruesi i shërbimeve mediatike”**, çdo ofrues, sipas përkufizimit të bërë në legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

3. Institucionet e arsimit parauniversitar, publike ose private, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe çdo institucion që mundëson dhe shërben aksesin në internet për fëmijë, në të gjitha mjediset e tyre, ku ofrojnë shërbimin e internetit, duhet të zbatojnë kriteret teknike, si më poshtë vijon:

a) Të aplikojnë kontrollin e aksesit mbi shërbimin e internetit dhe, nëse verifikohet se ka përmbajtje të dëmshme dhe/ose të paligjshme, të mos lejohet aksesimi i faqes nga fëmijët dhe të rriturit, kur ka fëmijë në të njëjtin mjedis ku ofrohet ky shërbim;

b) Të përdorin kontrolle aksesit, si në shkronjën “a”, të kësaj pike, për sipërmarrësit, nëpërmjet lokalizimit të pajisjeve portabël, të cilat ofrojnë akses në internet për fëmijët, kur ato përdoren në këto institucione.

4. Ofruesit e shërbimeve mediatike, në çdo rast, sigurojnë marrjen e masave për ndalimin e publikimeve me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët, sipas këtij vendimi dhe ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

5. Sipërmarrësit janë të detyruar të bllokojnë menjëherë çdo faqe/material me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në internet, që publikohet në portalin e bllokimit të faqeve të paligjshme të administruara nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Sipërmarrësit kanë detyrimin që të ofrojnë mundësitë teknike për prindërit dhe institucionet arsimore të lartpërmendura, në mënyrë që ata të kenë mundësinë e kontrollit të aksesit për fëmijët.

6. Në subjektet tregtare, që ofrojnë shërbimin e internetit për të tretë ose lojëra *on-line*, ndalohet hyrja e fëmijëve nën moshën 14 vjeç, të pashoqëruar nga, të paktën, njëri prej prindërve të tyre, kujdestari apo i afërm madhor, me lidhje të afërt familjare me fëmijën. Ky detyrim afshohet në mënyrë të dukshme në hyrje të subjektit tregtar që ofron shërbimin e internetit për të tretë ose lojëra *on-line*.

Në këtë rast prindi, kujdestari i fëmijës apo i afërmi që shoqëron fëmijën, nënshkruan, para se t’u ofrohet shërbimi, formularin tip, që përcaktohet nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Në rast se nuk nënshkruhet ky formular, fëmijës nuk i ofrohet shërbimi i internetit ose i lojërave *on-line*.

Për fëmijët deri në moshën 18 vjeç shërbimi i internetit ofrohet vetëm në kompjuterë që respektojnë kriteret teknike të pikës 4, të këtij vendimi.

7. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës shqyrton çdo raportim nga të tretë, çdo rast të konstatuar gjatë veprimtarisë së vet lidhur me faqe/materiale me përmbajtje potencialisht të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në internet dhe:

- në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive, merr masat përkatëse për bllokimin e tyre, në rast konstatimi të publikimeve me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët nga ofruesit e shërbimeve mediatike;

- në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, merr masa për bllokimin e faqeve, në rastet kur verifikohet se faqet/materialet janë me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të papërshtatshme për fëmijët në internet dhe i publikon ato në portalin për bllokimin e faqeve me përmbajtje të paligjshme, të administruar nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

8. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në rastet e përcaktuara në pikën 7, të këtij vendimi, merr masa për referimin e rastit pranë strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijës, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës vendos në dispozicion linja aksesit për fëmijët dhe publikun, vetë ose në bashkëpunim edhe me organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, me qëllim raportimin e materialeve të dëmshme ose të paligjshme për fëmijët në internet apo rasteve të tjera të abuzimit me fëmijët, nëpërmjet:

a) mjeteve të komunikimit telefonik;

b) raportimeve *on-line* në faqen e *web-it* të dedikuar.

10. Ministri përgjegjës për fushën e arsimit dhe ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, brenda 6 muajve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët listën e veprimeve që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij.

11. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 6, datë 21.5.2014

**PËR PROCEDURAT E SISTEMIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET
REZIDENCIALE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR, PUBLIKE DHE JOPUBLIKE¹**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.6.2012, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”,

UDHËZOJ:

Pranimi i personave në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publik dhe privat, bëhet me vendim të Shërbimit Social Shtetëror për institucionet e varësisë së tyre, me vendim të këshillit të qarkut apo këshillit të bashkisë/komunës për institucionet e varësisë së tyre, pasi të jetë plotësuar dokumentacioni i përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.6.2012, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”.

1. Për fëmijët e moshës 0-18 vjeç, subjekti publik dhe jopublik, që ofron shërbime rezidenciale të përkujdesit social, ku vendoset të sistemohet fëmija, paraqet kërkesën për marrjen e kujdestarisë së tyre pranë gjykatës së rrethit të vendbanimit apo vendqendrimit të fëmijës, 12 muaj pas vendosjes së fëmijës në institucion, në zbatim të vendimit të nxjerrë nga gjykata, fëmija qëndron në institucion deri në moshën 18 vjeç.

2. Brenda 12 muajsh, që nga koha e vendosjes së fëmijës në institucion, me vendim komisioni të Shërbimit Social Shtetëror ose me vendim të këshillit të qarkut apo këshillit të bashkisë/komunës për institucionet e vartësisë së tyre, publike apo jopublike, për fëmijët të cilët janë me interesim nga familja e tyre ose kanë të afërm familjarë, duhet të përgatitin dokumentacionin për t’u kthyer në familjen biologjike, duke i mbështetur me ofrimin e shërbimeve komunitare, pranë vendbanimit të familjes së fëmijës, ose në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 26.1.2012, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë”, të përfshihen në shërbimin e kujdestarisë së përkohshme.

3. Drejtuesi i institucionit, kur gjykata me vendim të formës së prerë ka vendosur sistemimin e fëmijës në institucion, brenda 10 ditëve dërgon në gjykatë emrin e punonjësit të cilit i delegohet e drejta e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit. Ky dokument depozitohet në dosjen gjyqësore dhe pasqyrohet në regjistrin e kujdestarisë së gjykatës.

4. Për fëmijët që mbushin moshën 16 vjeç në institucionet e përkujdesit 6-16 vjeç, të cilët ndjekin arsimin e mesëm dhe vendosen në konviktet e shkollave, drejtuesi i institucionit duhet të ndjekë ecurinë e fëmijës në

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 100*. Tiranë 2014. f. 3912.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

bashkëpunim me personat përgjegjës të konviktit ku është vendosur fëmija dhe gjatë periudhës së pushimeve gjatë të cilave konviktet janë të mbyllura, të marrin përsipër akomodimin e fëmijës në institucionin e përkujdesit.

5. Për fëmijët, të vendosur me vendim gjykate në institucionin e përkujdesit shoqëror, publik apo jopublik, të cilët janë shpallur të braktisur me vendim gjykate, përgatitet dokumentacioni në përputhje me listën sipas modularit nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe dërgohet, rast pas rasti, në Komitetin Shqiptar të Birësimeve për fillimin e procedurave për birësim.

6. Institucioni rezidencial i përkujdesit shoqëror, publik apo jopublik, në kujdestarinë e të cilit është fëmija, krijon një dosje personale ku arkivohet dokumentacioni i përcaktuar në kreun I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror", si dhe dosje për planet e përkujdesjes në institucion në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 17.10.2005, "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale".

7. Dosja me dokumente personale dhe dosja e planit të përkujdesit e shoqëron fëmijën në rastet e kalimit nga institucioni 0-3 vjeç në institucionet 3-6 vjeç dhe më pas në institucionet 6-18 vjeç.

8. Kalimi i fëmijëve nga një institucion rezidencial i përkujdesit shoqëror në tjetrin, sipas grup-moshës së tyre bëhet me vendim të komisionit të SHSSH-së, qarkut/bashkisë/komunës, në varësi të të cilit ai funksionon, si dhe shoqërohet me një procesverbal të institucioneve të origjinës dhe atyre pritëse. Institucioni, nga i cili transferohet fëmija, kryen procedurat pranë gjykatës për çregjistrimin në institucionin e origjinës dhe regjistrimin e kujdesit të ri në institucionin pritës.

9. Prindërit biologjikë, të afërmit e fëmijës apo familja kujdestare, që kërkojnë të marrin kujdestarinë e fëmijëve të vendosur në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publik ose privat, i drejtohen gjykatës për të vendosur transferimin e kujdestarisë së fëmijës nga institucioni te personi/familja kujdestare kërkuuese.

10. Vendimit të gjykatës për vendosjen e fëmijës në kujdestari jashtë institucionit, i paraprihet me një vlerësim të situatës social-ekonomike të familjes që kërkon kujdestarinë, i cili përgatitet nga seksioni i ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, në nivel vendor, si dhe me një vlerësim social dhe psikologjik të fëmijës që përgatitet nga institucioni rezidencial i përkujdesit shoqëror, publik apo jopublik, ku ndodhet fëmija.

11. Një kopje origjinale e vendimeve të gjykatës për vendosjen në kujdestari të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publik apo jopublik, si dhe një kopje origjinale e vendimit për heqjen e kujdestarisë nga institucioni, do të mbeten në institucionet e fundit të qëndrimit së bashku me dosjet e fëmijës.

12. Transferimi i fëmijës nga institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publik ose privat, në familjen kujdestare, bëhet në bazë të urdhrit të ekzekutimit, të nxjerrë nga gjykata dhe pasohet me një procesverbal midis titullarit të institucionit dhe familjes kujdestare që merr fëmijën në kujdestari. Familja kujdestare ka të drejtë të informohet mbi dokumentacionin që gjendet në dosjen për planet e përkujdesjes në institucion të fëmijës.

13. Institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publik dhe jopublik, krahas dosjes së fëmijës mbajnë edhe një regjistër sipas modularit nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

14. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

Modular nr. 1

Lista e dokumentacionit që paraqitet në komitetin shqiptar të birësimeve

1. Kërkesë e institucionit rezidencial të përkujdesit shoqëror drejtuar Komitetit Shqiptar të Birësimeve, për birësimin e fëmijës.

2. Certifikatë e lindjes.

3. Certifikatën e prindërve biologjikë të fëmijës, nëse ata njihen.

4. Procesverbalin për marrjen e fëmijës nga materniteti, nëse është marrë prej këtij institucioni ose procesverbalin e strukturave të tjera shtetërore, të cilat kanë gjetur fëmijën.

5. Vendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror për sistemimin e fëmijës në institucionin rezidencial të përkujdesit shoqëror.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

6. Vërtetim i cili dokumenton pranimin e fëmijës në institucionin rezidencial të përkujdesit shoqëror, pas marrjes së vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së.

7. Deklaratën me shkrim të prindit biologjik për pëlqimin për birësim ose vendimin gjyqësor që ka dhënë pëlqimin për birësimin e fëmijës, ose vendimin gjyqësor që e ka deklaruar fëmijën të braktisur.

8. Kërkesë e institucionit rezidencial të përkujdesit shoqëror për shpalljen e fëmijës si i braktisur.

9. Vërtetim i institucionit rezidencial të përkujdesit shoqëror që nuk ka pasur interesim.

10. Raport për gjendjen psikologjike, fizike dhe sociale të tij.

11. Raport për gjendjen shëndetësore ekzistuese dhe historikun mjekësor.

12. Mendimin e fëmijës, nëse ai ka mbushur moshën 10 vjeç, duke pasur parasysh aftësinë e tij për të arsyetuar.

13. Pëlqimin e fëmijës për birësim, nëse ai ka mbushur moshën 12 vjeç.

14. Raport me të dhëna mbi historikun mjekësor të prindërve, nëse ata dihen, dhe informacion për shtatzëninë dhe lindjen.

Prepektura _____

Rrethi _____

Bashki/komune _____

Institucioni _____

mb-2

Nr	Emër/Misioner	Ditëlindja	Vendndje	Gjinia		Situata Sociale				Vendimi i Komitetit për pranimin në institucion	Vendimi i gjykatës për çelësin e kujdestarisë	Datjet/Tranferime				Vendimi i Komitetit për largimin/institucionin e fëmijës	Vendimi i gjykatës për çelësin e kujdestarisë pas largimit
				Mashkull	Femër	Jetë Biologjik	Jetë Social	Me interesim	Pë llogarit			Ne prapë birësimi	Të bërë	Kërkim në fëmijë biologjike	Llogarit /Transferimet		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	
13																	
14																	
15																	
16																	
17																	
18																	
19																	
20																	
21																	
22																	
23																	
24																	
25																	
26																	
27																	
28																	

Shënim : Ky formular është i detyrueshëm çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas Vëzhg. Nr. 209 datë 12.04.2006

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 658, datë 23.9.2019

PËR PROCEDURAT DHE VEPRIMET QË NDËRMARRIN STRUKTURAT ARSIMORE, NË BASHKËPUNIM ME STRUKTURAT E MBROJTJES SË FËMIJËS, NË RASTET KUR NË MJEDISËT E INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR, PUBLIK OSE PRIVAT, KONSTATOHET SE NJË FËMIJË ËSHTË DUKE AKSESUAR NË INTERNET PËRMBAJTJE TË PALIGJSHME DHE /OSE TË DËMSHME PËR MOSHËN E TIJ¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të nenit 10, të vendimit nr. 465, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesimi në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet”, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

UDHËZOJNË:

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 140*. Tiranë 2019. f. 11598.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij.

2. Qëllimi i këtij udhëzimi është të garantojë mbrojtjen e fëmijëve nga aksesimi në materiale me përmbajtje të dëmshme dhe/ose të paligjshme në internet.

3. Ky udhëzim ka në themel parimet e përgjithshme të interesit më të lartë të fëmijës, barazisë dhe mosdiskriminimit, ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënave personale.

4. Në zbatim të këtij udhëzimi përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) “Përmbajtje e paligjshme” është çdo pamje, imazh dhe material tjetër, që qarkullon në internet, dhe që, sipas legjislacioni në fuqi, është i ndaluar dhe pasi përbën vepër penale.

b) “Përmbajtje e dëmshme për fëmijën” është çdo pamje, imazh dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cenon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.

KREU II PROCEDURAT DHE VEPRIMET E STRUKTURAVE ARSIMORE

1. Çdo mësues, mësuesndihmës dhe çdo punonjësi i institucionit arsimor (psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari), në rast se në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstaton një nxënës që është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij, ka detyrimin të raportojë pranë drejtorisë së institucionit arsimor, institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar (në vijim “IAVPAP”), organeve të Policisë së Shtetit dhe strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës.

2. Mësuesit, mësuesit ndihmës dhe punonjësit e institucionit arsimor raportojnë rastet e identifikuar pranë drejtorisë së institucionit arsimor dhe IAVPAP-së, me çdo mjet komunikimi, me telefon, e-mail, me postë, në formë shkresore etj.

3. Drejtori i institucionit arsimor dhe drejtori i IAVPAP-së, brenda 24 orëve nga identifikimi, raportojnë rastin pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijës me çdo mjet komunikimi.

4. Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje sipas aneksit 2, të vendimit nr. 578, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

5. Formulari i plotësuar dërgohet në rrugë elektronike apo me postë te punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, përgjegjës për territorin ku është bërë identifikimi i rastit. Në formular hidhet i gjithë informacioni dhe të gjitha detajet e njohura nga personi/personat, të cilët janë në dijeni dhe kanë raportuar rastin.

KREU III PROCEDURAT DHE VEPRIMET E STRUKTURAVE TË MBROJTJES SË FËMIJËS

1. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki ose njësi administrative, pas marrjes së raportimit, ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin ose jo të vlerësimit fillestar të rastit.

2. Pas verifikimit të informacionit dhe vlerësimit fillestar të rastit, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës njofton Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës e cila sipas ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike” i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masa për bllokimin e aksesit në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit dhe në faqet e internetit.

3. Punonjësi mbrojtjes së fëmijës organizon takime këshilluese, ndërgjegjësuere me prindërit dhe fëmijën. Në rastin kur vlerësohet se janë të pamjaftueshme seancat e këshillimit ndaj prindërve të fëmijës, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashkëpunim me Njësinë e Vlerësimit e Referimit të Rasteve marrin masa për hartimin e planit për aftësim prindëror i cili përmban masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror duke marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

4. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore, marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, për të lehtësuar raportimin.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

5. Njoftimi me informacionin e kontaktit duhet të përmbajë:
- a) strukturat ku mund të raportohet dhe adresat përkatëse;
 - b) numrin e telefonit në dispozicion dhe adresat e email-it;
 - c) informacion që raportimi mund të bëhet në çdo kohë;
 - d) informacion që të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas legjislativi për mbrojtjen e të dhënave personale;
 - e) informacion që punonjësit e çdo strukture, të cilët marrin raportimin dhe ata që do të ndjekin çështjen e raportuar, kanë detyrimin për të ruajtur anonimitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU III

RREGULLA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETIN E ÇËSHITJES

1. Të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim sipas këtij ligji, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislativin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Punonjësit e çdo strukture, të cilat marrin raportimin dhe ata që do të ndjekin çështjen e raportuar, kanë detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin e çështjes dhe mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës dhe të personit të dyshuar për abuzim.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo mospërmbushje e detyrimit ligjor për raportimin e rastit nga strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës konsiderohet kundërvajtje administrative sipas nenit 69, të ligjit nr. 18/2017.
2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, që nëpërmjet punonjësve të mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim edhe me ekspertë të fushës të organizojë trajnime për institucionet arsimore parauniversitare, publike ose private, lidhur me identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve kur identifikohet një fëmijë që është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe /ose të dëmshme për moshën e tij.
3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, vetë ose nëpërmjet punonjësve të mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim edhe me ekspertë të fushës zhvillon fushata ndërgjegjëse lidhur me parandalimin e rasteve dhe mbrojtjen e fëmijëve nga aksesimi në përmbajtje të paligjshme dhe/ ose të dëmshme në internet.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, strukturat për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Ogerta Manastirliu

VENDIM

Nr. 551, datë 31.7.2019

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PESTË DHE TË GJASHTË PERIODIK KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E KONVENTËS SË OKB-së “PËR TË DREJTAT E FËMIJËS” DHE TË DY PROTOKOLLEVE OPSIONALE TË SAJ “PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË KONFLIKT TË ARMATOSUR” DHE “PËR SHITJEN E FËMIJËVE, PROSTITUCIONIN E FËMIJËVE DHE PORNOGRAFINË ME FËMIJË”¹²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 7531, datë 11.12.1991, “Për ratifikimin e konventës së

¹ Në lidhje me tekstin e raportit të sipërcituar mund të konsultoheni me linkun <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/07/31/551/737a9679-32c1-494a-8ee1-56ed6f8b2b13;q=551>

² Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 115*. Tiranë 2019. f. 8583.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

OKB-së “Për të drejtat e fëmijës”¹, të ligjit nr. 9834, datë 22.11.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë”, dhe të ligjit nr. 9833, datë 22.11.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të pestë dhe të gjashtë periodik kombëtar për zbatimin e konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijës” dhe të dy protokolleve opsionale të saj “Për përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur” dhe “Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 394, datë 9.5.2019

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT MULTIDISCIPLINAR, SI DHE PROCEDURAT DHE ZBATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMIT TË PËRKUJDESJES ALTERNATIVE PËR FËMIJË NË FAMILJE KUJDESTARE¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikave 6 dhe 4, të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE MULTIDISCIPLINORE TË KUJDESTARISË

1. Në çdo Bashki ngrihet dhe funksionon komisioni multidisiplinor i kujdestarisë. Ky komision ka në përbërje:

- a) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki;
- b) drejtuesin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës;
- c) punonjës social të njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ku ka gjendjen civile familja e fëmijës që do të vendoset në kujdestari dhe/ose familja kujdestare;

d) jurist;

e) psikolog;

f) specialist për çështjet e arsimit në Bashki;

g) specialist për çështjet e shëndetësisë në Bashki.

2. Komisioni multidisiplinor i kujdestarisë është përgjegjës, për:

a) vlerësimin nëse familja që ka shprehur interesin për të qenë familje kujdestare, plotëson kushtet për të ofruar shërbimin e kujdestarisë në familje, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur;

b) merr vendim për miratimin e familjes kujdestare dhe përfshirjen e saj në regjistrin e familjeve kujdestare të Bashkisë;

c) përzgjedh familjen kujdestare ku do të vendoset fëmija, që ka të nevojshëm shërbimin e kujdesit në familje kujdestare, duke gjykuar mbi përshtatshmërinë sa më mirë të nevojave të fëmijës me familjen, e cila propozohet si familje kujdestare.

3. Në çdo bashki, struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të ketë ngritur dhe administrojë regjistrin e familjeve kujdestare, duke mundësuar kështu ekzistencën e disa familjeve të gatshme për të marrë në përkujdesje si raste emergjente fëmijë, për të cilët është dhënë masa emergjente mbrojtjes apo familje të

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 89*. Tiranë 2019. f. 6373.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

gatshme për të vijuar procedurat në Gjykatë, për marrjen e kujdestarisë së përkohshme për fëmijën pa kujdes prindëror.

4. Komisioni multidisiplinar për vlerësimin e rasteve të kujdestarisë, mbledhet me kërkesën e strukturës përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare dhe brenda këtyre afateve:

- a) për miratimin e familjes kujdestare, brenda 30 ditëve nga paraqitja e dosjes nga struktura përgjegjëse.
- b) për përzgjedhjen e familjes kujdestare ku do të vendoset fëmija, që ka të nevojshëm shërbimin e kujdestarisë, brenda një afati 7-ditor nga paraqitja e dosjes nga struktura përgjegjëse.

II. PROCEDURAT PËR VENDOSJEN E FËMIJËS NË SHËRBIMIN E PËRKUJDESJES ALTERNATIVE, NË FAMILJE KUJDESTARE

5. Procedura e vendosjes së fëmijës në përkujdesje alternative ndodh, kur:

- a) prindërit e fëmijës kanë vdekur ose janë shpallur të vdekur nga gjykata, janë të panjohur, u është hequr përgjegjësia prindërore dhe janë në kushte nevojë për mbrojtje;
- b) prindi ose kujdestari ligjor i të cilit është shoqëruar, ndaluar, arrestuar ose dënuar me heqje lirie dhe fëmija është në nevojë emergjente mbrojtjeje;
- c) kur, në interesin e tij më të lartë, nuk mund të lihet në kujdesin prindëror, për shkak se rrezikohet integriteti i tij fizik, moral, psikologjik e emocional;
- ç) është abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar ose neglizhuar;
- d) është braktisur nga prindërit që në lindje ose është nën moshën 16 vjeç dhe askush nuk është duke u kujdesur për të;
- dh) ka kryer një vepër penale dhe për shkak të moshës, nuk ka përgjegjësi penale;
- e) ka, dyshohet ose akuzohet, ose është dënuar se ka kryer një vepër penale, është në gjendje të lirë dhe ka nevojë për mbrojtje.

6. Vendimi për ta vendosur fëmijën në familje kujdestare bazohet në një vlerësim shumë të kujdesshëm të nevojave të fëmijës dhe i arsyeye pse prindërit dhe familja e fëmijës nuk e kanë mundësinë t'i përgjigjen këtyre nevojave.

7. Gjatë procesit të vlerësimit për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare punonjësi social përgjegjës siguron që:

- a) vlerësimi për të vendosur fëmijën në shërbimin e kujdesit në familje kujdestare bëhet pjesë e Planit Individual të Fëmijës dhe diskutohet me të gjitha palët. Planit Individual detajon formën e kujdesit alternativ të nevojshëm për fëmijën, periudhën kohore, objektivat dhe qëllime të qarta, si dhe personat përgjegjës;
- b) fëmija dhe prindërit e tij/saj dhe/ose kujdestarët ligjor dëgjohen dhe përfshihen aktivisht në këto procese;
- c) në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit fëmija përfshihet në përgatitjen e planit individual dhe në përcaktimin e objektivave dhe aktiviteteve;
- ç) fëmija informohet dhe shpreh lirshëm dëshirat që ka vazhdimisht;
- d) pjesë e planit individual është edhe mundësia e kontakteve mes fëmijës dhe prindërve biologjik, pjesëtarëve të familjes dhe personave që kanë rol të rëndësishëm në jetën e fëmijës;
- dh) fëmijës dhe prindërve të fëmijës i jepet mbështetje maksimale gjatë procesit të marrjes së vendimit për kalimin në familje kujdestare, si dhe pas vendosjes së fëmijës në familjen kujdestare;
- e) motrave dhe vëllezërve u jepet mundësia që të jetojnë bashkë, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë bie ndesh me interesin më të lartë të tyre. Nëse nuk vendosen në të njëjtën familje kujdestare, merren masa që të ruhen lidhjet dhe kontaktet mes tyre.

8. Procedurat e vendosjes së një fëmijë në kujdes alternative do të ndjekin të njëjtën logjikë si për menaxhimin e një rasti, të parashikuar në VKM-në respektive, që rrjedh nga ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, sipas udhëzuesit në Aneksin bashkëngjitur këtij udhëzimi.

9. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale, strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ardiana Jaku

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ANEKS

UDHËZUESI I OFRIMIT TË PËRKUJDESIT ALTERNATIV PËR FËMIJË NË FAMILJE KUJDESTARE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzuesi është përcaktimi i procedurave, detyrave dhe përgjegjësi të strukturave përgjegjëse për zbatimin e standardeve në ofrimin e përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare.

2. Ky udhëzues përmban procedurat, që duhet të ndiqen për të vendosur fëmijët pa kujdes prindëror në shërbimin e përkujdesjes alternative në familje kujdestare dhe synon të njehsojë rregullat dhe procedurat të cilat duhet të njihen, ndiqen dhe zbatohen nga të gjitha institucionet publike dhe jopublike që kanë detyrimin ligjor për ofrimin e këtij shërbimi.

3. Udhëzuesi mban në konsideratë faktin që familja është mjedisi më i mirë ku duhet të rriten fëmijët. Prindërit dhe fëmija janë aktorët dhe partnerët më të rëndësishëm për të përmirësuar situatën e fëmijës, por kur vërtetohet se familja nuk e mbron fëmijën apo në rastin më të keq, është abuzuesi i fëmijës, strukturat shtetërore kanë përgjegjësinë për të ndërhyrë edhe në familje.

II. PARIMET E SHËRBIMIT TË PËRKUJDESJES ALTERNATIVE PËR FËMIJË NË FAMILJET KUJDESTARE

4. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për të. Të gjitha vendimet që merren duhet të kenë si konsideratë kryesore interesin më të lartë të fëmijës.

5. Shërbimi ofrohet në përputhje me nevojat e fëmijës. Fëmijës i ofrohet shërbim kujdestarie duke marrë në konsideratë moshën, nivelin e zhvillimit, nevojat individuale të vlerësuara, gjendjen shëndetësore, aftësi të kufizuara të mundshme, gjininë, situatën familjare, kulturën, përkatësinë etnike dhe besimin fetar. Vlerësimi i nevojave të fëmijës kryhet përpara se fëmija të sistemohet në familjen kujdestare, me përjashtim të rasteve të emergjencës kur vlerësimi i nevojave të fëmijës bëhet pas sistemimit, por sa më shpejtë të jetë e mundur.

6. Konfidencialiteti. I gjithë informacioni i mbledhur do të përdoret vetëm për të përcaktuar nevojat e fëmijës dhe për ta mbrojtur atë nga dëmtimi, duke mbrojtur privatësinë dhe identitetin e fëmijës. Çdo e dhënë për çdo fëmijë duhet të mbahet e ruhet në një vend të sigurt.

7. Respektimi dhe promovimi i të drejtës së fëmijës për mbrojtje, përkujdesje dhe për t'u dëgjuar. Çdo fëmijë do të trajtohet me respekt dhe në përshtatje me zhvillimin e tij/saj individual, si dhe me nevojat dhe të drejtat për mbrojtje.

8. Pjesëmarrja në vendimmarrje. Fëmija i vendosur në familje kujdestare ka të drejtë të shprehë lirish mendimin e tij/saj për të gjitha çështjet dhe vendimet që kanë të bëjnë me të. Në bazë të informacionit që i ofrohet në përputhje me moshën ai/ajo bën zgjedhjet dhe ka pikëpamjet e veta të pavarura, përfshirë edhe ankimet të cilat duhen dëgjuar dhe konsideruar në të gjitha vendimet e marra lidhur me mirëqenien e tij/saj.

9. Mosdiskriminimi. Çdo fëmijë pa kujdes prindëror merr të njëjtin shërbim ose ndihmë dhe nuk do të diskriminohet si rezultat i statusit që ka, të etnisë, gjinisë, besimit fetar, moshës, vendndodhjes ose aftësisë.

10. Partneriteti dhe bashkëpunimi. Mbrojtja e fëmijës dhe promovimi i mirëqenies së tij/saj është një përgjegjësi e përbashkët dhe duhet të përfshijë gjatë procesit të vendimmarrjes të gjitha strukturat dhe shërbimet, fëmijët, familjen biologjike dhe familjen kujdestare.

11. Sigurimi i pavarësisë, integrimi social dhe pjesëmarrjes në jetën komunitare të fëmijës. Planet për fëmijën duhet të promovojnë aftësinë e familjes për t'u kujdesur në mënyrën e duhur, për të zhvilluar pavarësinë e tij/saj dhe për të inkurajuar integrimin social dhe pjesëmarrjen në komunitet.

12. Respektimi i përgjegjësi, të drejtave dhe detyrave që kanë prindërit për fëmijën: Prindërit biologjik të fëmijës marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve dhe ruajnë kontaktet me fëmijën në një formë të dakordësuar në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

13. Prindërit kujdestarë të fëmijës marrin pjesë aktivisht dhe bashkëpunojnë me ekipin e profesionistëve të shërbimit të kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare, si dhe përfshihen në vendimmarrjet dhe planet e kujdesit për fëmijën. Familjet kujdestare sigurojnë një ambient të sigurt, të shëndetshëm dhe pozitiv për fëmijët.

Shkurtime:

VKM -Vendim i Këshillit të Ministrave

PIM - Plan individual i Mbrojtjes

MGJ - Marrëdhënie Gjaku

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

RKGJC - Regjistri Kombëtar i Gjëndjes Civile

NJVNR - Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit

NJMF Njësia e Mbrojtjes së fëmijëve

Përkujdesi alternativ

14. Fëmija i privuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga mjedisi i tij familjar, për shkak se prindërit kanë vdekur ose mbi bazë të një vendimi gjyqësor apo kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojnë në këtë mjedis, për shkak të një mase mbrojtjeje, vendoset në përkujdesje alternative. Në zbatimin e kësaj mase, i jepet përparësi vendosjes së fëmijës në një mjedis familjar, sipas interesit më të lartë të fëmijës.

15. Rastet më tipike kur aplikohet përkujdesja alternative janë:

a) vendosja e fëmijës në familjen e ndonjërit nga të afërmit e tij, nëse kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës (kujdesi brenda lidhjes së gjakut, i cili mund të jetë formal ose jo formal);

b) vendosja e fëmijës në një familje kujdestare, në rast se prindërit biologjikë ose ndonjë i afërm tjetër nuk mund të kujdesen për fëmijën (kujdestari e përkohshme pa lidhje gjaku, është gjithmonë formale);

c) vendosja e fëmijës në një institucion të përkujdesit për fëmijët, për një periudhë sa më të shkurtër kohe.

16. Fëmija në nevojë për mbrojtje mund të vendoset në një nga format e mësipërme të përkujdesjes alternative për shkak të një mase mbrojtjeje.

17. Marrja e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative merr parasysh mosndarjen e motrave dhe vëllezërve.

18. Vendimi për marrjen e masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative është i vlefshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata për konfirmimin ose jo të saj dhe ka të njëjtat efekte si vendimi i gjyqësor për kujdestarinë.

19. Personat apo institucioni, pranë të cilit vendoset fëmija në përkujdesje alternative, ka të njëjtat detyra, përgjegjësi dhe të drejta si ato të kujdestarit, të parashikuara në Kodin e Familjes, ndërsa prindërit e fëmijës, gjatë kohës së vlefshmërisë së masës së mbrojtjes, nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

20. Gjatë zbatimit të kësaj mase mbrojtëse, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek me përparësi këto çështje:

a) trajtimin dhe gjendjen psiko-emocionale të fëmijës së vendosur në përkujdesje alternative;

b) ndihmën dhe krijimin e mundësive për prindërit për të mbajtur kontakte e marrëdhënie personale me fëmijët e tyre;

c) përgatitjen e dokumenteve përkatëse, të kërkuara nga gjykata në procesin gjyqësor, të konfirmimit ose jo të masës së mbrojtjes dhe të vendosjes së fëmijës në kujdestari;

ç) nevojën për ndryshimin apo heqjen e masës mbrojtëse, në varësi të progresit, kushteve dhe rrethanave të rastit.

21. Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e masës së mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. Ankimi shqyrtohet nga gjykata, së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës nga gjykata.

22. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e njëres prej alternativave të parashikuara më sipër, bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes dhe ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe aktet nënligjore respektive.

Procedurat për parandalimin dhe masat emergjente të mbrojtjes¹

23. Fëmijët rriten në familjet e tyre biologjike dhe kur është e nevojshme, familjet dhe fëmijët mbështeten me shërbime të kujdesit shoqëror. Prindërit biologjikë kanë përgjegjësinë ligjore të kujdesen për fëmijët e tyre dhe të mundësojnë mirëqenien dhe sigurinë e tyre. Në rastet kur familja nuk e përmbush dot këtë rol, atëherë ndërhyrja shteti.

24. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin të mbështesin prindërit në detyrën e tyre për të mirërritur fëmijët përmes ngritjes dhe funksionimit të sistemit të mbrojtjes sociale, me qëllim që të parandalojnë rastet e rritjes së fëmijëve në varfëri, neglizhimin apo abuzimin me fëmijët dhe për të mbështetur prindërit që t'u garantojnë fëmijëve një mjedis të shëndetshëm, të ndjekin shkollën dhe t'u mundësojnë atyre rritje dhe jetesë të përshtatshme.

¹ VKM nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes"

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

25. Masat kryesore, që struktura përgjegjëse në Bashki merr në funksion të garantimit të të drejtës së fëmijës për t'u rritur në familje janë:

a) Identifikim i hershëm: Njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes strukturave përgjegjëse duhet të kryejnë identifikim proaktiv i cili lejon trajtimin e të gjithë nevojave të fëmijëve duke parandaluar përshkallëzimin e problemeve. Identifikimi proaktiv realizohet kryesisht nëpërmjet punës së përditshme në terren. Identifikimi i fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo shërbime mund të kryhet nga vetë:

i. Fëmija/ përfituesi që kërkon mbështetjen (vetëreferimi).

ii. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ose punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore kur konstatohet situata e nevojës për shërbime.

iii. Agjenci të tjera publike dhe jopublike që mund të identifikojnë dhe të referojnë raste me të cilat hyjnë në kontakt.

b) Mbështetja për fuqizimin e familjes biologjike të fëmijës: Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve dhe/ose punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore vlerësojnë nevojat e fëmijës dhe familjes dhe rast pas rasti i referojnë tek shërbimet specifike sociale me qëllim krijimin e kushteve për vijimin e jetesës së fëmijës në familje biologjike.

c) Kur janë ezauruar të gjitha përpjekjet për të mbështetur fëmijën dhe familjen me shërbime që synojnë garantimin e jetesës së përshtatëshme të fëmijës në familjen biologjike dhe kur punonjësi i mbrojtjes së fëmijës vlerëson që fëmija është në situatë emergjence, vendoset për largimin e fëmijës nga familja biologjike dhe ofrimin e shërbimeve të tjera alternative në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, përmes marrjes së njëres prej masave të mbrojtjes:

i. masa emergjente e mbrojtjes, e cila është një masë e përkohshme mbrojtjeje për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative;

ii. masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative;

iii. masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

26. Në kuptimin e pikës 25/c/i, të këtij udhëzuesi, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës që informohet ose mendon në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në një situatë urgjente, ka detyrimin e ndërhyrjes së menjëhershme, vlerësimit të nivelit të rrezikut ndaj të cilit është ekspozuar fëmija dhe ndërmerr veprimet e mëposhtme para se të vazhdohet më tej me procesin e menaxhimit të rastit:

a) komunikon me fëmijën për të kuptuar situatën e tij;

b) informon fëmijën për hapat që duhen ndjekur;

c) largon fëmijën nga vendndodhja aktuale dhe e strehon atë në strehën e përkohshme më të afërt;

ç) ndihmon fëmijën duke e dërguar në spital ose informon menjëherë policinë në rast se është e nevojshme;

d) i kërkon drejtorit të strukturës përgjegjëse në Bashki dhënien e masës së emergjente të mbrojtjes.

27. Masa emergjente e mbrojtjes merret nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, apo vendimi i gjykatës për konfirmimin e saj, dhe gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj mase prindërit e fëmijës nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore. Ajo është një masë e përkohshme mbrojtjeje, e cila vendoset për fëmijën që ndodhet në situatat e mëposhtme:

a) kur fëmija vlerësohet të jetë në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo formë dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku fëmija qëndron nuk është e sigurt për fëmijën;

b) është braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;

c) është pa përkujdes prindëror, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situata të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

28. Largimi i fëmijës nga përkujdesja e familjes duhet të shihet si një masë e fundit dhe kur është e mundur, duhet të jetë i përkohshëm dhe me kohëzgjatje sa më të shkurtër. Vendimet për largime të tilla duhet të rivlerësohen rregullisht dhe rikthimi i fëmijës nën përkujdesjen prindërore, sapo shkaqet fillestare të largimit të jenë zgjidhur ose eliminuar, duhet të jetë në interesin më të mirë të fëmijës.

29. Kushtet e vështira financiare dhe materiale, ose kushtet që shkaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të veçantë një varfëri të tillë, nuk duhet të shërbejnë kurrë si një justifikim i vetëm për largimin e një fëmije nga përkujdesja prindërore, për vendosjen e tij nën përkujdesje alternative, ose për parandalimin e rintegritetit të tij/saj, por duhen parë si një sinjal për nevojën e ofrimit të mbështetjes së duhur për familjen.

30. I duhet kushtuar vëmendje promovimit dhe respektimit të të gjitha të drejtave të tjera në rastin e fëmijëve pa kujdes prindëror, përfshi por jo e kufizuar në të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor dhe të tjera shërbimeve bazë, të drejtën për identitet, liri apo besim fetare, të drejtën e gjuhës dhe të mbrojtjes së pronës dhe trashëgimisë.

31. Vëllezërit dhe motrat që aktualisht kanë lidhje midis tyre, parimisht nuk duhet të ndahen nga njëri-tjetri kur vendosen nën përkujdesje alternative nëse nuk ekziston ndonjë rrezik i qartë abuzimi apo justifikime të tjera në të mirë të interesave të fëmijëve. Në secilin rast, duhet bërë çdo përpjekje për t'i mundësuar vëllezërve dhe motrave që të ruajnë kontaktet me njëri-tjetrin, përveç rasteve kur kjo është në kundërshtim me dëshirën ose interesat e tyre.

Punonjësit socialë dhe të gjitha aktorët përgjegjës të përfshirë duhet të marrin në konsideratë:

32. Është e udhës, nëse është mundësia që fëmija të shprehë lirshëm mendimet dhe dëshirat e tij/saj (në bazë të marrjes së informacionit sa më të plotë të mundur), duke marrë në konsideratë pjekurinë e fëmijës dhe aftësinë për të vlerësuar pasojat e mundshme të çdo alternative të paraqitur.

33. Situata, qëndrimet, kapacitetet, mendimet dhe dëshirat e anëtarëve të familjes së fëmijës (prindërit, vëllezërit/motrat, të afërmit e rritur, "të tjerët" e afërt) dhe natyra e marrëdhënies së tyre emocionale me fëmijën.

34. Niveli i qëndrueshmërisë dhe sigurisë së ofruar nga mjedisi i përditshëm i fëmijës (qoftë me prindërit biologjikë, në kujdestarinë MGJ ose në kujdestari tjetër joformale, ose në kontekstin e kujdestarisë formale):

- aktualisht (vlerësimi i rrezikut të menjëhershëm);
- më parë në të njëjtin mjedis (vlerësimi i rrezikut të përgjithshëm);
- potencialisht në të njëjtin mjedis (p.sh., me çfarëdo ndërhyrje të nevojshme);
- potencialisht në çfarëdo konteksti tjetër kujdestarie që mund të merret në konsideratë.

35. Kur është e mundur konsideroni, efektet e ndarjes dhe potenciali për riintegrimin e familjes. Nevojat e veçanta të zhvillimit të fëmijës të lidhura me një paafësi fizike ose mendore, ose me karakteristika ose rrethana të tjera të caktuara. Çështje të tjera të përshtatshme. Për shembull:

- Etnia e fëmijës, besimi fetar ku ka lindur / është rritur, kulturor dhe/ose gjuhësor, kështu që, mund të bëhen përpjekje për të siguruar vazhdimësinë e edukimit dhe, në parim, ruajtjen e lidhjeve me komunitetin e fëmijës. Përgatitja për tranzicionin për të jetuar i/e pavarur.

36. Rishikimi i përshtatshmërisë së çdo alternative të kujdestarisë për plotësimin e nevojave të fëmijës, duke pasur parasysh të gjitha konsideratat e mësipërme.

37. Ky vlerësim duhet të jetë në bazë të vendimit për kujdestarinë e fëmijës. Të njëjtat pyetje mbi interesin më të mirë të fëmijës duhet të përsëriten kurdoherë që rishikohet një alternativë kujdestarie. Ky vlerësim duhet të bëhet para se fëmija të zhvendoset apo të merret në kujdestari. Kur fëmija është në rrezik dhe kur është e nevojshme mbrojtja e menjëhershme e tij, procesi i plotë PIM duhet të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe kujdestaria duhet të jetë vetëm për një periudhë afatshkurtër.

38. Përgatitja për kujdestarinë

Para kujdestarisë është e rëndësishme të realizohet të paktën një takim me fëmijën dhe kujdestarin.

1. Përgatitja e fëmijës

- Shpjegoji fëmijës se ku po shkojnë dhe më do të jetojnë, pse do të jetojnë atje, sa kohë do të zgjasë kujdestaria dhe kur do të zhvendosen.

- Jep sa më shumë informacion në lidhje me familjen/kujdestarin me të cilët ata do të jetojnë.

- Përkrahja e fëmijës çdo pjesëtar të familjes, me emrat, moshën, rolet në familje. Nëse fëmija do të ribashkohet me familjen e tij është e rëndësishme të informohet në lidhje me çdo ndryshim në familje që nga hera e fundit që aknë parë njëri tjetrin- lindjet, vdekjet etj.

- Shpjego çdo pritshmëri që familja kujdestare ka, p.sh., të ndihmuarit në punët e shtëpisë.

- Tregoji fëmijës që i ke treguar kujdestarit të tij për të, dhe në lidhje me hapat që duhet të plotësohen për kërkesat e veçanta që ai mund të ketë.

- Fëmija pyetet nëse ka ndonjë gjë tjetër që do të donte që familja/kujdestari ta dinte përpara se ata të zhvendosen në kujdestarinë e tyre, ose nëse ka ndonjë gjë të cilën nuk do të donin që familja/kujdestari të dinte ose që do të donin ta thoshin vetë.

- Tregoji fëmijës që janë bërë marrëveshjet që ata të jenë pjesë e familjes (p.sh., të gatuajnë për ta dhe të socializohen), të marrin pjesë në shërbime (p.sh., shërbimet në grup) dhe shpjego se ata mund të të raportojnë për çfarëdo problemi ose sfide që hasin.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- Informo fëmijën se sa shpesh do t'i vizitosh ata dhe kur do të jetë vizita e parë. Shpjego se ata do të kenë gjithmonë mundësinë që të flasin me ty privatisht në këto vizita dhe se si mund të të kontaktojnë kur është e nevojshme.

- Pyet nëse fëmija ka ndonjë pyetje ose shqetësim dhe përpiku t'u përgjigjesh atyre.

2. Përgatitja e familjes

- Tregoji kujdestarit të ri emrin e fëmijës, emrin e preferuar, moshën dhe gjininë, dhe çdo informacion të bekgarandit në lidhje me fëmijën dhe që fëmija ka rënë dakord që ta ndash me kujdestarin. Kujtoji kujdestarit se çfarëdo informacion i ndjeshëm është konfidencial.

- Konfirmo datën dhe orën e arritjes së fëmijës dhe kërkoji kujdestarit të përgatisë një mirëseardhje për fëmijën/ të përgatisë një festë lamtumire, nëse fëmija po largohet nga një kujdestari rezidenciale dhe është birësuar nga një familje.

- Konfirmo që fëmija do të ketë dhomën e tij për të fjetur dhe për të mbajtur sendet e tij.

- Shpjego çdo kërkesë në lidhje me ushqyerjen, shëndetin, dhe edukimin, dhe kujdestarinë që mund të ketë fëmija dhe punohet me kujdestarin se si mund të plotësohen këto kërkesa.

- Informo kujdestarin për çdo marrëveshje që është bërë, në mënyrë që fëmija të ndjekë shërbimet dhe shpjego se çfarë kërkohet nga ata, në mënyrë që të mbështesin fëmijën të kenë akses në këto shërbime.

- Tregoji kujdestarit se çfarë informacioni i është dhënë fëmijës në lidhje me punët e shtëpisë dhe pritshmëritë e tyre.

- Informo kujdestarin se duhet të të informojnë ty për çdo informacion të ri që fëmija u jep atyre, çdo sfidë ose çështje që haset etj.

- Informo kujdestarin sesa shpesh do t'i vizitosh ata dhe kur do të jetë vizita e parë. Shpjego se do të flasësh gjithmonë privatisht me fëmijën.

- Këshillo kujdestarin se sit ë kontaktojë me ty dhe me kë të kontaktojë nëse nuk mund të kontaktojë dot me ty.

3. Përfshirja e fëmijëve

Mekanizmat dhe strukturat mbështetëse do të ndihmojnë për t'u siguruar që zërat e fëmijëve të dëgjohen:

Në nivel kombëtar, duhet të ketë institucione të pavarura për të drejtat e njeriut si avokati i fëmijëve ose komisioneri i fëmijëve, i cili të jetë i aftë të mbështesë të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar në të gjitha situatat, duke përfshirë kujdestarinë MGJ.

Duhet të ketë mekanizma të përcaktuar për fëmijët në mënyrë që të komunikojnë ose raportojnë çështjet dhe/ose shqetësimet.

4. Kur merret në konsideratë perkujdesi alternativ:

- Të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, duhet të konsultohen në lidhje me vendimet se ku jetojnë. Nëse fëmijët janë shumë të vegjël për të folur, emocionet e tyre për kujdestarët mund të kuptohen nëse ata ndihen rehat me kujdestarin e tyre primar.

- Nëse një marrëveshje kujdestarie vlerësohet ose monitorohet, duhet të realizohen gjithmonë diskutime të veçuara me fëmijët në lidhje me kujdestarinë e tyre dhe gjithashtu në lidhje me këndvështrimet e tyre mbi shërbimet, të cilat mund të mbështesin fëmijët, familjet dhe kujdestarët e tyre.

- Të gjithë aktorët në komunitet duhet të sigurojnë që ka mënyra në të cilat fëmijët mund të ngrenë shqetësimet joformale. Shqetësimet e fëmijëve duhet të dëgjohen gjithmonë, të reagohej ndaj tyre dhe duke iu referuar një punonjësi social nëse është e nevojshme.

- Familjet kujdestare dhe të tjerët duhet të inkurajohen të ruajnë dokumentet e prejardhjes familjare dhe origjinës së fëmijës, kështu që fëmijët të kenë mundësi të kërkojnë për origjinën e tyre, nëse zgjedhin të bëjnë diçka të tillë.

Procedurat për evidentimin, vlerësimin dhe regjistrimin e familjes kujdestare¹

39. Kriteret e përgjithshme të përcaktimit të familjeve kujdestare janë:

1. Vlerësimi i familjes kujdestare

Në vlerësimin e familjes kujdestare do të merren parasysh strukturat dhe dinamikat familjare, funksionimi i saj, pjekuria emocionale, cilësia e marrëdhënieve bashkëshortore, mundësia për t'u kujdesur për fëmijën/ fëmijët në nevojë, si edhe gatishmëria për të qenë një familje kujdestare.

¹ Pikat 3–19 e VKM-së nr. 149, datë 13.3.2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare".

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Mosha

Aplikuesit për të qenë prindër kujdestarë, nuk duhet të jenë më pak se 25 vjeç dhe më shumë se 65 vjeç.

3. Marrëdhëniet me ligjin

Aplikuesit për të qenë prindër kujdestarë dhe anëtarët e familjes së tyre, duhet të mos kenë kryer vepra kriminale, si edhe referencat nga komuniteti të jenë të qarta për sjellje të pranueshme etike dhe moral (dëshmitë përkatëse). Aplikuesit për të qenë prindër kujdestar janë të gjithë personat, të cilët nuk përjashtohen në bazë të Kodit të Familjes dhe VKM-së për kujdestarinë.

4. Statusi financiar

Familja kujdestare duhet të ketë të ardhura të vazhdueshme dhe në masë të mjaftueshme, për të plotësuar nevojat e familjes.

5. Motivimi për të qenë prindër kujdestare

Prindërit kujdestarë, si dhe të gjithë pjesëtarët e familjes, duhet të jenë të motivuar për të siguruar mbrojtje, dashuri dhe kujdesje familjare për fëmijën/ fëmijët.

6. Aftësitë prindërore

Aplikantët duhet të demonstrojnë aftësi kujdesi dhe edukuese, durim, mirëkuptim, altruizëm, afeksion, fleksibilitet dhe empati ndaj nevojave të fëmijës.

7. Edukimi

Prindërit kujdestarë duhet të kenë kapacitete edukimi të nevojshme, për të siguruar një edukim sa më të mirë të fëmijës /fëmijëve.

8. Shëndeti

Të gjithë pjesëtarët e familjes duhet të gëzojnë shëndet të mire fizik dhe mendor.

9. Strehimi

Kujdestarët duhet të kenë strehim (sipërfaqe banimi), që të garantojë një mjedis të sigurt dhe kushte higjienike, të nevojshme këto për një shëndet të mirë dhe mirëritje të fëmijës/fëmijëve. Shtëpia duhet të ketë një dhomë të veçantë për fëmijët dhe krevat për çdo fëmijë.

10. Qëndrime jodiskriminuese

Aplikantët për të qenë prindër kujdestarë, nuk duhet të kenë qëndrimeve diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara apo minoriteteve etnike dhe duhet të respektojë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve.

11. Infrastruktura e komunitetit

Komuniteti në të cilin jeton aplikanti, duhet t'u ofrojë fëmijëve të vendosur në kujdestari mundësi për: edukim; kujdes shëndetësor; transport; mjedise zbatimëse.

12. Përfshirja e anëtarëve të familjes kujdestare

Përfshirja e të gjithë anëtarëve të familjes në marrjen e vendimit për të qenë një familje kujdestare është e domosdoshme.

13. Marrëdhëniet e familjes kujdestare me institucionet e përfshira në procesin e kujdestarisë

Familja kujdestare duhet të jetë gjithmonë e gatshme dhe e hapur për një bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Shërbimeve Sociale/Agjenci, Organizata, Gjykatën, Inspektoratin Shtetëror të Shërbimeve Shoqërore etj.

14. Marrëdhëniet e familjes kujdestare me familjen e origjinës

Të kuptojë, të pranojë dhe zbatojë parimet e bashkëpunimit me familjen biologjike të fëmijës.

40. Në çdo Bashki struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duhet të ketë ngritur dhe administrojë regjistrin e familjeve kujdestare, duke mundësuar kështu ekzistencën e disa familjeve, të gatshme për të marrë në përkujdesje si raste emergjente, fëmijë për të cilët është dhënë masa emergjente mbrojtjes apo familje të gatshme për të vijuar procedurat në Gjykatë, për marrjen e kujdestarisë së përkohshme për fëmijën pa kujdes prindëror.

41. Struktura përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ në çdo Bashki, planifikon fonde dhe ndërmerr fushata të vazhdueshme informimi dhe komunikimi me komunitetin, me qëllim identifikimin e familjeve të mundshme, për të qenë familje kujdestare. Struktura përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare është:

- a) struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë ku banon fëmija;
- b) Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit në njësinë administrative të bashkisë, ku banon fëmija;
- c) subjekti publik ose jopublik ofrues i shërbimeve të kujdesit shoqëror ku është vendosur përkohësisht fëmija; apo

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ç) organizatat jofitimprurëse që ushtrojnë aktivitet në fushën e shërbimeve të përkujdesit alternativ për fëmijë.

42. Për t'u përcaktuar si familje e gatshme për të qenë familje kujdestare, një familje duhet të plotësojë këto kritere¹:

- a) të ketë shfaqur interesin për të ofruar shërbimin e përkujdesjes alternative;
- b) anëtarët e familjes të jenë të motivuar për të qenë familje kujdestare;
- c) anëtarët e familjes të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale apo dhunë në familje, me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- ç) prindërit kujdestarë të kenë aftësi për të kryer detyrën e kujdestarit;
- d) prindërit kujdestarë dhe të gjithë anëtarët e familjes të vërtetojnë me raport mjekësor nga komisioni mjeko-ligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe se nuk mbartin sëmundje të transmetueshme;
- dh) të strehojnë dhe garantojnë mjedis familjar të sigurt për fëmijën;
- e) anëtarët e familjes të mos kenë qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;
- ë) të respektojnë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve, apo të gjitha gjendjet e fëmijës sipas njërës apo disa prej shkaqeve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi;
- f) prindërit kujdestarë të kenë kuptim të qartë dhe të jenë të gatshëm të zbatojnë parimin e veprimit në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;
- g) prindërit kujdestarë të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;
- gj) prindërit kujdestarë nuk kanë humbur ose u është hequr përgjegjësia prindërore, ose u është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;
- h) prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç;
- i) prindërit kujdestarë të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në jo më shumë se tre fëmijë;

43. Çdo familje e interesuar për të qenë familje kujdestare, duhet të shprehë interesin duke paraqitur një kërkesë pranë strukturës përgjegjëse. Kërkesa përmban informacion për familjen sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi. Kërkesës i bashkëlidhen dokumenti/et e identifikimit të prindërve të familjes.

44. Punonjësi social i strukturës përgjegjëse (në vijim "punonjësi social përgjegjës"), bën vlerësimin paraprak të familjeve të interesuara, në bazë të kriterëve të vlerësimit të parashikuara në pikën 42 të këtij udhëzuesi dhe fton familjet e përzgjedhura të ndjekin sesionin e informimit mbi shërbimin e kujdestarisë.

45. Sesioni informues konsiston në dhënien e informacionit të hollësishëm për përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e familjes kujdestare.

46. Në përfundim të sesionit informues punonjësi social përgjegjës, fton familjen kujdestare të konfirmojë me shkrim, interesin për të vijuar me procedurën e regjistrimit si familje kujdestare.

47. Prindërit kujdestarë të interesuar ftohen nga punonjësi social përgjegjës dhe zhvillojnë një intervistë të strukturuar sipas formularit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi. Intervista synon të marrë informacion të detajuar mbi kontekstin familjar, edukativ dhe social të familjes aplikuese, si dhe të kushteve dhe mundësive që ka familja për të krijuar një mjedis të përshtatshëm familjar për mirërritjen e fëmijës.

48. Familjes së interesuar i kërkohet të paraqesë pranë punonjësit social përgjegjës këto dokumente plotësuese:

- a) raportin mjeko-ligjor, që vërteton se prindërit e familjes janë të aftë fizikisht dhe mendërisht;
- b) referenca për familjen nga 2 persona (njëri prej të cilëve duhet të jetë një përfaqësues i komunitetit në të cilin jeton familja).

49. Punonjësi social përgjegjës, mbledh nëpërmjet paraqitjes të kërkesës në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik, për llogarë të personave fizik sipas legjislacionit në fuqi edhe këto dokumente mbi familjen e interesuar:

- a) përbërjen familjare nga Regjistri i Gjendjes Civile;
- b) vërtetimin e gjendjes gjyqësore për anëtarët e familjes mbi 18 vjeç;
- c) të ardhurat e familjes;

¹ Pika 5 e VKM-së nr. 149, datë 13.3.2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare".

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) pasuritë e paluajtshme të familjes;
d) vërtetim nga strukturat e policisë, nëse ka pasur denoncime për dhunë në familje apo probleme të tjera me komunitetin;

dh) verifikim social ekonomik të familjes nga administratori shoqëror i Njesisë Administrative.

50. Mbas plotësimit të dokumentacionit, punonjësi social përgjegjës, në bashkëpunim me psikologun, kryen vlerësimin e mëtejshëm të familjes kujdestare të interesuar. Për kryerjen e vlerësimit punonjësi social përgjegjës dhe psikologu, mbështeten të dhënat e mbledhura sipas pikave 43, 47, 48, dhe 49 të këtij udhëzuesi, si dhe informacionet që marrin nga:

a) vizitat në banesën e aplikantit, për të verifikuar kushtet e jetesës së familjes kërkuuese;
b) takimet individuale dhe në grup me të gjithë anëtarët e familjes së aplikantit;
c) intervistimit të personave të paraqitur nga aplikanti si referencë;
d) intervistimit të specialistëve të tjerë, si psikologë, punonjës të policisë, përfaqësues të organeve të pushtetit vendor në vendbanimin e familjes kërkuuese, punëdhënësin e bashkëshortit/es, përfaqësues të institucioneve arsimore, përfaqësues të komunitetit.

51. Nëse sipas vlerësimit, gjykohet se familja është e përshtatshme për të qenë familje kujdestare, prindërit kujdestarë të interesuar, i nënshtrohen trajnimit për prindër kujdestarë, të organizuar nga struktura përgjegjëse dhe gjatë këtij procesi vlerësohen kapaciteti, aftësitë dhe shprehitë e tyre si prindër kujdestar. Kryerja e trajnimit dokumentohet me një procesverbal ose me certifikatën e trajnimit.

52. Pas përfundimit të trajnimit, punonjësi social përgjegjës dhe psikologu përgatisin Raportin e Vlerësimit të Familjes Kujdestare (referim formulari nr. 5).

53. Dokumentet e mbledhura sipas pikave 43, 47, 48, 49, 50, 51, dhe 52 të këtij udhëzuesi sistemohen nga punonjësi social përgjegjës, në dosjen e familjes kujdestare të interesuar dhe dërgohen nga struktura përgjegjëse për vendimmarrje në Komisionin Multidisiplinar në bashkinë përkatëse.

54. Komisioni Multidisiplinar mblidhet për të shqyrtuar rastin, bën vlerësimin nëse familja plotëson ose jo kushtet për të ofruar shërbimin e kujdestarisë në familje, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe merr vendim për miratimin e familjes kujdestare brenda 30 ditëve nga paraqitja e dosjes sipas pikës 53 të këtij udhëzuesi.

55. Vendimi i Komisionit Multidisiplinar i përcillet strukturës përgjegjëse që ka paraqitur dokumentacionin pranë saj, si dhe strukturës së shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki dhe Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit në njësinë administrative ku banon familja kujdestare. Struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki regjistron familjen në regjistrin e familjeve kujdestare që ngre dhe administron.

Komisionimi dhe vendosja e fëmijës pa kujdës prindëror në familjen kujdestare¹

56. Pas sigurimit të përkujdesit të menjëhershëm sipas pikës 27 të këtij udhëzuesi, Njësia e Mbrojtjes të Fëmijëve i referon rastin strukturës përgjegjëse ku ka vendbanimin fëmija.

58. Struktura përgjegjëse, me marrjen e referimit, sipas pikës 56 të këtij udhëzuesi, mbledh të dhëna për fëmijën pa kujdës prindëror dhe familjen biologjike të tij. Informacioni mblidhet dhe evidentohet, sipas formularit nr. 3 dhe nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi.

59. Vendimi për ta vendosur fëmijën në familje kujdestare bazohet në një vlerësim shumë të kujdesshëm të nevojave të fëmijës dhe i arsyëve pse prindërit dhe familja e fëmijës nuk e kanë mundësinë t'i përgjigjen këtyre nevojave.

60. Në kuptimin e pikës 25/c/ii të këtij udhëzuesi, vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative është një masë e përkohshme mbrojtjeje për fëmijën pa përkujdesje prindërore dhe kur për mbrojtjen e tij është i nevojshëm strehimi apo vendosja e tij në përkujdesje alternative, duke ndjekur këtë radhë:

a) pranë një të afërmi të fëmijës;
b) pranë një familjeje kujdestare;
c) në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e mësipërme;

61. Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit punonjësi social përgjegjës harton Raportin e Vlerësimit të Rastit. Raporti i Vlerësimit të Rastit përfshin vlerësimin e fëmijës pa kujdës prindëror dhe vlerësimin e familjes të tij biologjike dhe përmban të paktën këto informacione:

a) moshën dhe gjendjen civile të fëmijës;

¹ Pikat 22–41 e VKM-së nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdës prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) marrëdhëniet familjare dhe sociale të fëmijës;
c) gjendjen shëndetësore të fëmijës;
ç) nivelin e arsimimit të fëmijës;
d) temperamentin dhe interesat e shfaqura të fëmijës;
dh) nevoja të veçanta, probleme të shfaqura të fëmijës;
e) arsyet për të cilat fëmija duhet të vendoset në shërbim kujdestarie;
ë) moshën e prindërve biologjikë;
f) vendbanimin e prindërve biologjikë;
g) punësimin dhe të ardhurat financiare të prindërve biologjikë;
gj) nivelin e arsimimit të pjesëtarëve të familjes biologjike;
h) kushtet e strehimit të familjes biologjike;
i) gjendjen shëndetësore të anëtarëve të familjes biologjike;
j) gjendjen psiko-sociale dhe ligjore të pjesëtarëve të familjes biologjike;
k) deklaratën e prindit/prindërve biologjikë kur prindi/prindërit jetojnë, në të cilën shprehet aprovimi për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare, me përjashtim të rasteve kur për fëmijën është marrë një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në nenin 55 të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

62. Punonjësi social përgjegjës, gjithashtu plotëson dosjen e fëmijës me këto dokumente:

- a) certifikatën personale të fëmijës me fotografi;
- b) 4 fotografi të fëmijës;
- c) certifikatën familjare të fëmijës;
- ç) raportin mjeko-ligjor për gjendjen shëndetësore dhe mendore të fëmijës;
- d) kopjen e fletores së fëmijës për vaksinimet e kryera;
- dh) dëftesën shkollore për fëmijën, nëse fëmija frekuenton një të tillë;
- e) vërtetimin nga institucioni i përkujdesjes shoqërore, nëse fëmija është vendosur në një të tillë.

63. Plotësimi i dosjes, përveç në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 62 të këtij udhëzuesi, të sigurohet nëpërmjet kërimit të dokumentacionit në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik për llogari të personave fizik sipas legjislacionit në fuqi.

64. Dosja e rastit që përfshin dokumentet e mbledhura sipas 58, 61 dhe 62 të këtij udhëzuesi, dërgohet nga struktura përgjegjëse Komisionit Multidisiplinar të kujdestarisë në bashkinë që ka bërë referimin, brenda një afati 15-ditor nga referimi.

65. Komisioni Multidisiplinar brenda një jave nga paraqitja e dosjes sipas pikës 64 të këtij udhëzuesi, përzgjedh dhe propozon një nga familjet kujdestare nga Regjistri i Familjeve Kujdestare të krijuar sipas pikës 55 të këtij udhëzuesi.

Përshtatshmëria

66. Komisioni Multidisiplinar përzgjedh familjen kujdestare, sipas pikës 65 të këtij udhëzuesi duke gjykuar mbi përshtatshmërinë sa më mirë të nevojave të fëmijës me familjen që propozohet si familje kujdestare.

67. Përshtatshmëria ndërmjet familjes kujdestare dhe fëmijës bazohet në vlerësimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës, në kontekstin familjar edukativ e social, vlerësimin e kushteve dhe të përshtatshmërisë së fëmijës me familjen kujdestare të ardhshme, si dhe në kriteret e mëposhtme:

a) Për fëmijën: moshë, temperament, interesat, marrëdhëniet me fëmijët e tjerë dhe nevoja të veçanta që mund të ketë;

b) Për familjen biologjike: moshë, temperament, profesioni/punësimi, strehimi, interesat, niveli i edukimit;

c) Për familjen kujdestare: moshë, temperament, punësimi/profesioni, aftësitë, interesat, niveli edukativ, qëndrimet kundrejt kulturave të tjera, statusi ligjor, kompetencat profesionale, preferencat ndaj fëmijëve potencialë për shërbim kujdestarie, gatishmëria, banimi (distanca nga familja biologjike), fëmijët e tjerë të familjes.

68. Me marrjen e njoftimit nga Komisioni Multidisiplinar, sipas pikës 66 të këtij udhëzuesi, struktura përgjegjëse njofton familjen kujdestare për vendimin që ka marrë për përzgjedhjen si familje kujdestare dhe kjo e fundit i paraqet deklaratën e gatishmërisë për të marrë fëmijën në përkujdesje.

69. Struktura përgjegjëse paraqet kërkesën në Gjykatë sipas nenit 264 të Kodit të Familjes.¹

¹ Neni 264 i Kodit të Familjes; e drejta për paraqitjen e kërkesës - të drejtën për paraqitjen e kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

70. Gjykata vendos sipas dispozitave të Kodit të Familjes për vendosjen e fëmijës në një Familje kujdestare.

71. Struktura përgjegjëse që ka ndjekur procedurën përkatëse në Gjykatë depoziton një kopje të vendimit të Gjykatës pranë NJVNR-së ku banon familja kujdestare.

72. Me marrjen e vendimit, sipas pikës 70 të këtij udhëzuesi, punonjësi social përgjegjës bën përgatitjen paraprake të fëmijës, që përfshin:

- a) informimin e fëmijës (bazuar në nivelin e të kuptuarit dhe moshën);
- b) përshtatjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare, nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta të fëmijës me familjen kujdestare, vizitave dhe takimeve, numri i të cilave përcaktohet dhe realizohet rast pas rasti dhe është i kushtëzuar nga ritmi individual i përshtatjes së çdo fëmije;
- c) sistemimin e fëmijës në familjen kujdestare;
- ç) hartimin e një plani individual për fëmijën;
- d) hartimin e një plani për fuqizimin e familjes biologjike, për mundësimin e rikthimit të fëmijës.

Monitorimi i fëmijës në familjen kujdestare

73. Gjatë vizitave monitoruese punonjësi social përgjegjës dhe psikologu sigurohen që:

- a) fëmija trajtohet me ngrohtësi, mirëkuptim, respekt dhe ndihet i mbrojtur dhe i mbështetur nga familja kujdestare;
 - b) prindërit kujdestarë komunikojnë hapur dhe me respekt me fëmijën;
 - c) fëmija është i mbrojtur nga abuzimi dhe shfrytëzimi;
 - ç) fëmija merr kujdesin e duhur shëndetësor;
 - d) fëmija ushqehet shëndetshëm;
 - dh) fëmija ndjek sistemin arsimor në përputhje me kapacitetin, rrethanat dhe nevojat për zhvillim, si dhe mbështetet në procesin e të mësuarit;
 - e) fëmija ka mundësi të luaj në një mjedis të mbrojtur dhe stimulus, i cili mbështet miqësinë me fëmijët e tjerë, si dhe nevojat individuale për zhvillim shoqëror;
 - f) fëmija mbështetet për të arritur zhvillimin e duhur fizik, social dhe emocional;
 - g) fëmijës i janë krijuar kushtet për të ruajtur kontaktet me prindërit biologjik apo pjesëtarët e familjes në përputhje me përcaktimet në Planin Individual;
 - h) fëmija përfshihet në marrjen e vendimeve brenda familjes dhe për çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tij/saj;
 - i) fëmija është i informuar për të drejtat dhe përgjegjësitë brenda familjes;
 - j) fëmija është i informuar mbi mekanizmin e ankimit dhe raportimit, në raste të abuzimit apo neglizhimit.
- Në përputhje me moshën dhe pjekurinë, fëmija trajnohet për t'i përdorur këto procedura.

74. Gjatë periudhës së jetesës së fëmijës në familjen kujdestare, punonjësi social përgjegjës mundëson:

- a) përfshirjen e fëmijës, në përputhje me moshën dhe shkallën e të kuptuarit, në përgatitjen dhe rishikimin e vazhdueshëm të Planit Individual dhe të Planit të zhvillimit të fëmijës.
- b) takime individuale me fëmijën.
- c) vizita monitoruese në ambientin ku jeton me familjen kujdestare.
- d) mbështetje për prindërit kujdestarë, sa herë që ata e kanë të nevojshme, për të kapërcyer vështirësi të mundshme, që krijohen me fëmijën.

75. Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ose struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për bashkitë që nuk kanë njësi të vlerësimit dhe referimit të rastit, monitoron në vazhdimësi familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari, nëpërmjet kryerjes së vizitave të monitorimit në shtëpi apo gjatë veprimtarisë normale të familjes.

76. Vizitat e monitorimit, sipas pikës 75, bëhen çdo 2 javë në 3 muajt e parë, për familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari dhe më pas çdo muaj. Rezultatet e çdo vizite dokumentohen dhe përfshihen në dosjen përkatëse të fëmijës.

77. Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror monitorojnë çdo 3 muaj proceset e punës së punonjësit social të njësive të qeverisjes vendore dhe bëjnë monitorimin e fëmijëve të vendosur në familje kujdestare.

- a) të afërmit e fëmijës së mitur; b) cilido që merr njoftim për mbetjen e fëmijës pa prindër ose për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur;
- c) vetë i mituri që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç;
- ç) prokurori;
- d) noteri, i cili në çeljen e një testamenti vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

78. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale, inspekton 2 herë në vit familjen kujdestare dhe fëmijën, për të siguruar respektimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë, si dhe për të siguruar mirëqenien e fëmijës, sipas procedurave për zbatimin e standardeve të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

79. Monitorimi nga drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror dhe inspektimi nga Inspektorati përgjegjës për shërbimet shoqërore, koordinohen dhe realizohen në ditët e monitorimit të familjes nga struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror të bashkisë ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit, të njësisë administrative.

80. Në rastet kur punonjësit e strukturave monitoruese apo inspektuese, informohen ose besojnë në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në situatë emergjence, procedojnë menjëherë, duke referuar rastin të NJMF-së, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

81. Në rastet kur gjatë monitorimit të fëmijës në familje kujdestare, konstatohet papërputhshmëri mes fëmijës dhe familjes kujdestare, por që nuk paraqet emergjencë për largimin e menjëhershëm të fëmijës nga familja kujdestare, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ndjek nga fillimi procedurat e parashikuara për komisionimin dhe vendosjen e fëmijës në familjen kujdestare.

Kujdestaria në marrëdhënie gjaku

Të gjithë fëmijët që janë vendosur në familje kujdestare me marrëdhënie gjaku duhet të plotësojnë të njëjtin dokumentacion. Marrëdhënia e fëmijës me familjen me lidhje gjaku do të bëjë ndryshimin në dhënien e prioritetit për mbështetje nga strukturat përkatëse, nëse familja kujdestare nuk plotëson kriterin financiar.

Monitorimi i fëmijëve në kujdestari me lidhje gjaku ndjek të njëjtat procedura si në ato pa lidhje gjaku.¹

UDHËZIM

Nr. 584, datë 31.7.2019

PËR RREGULLAT, PROCEDURAT DHE VEPRIMET KONKRETE TË AUTORITETEVE TË PUSHTETIT QENDROR OSE VENDOR, SI DHE DETYRIMET E PERSONELIT MJEKËSOR OSE TË PROFESIONISTËVE TË FUSHAVE TË TJERA, QË LIDHEN ME PARANDALIMIN OSE TRAJTIMIN E RASTEVE TË BRAKTISJES SË FËMIJËS NË INSTITUCIONET E KUJDESIT SHËNDETËSOR²

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 9, të nenit 8, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,

UDHËZOJ:

KREU I TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave dhe veprimeve konkrete të personelit mjekësor dhe profesionistëve të fushave të tjera për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor.

2. Personeli mjekësor dhe profesionistët e fushave të tjera kanë detyrimin për raportimin e rasteve të identifikuara në rrezik braktisjeje dhe rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor.

3. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (“PMF” në vijim) në bashkëpunim me institucionet e kujdesit shëndetësor kanë detyrimin të identifikojnë dhe trajtojnë rastet në rrezik braktisjeje ose të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor.

KREU II

PARANDALIMI I BRAKTISJES SË FËMIJËVE DHE DETYRIMET E PERSONELIT MJEKËSOR DHE TË PROFESIONISTËVE TË FUSHAVE TË TJERA NË INSTITUCIONIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Institucionet e kujdesit shëndetësor (personeli mjekësor dhe profesionistët e fushave të tjera) kur gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre konstatojnë raste në rrezik braktisjeje të fëmijës nga:

¹ Anekset bashkëlidhur vendimit mund t'i konsultoni në linkun:

<https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2019/05/09/394/cc264d15-b670-4088-a6d2-094494e08103;q=394>

² Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 121*. Tiranë 2019. f. 8942.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) nëna që janë në pritje të një fëmije;
- b) nëna, babai ose kujdestari ligjor
duhet të referojnë rastin te PMF-ja përkatëse ku ka vendbanimin familja, nëna, babai ose kujdestari ligjor i fëmijës.
2. Punonjësit e personelit mjekësor dhe profesionistët e fushave të tjera, brenda 24 orëve nga momenti i identifikimit të rasteve në rrezik braktisje, plotësojnë dhe dërgojnë pranë PMF-së përkatëse formularin e referimit dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas përcaktimeve të bëra në aneksin 2, të vendimit nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
3. Referimi i rasteve bëhet me qëllim parandalimin e braktisjes së fëmijës dhe bazohet në dyshime të arsyeshme të personelit mjekësor ose profesionistëve duke u nisur nga rrethanat sociale, ekonomike e psikologjike të familjes ose nënës.
4. PMF-ja pas raportimit të rastit nga personeli mjekësor ose profesionistët e fushave të tjera bën një vlerësim të rastit dhe ofron mbështetje ndërgjegjësuere për familjet ose nënat të cilat janë në kushtet e tentativës për të braktisur fëmijët.
5. PMF-ja gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të ketë një fokus të veçantë ndaj familjeve dhe nënave të cilat kanë fëmijë ose janë në pritje të lindjes së një fëmije, lidhur me rrezikun për braktisje, duke konsideruar dhe vlerësuar kushtet sociale, ekonomike e psikologjike.
6. PMF-ja referon rastin edhe te njësia e referimit e vlerësimit të nevojave, e cila bën një vlerësim të kushteve sociale ekonomike të familjes.
7. PMF-ja në bashkëpunim me njësinë e referimit e vlerësimit të nevojave ka detyrimin të identifikojë për raste të tilla shërbime mbështetëse për familjen ose nënën.

KREU III

TRAJTIMI I RASTEVE TË BRAKTISJES

1. Kur fëmija braktiset në maternitetet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, personeli social dhe mjekësor i tyre, brenda 24 orëve, njofton me telefon dhe me shkrim PMF pranë pushtetit vendor dhe policinë.
 2. PMF-ja pranë pushtetit vendor, në bashkëpunim me punonjësin e policisë, përgatit raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.
 3. Pas raportimit të rastit, PMF-ja merr masa për menaxhimin e rastit dhe vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, sipas ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe vendimit nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.
 4. PMF-ja gjatë procesit të menaxhimit të rastit bën përpjekje për të kontaktuar nënën e fëmijës dhe merr masa për të këshilluar atë për të ushtruar përgjegjësitë prindërore.
 5. PMF-ja gjatë ushtrimit të detyrave të saj bashkëpunon me strukturat vendore të policisë së shtetit dhe me strukturat e tjera të Bashkisë.
 6. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës që të organizojë trajnime për personelin e përfshirë në trajtimin e rasteve të braktisjes, lidhur me mënyrën e trajtimit dhe parandalimit të rasteve të braktisjes së fëmijëve.
 7. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës që të zhvillojë fushata ndërgjegjësuere lidhur me parandalimin e rasteve të braktisjes së fëmijëve.
 8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor për zbatimin e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 650, datë 13.9.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE PROCEDURALË PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN, FËMIJËT VIKTIMA DHE DËSHMITARË NË PROCESIN PENAL¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 49, të ligjit 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Drejtësisë,

UDHËZOJNË:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal.

2. Përfaqësuesit proceduralë kryejnë përfaqësimin procedural të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

3. Përfaqësuesit proceduralë, ushtrojnë funksionet e tyre kur kërkohet nga organi procedues, duke i shërbyer në çdo rast interesit më të lartë të fëmijës në konflikt me ligjin, fëmijës viktimë dhe dëshmitar në procesin penal.

4. Njësia për mbrojtjen e fëmijës harton dhe përshtat, një herë në vit, listën me përfaqësuesit proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe fëmijët dëshmitarë në procesin penal.

5. Në listën e hartuar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës gjenden të përcaktuara:

a) emrat e personave që janë përzgjedhur për të ushtruar përfaqësimin procedural të fëmijës në procesin penal;

b) njësitë administrative përkatëse që mbulojnë përfaqësuesit proceduralë. Një përfaqësues procedural mund të mbulojë më shumë se një njësi administrative;

c) adresat dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre. Për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të dhënave elektronike të kontaktit të tyre, përfaqësuesit proceduralë detyrohen të njoftojnë njësinë për mbrojtjen e fëmijës.

6. Punonjësit e njësive për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe njësi administrative, mund të kryejnë rolin e përfaqësuesit procedural, vetëm në ato raste, kur nuk ka persona të tjerë të përzgjedhur për të kryer rolin e përfaqësuesit procedural.

7. Kriteret që duhet të plotësojë një individ për të qenë përfaqësues procedural, janë:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë diplomën e studimeve të larta Bachelor dhe Master Shkencor ose Master Profesional në shkencë sociale, juridike, psikologji, sipas legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) të ketë minimalisht 2 vjet eksperiencë pune të mëparshme në çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

ç) të ketë trajnime në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

d) të ketë njohuri mbi rregullat e zbatueshme për drejtësinë penale për të mitur;

dh) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale dhunë në familje dhe vepra penale kundër personit të kryera me dashje.

8. Përfaqësuesit proceduralë pezullohen nga detyra kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj të miturve ose kur ata akuzohen për kryerjen e një vepre penale në bashkëpunim me një të mitur.

9. Kryetari i Bashkisë me propozim të drejtuesit të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijës, përpara hartimit të listës me përfaqësuesit proceduralë sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, shpall thirrjen publike në faqen zyrtare të bashkisë dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, për të ftuar personat e interesuar për të ushtruar rolin e përfaqësuesit procedural për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë apo dëshmitarë në procesin penal.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 156*. Tiranë 2019. f. 12796.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

10. Thirrja publike qëndron e hapur për një periudhë prej 30 ditësh nga data e shpalljes. Njësia për mbrojtjen e fëmijës kujdeset që të njoftohen individë të interesuar, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 7 të këtij udhëzimi, si dhe organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

11. Kandidatët e interesuar dorëzojnë pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës të gjithë dokumentacionin e mundshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në pikën 7 të këtij udhëzimi, si dhe deklarojnë adresat dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre.

12. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës është 5 ditë nga përfundimi i afatit 30-ditor, të përcaktuar në nenin 10 të këtij udhëzimi.

13. Brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit 5-ditor, të përcaktuar në pikën 12 të këtij udhëzimi, kryetari i Bashkisë ngre komisionin për përzgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve për të ushtruar rolin e përfaqësuesve proceduralë. Komisioni kryesohet nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe në përbërje të tij janë:

- a) drejtuesi i njësisë për mbrojtjen e fëmijës në bashki;
- b) dy punonjës të njësisë për mbrojtjen e fëmijës në bashki;
- c) një psikolog, i caktuar nga urdhri i psikologut;
- ç) një përfaqësues nga çdo organizatë jofitimprurëse që merret me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë. Organizata jofitimprurëse, punonjësit e së cilës kanë aplikuar për të ushtruar rolin e përfaqësuesit procedural, përjashtohet nga gjykimi i këtyre kandidaturave.

14. Procedura për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për përfaqësues proceduralë zhvillohet në dy faza. Faza e parë e vlerësimit e cila zgjat jo më shumë se 10 ditë, konsiston në shqyrtimin dhe verifikimin e plotësimit të dokumentacionit, që vërteton përmbushjen e kriterëve formale të përcaktuar në pikën 7, të këtij udhëzimi dhe vlerësohet maksimalisht me 70 pikë.

15. Komisioni përzgjedhës, pasi kryen verifikimin për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në pikën 7 të këtij udhëzimi në bazë të dokumentacionit provues të depozituar nga kandidatët, i njofton ata për rezultatet e fazës së parë të përzgjedhjes, si dhe për arsyet e skualifikimit, në rrugë shkresore dhe elektronike, jo më vonë se 10 ditë nga përfundimi i afatit sipas pikës 14 të këtij udhëzimi.

16. Kandidatët të cilët nuk janë kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të përzgjedhjes, kanë të drejtën e ankimit brenda 3 ditëve pranë komisionit përzgjedhës.

17. Pas shqyrtimit të kërkesave ankimore të paraqitura, komisioni përzgjedhës njofton kandidatët që kanë paraqitur ankim, për rezultatin e ankesave të tyre brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës ankimore.

18. Faza e dytë e përzgjedhjes zhvillohet brenda 3 ditëve nga momenti i përfundimit të afatit 5-ditor të parashikuar në pikën 17 të këtij udhëzimi. Në këtë fazë komisioni përzgjedhës zhvillon intervista me gojë me kandidatët, të cilët kanë rezultuar fitues në fazën e parë, ku vlerësohen në lidhje me njohuritë, aftësitë, motivimin si dhe eksperiencat e mëparshme të tyre. Totali i pikëve për këtë fazë është 30 pikë.

19. Kandidatët, të cilët nuk janë kualifikuar pas fazës së dytë të vlerësimit, kanë të drejtën e ankimit brenda 3 ditëve pranë komisionit përzgjedhës.

20. Pas shqyrtimit të kërkesave ankimore të paraqitura lidhur me rezultatet e fazës së dytë, komisioni përzgjedhës njofton kandidatët që kanë paraqitur ankim, për rezultatin e ankesave të tyre brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës ankimore.

21. Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, komisioni përzgjedhës, brenda 5 ditëve, shpall në faqen zyrtare të bashkisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, listën e kandidatëve fitues të renditur sipas pikëve totale të fituara nga secili prej tyre.

22. Komisioni përzgjedhës, për çdo mbledhje të tij, mban procesverbalin përkatës, në të cilin përcaktohet data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, një përmbledhje të diskutimeve të mbajtura në mbledhje, vendimet që u morën, forma dhe rezultati i votimeve. Procesverbali mbahet nga njëri prej anëtarëve të komisionit, i cili luan edhe rolin e sekretarit të komisionit.

23. Përfaqësuesit proceduralë të zgjedhur e ushtrojnë funksionin e tyre për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë rikandidimi një herë.

24. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki, pas hartimit të listës me përfaqësuesit proceduralë, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, e dërgon atë pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit e të apelit përkatës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

25. Fëmijës në konflikt me ligjin, fëmijës viktimë apo dëshmitar në procesin penal, i caktohet përfaqësuesi procedural nga lista e njësive për mbrojtjen e fëmijës të bashkisë, ku ai ka vendbanimin apo vendqëndrimin.

26. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki zhvillojnë trajnime për personat që ushtrojnë funksionin e përfaqësuesit procedural.

27. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 651, datë 13.9.2019

PËR PROCEDURAT E RAPORTIMIT, TË RASTEVE TË FËMIJËVE NË NEVOJË, PËR MBROJTJE¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 7, të nenit 67, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e të fëmijës”, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Brendshëm dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

UDHËZOJNË:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave të raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nga çdo person fizik ose juridik, institucionet publike dhe private, mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psikosocial në shkollë, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes shoqërore të fëmijës, publike apo private, organet e policisë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në nivel vendor, sipas përcaktimeve në ligjin nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” (në vijim “ligji”).

2. Personat fizikë ose juridikë, të përmendur në pikën 1 të këtij udhëzimi, kanë detyrimin ligjor të raportojnë pranë organeve të Policisë së Shtetit ose strukturave për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor, për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit apo shfrytëzimit të fëmijës.

3. Strukturat për mbrojtjen e fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore, marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha institucionet publike apo private të përkujdesjes shoqërore për fëmijët, të arsimit e të shëndetësisë, strukturat e policisë dhe personat juridikë, publikë dhe privatë, për të lehtësuar raportimin.

4. Njoftimi me informacionin e kontaktit duhet të përmbajë:

- a) strukturat ku mund të raportohet dhe adresat përkatëse;
- b) numrin e telefonit në dispozicion dhe adresat e *email-it*;
- c) informacion që raportimi mund të bëhet në çdo kohë;
- ç) informacion që të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale;
- d) informacion që punonjësit e çdo strukture, të cilët marrin raportimin dhe ata që do të ndjekin çështjen e raportuar, kanë detyrimin për të ruajtur anonimatën dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 145*. Tiranë 2019. f. 12037.

KREU II PROCEDURAT E RAPORTIMIT DHE DOKUMENTACIONI

1. Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.

2. Çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët, për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

3. Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor dhe oficerët e sigurisë, për ato insitucione të arsimit parauniversitar, ku janë emëruar, kanë për detyrë të referojnë në drejtorinë e shkollës, çdo rast të dyshuar apo të ndodhur abuzimi, neglizhimi, dhune apo shfrytëzimi të fëmijës. Drejtuesit e shkollës kanë për detyrë ta referojnë rastin pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të cilat e referojnë rastin menjëherë pranë strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve.

4. Punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private, kanë për detyrë të raportojnë menjëherë te drejtori i institucionit, organet e Policisë së Shtetit, strukturat për mbrojtjen e fëmijës, çdo rast të dyshuar apo të ndodhur të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes, neglizhimit apo dhunës te fëmijët.

5. Punonjësit e policisë pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, përveç marrjes së masave për trajtimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të rasteve të njoftuara nga punonjësit/profesionistët, përgjatë përmbushjes së detyrave funksionale të tyre, identifikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe kryejnë procedurën për raportimin e rastit te strukturat vendore për mbrojtjen e fëmijës.

6. Profesionistët e përmendur në nenin 67, të ligjit 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ose struktura përgjegjëse pranë institucionit, raportojnë menjëherë, duke kontaktuar punonjësin e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës, me çdo mjet komunikimi, telefon, *email*, me postë, në formë shkresore, rastet që identifikohen si në rrezik të menjëhershëm apo të lartë, ndërsa, rastet e tjera të rrezikut, të mesëm apo të ulët, raportohen brenda 24 orëve nga identifikimi.

7. Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje të përcaktuar në aneksin 2, vendimin nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

8. Formulari i plotësuar dërgohet në mënyrë elektronike apo me postë te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, përgjegjës për territorin ku është bërë identifikimi i rastit. Në formular hidhet i gjithë informacioni dhe të gjitha detajet e ditura nga personi apo personat, të cilët janë në dijeni dhe kanë raportuar rastin.

9. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit e strukturave vendore të Policisë së Shtetit, shënojnë në një regjistër të veçantë të emërtuar: “Regjistri i raportimeve të rasteve të fëmijëve”, të gjitha rastet e raportuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Regjistri duhet të përmbajë:

- a) orën dhe datën e raportimit;
- b) të dhëna për raportuesin;
- c) gjeneralitetet e fëmijës;
- ç) vendndodhjen e fëmijës;
- d) emrin apo të dhëna për personin, i cili dyshohet se ka abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar apo keqtrajtuar fëmijën;
- dh) institucionin publik apo privat ku ndodhet fëmija;
- e) kualifikimi i ngjarjes së identifikuar dhe lloji i dhunës;
- ë) cilës strukturë i është drejtuar çështja për ndjekje.

10. Regjistri i raportimeve të rasteve të fëmijëve krijohet, administrohet, ruhet dhe arkivohet, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

11. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës me marrjen e raportimit dhe regjistrimin e tij në regjistër, ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat e veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin ose jo të vlerësimit fillestar të rastit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

12. Punonjësit e strukturave vendore të Policisë së Shtetit, me marrjen e raportimit dhe regjistrimin në regjistër, kanë detyrimin të referojnë rastin në kohë të punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, përgjegjës për territorin ku është bërë identifikimi i rastit, si dhe të bashkëpunojë me punonjësin për mbrojtjen e fëmijës, sipas nevojave të identifikuara gjatë procesit të menaxhimit të rastit.

KREU III RREGULLA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETIN E ÇËSHTJES

1. Të gjithë personat fizikë ose juridikë të përmendur në kreun I, pikën 1 të këtij udhëzimi, të cilët kanë detyrim për raportim, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale të rasteve të raportuara, sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Punonjësit e çdo strukture, të cilët marrin raportimin dhe ata që do të ndjekin çështjen e raportuar, kanë detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin e çështjes dhe mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës dhe të personit të dyshuar për abuzim.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo mospërbushje e detyrimit ligjor për raportimin e rastit nga personat fizikë ose juridikë, të përmendur në kreun I, pikën 1 të këtij udhëzimi, konsiderohet kundërvajtje administrative, sipas nenit 69, të ligjit nr. 18/2017.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, strukturat për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 659, datë 23.9.2019

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE NË OFRIMIN E SHËRBIMIT ARSIMOR, SHËNDETËSOR APO REHABILITUES, NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT SPECIFIKE, NË NJË NJËSI TË QEVERISJES VENDORE TË NDARYSHME NGA AJO KU FËMIJA ME AFTËSI TË KUFIZUARA JETON¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

UDHËZOJNË:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 138*. Tiranë 2019. f. 11515.

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është garantimi i vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe rehabilituese (aftësuese) për fëmijën me aftësi të kufizuara kur është e nevojshme që këto shërbime të ofrohen në një njësi vendore të ndryshme nga ajo ku fëmija ka vendbanimin.

Neni 2

Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe rehabilituese (aftësuese) për fëmijën me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat specifike, në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme dhe mbulimi i shpenzimeve për shërbimet e ofruara në të gjitha rastet e parashikuara si më poshtë:

a) në rastet kur në njësinë vendore ku banon fëmija me aftësi të kufizuara, nuk ofrohet ndonjë nga llojet e shërbimeve që trajton ky udhëzim dhe për të cilin fëmija ka nevojë. Në këto raste fëmija duhet të marrë shërbimin e duhur në një njësi vendore që ka vendndodhjen më të afërt me vendin ku banon;

b) gjatë një periudhe tranzitore apo të përkohshme, kur familja biologjike apo ajo kujdestare, e fëmijës me aftësi të kufizuara, ka ndryshuar vendbanimin, duke u transferuar në territorin e një njësie të qeverisjes vendore të ndryshme me atë të mëparshmen;

c) në rastet kur vendndodhja e banesës së fëmijës me aftësi të kufizuara, është afër vijës kufizuese me një njësi tjetër të qeverisjes vendore e për pasojë mund të jetë më afër një shërbimi që ofrohet në njësinë vendore të ndryshme nga ajo ku fëmija banon;

d) fëmija me aftësi të kufizuara, për arsye të ndryshme, është duke qëndruar në vendbanimin e të afërmeve ose miqve për një kohë të pacaktuar, por jo më pak se 3 muaj (periudha minimale e nevojshme për të cilën mund të alokohet fondi për mbulimin e shpenzimeve nga një njësi vendore tek tjetra);

e) fëmija me aftësi të kufizuara është duke qëndruar në vendbanimin e të afërmeve apo miqve, për shkak të humbjes së prindërve të tij apo braktisjes nga ana e tyre;

f) në rastet kur fëmija me aftësi të kufizuara është i detyruar të qëndrojë në një njësi tjetër vendore, për shkak të situatave të rrezikshme që fëmija mund të ndodhet dhe kur ndaj tij janë marrë masat e mbrojtjes.

KREU II

LLOJET E SHËRBIMEVE QË PËRFITON FËMIJA MË AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 1

Shërbimi arsimor

Shërbimi arsimor, në kuptimin e këtij udhëzimi, është ai shërbim që do t'i sigurojë fëmijës me aftësi të kufizuara, fillimin apo vazhdimësinë e klasës dhe nivelit arsimor në institucionet publike, në përputhje me kërkesat e tij specifike, duke përfituar të gjitha lehtësimet e parashikuara nga legjislatoni për aftësinë e kufizuar dhe nga legjislatonet e tjera sektoriale.

Neni 2

Kërkesa për marrjen e shërbimit arsimor në njësinë e ndryshme nga njësia ku fëmija ka vendbanimin

1. Për përfitimin e shërbimit sipas nenit 1, të kreut II, të këtij udhëzimi, prindi apo kujdestari i fëmijës me aftësi të kufizuara, duhet të paraqesë një kërkesë pranë institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar të njësive vendore ku fëmija banon.

2. Në rastet e parashikuara nga pikat 5 dhe 6, të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, kërkesa bëhet nga punonjësi i Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës pranë bashkisë ose nga një përfaqësues i institucionit të përkujdesit shoqëror për fëmijët me aftësi të kufizuar publike apo private në rastet kur fëmija merr shërbim përkohësisht pranë tyre.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

3. Kërkesa duhet të përmbajë vendndodhjen e institucionit publik arsimor ku fëmija do të marrë shërbimin arsimor dhe arsyen e marrjes së këtij shërbimi në një njësi vendore të ndryshme nga ajo e vendbanimit të tij.

4. Struktura përgjegjëse pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku fëmija banon duhet ta referojë kërkesën tek institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar të njësisë vendore pritëse të përcaktuar në kërkesë, duke bërë rekomandimet përkatëse të bazuara në këtë udhëzim. Një kopje e kërkesës dorëzohet edhe në bashkinë pritëse, me qëllim marrjen e masave, nëse është e nevojshme, për të siguruar aksesueshmërinë e duhur në institucionin arsimor ku fëmija do të marrë shërbimin arsimor.

5. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet si më poshtë:

- a) kopje e dokumentit të identifikimit të fëmijës;
- b) dëftesën e klasës së mëparshme dhe vërtetimin me nota për ndjekjen e shkollës deri në momentin e ndryshimit të vendbanimit;
- c) kopje të planit edukativ individual (PEI), nëse fëmija ka punuar me PEI.
- d) kopje e vërtetimit të lëshuar nga komisioni i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.
- e) kopje e dokumentit të identifikimit të personit që paraqet kërkesën për përfitimin e shërbimit.
- f) deklaratë nga prindi ose kujdestari, në rastet kur fëmija do të banojë tek të afërmit ose miqtë për një periudhë të caktuar. deklarata duhet të përcaktojë të dhënat e kryefamiljarit të familjes ku do të qëndrojë fëmija për një kohë të caktuar si dhe adresën e banimit. në rastet e parashikuara nga pikat 5 dhe 6, të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, deklarata do të bëhet nga kujdestari ligjor i caktuar sipas procedurave të legjislacionit në fuqi;
- g) kopje e rekomandimit, nëse është vlerësuar, nga komisioni multidisiplinor i vlerësimit për arsimin, që funksionon pranë institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar në territorin ku fëmija është rezident. nëse fëmija nuk është vlerësuar ndonjëherë nga komisioni i sipërpërmendur në vendbanimin e përherëshëm, mund të aplikojë në komisionin e njësisë tjetër të qeverisjes vendore.

Neni 3

Shërbimi shëndetësor

Shërbimi shëndetësor, në kuptimin e këtij udhëzimi, është ai shërbim që i jepet fëmijës në mënyrë të vazhdueshme dhe në të gjitha rastet që do t'i duhet në përputhje me kërkesat e tij specifike, me qëllim që fëmija të ketë një jetë të shëndetshme, duke përfituar të gjitha lehtësimet e parashikuara nga legjislacioni për aftësinë e kufizuar. Shërbimi shëndetësor parashikon shërbimet e ofruara për kontrollin mjekësor rutinë si dhe shërbimet e ofruara në rastet e urgjencave ose shërbim tjetër parashikuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Kërkesa për marrjen e shërbimit shëndetësor në njësinë e ndryshme nga njësia ku fëmija ka vendbanimin

1. Për përfitimin e shërbimit sipas nenit 3, të kreut II, të këtij udhëzimi, për kontrollin mjekësor rutinë, prindi apo kujdestari i fëmijës me aftësi të kufizuara, duhet të paraqesë një kërkesë pranë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor të njësisë vendore ku fëmija banon.

2. Në rastet e parashikuara nga pikat 5 dhe 6, të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, kërkesa bëhet nga punonjësi i Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës ose nga një përfaqësues i institucionit të perkujdesit shoqëror për fëmijët me aftësi të kufizuara publike apo private, në rastet kur fëmija është strehuar përkohësisht pranë tyre.

3. Kërkesa duhet të përmbajë adresën e vendndodhjes në njësinë vendore ku fëmija do të marrë shërbimin shëndetësor dhe arsyen e marrjes së këtij shërbimi në një njësi vendore të ndryshme nga ajo e vendbanimit të tij.

4. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor ku fëmija banon, duhet ta referojë kërkesën te Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, e njësisë vendore pritëse të përcaktuar në kërkesë, duke bërë rekomandimet përkatëse lidhur me gjendjen e fëmijës.

Një kopje e kërkesës dorëzohet edhe në Bashkinë pritëse, me qëllim marrjen e masave, nëse është e nevojshme, për të siguruar aksesueshmërinë e duhur në ndërtesën e shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor ku fëmija do të marrë shërbimin shëndetësor.

5. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet si më poshtë:

- a) kopje të dosjes shëndetësore të fëmijës me aftësi të kufizuara, e cila gjendet në qendrën e kujdesit shëndetësor parësor të vendbanimit të fëmijës;
- b) kopje e dokumentit të identifikimit të fëmijës;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- c) kopje e vërtetimit të lëshuar nga Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;
- d) kopje e dokumentit të identifikimit të personit që paraqet kërkesën për përfitim të shërbimit;
- e) deklaratë nga prindi ose kujdestari, në rastet kur fëmija do të banojë tek të afërmit/miq të për një periudhë të caktuar. Deklarata duhet të përcaktojë të dhënat e kryefamiljarit të familjes ku do të qëndrojë fëmija për një kohë të caktuar si dhe adresën e banimit. Në rastet e parashikuara nga pikat 5 dhe 6, të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, deklarata do të bëhet nga kujdestari ligjor i caktuar sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Shërbimi rehabilitues

Shërbimi rehabilitues, në kuptimin e këtij udhëzimi, është ai shërbim që i ofrohet fëmijës me aftësi të kufizuara, me qëllim rehabilitimin apo zhvillimin (aftësimin) e tij. Fëmija me aftësi të kufizuara e merr këtë shërbim pranë qendrave të zhvillimit apo qendrave rehabilituese në të gjithë territorin e vendit, pavarësisht nga vendbanimi ku ai është i regjistruar apo nga fakti nëse qendra është vendore apo kombëtare.

Neni 6

Kërkesa për marrjen e shërbimit rehabilitues (aftësues) në njësinë e ndryshme nga njësia ku fëmija ka vendbanimin

1. Për përfitim të shërbimit sipas nenit 6, të këtij udhëzimi, prindi apo kujdestari i fëmijës me aftësi të kufizuara, duhet të paraqesë një kërkesë pranë strukturave të posaçme të shërbimeve shoqërore në njësitë e qeverisjes vendore, ku fëmija banon.

2. Në rastet e parashikuara nga pikat 5 dhe 6, të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, kërkesa bëhet nga punonjësi i Njësies së Mbrojtjes së Fëmijës pranë bashkisë ose nga një përfaqësues i institucionit të përkujdesit shoqëror për fëmijët me aftësi të kufizuar publike apo private në rastet kur fëmija është strehuar përkohësisht pranë tyre.

3. Kërkesa duhet të përmbajë njësinë vendore ku fëmija do të qëndrojë dhe ku do të marrë shërbimin e rehabilitimit apo zhvillimit të tij/saj, si dhe arsyen e marrjes së këtij shërbimi në një njësi vendore të ndryshme nga ajo e vendbanimit të tij.

4. Në rastet kur fëmija me aftësi të kufizuara do të marrë shërbimin pranë qendrave të zhvillimit apo qendrave rehabilituese kombëtare apo në nivel qarku të financuara nga buxheti i shtetit, kryetari i bashkisë referon rastin nëpërmjet drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, duke respektuar procedurat e përcaktuara nga legjislacioni i shërbimeve sociale.

5. Bashkia pasi merr kërkesën, duhet ta referojë atë tek Bashkia pritëse e përcaktuar në kërkesë.

6. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet si më poshtë:

- a) kopje e dokumentit të identifikimit të fëmijës;
- b) kopje e vërtetimit të lëshuar nga Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;
- c) kopje e dokumentit të identifikimit të personit që paraqet kërkesën për përfitim të shërbimit;
- d) deklaratë nga prindi ose kujdestari, në rastet kur fëmija do të banojë tek të afërmit/miq të për një periudhë të caktuar. Deklarata duhet të përcaktojë të dhënat e kryefamiljarit të familjes ku do të qëndrojë fëmija për një kohë të caktuar si dhe adresën e banimit. Në rastet e parashikuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, deklarata do të bëhet nga kujdestari ligjor i caktuar sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

KREU III

SHPENZIMET, HYRJA NË FUQI DHE INSTITUCIONET E NGARKUARA PËR ZBATIMIN E KËTJË UDHËZIMI

Neni 1

Mbulimi i shpenzimeve

1. Shpenzimet për mbulimin e shërbimit të duhur që do të marrë fëmija me aftësi të kufizuar në një njësi të qeverisjes vendore të ndryshme nga ajo ku jeton, do të mbulohen nga buxheti i të dyja njësive të qeverisjes vendore.

2. Mbulimi i shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në këtë udhëzim do të ndahen si më poshtë:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) shpenzimet për të siguruar kushtet e duhura të aksesueshmërisë në institucionin ku fëmija me aftësi të kufizuara do të marrë shërbimin do të mbulohen nga njësi vendore pritëse;
- b) shpenzimet për të siguruar mësues ndihmës për fëmijën me aftësi të kufizuara do të mbulohen nga institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar e njësisë vendore pritëse;
- c) të gjitha shpenzimet e tjera që sigurojnë kushtet lehtësuese në marrjen e shërbimit si transporti kur është i nevojshëm, tekstet shkollore apo edhe përfitime të tjera të sanksionuara me ligj, do të mbulohen nga institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar e njësisë vendore ku fëmija është i regjistruar.

Neni 2

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij udhëzimi

Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror, njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM

Nr. 262, datë 26.5.2021

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PUNËS PËR MENAXHIMIN E RASTIT TË FËMIJËS NË KONFLIKT ME LIGJIN, NGA PUNONJËSI I MBROJTJES SË FËMIJËS¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 38, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 84*. Tiranë 2021. f. 8641.

UDHËZUES

PËR METODOLOGJINË E PUNËS PËR MENAXHIMIN E RASTIT TË FËMIJËS NË KONFLIKT ME LIGJIN, NGA PUNONJËSI I MBROJTJES SË FËMIJËS

Lista e shkurtimeve

ASHDMF	Ajencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
Ligji për fëmijët	Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
IEVP	Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale
NJMF	Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve
NJVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
PIM	Plan individual i mbrojtjes
PMF	Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës
SIMF	Sistemi i integruar i mbrojtjes së fëmijëve

Përmbajtja

Hyrje

I. Qëllimi dhe përdoruesit e protokollit të punës

1.1 Qëllimi

1.2 Përdoruesit

II. Struktura e mbrojtjes së fëmijëve

III. Menaxhimi i rastit

3.1 Çfarë është menaxhimi i rastit

3.2 Veprimet paraprake

3.3 Identifikimi i rastit

3.4 Menaxhimi i rastit të fëmijës së moshës për përgjegjësi penale

3.4.1 Hetimi dhe gjykimi penal

a) *Vlerësimi i të miturit nga eksperti ose shërbimi i provës*

b) *Shmangia dhe ndërmjetësimi*

3.4.2 Ekzekutimi i dënimit/masës penale

3.4.3 Riintegrimi i të miturit

3.4.4 Menaxhimi i rastit të Arbrit

3.5 Menaxhimi i rastit të fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale

3.5.1 Regjistrimi i rastit

3.5.2 Vlerësimi fillestar

3.5.3 Vlerësimi i plotë

3.5.4 Hartimi i planit individual të mbrojtjes (PIM)

3.5.5 Zbatimi, ndjekja dhe monitorimi i PIM-it

3.5.6 Mbyllja e rastit

3.5.7 Menaxhimi i rastit të Eraldit

3.6 Pjesëmarrja në procese gjyqësore

3.7 Familja dhe roli i saj gjatë menaxhimit të rastit

3.7.1 Faktorët familjarë që ndikojnë në nivelet e delikuencës së të miturve

3.7.2 Faktorët mbrojtës

3.7.3 Strategjitë e ndërhyrjes: çfarë funksionon me familjet

Aneks 1

Modelet e akteve të PMF-së

Aneks 2

Njohuri specifike për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve

1. Parimet e përgjithshme dhe standardet

2. Rëndësia e pjesëmarrjes së fëmijës

3. Përvojat negative të fëmijërisë

Aneks 3

Fjalorth

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Hyrje

Shqipëria ka një popullsi prej 2.862.427 banorësh; prej tyre, 1.043.491 janë në moshën deri më 19 vjeç dhe 733.845 janë fëmijë nën 14 vjeç.¹

Sipas të dhënave policore, vetëm gjatë periudhës janar–qershor 2018 janë regjistruar 965 të mitur si të dyshuar për kryerjen e veprave penale, ndërsa gjatë gjithë vitit 2018 Prokuroria ka regjistruar 423 procedime penale dhe 481 të mitur si të pandehur/persona nën hetim për kryerjen e veprave penale. Veprat penale më të përhapura, janë: vjedhja e pasurisë (39% e të pandehurve të mitur), drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt (27% e të pandehurve të mitur), vepra kundër personit (15% e të pandehurve të mitur), vepra të lidhura me lëndët narkotike (4% e të pandehurve të mitur), prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve (3.5% e të pandehurve të mitur).² Të dhënat zyrtare i referohen vetëm grup-moshës 14–18 vjeç (për fëmijët në konflikt me ligjin nën moshën 14 vjeç nuk ka të dhëna zyrtare).

Në Shqipëri, gjatë vitit 2017, vepronin 223 punonjës të mbrojtjes së fëmijës (PMF), nga të cilët 45 punonjës kryenin vetëm këtë detyrë, ndërsa pjesa tjetër ishte ngarkuar edhe me detyra të tjera (administrim social, barazi gjinore, dhunë në familje, për personat me aftësi të kufizuara etj.). Gjatë vitit 2017 PMF-të kanë menaxhuar rreth 1650 raste të fëmijëve që kanë pasur nevojë për mbrojtje; prej tyre, 929 janë raste të reja, pjesa tjetër ka të bëjë me raste të identifikuar gjatë viteve të mëparshme (raste të mbartura) dhe të papërfunduara.³

Vitet e fundit, Shqipëria ka bërë përpjekje lidhur me krijimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë edhe fëmijët në konflikt me ligjin. Kështu, janë ndërmarrë disa hapa pozitivë, që përfshijnë miratimin e disa ligjeve (ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,⁴ ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe aktet nënligjore), si dhe ngritjen e strukturave të përkushtuara publike (Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, njësitë vendore për mbrojtjen e fëmijëve dhe grupet teknike ndërsektoriale *ad hoc*).

Një studim mbi “Mbrojtjen e fëmijëve për shkelësit e ligjit nën moshën 14 vjeç në Shqipëri”⁵, në vitin 2018, konfirmoi se kuadri ligjor shqiptar është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe siguron një qasje shumëdisiplinore ndaj fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje. Ligji thekson koordinimin e strukturave që mendohet të punojnë së bashku me role dhe përgjegjësi të ndara. Mirëpo, në praktikë, bashkëpunimi dhe koordinimi i strukturave është i dobët, profesionalizmi i tyre nuk është në nivelin e duhur dhe praktikat e punës nuk bazohen në instrumente (protokolle apo manuale) standarde dhe të unifikuara. PMF-të shpjegojnë se menaxhimi i rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin është një fushë e tyre e re, se legjislacioni ka pësuar ndryshime thelbësore dhe ata nuk kanë krijuar ende traditë për menaxhimin e këtyre rasteve.

Në përputhje me këtë sfond zhvillimesh është ndërmarrë nisma mbi hartimin e protokollit të punës lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin. Kjo është një nismë e përbashkët e *Defence for Children*, Holandë; *Terre des hommes*, Shqipëri dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF).

Struktura e protokollit të punës është orientuar që të lehtësojë kuptimin dhe përdorimin e tij. Pjesa e parë jep qëllimin dhe përdoruesit e këtij protokollit. Pjesa e dytë paraqet në mënyrë sintetike strukturat e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Pjesa e tretë dhe më e rëndësishmja përqendrohet në menaxhimin e rastit, duke e ndarë veçmas informacionin për fëmijët mbi moshën e përgjegjësisë penale, nga fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale. Në mënyrë që të lehtësohet përdorimi i protokollit, menaxhimi i rasteve është shoqëruar me raste praktike dhe me diagrame. Po ashtu, në *aneksin 1* të protokollit jepen disa modele aktesh për PMF-të gjatë menaxhimit të rastit të fëmijëve në konflikt me ligjin.

Në hartimin e protokollit të punës është mbajtur parasysh profili i punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve, i

¹ Të dhënat e datës 1 janar 2019, të llogaritura nga INSTAT-i dhe të publikuara në:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/>, e vizituar për herë të fundit më 14.8.2019.

² Shih: Raportin vjetor të prokurorit të përgjithshëm në lidhje me gjendjen e kriminalitetit drejtuar Kuvendit:

http://www.pp.gov.al/web/raporti_vjetor_2018_1571.pdf, e vizituar për herë të fundit më 14.8.2019.

³ Shih: <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Raporti-i-vitit-2017-i-Agjencis%C3%AB-Shtet%C3%ABrore-p%C3%ABr-t%C3%AB-Drejtat-dhe-Mbrojtjen-e-F%C3%ABmij%C3%ABs.pdf>, e vizituar për herë të fundit më 14.8.2019.

⁴ Ligji nr. 18/2017.

⁵ Shih http://tdh.europa.org/upload/document/7285/STUDY%20CHILD%20PROTECTION%20BELOW%2014_web.pdf, e vizituar për herë të fundit më 14.8.2019.

cili, sipas ligjit, duhet të jetë me formim punonjës social.¹ Gjithashtu, është pasur kujdes edhe situata aktuale në praktikë, sipas së cilës, 35% e punonjësve e përmbushin këtë kusht ligjor.² Teksti i protokollit është hartuar me një gjuhë të thjeshtë dhe praktike dy anekse të tij përmbajnë edhe një fjalorth termash teknikë, ku shpjegohet përmbajtja e koncepteve kyçe të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin.

I. Qëllimi dhe përdoruesit e protokollit të punës

1.1 Qëllimi

Protokolli i punës ka si qëllim standardizimin dhe unifikimin e procedurave në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin. Ai ofron një grumbull udhëzimesh praktike, që përbëjnë kornizën e strukturuar të rolit e punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve në menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin. Roli i PMF-së është shpjeguar hap pas hapi, duke ndjekur rastin prej referimit deri në mbyllje, si dhe duke treguar çdo aktor me të cilën punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet e veta.

Në këtë këndvështrim, është e pritshme që përdorimi i protokollit në praktikë ta përmirësojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional, si dhe të lehtësojë monitorimin dhe vlerësimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve në tërësinë e tij. Gjithashtu, është e pritshme që protokollin i punës ta rrisë edhe efektshmërinë e menaxhimit të rastit, të nxisë qasjen ndërsektoriale dhe të sigurojë mbështetjen e duhur për familjet e fëmijët në konflikt me ligjin.

1.2 Përdoruesit

Protokolli i punës i drejtohet në radhë të parë punonjësit të mbrojtjes së fëmijës, i cili, me ligj, ka rolin e menaxherit të rastit për fëmijën në konflikt me ligjin, që prej momentit të identifikimit ose i referimit, gjatë hartimit dhe zbatimit të masës së mbrojtjes dhe planit individual të mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.³

Gjithashtu, protokollin i punës i vjen në ndihmë çdo aktori i cili ka një rol apo ushtron përgjegjësi në sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës në konflikt me ligjin. Aktorë të tillë, janë: Policia e Shtetit, punonjësit e shërbimit social, psikologu, punonjësi social, punonjësit e shërbimit shëndetësor, punonjësit e arsimit, avokati mbrojtës, gjyqtari, prokurori, punonjësi i shërbimit të provës deri tek organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në këtë fushë. Secili prej këtyre aktorëve ka mundësinë që të kuptojë, me gjuhë të thjeshtë dhe praktike, rolin edhe përgjegjësitë e PMF-së. Rrjedhimisht, secilit prej këtyre aktorëve i ofrohet një instrument pune për të kuptuar edhe rolin dhe përgjegjësitë e tij në sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës dhe se si ai mund dhe duhet të bashkëpunojë me punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve.

Protokolli i punës është një mjet informues edhe për vetë fëmijën në konflikt me ligjin, si dhe për familjen e tij. Në këtë mënyrë, fëmija dhe familja e tij janë në gjendje ta identifikojnë rrethin e të drejtave dhe të shërbimeve që mund dhe duhet të kërkojnë lidhur me mbrojtjen e integruar, të ofruar nga ligji në fuqi.

Protokolli i punës i shërben edhe çdo strukture shtetërore apo organizmave të shoqërisë civile, që mbikëqyrin dhe monitorojnë sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës në konflikt me ligjin, veçanërisht veprimtarinë e punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve.

II. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës

Sistemi i integruar i mbrojtjes së fëmijës në konflikt me ligjin është i përbërë nga një numër organizatash/institucionesh, që punojnë së bashku për të njëjtin qëllim. Disa prej tyre përqendrohen në identifikimin e nevojave të fëmijës me qëllim sigurimin e mirëqenies së tij (shërbimet shëndetësore, sociale, arsimore dhe të strehimit) dhe zakonisht veprojnë në mënyrë të decentralizuar; të tjerat ofrojnë shërbim të centralizuar dhe shërbejnë në zbatimin e ligjit, duke siguruar që fëmija të mbajë përgjegjësi për veprën penale (policia, prokuroria, gjykata dhe shërbimi i provës). Kur menaxhohet rasti i fëmijës në konflikt me ligjin, është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët e shumtë veprues të sigurojnë harmoninë e duhur për të dhënë një rezultat në interesin më të lartë të fëmijës. Për këtë arsye në rrjetin e organizatave/institucioneve përfshihet edhe vetë fëmija, edhe familja dhe kujdestarët e tij ligjorë, komuniteti e shoqëria civile.

Duke iu referuar ligjit, strukturat që veprojnë për mbrojtjen e fëmijës mund të ndahen në dy nivele: *qendror* dhe *vendor*.

¹ Shih nenin 49, pika 2, ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

² Shih: Raportin vjetor 2017, të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, faqe 18.

³ <http://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2019/01/Raporti-i-vitet-2017-i-Agjencise-C3%AB-Shtet-C3%ABrore-p-C3%ABr-t-C3%AB-Drejtat-dhe-Mbrojtjen-e-F-C3%ABmij-C3%ABs.pdf>, e vizituar për herë të fundit më 14.8.2019.

³ Shih: nenin 51 në kombinim me nenin 3, pika 6, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Në nivel qendror bëjnë pjesë këto struktura:

- Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, i cili ka detyra këshillimore, politikëbërëse dhe koordinuese;
- ministri përgjegjës për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës (aktualisht ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes Sociale, i cili ka detyra drejtimi dhe monitorimi);
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, që ka detyra koordinimi dhe organizimi për sa u përket politikave të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës;
- çdo ministër, i cili, sipas fushës përkatëse, ka përgjegjësi të lidhura me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, siç janë ato në lidhje me drejtësinë apo me punët e brendshme;
- Avokati i Popullit, që monitoron zbatimin e të drejtave të fëmijëve;
- komisionari kundër diskriminimit dhe çdo komisionar tjetër, i cili mbron të drejta themelore;
- gjykata, prokuroria, Policia e Shtetit dhe shërbimi i provës, që sigurojnë lidhjen ndërmjet drejtësisë dhe sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve.

Në nivel vendor veprojnë:

- bashkitë, që janë përgjegjëse për ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës;
- struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, që kryesohet nga drejtori me detyra zbatuese lidhur me mbrojtjen e fëmijës;
- njësia e mbrojtjes së fëmijës, e atashuar në strukturën e shërbimeve sociale në bashki, me detyra në parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje;
- njësia e referimit dhe e vlerësimit në bashki, e cila përbëhet edhe nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës;
- grupi teknik ndërsektorial, që është strukturë *ad hoc* mbi vlerësimin e situatës së çdo fëmije, përgatitjen dhe miratimin e planit individual të mbrojtjes, rishqyrtimin e rastit, si dhe për të vendosur mbylljen e rastit.

III. Menaxhimi i rastit

3.1 Çfarë është menaxhimi i rastit

Menaxhimi i rastit është një metodologji e standardizuar, që siguron hap pas hapi ofrimin e vazhdueshëm dhe efektiv të ndihmës së fëmijës në nevojë për mbrojtje, duke synuar ndërkohë të promovojë e të nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e tij. Zbatimi i kësaj metodologjie siguron, gjithashtu, që rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtohen në mënyrë kompetente, në afatet të përcaktuara kohore, si dhe me standardet e duhura të shërbimit.

Menaxhimi i rastit në punën për mbrojtjen e fëmijëve mbështetet dhe drejtohet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, në nevojat e tij, në ligjin mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si edhe në bashkëpunimin e ngushtë mes aktorëve të ndryshëm, që kanë ndikim në jetën e fëmijës, duke përfshirë: prindërit, mësuesit, personelin shëndetësor, anëtarë të tjerë të familjes etj.

Procesi i menaxhimit të rastit të fëmijës në konflikt me ligjin, që është një fëmijë në nevojë për mbrojtje, ndjek hapat e mëposhtëm:

1. Identifikimi i rastit
2. Regjistrimi i rastit;
3. Vlerësimi fillestar;
4. Vlerësimi i plotë;
5. Hartimi i planit individual të mbrojtjes (PIM);
6. Zbatimi i planit individual të mbrojtjes;
7. Mbyllja e rastit.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës bën vetë identifikim aktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo sipas raportimeve/referimeve të marra nga institucione të tjera, nga OJF-të, nga anëtarë të komunitetit, nga publiku, nga vetë fëmija/ët dhe media. Ai bashkëpunon me policinë, me Shërbimin Social Shtetëror, si dhe me aktorë të tjerë të nevojshëm në menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Në bashkëpunim me grupin teknik ndërsektorial (GTN), punonjësi i mbrojtjes së fëmijës harton planin individual të mbrojtjes. Grupi teknik ndërsektorial funksion si një grup *ad hoc* në çdo bashki dhe njësi administrative bashkiake, dhe ka si qëllim trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Në të marrin pjesë: përfaqësues të strukturave të policisë; përfaqësues të strukturave të shërbimeve sociale; përfaqësues të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar; përfaqësues të strukturave shëndetësore; përfaqësues të strukturave të drejtësisë; përfaqësues të organizatave jofitimprurëse;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

çdo specialist tjetër i cili ka njohuri lidhur me situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës.

Qëllimi kryesor i menaxhimit të rasteve për mbrojtjen e fëmijëve është parandalimi dhe përgjigjja ndaj nevojave të fëmijëve të cilët përjetojnë ose rrezikojnë abuzim, nënvleftësim, dhunë dhe shfrytëzim përmes shërbimeve sociale që garantojnë të drejtat dhe mirëqenien e tyre.

Menaxhimi i rastit të fëmijës në konflikt me ligjin është një fushë pak a shumë e re në Shqipëri. Raportet për të drejtat e fëmijëve dhe statistikat e publikuara zyrtare tregojnë se rastet në praktikë pothuajse kanë munguar. Për këtë qëllim, në këtë kapitull shpjegohet në mënyrë të detajuar ecuria procedurale e rastit të fëmijës që hyn në konflikt me ligjin, duke ndjekur si aktor kryesor punonjësën e mbrojtjes së fëmijëve.

Për të pasur menaxhim të suksesshëm të rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin është e nevojshme që njësia e mbrojtjes së fëmijëve dhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijës të kryejnë disa veprime paraprake për të gjitha rastet e fëmijëve, pavarësisht nëse fëmija e ka mbushur ose jo moshën e përgjegjësisë penale.

Në Shqipëri, moshë minimale që lidhet me përgjegjësinë penale, është e caktuar nga Kodi Penal: 14 vjeç për krimet dhe 16 vjeç për kundërvajtjet penale. Kjo moshë është kusht që fëmija t'u nënshtrohet përgjegjësisë penale, pra, të akuzohet dhe të dënohet për kryerjen e një veprë penale (krimi ose kundërvajtje). Fëmijët që nuk kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale, nuk i nënshtrohen përgjegjësisë penale. Në këto raste, prokurori dhe, sipas rastit, gjykata janë të detyruar të vendosin mosfillimin e procedimit penal. Në qoftë se procedimi penal ka filluar dhe vërtetohet se fëmija nuk e ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale, atëherë vendoset menjëherë pushimi i çështjes penale.

Për fëmijët në konflikt me ligjin, sistemi i integruar i mbrojtjes së fëmijës ofron dy rrugë menaxhimi të rastit: vetëm rrugën civile për *fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale* dhe rrugën penale të ndërthurur me rrugën civile për *fëmijën e moshës së përgjegjësisë penale*. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës i fillon të dyja me *identifikimin e rastit*.

3.2 Veprimet paraprake

a) Lista e përfaqësuesve proceduralë

Njësia e mbrojtjes së fëmijëve në çdo bashki harton dhe përshtat (një herë në vit) listën e [përfaqësuesve proceduralë](#) për fëmijët në konflikt me ligjin dhe ua dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor, po ashtu edhe gjykatës përkatëse të apelit.

Në përpilimin dhe përshtatjen e kësaj liste, NJMF-ja zbaton kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit, i cili bashkërendon punën lidhur me çështjet e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës dhe ministrit të Drejtësisë.

Për ta lehtësuar këtë proces, është e këshillueshme që çdo njësi e mbrojtjes së fëmijëve ta administrojë informacionin e nevojshëm mbi organizimin gjyqësor, të prokurorisë dhe të Policisë së Shtetit, që vepron në territorin e bashkisë apo të njësisë së saj administrative.

b) Përgatitja e informacioneve të përkushtuara

Për ta lehtësuar procesin e raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, duke përfshirë edhe fëmijët në konflikt me ligjin, vetë ligji i detyron strukturat e mbrojtjes së fëmijës të vendosin njoftime me informacionin e kontaktit në të gjitha institucionet publike apo private të përkujdesjes së fëmijës, të arsimit dhe shëndetësisë.

Nga ana tjetër, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), vetë ose në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse, vë në dispozicion një linjë telefoni pa pagesë me një numër të publikuar gjerësisht, dhe është e detyruar të verifikojë e të referojë pranë njësive për mbrojtjen e fëmijës apo pranë strukturave të tjera kompetente çdo rast të raportuar. Linja telefonike Alo 116 është tashmë në shërbim të të gjithë fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si një projekt i zbatuar në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse.

c) Informacion mbi organizatat që ofrojnë shërbime

Njësia e mbrojtjes së fëmijëve ka detyrimin t'i identifikojë të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike e jopublike të mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë, duke përfshirë: përfaqësues nga shërbimet e kujdesit alternativ, të shërbimit shëndetësor, psikologjik, social, ligjor; punonjës të specializuar të rendit, përfaqësues të organit të prokurorisë dhe të institucioneve arsimore. Ndërkohë PMF-ja u kërkon në rrugë zyrtare organizatave jofitimprurëse informacion të detajuar me shkrim lidhur me shërbimet konkrete që ofrojnë për fëmijët në konflikt me ligjin; si dhe për licencimin, statusin e tyre ligjor dhe mënyrën e organizimit që kanë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ç) Përgatitja e statistikave dhe përpunimi i tyre

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve ka detyrimin t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar në lidhje me fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësive administrative përkatëse.

Raportimi bëhet dy herë në vit (më datë 30 maj dhe 30 nëntor) edhe te drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki, i cili i paraqet rezultatet në mbledhjen e Këshillit bashkiak, ku diskutohet buxheti, si dhe kërkon përditësimin e fondit për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, nëse kjo është e nevojshme.

Në shtesë të këtyre detyrimeve ligjore duhet theksuar se përgatitja e statistikave dhe përpunimi i tyre u shërben strukturave të nivelit vendor edhe për të analizuar cilësinë e punës së tyre, si dhe që të marrin masat e duhura në drejtim të përmirësimit të saj.

d) Veprimet parandaluese

Parandalimi është ndërhyrja në faza të hershme të fëmijët në rrezikshmëri për të kryer vepra penale. Neni 49, pika "e"¹ e KDPM-së parashikon rolin edukues dhe informues të njësive të mbrojtjes së fëmijëve në drejtim të identifikimit në moshë të hershme të fëmijëve në rrezik për të kryer vepra penale dhe, më tej, për t'u përfshihen në sistemin e drejtësisë penale për të mitur.

Gjithashtu, në ligjin për fëmijët (neni 65 dhe neni 66) parashikohet i njëjti rol i NJMF-së për fëmijët që nuk e kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale. Ky rol përmbushet nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve përmes përfshirjes në planin individual të mbrojtjes, ofrimit të ndërhyrjes dhe shërbimeve të nevojshme për riintegrimin e tij, duke pasur parasysh shumë elemente të përfshira, si dhe *përvojat negative të fëmijërisë*,² nivelin e rrezikshmërisë e, më tej, planin e këshillimit për fëmijët dhe prindin. Që të hartojë një plan të tillë, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në Grupin teknik ndërsektorial në çdo rast duhet të ftojë një psikolog. Po ashtu, PMF-ja mbikëqyr zbatimin e masës së specializuar për këta fëmijë, ku përfshihen: vijimi i procesit mësimor, pjesëmarrja në aktivitete, ndalime të caktuara etj.

Aktivitetet parandaluese kanë qëllim ta ulin sa më tepër mundësinë e kryerjes së veprave penale dhe duhet t'i ndërgjegjësojnë prindërit, se është shumë e rëndësishme përfshirja e tyre në programe këshillimi që e përmirësojnë prindërimin dhe ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

Identifikimi i rastit

Fëmija hyn në konflikt me ligjin atëherë kur verifikohet kryerja e një vepre penale, për të cilën ai dyshohet se është autor. Hapi i parë në menaxhimin e një rasti të tillë është identifikimi i rastit nga njësia e mbrojtjes së fëmijëve dhe kjo bëhet në dy forma: nga vetë njësia e mbrojtjes së fëmijëve ose nga të tretët, që e referojnë rastin tek ajo (NJMF-ja).

Njësia e mbrojtjes së fëmijëve mund ta identifikojë vetë rastin, duke u bazuar tek informacionet që i siguron nga ushtrimi i detyrave të saj, po ashtu edhe kur bazohet në informacione të bëra publike nëpërmjet medias së shkruar, medias elektronike apo asaj sociale.

Mënyra tjetër e identifikimit – raportimi nga të tretët – ka formën e referimit që tregon informacionin-bazë për identifikimin e rastit. Por duhet pasur kujdes, se mungesa e disa elementeve në aktin e raportimit apo të referimit nuk përbën arsye që njësia e mbrojtjes së fëmijëve të mos veprojë. Raportuesi ka detyrimin ta ofrojë informacionin që ka në dispozicion, dhe kjo nënkupton se ndonjëherë informacioni mund të jetë i paplotë, prandaj duhet punuar aktivisht për identifikimin e plotë të rastit.

Raportimi ose referimi i rasteve ka rëndësi thelbësore, sepse është metodë me të cilën materializohet parimi i ndarjes së përgjegjësisë në mbrojtjen e fëmijëve. Kjo është arsyeja pse ligji për fëmijët e cilëson "referimin e rastit"³ si pjesë përbërëse të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve.

Njësia e mbrojtjes së fëmijëve merr raportime apo referime të rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin nga këto burime:

¹ Ta ndërgjegjësojë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës.

² Menaxhimi i suksesshëm i rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin kërkon vëmendje mbi përvojat negative të fëmijërisë. Për këtë arsye, në *aneksin 2*, pika 3 e këtij protokoll i jepet informacion i zgjeruar mbi vlerësimin e këtyre përvojave, si dhe formularët përkatës.

³ Ligji vendos mekanizmin e referimit në shumë veprime procedurale të sistemit të mbrojtjes së fëmijës, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimeve për të cilat ka nevojë fëmija.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- çdo person fizik ose juridik, duke përfshirë edhe vetë fëmijën, si dhe familjen e tij. Ky lloj raportimi mund të shkojë drejtpërdrejt te njësia e mbrojtjes së fëmijëve ose te Policia e Shtetit, e cila, po qe se i vjen informacioni, ka detyrimin ta referojë rastin te NJMF-ja;


- çdo punonjës i institucioneve publike ose private, që vjen në kontakt me fëmijën për arsye të profesionit dhe merr informacion se fëmija ka hyrë në konflikt me ligjin. Raportimi mund të shkojë drejtpërdrejt te njësia e mbrojtjes së fëmijëve ose te Policia e Shtetit, kjo e fundit, në qoftë se e merr informacionin, ka detyrimin ta referojë rastin te NJMF-ja;

- mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor, të cilët marrin informacion se fëmija ka hyrë në konflikt me ligjin. Ky lloj raportimi mund të shkojë drejtpërdrejt te njësia e mbrojtjes së fëmijëve ose te njësia arsimore vendore. Kjo e fundit ka detyrimin ta referojë rastin te NJMF-ja;

- çdo punonjës i institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private. Ky lloj raportimi shkon menjëherë te njësia e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe te drejtori i institucionit dhe te Policia e Shtetit;

- çdo punonjës policie dhe prokuroria janë të detyruar ta referojnë menjëherë rastin te punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki ose në njësinë administrative ku është konstatuar vepra penale, për kryerjen e së cilës dyshohet fëmija nën moshën 14 vjeç.

Grafik që tregon institucionet të cilat referojnë raste te Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës



3.4 Menaxhimi i rastit të fëmijës së moshës për përgjegjësi penale

Rasti i Arbrit

Arbri është një djalë 16 vjeç, fëmijë i dy prindërve të divorcuar për shkak të dhunës në familje. Familja e tij ka edhe probleme ekonomike.

Në moshën 12-vjeçare Arbri hyri për herë të parë në konflikt me ligjin, pasi mori pjesë në vjedhjen e një makine së bashku me shokë më të rritur në moshë. Pak ditë pasi kish mbushur 16 vjeç, gjatë një konflikti të çastit, ai goditi me thikë një nxënës në shkollë. Një polic, që u ndodh aty pranë, e arrestoi menjëherë për plagosje të rëndë me dashje ndaj shokut të shkollës.

Fëmijët që e kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri në 18 vjeç,¹ kur dyshohen se kanë kryer një veprë penale, procedohen përmes sistemit të [drejtësisë penale për të mitur](#). Ndaj tyre fillon procedimi penal, i cili zhvillohet në tri faza të ndryshme, që përfshijnë: a) hetimet paraprake; b) gjykimin dhe dënimin; c) ekzekutimin e masës/të dënimit penal.

¹ Legjislacioni ynë tashmë njeh edhe kategorinë e të rinjve të moshës 18–21 vjeç, që kanë specifikat e veta dhe të dallueshme nga të rriturit mbi 21 vjeç. (Trajtimi i kësaj kategorie nuk është objekt i këtij protokoll pune.)

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Qëllimi i rrugës penale ndryshon nga qëllimi i rrugës civile. Rruga penale synon të mbrojë sigurinë publike, duke identifikuar dhe duke vënë para përgjegjësisë penale autorin e veprës penale. Por, meqë ai (autori i veprës penale) është ende fëmijë, kjo rrugë synon edhe që ta mbështesë atë, duke pasur parasysh nevojat e tij, po ashtu edhe duke e integruar në mënyrë të suksesshme në shoqëri. I mituri, jo vetëm që gëzon tërë të drejtat për një proces sipas rregullave të ligjeve në fuqi, por, mbi të gjitha, edhe për të marrë mbrojtje të veçantë.

Përgjatë rrugës penale duhet të përmbushen disa objektiva. Kështu, duhet identifikuar shkalla e përgjegjësisë së të miturit dhe duhet gjetur masa më e përshtatshme, që i shërben edukimit dhe rehabilitimit të tij. Gjithashtu, duhen bërë të gjitha përpjekjet për ekzekutimin e suksesshëm të masës që merret ndaj atij fëmije.

Rruga penale ka në qendër interesin më të lartë të fëmijës dhe të drejtat e tij të veçanta. Në përmbushje të këtij objekti, gjatë procesit penal kryhen vlerësimet individuale të të miturit, të cilat shërbejnë për t'i përshtatur nevojat e tij në programe edukimi dhe rehabilitimi në mënyrë që të bëhet i mundur riintegrimi i atij fëmije, duke e ulur kështu edhe mundësinë e përsëritjes së situatës së mëparshme. Por, nga ana tjetër, rregullat e KDPM-së synojnë ta rrisin edhe përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e organeve kompetente, në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur.

Rruga penale mund të ndahet në tri etapa, që janë:

1. Parandalimi përmes ndërhyrjes në fazë të hershme të fëmijës në rrezikshmëri për kryerjen e veprave penale;

2. Fazë e procedimit penal, e cila përfshin të gjithë hapat dhe ndërveprimin e të miturit me institucionet e sistemit të drejtësisë. Vetëprocedimi penal zhvillohet në tri faza: a) hetimet paraprake; b) gjykimi dhe dënimi; c) ekzekutimi i masës/dënimit penal;

3. Fazë e riintegrit, e cila nis prej momentit kur i mituri është ende në kryerjen e dënimit dhe vazhdon edhe pas kryerjes së këtij dënimi.

Sistemi i drejtësisë penale për të mitur parashikon një seri profesionistësh, të cilët janë të përfshirë në hapa të ndryshëm të procedimit penal. Të gjithë ata persona që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur, duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Profesionistët që kanë kontakte me të miturin gjatë ndërveprimit të tij me sistemin e drejtësisë, janë:

- punonjësit e policisë.
- prokurori;
- gjyqtari;
- punonjësi i qendrës së rehabilitimit për të mitur dhe i paraburgimit;
- punonjësi i shërbimit të provës;
- punonjësi i njësive për mbrojtjen e fëmijës;
- ndërmjetësi;
- avokati;
- psikologu;
- përkthyesi;
- përfaqësuesi procedural.

Njësia e mbrojtjes së fëmijëve është e përfshirë në të gjitha fazat, që kalon procesi penal në ngarkim të të miturit, madje edhe pas përfundimit të atij procesi penal, deri në riintegrimin e të miturit. Pra, përveç shërbimeve të paraqitura në rrugën civile, kryesisht edhe në parandalimin dhe ndërhyrjen në rastin e fëmijëve në rrezikshmëri (nën 14 vjeç), NJMF-ja duhet të bashkëpunojë me të gjitha institucionet e tjera të sipërpërmendura në rrugën penale.

Duke u nisur nga tipologjia e veprimeve dhe përgjegjësi, ¹ roli i njësive të mbrojtjes së fëmijëve mund të ndahet në tri faza: a) roli gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale, ku roli është i njëjtë; b) roli gjatë ekzekutimit të dënimit/masës penale; c) roli në riintegrimin e të miturit.


¹ Kuadri i zbatueshëm ligjor në këtë rast përbëhet nga: Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, ligji për fëmijët, VKM-ja nr. 635, datë 26.10.2018, "Mbi veprimtarinë e strukturave mbi mbrojtjen e fëmijës, për fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet apo ka kryer vepër penale"; VKM-ja nr. 578, datë 3.10.2018, "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit"; VKM-ja nr. 207, datë 10.4.2019, "Mbi përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet në përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin".

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Diagrami për menaxhimin e rastit në rrugë penale

Menaxhimi i rastit të fëmijëve mbi 14 vjeç

Ky grafik u referohet rasteve kur fëmija në konflikt me ligjin e ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe i nënshtrohet ndjekjes penale, por ndaj tij zbatohet shmangia ose caktohet një masë alternative (jo dënim me burgim).



3.4.1 Hetimi dhe gjykimi penal

Hetimet paraprake fillojnë me njoftimin për veprën penale. Ato përmbajnë, gjithashtu, kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme procedurale në lidhje me mbledhjen e provave mbi veprën penale dhe autorin e saj. Gjatë kësaj faze, kur janë kushtet e caktuara nga ligji, mund të vendoset edhe masë sigurimi, duke përfshirë edhe “arrestin në burg”. Organi kompetent që vepron në këtë fazë, është prokurori i cili drejton hetimet, po ashtu dhe policia gjyqësore që kryen të gjitha veprimet e treguara nga prokurori.

Identifikimi i një fëmije të përfshirë në sistemin e drejtësisë mund të bëhet në çdo hallkë të procesit, por zakonisht në këtë situatë kontaktin e parë me fëmijën e merr punonjësi i policisë, i cili e referon rastin te Njësia e mbrojtjes së fëmijëve dhe bashkëpunon në vijim për menaxhimin e tij (rastit) sipas rrugës civile. Si vlerësimi parë kur merret një referim i tillë, është siguria e menjëhershme e fëmijës. Më tej, punonjësi i Njesisë së mbrojtjes së fëmijëve ndjek hapat standardë të përcaktuar në rrugën civile. Për sa i takon procesit penal, roli i kësaj njësie është orientues dhe këshillues për një seri profesionistësh.

Njësia e mbrojtjes së fëmijëve kryen të njëjtin rol edhe gjatë gjykimit të çështjes penale, që fillon me kërkesë të prokurorit dhe me vendim të gjyqtarit të seancës paraprake, kur, nga hetimet paraprake, del se ka prova të mjaftueshme që e mbështesin akuzën kundër të pandehurit. Gjykimi i çështjes përfundon me dhënien e vendimit të (pa)fajësisë për të pandehurin.

Në të dyja këto faza të procedimit penal, Njësia e mbrojtjes së fëmijëve kontribuon në veprimet të mëposhtme procedurale:

a) *Vlerësimi i të miturit nga eksperti ose shërbimi i provës*

Gjatë hetimit paraprak ose gjykimit penal të të miturit kryhet vlerësimi i tij individual nga një ekspert psikolog ose nga shërbimi i provës. Në këtë rast, punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve jep informacion tek eksperti psikolog ose te shërbimi i provës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Duke qenë se, menjëherë pas referimit të rastit, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ka detyrimin të kryejë vlerësimin fillestar dhe të plotë të fëmijës, është e qartë se *ai zotëron një informacion të rëndësishëm për disa fusha në të cilat ka pasur qasje, siç janë: mikromjedisi ku jeton fëmija, historia shkollore, historia mjekësore, të dhëna për situatën social-ekonomike të familjes*. Për këtë arsye ai i jep informacion dhe porosi ekspertit të caktuar nga prokuroria/gjykata për kryerjen e vlerësimit.

Po ashtu, për kryerjen e vlerësimit individual, KDPM-ja (neni 47, pika 7) lejon të komunikohet lirisht me të miturin, si dhe të merret informacion prej kujtdo që e disponon atë. Megjithatë, për të mos pasur një riviktimizim të veprimeve të të miturit, mosidentifikim të tij, si dhe për faktin që rrethanat social-ekonomike janë të lidhura më shumë me pozicionin e punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve, nuk rekomandohet që këtë mbledhje të dhënash në komunitet ta kryejnë persona të tjerë. Ky rekomandim nuk duhet zbatuar kur mbledhja e të dhënave është në interesin më të lartë të fëmijës dhe e domosdoshme për vlerësimin.

Me qëllim që të zbatohet roli i psikologut, sipas parashikimeve të KDPM-së, urdhri i psikologut ka vënë në dispozicion të gjykatave një listë të psikologëve ndihmës (neni 18), si dhe një listë të psikologëve vlerësues (neni 47), të cilat i ka hartuar duke pasur parasysh formimin profesional dhe trajnimet e posaçme të psikologëve.

Në këtë fazë, duke marrë një kontakt të zgjeruar edhe me persona të tjerë, që kanë lidhje me të miturin, njësia e mbrojtjes së fëmijëve mbledh të dhëna paraprake nëse kanë të bëjnë me rastin, “*përvoja negative të fëmijërisë*”, dhe i referon ato te psikologu vlerësues. Të dhënat në fjalë janë me rëndësi për t’i kuptuar në mënyrë sa më të plotë rrethanat që kanë ndikuar tek i mituri dhe e kanë çuar deri në kryerjen e veprës penale.

b) Shmangia dhe ndërmjetësimi

Në një proces konsultimi, njësia e mbrojtjes së fëmijëve mund të përfshijë aktorë të tjerë: *prokurori, gjykata apo ndërmjetës për proceset e shmangies¹ apo të ndërmjetësimit*. Por, nëse palët japin pëlqim, ajo (NJMF) mund të marrë pjesë edhe në procesin e ndërmjetësimit, po ashtu edhe në atë të shmangies.

Shmangia përbën një lloj zhvendosje të të miturit nga sistemi i drejtësisë penale, por duke e bërë atë të përgjegjshëm për veprimet që ka kryer. NJMF-ja mund ta ndihmojë procesin, duke i ofruar prokurorit/gjyqtarit/ndërmjetësit/prindit/të miturit mendimin e saj në këtë proces, ashtu sikurse vepron edhe në vlerësimin e kryer nga ekspertët siç jepet në pikën “a” më lart.

Këto mënyra për zgjidhjen e çështjes në ngarkim të të miturit përqendrohen më tepër te rehabilitimi sesa te ndëshkimi. Ky përqendrim duhet të drejtohet te shkaqet që e çuan fëmijën në këtë situatë, dhe më pas të propozohen edhe ndërhyrje të orientuara në trajtimin e tyre. Kjo rrugë e bën fëmijën më të përgjegjshëm për veprimet e tij dhe shmang kështu një ndërveprim me sistemin e drejtësisë që do ta lëndonte së tepërmi.² Një përparësi tjetër në këtë drejtim është pajtimi i autorit me viktimën, si dhe shmangia e identifikimit të fëmijës në institucionet e sistemit të drejtësisë.

3.4.2 Ekzekutimi i dënimit/masës penale

Vendimi penal vihet në ekzekutim kur merr formë të prerë, domethënë kur ndaj atij nuk ka pasur ankim, por gjithashtu edhe në rastet kur është ushtruar ankim dhe gjykatat më të larta kanë vendosur mbi ankimin. Veprimi më i rëndësishëm gjatë kësaj faze është hartimi, miratimi dhe sigurimi i përmbushjes së planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit nga ana e NJMF-së së bashku me aktorë të tjerë pjesëmarrës, në kohën kur i mituri merr dënimin.

Kur të miturit i është hequr liria për shkak burgimi ose paraburgimi, atëherë NJMF-ja informohet për datën e mbarimit të dënimit nga ana e IEVP-së, pasi merr pjesë në hartimin e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit, e miraton dhe siguron përmbushjen e tij. Këto veprime kryhen deri në 3 muaj para liritimit. Në të njëjtën fazë NJMF-ja merr informacion nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale lidhur me nivelin e rrezikut familjar dhe shoqëror, si dhe për nevojat e fëmijës jashtë sistemit ndëshkues.

Në hartimin e planit individual për të miturin në këto raste, duhet pasur parasysh:

- mosha e të miturit;
- gjendja mendore dhe emocionale;
- nevojat e veçanta;

¹ Me “shmangie” nënkuptohet masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të KDPM-së.

² UNICEF - *Workshop on Justice for Children, January 2009*.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- mënyra e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen;
- edukimi ose puna;
- motivet e kryerjes së veprës penale;
- qëndrimi pas kryerjes së veprës penale;
- rrethana të tjera që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve dhe në mbikëqyrjen e tyre.

Nuk duhet harruar se, në përfundim të gjykit, kur gjykata vendos që i mituri është fajtor, masa e fundit për të është dënimi me burgim. Si rregull, ndaj të miturit në konflikt me ligjin, gjykata përcakton një ose disa detyrime për t'u përmbushur, të tilla si: një lloj programi arsimor, një program formimi profesional, një program social punësimi, riparimin e një dëmi civil, një program rehabilitues psikologjik apo mjekësor, mosfrekuentimin e vendeve të caktuara apo mosshoqërimin me persona të veçantë (KDPM, neni 102). Në këtë rast, organi kompetent që ndjek përmbushjen e detyrimit nga i mituri, caktohet në vendimin e gjykatës, duke mbajtur parasysh llojin e detyrimit.

Vendimin nr. 207/2019, i Këshillit të Ministrave, jep një listë treguese të këtyre organeve, në nivel qendror dhe vendor, e shoqëruar me përgjegjësitë dhe procedurat e tyre. Në sigurimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve, përveç NJMF-së, përcaktohet edhe një ose më shumë autoritete përgjegjëse dhe¹ çdo një prej tyre zbaton planin e vet të trajtimit me të miturin, po ashtu edhe me familjen e tij.

Në varësi të formës së vuajtjes së dënimit që ka marrë fëmija (me burg apo masë alternative) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës mban kontakte me IEVP-në apo me zyrën lokale përkatëse të shërbimit të provës. Sot, në sistemin e burgjeve në Shqipëri ka vetëm një, institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale për të miturit – IEVP-ja në Kavajë, prandaj është i domosdoshëm forcimi dhe bashkëpunimi mes NJMF-ve të ndryshme.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet trajtimit të familjes si në rastin kur fëmija ka marrë dënim alternativ, ashtu edhe kur ai ka marrë dënim me burg. Për këtë, NJMF-ja komunikon me njësinë e vlerësimit e referimit të rasteve.

Familja luan një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e sjelljes së të miturit dhe të integritetit të tij në shoqëri pas përfundimit të dënimit, prandaj gjatë zbatimit të planit me familjen, duhet të kihet parasysh disa elemente që ndihmojnë në përfshirjen e familjarëve në programin e ndreqjes së sjelljes së të miturit, si: respektimi i kulturës së familjes, krijimi i besimit dhe komunikimi efektiv me familjarët.

Në hartimin e planit të shoqërizimit dhe rehabilitimit duhet të kihet parasysh në radhë të parë ndihma për të miturin, që ai ta kuptojë se çfarë ndikimi negativ mund të kish pasur sjellja e tij keqbërëse ndaj një viktime të mundshme apo ndaj komunitetit; të kuptojë, gjithashtu, shkaqet që e çuan në kryerjen e asaj veprë. Plani në fjalë duhet të specifikojë edhe mënyrën se si të miturit duhet të pajisen me njohuri dhe aftësi, të bëjnë trajnime, aktivitete; të kenë formim profesional dhe marrëdhënie pozitive.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës duhet t'i nxitë e t'i ndihmojë të miturit dhe familjet e tyre për t'i njohur dhe pranuar përgjegjësitë e tyre. I mituri dhe familja duhet të vihen në dijeni të këtij plani deri në 24 orë pasi është miratuar. PMF-ja bashkëpunon me ekipin, edhe me psikologun në rastet kur ka probleme të veçanta.

Një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet seancave këshilluese individuale lidhur me orientimin profesional të të miturit, me zgjedhjen e një kursi profesional që përputhet me interesat dhe prirjet e tij. Në këtë proces, të miturit i duhen ofruar alternativa të ndryshme dhe të përshtatshme, prandaj është shumë e rëndësishme që në planin individual të shënohen mënyrat dhe protokollet e komunikimit midis autoriteteve, kur, për zbatimin e tij, vepron më shumë se një organ përgjegjës sipas vendimit gjyqësor që ka caktuar detyrimet ndaj të miturit.

Këto aktivitete duhet të përfshihen në plan dhe vetë plani duhet të monitorohet gjatë periudhës së zbatimit të tij, e cila përfshin edhe periudhën pas lirimit nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale apo pas përfundimit të kohës së provës. Po ashtu, në rastet e të miturve, dënimi i të cilëve është konvertuar në kohë prove me detyrimin për ndjekjen e procesit mësimor, PMF-ja duhet të mbajë marrëdhënie dhe kontakte periodike me drejtoritë arsimore apo me mësuesin e të miturit, që janë pjesë e Grupit teknik ndërsektorial për të verifikuar mbarëvajtjen e tij në shkollë.

3.4.3 Riintegrimi i të miturit

Riintegrimi është një fazë që nis në kohën kur i mituri është duke kryer dënimin penal e vazhdon edhe pas kryerjes së dënimit. Kjo mënyrë konceptimi e fazës së riintegritetit të të miturit nga ana e KDPM-së e zbut gjendjen e tij të dikurshme, kur ai, pasi përfundonte dënimin, ishte krejtësisht i shpëputur, i turbulluar, i papërgatitur dhe pa asnjë pikësynim.

¹ Shih: urdhër i brendshëm i Ministrisë së Drejtësisë, nr. 367, datë 15.7.2019, "Mbi miratimin e formatit të planit individual për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin".

Në varësi të ndryshimit të rrethanave, si dhe progresit të trajtimit të të miturit, njësia e mbrojtjes së fëmijëve vijon koordinimin e veprimeve për zbatimin e planit të hartuar, i cili është pasuruar ndërkohë me ndryshime të mundshme gjatë kohës që i mituri kryente dënimin. Në këtë fazë, PMF-ja bën kujdes që, pas përfundimit të dënimit, i mituri të integrohet sa më natyrshëm në rutinën e jetës së përditshme në shoqëri.

Në rastin e të miturve që e kanë kryer dënimin në kohë prove, ky plan zbatohet nëpërmjet përfshirjes së tij në aktivitete të ndryshme, pasi, duke qenë në gjendje lirie, ai nuk e ndërpret jetesën pranë familjes, as edukimin dhe as mënyrën e jetesës së përditshme.

Për të miturit që e kanë kryer dënimin në IEVP, është i nevojshëm një monitorim më i shpeshtë dhe intensiv. Faza e riintegritetit kërkon më tepër mbështetje për këta fëmijë, pasi për periudha pak a shumë të gjata, ata kanë qenë të shkëputur nga jeta e përditshme e moshatarëve të tyre, nga familja, edukimi dhe marrëdhëniet sociale.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka parashikuar, që në këtë fazë duhet të sigurohet njësia e mbrojtjes së fëmijëve, sepse pas daljes nga institucioni, siguria që duhet t'i ofrohet të miturit atij është element kyç, ashtu si dhe plotësimi i nevojave kryesore jetësore: strehim, veshje etj., dhe shërbime të tjera të specializuara. PMF-ja ndërkohë, falë angazhimit në fazën e mëparshme, mundëson lidhjet e duhura për të miturin me shërbime të specializuara që ndryshojnë sipas rastit, si edhe me përfshirjen e tij në aktivitete të ndryshme.

3.4.4 Menaxhimi i rastit të Arbrit

Arbri ishte një i ri në moshën e përgjegjësinë penale për krime (ishte 16 vjeç), prandaj rasti i tij u menaxhua në rrugë penale.

Hetimi dhe gjykimi

Gjatë hetimeve paraprake, po ashtu edhe gjatë gjykimit, prokurori dhe gjykata bashkëpunuan me punonjës të mbrojtjes së fëmijëve në njësine administrative të Bashkisë së Durrësit, ku jetonte Arbri, i cili e regjistroi rastin dhe hapi një dosje, duke i caktuar edhe numrin përkatës. Në vijim të procesit, prokurori i çështjes e informoi PMF-në se kishte caktuar ekspertin psikolog (nga lista e psikologëve ekspertë në sistemin e drejtësisë) për të kryer vlerësimin e të miturit, duke u bazuar në nenin 47, të KDM-së. Vlerësimi i psikologut do të shërbente edhe gjatë gjykimit.

Prokuroria dhe eksperti i caktuar psikolog për kryerjen e vlerësimit të të miturit, i kërkuan punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve informacione lidhur me rrethanat social-ekonomike të fëmijës, për gjendjen e tij familjare, si dhe rrethana të tjera të veçanta. Në përfundim të gjykimit, Arbri u dënua me 2 vjet burg.

Ekzekutimi i vendimit

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës u lidh me institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale në Kavajë dhe e njoftoi se rasti i ishte referuar Njesisë së vlerësimit dhe referimit të rasteve për punën me familjen. NJVRR-ja, nga ana e vet, vendosi kontakte me nënën e djalit, si dhe u përpoq të komunikonte edhe me babanë e tij. Ndërkohë juristi i institucionit, kreu llogaritjen e saktë të kohës së mbetur të dënimit dhe IEVP-ja Kavajë ia përcolli këtë njoftim punonjësit të mbrojtjes së fëmijës.

Gjatë qëndrimit në IEVP, Arbri u trajtua nga psikologu i institucionit për problemet me sjelljen dhe ndoqi një kurs profesional.

Rreth 4 muaj para se të përfundonte dënimi, IEVP-ja i dërgoi punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve një raport mbi vlerësimin dhe situatën e të miturit, duke kërkuar prej tij (PMF) bashkëpunim për hartimin e një plani rishoqërizimi dhe rehabilitimi. Ky i fundit punoi së bashku me njësine e vlerësimit (NJVRN), si dhe me nënën e të miturit, e cila, duke pasur një punë të lodhshme, mjaft përvoja negative jetësore, por dhe stres të madh, e kishte humbur vëmendjen ndaj fëmijës dhe nuk kishte mundur të ruante një marrëdhënie të shëndetshme me të. Fryt i këtij bashkëpunimi ishte edhe rivendosja e marrëdhënies me Arbrit dhe të atit.

Në përfundim të këtij plani rishoqërizimi dhe rehabilitimi, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës nënvizoi një element të rëndësishëm vështirësie, që e priste Arbrin pas daljes nga burgu, marrëdhënia e tensionuar me shokun e plagosur dhe familjen e tij. Për këtë ai (PMF-ja) u lidh me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve dhe kërkoi ndihmën e një ndërmjetësi me qëllim normalizimin e marrëdhënieve me të miturve dhe familjes së viktimës. Ndërmjetësi u bë pjesë e Grupit teknik ndërsektorial.

Në përfundim, pas hartimit të planit të rishoqërizimit, u vendos:

- të miturit t'i gjendej punë si mekanik, duke qenë se kishte përfunduar një kurs të tillë në IEVP;
- ndërmjetësi të identifikonte mundësitë për të normalizuar marrëdhënien me Arbrit dhe shokut të shkollës (atë që pati plagosur);

Përmbledhje legjislacioni për të miturit


- punonjësi i mbrojtjes së fëmijës të gjente burime në komunitet në lidhje me sigurimin e disa mundësive bazë jetese (veshje etj.) për Arbrin pas daljes nga burgu.

Periudha pas lirimit

Në përfundim të dënimit, u arrit që Arbrin ta priste një situatë më e qetë dhe bashkëpunuese familjare, si dhe një interesim më i madh të prindërve ndaj zhvillimit dhe ecurisë së tij të përditshme. Gjithashtu, duke qenë se gjatë qëndrimit në institucionin e dënimit ai kishte ndjekur kursin e mekanikut, iu mundësua edhe gjetja e një pune në atë zanat.

Pas daljes së Arbrit nga burgu, u vijua me procesin e ndërmjetësimit në lidhje me shokun e plagosur dhe familjen e tij. Në këtë proces ndërmjetësimi u thirr edhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijës për të ndihmuar në shpjegimin e disa proceseve që kishin ndodhur gjatë gjithë kohës dhe përpjekjeve të të miturit, me ndihmën e profesionistëve, për ta ndryshuar dhe modifikuar sjelljen e tij. Në fund të këtij procesi u nënshkrua një marrëveshje ndërmjetësimi.

Nëntë muaj pasi Arbri kishte dalë nga burgu, PMF-ja hartoi një raport për mbylljen e suksesshme të rastit, ku shpjegonte me hollësi se si ishte arritur interesi më i lartë i të miturit gjatë menaxhimit të rastit. Raportin e paraqiti në Grupin teknik ndërsektorial, i cili vendosi edhe mbylljen e rastit, duke dalë në përfundimin se tashmë Arbri ishte jashtë rrezikut dhe nuk kishte shqetësime të tjera. Duhet theksuar se faktorët rrezikues në këtë histori qenë shumë më tepër sesa ata mbrojtës, por rasti i Arbrit u menaxhua në mënyrë të suksesshme nga një grup profesionistësh.



3.5 Menaxhimi i rastit të fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale

Rasti i Eraldit

Eraldi është 14 vjeç. Jeton në Durrës vetëm me babanë, pasi e ëma u largua nga shtëpia kur ai ishte vetëm 6 vjeç dhe qysh atëherë nuk pati asnjë kontakt me të. Kjo familje e vogël jeton në varfëri. Babai është invalid dhe pensioni i tij mujor është e ardhura e vetme e familjes.

Dalëngadalë Eraldi filloi të mos shkonte rregullisht në mësim deri sa u shkëput fare nga shkolla. Psikologu i shkollës, duke qenë se punonte në disa shkolla, e kishte të pamundur që t'i kushtonte atij kohën e nevojshme. Kështu, i mituri filloi të shoqërohej me fëmijë me probleme të ngjashme me të; të rritur po ashtu si ai, edhe ata anëtarë të komunitetit, por që kishin sjellje antishoqërore.

Kur ishte rreth 13 vjeç, Eraldi pati kontaktin e parë me policinë, por ai vazhdoi përsëri të përfshihej në sjellje antishoqërore dhe të ndalohej nga policia. Oficerët e policisë i kishin kërkuar disa herë të atit të Eraldit që të ishte i pranishëm në komisariatën e policisë kur merrej në pyetje i biri. Babai kishte shprehur aty dyshimet që Eraldi mund të përdorte drogë, pasi ishte bërë i dhunshëm ndaj të tij. Madje puna arriti deri aty sa ai kërkoi dy herë urdhër mbrojtjeje. Ndoshta edhe për arsye të paaftësive fizike babai nuk e menaxhon dot Eraldin.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Duhet nënvizuar se, kur fëmija nën moshën e përgjegjësisë penale hyn në konflikt me ligjin, rasti i tij menaxhohet vetëm në rrugë civile. Menaxher i rastit është punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, i cili e kryen këtë funksion që nga identifikimi i rastit deri në mbylljen e tij.

Nëpërmjet rrugës civile synohet përmbushja e **objektivave** të mëposhtëm:

- mbrojtja e të miturit duke marrë në parasysh interesin e tij më të lartë;
- parandalimi, identifikimi, vlerësimi, mbrojtja dhe ndjekja e rasteve të të miturve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje;
- punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim dhe në koordinim me institucionet e tjera, ndërmerr veprimet e caktuara sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet apo ka kryer një vepër penale;
- forcimi i përgjegjësisë të prindërve/kujdestarëve si përgjegjës kryesisht për mbrojtjen e të miturit dhe eliminimin e rreziqeve që e rrethojnë atë;
- fuqizimi i mjedisit shoqëror/komunitetit për t'i ofruar mbështetje të miturit dhe prindërve/kujdestarëve të tij.

Garantimi i mbrojtjes për të miturit është përgjegjësi e përbashkët, që përfshin të gjithë aktorët e mëposhtëm:

- prindërit/familjen/kujdestarët të cilët kanë përgjegjësi kryesore për fëmijën;
- të miturin (në varësi të moshës së tij);
- komunitetin, që u ofron ndihmë dhe mbështetje prindërve/kujdestarëve për të përmbushur përgjegjësitë/detyrimet e tyre;
- shtetin i cili ofron shërbimet e nevojshme për të gjitha familjet/kujdestarët dhe ka autoritetin të përdorë masat e mbrojtjes të parashikuara me ligj për të plotësuar çdo nevojë të të miturit të shkakuar nga mungesa ose paaftësia e prindërve/familjes/kujdestarëve, si dhe për të garantuar sigurinë dhe zhvillimin e tij (të miturit).

Për mbrojtjen e fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet apo ka kryer vepër penale, përfshihen këto struktura dhe mekanizma:


- Bashkia;
- Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe Njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit;
- Policia;
- Prokuroria;
- Grupi teknik ndërsektorial;
- Autoritete apo shërbime të tjera në nivel lokal.

Strukturat e mbrojtjes së fëmijës marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e rastit të fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën e përgjegjësisë penale. Ato angazhojnë njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe Grupin teknik ndërsektorial për hartimin e planit individual të mbrojtjes, që përmban një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndërhyrje te shërbime të tjera të nevojshme për riintegrimin e miturit.

Në menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ofron përkujdesje sociale dhe bashkëpunon e shkëmben informacion me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore; me struktura të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendore kombëtar, si dhe me shoqërinë civile. Gjithashtu, ai ka një bashkëpunim të pandërprerë gjatë tërë hapave me të miturin dhe familjen e tij. Ndër të tjera, ka për detyrë edhe që ta lehtësojë dhe ta mbështesë fëmijën dhe/ose familjen e tij në përmbushjen e veprimeve ose të detyrave të përcaktuara në planin individual të mbrojtjes.

Menaxhimi i rastit për fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili ka hyrë në konflikt me ligjin, kalon në 7 faza: 1) identifikimi i rastit; 2) regjistrimi i rastit; 3) vlerësimi fillestar; 4) vlerësimi i plotë; 5) hartimi i PIM-it; 6) zbatimi i PIM-it; 7) mbyllja e rastit.¹

¹ Kuadri i zbatueshëm ligjor për fëmijët në konflikt me ligjin, të cilët nuk e kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale, rregullohet nga ligji për fëmijët, VKM-në nr. 635, datë 26.10.2018, "Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës në lidhje me fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale, që dyshohet apo ka kryer vepër penale" dhe VKM-në nr. 578, datë 3.10.2018, "Për procedurat e referimit dhe të menaxhimit të rastit".



3.5.1 Regjistrimi i rastit

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës e identifikon rastin duke u bazuar në informacionet e veta ose me referim nga të tretët. Rolin kryesor në referimin e këtyre rasteve e luajnë punonjësit e policisë dhe prokuroria, që, për arsye të detyrës, janë struktura kryesore, të cilat regjistrojnë kryerjen e veprave penale dhe e njoftojnë PMF-në e bashkisë ose të njësisë administrative ku është konstatuar vepra penale.

Veprimi i parë i PMF-së, pas identifikimit të rastit, është hapja e dosjes për fëmijën në konflikt me ligjin, e cila përmban të gjitha dokumentet e mbledhura gjatë menaxhimit të rastit, si dhe regjistron çdo veprim që kryhet. Fëmijës i caktohet një numër, i cili është dhe numri i tij identifikues gjatë tërë procesit të menaxhimit. Ky numër përdoret në të gjitha komunikimet, përveç rastit kur është e nevojshme të përdoret emri i fëmijës, për efekt të referimit apo të ndërhyrjeve lidhur me mbrojtjen e tij.

3.5.2 Vlerësimi fillestar

Me hapjen e dosjes, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës procedon me vlerësimin fillestar, që është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut, duke u bazuar në informacionin që ka nga identifikimi ose raportimi, si dhe nga informacioni i cili mund të merret prej institucioneve, organizatave apo personave të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën. Ky lloj vlerësimi kryhet sa më shpejt të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi i rastit.

Gjatë vlerësimit fillestar, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës përcakton:

- nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër, duke pasur parasysh sigurinë, mbrojtjen fizike, shëndetin e fëmijës dhe nevojën për masë emergjente të mbrojtjes;
- nevojat bazë për sa u përket: ushqimit, higjienës, strehimit dhe kujdesit shëndetësor;
- shërbimet e domosdoshme, me qëllim përmbushjen e nevojave të identifikuara në kushtet e emergjencës.

Pas intervistës fillestare me fëmijën apo pas verifikimit të gjendjes së tij, nëse fëmija nuk është në gjendje të flasë apo të merret në pyetje, të dhënat e marra nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, dokumentohen menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 orë nga vlerësimi fillestar.

Në bazë të këtij vlerësimi fillestar, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës që regjistron rastin, ka kompetencë për të marrë masat e menjëhershme që nuk presin, siç është p.sh. masa emergjente e mbrojtjes, e cila ka të bëjë me largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen e tij në përkujdesje alternative në situatat e përshkruara nga neni 56, i ligjit për fëmijët.

Por duhet pasur kujdes, që kjo masë merret në raste të jashtëzakonshme dhe duhet përdorur si mjet i fundit. Sipas rrethanave, një masë e tillë merret edhe nëse fëmija e ka vendbanimin në një territor tjetër.

Kur punonjësi i mbrojtjes së fëmijës konstaton se fëmija e ka vendbanimin në një bashki ose njësi tjetër administrative, e referon rastin atje. Caktimi i kompetencës së PMF-së mbështetet në parimin e decentralizimit, sipas të cilit, fëmija duhet të marrë shërbimet e duhura dhe të nevojshme me sa më lehtësi për vete dhe familjen e tij.

3.5.3 Vlerësimi i plotë

Vlerësimi i plotë i situatës së fëmijës në konflikt me ligjin është një proces që kryhet nga strukturat e

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve dhe Grupin teknik ndërsektorial.

Ky lloj vlerësimi kryhet për çdo rast të fëmijës në konflikt me ligjin, që sipas ligjit për fëmijët, cilësohet si fëmijë në nevojë për mbrojtje. Vlerësimi në fjalë ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e planit individual të mbrojtjes.

Gjatë vlerësimit të plotë, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës përcakton:

- nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, si dhe faktorët e rrezikut;

- nevojat e fëmijës, në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij, po ashtu dhe nevojat e familjes;

- faktorët mbrojtës, në veçanti pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e fëmijës, të familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë;

rezultatit e procesit të punësimit të masës nga gjykata, për në rastet kur për fëmijën është marrë një masë emergjente mbrojtjeje, si dhe vlerësimin e kushteve të institucionit, të personit apo të familjes kujdestare pranë së cilës është vendosur fëmija, në kuadër të masës.

Për realizimin e procesit të vlerësimit të plotë, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës duhet të veprojë në këtë mënyrë:

- të kryejë të paktën një vizitë në shtëpinë e fëmijës dhe të dhënat/informacionin e marrë gjatë asaj vizite t'i hedhë në formularin për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime;

- të realizojë një intervistë me fëmijën, motrat/vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, siç tregohet në formularin e intervistës;

- për realizimin e vizitave në familje, në rastet kur është e nevojshme për arsye sigurie apo kur prindi nuk është bashkëpunues dhe nuk e lejon vizitën apo takimin e PMF-së me fëmijën/fëmijët e tjerë të familjes, ky i fundit (PMF) kërkon që gjatë kryerjes së vizitës në familje të shoqërohet nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Pas mbledhjes së të gjithë informacionit të nevojshëm për rastin, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës plotëson formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut.

Vlerësimi i plotë kryhet brenda 20 ditëve pune nga vlerësimi fillestar. Gjatë kësaj periudhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ka detyrimin të mbledhë Grupin teknik ndërsektorial, në rastet kur fëmija në nevojë për mbrojtje është në nivel rreziku të mesëm dhe të lartë. Në rastet e rrezikut të ulët, ai e mbledh GTN-në vetëm nëse e vlerëson si të nevojshme.

Vlerësimi i plotë për rastet e rrezikut të menjëhershëm kryhet nga PMF-ja brenda 5 ditëve, që prej miratimit të masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i sektorit të shërbimeve shoqërore në bashki. Vendimi për masën e mbrojtjes dhe vlerësimi i plotë i kalojnë për miratim gjykatës.

3.5.4 Hartimi i planit individual të mbrojtjes (PIM)

Pas vlerësimit të rastit, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës bashkëpunon në mënyrë konkrete me strukturat publike dhe private, që të identifikohen shërbimet dhe programet e posaçme të mbrojtjes për fëmijën në konflikt me ligjin, me qëllim edhe krijimin e mundësive dhe të alternativave të përshtatshme. Gjithashtu, në rrugë zyrtare, ai kërkon nga organizata jofitimprurëse një informacion të detajuar me shkrim, lidhur me: a) shërbimet konkrete që ofruan për fëmijën ajo organizatë; b) licencimin e saj, c) statusin ligjor dhe mënyrën e organizimit të saj.

Marrja e këtij informacioni është i rëndësishëm, sepse shërben për të hartuar projektplanin individual të mbrojtjes, të cilin e bën PMF-ja pas plotësimit të formularit të vlerësimit dhe analizës së rrezikut dhe mbi bazën e nevojave të identifikuara të rastit. Projektplani përmban veprimet, ndërhyrjet, si dhe shërbimet e nevojshme për të ulur nivelin e rrezikut. Gjithashtu, bëhet kujdes që, nëse konstatohet se seancat e këshillimit ndaj prindërve të fëmijës janë të pamjaftueshme, atëherë merren masa për forcimin e aftësive të tyre prindërore.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ose drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki u dërgon anëtarëve të Grupit teknik ndërsektorial formularin dhe projektin e PIM-it, formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut, së bashku me kërkesën për mbledhjen e grupit. Në atë mbledhje anëtarët e GTN-së, *së pari*, përmbysin vlerësimin e plotë, duke e shqyrtuar dhe plotësuar, sipas rastit, informacionin e hedhur në formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut; *së dyti*, shqyrtojnë hartimin e PIM-it dhe bëjnë rekomandimet përkatëse për ndërhyrjet apo shërbimet e nevojshme që kanë të bëjnë me rastin, duke caktuar detyrat për secilin anëtar të GTN-së, me afatet përkatëse, po ashtu si dhe cilat

shërbime apo ndërhyrje kanë nevojë të mbulohen me shpenzime nga ana e bashkisë.

Brenda dy ditëve pune nga mbledhja e GTN-së, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pasqyron në formularin e vlerësimit, në analizën e rrezikut dhe në projektplan, ndryshimet për të cilat kanë qenë në një mendje anëtarët e Grupit teknik ndërsektorial. Këtë dokument ai ia paraqet për miratim drejtorit të strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki së bashku me formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut, shoqëruar edhe me rekomandimet e GTN-së.

Drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki, brenda dy ditëve pune, e miraton PIM-in, duke u bazuar në propozimin e punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve dhe Grupit teknik ndërsektorial, si dhe merr masat për prokurimin e shërbimeve, shpenzimet e të cilave janë të pambuluara në PIM-in i propozuar. (Një kopje e PIM-it duhet të mbahet në dosjen individuale të fëmijës.)

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës bën të gjitha përpjekjet për të siguruar bashkëpunimin e familjes dhe të fëmijës në realizimin e PIM-it. Ai diskuton me ta, i shpjegon fëmijës dhe anëtarëve të familjes përmbajtjen e atij dokumenti. Më të bashkëpunojnë edhe punonjësit e tjerë të NJMF-së, NJVNR-së apo dhe ofrues të shërbimeve shoqërore publike e private, duke e mbështetur nëse fëmija dhe/ose anëtarët e familjes së tij paraqesin vështirësi në të kuptuarin, shprehjen apo ndërveprimin e nevojshëm për zbatimin e PIM-it.

3.5.5 Zbatimi, ndjekja dhe monitorimi i PIM-it

Çdo institucion, autoritet apo ofrues shërbimi i përcaktuar në PIM, është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve, të veprimeve, ndërhyrjeve apo ofrimit të shërbimeve të përcaktuara po aty (në PIM) për fëmijën, prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes së tij.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës referon zyrtarisht (me shkresë) te shërbimet e përcaktuara në PIM; kërkon informacion, sipas afateve të përcaktuara në PIM; njofton drejtorin e strukturës përgjegjëse, në nivel vendor, në rastet kur koordinimi dhe ndërveprimi institucional është i vështirë; referon tek ASHDMF-ja rastet kur autoritetet shtetërore nuk bashkëpunojnë e as ndihmojnë në qasjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve; kryen rishqyrtimin zyrtar të PIM-it; bën vizita të rregullta në familje ose pranë institucionit/kujdestarit apo një personi tjetër, pranë të cilit është vendosur fëmija. Gjithashtu, ai merr informacione mbi:

- fëmijën dhe marrëdhëniet e tij me familjen e origjinës, vëllezërit, motrat;
- zbatimin e veprimeve dhe të detyrave të PIM-it dhe sa efektive kanë qenë ato;
- rivlerësimin e nivelit të rrezikut dhe të nevojave të fëmijës e familjes së tij;
- hartimin e PIM-it të rishikuar.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës i përditëson të dhënat për rastin në formularin e shqyrtimit të progresit dhe bën ndryshimet përkatëse në planin individual për mbrojtjen e fëmijës.

3.5.6 Mbyllja e rastit

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës raporton te Grupi teknik ndërsektorial për mbylljen e rastit, nëse, pas rishqyrtimit të PIM-it, arrin në përfundimet e mëposhtme:

- fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera. Këtu bëhet fjalë për një menaxhim të suksesshëm të rastit;
- fëmija ka mbushur moshën 18 vjeç, prandaj ai e ka humbur cilësinë “fëmijë” dhe ka dalë jashtë sistemit të mbrojtjes së fëmijës;
- fëmija ka vdekur. Kjo hipotezë mund të verifikohet përgjatë tërë fazave të menaxhimit të rastit dhe përbën shkak që të mbyllet rasti, pa pasur nevojë për kryerjen e veprimeve të tjera;
- fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim dhe dosja e tij është transferuar. Këtu bëhet fjalë për mbyllje të rastit nga PMF-ja, në bashkinë apo njësinë administrative të së cilës, fëmija kishte pasur vendbanimin apo vendqëndrimin e mëparshëm.

3.5.7 Menaxhimi i rastit të Eraldit

Policia kishte episode të përsëritura me fëmijën (Eraldin), i cili ishte përfshirë në sjellje kriminale, kështu që e referoi rastin te njësia e mbrojtjes së fëmijës.

Duke qenë se fëmija ishte nën moshën për përgjegjësi penale, rasti i tij u menaxhua vetëm në rrugë civile nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, i cili e kryen këtë funksion që nga identifikimi i rastit gjer në mbylljen e tij. Kështu, ai e identifikoi rastin përmes referimit nga policia dhe hapi menjëherë një dosje për fëmijën, duke i vendosur edhe një numër çështjes. Gjithashtu, përgatiti vlerësimin paraprak, duke u përqendruar në nivelin e rrezikut, por duke u bazuar edhe në informacionin e dhënë nga oficeri i policisë, si dhe babai i fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashkëpunim me punonjësin social të NJVNR-së bëri një vlerësim të rastit; më pas hartoi planin individual të mbrojtjes bashkë me Grupin teknik ndërsektorial, ku merrnin pjesë: oficeri i policisë, psikologu, mësuesi, punonjësi social i Njesisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit. Me të gjithë aktorët pjesëmarrës për këtë rast konkret, GTM-ja zhvilloi një mbledhje, në të cilën u miratua plani individual i mbrojtjes për Eraldin, i propozuar nga PMF-ja. Në mbledhje u kërkuar për t'u dëgjuar edhe Eraldi bashkë me të atin. GTN-ja propozoi që babait t'i ofroheshin disa seanca këshillimi.

Plani individual i mbrojtjes për Eraldin u hartua duke e vlerësuar rastin në mënyrë të plotë nga ana e PMF-së, i cili i kushtoi rëndësi të veçantë interesit më të lartë të fëmijës. Kështu, ai bëri vizitë në familjen e djalit, kreu intervistë me të, me babanë e tij, si dhe me ish-mësuesit e shkollës ku kishte qenë Eraldi para se të dënohej.

Plani i mbrojtjes përcaktoi disa pika kryesore, që ishin:

- ripërfshirja në procesin edukativ dhe ndjekjen nga psikologu/punonjësi social shkollor;
- referimi në shërbim të specializuar psikologjik për problemet e sjelljes, i cili do të ofrohej në qendrën komunitare shumëfunktionale;
- rindërtimi i marrëdhënies me babanë;
- seanca për forcimin e aftësive prindërore për babanë;
- paketa ushqimore.

Gjatë gjithë kohës, PMF-ja në bashkëpunim me punonjësin social të NJVNR-së, ishin në kontakte të vazhdueshme me të gjithë aktorët e përfshirë në rastin konkret, duke u informuar në lidhje me progresin e rastit, me sfidat dhe problemet që dilnin, deri në mbylljen e tij. Kështu, u arrit përmirësimi i marrëdhënies baba-fëmijë, Eraldi u kthye në shtëpi dhe mendonte të vazhdonte shkollën. U duk qartë dhe një ulje e ndjeshme e problemeve të mëparshme në sjellje siç ishin: kundërshtimi i autoritetit, i normave; largimet pa lajmëruar nga shtëpia, braktisja e shkollës, pjesëmarrja në konflikte, mungesë kontrolli dhe agresivitet.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësi social i NJVNR-së e ndoqën progresin e fëmijës, duke bashkëpunuar me aktorët e ndryshëm dhe duke zhvilluar vizita të rregullta në familjen e tij, si dhe duke mos e reshtur punën sistematike për fuqizimin e familjes.

Pas 6 muajve që zgjati menaxhimi i këtij rasti, PMF-ja raportoi në GTN se si ishte zbatuar plani individual i mbrojtjes, duke treguar edhe se si ishte arritur interesi më i lartë i fëmijës. Me masat e marra nga ai plan Eraldi iu rikthye shkollës. Tashmë ai e ka përmirësuar marrëdhënien me të atin. Shërbimet e ofruara nga qendra qendrën komunitare shumëfunktionale e ndihmuan, gjithashtu, edhe babanë për t'i forcuar aftësitë prindërore, duke e menaxhuar më mirë sjelljen e djalit.

3.6 Pjesëmarrja në procese gjyqësore

Gjatë menaxhimit të rastit të fëmijës në konflikt me ligjin, pavarësisht nga mosha e fëmijës, Njësia e mbrojtjes së fëmijës dhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijës marrin pjesë edhe në proceset gjyqësore, që zhvillohen për masat emergjente të mbrojtjes apo për masat e mbrojtjes. Kështu, ata janë pjesëmarrës për gjykime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, e cila vepron në territorin e bashkisë apo të njesisë administrative. Nëse kundër vendimit gjyqësor të shkallës së parë bëhet ankim, atëherë gjykimi vijon në Gjykatën e Apelit, që është kompetente për të shqyrtuar apelin ndaj vendimit gjyqësor.

Pjesëmarrja e PMF-së dhe NJMF-së shfaqet në formë të ndryshme, që bën të nevojshme hartimin e akteve të veçanta procedurale. Duhet theksuar se aktet që depozitohen në gjykatë, duhet të respektojnë një formë të caktuar nga Kodi i Procedurës Civile.

Në shtesë të këtyre elementeve, PMF-ja duhet t'i kushtojë rëndësi edhe arsytimit mbi interesin më të lartë të fëmijës, rasti i të cilit është duke u trajtuar. Kjo pjesë e arsytimit duhet të konkretizohet për t'u përshtatur rastit konkret dhe duke eliminuar, me aq sa është e mundur, përgjithësimet dhe vlerësimet abstrakte. Kështu, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës paraqet **kërkesat në gjykatë për vlefshmërinë e masës** emergjente ose të masës së mbrojtjes (ligji për fëmijët, neni 59, pika 4).

Një dokument tjetër i rëndësishëm për pjesëmarrjen në gjykim është **deklarata e fëmijës**, e cila jepet gjatë procesit të verifikimit të situatës së fëmijës dhe mund të administrohet si një provë *ex-officio* (ligji për fëmijët, neni 63). Deklarata e fëmijës konsiderohet e vlefshme, pavarësisht nga mënyra e regjistrimit të saj, me shkrim apo me mjete audiovizive, gjithmonë në prani të një psikologu dhe me pëlqimin e fëmijës mbi 10 vjeç.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës merr pjesë në seancë gjyqësore, ku, krahas shpjegimeve, paraqet edhe **kërkimet për prova** (ligji për fëmijët, neni 51, pika 2, shkronja "F"). Gjithashtu, PMF-ja ka detyrë të

përgatitë **çdo dokument** që kërkohej nga gjykata (ligjit për fëmijët, neni 58, pika 5, shkronja “c” dhe bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe/ose institucione të tjera që administrojnë informacion.

Një akt tjetër është **ankimimi gjyqësor**, kur PMF-ja vlerëson se nuk është dakord me mënyrën se si e ka zgjidhur çështjen gjykata.¹

3.7 Familja dhe roli i saj gjatë menaxhimit të rastit

Edukimi i përshtatshëm i fëmijëve është përgjegjësia kryesore e prindërve, sepse vlerat që u jepen fëmijëve dhe lloji i edukimit që ata marrin nga prindërit, duket se përcaktojnë në një masë të madhe stilin e tyre të ardhshëm të jetës. Prindërit i ndihmojnë fëmijët për të krijuar qëndrime të caktuara të sjelljes dhe, pasi t'u jenë krijuar ato qëndrime, është e vështirë të ndryshohen. Prindërit, që shfaqin qëndrime dhe sjellje antisociale të fëmijët e tyre, nxisin zhvillimin e qëndrimeve të njëjta (antisociale) në të ardhmen.

Zhvillimi i fëmijëve ka aspekte emocionale, intelektuale, sociale dhe fizike me familjen, që është themeli mbi të cilin ndodh ky zhvillim. Struktura e familjes luan një rol të rëndësishëm në formimin e një fëmije, duke garantuar siguri dhe duke zhvilluar vlerat, aftësitë e tyre.

3.7.1 Faktorët familjarë që ndikojnë në nivelet e sjelljes së ulët të të miturve

a) Qëndrimet e prindërve

Familja është burimi kryesor i mbështetjes, i dashurisë dhe sigurisë për fëmijët. Natyra e marrëdhënies mes prindërve dhe fëmijëve ndihmon të përcaktohet nëse një fëmijë do të bëhet një keqbërës. Në një shtëpi ku zotëron dashamirësia, mbështetja për njëri-tjetrin dhe mirëkuptimi, përcillet sjellje shoqërore konformiste dhe konstruktive, sepse një mjedis pozitiv familjar çon në zhvillimin e shëndetshëm të personalitetit. Në të kundërt, mungesa e dashurisë dhe e mbështetjes së prindërve ose, në raste më të rënda, indiferentizmi prindëror, armiqësia ose refuzimi, bën që fëmijët të ndihen të pasigurt nga ana emocionale, dhe kjo çon në një zhvillim të dobët të personalitetit të tyre, duke u nxitur kështu një sjellje antisociale. Qëndrimet negative të prindërve shpesh përfshijnë edhe tallje dhe mungesë dashurie ndaj fëmijëve.

Një qëndrim tjetër negativ është ai i prindërimit autoritar, kur kontrolli i tepërt, duke përdorur madje dhe komanda të ashpra e të rrepta, ua heq mundësinë fëmijëve për t'u shprehur lirshëm. Mungesa për t'u shprehur në mënyrë të lirshme dhe mungesa e dashurisë i nxisin fëmijët që të rebelohen kundër prindërve, të ikën nga shtëpia dhe për rrjedhojë, të hyjnë në një jetë krimi.

Qëndrimet negative të prindërve, duke përfshirë edhe fshehjen e informacionit ose dështimin për t'u përgjigjur pyetjeve, kanë treguar se nxisin ndjenja të pasigurisë emocionale dhe sociale të fëmijët. Një pasiguri e tillë mund të degjenerojë te fëmijët dhe t'u krijojë atyre probleme mendore ose mund t'i çojë në sjellje rrugaçërie.

b) Niveli i kohezionit familjar

Glenn Shields dhe Richard D. Clark², studiues të marrëdhënies në familje, në botimin e tyre të përbashkët “Komunikimi familjar dhe delinkuenca” theksojnë që komunikimi midis anëtarëve të familjes, përgjithësisht pranohet si një nga aspektet më të rëndësishme të marrëdhënies ndërnjerëzore dhe shihet si një çelës për të kuptuar dinamikën në themel të marrëdhënies familjare. Ata vërejnë se, nivele të ulëta të kohezionit familjar, ka gjasa që çojnë në krime të të miturve. Po kështu edhe studiuesi e kërkuesi social, S. Sarantakos³ në botimet e tij me statistika nga këto kërkime tregojnë se 73% e keqbërësve të mitur vinin nga familje me kohezion të ulët, ndërsa vetëm 27% e shkelësve vinin nga familje me kohezion të lartë. Ai, gjithashtu, zbuloi se, ndërsa 91% e joshkelësve vinin nga familje me kohezion të lartë, vetëm 9% e joshkelësve vinin nga familje me nivel të ulët kohezioni.

c) Niveli i dhunës

Niveli i dhunës mes prindërve dhe ndaj fëmijëve të tyre mund të ndikojë, gjithashtu, në nivelet e sjelljes së keqe të miturve. Sipas hulumtimeve të S. Sarantakos, 78% e fëmijëve në konflikt me ligjin e kishin prejardhjen nga familje që përjetonin dhunë fizike dhe abuzim, ndërsa vetëm 22% e fëmijëve në konflikt me ligjin vinin nga familje jo të dhunshme.

ç) Mospërfshirja në prindërim

Mospërfshirja në prindërim apo moskryerja e detyrave prindërore ka të bëjë me situatat kur prindërit u

¹ Për të lehtësuar punën e PMF-së, në aneksin 1 të këtij protokolli, jepen disa modele të këtyre akteve.

² Clark, Richard D., and Glenn Shields, “Family communication and delinquency”, *Adolescence*, vol. 32, no. 125, 1997, p. 81+. Accessed 29 May 2020.

³ Mwangi, R.K. (2019) The Role of Family in Dealing with Juvenile Delinquency. *Open Journal of Social Sciences*, 7, 52–63: <https://doi.org/10.4236/jss.2019.73004>

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

rrinë larg fëmijëve nga pikëpamja emocionale, u shprehin pak ngrohtësi dhe dashuri, pothuaj nuk u kushtojnë vëmendje, u shmangen me qëllim, kanë pak kërkesa për sjelljen e tyre dhe nuk marrin kurrë pjesë në aktivitetet shkollore, e në përgjithësi janë tepër të mbingarkuar me problemet e veta, sa nuk kanë kohë të merren me fëmijët.

Sarantakos argumenton se të miturit në konflikt me ligjin ka më shumë të ngjarë të vijnë nga familje me prindër që nuk bashkëpunojnë në familje, se sa nga ata me prindër që janë të interesuar për fëmijën e tyre. Sipas hulumtimeve të tij, afërsisht dy të tretat e të miturive në konflikt me ligjin, vinin nga ato familje ku prindërit nuk tregonin interes për fëmijët.

3.7.2 Faktorët mbrojtës

Faktorët mbrojtës ndihmojnë për të kuptuar karakteristikat dhe situatat që i mbrojnë fëmijët në konflikt me ligjin dhe i largojnë ata nga kryerja e sjelljeve antisociale. Faktorët mbrojtës janë karakteristika ose kushte që i lehtësojnë rreziqet, mundësojnë zvogëlimin e ndikimit negativ të lidhur me faktorët e rrezikut dhe i ndihmojnë të rinjtë ta zgjidhin situatën e tyre në mënyrë më të suksesshme.

Disa nga faktorët mbrojtës të lidhur me familjen janë:

- praktikat e duhura të prindërimit janë shoqëruar me një drejtim më të ulët të sjelljes, siç është keqbërja dhe përdorimi i drogës dhe i alkoolit;
- mbikëqyrja prindërore, dashuria për prindin dhe disiplinimi i vazhdueshëm dhe këmbëngulës janë faktorët më të rëndësishëm në shfaqjen e aftësive mbrojtëse dhe ripërtëritëse të të rinjve në rrezik, që sjellin dhe uljen e mundësive për t'u shoqëruar me bashkëmoshatarët keqbërës;
- marrëdhëniet harmonike familjare dhe një marrëdhënie e mirë me prindërit ofrojnë mbrojtje kundër sjelljes së keqe në të gjitha moshat, si midis djemve edhe mes vajzave;
- mbështetja dhe përfshirja e prindërve e zvogëlojnë rrezikun që fëmijët të përfshihen në aktivitete të kundërligjshme;
- kur krahasohen të gjitha familjet që jetojnë në një lagje të varfër, ato me dy prindër duket se kanë një efekt më të fortë mbrojtës. Sidoqoftë, familjet me një prind të vetëm që jetojnë në një lagje të sigurt dhe të qetë, nuk janë më në rrezik, se sa familjet e tjera;
- integrimi i familjeve në jetën e lagjes, kohezioni i fortë shoqëror, disponueshmëria e burimeve dhe e shërbimeve brenda lagjes, si dhe përfshirja e familjes në aktivitete jashtëshkollore dhe shkollore janë, gjithashtu, faktorë mbrojtës.

3.7.3 Strategjitë e ndërhyrjes: Çfarë funksionon me familjet?

Në programet që merren me familjen, janë të përshtatshme të ndiqen tri strategji ndërhyrjeje: programet e edukimit të prindërve, të terapisë familjare dhe të qasjes së integruar.

1. *Programet e edukimit të prindërve* në thelb janë hartuar që ta përmirësojnë përgjegjësinë dhe sjelljet prindërore. Këto programe përpiqen t'i mësojnë prindërit të përdorin teknikat e duhura të disiplinimit, të ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontroll të ekuilibruar, si dhe të vënë kufij të qartë e të qëndrueshëm për fëmijët dhe të rinjtë që nuk priren t'i ndjekin rregullat.

2. *Programet e terapisë familjare* ndjekin një qasje në shumë drejtime, duke kombinuar seancën e trajnimit të prindërve, seancën e trajnimit të të rinjve dhe përmirësimin e dinamikës së familjes. Zakonisht këto programe kryhen nga terapistë të kualifikuar në një mjedis klinik.

3. *Programet e qasjes së integruar* bazohen në parimin se fëmija dhe familja e tij nuk jeton në izolim. Një ndërhyrje efektive duhet ta vendosë familjen fillimisht në mjedisin e vet dhe pastaj të përqendrohet në faktorët e rrezikut që vijnë nga fusha të ndryshme (p.sh., komuniteti, fqinjët, shkolla, miqtë, familja dhe vetë fëmija); më tej të zhvillojë një qasje të integruar, e cila përfshin një numër partnerësh kyçë: shërbimet shëndetësore dhe sociale, të edukimit, shërbimet juridike, të shëndetit mendor, të abuzimit me substancat etj.

ANEKS 1

MODELET E AKTEVE TË PMF-së

1. Formë standarde (formular) për regjistrimin e rastit dhe hapjen e dosjes

REGJISTRIMI I RASTIT DHE HAPJA E DOSJES	
Emri dhe mbiemri i PMF-së që regjistron rastin, si dhe bashkinë ku ai kryen funksionin	
Emri i fëmijës:	
Mosha/data e lindjes	

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Ka mbushur moshën për përgjegjësi penale (14 vjeç për krime dhe 16 vjeç për kundërvajtje penale)	
Vepra penale e dyshuar: (shëno edhe nëse është krim apo kundërvajtje)	
Vendbanimi i fëmijës	
Bashkia që përfshin vendbanimin e fëmijës (shënoni nëse është bashki tjetër nga ajo ku punoni)	
Data dhe mënyra e referimit të rastit	
Caktimi i numrit të identifikimit të fëmijës (kodi) Ky kod është unik dhe e shoqëron fëmijën në të gjitha veprimet gjatë menaxhimit të rastit.	
Data, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i PMF-së	

2. Formë standarde (formular) i vlerësimit fillestar

VLERËSIMI FILLESTAR	
Emri i fëmijës:	Nr. i regjistrimit (kodi):
Mosha/data e lindjes:	Gjinia:
Mbi apo nën moshën për përgjegjësi penale:	
Data kur është bërë raportimi i rastit:	Vlerësimi është bërë nga:
Personi fizik juridik që ka bërë raportimin:	
Arsyeja përse është bërë raportimi:	
Vepra penale (cilëso krim apo kundërvajtje)	
Shërbimet/strukturat në kontakt me fëmijën	Shkolla:

Arsyeja përse është bërë referimi:
Sfondi familjar/përmbledhje e historive të fundit/ngjarje kritike:
Në qoftë se fëmija është mbi moshën e përgjegjësisë penale, masa e sigurimit e dhënë për të nga gjykata:
Vendbanimi i tanishëm i fëmijës: a) shtëpi b) institucioni i paraburgimit c) tjetër _____
Nëse fëmija është mbi moshën e përgjegjësisë penale, stadi në të cilin ndodhet çështja në momentin e referimit (hetim, gjykim, zbatim i dënimit etj.):
Në qoftë se fëmija është mbi moshën e përgjegjësisë penale, si është bashkëpunuar me prokurorinë dhe gjykatën:
Nevojat e shpejta të fëmijës:

Vlerësimi i nivelit të rrezikut

- Rrezik i menjëhershëm

Rrezik i menjëhershëm konsiderohet situata ku gjendet fëmija, i cili në momentin e identifikimit, nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe nëse lihet në ato rrethana, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, ai mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë; me të mund, të abuzohet seksualisht; mund të trafikohet apo të jetë viktimë e keqtrajtimit të tjerë, të konsideruara vepra penale sipas Kodit Penal. Në një rast të tillë duhet ndërhyhet urgjentisht dhe të sigurohet largimi i fëmijës nga situata e rrezikut.

- Rrezik i lartë

Rrezik i lartë quhet situata në të cilën gjendet fëmija, gjë që nënkupton, se, për shkak të faktorëve të ndryshëm, ka shumë gjasa që ai të dëmtohet rëndë apo të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet aq shumë, sa të vuajë nga paaftësi të përhershme ose edhe t'i rrezikohet seriozisht jeta. Në këtë rast rreziku të lartë për fëmijën duhet marrë menjëherë masa mbrojtëse për të.

- Rrezik i mesëm

Me rrezik të mesëm kuptojmë situatën ku ndodhet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna se është në rrezik që të pësojë dëmtime të rënda apo, më keq akoma, se ka pësuar dëmtime të rënda. Por, në rast se nuk merren masa, ekziston vërtet mundësia që ai të dëmtohet apo të abuzohet, prandaj është e domosdoshme ndërhyrja për ta mbrojtur dhe për t'i ofruar shërbimet e duhura.

- Rrezik i ulët

Rrezik i ulët konsiderohet situata që gjendet fëmija, i cili është pak a shumë i sigurt, nuk vuan nga

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

dëmtime që vijnë si rrjedhojë e abuzimit dhe është i aftë ta mbrojtë veten. Megjithatë duhet të bëhen ndërhyrje për t'i ofruar respektimin dhe qasjen në të drejta, si dhe t'i ofrohen shërbimet për të cilat ka nevojë, pasi në atë situatë janë të pranishëm faktorë të rrezikut dhe fëmija mund të bëhet pre e abuzimit, e dhunës, nënvleftësimit apo shfrytëzimit.

MASAT E MBROJTJES, NË VARËSI TË NIVELIT TË RREZIKUT	
Masa emergjente e mbrojtjes	Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative
Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar	
Emri dhe nënshkrimi i punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve	Emri dhe nënshkrimi i drejtorit të shërbimeve shoqërore në bashki
Data	Data

3. Model i kërkesës në gjykatë për caktimin e masës emergjente të mbrojtjes

Durrës¹, më _____

KËRKESË

Për konfirmimin/vleftësimin e masës emergjente të mbrojtjes apo të masës së mbrojtjes

KËRKUES:

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës i cili e paraqet kërkesën në gjykatë, si dhe bashkia pranë së cilës ai ushtron detyrën; akti i përfaqësimit dhe adresa e saktë bashkë me të dhënat elektronike të kontaktit të tij.

PERSONA TË TRETË:

Nëna e fëmijës (emri, mbiemri, atësia, datëlindja, vendlindja, adresa e saktë e njoftimit, sipas vendbanimit/vendqëndrimit).

Babai i fëmijës (emri, mbiemri, atësia, datëlindja, vendlindja, adresa e saktë e njoftimit, sipas vendbanimit/vendqëndrimit).

OBJEKTI:

Organi publik, sipas emërtesës në regjistrat publikë dhe adresa e tij e saktë, sipas selisë së regjistruar, ku fëmija është kaluar në përkujdesje alternative.

Konfirmim i masës emergjente të mbrojtjes "largim nga prindërit dhe vendosje e fëmijës (emri dhe mbiemri) në përkujdesje alternative në organin publik, sipas emërtesës", të caktuar më datë _____

BAZA LIGJORE:

Neni 59, pika 4, e ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

(Shëno gjykatën e rrethit gjyqësor, e cila ka kompetencë tokësore në bashkinë ku ushtron detyrën.)

E/i nderuar znj./z. gjyqtar,

Në pjesën shpjeguese të kërkesës trajtohen:

a) *Parashtrimi i rrethanave të çështjes*

Rrethanat parashtrihen sipas ecures në kohë të fakteve të ndodhura, ku shtjellohet në mënyrë të qartë dhe të saktë rasti i fëmijës në konflikt me ligjin që po menaxhohet, gjithashtu, edhe mënyra se si është referuar ky rast; cilat janë detajet e tij konkrete, cili ishte rezultati i vlerësimit fillestar, lloji konkret i masës emergjente apo i masës së mbrojtjes, e caktuar nga drejtori, po ashtu edhe arsyeja/shkaku i caktimit të asaj mase.

Te shkaku i caktimit të masës duhet theksuar interesi më i lartë i fëmijës dhe të bëhet kujdes që arsyetimi për interesin më të lartë të fëmijës të jetë konkret, i lidhur me të dhënat e rastit në fjalë dhe duke treguar qartë përse është proceduar me largimin e fëmijës nga prindërit e tij, si një masë e fundit. Gjithashtu, duhet të shpjegohet edhe data e caktimit të masës nga drejtori, për të treguar se kërkesa në

¹ Duhet shënuar vendi ku ushtrohet funksioni.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

gykatë është paraqitur nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës brenda afatit ligjor 5-ditor.

b) Tregimi i provave

Në rastin e tregimit të provave kemi të bëjmë me qartësimin e provave që mbështesin rrethanat e parashtruara. Si rregull bëhet fjalë për prova dokumentare, pasi objekt i kësaj kërkesë është konfirmimi i ligjshmërisë së veprimeve të drejtorit në caktimin e masës emergjente apo të masës së mbrojtjes.

c) Citimi i dispozitave ligjore

Citohen dispozitat ligjore të kërkesës, që mbështesin konfirmimin e masës emergjente apo të masës së mbrojtjes.

Në pjesën përmblylëse të kërkesës kemi këto trajtesa:

- kërkimi për konfirmimin e masës emergjente apo të masës së mbrojtjes, sipas objektit të kërkesës;
- nëse bëhet fjalë për masë mbrojtjeje, kërkohet që gjykata të shprehet për konfirmimin e masës së mbrojtjes dhe pastaj ta vendosë fëmijën në kujdestari;
- mënyra dhe veprimet konkrete që duhen kryer për ekzekutimin e masës emergjente apo të mbrojtjes së fëmijës.

Me respekt,

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi

4. Formë standarde (formular) e planit individual të mbrojtjes

Nr. i regjistrimit (kodi): _____				
Data e miratimit të planit individual të mbrojtjes: _____				
Data e rishikimit të planit individual të mbrojtjes: _____				
Veprimet e nevojshme	Nevojat për mbrojtje që synojnë këto veprime	Personi përgjegjës	Afati kohor	Komente mbi progresin e arritur (datat)
Angazhimet/përgjegjësitë që marrin prindërit/kujdestarët në lidhje me të miturin:				
Persona të përfshirë në hartimin e PIM-it (firmat):				
Personat të cilët nuk bien dakord me PIM-in dhe arsyet pse:				
Rishikimi dhe aprovimi nga drejtori i strukturës së shërbimeve sociale në bashki:				

5. Formë standarde (formular) që dokumenton vizitat në shtëpi

Formular i vizitave në shtëpi					
Numri i regjistrimit (kodi):					
DATA/ORA	MBIEMRI I FAMILJES	PUNONJËSI			
Kush është i pranishëm					
		Nuk ka shqetësim	Ka pak shqetësim	Ka shumë shqetësime	Komente/shënime
Mjedisi fizik					
A është e përshtatshme shtëpia ku jeton i mituri? <i>Për shembull: ka hapësira të mjaftueshme; ka ujë pa ndërprerje/ banjë; a është e ngrohtë sa duhet?</i>					
Shtëpia a është e pastër dhe e rregullt? <i>A ka ndonjë tregues që dëshmon për rreziqe ndaj shëndetit të të miturit?</i>					
I mituri a ka një vend të përshtatshëm për fjetur?					
A ekzistojnë rreziqe të dukshme fizike për të miturin? <i>Për shembull: xhama, thika dhe objekte të mprehta që mund të jenë aty-këtu ose pranë një mjedisi rrotull tyre?</i>					
A ka objekte argëtimi (lodra etj.), që përshkatojnë me moshën e të miturit?					
Vëzhgimi dhe sjellja e të miturit					
I mituri a vishet në mënyrën e duhur?					
I mituri a është i pastër?					
A i përmbush i mituri etapat e një zhvillimi normal (këtu duhet mbajtur parasysh moshën e tij)?					

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

<i>A është i përshtatshëm ndërveprimi i të miturit me të tjerët (duke mbajtur parasysh moshën e tij)?</i>				
<i>E folura dhe gjuba e të miturit a është në përputhje me moshën e tij?</i>				
<i>A luan i mituri dhe a e mbush kohën e vet në mënyrën e duhur?</i>				
<i>I mituri a i ndjek udhëzimet/ kërkesat?</i>				
<i>A ka shenja abuzimi tek i mituri, si p.sh., nxirje ose dëmtime të pashpjegueshme?</i>				
<i>Tek i mituri a vihet re sjellje që mund të përbëjë shqetësim ose mund të mos duket “normale”?</i>				
Ndërveprimi prind-i mitur				
<i>A ka ndonjë veprim të përgjigjshëm fizik ndërmjet prindit dhe të miturit?</i>				
<i>Prindi i të miturit a bën komente pozitive për fëmijën e vet në prani të tij?</i>				
<i>Ndërveprimi prind-i mitur a është udhëzues (kontrollues) apo ai (prindi) i të miturit mundësi zgjedhjeje?</i>				
<i>Prindi dhe i mituri a e shohin në sy njëri-tjetrin?</i>				
<i>A duket se ka një marrëdhënie të ngrohtë dhe të natyrshme ndërmjet prindit dhe të miturit?</i>				
<i>I mituri a duket të jetë i lumtur?</i>				
<i>A vihet re se ka një dallim të dukshëm në sjellje ose në qëndrimin ndaj fëmijëve të ndryshëm në familje?</i>				
<i>Nëse ka fëmijë të tjerë në shtëpi, a duket që marrëdhëniet mes fëmijëve është e përshtatshme? Ndonjëri nga fëmijët a është mbizotëruar apo ushtron bullizëm ndaj të tjerëve?</i>				
Prezantimi i prindërve/të rriturve				
<i>Prindi a paraqet pritshmëri jorealiste për të miturin, për sjelljen e tij?</i>				
<i>Prindërit a janë të ndërgjegjësuar në lidhje me rëndësinë e situatës dhe me pranimin e përgjegjësiave të tyre?</i>				
<i>A bashkëpunojnë prindërit dhe cili është pozicioni i tyre në lidhje me shërbimet e propozuara dhe të ofruara?</i>				
<i>Prindi e flet keq për të miturin dhe a duket shumë kritik ndaj tij?</i>				
<i>A e kontrollojnë tërësisht sjelljen e të miturit prindi apo vetë i mituri duket sikur është nën ndikimin e drogës, alkoolit etj.?</i>				
<i>A ka ndonjë shenjë të dhunës brenda familjes?</i>				
<i>A ka ndonjë shenjë ose a përmendet ndonjë vështirësi në marrëdhëniet ndërmjet të rriturve në shtëpi?</i>				
<i>Prindi a përmend ndonjë sjellje lidhur me kujdesin e të miturit, që mund të jetë shkak për një shqetësim (p.sh. ndëshkimi trupor)?</i>				
<i>A ka ndonjë gjë të “çuditshme” ose shqetësuese mbi sjelljen e prindërve, e cila mund të sugjerojë pranimin e problematikave të rëndësishme (p.sh. probleme me shëndetin mendor)?</i>				
<i>Prindi a ishte agresiv apo mbrojtës gjatë vizitës?</i>				
PAS VIZITËS/Vëzhgime				
Cilat ishin dinamikat gjatë vizitës?				
A patët mundësi të flisnit me fëmijën në mënyrë individuale? Nëse po, a keni ndonjë element që do të donit ta trajtonit?				

6. Formë standarde (formular) i intervistave që merren gjatë menaxhimit të rastit

Formulari i intervistës me fëmijën

ii. Intervista e personave të tjerë

7. Formë standarde (formular) e vlerësimit të plotë dhe e analizës së rrezikshmërisë

296

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Të dhëna për veprën e tanishme penale:

Qëndrimi ndaj veprës:

Faza ku ndodhet çështja:

- *i mituri ndodhet në gjendje të lirë/paraburgim/ burg;*
- *i mituri ka marrë dënimin (nëse gjykimi ka përfunduar);*
- *i mitur po merr edukim/ arsimimin e detyrueshëm apo formim profesional;*
- *tjetër.*

8. Model i kërkesës në gjykatë për heqjen e masës së mbrojtjes

Tiranë¹, më _____

KËRKESË

Për heqjen e masës së mbrojtjes

KËRKUES:	Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës i cili e paraqet kërkesën në gjykatë, si dhe bashkia pranë së cilës ai ushtron detyrën; akti i përfaqësimit, dhe adresa e saktë bashkë me të dhënat elektronike të kontaktit të tij
PERSONA TË TRETË:	Nëna e fëmijës (emri, mbiemri, atësia, datëlindja, vendlindja, adresa e saktë e njoftimit, sipas vendbanimit/vendqëndrimit)
	Babai i fëmijës (emri, mbiemri, atësia, datëlindja, vendlindja, adresa e saktë e njoftimit, sipas vendbanimit/vendqëndrimit)
	Organi publik , sipas emërtesës në regjistrat publikë dhe adresa e saktë e tij, sipas selisë së regjistruar, ku fëmija është kaluar në përkujdesje alternative
OBJEKTI:	Heqje e masës së mbrojtjes, “vendosje e fëmijës” (<i>emër, mbiemër</i>) në përkujdesje alternative në organin publik sipas emërtesës”, e konfirmuar me vendimin gjyqësor nr. _____, datë _____ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
BAZA LIGJORE:	Neni 59, pika 6, ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

(Shëno gjykatën e rrethit gjyqësor, e cila ka kompetencë tokësore në bashkinë ku ushtron detyrën.)

E/i nderuar znj./z. gjyqtar,

Në pjesën shpjeguese të kërkesës trajtohen:

a) Parashtrimi i rrethanave të çështjes

Rrethanat parashtrihen sipas ecurisë në kohë të fakteve që kanë ndodhur, ku shtjellohen në mënyrë të qartë dhe të saktë: rasti i fëmijës në konflikt me ligjin i cili po menaxhohet; masa konkrete e mbrojtjes që është caktuar ndaj fëmijës dhe vendimi gjyqësor, i cili e ka konfirmuar këtë masë mbrojtje, duke treguar edhe shkaktuesin dhe u caktua dhe u konfirmua masa e mbrojtjes. Më pas shpjegohet rrethana që ka ndryshuar, e cila e justifikon kërkesën për heqjen e masës së mbrojtjes, duke vënë theks veçanërisht në interesin më të lartë të fëmijës. Duhet bërë kujdes që arsyetimi mbi interesin më të lartë të fëmijës të jetë konkret, duke u lidhur me të dhënat e rastit në fjalë. Gjithashtu, duhet shpjeguar edhe procedura e brendshme e ndjekur në bashki, ku duket qartë vlerësimi që i është bërë rastit, po ashtu edhe nëse propozimi i punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve lidhur me heqjen e masës është përkrahur edhe nga drejtori.

b) Pasqyrimi i provave

Tregimi i provave lidhet me evidentimin e provave që mbështesin rrethanat e parashtruara. Zakonisht bëhet fjalë për provat dokumentare, të cilat tregojnë se ndaj fëmijës është caktuar një masë mbrojtje, e konfirmuar nga gjykata dhe se janë veçanërisht ato prova që hedhin dritë mbi rrethanën e ndryshuar, e cila justifikon edhe heqjen e masës së mbrojtjes.

c) Citimi i dispozitave ligjore

Citohen dispozitat ligjore të kërkesës, që mbështesin heqjen e masës së mbrojtjes.

Në pjesën përmbjllëse të kërkesës trajtohet:

- Kërkimi për heqjen e masës së mbrojtjes, sipas objektit të kërkesës;

¹ Shënohet vendi ku ushtrohet funksioni.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- Mënyra dhe veprimet konkrete që duhen kryer për heqjen e masës së mbrojtjes.

Me respekt,

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi

9. Formë standarde e raportit drejtuar GTN-se për zbatimin e PIM-it

Nr. i regjistrimit (kodi): _____

Data: _____

1. Përshkruani të gjitha përfitimet, shërbimet dhe hapat që janë ndjekur në lidhje me të miturin (pavarësisht nëse është deklaruar apo jo në plan).

2. Jepni një përshkrim të hollësishëm të përparimit/ndryshimit të gjendjes së të miturit, po ashtu edhe të prindërve të tij. Shkruani një fragment të shkurtër, ku të përfshini të dhëna dhe fakte të prekshme konkrete, që janë të lidhura me ndikimin e situatës dhe të rrezikshmërisë së saj, duke u mbështetur tek elementet në vijim:

- Zhvillimi i sjelljeve të të miturve në të gjitha fushat e jetës (shkollore, shoqërore, krijuese, shëndetësore, psikologjike) brenda familjes ose mjedisit tjetër të kujdesit. Nëse i mituri është adoleshent, sjelljet e tij vlerësohen në lidhje me integrimin e tij shoqëror në nivelin personal, shoqëror, familjar dhe profesional.

- Zhvillimi i aftësive të prindërve/kujdestarëve: shkruani dy paragrafë të ndryshëm, një për nënën dhe një tjetër për babanë/kujdestarin, duke përmendur posaçërisht të gjithë hapat që kanë ndërmarrë deri më tani, me një përshkrim të pikave të forta dhe sfidave me të cilat janë përballur, sipër vetëmotivimit të tyre.

- Zhvillimi i marrëdhënieve ndërmjet të miturit dhe prindërve/kujdestarëve të tij: ndërgjegjësimi i prindërve/kujdestarëve për nevojat e të miturve dhe se si ndikojnë pasojat e situatës në zhvillimin e tij. Përshkruani marrëdhëniet ndërmjet nënës dhe të miturit, mes babait/kujdestarit dhe të miturit, si dhe marrëdhëniet e të miturit me motrat e vëllezërit.

3. Jepni mendimet dhe propozimet tuaja profesionale.

4. Këndvështrimi i punonjësit të mbrojtjes së fëmijës mbi zhvillimin e sjelljeve të të miturit dhe natyrës së marrëdhënies midis tij dhe prindërve/kujdestarëve (shpeshtësia e vizitave, periudha kohore, cilësia e mbikëqyrjes dhe ndjekjes):

- vazhdimi i masave jogjyqësore;

- ndryshimi ose zgjatja e periudhës së masave gjyqësore;

- transferimi në masat gjyqësore gjatë zbatimit të masave jogjyqësore;

- mbyllja e rastit, duke treguar me saktësi edhe shkaku e mbylljes.

Emri dhe nënshkrimi i punonjësit të mbrojtjes së fëmijës:

ANEKS 2

NJOHURI TË VEÇANTA PËR SISTEMIN E MBROJTJES SË FËMIJËVE

1. Parimet e përgjithshme dhe standardet

Shqipëria ka një legjislacion të pasur dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Konventat dhe protokollet kryesore të OKB-së dhe të Këshillit të Evropës që lidhen me të drejtat e fëmijëve, janë ratifikuar dhe janë bërë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm. Kushtetuta e Shqipërisë parashikon të drejtën e fëmijëve për të pasur mbrojtje të veçantë nga shteti¹ dhe kjo rregull kushtetuese është pasur parasysh në hartimin e ligjeve, që përmbajnë rregulla për fëmijët.

Në praktikën e punës së tij, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës e ka të nevojshëm zbatimin e rregullave, pjesë e ligjeve të ndryshme. Por ndonjëherë gjuha apo terminologjia e përdorur në një ligj, është e ndryshme nga ajo e një ligji tjetër, kështu që herë-herë një situatë konkrete (që po trajtohet prej PMF-së) nuk rregullohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shtruese nga ligji. Për t'i dhënë zgjidhje këtij “problem”, hyjnë në lojë parimet që janë rregulla ligjore me natyrë të përgjithshme dhe që deklarojnë hapur qëllimin e ligjit, duke treguar edhe vlerën thelbësore se si zbatohen rregullat ligjore më të detajuara dhe konkrete.

Kuadri ligjor në fuqi, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe veçanërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, parashikon një numër parimesh themelore, siç janë: interesi më i lartë i fëmijës, qasja

¹ Shih nenin 54, pika 1, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

shumëdisiplinore për vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës, respekti për mendimet e fëmijës, ndalimi i diskriminimit, e drejta e jetës, e mbijetesës dhe e zhvillimit, si dhe dinjteti i fëmijës. Po kështu, në nenin 15 të Kushtetutës sonë, theksohet që: *“të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*. Ndërkohë, ligji për fëmijët¹ shpall 11 parime të përgjithshme, që duhen pasur parasysh kur veprohet për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe që janë të zbatueshme edhe për fëmijët në konflikt me ligjin, ndërsa Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur² përcakton, gjithashtu, 11 parime, që zbatohen në mënyrë të veçantë për të miturit në konflikt me ligjin, të cilët e kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale.

Duke i kombinuar së bashku këto parashikime ligjore, parimet që duhen zbatuar për të miturit në konflikt me ligjin janë si më poshtë:

1. Universaliteti i të drejtave

Fëmija është bartës i të drejtave, dhe kjo nënkupton se çdo të drejtë të fëmijës i përkon një detyrim i organeve publike. Të drejtat e fëmijës janë:

- *universale*, sepse çdo fëmijë është qenie njerëzore, që lind e lirë, e barabartë në të drejta dhe me dinjitet;
- *të patjetërsueshme*, pasi nuk mund të kalohen në asnjë mënyrë nga fëmija te një individ tjetër;
- *të pandashme*, sepse burojnë dhe lindin për arsyen se fëmija është qenie njerëzore me cilësi të veçanta, duke e shoqëruar atë përgjatë gjithë kohës që ka cilësinë e fëmijës;
- *të ndërruarur* dhe progresive, sepse shteti dhe kushdo ka detyrimin t'i përmirësojë standardet e shërbimeve përkundrejt këtyre të drejtave.

Çdo autoritet publik kompetent, duke përfshirë edhe PMF-në ka detyrimin kushtetues që gjatë ushtrimit të detyrave të veta të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të fëmijës në konflikt me ligjin, si dhe të kontribuojë në realizimin e tyre. Në mënyrë të veçantë, kur i mituri në konflikt me ligjin i nënshtrohet procesit penal, atëherë çdo person dhe çdo organ kompetent, duke përfshirë edhe PMF-në, është i detyruar të zbatojë parimet e drejtësisë penale për të mitur në të gjithë përmbajtjen e tyre, në çdo veprim dhe në çdo vendim që merr lidhur me të miturin. Në këtë detyrim bëjnë pjesë edhe veprimet administrative që kryhen në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur.

2. Prezumimi i pafajësisë

Çdo i mitur në konflikt me ligjin mendohet si i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën ndaj të llogaritet në favor të tij. Me fjalë të thjeshta, ky parim nënkupton që i mituri nuk ka asnjë detyrim ta provojë fajësinë e vet, pasi këtë e ka për detyrë ta bëjë prokurori. Gjithashtu, zbatimi i këtij parimi përfshin edhe të drejtën e heshtjes së fëmijës gjatë procedimit penal, pa pasur detyrimin për të dhënë shpjegime dhe pa pasur asnjë pasojë nëse ai zgjedh të heshtë.

3. Interesi më i lartë i fëmijës

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe çdo organ kompetent, në të gjitha vendimet dhe veprimtaritë që ndërmarrin gjatë ushtrimit të detyrave, janë të detyruar të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit. Ky interes kërkon që të mbahen parasysh: a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje; b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; c) historia e fëmijës, duke mos nënvlehtësuar situatat e veçanta të abuzimit, lënies pas dore, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, po ashtu dhe rrezikun e mundshëm që në të ardhmen të ndodhin situata të ngjashme; ç) aftësia e prindërve ose e personave të cilët kujdesen për mirërritjen e fëmijës, që t'u përgjigjen nevojave të fëmijës; d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm, lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.

4. Dinjteti

Preambula (hyrja) e Kushtetutës e thekson shprehimisht dinjitetin dhe personalitetin njerëzor si një prej vlerave më të larta të njerëzimit. Duke u nisur nga kjo, neni 3 i Kushtetutës së Shqipërisë e përcakton dinjitetin njerëzor si një prej bazave të shtetit shqiptar, të cilin shteti ka për detyrë ta respektojë dhe ta mbrojë. Ligji për fëmijët e thekson në mënyrë të veçantë detyrimin për të respektuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e

¹ Shih nenin 5, ligji nr. 18/2017.

² Shih Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, nenet 8–18.

fëmijës.

Ky rregull parimor për dinjitetin nënkupton: a) çdo fëmijë, si qenie njerëzore, ka dinjitet të qenësishëm të barabartë, i cili nuk mund të hiqet apo të zvogëlohet; b) çdokush duhet ta njohë dhe ta respektojë dinjitetin e qenësishëm njerëzor të fëmijës; c) shteti ka detyrimin të mos e cenojë dinjitetin e individit, por, gjithashtu, ka dhe detyrimin që ta përmbushë në mënyrë progresive dinjitetin njerëzor. Në mënyrë bazike dhe minimale, thelbi i konceptit të dinjitetit nënkupton se çdo fëmijë, si të gjitha qeniet njerëzore, mbart një vlerë të brendshme e cila duhet të respektohet, se disa forma sjelljeje janë të papajtueshme me respektin e kësaj vlere të brendshme dhe se shteti ekziston për individin dhe jo e anasjelltas.

5. Ndalimi i diskriminimit

Fëmijës në konflikt me ligjin i garantohen të drejtat, pa asnjë lloj diskriminimi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, prirjet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, e prindërve ose e përfaqësuesve të tij ligjorë. Gjithashtu, të drejtat e fëmijës në konflikt me ligjin mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e renditura më lart.

Ndalimi i diskriminimit është pjesë përbërëse e së drejtës së barazisë para ligjit, e cila nënkupton që të gjithë individët, duke përfshirë edhe fëmijët, kanë të njëjtat të drejta dhe meritojnë të njëjtin nivel respekti. Mosdiskriminimi siguron që askujt të mos i mohohen të drejtat për faktorët e renditur më lart.

Duhet ditur se ndonjëherë është e nevojshme që individit të trajtohet ndryshe. Nevoja për trajtim ndryshe lidhet me dallimet që kanë ata ndërmjet tyre, kur disa individë, për të gëzuar në mënyrë të plotë të drejtat e veta, kanë nevojë për mbështetje shtesë. Në këtë rast, bëhet fjalë për diskriminim pozitiv, i cili nuk është gjë tjetër veçse marrja e “masave pozitive” ose “masave të veçanta” përkundrejt një grupi individësh që kanë pësuar më parë praktika diskriminimi. P.sh., vitet e fundit legjislacioni shqiptar ka parashikuar një sërë masash të veçanta shtesë për fëmijët në konflikt me ligjin, në raport me fëmijët e tjerë, për arsye të pozicionit të tyre të dobët dhe të diskriminuar më parë. Ky trajtim i ndryshëm nuk përbën diskriminim negativ (të ndaluar), por diskriminim pozitiv.

6. Decentralizimi i shërbimeve

Shërbimet që ofrohen për fëmijët në sistemin e mbrojtjes së tyre, i nënshtrohen parimit të decentralizimit. Kjo nënkupton se shërbimet ofrohen nga niveli-bazë dhe më pranë fëmijës. Ndërhyrja është sektoriale në varësi të nevojës për mbrojtje që ka fëmija. Nga ana tjetër, në bazë të këtij parimi ngrihet dhe funksionon edhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike dhe jopublike, të autorizuar me ligj.

7. Shërbimi i personalizuar

Ofrimi i shërbimit të personalizuar dhe të specializuar për çdo fëmijë mbështet në faktin që çdo fëmijë përparon dhe zhvillon aftësi në kohë e nivele të ndryshme. Një fëmijë mund të përparojë më shpejt në disa fusha të zhvillimit dhe më ngadalë në disa të tjera. Po ashtu, disa shfaqin vonesa dhe vështirësi në disa fusha të zhvillimit. Duke u bazuar në një vlerësim të specializuar dhe individual, është e rëndësishme që çdo fëmijë të marrë mbështetjen dhe ndërhyrjen e duhur, sipas nevojave të tij të veçanta. Kështu, shërbimet duhet të përqendrohen në nevojat e veçanta të fëmijës, si dhe në nivelin e funksionimit të tij.

8. Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia

Në trajtimin e çështjeve me fëmijët, duke përfshirë edhe fëmijët në konflikt me ligjin, duhet garantuar qëndrueshmëria dhe vazhdimësia në kujdesin, rritjen dhe edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor. Përvojat e fëmijërisë e formësojnë individin në të ardhmen. Për të zhvilluar mundësitë e tij të plota, fëmija duhet të ndihet i sigurt, të ketë një strehë të qëndrueshme; të ketë mundësi për t'u ushqyer, për shërbime mjekësore; të ketë marrëdhënie të sigurta, si dhe mundësi për edukim e arsimim.¹

Fëmijët zhvillohen në mjedise të qëndrueshme, ku kanë një rutinë të parashikueshme. Pavarësisht se një nivel ndryshimesh në jetën e fëmijës është normal, ndërprerjet, ndarjet dhe ndryshimet drastike mund të jenë shumë stresuese dhe të ndikojnë në ndjenjën e tij të sigurisë. Brenda kontekstit të marrëdhënieve mbështetëse që e mbrojnë fëmijën ndaj efekteve negative, pasigurisë, fëmija mëson si të përballet me negativën, të përshtatet me ambientin dhe t'i rregullojë emocionet e tij.² Kur prindërve u mungon zgjedhja

¹ *The Negative Effects of Instability on Child Development: A Research Synthesis* Heather Sandstrom Sandra Huerta, September 2013.

² *National Scientific Council on the Developing Child* 2007.

apo kontrolli mbi ndryshimin, ka më pak gjasa që mund ta mbrojnë fëmijën që të përshtatet me situatat e vështira. Stresi i pakontrolluar, i cili arrin nivele të skajshme, mund të jetë i dëmshëm për shëndetin mendor të fëmijës dhe në përqendrimin e tij njohës.¹

9. Përgjegjësia parësore e prindit/kujdestarit

Prindërit/kujdestari ligjor i fëmijës ka përgjegjësi parësore për t'i krijuar të miturit kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin. Kur fëmija në konflikt me ligjin e ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe i nënshtrohet procesit penal, prindërit/kujdestarët ligjorë marrin pjesë në faza të ndryshme të procesit penal dhe si e mendojnë ata. Me praninë e tyre, ata ofrojnë mbështetje për fëmijën; e lehtësojnë zbatimin e interesit më të lartë të tij, duke dhënë deklarata e autorizime për veprime të ndryshme procedurale, që kryhen gjatë procesit penal; gjithashtu, sigurojnë informacion të veçantë për fëmijën dhe mbështetje përgjatë zbatimit të vendimit gjyqësor, sidomos kur ndaj fëmijës caktohet një masë alternative dënimi. Kjo nënkupton detyrimin e organeve shtetërore për t'i respektuar të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve/kujdestarëve ligjorë, në mënyrë që ata t'i sigurojnë fëmijës drejtimin dhe udhëzimet e duhura, në lidhje me përmbushjen e të drejtave që ka (fëmija), por edhe në përputhje me aftësitë që tregon ai gjatë rritjes.

Gjithashtu, organet shtetërore kanë përgjegjësinë t'i ndihmojnë dhe t'i mbështesin prindërit që kanë nevojë për mbështetje, duke i konsideruar si një pjesë shumë e rëndësishme e programeve për mbrojtjen e fëmijës.

10. Ndarja e përgjegjësisë

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve përbëhet nga një grup aktorësh dhe organizatash që punojnë së bashku sipas parimit të ndarjes së përgjegjësisë. Ndarja e përgjegjësisë nuk është gjë tjetër, veçse ushtrimi i përgjegjësisë të caktuar nga ligji me role dhe përgjegjësi të ndara, ku çdo aktor përmbush detyrat e veta, duke qenë i qartë për rolin e tij, por edhe duke e kuptuar se vepron si pjesë e një sistemi të tërë.

Përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijës ndahen ndërmjet prindit ose kujdestarit të fëmijës, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë. Kështu:

- përgjegjësia është e ndarë mes shumë aktorëve dhe organizatave, duke përfshirë edhe familjen;
- procesi koordinohet në nivel vendor nga një grup shumëdisiplinor – GTN;
- vendimet për fëmijët nuk merren asnjëherë vetëm nga një individ, përkundrazi, ato janë rrjedhojë e një procesi pune dhe e një diskutimi efektiv në grup mes të gjithë aktorëve dhe organizatave që veprojnë brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

11. E drejta për zhvillim harmonik

Në çdo vendim dhe procedurë, lidhur me drejtësinë penale për të mitur, kihet parasysh e drejta e të miturit për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një arsyetim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është vlerësuar e drejta e të miturit për atë zhvillim dhe si do të realizohet ai detyrim.

12. Parimi i proporcionalitetit

Çdo masë e marrë ndaj të miturit në konflikt me ligjin, i cili ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale, duhet të jetë në lidhje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, me personalitetin e të miturit, në përputhje me nevojat që lidhen me moshën, edukimin, arsimimin, me kushtet personale, familjare, sociale dhe mjedisore, me nevojat zhvillimore, si dhe me nevoja të tjera të të miturit, duke përfshirë, nëse është rasti, edhe nevojat e veçanta.

13. Jeta dhe rritja në mjedis familjar

Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar. Kjo e drejtë është një prej elementeve përbërëse të interesit më të lartë të fëmijës. Zhvillimi dhe mirëqenia e fëmijës në mjedis familjar është edhe qëllimi i mbrojtjes së tij. Kur prindërit ose, sipas rastit, kujdestarët ligjorë të fëmijës nuk janë në gjendje të mjaftueshme të kujdesen për të, atëherë organet shtetërore kanë përgjegjësi të ndërhyjnë. Ndarja e fëmijës nga prindërit duhet parë gjithnjë si zgjidhja e fundit. Kjo do të thotë se organet shtetërore duhet të sigurohen që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rastit kur gjykata, si organi kompetent, vendos, sipas ligjit, që ndarja e fëmijës nga prindërit është në interesin më të lartë të vetë fëmijës. Duhet theksuar se mungesa e mjeteve financiare nuk përbën shkak të mjaftueshëm qoftë për të ndarë fëmijën nga familja, qoftë për të vepruar edhe për heqjen e përgjegjësisë prindërore.

14. Përparësia e masave alternative të shmangies

¹ Evans, Brooks-Gunn, and Klebanov 2011; Shonkoff and Garner 2011.

Në procedurën e drejtësisë penale për të mitur u jepet përparësi masave alternative të shmangies nga procedimi penal, të cilat synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose që zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, çdo organ kompetent, në aktet përkatëse pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies u shërben më mirë qëllimeve të rishoqërimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij (të miturit) nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal. Sa herë është e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, shmanget vënia në lëvizje e procedurës penale për të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat dhe mbrojtja e tij. Çdo masë që përdoret ndaj të miturit si alternativë për shmangien nga procedimi penal, duhet t'i shërbejë qëllimit të mbrojtjes së të drejtave e garancive të tij ligjore.

15. Kufizimi i lirisë si masë e fundit

Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri nuk zbatohet nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë. Këto lloj kufizimesh të lirisë zbatohen vetëm në përputhje me kriteret ligjore, si një masë e fundit, për një kohë sa më të shkurtër, si dhe janë objekt i rishikimit të rregullt periodik nga gjykata.

16. E drejta e pjesëmarrjes

Një prej parimeve më të rëndësishme në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve është pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Ky parim zbaton interesin më të lartë të fëmijës, pasi i jep atij mundësinë që të ndikojë në rezultatin e procedurave të sistemit të mbrojtjes përmes shprehjes së dëshirave, ndjenjave dhe mendimeve të veta. Nga ana tjetër, parimi i pjesëmarrjes së fëmijës në këto procedura i jep atij mundësinë që të mësojë t'i shprehë mendimet, të marrë përsipër përgjegjësi dhe të jetë i aftë për të marrë vendime në të ardhmen.

E drejta e pjesëmarrjes në procesin penal përfshin të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe për të shprehur mendimet e veta, të cilat mbahen parasysh në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit të të miturit. Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij pranohet vetëm për arsye të rëndësishme, të cilat arsyetohen në vendimin përkatës. Nëse i mituri nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë, mund ta realizojë atë nëpërmjet prindit si përfaqësues i tij ligjor.

I mituri, drejtpërdrejt dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, ka të drejtë të marrë pjesë në çdo proces vendimmarrjeje lidhur me të. Ai nuk mund të detyrohet të marrë pjesë personalisht në proces, por as mospjesëmarrja nuk mund t'ia rëndojë pozitën ose/dhe të përdoret në dëm të tij. Prokurori dhe gjykata krijojnë të gjitha kushtet dhe marrin çdo masë për ta nxitur të miturin të jetë i pranishëm në procedimin penal ndaj tij, nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit. Çdo veprim i ndërmarrë nga organet kompetente gjatë procesit ku merr pjesë i mituri, kryhet në përshtatje me moshën dhe/ose aftësitë e tij të të kuptuarit.

Për personat me aftësi të kufizuara ndihma dhe mbështetja e nevojshme sigurohet nga mënyrat e parashikuara në aktet e ratifikuara ndërkombëtare, si edhe nga ligji në fuqi në mbrojtje të tyre. Në rast se pretendimet e të miturit dhe të përfaqësuesit të tij ligjor/procedural janë kontradiktore, organi kompetent vlerëson pretendimin, që i shërben interesit më të lartë të të miturit.

17. Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi

Kur i mituri në konflikt me ligjin i nënshtrohet procesit penal, atëherë të gjitha vendimet dhe veprimet e ndërmarrja, që nga fillimi i procesit penal deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kryhen shpejt, me përparësi, pa vonesa të pajustificuara dhe duke pasur parasysh interesin më të lartë të të miturit, si dhe duke respektuar të drejtat e tij. Brenda afateve të caktuara në kodin përkatës, çdo organ kompetent i shqyrton në mënyrë të shpejtë dhe me përparësi çështjet e të miturve në konflikt me ligjin, po ashtu edhe çështjet me të mitur viktimë dhe dëshmitarë, duke garantuar që procesi penal, në çdo fazë të tij, të mos e përkeqësojë traumën e përjetuar nga i mituri dhe që sistemi i drejtësisë penale për të miturit të sigurojë, sipas rastit, gjithë ndihmën e duhur ndaj të miturit.

18. Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut

Kur i mituri në konflikt me ligjin i nënshtrohet procesit penal, atëherë në çdo fazë të atij procesi është e detyrueshme prania e psikologut. Sipas rastit, psikologu garanton mbështetjen psikologjike të të miturit dhe i vlerëson thëniet e tij në përputhje me zhvillimin mendor. Prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë, duke bërë kujdes për t'i hequr frikën ose druajtjen nga procesi.

Organet kompetente, sipas rastit dhe nëse kjo është e mundur, kujdesen që të sigurojnë praninë e të njëjtit psikolog gjatë tërë procesit të drejtësisë penale për mitur dhe vetëm nëse kjo është në interesin më

të lartë të të miturit. Psikologu, i cili kryen rolin e mbështetësit emocional të fëmijës gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit, nuk mund të caktohet nga gjykata për të marrë rolin e ekspertit, duke përgatitur vlerësim psikologjik për të njëjtin të mitur.

19. Të dhënat personale

Vitet e fundit në Shqipëri ka një vëmendje të madhe për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje edhe me tendencat evropiane në këtë fushë. Organizatat që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe në veçanti PMF-ja, ndeshen shpesh me informacione, që ligji i klasifikon si të dhëna personale dhe delikate. Ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, përcakton rregulla të detajuara se si mbrohen dhe përpunohen të dhënat personale. Megjithatë, këto rregulla nuk duhen kuptuar si pengesë në ushtrimin e funksionit, sepse sistemi i mbrojtjes së fëmijës është një strukturë e ngritur nga ligji dhe aktorët të cilët veprojnë brenda kësaj strukture janë të autorizuar nga ligji që të mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të fëmijës në nevojë për mbrojtje (përfshihet këtu edhe fëmija në konflikt me ligjin).

Në këtë situatë duhet të kihen parasysh:

- gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike (KDPM, neni 29, pika 6);

- gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ka detyrimin të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, me struktura të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, gjithnjë duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës (KDPM, neni 51, pika 2, shkronja “d”);

- të gjithë personat që kanë detyrim për raportim në rastin e fëmijëve në konflikt me ligjin, njëherazi kanë dhe detyrimin t’i mbrojnë të dhënat e tij (fëmijës) personale, sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale (KDPM, neni 67, pika 6).

2. Rëndësia e pjesëmarrjes së fëmijës

Pjesëmarrja në proces është një nga të drejtat themelore të fëmijëve në konflikt me ligjin. Ashtu siç u shpjegua te parimet e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, kjo e drejtë është ngritur në nivel parimor nga legjislacioni shqiptar dhe përshkon çdo procedurë që ka lidhje me atë sistem që mbron fëmijët. Pjesëmarrja e fëmijës në proces ka disa aspekte: të drejtën për t’u dëgjuar; të drejtën për t’u shprehur dhe për t’u dëgjuar; të drejtën për të marrë pjesë, pa u detyruar, në proces; si dhe aspektin që kjo e drejtë të realizohet në përshtatje me moshën dhe aftësitë e fëmijës për të kuptuar. Në rast se pretendimet e të miturit dhe të përfaqësuesit ligjor/procedural të tij janë kontradiktore, organi kompetent vlerëson pretendimin që i shërben interesit me të lartë të të miturit.

Duhet vënë re se këtë të drejtë e gëzon plotësisht edhe i mituri me aftësi të kufizuara, të cilit i sigurohet qasja efektive në organet e drejtësisë përmes lehtësimin të rolit të tij dhe vendosjes si pjesëmarrës në çdo fazë. Përshtatja dhe mbështetja e nevojshme sigurohet nëpërmjet mënyrave të parashikuara në aktet ndërkombëtare, lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe ligjit mbi “Përfshirjen dhe qasjen e personave me aftësi të kufizuara”.

2.1 Përmbajtja e së drejtës së pjesëmarrjes

E drejta e fëmijës për t’u dëgjuar ose për t’ia marrë parasysh pikëpamjet, siç parashikohet në nenin 12 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, ka një domethënie të madhe mjaft të rëndësishme, që shkon përtej recetës ligjore në vetvete. Si një nga parimet e përgjithshme të të drejtave të fëmijëve, ky nen (neni 12 në fjalë) mund të merret si pikë hyrëse në qasjen holistike dhe fuqizuese të promovuar nga Konventa: njohja e fëmijëve si mbajtës të të drejtave. Konventa nuk përcakton ose nuk e përmend “të drejtën e pjesëmarrjes” si të tillë. Sidoqoftë, neni 12, i lidhur me nenet e tjera të Konventës interpretohet së bashku me to si “*të drejtat e pjesëmarrjes së fëmijëve*”.

Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve nënvizon (në komentin e përgjithshëm nr. 12 mbi të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar) se e drejta e pjesëmarrjes ndikon në ushtrimin e të gjitha të drejtave të Konventës dhe se këto të drejta nuk mund të zbatohen pa marrë parasysh pikëpamjet dhe mendimet e fëmijës. Kur fëmijët dëgjojnë me qëllim që t’u vlerësohen dhe t’u kuptohen pikëpamjet, është mjaft e rëndësishme t’u kushtohet vëmendje edhe ndjenjave, ideve dhe dëshirave të tij; të kuptohet situata dhe historia e tij e veçantë. Qasjet në shumë fusha ndihmojnë që të merren parasysh në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha aspektet përkatëse të situatës së një fëmije, siç janë: aspektet ligjore, psikologjike, sociale dhe ato fizike.

- E drejta për t’i shprehur pikëpamjet lirisht

Mbështetje e fëmijëve për ta gëzuar lirinë e shprehjes do të thotë gjetja e mënyrave që bëjnë të mundur dhe i nxitin fëmijët për të qenë vazhdimisht të interesuar dhe për t'i shprehur pikëpamjet e tyre. Fëmijët mund të kenë nevojë për mbështetje, që të ndërgjegjësohen lidhur me ato pikëpamjet e veta, duke përfshirë edhe ndihmën psikologjike dhe emocionale. Por mbështetja mund të jetë e rëndësishme për t'i nxitur ata fëmijët që ta ushtrojnë të drejtën të shprehin çfarë mendojnë, p.sh., duke siguruar informacione në një gjuhë që e kuptojnë, si dhe procedura të ndjeshme ndaj tyre. Është e rëndësishme të garantohet se pjesëmarrja është një proces vullnetar dhe, para së gjithash, nënkupton që e drejta e shprehjes nuk mund të imponohet: nuk është detyrim, por zgjedhje.

- Në të gjitha çështjet që prekin fëmijën

Formulimi i nenit 12, të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, nuk lejon përjashtime. Sipas tij, fëmijët duhet të kenë mundësi të dëgjohen në të gjitha çështjet që kanë ndikim në jetën e tyre, duke përfshirë “çdo proces gjyqësor dhe administrativ”. Ata duhet t'i shprehin pikëpamjet e veta, pasi të jenë informuar në lidhje me ligjet përkatëse, me faktet, përfshirjet në to dhe pasojat e mundshme, po ashtu dhe për mundësitë që kanë në dispozicion. Në mbrojtje të së drejtës për t'u dëgjuar në të gjitha çështjet në praktikë, qasja në informacion është thelbësore. Komunikimi me fëmijën duhet të jetë i ndjeshëm ndaj nevojave të tij të veçanta, por dhe i përshtatshëm për situatën e tij individuale. Të gjitha aspektet e situatës së fëmijës duhet t'i shpjegohen atij në një gjuhë që ta kuptojë mirë. Qasja në informacion është e rëndësishme për fëmijën, në mënyrë që ai të jetë i vetëdijshëm për të drejtat e veta, si dhe të mund t'i kërkojë e t'i ushtrojë ato.

- Dhënia peshë e mendimeve të fëmijës

Me qëllim që të garantohet e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar, profesionistët dhe zyrtarët duhet t'i dëgjojnë ata dhe të përpiqen t'i kuptojnë e interpretojnë nevojat, perspektivat dhe pritshmëritë e tyre. Dëgjimi i mendimeve të fëmijëve dhe marrja e tyre parasysh nuk nënkupton që rezultati i vendimit do të përkojë domosdoshmërisht me mendimet e fëmijës. Në të gjitha kontekstet zyrtare të vendimmarrjes në lidhje me një fëmijë profesionistët ose zyrtarët janë përgjegjës për vendimin përfundimtar. Sidoqoftë është e rëndësishme që procesi i vendimmarrjes të marrë parasysh perspektivën e informuar të fëmijës. Për të siguruar një proces transparent të vendimmarrjes, është e rëndësishme të dokumentohet qartë se si janë dëgjuar dhe vlerësuar mendimet e fëmijës.

Gjithashtu, fëmijës ose përfaqësuesit të tij duhet t'i krijohet mundësia për ta njohur e kontrolluar procesin përkatës të vlerësimit, duke përfshirë në të të gjitha interesat, mendimet që janë marrë parasysh, burimet e informacionit të konsultuar dhe balancimin e tyre.

Dëgjimi i mendimeve të fëmijëve, duke u dhënë rëndësinë e duhur, si edhe drejtpeshimi i kërkesave dhe zgjidhjeve të ndryshme, janë në themel të të gjitha vlerësimeve dhe përcaktimeve të interesave të tij më të mira.

- Në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës

Kur i jepet rëndësi moshës dhe pjekurisë së një fëmije, mendimet e të cilit dëgjohen, nuk do të thotë që mendimi i shprehur nga një fëmijë më i madh do të meritonte më tepër vëmendje, sesa ai i një fëmije më të vogël. Përkundrazi, do të thotë se profesionistët e zyrtarët që dëgjojnë mendimet e një fëmije, duhet ta vlerësojnë aftësinë e tij (fëmijës) për të formuar një mendim të pavarur mbi situatën, pavarësisht nga mosha dhe niveli i zhvillimit që ka. Kjo dispozitë thekson se stili dhe metodat e komunikimit duhet të përshtaten me personalitetin dhe aftësitë individuale të fëmijës. Në këtë kontekst, “mendimet e fëmijës duhet të vlerësohen dhe të ekzaminohen rast pas rasti”, pasi çdo fëmijë ka nevoja, përvoja të papërsëritshme shoqërore dhe kontekste kulturore.

2.2 Roli i pjesëmarrjes për një qasje të bazuar në të drejtat e fëmijëve

Pjesëmarrja është një koncept kompleks dhe i shumanshëm, si një mozaik i përbërë nga shumë pjesë të vogla dhe unike. Standardet ndërkombëtare, siç janë ato të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, sigurojnë gurët e domosdoshëm dhe kornizën themelore në këtë rast. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për t'i vlerësuar mendimet e tij, siç parashikohet në nenin 12 të Konventës, paraqet një pjesë qendrore, por jo të vetme. Origjina etimologjike e “pjesëmarrjes”, do të thotë “të jesh pjesë e diçkaje”, gjë që tregon një karakteristikë tjetër të rëndësishme të konceptit: përshkruan një proces dinamik i cili përfshin pjesë dhe elemente të ndryshme. Sipas komentit të përgjithshëm nr. 12, të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve, koncepti i pjesëmarrjes bën fjalë për “procese të vazhdueshme, që përfshijnë shkëmbimin e informacionit mes fëmijëve dhe të rriturve, të bazuar në respektin e ndërsjellë, dhe ku fëmijët mund të shohin se si merren parasysh mendimet e tyre dhe ato të të rriturve dhe formojnë rezultatin e proceseve të tilla.”.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Një qasje e bazuar në pjesëmarrjen e fëmijëve, i bën ata që të kuptojnë se janë protagonist dhe zotërues të të drejtave, duke i bërë kështu të vetëdijshëm për të drejtat e tyre. Gjithashtu, u lejon të kuptojnë se kanë një rol në identifikimin e nevojave të veta dhe duhet t'i kërkojnë ato. Kjo qasje njih aftësitë, burimet, mundësitë e zhvillimit të fëmijëve dhe sfidon mendimet e praktikat që i shohin fëmijët kryesisht si të cenueshëm, të pa aftë dhe që kërkojnë mbrojtje.

a) Pjesëmarrja në sistemin e drejtësisë penale për të mitur

Në këtë rast bëhet fjalë për krijimin e mundësisë që të dëgjohen dhe të merren parasysh mendimet e fëmijëve, për të pasur qasje në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore, në procedurën paraprake, në gjykim dhe para e pas dënimit. Në kontekstin e sistemit të drejtësisë penale për të mitur, pjesëmarrja e fëmijëve mund të marrë një rol themelor. Përmes saj fëmijët mund të marrin rolin e protagonistëve në rehabilitimin dhe përfshirjen e tyre sociale. Ky proces mund t'i ndihmojë ata ta kuptojnë përgjegjësinë personale për veprimet që kanë kryer; të marrin përgjegjësi dhe të njihen e të respektohen nga të tjerët si anëtarë të komunitetit. Është e rëndësishme të nënvizohet se pjesëmarrja efektive dhe domethënëse e fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale për të mitur është një proces me dy drejtime: kërkon një dinamikë të reciprocitetit dhe të dëgjimit, të të kuptuarit dhe respektit të ndërsjellë. Kjo pjesëmarrje është një përvojë e përbashkët, e cila kërkon nga personat që e rrethojnë fëmijën, të zhvillojnë qëndrime, vetëdije dhe aftësi për t'i përfshirë fëmijët në mënyrë aktive, si dhe të ndihen të përfshirë prej tyre.

b) Pranimi

Mundësitë e pjesëmarrjes lejojnë që fëmijët, profesionistët dhe zyrtarët në fushën e drejtësisë për të mitur të bashkëveprojnë dhe bashkëpunojnë, duke treguar kështu respekt për njëri-tjetrin dhe duke pranuar njohjen e tjetrit. Kur profesionistët dhe zyrtarët hyjnë në dialog me fëmijët dhe ua dëgjojnë mendimet, ata mund t'i kuptojnë më mirë perspektivat, nevojat dhe situatat e tyre konkrete. Ndërkohë shohin se nevojat, dëshirat dhe përparësitë e fëmijëve mund të jenë të ndryshme nga ato të të rriturve.

Pjesëmarrja e frytshme e fëmijëve i lejon, gjithashtu, profesionistët dhe zyrtarët që t'i njohin dhe t'i zhvillojnë aftësitë pozitive individuale të fëmijëve. Mbi këtë bazë, së bashku me fëmijët, ata mund të planifikojnë më tepër masa të përshtatshme për nevojat e fëmijëve brenda sistemit të drejtësisë penale për të mitur.

Mundësitë për pjesëmarrje e lejojnë fëmijën që t'i perceptojë më mirë aftësitë dhe mundësitë e veta zhvilluese. Pjesëmarrja kuptimplotë dhe një dialog i besueshëm mes profesionistëve, zyrtarëve dhe fëmijëve, mund ta ndihmojnë fëmijën për ta kuptuar dhe për ta njohur më mirë personalitetin e vet. Përmes bashkëveprimit me të rriturit dhe moshatarët, fëmijët mund të mësojnë njohuri të reja, të ndërgjegjësohen dhe të zhvillojnë talentet e tyre.

Ky proces i njohjes/pranimit dhe i respektit është i ndërsjellë: ndihmon të lindë dialogu dhe shoqëria apo komuniteti ta pranojnë fëmijën në konflikt me ligjin. Pranimi lejon të shfaqen identitetet njerëzore, ngjarjet e nevojshme për të kuptuar rrethanat e veçanta, që kanë shoqëruar jetën e fëmijës.

c) Përgjegjësia

Pjesëmarrja mundëson që fëmijët të jenë protagonistë të jetës së tyre, madje edhe në kontekstin kompleks të privimit të lirisë. Fëmijët që kanë mundësi të angazhohen dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre pjesëmarrëse, kanë mundësi më të mira për të marrë një ndjenjë përgjegjësie në rritje. Ndjesia e përgjegjësisë së fëmijës për jetën e tij aktuale dhe të ardhmen varet, gjithashtu, nga niveli ku identifikohet fëmija me planin e tij të kujdesit dhe të rehabilitimit individual të zhvilluar në kontekstin e sistemit të drejtësisë penale të të miturve, si dhe në cilën shkallë angazhohet ai në këtë plan. Për ta forcuar angazhimin e fëmijës ndaj planit është thelbësore që ai (fëmija) të jetë pjesë e zhvillimit dhe rishikimit periodik të këtij plani, gjithashtu, ta ndiejë se mendimet e tij dëgjohen dhe merren parasysh për zhvillimin dhe zbatimin e planit. Kur fëmijët e kuptojnë se pranohen dhe besohen si anëtarë aktivë dhe të aftë të komunitetit, ata i vlerësojnë më shumë veprimet e tyre dhe ndikimin që mund të kenë te njerëzit e tjerë të komunitetit. Në rastet kur e ndjejnë se mendimet u janë marrë seriozisht, fëmijët mund të reflektojnë ndaj vetes dhe të kuptojnë se çfarë mund ose duhet të bëjnë si anëtarë të komunitetit.

Pjesëmarrja vërtet mund t'i mbështesë fëmijët në zhvillimin e një sensi të përgjegjësisë, por edhe roli i aktorëve të tjerë të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale për të mitur është po aq i rëndësishëm për këtë proces. Këta aktorë mund të jenë: gjyqtarë, avokatë, oficerë policie, punonjës socialë, mësuesit dhe familjarët e fëmijës. Në një nivel më të gjerë, edhe hartuesit e politikave dhe shoqëria civile luajnë një rol të rëndësishëm në pjesëmarrje, duke përfshirë dhe median. Këta aktorë janë të rëndësishëm për rehabilitimin dhe përfshirjen sociale të fëmijës, pasi mund të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme për të parandaluar që

fëmija të kryejë përsëri vepra penale.

ç) *Rehabilitimi*

Proceset e pjesëmarrjes luajnë një rol themelor për rehabilitimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve që vuajnë një dënim gjyqësor ose jogjyqësor. Ata mund t'u japin një kuptim masave penale, duke e mbështetur fëmijën që ta braktisë vullnetarisht kontekstin kriminalistik dhe të (ri)krijojë lidhje pozitive dhe marrëdhënie mes fëmijës dhe shoqërisë. Kuptimi i rehabilitimit dhe i përfshirjes sociale është krijimi i mundësive dhe nxitjes së fëmijëve dhe të rinjve për t'u bërë anëtarë aktivë të komunitetit, të kontribuojnë me burimet dhe aftësitë e tyre, gjithashtu, edhe të marrin një rol konstruktiv në shoqëri. Kjo mund të arrihet për arsye të natyrës së ndërsjellë të procesit të rehabilitimit, e cila krijon ndjenjën e përkatësisë dhe u mundëson fëmijëve të ndihen të pranuar nga komuniteti ku bëjnë "pjesë". Profesionistët dhe zyrtarët në sistemin e drejtësisë penale për të mitur ofrojnë mbështetje të madhe për rehabilitimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve. Angazhimi i tyre për të (ri)krijuar rrjete të mbështetjes sociale, pikat e referencës dhe marrëdhëniet pozitive rreth fëmijës janë thelbësore që nga momenti kur fëmija fillon të vuajë një dënim gjyqësor ose jogjyqësor deri në arrijtjen e rehabilitimit dhe të përfshirjes së tij sociale.

3. Përvojat negative të fëmijërisë (ACE)¹

3.1 Çfarë janë përvojat negative të fëmijërisë

Përvojat negative të fëmijërisë janë ngjarje të mundshme traumatike, të cilat mund të kenë efekte afatgjata negative në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës. Këto përvoja varen nga abuzimi fizik, emocional apo seksual, zgjidhja e martesës së prindërve apo burgosja e një prindi apo kujdestari etj., që mund të ndodhin te personat deri në moshën 18 vjeç.²

Më konkretisht, këto përvoja janë të lidhura me:

- abuzim fizik;
- abuzim emocional;
- abuzim seksual;
- një përdorues i alkoolit apo substancave narkotike në familje;
- një anëtar i familjes i burgosur;
- një anëtar i familjes depresiv, me probleme të shëndetit mendor apo i institucionalizuar;
- nëna ka qenë viktimë e dhunës;
- pasja e një ose asnjë prindi gjatë rritjes;
- neglizhim fizik apo emocional.

Gjithashtu, përvojat negative të fëmijërisë³ mund të përshkruhen si përvoja që vijnë nga përballja e vazhdueshme me stresin dhe mungesa e mbështetjes nga personat e rritur. Këto janë përvoja që ndikojnë në zhvillimin e trurit të fëmijës dhe mund të çojnë në probleme me sjelljen në moshë të rritur, si dhe me pasojat në shëndet. P.sh., fëmija që rritet në një shtëpi me një prind përdorues të substancave narkotike, ka një rrethanë jo të favorshme për arsye të ndërveprimit mosfunksional prind-fëmijë në një mjedis kaotik, të paparashikueshëm dhe jo mbështetës.

The National Child Trauma Stress Network vë në dukje se fëmijët që përjetojnë ngjarje traumatike, e kanë të zhvilluar përgjigjen individuale ndaj traumës, gjë që ndikon në fiziologjinë e tyre, te ndjenjat dhe mendimet. Një reagim i fëmijës ndaj traumës ka shumë dimensionë që ndikohen nga karakteristikat e tij personale, nga përvojat jetësore dhe rrethanat e momentit. Fëmijët që ndodhen të pambrojtur para ngjarjeve të rënda (trauma), me kalimin e kohës mund të shkojnë drejt një stresi posttraumatik, i cili më tej mund të çojë në gjendje, të tilla si: ankthi, depresioni, ankthi i ndarjes, sidomos nëse fëmija nuk është përballur me ndonjë trajtim të përkushtuar dhe të ndërgjegjshëm nga kujdestarët e vet apo nga shërbime të specializuara.

Gjithashtu, përvoja e stresit mund të çojë në keqfunksionim të fushave të ndryshme të zhvillimit të fëmijës, duke përfshirë marrëdhëniet atashuese, marrëdhëniet me moshatarët dhe rregullimin e emocioneve. Dëmtimet në këto fusha mund ta ulin nivelin e funksionimit të tij në shtëpi, shkollë dhe komunitet. Reagimet e fëmijës ndaj një ngjarjeje mjaft të rëndë mund të intensifikohen edhe nga probleme që ai mund t'i ketë pasur më parë. Po ashtu, nëse fëmija është i përqendruar për ta parandaluar rrezikun

¹ ACE -Adverse Childhood Experiences.

Shih <https://www.cdc.gov/violenceprevention/childabuseandneglect/acestudy/aboutace.html>, e vizituar për herë të fundit më 13.8.2019.

² Vanessa Sacks, M.P.P., David Murphey, Ph.D., and Kristin Moore, Ph.D. July 2014.

³ Research Update for Practitioners: The ACE Study, By Mary Sciaraffa, Ph.D., CFLE, August 6, 2017.

ndaj tij (pasi rikujton vazhdimisht momente të forta tronditjeje), ai mund të ketë prirje për të reaguar me dhunë apo pa u përmbajtur ndaj një stimuli, të cilin mund ta shohë si një kërcënim për veten.

Të gjitha këto efekte mund të bëjnë që fëmija të ketë vonesa në zhvillim, kthim prapa, problem me veten, marrëdhënie të vështira shoqërizimi në shtëpi e jashtë saj, si dhe problem në të nxënë. Reagimi i fëmijës ndaj një ngjarjeje shumë të rëndë (traumatike), mbështetja nga shërbime ndihmëse dhe karakteristikat e tij individuale janë faktorët kyç që ndikojnë në funksionimin e tij të përgjithshëm.

3.2 Lidhja me sjelljen e kundërligjshme

Dokumentimi i nivelit të lartë të përjetimit të traumave fëmijërore dhe abuzimit të popullata e përfshirë në aktivitet kriminal nuk është diçka e re. Sigurisht, prania e këtyre përvojave të pafavorshme të fëmijërisë nuk nënkupton që çdo fëmijë i cili përjeton një ngjarje të tillë, do të përfshihet në sjellje të kundërligjshme. Megjithatë, mundësia më e lartë e përfshirjes në këta persona tregon se, kur hartohen ndërhyrje apo plane trajtimi për uljen e aktiviteti kriminal të të miturit, duhet të kihet parasysh elemente të tilla. Dhuna depërton në disa segmente të shoqërisë dhe ende shumë të rinj jetojnë në zona jo të sigurta, ku janë dëshmitarë të akteve të dhunës apo madje edhe marrin pjesë në to.

Kriminologu dhe psikologu anglez D. Farrington, sugjeron po ashtu se rrethanat në të cilat ndodh ndarja e familjes dhe efektet e pasndarjes janë faktorët kryesorë për t'u marrë parasysh kur vlerësohet rreziku i sjelljes kriminale të të miturit. Një nga faktorët më të studiuar të këtij rreziku është efekti i prindërimit të vetëm (me një prind) në shfaqjen e sjelljes së kundërligjshme në rini. Ky faktor merret si i rrezikshëm, sepse është i shoqëruar me mungesë monitorimi, mungesë e prindit për ta kaluar kohën e lirë me fëmijët, pamundësi ekonomike, komunitet i varfër.

Praktikat prindërore janë të ndikuara nga konteksti social në të cilin jetojnë familjet. Kështu, p.sh., lagjet e varfra karakterizohen nga lëvizje të shumta të popullsisë, që priren t'i dobësojnë lidhjet sociale dhe të theksojnë praktikat prindërore joefektive.

Po ashtu, **psikologu** Smith (2004) vë në dukje se funksioni i familjes ndikohet nga konteksti rrethues shoqëror. Prindërit që jetojnë në lagje të varfra dhe kanë pak burime të ardhurash, kanë më tepër vështirësi për t'i "mbajtur fëmijët" larg sjelljeve të këqija dhe me rrezik. Gjithashtu, fëmijët që jetojnë në lagje të tilla dhe rriten në një familje ku monitorimi prindëror nuk është i mjaftueshëm, janë përherë të rrezikuar se në adoleshencë mund të kenë sjellje të kundërligjshme.

Konkluzionet e studimeve tregojnë se duhet marrë parasysh fakti që në planin e ndërhyrjes duhet përfshirë reagimi dhe mënyra si duhet ndikuar në zbutjen e efekteve të këtyre përvojave jo të favorshme të fëmijërisë.

Në përgjigje të ngjarjeve traumatike, fëmijët mund të shfaqin sjellje të rrezikshme, që kanë ndikim afatgjatë në shëndetin e tyre dhe madje mund të çojnë në probleme të rënda disiplinore në shkollë ose edhe në dyert e sistemit të drejtësisë. Këto efekte negative zhvillohen nga disa faktorë, që janë: varfëria e madhe, abuzimi fizik, emocional etj., që janë disa forma të traumës, të përfshira në vlerësimin e ACE-së.

Sipas Qendrës Kombëtare për Shëndetin Mendor dhe Drejtësinë për të Mitur në Nju Jork, ekzistojnë disa mënyra se si, ndër të tjera, trauma mund të çojë edhe në veprime kriminale: të rinjtë, kur përballen me trauma, mund sillen me mospërfillje, armiqësi; të provokojnë apo të kryejnë agresione, duke i konsideruar si reagime vetëmbrojtëse. Në këto raste, përfshirja në rrezik, shkelja e rregullave, dëmtimi i tjetrit që perceptohet si i fuqishëm etj. mund të bëhen mënyra apo mjete mbijetese. Pikërisht sjellje të tilla i sjellin të miturit në sistemin e drejtësisë.

Sipas *ACE Study*¹ dy të rriturve që përballen me kriza të shëndetit mendor ose burgosje, kanë pasur një fëmijëri të shoqëruar nga abuzimi, lënia pas dore, faktorë të rrezikshmërisë së mjedisit, që i krijuan atij kushtet për stres shumë të madh.

3.3 Përfshirja në vlerësimin e fëmijës në konflikt me ligjin

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (neni 47, pika 3)², ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, e ngarkon psikologun vlerësues të çështjes që, në vlerësimin e tij, përveç detyrave të tjera, të japë edhe informacion mbi nivelin e rrezikshmërisë, si dhe nevojat e veçanta të të miturit dhe, mbi këtë bazë, të propozojë fushat e nevojshme të ndërhyrjes për të nxitur zhvillimin dhe riintegrimin e tij (të miturit) në

¹ *The Adverse Childhood Experiences Study (ACE Study) is a research study The Effects of Adverse Childhood Experiences on Adult Health and Well Being* V.J. Felitti, R.F. Anda www.acestudy.org-it.

² Raporti i vlerësimit individual përshkruan nevojat e veçanta të të miturit, rrezikun e kryerjes së veprës penale, si dhe elemente të tjera në varësi të rastit, duke rekomanduar edhe masat e duhura për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e tij në shoqëri.

shoqëri.

Masat e hershme parandaluese (*kryesisht të të miturit nën 14 vjeç, që nuk hyjnë në procesin penal*) janë kritike për ta ndryshuar trajektoren e traumës, problemet e shëndetit mendor, si dhe sjelljet e ulëta e të pahijshme, që çojnë më tej në keqbërje dhe përfshirje në sistemin e drejtësisë penale.

Ndërhyrjet kryesore¹ për të trajtuar efektet e ACE-së përfshijnë:

1. Ndërhyrje të hershme në jetën e fëmijës (p.sh., mbrojtja nga një prind që abuzon me alkoolin);
2. Identifikim të elementeve të tjera të ACE-së sa më herët në jetën e fëmijës;
3. Lidhje e fëmijës dhe familjes së tij me shërbime të shumta, për të mbuluar të gjitha fushat e nevojave.

Parandalimi i dëmit në rritje që sjell stresi në jetën e fëmijës, kërkon siguri dhe stabilitet në mjedisin e tij familjar. Në këtë kuptim, kjo pikë lidhet ngushtë me të gjitha ndërhyrjet që harton njësia e mbrojtjes së fëmijës për familjen në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Grupit teknik ndërsektorial, duke marrë parasysh vlerësimin e plotë që bëhet për ACE-në dhe që ka një rëndësi thelbësore.

Kështu, ndërhyrja për t'i zbehur efektet e ACE-së në jetën e fëmijës do të përqendrohet në rritjen e aftësisë përshtatëse, e cila ka të bëjë me aftësinë për ta mësuar të miturin të përballet me frikën dhe pasigurinë, të shfaqë mundësi të mira përshtatjeje, pavarësisht nga vështirësitë jetësore dhe sfidave që i sjell eksperiencia e jetës.

Fëmijët mund të kenë aftësi përshtatëse në një fushë të jetës, por jo në të gjitha. P.sh., ata që kanë aftësi në marrëdhëniet sociale, mund të kenë vështirësi në drejtime të tjera. Aftësia përshtatëse² nuk është një konstrukt i përgjithshëm, i cili zbatohet në çdo fushë të jetës. Fëmijët mund të kenë aftësi më të mira përshtatëse ndaj disa faktorëve të rrezikshmërisë, por jo ndaj disa të tjerëve. Aftësia përshtatëse është një fenomen shumëdisiplinor, specifik për një kontekst të caktuar dhe përfshin ndryshime zhvillimore. Gjithashtu, ajo duhet parë si një aftësi fluide me kohën. Rëndësia relative e faktorëve të rrezikshmërisë dhe atyre mbrojtës kanë gjasa të ndryshojnë përgjatë jetës së fëmijës në faza të ndryshme. Një fëmijë që ka aftësi në një fazë të jetës, mund të mos ketë në fazën tjetër të zhvillimit. Tranzicioni zhvillimor i adoleshencës është periudhë shumë e ndjeshme për ndikimin e traumës.

Faktorët që ndikojnë, gjithashtu, në aftësinë përshtatëse varen nga natyra e ngjarjes traumatike, pasi kjo aftësi nuk është e lindur, por zhvillohet dhe është rezultat i ndërveprimit kompleks të disa faktorëve.

Për të nxitur vlerësimin më të plotë të fëmijës, me qëllimin hartimin e një plani trajtimi të bazuar në nevojat e tij, gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave sugjerohet të përdoret pyetësi në vijim, i përshtatur për ACE-në.

Pyetësi për pikëzimin e eksperiencave negative të fëmijërisë (ACE)

1. Gjatë periudhës së rritjes (para moshës 18 vjeç) në shtëpi a të kanë fyer, të kanë poshtëruar apo kanë vepruar me ty në mënyrë të tillë, sa ke pasur frikë që mund të të goditnin fizikisht?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

2. A ka ndodhur që prindërit ose ndonjë i rritur tjetër në shtëpi të ka shtyrë, të ka gjuajtur apo të ka qëlluar me duar ose me objekte të ndryshme, apo ndonjëherë edhe të ka lënduar aq shumë, sa ke pasur shenja ose dëmtime?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

3. A ka ndodhur që një i rritur apo ndonjë person tjetër, të paktën 5 vjet më i madh sesa ty, të të ketë prekur ndonjëherë në trup në mënyrë seksuale ose të jetë përpjekur të bëjë seks oral, vaginal apo anal me ty?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

4. A e ke ndier shpesh që askush në shtëpi nuk të ka dashur ose nuk ka menduar se je i rëndësishëm apo i veçantë; ose që asnjë nga pjesëtarët e familjes nuk është kujdesur si duhet për ty dhe nuk e jeni ndier asnjëherë pranë mes jush, as nuk e keni mbështetur njëri-tjetrin?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

5. A e mban mend nëse shpesh nuk ke pasur për të ngrënë sa duhet, nuk kishe rroba të pastra dhe askënd që të të mbronte; ose që prindërit e tu qenë shumë të pirë ose të droguar, aq sa nuk mund të kujdeseshin për ty, madje as për të të çuar te mjeku, në rastet kur ishte e nevojshme?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

¹ *MLA and the FOCUS Program.*

² *Zimmerman and Arunkumar (1994).*

Përmbledhje legjislativi për të miturit

6. Prindërit e tu a janë ndarë apo divorcuar ndonjëherë?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

7. A të ka ndodhur ndonjëherë në shtëpi të kesh parë nënën apo gjyshen që dikush i ka goditur, përplasur e shtyrë apo u ka gjuajtur me objekte të ndryshme, apo me shkelma, grushte ose diçka tjetër më të rëndë? Më keq akoma, mos vallë ndonjëherë ose shpesh i ke parë që t'i kenë kërcënuar me thikë apo ndonjë armë tjetër?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

8. A ke jetuar ndonjëherë me dikë që e kishte problem pijen ose që përdorues droge?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

9. A ke pasur ndonjë person të familjes me depresion apo të sëmurë mendor, ose që të jetë përpjekur të vrasë veten?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

10. A ka qenë në burg ndonjë anëtar i familjes sate?

PO (1 pikë) JO (0 pikë)

Pikëzimi për ACE-në: TOTALI _____ pikë

Aftësitë përshtatëse

Qarko përgjigjen më të përshtatshme në çdo fjali.

1. Kur isha i/e vogël mendoj që nëna më donte.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

2. Kur isha i/e vogël mendoj se babai më donte.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

3. Kur isha i/e vogël, kishte njerëz që i ndihmonin prindërit e mi të kujdeseshin për mua, edhe ata më donin.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

4. Më kanë thënë se, kur isha i/e vogël, familjarët e mi kënaqeshin duke luajtur me mua, por edhe unë kënaqesha me ta.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

5. Kur isha fëmijë, ndonjëherë edhe i trishtuar apo i shqetësuar, disa të afërm më bënë të ndihesha më mirë.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

6. Kur isha i/e vogël dukej se fqinjët apo miqtë e prindërve të mi më pëlqenin si fëmijë.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

7. Kur isha fëmijë mësuesit, mjekët etj. qenë përherë të gatshëm të më ndihmonin.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

8. Dikush në familje interesohej për rezultatet e mia në shkollë.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

9. Në familje, por edhe fqinjët dhe miqtë flisnin shpesh se si ta bënë jetën tonë më të mirë.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

10. Ne kishim rregulla në shtëpi dhe kërkohej t'i zbatonim përherë.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

11. Kur ndihesha vërtetë keq, gjithmonë kisha dikë që më rrinte pranë për të biseduar me mua.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

12. Që kur isha i/e vogël, të tjerët vinin re se kisha aftësi dhe mund të bëja gjëra të mëdha.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

13. I/e vogël kam qenë i/e pavarur dhe energjik/e.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

14. Unë besoj se jeta është ashtu siç e bën ti atë.

Shumë e vërtetë E vërtetë Jo i/e sigurt Ndoshta jo e vërtetë Aspak e vërtetë

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin bazohet në një qasje tërësore (gjithëpërfshirëse të zgjidhjes së çështjes), duke ofruar dhe shërbime në shumë fusha të ndryshme. Për këtë arsye, në ushtrimin e detyrave të tyre, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve përballen me një fluks termash dhe konceptesh shumëdisiplinore, një pjesë prej tyre janë terma që vijnë nga fusha e ligjit, ndërsa një pjesë nga fusha e shkencave sociale. Duke mbajtur parasysh se PMF-ja vjen nga fusha e punës sociale, në vijim paraqiten shpjegime për një pjesë të termave juridikë që hasen më së shumti gjatë menaxhimit të rastit të fëmijëve në konflikt me ligjin. Gjithashtu, jepen edhe shpjegime për një pjesë të termave specifike të shkencave sociale.

Alternativë e dënimit me burgim është masa që vendoset ndaj autorit të veprës penale, në çdo fazë të procedurës penale, prej organit të përcaktuar nga ligji (prokurori ose gjykata). Kjo masë është e ndryshme nga heqja e lirisë me paraburgim ose me burgim. Në literaturë dhe përgjatë punës praktike këto alternativa njihen edhe me termat: “masa alternative” ose “sanksione komunitare”. Për ilustrim, në rastin e të miturit në konflikt me ligjin, kemi alternativa, të tilla si: “shmangia”, “gjysmëliria”, “pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë”, “qëndrimi në shtëpi”, “kryerja e një pune në shërbim publik” apo “lirimi me kusht”.

Drejtësia penale për të mitur kur i mituri në konflikt me ligjin ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale, atëherë ndaj tij fillon procedimi penal, i cili zhvillohet sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, që është dokumenti i parë në lidhje me drejtësinë penale për të mitur. Kodi në fjalë e përkufizon “drejtësinë penale për të mitur” si procedurë që lidhen me veprat penale, duke përfshirë: hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e dënimit, çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar të një veprë penale. Për qëllime të këtij protokollit, ky koncept është përdorur vetëm për fëmijët në konflikt me ligjin, pasi të miturit - viktimë ose dëshmitarë të një veprë penale nuk janë objekt i Protokollit.

Në sistemin e rrugës penale një premisë të rëndësishme përbën edhe fakti se i mituri është tërësisht ndryshe nga i rrituri, si në termat e përgjegjësisë, ashtu edhe ato të mundësisë për rehabilitim. Fëmijët dhe adoleshentët janë në gjendje të vazhdueshme ndryshimi. Aftësitë dhe karakteristikat e tyre evoluojnë nga ana fizike, konjitive, emocionale, po ashtu edhe nga pikëpamja shoqërore. Ky status i ndryshimit të vazhdueshëm i vendos ata në një gjendje jo të njëjtë me të rriturin.¹ Fëmijët maturohen në momente të ndryshme, por në rritjen e tyre ndikojnë, gjithashtu, edhe rrethanat jo të favorshme shoqërore e familjare. Gjatë kësaj periudhe të rëndësishme të zhvillimit fëmijët duhen mbrojtur nga ligji kurdo që të jetë e mundur. Ata mund të dështojnë edhe për të marrë pjesë në mënyrë të përshtatshme në procesin penal për një seri arsyes, siç mund të jenë: sugjestionimi, rënia dakord për të qenë në rregull me të tjerët (prindërit, kujdestarët, prokurorin); aftësi të kufizuara të vëmendjes dhe niveli i tyre i funksionimit konjitiv.² Ndonëse fëmijët mund të jenë në gjendje që ta dallojnë të mirën nga e keqja, kjo nuk garanton se ata janë në gjendje për ta vlerësuar rëndësinë e veprimeve të tyre.³ Fëmijët bien më shpejt në kontakt me sistemin e drejtësisë, po t'i krahasojmë me të rriturit, pasi kanë më pak përvojë, veprojnë në grup, kryejnë vepra në publik dhe pranë vendbanimit të tyre.⁴ Po ashtu, veprimtaria e tyre kërkon vëmendje, pasi është episodike, e paplanifikuar dhe e lidhur me rastin. Sipas kriminologut amerikan, Zimring, të miturve u mungon aftësia njohëse për ta kuptuar bazën morale të rregullave dhe ligjeve, madje, edhe nëse kanë arritur ta kuptojnë, atyre u mungon aftësia për të pasur një mendim të caktuar se si zbatohen ato në situata shoqërore. Aftësia për t'i frenuar impulset nuk është e zhvilluar ende tërësisht te adoleshentët, po ashtu edhe aftësia për t'i rezistuar “presionit të moshatarëve”. Për rrjedhojë, nxitja e metodave edukative në sistemin e drejtësisë për të mitur është një çështje e drejtësisë, por njëherësh edhe e shërbimeve sociale.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka sjellë një qasje të re në koncept, duke u larguar nga ajo ndëshkuese dhe duke u përqendruar në konceptin rehabilitues gjatë trajtimit të të miturve. Sipas tij, i duhet dhënë rëndësi parësore interesit më të lartë të fëmijës dhe kjo duhet të mbizotërojë në çdo vendim që do të ndërmarrin organet kompetente, ku duhet të përfshihet edhe arsyetimi se si janë vlerësuar të drejtat e fëmijës për zhvillim tërësor.

Faktorët mbrojtës janë karakteristikat ose ndikimet që kanë efekte pozitive ose i zvogëlojnë pasojat e faktorëve të rrezikshmërisë.

¹ Borum, *in press*; Borum & Verbaagen, *in press*; McCord & Spatz-Widom, 2001; Rosado, 2000; Griffin & Torbet, 2002; Grisso, 1998a.

² Farmer 2011.

³ Urbas 2000 and Arthur 2012.

⁴ Cunneen and White (2007).

Faktorët e rrezikshmërisë janë karakteristikat ose ndikimet të cilat e rrisin mundësinë që individi të përjetojë rezultate negative.

Fëmijë¹ është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit mund të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të ligjit, derisa mosha e tij të përcaktohet saktë sipas legjislacionit në fuqi.

Duhet mbajtur parasysh se KDPM-ja i referohet fëmijës me termin “i mitur”, duke përfshirë në këtë koncept fëmijën që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale (14 vjeç për krime dhe 16 vjeç për kundërvajtje penale).

Fëmijë në nevojë për mbrojtje² është personi nën moshën 18 vjeç, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, lënies pas dore, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

Duhet theksuar se një person nën 18 vjeç konsiderohet “fëmijë në nevojë për mbrojtje” kur është viktimë sipas shkaqeve që u treguan më sipër, pavarësisht nëse ai e ka fituar zotësinë për të vepruar. Zotësia për të vepruar fitohet pjesërisht në moshën 14 vjeç, ndërsa plotësisht në moshën 18 vjeç. Përjashtim bëjnë vajzat mbi 16 vjeç, që lidhin martesë me autorizim të gjykatës dhe kështu e fitojnë zotësinë për të vepruar me martesën e tyre, edhe pse nuk e kanë mbushur moshën 18 vjeç. Megjithatë, nëse bien viktimë e shkaqeve të mësipërme, edhe pse e kanë fituar zotësinë për të vepruar me martesë, ato konsiderohen përsëri “fëmijë në nevojë për mbrojtje”.

Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji parashikon dënim administrativ, zakonisht me gjobë. Shkelje të tilla përcaktohen me ligj ose me vendime të këshillit bashkiak.³

Mbrojtje e fëmijës⁴ quhet parandalimi dhe përgjigja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe nënvlerësimin që i bëhet fëmijës, duke përfshirë: rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

Mosha e përgjegjësisë penale është kusht për përgjegjësinë penale dhe dënimin penal të individit. Individi që nuk e ka mbushur moshën, nuk i nënshtrohet procedimit penal dhe nuk dënohet. Kodi Penal ka caktuar moshën më të ulët që nuk shkon në procedim penal. Kështu, për krimet është 14 vjeç, ndërsa për kundërvajtjet 16 vjeç.

Ndërmjetësim është procesi i zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje në mënyrë jashtëgjyqësore dhe përmes dialogut, i cili zhvillohet nga një ndërmjetës i licencuar sipas ligjit. Në rastin e të miturit në konflikt me ligjin, ndërmjetësimi kryhet mes të miturit që ka kryer veprën penale dhe viktimës, duke synuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, por, gjithashtu, edhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

Ndihma juridike falas është një shërbim i specializuar ligjor, i cili garantohet falas për individin, duke u financuar nga shteti. Kjo ndihmë jepet në tri forma:

a) parësore, që ka të bëjë me ndihmë për marrje informacioni ose marrje shërbimi nga administrata publike apo organe të ndryshme nga gjykata;

b) dytësore, që ka të bëjë me ndihmën për të paraqitur një çështje në gjykatë apo për t'u mbrojtur në një proces gjyqësor;

c) në formën e përjashtimit nga detyrimi për të paguar tarifat apo shpenzimet gjatë një procesi gjyqësor.

Fëmija në konflikt me ligjin përfiton ndihmë juridike falas, pavarësisht nga të ardhurat dhe pasuria e tij.⁵

Përfaqësuesi procedural⁶ është personi i caktuar nga autoriteti procedues prej listës që dërgon njësia për mbrojtjen e fëmijës. Ky person kryen përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast se ka konflikt interesi mes tij dhe fëmijës, ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimë, me qëllim që të mbrojë interesin më të lartë të fëmijës.

¹ Përkufizimi sipas ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

² Po aty.

³ Për më shumë informacion shih: ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

⁴ Po aty.

⁵ Për më tepër informacion, shih: ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

⁶ Po aty.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Duhet ditur se përfaqësuesi procedural është një figurë që zëvendëson *përfaqësuesin ligjor* të fëmijës, pra, është një figurë tjetër dhe e ndryshme prej tij.

Përfaqësuesi ligjor është prindi, i afërmi ose kujdestari ligjor që merr pjesë në procedurë për të mbrojtur interesat e fëmijës. Të drejtën e këtij përfaqësimit atij ia jep ligji për arsye të lidhjes me fëmijën. Pjesëmarrja e përfaqësuesit ligjor sugjerohet nga roli parësor që ka familja tek i mituri. Përgjatë procedurave të sistemit të mbrojtjes, fëmija përfaqësohet në mënyrë procedurale nga përfaqësuesi ligjor dhe, vetëm kur ai mungon ose nuk ka mundësi të paraqitet, vendin e tij e zë përfaqësuesi procedural.

Duhet ditur se përfaqësuesi ligjor është figurë e ndryshme nga *mbrojtësi*, por edhe *personi i besuar*.

Mbrojtësi është profesionist i ligjit - avokat i verifikuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Ai merr pjesë në procedurat që zhvillohen me të miturin (procedurë civile ose procedurë penale) për të garantuar mbrojtjen sa më të mirë dhe profesionale të të miturit. Një fëmijë në konflikt me ligjin mund të ketë njëkohësisht edhe mbrojtës, edhe përfaqësues procedural.

Personi i besuar është ai person madhor (mbi 18 vjeç), i kërkuar nga i mituri dhe i pranuar nga organi kompetent (zyrtari i policisë, avokati, prokurori, ndërmjetësi, psikologu, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, gjyqtari, punonjësi i shërbimit të provës etj.), i cili e shoqëron të miturin në fazat e procedimit penal. Roli i kësaj figure është që të garantojë mbështetje emocionale për fëmijën. Një fëmijë, mund të ketë njëkohësisht edhe përfaqësues procedural, edhe person të besuar.

Përvojat negative të fëmijërisë – ACE, një term që përdoret për të përshkruar të gjitha llojet e abuzimeve, të lënies pas dore dhe përvojave të tjera të mundshme traumatike, të cilat u ndodhin personave nën moshën 18 vjeç dhe janë veçanërisht të lidhura me sjelljet e tij keqbërëse.¹

Pjesëmarrje e fëmijës² është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes së tij aktive, si dhe i respektimit të së drejtës që ka ai për t'u shprehur dhe për t'u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje të lidhura me të.

Procedurë civile është ajo tërësi e hapave/veprimeve e cila zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara nga ligji për zgjidhjen e çështjes, duke zbatuar ligjet që i përkasin së drejtës civile (Kodi Civil, Kodi i Familjes etj.). E drejta civile njihet edhe si e drejta private, pasi ajo rregullon marrëdhëniet ndërmjet personave fizikë ose personave juridikë mbi të drejtat pasurore, personale dhe familjare.

Procedurë penale është tërësia e hapave/veprimeve që zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara nga ligji në rastin e kryerjes së një vepre penale, me synim identifikimin e autorit të veprës penale, identifikimin e përgjegjësisë së tij penale, caktimin e llojit dhe të dënimit penal ndaj tij deri në ekzekutimin e dënimit penal.

Psikologu mbështetës është psikologu që thirret nga prokurori ose gjykata për ta mbështetur emocionalisht të miturin në konflikt me ligjin, si dhe për ta lehtësuar komunikimin me të miturin përgjatë procedimit penal (në fazën e hetimeve paraprake ose të gjykimit). Pjesëmarrja e psikologut mbështetës në procedim është e domosdoshme.³

Psikologu vlerësues është ai psikolog i cili, në procedimin penal ndaj një të mituri në konflikt me ligjin, caktohet për të kryer vlerësimin e të miturit, gjë që i shërbyen prokurorit ose gjyqtarit për marrjen e vendimit. Psikologu vlerësues e dokumenton mendimin e vet në një raport me shkrim, ku përshkruan karakteristikat e personalitetit të të miturit, e sjelljes së tij; nevojat që ka (përfshin edhe nevojat e veçanta), rrezikun e kryerjes së veprave penale apo çdo element tjetër në varësi të rastit. Gjithashtu, ai propozon edhe masat e përshtatshme për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e të miturit në shoqëri.⁴

Duhet ditur se roli i psikologut mbështetës dhe ai i psikologut vlerësues nuk duhet të kryhen nga i njëjti person.

Sistemi i integruar i mbrojtjes⁵ së fëmijëve është tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete për bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësisë dhe koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesve të

¹ Shpjegime më të detajuara janë dhënë në *aneksin 2* të këtij protokoll.

² Për më tepër informacion, shih: ligji nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

³ Roli i psikologut mbështetës parashikohet në nenin 18 të KDPM-së.

⁴ Roli i psikologut vlerësues parashikohet në nenet 22 dhe 47, të KDPM-së.

⁵ Për më tepër informacion, shih: ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, duke përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.

Shërbimi shumëdisiplinor lidhet me natyrën e problemeve që duhen sqaruar apo zgjidhur, kur fëmija hyn në konflikt me ligjin, dhe shkojnë përtej çështjes ligjore. Këtu është fjala për përdorimin e shërbimeve shumëdisiplinore që është përdorimi i një metode gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar mbi gjetjen e zgjidhjes më të përshtatshme për riintegrimin e fëmijës. Shërbimet shumëdisiplinore ofrohen gjatë menaxhimit të rastit, i cili është një proces i orientuar drejt rezultatit, duke koordinuar një rang të gjerë shërbimesh (psikologjike, shoqërore, shëndetësore, arsimore, psikiatrike, ligjore etj.). Një vendim i bazuar në një të kuptuar gjithëpërfshirës të fëmijës dhe situatës së tij, kërkon vlerësime dhe ndërhyrje nga profesionistë të trajnuar të disiplinave të ndryshme, si: psikologë, punonjës socialë, psikiatër, edukatorë, avokatë etj. Këto shërbime duhet të jenë funksionale. Në rastin kur fëmija i nënshtrohet drejtësisë penale, atëherë këto shërbime e ndihmojnë gjykatën në procesin e vendimmarrjes për interesin më të lartë të fëmijës.¹ Gjithashtu, në fazën e hartimit të planit të trajtimit për fëmijën dhe zbatimit të tij, shërbimet shumëdisiplinore ofrojnë një qasje më gjithëpërfshirëse, e cila merr parasysh nevojat e ndryshme të fëmijës.

Veprë penale është shkelje me faj e ligjit, e kryer me veprim ose mosveprim nga individit ose personat juridikë, për të cilën ligji përcakton dënim penal. Veprat penale dhe lloji i dënimit penal përcaktohen vetëm nga ligji dhe ligji kryesor është Kodi Penal. Veprat penale ndahen në krime dhe kundërvajtje penale. Krimet janë më të rënda sesa kundërvajtjet penale.

Veprimi procedural është çdo hap i parashikuar nga ligji dhe i dokumentuar përgjithësisht me procesverbal, i cili kryhet nga organi i ngarkuar prej ligjit përgjatë procedurës civile, penale ose administrative në funksion të zgjidhjes së çështjes. Përbushja e një veprimi procedural i jep shkak kryerjes së një veprimi tjetër procedural deri në përfundimin e çështjes. P.sh., një veprim procedural është caktimi i mbrojtësit për fëmijën.

UDHËZIM

Nr. 564, datë 5.10.2022

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE PËR QENDRAT E TRAJTIMIT TË FËMIJËVE VIKTIMA APO DËSHMITARË TË ABUZIMIT SEKSUAL DHE FORMAVE TË RËNDA TË DHUNËS²

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3, të neneve 27 dhe 51, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e standardeve për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktima apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës, emergjent, me një ndalesë, në mënyrë të integruar, 24/7 dhe afatshkurtër, të vendosura pranë qendrave spitalore, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.

3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror apo dhe/ose personave juridikë publikë/privatë, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror, si dhe qendrat spitalore pranë të cilave do të ngrihet ky shërbim, për zbatimin e këtij udhëzimi.

¹ GUIDELINES ON CHILDREN IN CONTACT WITH THE JUSTICE SYSTEM, Adopted by the Council of the LAYFJM London, October 21st, 2016.

² Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 150. Tiranë 2022. f. 18195.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Ogerta Manastirliu

STANDARDET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

NË QENDRAT E TRAJTIMIT TË FËMIJËVE VIKTIMA APO DËSHMITARË TË ABUZIMIT
SEKSUAL DHE FORMAVE TË RËNDA TË DHUNËS
(TË VENDOSURA PRANË QENDRAVE SPITALORE, SHËRBIM ME NJË NDALESË, I
INTEGRUAR, 24/7 DHE AFATSHKURTËR)

Përmbajtja

I. Informacion i përgjithshëm

II. Baza ligjore dhe burimet kryesore

III. Përkufizime

IV. Modeli për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës

V. Parimet mbi të cilat mbështetet modeli i shërbimeve

VI. Standardet, kriteret dhe treguesit

VII. Anekset

I. Informacion i përgjithshëm

Mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit është një e drejtë themelore e të gjithë fëmijëve, prandaj institucionet shtetërore dhe ato publike, shoqëria civile, komunitetet dhe familja kanë detyrimin të krijojnë një mjedis që edukon, mbron dhe kujdeset për të gjithë fëmijët e një vendi. Reduktimi dhe zbutja e dhunës ndaj fëmijëve, me synimin final eliminimin e saj, është një nga qëllimet më të rëndësishme të strategjive dhe programeve sociale në të gjitha vendet e rajonit evropian, në përputhje me përmbytjen e objektivave të “Shëndetit 2020”.

Dhuna dhe abuzimi ndaj fëmijëve janë të pranishme në të gjitha vendet e botës dhe janë produkt kompleks i shumë faktorëve shoqërorë, kulturorë, ekonomikë dhe biologjikë. Për më tepër, dhuna dhe keqtrajtimi i fëmijëve përbën faktorin kryesor të pabarazive shëndetësore dhe padrejtësive shoqërore, ku grupet social-ekonomike vulnerabël janë edhe në risk më të lartë për të pësuar eksperiencë të tilla negative.

Konventa e Lanzarotës (2007)¹, është traktati i parë ndërkombëtar që adreson çështjen e abuzimit seksual të fëmijët brenda rrethit të besimit. Konventa përcakton qartë detyrimin e shteteve palë për të kriminalizuar abuzimin seksual me fëmijët në rrethin e besimit. Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon të forcojë parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale ndaj fëmijëve, duke modeluar shërbime të integruara dhe multidisiplinare me “një ndalesë”, të përshtatura për fëmijët e mbijetuar të dhunës seksuale dhe llojeve të tjera të dhunës së rëndë, si dhe ngritjen e procedurave dhe kapaciteteve referuese, profesionale dhe menaxhuese të rasteve të tilla.

Kuadri ligjor i brendshëm i përditësuar së fundmi dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara krijojnë hapësirën ligjore për një qasje gjithëpërfshirëse² dhe multidisiplinare ndaj abuzimit të fëmijëve dhe siguron bazën legjislative për ngritjen e një shërbimi të specializuar ndërdisiplinor ku ndërhyrja e agjencive të ndryshme koordinohet rreth fëmijës viktimë të abuzimit seksual ose formave të tjera të rënda të dhunës. Veçanërisht, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur synon të shmangë riviktimizimin e fëmijës viktimë të abuzimit seksual ose çdo lloj abuzimi tjetër dhe prezanton mundësinë që gjykata të pranojë dëshminë e fëmijës viktimë nëpërmjet teknologjive audiovizive, për të shmangur praninë e fëmijës në sallën e gjyqit. Ligji për shërbimet e kujdesit social sjell mundësinë e krijimit të shërbimeve sociale të specializuara, ndërkohë që legjislacioni për mbrojtjen e fëmijës ka njohur metodën multidisiplinare të punës për rastet e fëmijëve në situata abuzimi, dhune, neglizhimi dhe shfrytëzimi, duke përfshirë fëmijët viktimë të dhunës seksuale.

Në nëntor 2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHPS) miratoi udhëzimin nr. 816,

¹ [LanzaroteConvention al \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/konventa/LanzaroteConvention_al(coe.int))

² Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, ligji 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

datë 27.11.2018, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe funksionimin e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale”. Megjithatë udhëzimi u referohet “qendrave” në shumës, aktualisht ekziston vetëm një qendër (Qendra e Emergjencës LILIUM) e ngritur brenda QSUT-së “Nënë Tereza”, por qartësisht udhëzimi i referohet mundësisë për të pasur qendra të shumta, menaxhimi i të cilave duhet të jetë nën përgjegjësinë e Spitaleve Rajonale. Edhe pse fillimisht e ideuar për viktimë të rritura, qendra “Lilium” ka mbështetur edhe shumicën e rasteve të fëmijëve¹, duke qenë e vetmja në tipologjinë e saj që ofron shërbime të tilla të koordinuara ku angazhohet policia, agjencitë ligjzbatuese, shërbimi psikosocial dhe mjekoligjor dhe njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit, të cilat bashkojnë forcat për t’iu përgjigjur në kohë nevojave parësore të viktimës së dhunës seksuale.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke pranuar mangësitë dhe nevojën për një përgjigje të përshtatur për fëmijët dhe duke qenë se qeveria shqiptare është e vendosur të ketë shërbime më të përshtatura posaçërisht për fëmijët dhe sepse Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Shfrytëzimi Seksual” (e njohur si Konventa e Lanzarote) nëpërmjet ligjit nr. 10 071, datë 9.2.2009, standardet e përcaktuara në udhëzimin nr. 816 do të kërkonte shtjellim të mëtejshëm në përputhje me këtë Konventë.

Për më tepër, kuadri ligjor dhe rregullator ekzistues i brendshëm që rregullon mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi kërkon edhe artikullim më të mirë të shërbimeve të integruara “me një ndalesë” në një model multidisiplinar të orientuar drejt fëmijës, përfshirë qartësinë në lidhje me shtigjet/rrugët e referimit, kapacitetet profesionale dhe procedurat e menaxhimit të rasteve.

Gjithashtu, standardet plotësojnë detyrimet për zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015–2023 dhe ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Modeli i ofrimit të shërbimeve në qendrat e trajtimit të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës (të vendosura pranë qendrave spitalore, shërbim me një ndalesë, të integruar, 24/7 dhe afatshkurtër) (në vijim “Qendra”), pranë spitaleve rajonale (në vijim “spitali”), ka për qëllim të ofrojë një kornizë të ndërhyrjes shumësektoriale dhe ndërinstitutionale të mbështetjes së fëmijës gjatë procesit të menaxhimit dhe trajtimit të rastit në rrugë civile dhe/ose penale, si dhe përcaktimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve në këto qendra.

Modeli i shërbimeve për mbështetjen dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës (në vijim “Modeli i shërbimeve”), mbështetet në modelin dhe standardet *Barnabus* të shërbimeve të ngjashme në Evropë, të integruara në sistemin shëndetësor, që promovon praktika që parandalojnë ri/traumatizimin dhe janë në përputhje me të drejtat e fëmijëve për mbrojtje, ndihmë dhe drejtësi të përshtatur për fëmijët, si dhe duke bashkëpunuar me institucionet e drejtësisë, në kuadër të zhvillimit të procesit penal dhe sigurimit të provave. Ky model mbështetet në një qasje ndërsektoriale, me qëllim vlerësimin e nevojave, mbështetjen dhe përmbushjen e të gjitha nevojave që fëmija ka për shërbime.

Qendra ngrihet dhe do të funksionojë si pjesë e strukturës së spitaleve rajonale për trajtimin e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës (në vijim “fëmijët”) në të cilat ky target fëmijësh do të përfitojnë shërbimin emergjent, me një ndalesë, në mënyrë të integruar, 24/7, si dhe shërbime të kujdesit shëndetësor, afatshkurtër, përfshirë ndërhyrje për traumat, këshillim dhe terapi. Për t’i siguruar fëmijës këto shërbime, Qendra do të bashkëpunojë me strukturat e spitalit dhe me institucione apo struktura të specializuara në ofrimin e shërbimit të kërkuar duke vendosur, kur është e mundur, mjediset e saj në dispozicion të ofrimit të shërbimit. Prindërit/kujdestarët joabuzues të fëmijës janë, gjithashtu, përfitues të shërbimeve sipas modelit të shërbimeve, duke iu ofruar informacion të vazhdueshëm, këshillim dhe mbështetje në rast krize.

Qendra ofron shërbimet, si më poshtë:

- a) ndihma e parë dhe kujdesi i emergjencës;
 - b) mbështetje në rast krizash;
 - c) mbështetje dhe këshillim mjekësor i specializuar;
 - d) këshillim psikologjik i specializuar dhe ndërhyrje terapeutike;
 - e) transportimi i sigurt;
 - f) referimi dhe bashkëpunimi me PMF-në për menaxhimin e rastit.
- Modeli i shërbimeve paraqet në mënyrë të detajuar strukturën e organizimit dhe të funksionimit të

¹ Qendra ka ofruar shërbime në 82 raste, shumica fëmijë, ku mbizotërojnë djemtë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

qendrave, shërbimet që ofrojnë, si dhe format e bashkëpunimit me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijëve, prokurorinë dhe gjykatat duke evidentuar shërbimet dhe mbështetjen që i ofrohet fëmijës në faza të ndryshme të procesit civil dhe atij penal.

- Modeli i ofruar është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për menaxhimin civil ose penal të fëmijës viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës. Qendrat veprojnë në këtë proces (të menaxhimit) si struktura mbështetëse të vlerësimit të nevojave apo në ofrimin e shërbimeve dhe koordinuese të veprimeve dhe shërbimeve shumësektoriale. Punonjësit e Qendrës duhet të kenë kompetencat e nevojshme profesionale për përmbushjen e detyrave të tyre në mënyrë efektive, të specializuar, bazuar në evidenca dhe me në qendër fëmijën. Qendra ka në përbërje të saj të paktën koordinatorin dhe asistentin e fëmijës, të cilët punojnë me kohë të plotë.

Stafi mjekësor, pjesë e strukturave të tjera të spitalit, thirret sipas nevojave të rastit të fëmijës që po trajtohet në Qendër dhe sa herë që është e nevojshme.

Standardet e shërbimit për qendrat janë një parakusht për ofrimin e shërbimit në mënyrë cilësore dhe profesionale. Në to theksohen kushtet minimale bazë për t'u përmbushur, me qëllim ofrimin e shërbimit emergjent, afatshkurtër për fëmijët viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës si dhe prindërit/kujdestarët joabuzues. Të bazuara në modelet dhe praktikën më të mira në këtë fushë (modeli *Barnabus*), këto standarde reflektojnë parimet ndërkombëtare të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijës si parimin e interesit më të lartë të fëmijës, mosdiskriminimit, respektimit të mendimit të fëmijës, shmangien e vonësive të pajustificuara, respektimin e dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës, ofrimin të shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë, mbrojtjes së privatësisë, identitetit dhe imazhit të fëmijës, mbrojtjes së jetës private të fëmijës etj., si dhe të gjithë parimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Ofrimi i shërbimit në Qendër duhet të plotësojë të paktën 13 standardet e përcaktuara në këtë dokument, si më poshtë:

STANDARDI 1

Informimi i fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës dhe çdo veprim dhe/ose vendimarrje në lidhje me fëmijën.

STANDARDI 2

Shërbimet e ofruara në Qendër u përgjigjen nevojave individuale të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës.

STANDARDI 3

Qasja e koordinuar shumësektoriale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional midis Qendrës dhe aktorëve në nivel qendror dhe vendor.

STANDARDI 4:

Qendra ofron mjedis të përshtatur për fëmijët.

STANDARDI 5

Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesjes/ndihmës.

STANDARDI 6

Ofrimi i shërbimeve terapeutike të personalizuar për fëmijën nga profesionistë me formim dhe ekspertizë të specializuar.

STANDARDI 7

Ofrimi i shërbimeve cilësore nga personel i specializuar.

STANDARDI 8

Mbledhja e të dhënave, shpërndarja e informacionit dhe rritja e ndërgjegjësimit, me qëllim parandalimin e rasteve të abuzimit seksual dhe dhunës të fëmijës.

STANDARDI 9

Monitorimi dhe vlerësimi.

STANDARDI 10

Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesit/es, shmangia e abuzimit dhe procesi i ankimit.

Në standardet e ofrimit të shërbimeve nga qendrat përcaktohet standardi dhe më tej, kriteret, treguesit udhëzime dhe për plotësimin e standardit. Modeli i shërbimeve dhe shpjegimi i udhëzimeve të nevojshme për plotësimin e standardit janë përshkruar në pjesën shpjeguese të standardit. Detajimi i kriterëve dhe i treguesve do të shërbejnë si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë në ofrimin e shërbimeve në Qendër.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Paketa e standardeve do të shërbejë si një dokument praktik për Qendrat, të cilat do të punojnë për implementimin e tyre dhe rritjen cilësisë së shërbimeve. Ato do të pilotohen për një periudhë njëvjeçare dhe në bazë të përvojës më të mirë që do të arrihet në terren, standardet do të pasurohen më tej me elemente të reja.

Modeli i shërbimeve dhe i standardet janë përgatitur përmes një procesi konsultimi me pjesëmarrjen e specialistëve/eve të Sektorit të Zhvillimit të Shërbimeve Shoqërore, të Përfshirjes Sociale dhe Barazinë Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes Sociale, specialistëve/eve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore të Shërbimit Social Shtetëror të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe me grupe profesionistësh nga shoqëria civile, me mbështetjen e UNICEF-it, përmes *Terre des hommes*, Shqipëri dhe vënies në dispozicion të një grupi të gjerë ekspertësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

II. BAZA LIGJORE DHE BURIMET KRYESORE

Baza ligjore kryesore mbi të cilën është mbështetur modeli i shërbimeve dhe standardet e përcaktuara të ofrimit të shërbimeve nga qendrat e trajtimit të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës, listohet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, OKB, 20 nëntor 1989;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, 25.10.2007;
- Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;
- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- Ligj nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 55/2022, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
- Ligj nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- VKM nr. 578, datë, 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”;
- VKM nr. 353, datë 12.6.2018, “Për rregullat e funksionimit të Grupit Teknik Ndërsektorial për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë bashkive dhe njësi administrative”;
- VKM nr. 148, datë 13.3.2018, “Për vendosjen e rregullave të bashkëpunimit midis mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionale, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”;
- VKM nr. 334, datë 17 shkurt 2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.

Burimet kryesore janë:

- Standardet Evropiane të Cilësisë *Barnabus*¹;
- Marrëveshja Ndërinstitucionale: Modele dhe udhëzime²;
- Përshkrimin e shërbimit të *Lighthouse* në Londër, Mbretëri e Bashkuar³;
- Standardet Kombëtare të Akreditimit për Qendrat e Avokimit të Fëmijëve, 2023⁴;
- *The Child House Toolkit Resources*⁵.

III. PËRKUFIZIME

Modeli i shërbimeve dhe standardet e përcaktuara të ofrimit të shërbimeve nga qendrat e trajtimit të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës u referohen disa termave dhe koncepteve, të cilat janë përkufizuar më poshtë, nën dritën e parashikimeve të Konventave të

¹ [The Promise Barnabus Quality Standards](#)

² [Promise Interagency Template](#)

³ [Lighthouse Service Specification](#)

⁴ [National Standards of Accreditation for Children’s Advocacy Centers 2023 EDITION](#)

⁵ [The Child House Toolkit Resources](#)

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi.

“Abuzimi seksual i fëmijës”¹ është përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë që nuk e ka arritur moshën ligjore për aktivitete seksuale²; ose kur përdorimi bëhet me mjete shtrënguese, forcë ose kërcënime; ose kur abuzohet nga një person që gëzon besim, autoritet ose ndikim mbi fëmijët, duke përfshirë edhe marrëdhëniet brenda familjes; ose kur abuzohet në veçanti me situatën karakteristike të brishtë të fëmijëve, kryesisht për shkak të një paaftësie mendore ose fizike ose të një situatë varësie.

“Dhunë ndaj fëmijës” është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose psikologjike, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual³.

“Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç, sipas përkufizimit të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, nenit 1 të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës dhe nenit 3/a të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual.

“Fëmijë viktimë” është çdo person nën moshën 18 vjeç, sipas përkufizimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një veprë penale.

“Fëmijë dëshmitar” është çdo person nën 18 vjeç, sipas përkufizimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili mund të ketë informacion lidhur me veprën penale.

“Përfaqësues ligjor” është prindi, i afërmi ose kujdestari i të miturit, i cili merr pjesë në procedurën e drejtësisë penale për të mitur për të mbrojtur interesat e të miturit⁴.

“Përfaqësues procedural” është personi në kuptimin e përcaktuar në ligjin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës që do të kryejë përfaqësimin procedural të të miturit, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur⁵.

“Prindi ose kujdestari abuzues” konsiderohet prindi ose kujdestari i fëmijës që ka abuzuar me fëmijën ose në rastin e një krimi në familje; ose kur prindi/kujdestarit vepron në kundërshtim me interesat e fëmijës viktimë ose dëshmitar të një veprë penale të kryer nga vetë prindi/kujdestari; ose kur ka dyshime lidhur me paanshmërinë e prindit ose kujdestarit, për sa i përket natyrës së marrëdhënieve të tij me pjesëtarin e familjes, i cili është i akuzuar ose nuk mund të gjendet pasi e ka braktisur fëmijën. Në këtë rast, fëmijës i caktohet një përfaqësues procedural nga lista e dërguar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës⁶.

“Situatë emergjente” është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëhershme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit, në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese⁷.

“Urgjenca mjekësore” është një dëmtim ose sëmundje akute dhe që përbën një rrezik të menjëhershëm të jetës së personit apo të shëndetit të mëtejshëm të tij⁸.

“Veprat për shfrytëzimin seksual të fëmijës” përfshijnë në veçanti pornografinë dhe prostituimin e fëmijëve, si dhe të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijët, duke përfshirë dhe aktet që kryhen jashtë shteti⁹.

IV. MODELI PËR QENDRAT E TRAJTIMIT TË FËMIJËVE VIKTIMA APO DËSHMITARË TË ABUZIMIT SEKSUAL DHE FORMAVE TË RËNDA TË DHUNËS

1. Qëllimi dhe misioni

1. Modeli i shërbimeve për mbështetjen dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës është hartuar me qëllim që të ofrojë një kornizë të ndërhyrjes dhe të mbështetjes ndërsektoriale të fëmijës gjatë procesit të menaxhimit dhe të trajtimit të rastit në rrugë civile dhe/ose penale.

¹ Sipas përkufizimit të nenit 18 të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, 25.10.2007: <https://rm.coe.int/168046e1e3>

² Sipas Kodit Penal, neni 100, “Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjeç”.

³ Përkufizohet në nenin 19 të KDF-së dhe në nenin 3, të ligjit nr. 17/2018, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

⁴ Neni 3/16 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁵ Neni 3/17 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁶ Neni 74 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁷ Neni 3/14 i ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

⁸ Neni 3/11 i ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁹ Nenet 19–21 të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Modeli i shërbimeve mbështetet në modelin dhe standardet *Barnabus* të shërbimeve të ngjashme në Evropë, të integruara në sistemin shëndetësor, që promovon praktika që parandalojnë ri/traumatizimin dhe janë në përputhje me të drejtat e fëmijës për mbrojtje, ndihmë dhe drejtësi të përshtatur për fëmijën, si dhe duke bashkëpunuar me institucionet e drejtësisë, në kuadër të zhvillimit të procesit penal dhe sigurimit të provave.

3. Modeli i shërbimeve të ofruara nga Qendra mbështetet në një qasje ndërsektoriale, me qëllim vlerësimin, mbështetjen dhe përmbushjen e të gjitha nevojave që fëmija ka për shërbime.

4. Prindërit/kujdestarët joabuzues të fëmijës janë, gjithashtu, përfitues të shërbimit sipas Modelit të Shërbimeve duke iu ofruar informacion të vazhdueshëm, këshillim dhe mbështetje në rast krize.

2. Krijimi i Qendrës dhe bashkëpunimi ndërinstitutional

1. Për të zbatuar modelin e shërbimeve, pranë spitaleve në nivel qarku ngrihet **Qendra**, sipas pikës 6, me qëllim ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes ndërsektoriale të përshtatur për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Qendra bashkëpunon me institucione dhe profesionistë të ndryshëm, me qëllim që fëmijës t'i sigurohet mbështetja dhe ofrimi i të gjithë shërbimeve të nevojshme të identifikuar.

3. Vendndodhja dhe mjediset e Qendrës

1. Brenda mjediseve të qendrës spitalore, Qendra lidhet me Pediatriinë me tabela të qarta aksesueshmërie dhe hyrje të posaçme.

2. Mjediset e Qendrës janë të përshtatura dhe miqësore për fëmijët e moshave të ndryshme. Kur është e mundur, krijohen edhe mjedise të ndara, të izoluar nga ana akustike dhe private për të siguruar privatësinë.

3. Mjediset ofrojnë aksesueshmëri për fëmijët me nevoja të veçanta apo me aftësi të kufizuara dhe janë të sigurta fizikisht për fëmijët e të gjitha moshave dhe fazave zhvillimore.

4. Mjediset ofrojnë mundësinë e shmangies së kontaktit mes viktimës dhe autorit të dyshuar të veprës penale.

5. Intervistat ose marrja në pyetje e fëmijës zhvillohen në ambiente të projektuara ose përshtatura për këtë qëllim që mundësojnë monitorimin në kohë reale të tyre.

4. Organizimi i Qendrës

1. Qendra është pjesë e strukturës së spitalit, i cili është institucioni drejtues dhe përgjegjës për realizimin e veprimtarisë së Qendrës, sipas parashikimeve të këtij modeli të shërbimeve.

2. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përcakton organizimin, strukturën dhe rregulloren e funksionimit të Qendrës, si pjesë e strukturës së spitalit.

3. Qendra ka në përbërje të saj të paktën punonjësit, si më poshtë:

a) **koordinatori** që do të bashkërendojë punën ndërinstitutionale dhe do të sigurojë komunikimin me institucionet e tjera mbështetëse dhe bashkëpunuese. Ai kryen funksione administrative dhe koordinuese;

b) **asistentin e fëmijës**, i cili në bashkëpunim me punonjësin për mbrojtjen e fëmijës, do të kujdeset për përmbushjen e nevojave emergjente të fëmijës dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të parashikuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

4. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Qendra mbështetet nga mjekët dhe punonjësit e strukturave të tjera të spitalit, sipas nevojave të rastit, si dhe nga profesionistë të institucioneve të tjera që do të ofrojnë shërbime apo do të kryejnë veprime procedurale në mjediset e Qendrës.

5. Punonjësit e Qendrës duhet të kenë kompetencat e nevojshme profesionale, për përmbushjen e detyrave të tyre në mënyrë efektive, të specializuar, bazuar në evidenca dhe me në qendër fëmijën.

6. Punonjësit e Qendrës nuk mund të punësohen dhe, kur janë të punësuar, përfundojnë marrëdhënien e punës, në rast se janë dënuar me dënim të formës së prerë për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje dhe/ose ndaj tyre është marrë, me vendim gjykate, një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje. Ata (punonjësit) pezullohen nga detyra kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj të miturve ose kur ata akuzohen për kryerjen e një veprë penale në bashkëpunim me të mitur.

7. Koordinatorin dhe asistentin e fëmijës, në çdo rast, sigurohen që punonjësit e tjerë të spitalit dhe/ose të institucioneve që do të komunikojnë dhe/ose do të ofrojnë shërbime ndaj fëmijës të plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 4.6.

5. Cilësia e shërbimeve dhe profesionalizmi

1. Punonjësit e Qendrës duhet të kenë një kuptim të thellë të të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve,

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

si dhe të disponojnë kompetencë dhe përvojë klinike në fushën e traumës, përfshirë ekspertizën për të trajtuar nevoja të veçanta të fëmijëve më aftësi të kufizuara.

2. Punonjësit e Qendrës duhet të kenë një kuptim të zhvilluar të sistemit, në të cilin Qendra funksionon, kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë aspektet mjekësore, socioekonomike dhe rolin e Qendrës për të promovuar një qasje ndërsektoriale dhe të koordinuar, në kontekstin e ofrimit të shërbimit dhe sigurimin e mbrojtjes për fëmijën.

3. Punonjësit të Qendrës dhe të institucioneve të përfshira u ofrohet trajnim i vazhdueshëm në fushat e tyre specifike të ekspertizës, si dhe trajnim i përbashkët për çështjet ndërsektoriale dhe bashkëpunimin ndërsektorial.

6. Shërbimet që ofron Qendra

1. Qendra ka për detyrë t'i ofrojë fëmijës, që paraqitet apo referohet pranë Qendrës, të gjitha shërbimet që ajo ofron.

2. Qendra ofron shërbimet, si më poshtë:

- a) ndihma e parë dhe kujdesi i emergjencës;
- b) mbështetje në rast krizash;
- c) mbështetje dhe këshillim mjekësor i specializuar;
- d) transportimi i sigurt
- e) referimi dhe menaxhimi/ndjekja e rastit, në bashkëpunim me NJMF-në.

3. Për shërbime që nuk ofrohen nga Qendra, ajo bashkëpunon me institucione apo struktura të specializuara në ofrimin e shërbimit të kërkuar, duke vendosur, kur është e mundur, mjediset e saj në dispozicion të ofrimit të shërbimit.

7. Referimi i rasteve dhe raportimi

1. Qendra pranon 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, referimet me vetëiniciativë të fëmijës dhe/ose të prindërve/kujdestarit të fëmijës, si dhe referimet nga çdo person fizik apo juridik, si dhe nga çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, për shkak të profesionit apo të cilit i është raportuar rasti.

2. Qendra pranon menjëherë rastet e vetëreferuara ose të referuara nga strukturat e përmendura në pikën 7.1, pavarësisht formës së përdorur për njoftimin.

3. Menjëherë sapo merret referimi i një rasti, informacioni fillestar për referimin dokumentohet në një regjistër të veçantë.

4. Koordinatori ka përgjegjësinë të raportojë rastin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës dhe/ose pranë organeve të Policisë së Shtetit, nëse referimi nuk është bërë prej këtyre strukturave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 578, datë 3.10.2018, "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbytjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes".

5. Menjëherë sapo fëmija të paraqitet në mjediset e Qendrës, ai regjistrohet, i hapet një dosje e veçantë dhe i caktohet një numër identifikues i fëmijës gjatë gjithë procesit të trajtimit të tij në Qendër.

8. Bashkëpunimi me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës në kryerjen e vlerësimit fillestar të fëmijës dhe në zbatimin e masave emergjente të mbrojtjes

1. Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës, për kryerjen e vlerësimit fillestar të fëmijës, duke ofruar të gjithë informacionin që disponojnë dhe mjedise të përshtatshme për kryerjen e intervistimit fillestar të fëmijës.

2. Koordinatori mbështet punonjësën për mbrojtjen e fëmijës (në vijim "PMF") dhe lehtëson mbledhjen e informacionit të nevojshëm nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën.

3. Qendra në bashkëpunim me PMF-në menaxher të rastit dhe strukturat e tjera të specializuara mjekësore të spitalit i ofron fëmijës plotësimin e nevojave imediate për ushqim, higjienë, veshje, si dhe kujdesin shëndetësor e psikologjik të nevojshëm.

4. Asistenti i fëmijës i Qendrës mbështet PMF-në, koordinon veprimet ose referon rastin në institucionet përgjegjëse, kur nga vlerësimi fillestar i fëmijës identifikohet nevoja emergjente për t'i siguruar fëmijës shërbimet e domosdoshme që nuk ofrohen në Qendër dhe/ose për t'i siguruar atij mbrojtjen fizike dhe/ose për zbatimin e një mase emergjente të mbrojtjes.

5. Asistenti i fëmijës dhe PMF-ja vlerësojnë, rast pas rasti, nëse shërbimet emergjente të nevojshme, sipas pikës 8.4, do t'i ofrohen fëmijës në mjediset e Qendrës nga punonjës të specializuar, në kuadër të

bashkëpunimit ndërinstitucional apo fëmija do të duhet të zhvendoset në një tjetër strukturë të specializuar.

6. Asistenti i fëmijës mbështet PMF-në për zbatimin e masës emergjente të mbrojtjes dhe vendosjen e përkohshme të fëmijës pranë një të afërmi të fëmijës, në familje kujdestare apo në një strehë.

7. Kur siguria e fëmijës është në rrezik, Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në bashkëpunim me asistentin e fëmijës, marrin masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 37 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

9. Shërbimi i kujdesit shëndetësor emergjent ndaj fëmijës

1. Çdo fëmije që vetëreferohet apo është referuar në Qendër, i ofrohet kujdesi shëndetësor i emergjencës, që përfshin konsultën pediatrike dhe ofrimin e ndihmës mjekësore emergjente/të urgjencës, e cila ofrohet në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit.

2. Sapo fëmija mbërrin në Qendër, ai merr mbështetje të shëndetit mendor në formën e ndërhyrjes për krizën, që ofrohet nga një psikolog, sipas nevojave të rastit.

3. Asistenti i fëmijës bashkëpunon me strukturat e tjera të spitalit për caktimin e një psikiatri, i cili kryen vlerësimin e shëndetit mendor të fëmijës. Momenti përcaktohet mbi bazën e karakteristikave dhe situatës së fëmijës. Vlerësimi i shëndetit mendor përbën bazën për trajtimin e përshtatshëm që i ofrohet fëmijës pa vonesa të panevojshme.

4. Nëse prokurori ose gjykata nuk kanë caktuar një specialist për të vlerësuar nivelin e përgjegjshmërisë së fëmijës, atëherë, asistenti i fëmijës në vlerësimin e tij përcakton edhe shkallën e përgjegjshmërisë së fëmijës dhe ia njofton prokurorit ose gjykatës.

10. Bashkëpunimi me Prokurorinë dhe Gjykatat, në kuadër të marrjes në pyetje të fëmijës

10.1 Për të ulur rrezikun e riviktimizimit të fëmijës, Qendra në mbështetje të procesit të marrjes në pyetje të fëmijës dhe sipas kapaciteteve që disponon, ofron mjedise miqësore për fëmijët, pajisje për regjistrimin audio dhe video gjatë pyetjes së fëmijës në mjediset e Qendrës, pajisje që ndryshojnë pamjen dhe/ose zërin e dëshmitarit/viktimës gjatë marrjes në pyetje në distancë, si dhe lehtësi të tjera sipas nevojës¹.

10.2 Qendra, në çdo rast, kujdeset që të shmangë përballjen e të miturit viktimë me të akuzuarin, në të gjitha mjediset ku zhvillohet procesi i marrjes në pyetje dhe gjatë gjithë kohës.

10.3 Standardet dhe kriteret për ngritjen dhe funksionimin e dhomës së intervistimit janë të parashikuara në Kodin e drejtësisë për të mitur dhe Konventa e Këshillit të Evropës 2010 për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual (Konventa Lanzarote), direktiva e BE-së e datës 13 dhjetor 2011 për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë ("Direktiva për abuzimin seksual të fëmijëve") dhe direktiva e BE-së e 25 tetorit 2012, që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit ("Direktiva për të drejtat e viktimave")

11. Bashkëpunimi me Prokurorinë dhe Gjykatat në kuadër të ekzaminimit mjekoligjor dhe kontrollit intím

1. Kur për nevoja të hetimit dhe mbledhjes së provave, prokurori dhe/ose gjykata vendosin kryerjen e kontrollit/ekzaminimit intím dhe mjekësor të fëmijës dhe/ose marrjen me detyrim të kampionëve biologjikë, në vendim përcaktohet, ndër të tjera, edhe një përshkrim i detajuar i llojit të kampionit biologjik, që do të merret ose të procedurës mjekësore që do të kryhet, vendit, datës, kohës dhe mënyrës së saktë të marrjes së kampionit biologjik ose kryerjes së procedurës tjetër mjekësore.

2. Kur në vendimin e gjykatës/prokurorit sipas pikës 11.1, përcaktohet Qendra si vend për kryerjen e kontrollit/ekzaminimit intím dhe mjekësor të fëmijës dhe/ose marrjen e kampionëve biologjikë atëherë, ajo ofron mjedisin, mjetet dhe materialet e nevojshme klinike për këtë qëllim. Qendra bashkëpunon me strukturat e tjera të spitalit, për të siguruar pjesëmarrjen e një mjeku të certifikuar dhe infermieri me të njëjtën gjini me fëmijën ose të gjinisë së zgjedhur nga vetë fëmija, të trajnuar në abuzimin seksual dhe keqtrajtimin e fëmijës.

3. Procedura sipas pikës 11.2 kryhet me praninë e avokatit dhe prindit ose kujdestarit të fëmijës. Nëse i mituri nuk është dakord për pjesëmarrjen e prindit ose kujdestarit gjatë kontrollit të parashikuar ose përfaqësuesi ligjor nuk mund të marrë pjesë, veprimet procedurale do të kryhen në prani të përfaqësuesit procedural.

¹ Në përputhje me parashikimet e nenit 39 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

4. Nuk mund të kryhen procedura mjekësore, që vënë në rrezik jetën e personit, integritetin fizik ose shëndetin e tij, që mund të dëmtojnë fëmijën e palindur ose që sipas protokolleve mjekësore, mund të shkaktojnë vuajtje të papërligjura.

12. Bashkëpunimi me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës në kryerjen e vlerësimit të plotë fëmijës dhe në hartimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes (PIM)

1. Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës për kryerjen e vlerësimit të plotë të fëmijës, duke ofruar të gjithë informacionin që disponojnë, mjedise të përshtatshme për kryerjen e intervistimit me fëmijën, motrat/vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, vizita të përbashkëta me PMF-në në mjedisin ku jeton fëmija dhe ekspertizë në vlerësimin e nivelit të rrezikut, nevojave për shërbime, identifikimin dhe caktimin e ndërhyrjeve të nevojshme.

2. Koordinatori mbështet PMF-në dhe lehtëson mbledhjen e informacionit të nevojshëm nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën.

3. Asistenti i fëmijës merr pjesë në takimet e Grupit Teknik Ndërsektorial (në vijim "GTN"), të thirrura nga strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës dhe me kërkesë të këtyre strukturave.

4. Asistenti i fëmijës mbështet dhe lehtëson pjesëmarrjen e fëmijës në takimet e GTN-së dhe marrjen e mendimit të tij, në rastet kur kjo kërket nga NJMF-ja, nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve logjistike apo të mbështetjes institucionale.

5. Asistenti i fëmijës, pjesëmarrës në takimet e GTN-së, shqyrton projektin e PIM-së dhe bën rekomandimet përkatëse për ndërhyrjet apo shërbimet e nevojshme për rastin, duke marrë përsipër detyra dhe shërbime, që do t'i ofrohen fëmijës, si dhe afatet përkatëse.

13. Shërbimi i kujdesit shëndetësor ndaj fëmijës

1. Pas kryerjes së ekzaminimit mjekoligjor dhe kontrollit intim, sipas pikës 11 dhe përpara miratimit të PIM-së, Qendra në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit, i ofron fëmijës kujdes shëndetësor, sipas nevojave në formën e konsultave, ekzaminimeve mjekësore, analizave dhe mjekimit, përfshirë kontrceptimin emergjent, nëse nevojitet nga personel i specializuar dhe në një mënyrë miqësore për fëmijën.

2. Kur nga vlerësimi i plotë i fëmijës dhe në PIM identifikohet nevoja për përkujdesje shëndetësor, afatshkurtër ose afatgjatë, përfshirë ndërhyrje për traumat, këshillim dhe terapi, si dhe parashikohet që këto shërbime apo një pjesë e tyre, të ofrohen nga Qendra, atëherë ajo do të ofrojë këto shërbime vetë ose në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit.

3. Asistenti i fëmijës ka përgjegjësinë të kujdeset për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, sipas pikave 13.1 dhe 13.2.

14. Shërbimet e ofruara prindit/kujdestarit joabuzues

1. Prindërit/kujdestarët joabuzues të fëmijës janë, gjithashtu, përfitues të shërbimeve në Qendër, duke iu ofruar atyre informacion të vazhdueshëm, këshillim dhe mbështetje në rast krize. Qëllimi kryesor i informimit, këshillimit dhe mbështetjes në raste krize, për prindërit/kujdestarët joabuzues është që t'u mundësojë atyre, që t'i ofrojnë fëmijës mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme gjatë procesit penal dhe më tej.

15. Transporti i sigurt

Qendra do të mundësojë transportim të sigurt për fëmijën drejt dhe gjatë qëndrimit në Qendër, sipas nevojës së vlerësuar nga NJMF-ja, Gjykata ose asistenti i fëmijës në Qendër. Kjo procedurë ndiqet kur një fëmijë është në rrezik të menjëhershëm, dhe është vlerësuar se duhet të lëvizet drejt një shërbimi të strehimit emergjent të sigurt, shërbime të tjera alternative, gjykatë ose prokurori, qendër shëndetësore, mjekësia ligjore, si dhe në shërbime të tjera të vlerësuara dhe në përshtatje me nevojat e fëmijës. Qëllimi i shërbimit të transportit të sigurt është që të ndihmojë fëmijën duke i krijuar siguri të plotë gjatë lëvizjes nga familja apo struktura të tjera, drejt Qendrës ose shërbimeve të ndryshme të nevojshme ose nga këto të fundit drejt familjes.

1. Kur vlerësohet i nevojshëm sigurimi i transportimit të fëmijës drejt Qendrës ai realizohet gjithmonë në praninë e NJM-së/PMF-së të njësisë më të afërt administrative ku është identifikuar fëmija dhe ose kujdestarin joabuzues.

2. Transporti i fëmijës gjatë kohës së qëndrimit në Qendër për të marrë shërbime që nuk mundësohen në Qendër bëhen me shoqërimin e asistentit të fëmijës dhe ose kujdestarit ligjor joabuzues.

3. Mjeti lëvizës duhet të jetë i pajisur me të gjithë certifikatat e sigurisë teknike të siguruar nga

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

autoritetet përgjegjëse dhe sipas nevojës të plotësojë kushtet teknike për transportim të personave me aftësi ndryshe.

4. Asistenti i fëmijës siguron që në çdo rast duhet të ketë gjithmonë procesverbalet dhe materialet e mëposhtme:

- format e procesverbaleve sipas rastit;
- plotësimin e databazës së shërbimit.

5. Autorizimi për lëvizjet dhe shoqërimin e fëmijës së pashoqëruar drejt shërbimeve ndërqytetas ose drejt shërbimeve të tjera që nuk mundësohen në Qendër nënshkruhen dhe vulosen nga koordinatori i Qendrës, NJMF-së/PMF-së, i njësisë administrative më pranë Qendrës dhe, në çdo rast, bëhet njoftimi i institucioneve ligjzbatuese.

16. Financimi i shërbimeve dhe i Qendrës

1. Shërbimet në Qendër ofrohen falas dhe mbulohen nga buxheti i Qendrës.

2. Për të siguruar qëndrueshmërinë e Qendrës, financimi i saj do të mbështetet në parimet për një buxhet të plotë, të bazuar në nevoja dhe që mundëson funksionimin e plotë të shërbimit, sipas modelit të shërbimeve dhe standardeve të përcaktuara.

3. Qendra financohet nga buxheti i spitalit dhe ka këto burime financimi¹:

- a) Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- b) institucionet e sigurimeve shëndetësore;
- c) njësitë e qeverisjes vendore;
- d) donatorët vendas e të huaj.

4. Kostot operative dhe të personelit mbulohen nga Programi Buxhetor për Spitalet.

5. Kostot për shërbimet që ofrohen nga institucione apo struktura të tjera, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, mbulohen nga këto institucione apo struktura pavarësisht vendit ku ofrohet shërbimi.

17. Administrimi i dokumentacionit, mbrojtja e të dhënave dhe privatësia

1. Referimi, menaxhimi i rastit në Qendër, si dhe komunikimet apo procesverbalet e takimeve me institucionet apo strukturat e tjera dokumentohen në regjistra të veçantë dhe administrohen, sipas rregullave të spitalit. Punonjësit apo profesionistët që vijnë të ofrojnë shërbime në Qendër, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, respektojnë rregullat e administrimit të dokumentacionit të Qendrës.

2. Të dhënat lidhur me fëmijën, që trajtohet me shërbime pranë Qendrës janë konfidenciale dhe çdo profesionist apo punonjës, që ka të dhëna lidhur me fëmijën është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë, për shkak të detyrës ose/dhe gjatë kryerjes së detyrës. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

3. Ndalohej identifikimi ose publikimi në çfarëdoqë formë i të dhënave personale të fëmijës, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Përpunimi i të dhënave të fëmijës realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

18. Monitorimi dhe vlerësimi

1. Vlerësimi i cilësisë së shërbimit do të bëhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, si dhe institucione përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve shoqërore, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

2. Këto institucione bëjnë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve në Qendër (sipas modelit të shërbimeve dhe standardeve të përcaktuara), rezultatit, performancës dhe llojit të shërbimeve të ofruara, numrit të përfituesve dhe nivelit të kënaqshmërisë së tyre, si dhe vlerëson nevojat për ndryshime dhe/ose përmirësime. Vlerësimi i kryer i përcillet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deri më datë 31 janar të vitit pasardhës.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pasi shqyrton materialin, i përcjell spitalit rekomandimet lidhur me masat, që vlerëson se duhen marrë, duke ofruar, kur është e mundur, edhe zgjidhjet për përmbushjen e tyre.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke respektuar detyrat dhe përgjegjësitë e spitalit, ushtron sa herë e konsideron të arsyeshme, mbikëqyrje dhe kontroll për të siguruar cilësinë e shërbimeve dhe zbatimin e standardeve, sipas modelit të shërbimeve, si dhe kontroll ekonomiko-financiar për pjesën e buxhetit që financon.

¹ Neni 24 i ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

19. Mbledhja e të dhënave, shpërndarja e informacionit dhe rritja e ndërgjegjësimit

1. Qendra mbledh të dhëna dhe përpunon informacion statistikor, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit rreth abuzimit seksual dhe dhunës ndaj fëmijëve dhe rolit të përgjigjeve shumësektoriale dhe ndërinstitutionale. Të dhënat bëhen publike dhe ndahen me institucionet dhe palët e interesuara, me qëllim përmirësimin e politikave, legjislacioni dhe praktikave.

2. Qendra merr pjesë në aktivitete të natyrës informuese dhe ndërgjegjësuere, për përmbushjen e qëllimeve sipas pikës 18.1.

V. PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET MODELI I SHËRBIMEVE

Ofrimi i shërbimeve nga qendrat e trajtimit të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës dhe çdo veprim dhe/ose vendimmarrje, në lidhje me fëmijën bëhet duke respektuar parimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe kryesisht parimet e mëposhtme:

1.1 Interesi më i lartë të fëmijës është konsiderata parësore në të gjithë veprimet dhe vendimet, në lidhje me fëmijën dhe prindërit/kujdestarët joabuzues. Prandaj, qendrat duhet të garantojnë që vendimet dhe veprimet që do të merren ndaj fëmijës bazohen në vlerësimin e interesit më të lartë të tij. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Vlerësimi i interesit më të lartë merr në konsideratë nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje; mendimin e fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; historinë e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen; aftësinë e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës, si dhe vazhdimësinë e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore¹. Përcaktimi i interesit më të lartë kryhet nga profesionistë të kualifikuar pa vonesa të pajustificuara. Ai mbështetet në fakte të vërtetuara dhe në informacionet e dhëna nga fëmija dhe prindërit/kujdestarët joabuzues.

1.2 E drejta e marrjes së vendimit për ta përfituar shërbimin, bazuar në dhënien e një informacioni të plotë e të përditësuar. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Të gjithë shërbimet në Qendër janë vullnetare për fëmijën dhe prindin/kujdestarin joabuzues dhe planifikohen mbi bazën e kërkesës dhe dhënies së pëlqimit të tyre. E drejta e fëmijës për informim dhe respektimi i mendimeve të tij lidhur me vendimet apo veprimet që propozohen të merren ndaj tij, është në qendër të praktikave dhe proceseve në Qendër. Fëmija dhe prindi/kujdestari joabuzues duhet gjithmonë të kenë akses në informacion dhe mbështetje, përshtatur sipas moshës, zhvillimit, gjuhës dhe nevojave të veçanta. Qendra duhet të sigurojë pëlqimin e informuar të tyre, me qëllim që të mbështetë vendimmarrjen dhe të kuptohen pasojat e vendimeve që merren.

1.3 Parimet e mosdiskriminimit dhe barazisë respektohen në çdo moment. Qendra pranon dhe bën përpjekje për të arritur, pa diskriminim, çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç viktimë dhe/ose dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës.

1.4 Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfitueses/it. Fëmija duhet të trajtohet me përkujdesje, në mënyrë miqësore dhe të ndjeshme, të tilla që respektojnë dinjitetin e tij gjatë gjithë procesit, duke marrë në konsideratë gjendjen e tij personale, nevojat e menjëhershme dhe të veçanta, moshën, gjininë, aftësitë e kufizuara, nëse ka, dhe nivelin e pjekurisë.

1.5 Mbrojtja e privatësisë, identitetit dhe imazhit të fëmijës viktimë dhe ndalimi i publikimit të çdo lloj informacioni që mund të çojë në identifikimin e fëmijës. Qendra dhe institucionet e përfshira marrin masa për parandalimin përhapjes së çdo lloj informacioni që mund të shpjerë në identifikimin e tij. Të dhënat lidhur me fëmijën janë konfidenciale dhe çdo profesionist/punonjës që ka të dhëna lidhur me fëmijën është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë, për shkak të detyrës ose/dhe gjatë kryerjes së detyrës.

1.6 Jeta private e fëmijës është e mbrojtur. Ndërhyrja në jetën private të fëmijës, nëse është e nevojshme, duhet të jetë në nivelin më të ulët të mundshëm, në mënyrë që të sigurohet informacioni i

1 Neni 6 i ligjit nr. 17/2018, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" dhe neni 10 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

nevojshëm për vlerësimet, veprimet dhe shërbimet ndaj fëmijës.

1.7 Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e emergjencës për viktimat e dhunës seksuale ashtu sikurse të gjitha shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore¹.

VI. STANDARDET, KRITERET DHE TREGUESIT

“Standardet e shërbimeve për Qendrën” e trajtimit të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës mbështeten në Standardet e Cilësisë për *Barnabus* të projektit ROMISE² dhe Marrëveshjes Kuadër Ndërinstitucionale të PROMISE³, e cila bazohet në përvojën dhe praktikën e ofrimit të shërbimeve të ngjashme në Evropë, të integruara në Sistemin Shëndetësor⁴.

STANDARDI 1

Informimi i fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës dhe çdo veprim dhe/ose vendimmarrje në lidhje me fëmijën

Rezultati i dëshiruar

Shërbimet e ofruara demonstrojnë një qasje të përshtatshme dhe të informuar për përdorueset/it e shërbimit, që merr në konsideratë dinamikën dhe pasojat e të dhunës të viktimat.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Çdo vendim apo veprim që do të merret ndaj fëmijës që trajtohet pranë Qendrës mbështetet në një vlerësim të interesit më të lartë të tij. 2. E drejta e fëmijës për t'u informuar, dëgjuar, për të shprehur pikëpamjet e tij si dhe për të marrë informacion respektohet dhe përmbushet, si dhe është në fokus të praktikave dhe proceseve në Qendër. 3. Vonesat e pajustificuara shmangen në çdo moment nga Qendra, duke siguruar që vlerësimet, veprimet dhe shërbimet ndaj fëmijës të kryhen brenda një periudhe kohore të arsyeshme dhe që fëmijët të marrin informacionin në kohë.	1.1.1 Punonjësit e Qendrës: - përfshihen aktivisht në procesin e vlerësimit fillestar dhe të plotë të rastit; - marrin pjesë në takimet e GTN-së dhe në vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës; - i kanë të qarta rolet dhe përgjegjësitë përkatëse në vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të çdo fëmije; - të trajnuar se si të zbatojë procedurat dhe instrumentet për këtë qëllim, për shembull formatet e vlerësimit dhe proceset për të vlerësuar dhe përcaktuar interesin më të lartë të fëmijës. 1.2.1 Punonjësit janë trajnuar si të komunikojnë, të dëgjojnë dhe të ndajnë informacionin me fëmijët, të përshtatur për moshën dhe zhvillimin e tyre. 1.2.2 Fëmijët dhe prindërit/kujdestarët e tyre joabuzues mund të ndikojnë në kohën, vendin dhe konfigurimin e ndërhyrjeve si trajtimi dhe terapia. 1.2.3 Fëmijëve u jepet mundësia të japin përshtypjet e tyre për përvojën brenda shërbimit. 1.2.4 Informacioni i nevojshëm u vihet në dispozicion sistematikisht fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve të tyre, i përshtatur për moshën dhe zhvillimin e fëmijës. 1.2.5 Fëmijët dhe prindërit/kujdestarët marrin informacion në gjuhën që kuptojnë. 1.2.6 Bëhen përpjekje të veçanta për të	2. Punonjësit e Qendrës duhet që në çdo rast që janë përpara një vendimi apo do të ndërmarrin veprime/ofrojnë shërbime për fëmijën të vlerësojnë interesin më të lartë të fëmijës. Për këtë, punonjësit e Qendrës vlerësojnë rast pas rasti, në dritën e rrethanave specifike të secilit fëmijë, nevojat e fëmijës për shërbime apo mbështetje. 3. Punonjësit e Qendrës duhet të ofrojnë gjithmonë akses në informacion për fëmijën dhe prindin/kujdestarin joabuzues, të përshtatur sipas moshës, zhvillimit, gjuhës dhe nevojave të veçanta. Të dëgjuarit e mendimit të fëmijës do të sigurojë një kuptim më të thellë të dëshirave dhe nevojave të tij si dhe do të lehtësojë vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës. 4. Qendra duhet të shmangë vonesat e pajustificuara, duke siguruar një strukturë organizative efikase, personel të besueshëm dhe fonde të mjaftueshme, mekanizma solidë koordinimi, si edhe bashkëpunim konsistent me aktorët e jashtëm që luajnë rol në procesin hetimor dhe atë gjyqësor (oficerët e policisë gjyqësore, psikologë, avokatët, prokurorët, gjyqtarët etj.).

¹ Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 4, “Parimet”, pika “c”.

² Lind Haldorsson, Olivia (2017) Standardet Evropiane të Cilësisë *Barnabus*: Udhëzime për Përgjigjen Multidisiplinare dhe Ndërinstitucionale ndaj Fëmijëve Viktimë dhe Dëshmitarë të Dhunës (Këshilli i Shteteve të Detit Balltik dhe Rrethi i Fëmijës) [The Barnabus Quality Standards - Barnabus](#)

³ Marrëveshja Ndërinstitucionale: Modele dhe Udhëzime: <https://www.barnabus.eu/en/wp-content/uploads/2020/09/InteragencyAgreementTemplate.pdf>

⁴ Barnabus Linköping, Suedi; Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve në Zagreb, Kroaci; Lighthouse në Londër, Mbretëri e Bashkuar; Barnabus në Gjermani, dhe modelet e llojit Barnabus në Finlandë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	garantuar që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë të njëjtat mundësi për të marrë informacion dhe për t'u dëgjuar. 1.2.7 Punonjësit e Qendrës mbështesin dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijës në mbledhjet e GTN-së dhe marrjen e mendimit të tij, nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve logjistike apo të mbështetjes institucionale. 1.3.1 Qendra pranon 24 orë në ditë, 7 ditë të javës vetëreferimet apo referimet. 1.3.2 Koordinatori raporton menjëherë rastin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit. 1.3.3 Punonjësit e Qendrës: - bashkëpunojnë me PMF-në për kryerjen e vlerësimit fillestar të fëmijës dhe i ofrojnë fëmijës shërbimet imediate; - marrin pjesë rregullisht në takimet e GTN-së, në të cilat janë të ftuar; - ofrojnë pa vonesa dhe brenda afateve, shërbimet e përcaktuara në PIM për t'u ofruar nga Qendra apo nën kujdesin e saj.	
--	---	--

Standardi nr. 1 përbëhet nga tri parime kryesore, në të cilët mbështetet ofrimi i shërbimeve dhe vendimmarrja në qendrat e trajtimit të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës. Këto parime mishërojnë jo vetëm parashikimet e Konventave të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, por edhe dispozitat e legjislacionit tonë të brendshëm. Zbatimi i këtyre parime është thelbësor për të parandaluar ri/traumatizimin e fëmijës çfarë përbën edhe synimin kryesor të Qendrës.

Interesi më i lartë të fëmijës është konsiderata parësore në të gjitha veprimet dhe vendimet në lidhje me fëmijën dhe prindërit/kujdestarët joabuzues. Prandaj, qendrat duhet të garantojnë që vendimet dhe veprimet që do të merren ndaj fëmijës bazohen në vlerësimin e interesit më të lartë të tij. Neni 3 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (OKB) ka gjetur refleksim, në kuadrin ligjor të brendshëm në të cilin është përcaktuar kuptimi i këtij parimi dhe elementet që duhet të mbahen në konsideratë për vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës. Sipas nenit 6 të ligjit nr. 17/2018, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Ndërkohë, që për të vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës merren në konsideratë nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatesinë në një familje; mendimin e fëmijës, në varësi të moshës dhe të aftësisë së tij për të kuptuar; historinë e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen; aftësinë e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’u përgjigjur nevojave të fëmijës, si dhe vazhdimësinë e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore¹. Përcaktimi i interesit më të lartë mbështetet në fakte të vërtetuara dhe në informacionet e dhëna nga fëmija dhe prindërit/kujdestarët joabuzues.

Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës kërkon që punonjësit e Qendrës, përpara çdo veprimi apo vendimi lidhur me fëmijën, të mendojnë me kujdes ndikimin e veprimeve të tyre te fëmijët, për t’u siguruar që konsiderata parësore është interesi më i lartë i fëmijës. Komiteti për të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm nr. 13 thekson, se: “duhet të respektohet e drejta e fëmijëve që interesi e tyre më i lartë të jetë konsiderata kryesore në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ata, sidomos kur ata janë viktime të

¹ Neni 6 i ligjit nr. 17/2018, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe neni 10 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

dhunës, si dhe në të gjitha masat e parandalimit¹. Komenti i Përgjithshëm nr. 14 i këtij Komiteti vë theksin tek ekipet shumëdisiplinore në vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës. Duke punuar së bashku, një ekip shumëdisiplinor dhe ndërinstitutional është në pozitën më të mirë për të bërë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe për të marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës gjatë gjithë procesit².

Për sa më sipër, punonjësit e Qendrës do të duhet të vlerësojnë interesin më të lartë të fëmijës, në mënyrë të vazhdueshme dhe në bashkëpunim strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës dhe GTN, si për shembull:

20. Në vlerësimin e shërbimeve për kujdes shëndetësor emergjent ndaj fëmijës që paraqitet në Qendër, me qëllim plotësimin e nevojave të fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik;

21. Në mbështetjen e strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës për kryerjen e vlerësimit fillestar dhe të plotë të fëmijës;

22. Pjesëmarrja e asistentit të fëmijës në takimet e GTN-së të thirrura nga strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës dhe vlerësimi i nevojave afatshkurtra dhe afatgjata për shërbime të kujdesit shëndetësor ndaj fëmijës.

Punonjësit e Qendrës duhet t'i kenë të qarta rolet dhe përgjegjësitë përkatëse në vlerësimin dhe përcaktimin e interesit më të lartë të çdo fëmije dhe të jenë të trajnuar se si të zbatojnë procedurat dhe instrumentet për këtë qëllim.

Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, është në fokus të praktikave dhe proceseve në Qendër. Fëmijës i garantohej e drejta për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të³. Të dëgjuarit sistematik të mendimit të fëmijës do të sigurojë një kuptim më të thellë të nevojave të fëmijës, do të lehtësojë përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës, si dhe shërbimet dhe veprimet më të përshtatshme për t'u ndërmarrë, për shembull, trajtimi dhe terapia. Fëmija dhe prindi/kujdestari joabuzues duhet gjithmonë të kenë akses në informacion, përshtatur sipas moshës, zhvillimit, gjuhës dhe nevojave të veçanta. Gjithashtu, fëmijëve u jepet mundësia për të dhënë përshtypjet mbi përvojën e tyre në Qendër, me qëllim përmirësimin e mjediseve dhe shërbimeve që ofrohen në Qendër. Për të siguruar realizimin e plotë të këtyre të drejtave duhet që punonjësit e Qendrës të marrin pjesë në trajnime që i aftësojnë ata në këtë drejtim. Gjithashtu, punonjësit e Qendrës mund të mbështesin dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijës në mbledhjet e GTN-së dhe marrjen e mendimit të tij, nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve logjistike apo të mbështetjes institucionale për rastet kur fëmija e ka të pamundur të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Në këto raste, Qendra ose ofron mjetet logjistike të nevojshme që sigurojnë lidhjen *online* të fëmijës me GTN-në nga mjediset e Qendrës ose vendos në dispozicion të GTN-së mjediset e nevojshme për zhvillimin e mbledhjes (sallë takimesh/mbledhje).

Vonesat e pajustificuara shmangen në çdo moment nga punonjësit e Qendrës, duke siguruar që vlerësimet, veprimet dhe shërbimet ndaj fëmijës të kryhen brenda një periudhe kohore të arsyeshme dhe që fëmijët të marrin informacionin në kohë. Shmangia e vonesave të pajustificuara është një parim themelor i mbrojtjes së fëmijëve dhe i procesit penal me të mitur⁴. Fëmijët që do të trajtohen në Qendër janë viktimë ose dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës pra, të një veprë penale dhe si të tillë, ata do të jenë pjesë e një procesi penal. Për të shmangur ri/viktimizimin apo ri/traumatizimin e këtyre fëmijëve, KDPM-ja parashikon detyrimin për çdo organ kompetent që të shqyrtojë në mënyrë të shpejtë dhe me përparësi çështjet me të mitur viktimë dhe dëshmitar. Në të njëjtën mënyrë, edhe të gjitha institucionet që veprojnë në mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve nga fëmijës duhet të shmangin çdo lloj vonesë të pajustificuar që mund të çojë në përkeqësimin e traumës së përjetuar nga i mitur. Gjithashtu, një bashkëveprim dhe bashkëpunim ndërinstitutional efikas kërkon shmangien e vonesave të pajustificuara, në mënyrë që secili prej institucioneve të kryejë funksionet e veta në kohën e duhur. Për të siguruar respektimin e këtij parimi, Qendra duhet të pranojë 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, vetëreferimet apo referimet, të disponojë një strukturë organizative efikase, personel të besueshëm dhe fonde të mjaftueshme, mekanizma solidë koordinimi, si edhe bashkëpunim konsistent me aktorët e

¹ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm nr. 13, paragrafi 3/f: <https://www.refworld.org/docid/4e6da4922.html>

² Komiteti për të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm nr. 14, paragrafi 47: https://www2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/gc/crc_c_gc_14_eng.pdf

³ Neni 13, i ligjit nr. 17/2018, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

⁴ Neni 17, i KDPM-së.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

jashtëm, që luajnë rol në procesin hetimor dhe atë gjyqësor (oficerët e policisë gjyqësore, psikologë, avokatët, prokurorët, gjyqtarët etj.).

STANDARDI 2

Shërbimet e ofruara në Qendër u përgjigjen nevojave individuale të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës.

Rezultati i dëshiruar

Shërbimet e ofruara nga Qendra u përgjigjen nevojave individuale dhe komplekse të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës, i japin përparësi mirëqenies fizike dhe psikologjike të fëmijës, si dhe reflektojnë parimet e sigurisë dhe dinjitetit të fëmijëve.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Qendra ka një dokument të shkruar me misionin dhe objektivat e shërbimit, të cilat duhet të jenë të shkruara me gjuhë të kuptueshme dhe të afishuara në një vend të dukshëm. 2. Qendra ofron shërbimet si më poshtë: - Ndihma e parë dhe kujdesi i emergjencës; - Mbështetje në rast krizash; - Mbështetje dhe këshillim mjekësor i specializuar; - Këshillim psikologjik i specializuar dhe ndërhyrje terapeutike; - Transportimi i sigurt; - Referimi dhe menaxhimi/ndjekja e rastit në bashkëpunim me PMF-në. Shërbimet në Qendër ofrohen falas dhe mbulohen nga buxheti i Qendrës. 4. Për shërbime që nuk ofrohen nga Qendra ajo bashkëpunon me institucione apo struktura të specializuara në ofrimin e shërbimit të kërkuar duke vendosur, kur është e mundur, mjediset e saj në dispozicion të ofrimit të shërbimit. 5. Shërbimi i ofruar reflekton qartë parimet e sigurisë dhe dinjitetit njerëzor.	2.1.1 Qendra disponon një dokument në formë shkresore dhe të afishuar me misionin dhe objektivat e shërbimit. 2.1.2 Personeli mbështetjet dhe orientohet nga rregulla të brendshme të rëndësishme si Kodi i Sjelljes së Personelit, rregulla për raportimin e parregullsisë, procedurat e sigurisë, protokoll emergjence etj. 2.2.1 Formularët e pranimit, raportet e psikologes/pediatrit, vlerësimet e mjekut specialist dhe të mjekut ligjor, shërbimet e tjera ku referohet fëmija, deklarata e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale etj., të plotësuara dhe vendosura në dosjet e fëmijës. 2.3.1 Asnjë nga shërbimet e ofruara nga Qendra dhe nga institucione apo struktura të tjera në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional nuk janë me pagesë për përfituesin. 2.4.1 Numri i rasteve të trajtuara në Qendër, numri i rasteve të referuara në institucione të tjera, dokumentet e referimit të fëmijës në institucione apo struktura të specializuara etj. 2.5.1 Procedurat për sigurinë dhe respektimin e dinjitetit njerëzor, të shkruara dhe të afishuara për përdoruesit/et e shërbimit.	1. Fëmijët dhe prindi/kujdestari joabuzues njihen menjëherë me misionin dhe objektivat e shërbimit në Qendër, si dhe me të drejtat dhe detyrimet ndaj Qendrës dhe punonjësve të saj. 2. Qendra ofron shërbimet e saj në mënyrë të personalizuar për secilin fëmijë dhe mbi bazën e vlerësimit të nevojave. 3. Shërbimet e nevojshme ndaj fëmijës ofrohen nga Qendra ose nëpërmjet bashkëpunimit me institucione apo struktura të specializuara në ofrimin e shërbimit të kërkuar. 4. Për të siguruar qëndrueshmërinë e Qendrës, financimi i saj do të mbështetet në parimet për një buxhet të shëndoshë, të bazuar në nevoja dhe që mundëson funksionimin e plotë të shërbimit, sipas standardeve të përcaktuara. 5. Qendra disponon mjedise të përshtatshme për ekzaminimet mjekësore dhe këshillimin psikologjik të fëmijëve dhe, kur është e mundur, i vendos ato (mjediset) në dispozicion të ofrimit të shërbimit nga institucionet/strukturat bashkëpunuese. 6. Kur siguria e fëmijës është në rrezik, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me asistentin e fëmijës të Qendrës marrin masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 37 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Modeli i shërbimeve të ofruara nga qendrat për mbështetjen dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës ofron një kornizë të ndërhyrjes shumësektoriale dhe ndërinstitucionale të mbështetjes së fëmijës gjatë procesit të menaxhimit dhe trajtimit të rastit në rrugë civile dhe/ose penale. **Ky model, mbështetet në modelin dhe standardet Barnahus të shërbimeve të ngjashme në Evropë, të integruara në sistemin shëndetësor**, që promovon praktika që parandalojnë ri/traumatizimin dhe janë në përputhje me të drejtat e fëmijëve për mbrojtje, ndihmë dhe drejtësi të përshtatur për fëmijët, si dhe duke bashkëpunuar me institucionet e drejtësisë, në kuadër të zhvillimit të procesit penal dhe sigurimit të provave. **Ofrimi i shërbimeve nga qendrat mbështetet në një qasje ndërinstitucionale dhe shumësektoriale**, me qëllim vlerësimin e nevojave dhe përmbushjen e nevojave individuale dhe komplekse që kanë fëmijët viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës për shërbime.

Qendrat ofrojnë shërbimet, si më poshtë:

1. Ndihma e parë dhe kujdesi i emergjencës;
2. Mbështetje në rast krizash;
3. Mbështetje dhe këshillim mjekësor i specializuar;
4. Këshillim psikologjik i specializuar dhe ndërhyrje terapeutike;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

5. Transporti i sigurt përmes një mjeti të paidentifikueshëm, me qëllim garantimin e anonimitetit dhe ruajtjen e privatësisë;

6. Referimi dhe bashkëpunim me PMF-në për menaxhimin e rastit.

Për ofrimin e shërbimeve të mësipërme, pranë spitaleve rajonale ngrihen Qendra të specializuara, me qëllim ofrimin e kujdesit dhe të mbështetjes shumësektoriale të përshtatur për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës. **Qendra është pjesë e strukturës së Spitalit,** i cili është institucioni drejtues dhe përgjegjës për realizimin e veprimtarisë së Qendrës, sipas parashikimeve të këtij urdhri/udhëzimi. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përcakton organizimin, strukturën dhe rregulloret e funksionimit të Qendrës, si pjesë e strukturës së spitalit. Qendra ka në përbërje të saj të paktën punonjësit, si më poshtë:

c) Koordinatori që do të bashkërendojë punën ndërinstitutionale dhe do të sigurojë komunikimin me institucionet e tjera mbështetëse dhe bashkëpunuese. Ai kryen funksione administrative dhe koordinuese.

d) Asistenti i fëmijës, i cili në bashkëpunim me punonjësin për mbrojtjen e fëmijës do të kujdeset për përmbushjen e nevojave emergjente të fëmijës dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të parashikuara në planin individual të mbrojtjes.

Shërbimet në Qendër ofrohen falas dhe mbulohen nga buxheti i Qendrës. Për të siguruar qëndrueshmërinë e Qendrës, financimi i saj do të mbështetet në parimet për një buxhet të shëndoshë, të bazuar në nevoja dhe që mundëson funksionimin e plotë të shërbimit, sipas modelit të shërbimeve dhe standardeve të përcaktuara. **Qendra financohet nga buxheti i spitalit dhe ka këto burime financimi¹:**

e) Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

f) institucionet e sigurimeve shëndetësore;

g) njësitë e qeverisjes vendore;

h) donatorët vendës e të huaj.

Kostot operative dhe të personelit mbulohen nga buxheti i akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për spitalin. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke respektuar detyrat dhe përgjegjësitë e spitalit, ushtron sa herë e konsideron të arsyeshme, kontroll ekonomik-financiar për pjesën e buxhetit që financon. Kostot për shërbimet që ofrohen nga institucione apo struktura të tjera, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, mbulohen nga këto institucione apo struktura pavarësisht vendit ku ofrohet shërbimi.

Qendra pranon 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, referimet me vetiniciativë të fëmijës dhe/ose të prindërve/kujdestarit të fëmijës, si dhe referimet nga çdo person fizik apo juridik, si dhe nga çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, për shkak të profesionit apo, të cilit i është raportuar rasti. Qendra pranon menjëherë rastet e vetëreferuara ose të referuara nga strukturat e sipërpërmendura, pavarësisht formës së përdorur për njoftimin.

Qendra ka për detyrë t'i ofrojë fëmijës, që paraqitet apo referohet pranë Qendrës, të gjitha shërbimet që ajo ofron dhe vlerësohen të nevojshme për të siguruar mirëqenien fizike dhe psikologjike të fëmijës. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Qendra mbështetet nga mjekët dhe punonjësit e strukturave të tjera të spitalit, sipas nevojave të rastit, si dhe nga profesionistë të institucioneve të tjera që do të ofrojnë shërbime apo do të kryejnë veprime procedurale në mjediset e Qendrës. **Për shërbime që nuk ofrohen nga vetë punonjësit e Qendrës apo strukturat e spitalit, ajo bashkëpunon me institucione/struktura të specializuara në ofrimin e shërbimit të kërkuar duke vendosur, kur është e mundur, mjediset e saj në dispozicion të ofrimit të shërbimit.**

Gjithashtu, **shërbimet e ofruara nga Qendra duhet të reflektojnë parimet e sigurisë dhe dinjitetit të fëmijëve.** Kështu, kur siguria e fëmijës është në rrezik, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me punonjësit e Qendrës marrin masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 37 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës janë, gjithashtu, fëmijë viktimë apo dëshmitarë të një veprë penale dhe si të tillë ata përfitojnë nga të gjitha masat mbrojtëse të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Në nenin 37 të këtij Kodi parashikohet, se: “kur siguria e fëmijës viktimë ose dëshmitar është në rrezik, sipas rastit, prokurori, policia gjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës marrin masa mbrojtëse, të tilla si:

a) shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë ose dëshmitar dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit;

¹ Neni 24, i ligjir nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- b) bërjen e kërkesës për nxjerrjen e një “urdhërkufizimi” në gjykatë;
- c) bërjen e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg” ose “arrest në shtëpi” për të akuzuarin me kushtin e ndalimit të kontaktit me të miturin;
- ç) bërjen e kërkesës për marrjen e masave mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar prej policisë ose strukturave të tjera dhe ruajtjen e sekretit të vendndodhjes së të miturit;
- d) të marrë ose të kërkojë nga autoritetet kompetente masa të tjera mbrojtëse që konsiderohen të përshtatshme.

Nga leximi i dispozitave të mësipërme, rezulton e rëndësishme që ndërkohë që fëmija trajtohet në Qendër dhe punonjësit e Qendrës marrin dijeni për një rrezik që cenon sigurinë e fëmijës atëherë ata duhet të njoftojnë dhe të bashkëpunojnë me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës për marrjen e masave mbrojtëse ndaj fëmijës. Roli i punonjësve të Qendrës në këtë rast është të bashkëpunojë dhe mbështesë Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës. Në të njëjtën mënyrë, kur ndaj fëmijës është marrë një masë mbrojtëse nga prokurori, policia gjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës atëherë punonjësit e Qendrës duhet të kujdesen që, gjatë trajtimit në Qendër, fëmija të gëzojë mbrojtjen e nevojshme (si për shembull: të kujdesen që të shmanget përballja e të miturit viktimë me të akuzuarin apo të ruajnë sekretin e vendndodhjes së të miturit).

STANDARDI 3

Qasja e koordinuar shumësektoriale dhe bashkëpunimi ndërinstytucional midis Qendrës dhe aktorëve në nivel qendror dhe vendor

Rezultati i dëshiruar

Të garantohet ofrimi i shërbimeve dhe trajtimi i rasteve në mënyrë të koordinuar dhe përmes zbatimit të qasjes shumësektoriale dhe bashkëpunimit të aktorëve në nivel qendror dhe vendor.

Qendra bashkëpunon me Prokurorinë dhe Gjykatat më kuadër të ekzaminimit mjekoligjor dhe kontrollit intim, duke ofruar mjedisin, mjetet dhe materialet e nevojshme klinike, si dhe bashkëpunon me strukturat e tjera të spitalit për të siguruar pjesëmarrjen e një mjeku të certifikuar dhe infermieri me të njëjtën gjini me fëmijën ose të gjinisë së zgjedhur nga vetë fëmija, të trajnuar në abuzimin seksual dhe keqtrajtimin e fëmijës.

Çdo fëmije që vetëreferohet apo është referuar në Qendër i ofrohet kujdesi shëndetësor i emergjencës që përfshin konsultën pediatrike dhe ofrimin e ndihmës mjekësore emergjente/të urgjencës që ofrohet në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit.

Qendra, në bashkëpunim me strukturat e tjera të spitalit, i ofron fëmijës kujdes shëndetësor, afatshkurtër apo afatgjatë dhe, sipas nevojave, nga personel i specializuar dhe në një mënyrë miqësore për fëmijën.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Qendra ofron tërësinë e shërbimeve të parashikuara bazuar në qasjen e koordinuar shumësektoriale dhe në bashkëpunimin ndërinstytucional midis Qendrës dhe aktorëve në nivel qendror dhe vendor.	3.1.1 Qendra ka një mandat formal nga autoritetet përkatëse për të bashkërenduar bashkëpunimin ndërinstytucional dhe për të ofruar shërbime shumësektoriale. 3.1.2 Qendra ka lidhur marrëveshje ndërinstytucionale me institucionet me të cilët bashkëpunon për ofrimin e shërbimeve në Qendër. 3.1.3 Qendra ka të punësuar një koordinator që do të bashkërendojë punën ndërinstytucionale. 3.1.4 Roli i koordinators përcaktohet qartë në përkrahimin e punës. 3.1.5 Punonjësit e Qendrës marrin pjesë aktivisht në mbledhjet e GTN-së për trajtimin e rastit.	Identifikimi i institucioneve/strukturave të specializuara në ofrimin e shërbimeve të kërkuara jashtë spitalit, me të cilat Qendra do të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi dhe do të trajtojë rastet sipas qasjes shumësektoriale.
2. Qendra disponon mjedisin, mjetet dhe materialet e nevojshme klinike për të kryer ekzaminimin mjekoligjor dhe kontrollin intim të	3.2.1 Mjedişi i përshtatshëm, mjetet dhe materialet e nevojshme klinike. 3.2.2 Vlerësimet e mjekut specialist dhe të mjekut ligjor, dokumentacioni që vërteton shërbimet që i janë ofruar fëmijës në spital; Dosja personale e fëmijës.	Me kërkesë të prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, për të ulur rrezikun e riviktimizimit të fëmijës dhe në mbështetje të procesit të marrjes në pyetje, Qendra, sipas kapaciteteve që disponon, ofron mjedise miqësore për

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

fëmijës si dhe bashkëpunon me strukturat e tjera të spitalit për të siguruar pjesëmarrjen e një mjeku të certifikuar dhe infermieri me të njëjtën gjini me fëmijën.		fëmijët dhe pajisjet/logistikën e nevojshme. Kur në vendimin e gjykatës/prokurorit, përcaktohet Qendra, si vend për kryerjen e kontrollit/ekzaminimit intim dhe mjekësor të fëmijës dhe/ose marrjen e kampionëve biologjikë atëherë, ajo ofron mjedisin, mjetet dhe materialet e nevojshme klinike për këtë qëllim.
3. Fëmijët e referuar në Qendër përfitojnë kujdesin shëndetësor të emergjencës që përfshin konsultën pediatrike dhe ofrimin e ndihmës mjekësore emergjente/të urgjencës që ofrohet në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit. 4. Fëmija përfiton në Qendër kujdes shëndetësor, afatshkurtër apo afatgjatë, dhe sipas nevojave nga personel i specializuar dhe në një mënyrë miqësore për fëmijën.	3.3.1 Ekzaminimi mjekësor, trajtimi dhe dërgimi i mundshëm të trajtimit mjekësor i specializuar është pjesë përbërëse e shërbimeve që ofron Qendra; 3.4.1 Vlerësimet mjekësore kryhen në ambientet e Qendrës; 3.4.2 Asistenti i Fëmijës merr pjesë rregullisht në takimet e GTN-së për përcaktimin e nevojave për kujdes shëndetësor të fëmijës. 3.4.3 Asistenti i fëmijës kujdeset për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore të parashikuara në PIM. 3.4.4 Qendra bashkëpunon dhe mbështetet nga strukturat e tjera të specializuara të spitalit në ofrimin e ndihmës mjekësore emergjente apo të vazhdueshme.	Fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve joabuzues të tyre u sigurohet informacioni i duhur për ekzaminimet dhe trajtimin mjekësor. Punonjësit e Qendrës duhet t'i japin peshën e duhur mendimeve të fëmijës për ekzaminimin dhe trajtimin.

Siç e theksuam, **ofrimi i shërbimeve nga qendrat mbështetëse në një qasje ndër-institucionale dhe shumësektoriale** me qëllim vlerësimin e nevojave dhe përmbushjen e nevojave individuale dhe komplekse që kanë fëmijët viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës për shërbime. Qendra është pjesë e strukturës së spitalit, i cili është institucioni drejtues dhe përgjegjës për realizimin e veprimtarisë së Qendrës.

Veprimtaria parësore e qendrave është ofrimi i shërbimeve të sipërpërmendura (standardi nr. 2) për fëmijët viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës. Në kuadër të ofrimit të këtyre shërbimeve, Qendra mbështetet nga mjekët dhe punonjësit e strukturave të tjera të spitalit, sipas nevojave të rastit, si dhe nga profesionistë të institucioneve të tjera që do të ofrojnë shërbime apo do të kryejnë veprime procedurale në mjediset e Qendrës. Për shërbime që nuk ofrohen nga vetë punonjësit e Qendrës apo strukturat e spitalit, ajo bashkëpunon me institucione/struktura të specializuara në ofrimin e shërbimit/eve të kërkuara duke vendosur, kur është e mundur, mjediset e saj në dispozicion të ofrimit të shërbimit. Për të materializuar këtë bashkëpunim me institucionet/strukturat e specializuara në ofrimin e shërbimit/eve të kërkuara jashtë spitalit, Qendra do të lidhë marrëveshje ndër-institucionale (ose bashkëpunimi) me këto struktura apo institucione.

Veprimtaria dytësore e Qendrës është bashkëpunimi dhe mbështetja që ajo do t'i ofrojë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës, Prokurorisë dhe Gjykatës gjatë menaxhimit të rastit. Në këtë rast, roli i punonjësve të Qendrës është bashkëpunimi, mbështetja dhe lehtësimi i disa proceseve gjatë fazës së menaxhimit të rastit nga institucionet përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi (strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës, Prokuroria dhe Gjykatat). Kështu:

1. Menjëherë sapo Qendrës i vetëreferohet apo i referohet një rast, punonjësit e saj (koordinatori) kanë përgjegjësinë të raportojë rastin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës dhe/ose pranë organeve të Policisë së Shtetit sipas parashikimeve të VKM-së nr. 578, datë 3.10.2018, "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes".

2. Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës për të lehtësuar kryerjen e vlerësimit fillestar të fëmijës, ofrimin e shërbimeve emergjente në Qendër apo koordinimin e veprimeve për ofrimin e shërbimeve emergjente të identifikuara nga vlerësimi fillestar nga

struktura/institucione jashtë spitalit.

3. Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës për kryerjen e vlerësimit të plotë të fëmijës, duke ofruar të gjithë informacionin që disponojnë, mjedise të përshtatshme për kryerjen e intervistimit me fëmijën, motrat/vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, vizita të përbashkëta me PMF-në në mjedisin ku jeton fëmija dhe bashkëpunim në vlerësimin e nivelit të rrezikut, nevojave për shërbime, identifikimin dhe caktimin e ndërhyrjeve të nevojshme. Punonjësit e Qendrës (punonjësi social) marrin pjesë në takimet e GTN-së të thirrura nga strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës, dhe me kërkesë të këtyre strukturave. Kur nga vlerësimi i plotë i fëmijës dhe në PIM identifikohet nevoja për përkujdes shëndetësor, afatshkurtër ose afatgjatë, përfshirë ndërhyrje për traumat, këshillim dhe terapi, dhe parashikohet që këto shërbime apo një pjesë e tyre të ofrohen nga Qendra, atëherë ajo do të ofrojë këto shërbime vetë ose në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit.

4. Me kërkesë të prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, për të ulur rrezikun e riviktimizimit të fëmijës dhe në mbështetje të procesit të marrjes në pyetje, Qendra, sipas kapaciteteve që disponon, ofron mjedise miqësore për fëmijët, pajisje për regjistrimin audio dhe video gjatë pyetjes së fëmijës në mjediset e Qendrës, pajisje që ndryshojnë pamjen dhe/ose zërin e dëshmitarit/viktimës gjatë marrjes në pyetje në distancë, si dhe lehtësi të tjera sipas nevojës.

5. Kur në vendimin e gjykatës/prokurorit, përcaktohet Qendra si vend për kryerjen e kontrollit/ekzaminimit intim dhe mjekësor të fëmijës dhe/ose marrjen e kampionëve biologjikë atëherë, ajo ofron mjedisin, mjetet dhe materialet e nevojshme klinike për këtë qëllim. Qendra bashkëpunon me strukturat e tjera të spitalit për të siguruar pjesëmarrjen e një mjeku të certifikuar dhe infermieri me të njëjtën gjini me fëmijën ose të gjinisë së zgjedhur nga vetë fëmija, të trajnuar në abuzimin seksual dhe keqtrajtimin e fëmijës.

Për të siguruar bashkërendimin e punën ndërinstitucionale, Qendra ka të punësuar një koordinator, i cili do të sigurojë komunikimin me institucionet e tjera mbështetëse dhe bashkëpunuese.

Bashkëpunimi me Prokurorinë dhe Gjykatat në kuadër të ekzaminimit mjekoligjor dhe kontrollit intim dhe të marrjes në pyetje të fëmijës

Për të ulur rrezikun e riviktimizimit të fëmijës, Qendra, në mbështetje të procesit të marrjes në pyetje të fëmijës dhe sipas kapaciteteve që disponon, ofron mjedise miqësore për fëmijët, pajisje për regjistrimin audio dhe video gjatë pyetjes së fëmijës në mjediset e Qendrës, pajisje që ndryshojnë pamjen dhe/ose zërin e dëshmitarit/viktimës gjatë marrjes në pyetje në distancë, si dhe lehtësi të tjera sipas nevojës. Qendra, në çdo rast, kujdeset që të shmangë përballjen e të miturit viktimë me të akuzuarin, në të gjitha mjediset ku zhvillohet procesi i marrjes në pyetje dhe gjatë gjithë kohës. Kur për nevoja të hetimit dhe mbledhjes së provave, prokurori dhe/ose gjykata vendosin **kryerjen e kontrollit/ekzaminimit intim dhe mjekësor të fëmijës dhe/ose marrjen me detyrim të kampionëve biologjikë**, në vendim përcaktohet, ndër të tjera, edhe një përshkrim i detajuar i llojit të kampionit biologjik që do të merret ose të procedurës mjekësore që do të kryhet, vendit, datës, kohës dhe mënyrës së saktë të marrjes së kampionit biologjik ose kryerjes së procedurës tjetër mjekësore. Kur në vendimin e gjykatës/prokurorit, përcaktohet Qendra si vend për kryerjen e kontrollit/ekzaminimit intim dhe mjekësor të fëmijës dhe/ose marrjen e kampionëve biologjikë atëherë, ajo ofron mjedisin, mjetet dhe materialet e nevojshme klinike për këtë qëllim. Qendra bashkëpunon me strukturat e tjera të spitalit për të siguruar pjesëmarrjen e një mjeku të certifikuar dhe infermieri me të njëjtën gjini me fëmijën ose të gjinisë së zgjedhur nga vetë fëmija, të trajnuar në abuzimin seksual dhe keqtrajtimin e fëmijës. Nuk mund të kryhen procedura mjekësore që vënë në rrezik jetën e personit, integritetin fizik ose shëndetin e tij, që mund të dëmtojnë fëmijën e palindur ose që sipas protokolleve mjekësore, mund të shkaktojnë vuajtje të papërligjura.

Çdo fëmije që vetëreferohet apo është referuar në Qendër i ofrohet **kujdesi shëndetësor i emergjencës** që përfshin konsultën pediatrike dhe ofrimin e ndihmës mjekësore emergjente/të urgjencës, e cila ofrohet në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit. **Pas kryerjes së ekzaminimit mjekoligjor dhe kontrollit intim dhe përpara miratimit të PIM-së, Qendra në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit i ofron fëmijës kujdes shëndetësor sipas nevojave** në formën e konsultave, ekzaminimeve mjekësore, analizave dhe mjekimit, përfshirë kontrceptimin emergjent nëse nevojitet, nga personel i specializuar dhe në një mënyrë miqësore për fëmijën. **Kur nga vlerësimi i plotë i fëmijës dhe në PIM identifikohet nevoja për përkujdes shëndetësor, afatshkurtër ose afatgjatë**, përfshirë ndërhyrje për traumat, këshillim dhe terapi, dhe parashikohet që këto shërbime apo një pjesë e tyre të ofrohen nga Qendra, atëherë, ajo do të ofrojë këto

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

shërbime vetë ose në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit. Asistenti i Fëmijës ka përgjegjësinë të kujdeset për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të sipërpërmendura.

STANDARDI 4

Qendra ofron mjedis të përshtatur për fëmijët

4.1 Vendndodhja e Qendrës është lehtësisht e aksesueshme nga fëmijët dhe prindërit, në një mjedis të njohur dhe më vete. Mjediset janë të arritshme me transport publik dhe janë të aksesueshme nga fëmijë me aftësi të kufizuara.

4.2 Mjediset e brendshme janë të përshtatura për fëmijët dhe me moshën e tyre, sidomos në dhomat e pritjes. Mjediset janë të sigurta fizikisht për fëmijët e të gjitha moshave dhe fazave zhvillimore, madje edhe për fëmijë me aftësi të kufizuara.

4.3 Privatësia: Ekzistojnë mjedise të ndara, të izoluara nga ana akustike dhe private për të siguruar privatësinë.

4.4 Parandalimi i kontaktit me autorin e dyshuar të krimit: Mjediset ofrojnë mundësinë e shmangies së kontaktit mes viktimës dhe autorit të dyshuar të veprës penale gjatë gjithë kohës.

Rezultati i dëshiruar:

Vendndodhja e Qendrës është lehtësisht e aksesueshme nga fëmijët e prindërit/kujdestarët e tyre dhe mjediset e brendshme të saj janë të përshtatura për fëmijët dhe u sigurojnë atyre privatësinë e sigurinë e nevojshme.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Fëmijët dhe prindërit nuk hasin vështirësi në gjetjen e vendndodhjes së Qendrës dhe mund të shkojnë atje me transport publik apo nëpërmjet shërbimit të transportit të ofruar nga Qendra. 2. Mjediset janë të aksesueshme nga fëmijë me aftësi të kufizuara.	4.1.1 Qendra ndodhet në një zonë të njohur nga qytetarët. 4.1.2 Transporti publik është afër Qendrës. 4.2.1 Qendra është e pajisur me rampë ose platformë ngritëse në hyrje.	1. Brenda mjediseve të spitalit, Qendra lidhet me Pediatri në tabelat e qarta aksesueshmërie dhe hyrje të posaçme. Qendra ofron transport të sigurt për përfituesit e shërbimeve. 2. Mjediset e Qendrës aksesohen nga fëmijët me nevoja të veçanta apo me aftësi të kufizuara.
3. Fëmijët gjejnë në Qendër mjedise të përshtatura për ata dhe me moshën e tyre, si dhe mjedise të sigurta fizikisht.	4.3.1 Objektet në dhomën e pritjes, për shembull, lodrat, revistat, librat dhe mobilet, u përshtaten fëmijëve të të gjitha moshave, fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me aftësi të kufizuara. 4.3.2 Numri i inspektimeve të kryera për sigurinë e mjediseve.	3. Fëmija mirëpritet nga një anëtar i personelit me sjellje miqësore ndaj tij; Mjediset e Qendrës janë të sigurta fizikisht për fëmijët e të gjitha moshave dhe fazave zhvillimore. Qendra kryhen rregullisht inspektime për sigurinë e mjediseve.
4. Në Qendër janë krijuar mjedise të ndara, të izoluara nga ana akustike dhe që sigurojnë privatësinë.	4.4.1 Mjediset në Qendër që sigurojnë privatësinë.	4. Në Qendër ka dhoma të ndara pritjeje për raste kur është e nevojshme të mbrohet privatësia apo siguria e fëmijës ose nëse kërkohet nga prokurori/gjykata për ekzaminime ligjore. Dhomat kanë izolim akustik. Vendndodhja dhe shenjat orientuese nuk bien në sy.
5. Qendra, në çdo rast, kujdeset që të shmangë përballjen e të miturit viktimë me të akuzuarin, në të gjitha mjediset dhe gjatë gjithë kohës.	4.5.1 Mjediset e Qendrës ofrojnë mundësinë e shmangies së kontaktit mes viktimës dhe autorit të dyshuar të veprës penale, nëse ai hyn në të njëjtën ndërtesë.	5. Të miturit në konflikt me ligjin, autor të veprës penale ndaj fëmijës që trajtohet në Qendër, nuk mund të jenë përfitues të shërbimeve në Qendër apo të merren në pyetje në ambientet e Qendrës.

Për ofrimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët që janë viktime dhe/ose dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës duhen siguruar **mjedise fizike që karakterizohet nga një sërë tiparesh kyçe, domethënë, ato janë të aksesueshme, të sigurta, të përshtatura për fëmijët, të ndara dhe të izoluara nga ana akustike, që sigurojnë privatësinë dhe shmangin përballjen e të miturit viktimë me të akuzuarin. Mjediset e Qendrës duhet të aksesohen nga fëmijët me nevoja të**

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

veçanta apo me aftësi të kufizuara. Vendndodhja dhe krijimi i mjediseve, sipas karakteristikave të mësipërme është thelbësor për t'u siguruar të gjithë fëmijëve qasje në shërbime dhe për të garantuar privatësinë dhe sigurinë e fëmijëve. Krijimi i një mjedisi të sigurt, neutral dhe të përshtatur për fëmijën është thelbësor në uljen e ankthit dhe parandalimin e ri/traumatizimit.

Siç e theksuam, Qendra është pjesë e strukturës së spitalit rajonal. Brenda mjediseve të spitalit, Qendra lidhet me Pediatri me tabela të qarta askesueshmërie dhe hyrje të posaçme. Mjediset e Qendrës janë të përshtatura dhe miqësore për fëmijët e moshave të ndryshme. Kur është e mundur, krijohen edhe mjedise të ndara, të izoluara nga ana akustike dhe private për të siguruar privatësinë. Mjediset ofrojnë aksesueshmëri për fëmijët me nevoja të veçanta apo me aftësi të kufizuara dhe janë të sigurta fizikisht për fëmijët e të gjitha moshave dhe fazave zhvillimore. Mjediset ofrojnë mundësinë e shmangies së kontaktit mes viktimës dhe autorit të dyshuar të veprës penale. Intervistat ose marrja në pyetje e fëmijës zhvillohen në ambiente të projektuara ose përshtatura për këtë qëllim, që mundësojnë monitorimin në kohë reale të tyre. Fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve joabuzues u ofrohet nga Qendra transport i sigurt përmes një mjeti të paidentifikueshëm, me qëllim garantimin e anonimitetit dhe ruajtjen e privatësisë.

STANDARDI 5

Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesjes/ndihmës

Rezultati i dëshiruar

Nevojat e nevojat e përfitueses/it, viktimë/e mbijetuar e sulmit seksual, të vlerësuara plotësisht dhe në mënyrë të efektshme, sipas moshës, gjinisë dhe specifikimeve të tjera, si dhe plani individual i përkujdesjes/ndihmës i hartuar në bazë të tyre, të vlerësuara plotësisht dhe në mënyrë të efektshme, sipas moshës, gjinisë dhe specifikimeve të tjera, si dhe plani individual i përkujdesjes/ndihmës i hartuar në bazë të tyre. Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës për të lehtësuar kryerjen e vlerësimit fillestar dhe të plotë të fëmijës dhe sigurojnë/koordinojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor emergjent ndaj fëmijës, si dhe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor të parashikuar në PIM.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës për të lehtësuar kryerjen e vlerësimit fillestar të fëmijës dhe sigurojnë/koordinojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor emergjent. 2. Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës për të lehtësuar kryerjen e vlerësimit të plotë të fëmijës dhe sigurojnë/koordinojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor të parashikuar në PIM.	5.1.1 Numri i rasteve kur punonjësit e Qendrës kanë lehtësuar mbledhjen e informacionit të nevojshëm, në kuadër të vlerësimit fillestar të fëmijës. 5.1.2 Numri i rasteve, kur shërbimet e kujdesit shëndetësor emergjent janë ofruar nga Qendra në bashkëpunim me strukturat e spitalit. 5.1.3 Numri i rasteve, kur ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor emergjent nga struktura/institucione jashtë spitalit është koordinuar nga punonjësit e Qendrës. 5.1.4 Qendra ka në strukturën e saj një punonjës që lehtëson koordinimin ndërinstitutional (koordinatori). 5.2.1 Numri i rasteve, kur punonjësit e Qendrës kanë lehtësuar mbledhjen e informacionit të nevojshëm, në kuadër të vlerësimit të plotë të fëmijës. 5.2.2 Punonjësit e Qendrës marrin pjesë rregullisht në takimet e GTN-së, kur i kërkohet. 5.2.3 Numri i rasteve, kur shërbimet e kujdesit shëndetësor, afatshkurtër ose afatgjatë, sipas parashikimeve të PIM-së janë ofruar nga Qendra në bashkëpunim me strukturat e spitalit. 5.2.4 Punonjësit e Qendrës janë të informuar dhe trajnuar për procedurat e menaxhimit civil dhe penal të fëmijës	1. Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës për kryerjen e vlerësimit fillestar dhe të plotë të fëmijës, duke ofruar të gjithë informacionin që disponojnë, mjedise të përshtatshme për kryerjen e intervistimit të fëmijës, si dhe lehtësojnë mbledhjen e informacionit të nevojshëm. 2. Kur nga vlerësimi fillestar i fëmijës identifikohet nevoja emergjente për t'i siguruar fëmijës shërbime mjekësore, punonjësit e Qendrës vlerësojnë, rast pas rasti, nëse shërbimet emergjente do t'i ofrohen fëmijës nga Qendra në bashkëpunim me strukturat e spitalit apo fëmija do të duhet të zhvendoset në një institucionin të specializuar. Kur nga vlerësimi i plotë i fëmijës dhe në PIM identifikohet nevoja për përkujdes shëndetësor, afatshkurtër ose afatgjatë, dhe parashikohet që këto shërbime apo një pjesë e tyre të ofrohen nga Qendra atëherë, ajo do të ofrojë këto shërbime vetë ose në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	viktimë apo dëshmitarë.	
--	-------------------------	--

Qendra pranon 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, referimet me vetiniciativë të fëmijës dhe/ose të prindërve/kujdestarit të fëmijës, si dhe referimet nga çdo person fizik apo juridik, si dhe nga çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, për shkak të profesionit apo të cilit i është raportuar rasti. Menjëherë sapo merret referimi i një rasti, informacioni fillestar për referimin dokumentohet në një regjistër të veçantë. Në të njëjtën mënyrë, sapo fëmija paraqitet në mjediset e Qendrës, ai regjistrohet, i hapet një dosje e veçantë dhe i caktohet një numër identifikues i fëmijës gjatë gjithë procesit të trajtimit të tij në Qendër.

Punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës për kryerjen e vlerësimit fillestar të fëmijës, duke ofruar të gjithë informacionin që disponojnë dhe mjedise të përshtatshme për kryerjen e intervistimit fillestar të fëmijës. **Koordinatori i Qendrës** mbështet punonjësin për mbrojtjen e fëmijës menaxher të rastit (në vijim “PMF”) dhe lehtëson mbledhjen e informacionit të nevojshëm nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën. Qendra i ofron fëmijës nevojat imediate për ushqim, higjienë, veshje dhe kujdesin shëndetësor e psikologjik të nevojshëm, në bashkëpunim me PMF-në dhe strukturat e tjera të specializuara mjekësore të spitalit. **Asistenti i Fëmijës i Qendrës** mbështet PMF-në, koordinon veprimet ose referon rastin në institucionet përgjegjëse, kur nga vlerësimi fillestar i fëmijës identifikohet nevoja emergjente për t’i siguruar fëmijës shërbimet e domosdoshme që nuk ofrohen në Qendër dhe/ose për t’i siguruar atij mbrojtjen fizike dhe/ose për zbatimin e një mase emergjente të mbrojtjes. Punonjësi social dhe PMF-ja vlerësojnë, rast pas rasti, nëse shërbimet emergjente të nevojshme, do t’i ofrohen fëmijës në mjediset e Qendrës nga punonjës të specializuar, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional apo fëmija do të duhet të zhvendoset në institucionin e specializuar. Gjithashtu, asistenti i fëmijës mbështet PMF-në për zbatimin e masës emergjente të mbrojtjes dhe vendosjen e përkohshme të fëmijës pranë një të afërmi të fëmijës, në familje kujdestare apo në një strehë.

Edhe gjatë vlerësimit të plotë të fëmijës, punonjësit e Qendrës bashkëpunojnë me strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës, duke ofruar të gjithë informacionin që disponojnë, mjedise të përshtatshme për kryerjen e intervistimit me fëmijën, motrat/vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, vizita të përbashkëta me PMF-në në mjedisin ku jeton fëmija dhe bashkëpunim në vlerësimin e nivelit të rrezikut, nevojave për shërbime, identifikimin dhe caktimin e ndërhyrjeve të nevojshme. Koordinatori mbështet PMF-në dhe lehtëson mbledhjen e informacionit të nevojshëm nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën. Asistenti i fëmijës merr pjesë në takimet e GTN-së të thirrura nga strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës dhe me kërkesë të këtyre strukturave. Gjithashtu, punonjësit e Qendrës mund të mbështesin dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijës në mbledhjet e GTN dhe marrjen e mendimit të tij, nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve logjistike apo të mbështetjes institucionale, për rastet kur fëmija e ka të pamundur të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Në këto raste, Qendra ose ofron mjetet logjistike të nevojshme që sigurojnë lidhjen *online* të fëmijës me GTN-në nga mjediset e Qendrës ose vendos në dispozicion të GTN-së mjediset e nevojshme për zhvillimin e mbledhjes (sallë takimesh/mbledhjeje). Asistenti i fëmijës pjesëmarrës në takimet e GTN shqyrton projektin e PIM-së dhe bën rekomandimet përkatëse për ndërhyrjet apo shërbimet e nevojshme për rastin, duke marrë përsipër detyra dhe shërbime që do t’i ofrohen fëmijës, si dhe afatet përkatëse.

Referimi, trajtimi i rastit në Qendër, si dhe komunikimet apo procesverbalet e takimeve me institucionet apo strukturat e tjera dokumentohen në regjistra të veçantë dhe administrohen sipas rregullave të spitalit. Punonjësit apo profesionistët që vijnë të ofrojnë shërbime në Qendër, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, respektojnë rregullat e administrimit të dokumentacionit të Qendrës.

STANDARDI 6

Ofrimi i shërbimeve terapeutike të personalizuara për fëmijën nga profesionistë me formim dhe ekspertizë të specializuar.

Rezultati i dëshiruar

Çdo fëmijë që vetëreferohet apo është referuar në Qendër merr mbështetje të shëndetit mendor në formën e ndërhyrjes për krizën dhe i nënshtrohet vlerësimit të shëndetit mendor që përbën bazën për trajtimin e përshtatshëm që i ofrohet fëmijës pa vonesa të panevojshme.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Qendra në bashkëpunim me	6.1.1 Qendra ka në strukturën e tij psikolog/terapist fëmijësh.	Vlerësimet e shëndetit mendor në Qendër duhet të jenë të strukturuar dhe

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

strukturat e tjera të spitalit ofron mbështetje dhe vlerësime të shëndetit mendor të fëmijës nga personel i specializuar.	6.1.2 Qendra ka një punonjës të përhershëm e të përgatitur për mbështetjen në rast krize për të gjithë fëmijët dhe prindërit/kujdestarët joabuzues që kanë nevojë. 6.1.3 Psikiatri i kontaktuar nga Qendra: - ka marrë formim të specializuar për vlerësimin dhe trajtimin e fëmijëve, viktimë dhe dëshmitarë të dhunës; - kryen vlerësimin e shëndetit mendor të fëmijës që përbën bazën për trajtimin e përshtatshëm që i ofrohet fëmijës; - bashkëpunon në përcaktimin e shkallës së përgjegjshmërisë së fëmijës kur kërkohet nga prokurori ose Gjykata. 6.1.4 Trajtimi u përshtatet karakteristikave individuale të fëmijës, si: mosha, zhvillimi, niveli gjuhësor, social e kulturor, gjendja emocionale, si dhe nevojave të veçanta të fëmijës. 6.1.5 Fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve joabuzues u ofrohet rregullisht informacion për trajtimet e disponueshme për ta.	të kryhen bazuar në formate të miratuara. Vlerësimi i shëndetit mendor përbën bazën për trajtimin e përshtatshëm terapeutik që do t'i ofrohet fëmijës në funksion të traumës.
---	--	--

Sapo fëmija mbërrin në Qendër, ai merr mbështetje të shëndetit mendor në formën e ndërhyrjes për krizën, që ofrohet nga një psikolog i spitalit, sipas nevojave të rastit. **Prindërit/kujdestarët joabuzues të fëmijës janë, gjithashtu, përfitues të shërbimeve në Qendër, duke iu ofruar atyre informacion të vazhdueshëm, këshillim dhe mbështetje në rast krize.** Qëllimi kryesor i informimit, këshillimit dhe mbështetjes në raste krize, për prindërit/kujdestarët joabuzues, është që t'i mundësojë atyre që t'i ofrojnë fëmijës mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme gjatë rehabilitimit të fëmijës dhe gjatë procesit penal.

Asistenti i fëmijës bashkëpunon me strukturat e tjera të spitalit për caktimin e një psikiatri i cili kryen **vlerësimin e shëndetit mendor të fëmijës.** Momenti përcaktohet mbi bazën e karakteristikave dhe situatës së fëmijës. Vlerësimi i shëndetit mendor përbën bazën për trajtimin e përshtatshëm që i ofrohet fëmijës pa vonesa të panevojshme. Nëse prokurori ose gjykata nuk kanë caktuar një psikolog për të vlerësuar nivelin e përgjegjshmërisë së fëmijës atëherë, psikologu i Qendrës në vlerësimin e tij përcakton edhe shkallën e përgjegjshmërisë së fëmijës dhe ia njofton prokurorit ose gjykatës.

Kur nga vlerësimi i plotë i fëmijës dhe në PIM identifikohet nevoja për përkujdes shëndetësor, afatshkurtër ose afatgjatë, përfshirë ndërhyrje për traumat, këshillim dhe terapi, dhe parashikohet që këto shërbime apo një pjesë e tyre të ofrohen nga Qendra, atëherë ajo do të ofrojë këto shërbime vetë ose në bashkëpunim me strukturat e tjera të specializuara të spitalit.

STANDARDI 7

Ofrimi i shërbimeve cilësore nga personel i specializuar

Rezultati i dëshiruar

Punonjësit e Qendrës duhet të kenë kompetencat e nevojshme profesionale për përmbushjen e detyrave të tyre në mënyrë efektive, të specializuar, bazuar në evidenca dhe me në qendër fëmijën.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Punonjësit e Qendrës duhet të kenë: - kompetencat e nevojshme profesionale për përmbushjen e detyrave të tyre në mënyrë efektive dhe të specializuar; - një kuptim të thellë të të gjitha	7.1.1 Punonjësit disponojnë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme, sipas përshkrimit të punës. 7.1.2 Ekziston një plan i qartë për zhvillimin e aftësive dhe edukimin e vazhdueshëm të punonjësve të Qendrës.	Punonjësit e Qendrës duhet të kenë një kuptim të thellë të të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe të disponojnë kompetencë dhe përvojë klinike në fushën e traumës, përfshirë ekspertizën për të trajtuar nevoja

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

formave të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe të disponojnë kompetencë dhe përvojë klinike në fushën e traumës, përfshirë ekspertizën për të trajtuar nevoja të veçanta të fëmijëve më aftësi të kufizuara; - një kuptim të zhvilluar të sistemit në të cilin Qendra funksionon, kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë aspektet mjekësore, socioekonomike dhe rolin e Qendrës për të promovuar një qasje shumësektoriale dhe të koordinuar në kontekstin e rehabilitimit dhe riintegrit të fëmijëve në jetën shoqërore.	7.1.3 Punonjësit e Qendrës marrin pjesë në trajnime të përbashkëta me përfaqësuesit e GTN-së rreth çështjeve ndërsektoriale dhe bashkëpunimit shumëdisiplinor. 7.1.4 Punonjësve të Qendrës u ofrohet këshillim individual dhe në grup për raste specifike.	të veçanta të fëmijëve më aftësi të kufizuara. Ata duhet të kenë një kuptim të zhvilluar të sistemit në të cilin Qendra funksionon, kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë aspektet mjekësore, socioekonomike dhe rolin e Qendrës për të promovuar një qasje shumësektoriale dhe të koordinuar në kontekstin e rehabilitimit dhe riintegrit të fëmijëve në jetën shoqërore.
--	---	---

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përcakton organizimin, strukturën dhe rregulloret e funksionimit të Qendrës, si pjesë e strukturës së spitalit. Qendra ka në përbërje të saj të paktën punonjësit, si më poshtë:

- a) koordinatori që do të bashkërendojë punën ndërinstitutionale dhe do të sigurojë komunikimin me institucionet e tjera mbështetëse dhe bashkëpunuese. Ai kryen funksione administrative dhe koordinuese;
- b) punonjësi social i Qendrës, i cili në bashkëpunim me punonjësën për mbrojtjen e fëmijës do të kujdeset për përmbushjen e nevojave emergjente të fëmijës dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të parashikuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

Punonjësit e Qendrës duhet të kenë kompetencat e nevojshme profesionale për përmbushjen e detyrave të tyre në mënyrë efektive, të specializuar, bazuar në evidenca dhe me në qendër fëmijën. Punonjësit e Qendrës nuk mund të punësohen dhe, kur janë të punësuar, përfundojnë marrëdhënien e punës në rast se janë dënuar me dënim të formës së prerë për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje dhe/ose ndaj tyre është marrë, me vendim gjykate, një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje. Ata (punonjësit) pezullohen nga detyra kur ndaj tyre fillon një procedim penal për vepra penale të kryera ndaj të miturve ose kur ata akuzohen për kryerjen e një veprë penale në bashkëpunim me të mitur. Koordinatorin dhe asistentin i fëmijës kujdesen, në çdo rast, që punonjësit e tjerë të spitalit dhe/ose të institucioneve që do të komunikojnë dhe/ose do të ofrojnë shërbime ndaj fëmijës të plotësojnë kriteret e parashikuara si më sipër.

Punonjësit e Qendrës duhet të kenë një kuptim të thellë të të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe të disponojnë kompetencë dhe përvojë klinike në fushën e traumës, përfshirë ekspertizën për të trajtuar nevoja të veçanta të fëmijëve më aftësi të kufizuara. Ata duhet të kenë një kuptim të zhvilluar të sistemit në të cilin Qendra funksionon, kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë aspektet mjekësore, socioekonomike dhe rolin e Qendrës për të promovuar një qasje shumësektoriale dhe të koordinuar në kontekstin e rehabilitimit dhe riintegrit të fëmijëve në jetën shoqërore. Punonjësve të Qendrës dhe të institucioneve të përfshira u ofrohet trajnim i vazhdueshëm në fushat e tyre specifike të ekspertizës, si dhe trajnim i përbashkët për çështjet ndërsektoriale dhe bashkëpunimin ndërinstitutional.

STANDARDI 8

Mbledhja e të dhënave, shpërndarja e informacionit dhe rritja e ndërgjegjësimit me qëllim parandalimin e rasteve të abuzimit seksual dhe dhunës te fëmijët

Rezultati i dëshiruar

Qendra mbledh të dhëna, përpunon informacion statistikor dhe merr pjesë në aktivitete të natyrës informuese dhe ndërgjegjësuere me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit rreth abuzimit seksual dhe dhunës ndaj fëmijëve dhe rolit të përgjigjeve shumësektoriale dhe ndërinstitutionale.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Qendra mbledh dhe përpunon të dhëna/statistika dhe i ndan ato me aktorët e interesuar për të rritur ndërgjegjësimin rreth abuzimit	8.1.1 Është hartuar dhe miratuar formati për të mbledhur të dhëna dhe përdoret sistematikisht për të mbledhur të dhënat e shpërndara.	Të dhënat e mbledhura duhet të diskutohen gjerësisht me institucionet, shoqërinë civile, median etj., me qëllim rritjen e

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

seksual dhe dhunës ndaj fëmijëve dhe rolin e përgjigjeve shumësektoriale dhe ndërinstytucionale.	8.1.2 Ekzistojnë dhe zbatohen në mënyrë të qëndrueshme udhëzimet për përfshirjen e përshtatshme, të duhur dhe etike të Qendrës në rritjen e ndërgjegjësimit, në ngritjen e kompetencave dhe të kontributeve në fushata, studime, kërkime dhe konsultime.	ndërgjegjësimit rreth abuzimit seksual dhe dhunës ndaj fëmijëve, përmirësimin e politikave, legjislacionit dhe praktikave dhe forcimin e veprimeve dhe ndërhyrjeve ndërinstytucionale. Të dhënat lidhur me fëmijën janë konfidenciale dhe ndalohet identifikimi ose publikimi në çfarëdolloj forme i të dhënave personale të fëmijës.
--	--	---

Qendra mbledh të dhëna, përpunon informacion statistikor dhe merr pjesë në aktivitete të natyrës informuese dhe ndërgjegjëse, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit rreth abuzimit seksual dhe dhunës ndaj fëmijëve dhe rolit të përgjigjeve shumësektoriale dhe ndërinstytucionale. Të dhëna/statistika mbledhen, përpunohen dhe ndahen me palët e interesuara, me vendimmarrësit, specialistët e mbrojtjes së fëmijëve dhe publikun e gjerë për të rritur ndërgjegjësimin rreth abuzimit seksual dhe dhunës ndaj fëmijëve dhe rolin e përgjigjeve shumësektoriale dhe ndërinstytucionale.

Të dhënat lidhur me fëmijën që trajtohet me shërbime pranë Qendrës janë konfidenciale dhe çdo profesionist apo punonjës që ka të dhëna lidhur me fëmijën është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë, për shkak të detyrës ose/dhe gjatë kryerjes së detyrës. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës. Gjithashtu, ndalohet identifikimi ose publikimi në çfarëdolloj forme i të dhënave personale të fëmijës, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Përpunimi i të dhënave të fëmijës realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

STANDARDI 9

Monitorimi dhe vlerësimi

Rezultati i dëshiruar

Qendra ofron shërbime cilësore për fëmijët, edhe përmes procesit të monitorimit dhe vlerësimit.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
1. Spitali kryen çdo fund viti monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në Qendër, duke mbajtur në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimeve që duhen përmbushur.	9.1.1 Personat përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin janë të identifikuar në organigramën e spitalit dhe përshkrimet e punës. 9.1.2 Formulari i monitorimit dhe i vlerësimit të cilësisë i hartuar dhe i miratuar; 9.1.3 Pyetësori që mat nivelin e kënaqshmërisë së përfituesve të shërbimeve në Qendër i hartuar dhe i miratuar. 9.1.4 Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të hartuara.	Monitorimi dhe vlerësimi i brendshëm i cilësisë së ofrimit të shërbimeve në Qendër bëhet duke mbajtur në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimeve, rezultatin dhe performancës e arritur, llojin e shërbimeve të ofruara, numrin e përfituesve dhe nivelit e kënaqshmërisë së tyre, si dhe vlerëson nevojat për ndryshime dhe/ose përmirësime.

Spitali kryen çdo fund viti monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në Qendër (sipas standardeve dhe parashikimeve të këtij udhëzimi), të rezultatit, të performancës dhe llojit të shërbimeve të ofruara, numrit të përfituesve dhe nivelit të kënaqshmërisë së tyre, si dhe vlerëson nevojat për ndryshime dhe/ose përmirësime. Vlerësimi i kryer i përcillet Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror deri më datë 31 janar të vitit pasardhës. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë dhe Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror pasi shqyrton materialin, i përcjell spitalit rekomandimet lidhur me masat që vlerëson se duhen marrë duke ofruar, kur është e mundur, edhe zgjidhjet për përmbushjen e tyre.

Vlerësimi dhe monitorimi i shërbimit të **Qendrës** mund të jetë detyrim i SHSS-së/shërbimit mjekësor etj.

Në çdo rast, vlerësimi dhe monitorimi mund të përdoren për të përcaktuar:

Sa mirë po ofrohen shërbimet, duke anketuar ata që përdorin Qendrën (p.sh. duke përdorur anketat për kënaqësinë e përfituesve).

Rezultatit, performancën dhe llojin e shërbimeve të ofruara (p.sh. numri i përfituesve në një muaj).

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

STANDARDI 10

Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesit/es, shmangia e abuzimit dhe procesi i ankimit

“Qendra” ofron shërbimet për fëmijët viktime dhe dëshmitarë të formave më të rënda të dhunës, përfshirë abuzimin seksual me respekt, pa diskriminim dhe në përputhje me parashikimet ligjore vendëse dhe parimet universale të të drejtave të njeriut dhe fëmijës.

Rezultati i dëshiruar: Përfituesi/it e shërbimit të Qendrës gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj, trajtohet me dinjitet e respekt, si dhe mbrohet nga të gjitha format e abuzimit dhe diskriminimit gjatë kohës së qëndrimit në qendër.

Përfituesi/it mbrohet nga abuzimi: fizik, financiar, material, psikologjik, seksual, neglizhenca, diskriminimi dhe dëmtimi i vetvetes. Ekziston një procedurë ankesash e thjeshtë, e qartë dhe transparente, e cila zbatohet në praktikë.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
1. Informimi i përfituesit/es me të drejtat dhe përgjegjësitë gjatë kohës së qëndrimit në Qendër. 2. Ka një procedurë ankimi të thjeshtë e të qartë, që është e hapur për të gjithë përfituesit dhe familjarët e tyre. Procedura përmban afatet e përgjigjes dhe organet/personat që trajtojnë ankesën 3. Ekipi i Qendrës tregon respekt për dinjitetin e tyre në mënyrën se si sillen me ta dhe si i trajtojnë në të gjitha bashkëveprimet. 4. Përfituesi/ja mbrohet nga keqtrajtimi dhe abuzimi fizik, emocional 5. Përfituesi/ja trajtohet me dinjitet, pa diferencime, si pjesëmarrës/e në program. 6. Kriteret e së drejtës për të përfituar shërbime të specializuara janë të formuluar qartë. Të gjithë personat e interesuar për shërbimin marrin informacion për kriteret e përfitimit të shërbimeve.	10.1.1 Broshurë/fletëpalosje/dokument i afishuar që përfshin të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në Qendër, përfshirë të drejtën e përfitimit të shërbimeve pa diskriminim, i përshtatur në një gjuhë miqësore për fëmijët dhe i kuptueshëm dhe i lexueshëm për ta, që përfshin fëmijët me aftësi ndryshe (gjuhën <i>Braille</i>). 10.2.1 Procedurë ankimi me shkrim, që bën lidhjen me një sistem të jashtëm nëse ankesën nuk e zgjidh Qendra, e shpallur dhe e njohur nga të gjithë/a përfituesit/et dhe stafi. 10.2.2 Procedura të qarta ankimi, në rast abuzimi nga stafi ndaj përfituesit/et. 10.3.1 Ekipi i Qendrës trajton me konfidencialitet, informacionin që ka për përfituesin/it dhe familjarët e tyre. 10.4.1 Rregullorja e brendshme e Qendrës ka një pjesë për procedurën e ankimit që përmban kushtet e konfidencialitetit, afatet e përgjigjes dhe organet/personat që trajtojnë ankesën. Të gjitha ankesat e marra me gojë apo shkrim dhe përgjigjet e dhëna mbahen në një dosje të veçantë. 10.5.1 Përfituesit kanë marrë shpjegime se si të përdorin procedurat e ankimeve dhe janë të qartë për të. 10.6.1 Personeli trajnohet për bashkëveprimin me përfituesin/it që ka/në ankesa.	- Është mirë të mbahet një bazë të dhënash më vete për të gjitha ankesat e depozituara dhe për zgjidhjen që u është dhënë. - Pjesëmarrja e përfituesve/eve është thelbësore për të shkuar drejt vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

Koha e qëndrimit në Qendër është e kufizuar. Ajo është 24 orë. Largimi i përfituesit/es nga Qendra ju bëhet e ditur anëtarëve të GTN-së në nivel vendor, me qëllim që rasti të monitorohet.

Shërbimet për fëmijët në Qendër sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuara, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër. Është e nevojshme që stafi që punon me këtë kategori sociale të ketë njohuri të mjaftueshme të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe përfituesit/et të marrin njohuri mbi të drejtat që u burojnë nga legjislacioni.

Shërbimet në Qendër ofrohen falas. Qendra duhet të jetë e aksesueshme për të gjithë fëmijët dhe familjarët joabuzues pavarësisht përkatësisë etnike, nevojave të veçanta apo statusit dhe nevojave sociale.

Në të gjitha rastet duhet të merret në konsideratë edhe fakti që fëmijët dhe familjarët joabuzues, në varësi të situatës, mund të mos kenë me vete mjet identifikimi.

Bashkëpunimi i Qendrës me NJMF-në/PMF-në, e cila koordinon GTN-në në bashkinë përkatëse bën të mundur plotësimin e dokumentacionit përkatës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Qendra duhet të mbajë parasysh se në situata të veçanta mund t'i nevojitet edhe një përkthyes, kur fëmija është me nënshtetësi të huaj dhe ndodhet në Shqipëri si vizitor, azil kërkues apo për çdo arsye tjetër.

Lista e personave *on call* duhet të ketë edhe disa përkthyes profesionistë.

Me qëllim aksesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Qendra duhet të ketë në listën e saj të profesionistëve edhe specialistë të gjuhës së shenjave për personat që kanë nevojë për këtë lloj shërbimi.

Kur provohet se fëmija viktimë apo dëshmitar i dhunës seksuale apo i formave të rënda të dhunës ose familjarët joabuzues kujdestarë ligjorë kanë probleme të rënda të shëndetit mendor, bashkëpunohet me shërbimet e specializuara në nivel vendor apo kombëtar dhe PMF-në/NJMF-në për të përcaktuar masat dhe planin e mbrojtjes.

ANEKSI 1 DEKLARATË KOFIDENCIALITETI

Si e ruajmë informacionin tuaj privat

Marrëveshja për aksesin në shërbimet e Qendrës

Shërbimi

☐ Staf i në qendër do t'ju ndihmojë, mbështesë dhe këshillojë për të minimizuar efektet dhe mbrojtur nga abuzimi që keni përjetuar. Ata janë punonjës socialë, psikologë dhe mjekë të qendrës.

☐ Qendra ofron shërbime të kujdesit mjekësor, social dhe mbështetjen psikologjike për menaxhimin e krizës sikurse dhe bashkëpunon me shërbimet e mbrojtjes.

☐ Qëllimi i Qendrës është të sigurojë një vend të sigurt, të mbrojtur, mbështetje dhe terapi në kohën e duhur.

Marrëveshja për shërbimin

Stafi do të punojë me ju vetëm me marrëveshjen tuaj dhe me mirëkuptimin tuaj se çfarë informacioni do të regjistrojmë për ju dhe si do ta mbajmë këtë të sigurt. Punonjësi do t'ju shpjegojë procesin dhe ky formular përshkruan se si do ta bëjmë këtë dhe kërkon miratimin tuaj për të vazhduar me punën.

Konfidencialiteti

Çdo informacion që ndani me qendrën do të mbahet konfidencial, por mund të na duhet të ndajmë disa nga informacionet tuaja me institucione të tjera, siç janë policia dhe punonjësi/njësia për mbrojtjen e fëmijës.

Ne kemi një detyrim ligjor për t'i mbajtur fëmijët dhe të rinjtë të sigurt. Kjo do të thotë që nëse na tregoni ndonjë gjë për veten ose një person tjetër, të lënduar ose në rrezik, mund të na duhet t'i tregojmë dikujt që mund të ndihmojë (si për shembull, punonjësit për mbrojtjen e fëmijës).

Ne kemi, gjithashtu, një detyrë ligjore të ndajmë informacione nëse gjykata na urdhëron.

Ndërsa ne po ju mbështesim, do t'u bëjmë të ditur agjencive rezultatin e punës sonë dhe t'ju dërgojmë një kopje por gjithmonë do t'ju njoftojmë fillimisht, përveç nëse mendojmë se nuk është e sigurt ta bëjmë këtë.

Trajtim i drejtë

Qendra gjithmonë synon t'i trajtojë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë si një individ, në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Nëse në çdo moment mendoni se kjo nuk po ndodh, ju lutemi flisni me çdo anëtar të stafit me të cilin ndiheni rehat për këtë ose me njësinë për mbrojtjen e fëmijës.

Nëse ndiheni të pasigurt për ta bërë këtë ose jeni ende të pakënaqur, mund të përdorni procedurën e ankesave.

Në qendër ka një kuti ku ju mund të depozitoni ankesën tuaj.

Mbajtja e shënimeve

Stafi i Qendrës do të mbajë shënime për punën që bën me ju ose fëmijën tuaj dhe do t'i mbajmë ato në një dosje elektronike të sigurt. Shembuj se çfarë shënimesh dhe informacioni mbledhim janë:

- Takimi fillestar;

- Seancat e këshillimit të krizës, vëzhgime dhe telefonata nëse bëhen me ju ose kujdestarët apo çdo person që ka informacion apo kërkon informacion për fëmijën;

- Takime ku mund të diskutojmë rastin tuaj.

Stafi do të diskutojë nevojat tuaja që nga momenti kur referoheni për herë të parë dhe në takimet e

Përmbledhje legjislativi për të miturit

skuadrës, për t'u siguruar që po merrni ndihmën më të mirë. Diskutimet do të shënohen, gjithashtu, në dosjen individuale dhe ju ose kujdestari ligjor keni të drejtë të aksesoni dosjen tuaj në çdo kohë.

Shënimet individuale do të shihen vetëm nga stafi që punon drejtpërdrejt me fëmijën.

Ne i mbajmë të dhënat e fëmijës deri kur ai mbush 18 vjeç.

Miratimi

Unë jap miratimin tim për të marrë shërbimet e Qendrës dhe e kuptoj se çfarë informacioni do të mbajë Qendra për mua dhe si do të mbrohet. Unë e kuptoj që informacioni do të mbahet konfidencial, por se disa informacione rreth meje/fëmijës tim mund të duhet të ndahen me institucione të tjera, kur është e nevojshme për të parandaluar që dikush të dëmtohet.

E kuptoj që Qendra duhet të flasë me profesionistë të tjerë për situatën time ose të fëmijës tim dhe i jap leje punonjësit të Qendrës ta ndajë këtë informacion me institucionet e mëposhtme:

- ☐ Punonjësi/njësia për mbrojtjen e fëmijës
- ☐ Mjeku
- ☐ Oficeri i policisë
- ☐ Tjetër (ju lutem specifikojeni) _____

Firmosurfëmija mbi 14 vjeç.

Datë.....

Firmosur Kujdestari (sipas rastit) ose shoqëruesi i fëmijës.

Datë.....

PËR STAFIN E QENDRËS

- ☐ Unë ia kam lexuar dhe shpjeguar fëmijës dhe kujdestarit ligjor këtë formular

Firmosur Datë

ANEKSI 2 FLETA E DITARIT

Ky formular duhet të përdoret për të regjistruar të gjitha veprimet dhe kontaktet që bëhen në lidhje me një rast dhe mbahet në dosjen e fëmijës.

Kur përdoret një bllok shënimesh, informacioni nga blloku rekomandohet të hidhen në këtë formular. Çdo fletë ditari ruhet me kod në kompjuter dhe çdo fletë e shënimeve e printuar apo me shënim dore ruhen në një raft me çelës.

--	--	--

Aneksi 3

FORMULAR PËR VLERËSIM FILLESTAR TË NEVOJAVE

Ky formular mbahet në dosjen e fëmijës. Plotësohet ngapunojnësi social, pranë Qendrës me informacion që merret përmes: telefonit apo rasti është paraqitur pranë Qendrës dhe ka nevojë të mbështetjen përmes shërbimeve që ofrohen në qendër.

Ora dhe data e referimit _____

Ora dhe data e mbëritjes në qendër _____

TË DHËNA PERSONALE

Emri _____

Mbiemri _____

Atësia _____

Gjinia Mashkull ☐ Femër ☐

Ditëlindja _____

Vendlindja _____

Arsimi _____

TË DHËNA TË PERSONIT SHOQËRUES

Emri _____

Mbiemri _____

Atësia _____

Gjinia Mashkull ☐ Femër ☐

Ditëlindja _____

Vendlindja _____

Arsimi _____

Konakt: _____

HERA E PARE QE MERR SHERBIME NE QENDER? PO ☐ JO ☐

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

SHENDETI

Gjendje shëndetësore /aftësi të kufizuara që vazhdojnë:

LLOJI I SEMUNDJES	Prej sa kohë	Shkalla e sëmundjes
Reaksione alergjike		
Anemi		
Azmë		
Hipertension		
Paralizë cerebrale		
Artrid reumatoid		
Diabet		
Vartësi nga droga / alkooli		
Sëmundje mendore		
Epilepsi		
Alergji		
Dëmtim të dëgjimit		
Hepatit		
Kequshqyerje		
Aftësi të kufizuara fizike ose probleme me lëvizshmërinë		
Sëmundje të aparatit gastrointestinal		
Aftësi të kufizuara ndijimore / të të folurit		
Dëmtim të shikimit		

A ka gjendje të tjera që kërkojnë trajtime jashtëambulatore ose shtrim në spital?

Po

Jo

Specifiko _____

VLERËSIMI NGA PERSONI Q T Ë KRYEN AKIMIN

A. Vlerësim i përgjithshëm i paraqitjes fizike të personit që intervistohet (veshje, këpucë ..)

1. Në gjendje shumë të keqe

2. Në gjendje të keqe

3. Në gjendje mesatare

Shënime:

B. Çfarë karakteristika shihni ju në vlerësimin e situatës psikologjike për këtë fëmijë?

C. Çfarë karakteristika shihni ju në vlerësimin e situatës psikologjike për shoqëruar:

Punonjësi që ka plotësuar formularin

Personi i intervistuar

Data e intervistës.

Shpjegim/shënim: (Pasi është mbledhur info i parë, punonjësit diskutojnë për hapat e mëtejshëm në varësi të situatës së gjetur. Më pas, ia komunikojnë/ informojnë/ shpjegojnë/ sqarojnë fëmijës dhe prindit/kujdestarit se çfarë mund të bëhet për të ndihmuar në atë moment fëmijën dhe prindin/kujdestarin).

Përcakto Nivelin e Rrezikut për sigurinë dhe mirëqënien e fëmijës _____
Përcakto Nivelin e Rrezikut për sigurinë dhe mirëqënien e familjes _____
(referoju indikatorëve dhe faktorëve të rrezikut për fëmijën & familjen)

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Aneksi 4	FORMAT ANKESE
Të dhënat e personit që ngre ankesën:	
Plotësimi I të dhënave nuk është i detyrueshëm. Dhënia e emrit na e bën më të lehtë kthimin e përgjigjes për ankesën e ngritur, por ju mund të ankoheni edhe në anonim.	
Emër Mbiemër:	
Mosha:	
Gjinia:	
Përfitues i Qendrës: PO/JO	
Adresa:	
Kontakt:	
Cila është ankesa që keni dhe doni të adresoni?	
Data e marrjes në dorëzim të ankesës:	
Vendi:	
Personi që mori në dorëzim ankesën: Emër Mbiemër / Pozicioni _____	
Nënshkrimi:	
Personi që dorëzoi Ankesën:	
Nënshkrimi	

Aneksi 5

FLETË- VËZHGIMI

1. TË DHËNA TË PËRGJITHËSHME

Emri/ Mbiemri i Fëmijës _____ Data e vëzhgimit _____

2. Lloji i aktivitetit specifik: (lojë e lirë, aktivitet psikosocial/ këshillim/, të tjera)

3. Qëllimi i vëzhgimit:

4. Mënyra e vëzhgimit (bashkëbisedim, vëzhgim me sy të lirë, të tjera _____)

5. Qëndrimi i fëmijës së vlerësuar:

6. Marrëdhënia prind-fëmijë

7. Koment/ rekomandime në fund të vëzhgimit:

Përgatiti _____

Aneksi 6

FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJEN		
Emri /identiteti i fëmijës:	Data e lindjes:	Gjinia
Emri dhe adresa e prindit/e kujdestarit:		Vendndodhja e fëmijës/adresa ku po qëndron fëmija:
Shenjat e abuzimit/neglizhimit/dhunës së mundshme		Lloji i abuzimit i dyshuar/konstatuar: ☐ dhunë fizike ☐ dhunë seksuale ☐ dhunë psikologjike ☐ shfrytëzim ekonomik ☐ trafikim ☐ fëmijën në situatë rruge ☐ neglizhim

Të dhëna të tjera mbi situatën e fëmijës dhe familjes:

Arsyet për raportim: Shqetësimi për mbrojtjen e fëmijës:

Emri dhe detajet e kontaktit të personit që ka bërë identifikimin:	Emri dhe detajet e kontaktit të personit që bën raportimin:	
Firma	Emri dhe kontaktet e personit/institucionit, të cilit i dërgohet formulari:	Formulari është dërguar:

Aneksi 7

KËSHILLIM INDIVIDUAL (konfidenciale)

Data e Këshillimit: _____
 Qëllimi i këshillimit: _____

Emri Mbiemri _____
 Mosha: _____
 Cështjet kryesore të diskutuara gjatë këshillimit:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ANEKSI 8 KODI I SJELLJES

Kodi i Sjelljes duhet të nënshkruhet nga i gjithë stafi dhe vullnetarët para fillimit të kryerjes së detyrave.

Fëmijët mund të rrezikohen nga lëndimet apo abuzimet nga burime të ndryshme brenda Qendrës, si rezultat i veprimeve të tjerëve.

Të gjithë të rriturit (stafi) i Qendrës kanë për detyrë të ulin rrezikun që u kanoset fëmijëve dhe të raportojnë shqetësimet lidhur me sigurinë, mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve te njësia/punonjësi i/e mbrojtjes së fëmijës.

Në mënyrë më specifike, të rriturit duhet të:

- Sigurohen që të gjithë fëmijët të ndihen të vlerësuar dhe të përfshirë, duke mos treguar shenja diskriminimi apo favorizimi;
- Nxisin fëmijët të marrin pjesë plotësisht dhe po ashtu të respektojnë aftësitë dhe preferencat e ndryshme që ata kanë;
- Vlerësojnë mendimet dhe idetë e fëmijëve;
- Ndihmojnë fëmijët të marrin pjesë, brenda normave të sigurisë, duke u rikujtuar atyre kodet e sjelljes;
- Ballafaqojnë të rriturit e tjerë që dyshojnë se mund të jenë abuzivë ose të papërshtatshëm;
- Referojnë dhe raportojnë çdo shqetësim te PMF-ja/NJMF-ja.

Në mënyrë më specifike, të rriturit nuk duhet të:

- Kalojnë shumë kohë vetëm me fëmijën, të distancuar nga të tjerët.
- Godasin apo të abuzojnë fizikisht me fëmijët, qoftë edhe si formë disipline.
- Kenë sjellje që poshtërojnë, nënvlerësojnë, turpërojnë dhe degradojnë fëmijët.
- Kenë marrëdhënie fizike/seksuale me fëmijët apo marrëdhënie që mund të interpretohen si abuzive apo shfrytëzuese ndaj fëmijëve.
- Përdorin gjuhë ose veprime, të japin këshilla ose sugjerime të papërshtatshme, ofenduese, abuzive ose shfrytëzuese.
- Lejojnë që një fëmijë dhe/ose adoleshent ta kalojë natën në dhomën e njërit prej të rriturve (vetëm në rast se kjo është pranuar paraprakisht nga prindi/kujdestari i fëmijës dhe/ose adoleshenti) ose të flenë në të njëjtin shtrat me fëmijët që përdorin shërbimet e Qendrës.
- Ftojnë fëmijët dhe familjet te shtëpitë e tyre.
- Lejojnë fëmijët të largohen me të rritur të tjerë, përfshirë familjarë, përveç rasteve kur jepet miratimi nga prindërit/kujdestarët.
- Tolerojnë ose të marrin pjesë në ato sjellje të fëmijëve që janë të jashtëligjshme, të pasigurta ose abuzive, përfshirë talljen e fëmijëve të tjerë.
- Vijnë në gjendje të dehur ose të paaftë për punë në qendër.
- Bëjnë foto ose përfaqësime të tjera mediatike (p.sh., video) të fëmijëve ose përdoruesve të shërbimeve pa lejen e tyre.
- Ngarkojnë ose ndajnë detaje të përdoruesve të shërbimit, përfshirë fëmijët, si foto në rrjete sociale.
- Ndajnë informacione private ose konfidenciale rreth fëmijëve apo përdoruesve të shërbimeve pa miratim, përveç rasteve kur kanë të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve dhe në këto raste informacionet do t'i jepen fillimisht njësisë së mbrojtjes së fëmijëve.

Unë pranoj të respektoj Kodin e Sjelljes si më sipër dhe jam i/e vetëdijshëm që nëse i shkel, ndaj meje mund të merren masa që përfshijnë pezullimin dhe heqjen e së drejtës për të punuar brenda në Qendër.

Emri:

Data:

Nënshkrimi:

Aneksi 9

MBYLLJA E RASTIT	
Datë:	Nr. i regjistrimit (kodi)

Arsyet për referimin e parë dhe data e referimit:

Data e mbylljes së rastit: _____

Koordinatori/ja Qendrës: _____

Aneksi 10

Proces-verbal i daljes së rasteve nga Qendra

Sot, më datë __/__/____, ora _____, pranë Qendrës rasti _____ (emër, atësi, mbiemër),

ardhur në qendër nga data/ora _____ deri në datën/ora _____,

largohet për të shkuar:

Bashkëngjitur kopje e dokumentave që i jepen rastit me vete (nëse ka):

Fëmija/Personi që e shoqëron :

(emër, mbiemër, firmë në varësi të moshës)

Përfaqësuesi i Qendrës:

(emër, mbiemër, firma)

Aneksi 11

Procesverbal i hyrjes së përfituesve në moshë të mitur

Sot në datën __/__/__, ora ____, pranë Qendrës, u bë i mundur ofrimi i shërbimit të fëmijës

_____(emri, atësia, mbiemri) i/e

datëlindjes _____.

Fëmija është i shoqëruar nga: _____

Marrdhënia e fëmijës me personin që e shoqëron është: _____

Referimi u bë i mundur nga: _____

Përfaqësuesit e institucionit/agjensive referuese

(emër, mbiemër, firma)

Persona të tjerë që e shoqërojnë fëmijën (nëse ka)

(emër, mbiemër, firma)

Përfaqësuesi i Qendrës

(emër, mbiemër, firma)

Aneksi 12

PROCESVERBAL I TURNEVE

_____, më __/__/__

	Stafi (emër, mbiemër, firmë)	Gjeneralitetet e rastit (emër, mbiemër, moshë)	Shërbimi i Ofruar
Turni 1 Ora:			
Turni 2 Ora:			
Turni 3 Ora:			

Aneksi 13

PROCESVERBAL I TURNEVE

_____,mē / /

	Stafi (emër, mbiemër, firmë)	Gjeneralitetet e rastit (emër, mbiemër, mosha)	Shërbimi i Ofruar
Turni 1 Ora:			
Turni 2 Ora:			
Turni 3 Ora:			

Aneksi 14

[illegible]

Ekzaminimi u krye nga mjeku: _____
Specialiteti: _____
Data: _____

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ANEKSI 15 VLERËSIMI I RREZIKUT PËR VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE

Emri i personit/institucionit që bën raportimin:					
Data kur është bërë raportimi:					
Marrëdhënia me viktimën:					
Viktima					
Emri:	Mbiemri:				
Etnia:	Gjinia:		Data e lindjes:		
Nevoja të veçanta/aftësi të kufizuara/probleme të shëndetit mendor, nëse ka:					
A ka dëmtime të dukshme?	Po	Jo	A raporton viktima dhimbje?	Po	Jo
A janë përdorur armë?	Po	Jo	A mendon viktima se është droguar?	Po	Jo
A ka përdorur viktima alkool?	Po	Jo	A ka përdorur viktima vullnetarisht substanca të tjera?	Po	Jo
A është abuzuar viktima në mënyrë të vazhdueshme?	Po	Jo	A mendohet se ka viktima të tjera të mundshme?	Po	Jo
A raporton viktima probleme shëndetësore? Specifiko.	Po	Jo			
A ndihet viktima shumë e frikësuar nga dhunuesi?	Po	Jo	A është larguar nga shtëpia? A dëshiron të largohet nga shtëpia?	Po	Jo
Konsiderata të tjera në lidhje me viktimën.					
Konsiderata të tjera në lidhje me dhunuesin.					
Vëzhgime dhe komente:					

UDHËZIM Nr. 631, datë 21.11.2022

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PËR FËMIJËT 6-15 VJEÇ¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3, të neneve 27 dhe 51, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët 6-15 vjeç, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
 2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.
 3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror apo dhe/ose personave juridikë publikë/privatë, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.
 4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe Inspektorati Përgjegjës për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, për zbatimin e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 160*. Tiranë 2022. f. 19036.

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

STANDARDET E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PËR FËMIJËT 6–15 VJEÇ

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

HYRJE

Shqipëria është në një proces të rëndësishëm reformash ambicioze në nivel kombëtar dhe vendor. Qeveria Shqiptare, mbështetur nga UNICEF, *Save the Children* dhe partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ka planifikuar dhe ndërmarrë reforma për mbrojtjen e fëmijëve, duke përmirësuar paralelisht sistemin kombëtar të shërbimeve sociale.

Reforma në sistemin e mbrojtjes dhe të kujdesit ndaj fëmijës synon të sigurojë një kalim gradual nga kujdesi alternativ rezidencial drejt shërbimeve të kujdesit me bazë komunitare për fëmijët dhe familjet e tyre. Qëllimi i reformës për kujdesin ndaj fëmijës është orientimi drejt shërbimeve shoqërore cilësore, që fokusohen fëmija/i rrituri/familja, sigurimi i mbështetjes me bazë komunitare, kurdo që është e mundur, dhe të minimizimi i ndërhyrjes në jetën e familjes, duke prodhuar impakt pozitiv dhe afatgjatë.

Procesi duhet të jetë i mirëplanifikuar dhe duhet të menaxhohet me kujdes në mënyrë që të shmanget mbivendosja e shërbimeve, të bazohet në praktikat dhe modelet ekzistuese, të minimizohen kostot e transformimit dhe të sigurohet përdorimi efikas i burimeve për edukimin, kujdesin shëndetësor dhe përkujdesjen për të mbështetur fëmijët dhe familjet e tyre në komunitet.

Zhvillimi dhe transformimi i shërbimeve shoqërore, veçanërisht në nivel komunitar, janë kritike për reformat në zhvillim dhe agjendat prioritare në vend, konkretisht deinstitutionalizimi dhe reforma e sistemit të kujdesit ndaj fëmijës, përgjigjja ndaj dhunës dhe përjashtimit social, të rinjtë dhe adoleshentët, si dhe iniciativat, në kuadër të zhvillimit të hershëm të fëmijëve.

VKM-ja nr. 106, datë 15.2.2017, “Për një ndryshim në VKM-në nr. 425, datë 27.6.2012, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore”, të ndryshuar, në pikën 1 të vendimit parashikon ndryshimin e moshës së pranimit të fëmijëve në këto institucione, sipas tipologjive të caktuara të shërbimit, konkretisht: 0–5 vjeç; 6–15 vjeç dhe 16–18 vjeç, çka kërkon miratimin e standardeve specifike për këto grup-mosha.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të vlerësimeve të vazhdueshme për ofrimin e shërbimeve rezidenciale të përkujdesjes për fëmijët, mori nismën për rishikimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për fëmijët në institucionet rezidenciale.

PARIMET

Rishikimi i standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët pa kujdes prindëror nga 6–15 vjeç, ka për qëllim të ofrojë një dimension të ri, në frymën e të gjitha ndryshimeve ligjore, në sistemin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë. Standardet plotësojnë detyrimet për zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015–2023 dhe ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 121/2016, “Për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë dhe ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, bazohen në parimet:

1. Universaliteti, fëmija është bartës i të drejtave që janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërruar dhe progresive;
2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën;
3. Drejtësia sociale;
4. Subsidiariteti;
5. Mbështetja shoqërore dhe ofrim i shërbimit të specializuar për çdo fëmijë;
6. Deinstitutionalizimi dhe decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijëve;
7. Partneriteti ndërmjet institucioneve dhe ndërhyrje ndërsektoriale;
8. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës, si dhe i të drejtave të njeriut;
9. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar;
10. Mosdiskriminimi dhe barazia;
11. Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale;

12. Garantimi i stabilitetit të vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimit të fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor e gjuhësor.

Gjatë hartimit të këtyre standardeve janë marrë në konsideratë të drejtat e sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa për të drejtat e Fëmijëve. Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përkufizon shërbimet rezidenciale si shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në strehëzat rezidenciale, publike dhe jopublike.

Standardet e reja të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet rezidenciale, për fëmijët 6–15 vjeç, do të shërbejnë si një instrument bazë për sigurimin dhe matjen e cilësisë së shërbimeve në të gjitha institucionet publike dhe jopublike të ofrimit të këtyre shërbimeve dhe garantimin e ushtrimit të të drejtave të fëmijëve në bazë të ligjit nr. 18/2017, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 56 (kreu IV) përcakton dhënien e masës emergjente të mbrojtjes për rastet e fëmijëve në rrezik të menjëhershëm dhe mbrojtjen e tij nëpërmjet vendosjes në një strehim të sigurt, siç mund të jetë (pika “c” e nenit 57) vendosja e fëmijës në një strehëz rezidenciale, kur nuk janë të mundura alternativat e tjera si familja biologjike apo kujdestare.

Në të gjitha rastet, kur strehimi rezidencial është zgjidhja e vetme, kërkohet që të sigurohet një nivel shërbimi, që siguron përkujdes cilësor të lartë, në përshtatje me mundësitë për ofrimin e shërbimeve shoqërore në Shqipëri, që të jetë i realizueshëm në një plan afatshkurtër apo afatmesëm nga të gjithë ofruesit e shërbimeve rezidenciale për fëmijët, që garanton bazat për zhvillim të mtejshëm dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për fëmijët dhe që lejon një zhvillim të qëndrueshëm në një plan afatgjatë.

MODELI I PROPOZUAR: “SHTËPI-FAMILJE”

Koncepti bazë

Shtëpia-familje krijohet në ndërtesa normale banimi, duke iu referuar parametrave të banesave civile. Hapësirat janë të organizuara, si për zhvillimin e jetës së një familjeje të zakonshme, të ndara në zona dite (dhomë ndenjeje, kuzhinë) dhe zona nate, pa pengesa arkitektonike; numri i banjave është në përpjesëtim me kapacitetin mikpritës. Për shkak të karakteristikës së tipit familjar, nuk ka nevojë për një autorizim shëndetësor për kuzhinën, për hapësira apo shërbime që përdoren nga pjesëtarët e saj.

Në një shtëpi-familje jetojnë deri në 6 fëmijë të grup-moshës 6–15 vjeç dhe për ta kujdesen gra/nëna (përgjithësisht jo më shumë se katër) që u japin fëmijëve afeksionin, organizimin dhe funksionin e një familjeje. Në këto familje stimulohet jeta si një familje e zakonshme, fëmijëve u nxitet krijimtaria dhe nisma, zhvillojnë aftësi specifike dhe fitojnë vlerësim për veten. Shtëpia-familje bëhet baza e tyre e sigurt, me vlerë terapeutike dhe rehabilituese. Ajo shëron dhe parandalon.

Veprimtaritë dhe cilësitë funksionale:

- stabilitet jetese të fëmijëve;
- organizim të jetës së përditshme në bazë të një modeli jete familjare, që respekton ritmet, aftësitë dhe potencialitetet e personave të mikpritur;
- përdorim sipas problematikave të fëmijëve të shërbimeve të pranishme në territor.

Nënat kujdesen për fëmijët jo vetëm për shkollimin, por edhe për ushqimin e tyre, edhe për veshjet, duke respektuar dëshirat dhe shijet individuale të fëmijëve, si në çdo familje të shëndetshme.

Nëpërmjet hartimit të standardeve, përfituesit, kategoria fëmijë 6–15 vjeç, do të plotësojnë më mirë nevojat e tyre, duke u rritur dhe edukuar në një mjedis familjar.

Sfida ka qenë që të krijohet një paketë standardesh për shërbimet rezidenciale për fëmijët 6–15 vjeç, me qëllim që fëmijët e rritur jashtë familjes të gjejnë një mjedis të sigurt, që u mundëson atyre rritjen dhe edukimin, si qytetarë të përgjegjshëm dhe plotësisht të integruar në jetën e komunitetit, ose të mund të kthehen në familjet e tyre biologjike apo në familje që do të mundësojë rritjen e tyre.

Kujt i shërbejnë standardet?

Të gjithë aktorët, që nga përfituesit deri tek ofruesit e shërbimeve rezidenciale dhe bashkëpunëtorët e tyre janë të interesuar t’i përdorin standardet. Këto janë standarde minimale që synohet të zbatohen në të gjitha shërbimet rezidenciale për fëmijë 6–15 vjeç.

- Fëmijët/familjet dëshirojnë të marrin një nivel të kënaqshëm shërbimesh. Prindërit dhe të afërmit e fëmijëve, që ndodhen në qendrat e shërbimeve rezidenciale dhe fëmijët e rritur kanë të drejtën të informohen mbi standardet, që të mund të kontribuojnë edhe ata në zbatimin e tyre.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- Ofruesit, ku përfshihen: institucionet publike, OJF-të, grupet e interesuara, ofruesit privatë dhe bashkëpunëtorët e tyre do t'i përdorin standardet si një udhërrëfyes në procesin e realizimit të shërbimeve rezidenciale.

- Organizatat që përfaqësojnë interesat e fëmijëve apo ato që merren me mbrojtjen e fëmijëve apo më gjerë me zhvillimin e të drejtave njerëzore.

- Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror me agjencitë e tij rajonale, Inspektorati për Shërbimet Shoqërore, autoritetet vendore, ku përfshihen këshillat e qarkut, bashkisë, do t'i përdorin standardet për licencimin, inspektimin dhe vlerësimin e shërbimeve shoqërore.

- Të gjitha autoritetet e tjera publike në nivel qendror, si: Ministria e Shëndetësisë, e Arsimit, e Pushtetit Vendor, e Drejtësisë etj.

Standardet, gjithashtu, mund të jenë të dobishme, për:

- Institucionet akademike dhe organizata të tjera të përfshira në veprimtari arsimore dhe/apo trajnuese për personelin që ushtron veprimtari në shërbimet shoqërore;

- Studiuesit që i drejtohen fushës shoqërore;

- Të tjerë si persona/biznese të interesuar apo edhe të angazhuar në fusha që ndërthuren me shërbimet shoqërore.

Çfarë fushash mbulojnë standardet?

Ky dokument përbëhet nga 12 standarde bazë. Krahas standardeve, jepen edhe kriteret e vlerësimit, treguesit e matjes së cilësisë së shërbimeve, udhëzues dhe rezultatet e pritura, si dhe anekset përkatëse, të cilat paraqesin format për secilin nga hapat e ndjekur për arritjen e qëllimeve të standardeve. Standardet janë hartuar, si: standarde të shërbimit bazë dhe standarde të detyrueshme për të gjithë personat që ofrojnë shërbime publike dhe jopublike. Standardet mbulojnë disa fusha, si:

1. Qëllimi i shërbimit dhe përshtatshmëria sipas qëllimit;

2. Plani i përkujdesjes;

3. Përgatitja për jetesë të pavarur;

4. Ushqyerja;

5. Paraqitja, veshja dhe nevojat materiale;

6. Shëndeti fizik, emocional, mendor dhe dentar;

7. Edukimi;

8. Argëtimi;

9. Ankimimi;

10. Mbrojtja nga abuzimi;

11. Mjedisi dhe akomodimi;

12. Stafi.

Standardet janë konceptuar si standarde të cilësisë, në kuptimin që ato do të përdoren si mjet për të arritur dhe njëkohësisht për të vlerësuar cilësinë e shërbimit që ofrohet për fëmijët 6–15 vjeç, që rriten në institucionet rezidenciale, jashtë familjeve të tyre biologjike. Ato janë ndërtuar në 4 seksione. Së pari, përcaktimi i standardit që do të arrihet. Ky pasohet nga një përcaktim i rezultatit që arrihet te fëmijët nga zbatimi i standardit përkatës. Së treti, kriteret për vlerësimin e tij dhe së fundi treguesit për matjen e cilësisë së zbatimit të standardit që vlerësojnë nëse standardet janë arritur. Këta tregues do të shërbejnë edhe si bazë për inspektimin e shërbimeve rezidenciale për fëmijët. Në këtë mënyrë, të gjithë pjesëmarrësit në sistemin e shërbimeve rezidenciale për fëmijët dinë se ku duan të arrijnë me këtë lloj shërbimi dhe se si të marrin arritjet e tyre.

STANDARDI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILËSISË
I. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6 – 16 15 vjeç zotëron dokumentin ku përshkruan misionin, qëllimin, objektivat, si dhe modelin e shërbimit që ofrohet.	Fëmijët kanë njohuri për llojin e shërbimit që ofrohet, si dhe metodologjinë e përdorur për përkujdesjen ndaj tyre. Një deklaratë e qartë se si ofrohet shërbimi është e disponueshme për	1. Një përkufizim i qartë i misionit dhe i qëllimit të shtëpisë, ku parashtrihen shërbimet që ajo ofron, është lehtësisht i dukshëm për të gjithë përdoruesit e kësaj shtëpie. Ky përkufizim shkruhet në Deklaratën e Qëllimit. Format e shprehjes dhe	1.1 Ekziston një dokument zyrtar lidhur me Deklaratën e Qëllimit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

	fëmijët, prindërit dhe të interesuarit e tjerë.	prezantimi janë të qarta në vende të dukshme, në formën edhe të fletëpalosjeve, posterave, faqeve në internet etj.	1.2 Personeli mund të demonstrojë që e kupton dhe e zbaton politikën përkatëse të përshkruar në deklaratën e qëllimit. Në deklaratën e qëllimit të përfshihen edhe mendime apo sugjerime nga vetë fëmijët.
	Qendrat me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ofron një paketë shërbimesh, në përputhje me nevojat e fëmijëve në bashkëpunim edhe me ofruesit alternativë të shërbimeve, për të mundësuar kujdes dhe mirëqenie për çdo fëmijë në interesin e tij më të lartë.	2. Prindërit, fëmijët, përdoruesit e shërbimeve kanë akses te deklaratat e qëllimit, misioni dhe manuali.	2.1 Kopje të deklaratës së qëllimit janë të dukshme në të gjithë shtëpinë familje, janë të disponueshme për përdoruesit, si dhe në forma lehtësisht të kuptueshme edhe nga fëmijët.
		3. Personeli ofron informacion lidhur me funksionimin e shtëpisë ose të shërbimit që do t'u ofrohet fëmijëve, cilat janë shërbimet minimale, shitesë apo të specializuara që ofrohen në shtëpi apo mundësohen prej saj. Personeli dhe fëmijët angazhohen në mirëmbajtjen e mjediseve personale dhe të përbashkëta, respektimi i orareve të hyrjeve dhe të daljeve, të drejtave dhe detyrimeve.	3.1 Fëmijët, prindërit ose të afërmit konfirmojnë se kanë marrë informacion nga stafi mbi deklaratën e qëllimit dhe e kuptojnë atë, pasi ajo është diskutuar me ta. Përfutuesit kanë një kopje të deklaratës së qëllimit. Konfirmimi duhet të jetë i dokumentuar.
			3.2 Rregullore e brendshme ku përcaktohen qartë dhe hapur rregullat e jetesës në shtëpi për fëmijët dhe personelin..
		4. Deklarata e qëllimit rishikohet, përmirësohet në mënyrë periodike dhe pas kësaj vijnë modifikimet përkatëse në dokumentet dhe praktikatat e tjera.	4.1 Dokumentet dhe aktet zyrtare tregojnë që deklarata e qëllimit është diskutuar dhe rishikuar rregullisht.
II. Plani i përkujdesjes për fëmijë paraqet në mënyrë të qartë	Për çdo fëmijë ka një plan individual. Nevojat e fëmijëve vlerësohen dhe	1. Ekipi me specialistë është përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të nevojave të fëmijëve, për secilin nga	1.1. Është ngritur një ekip multidisiplinar, që njeh përgjegjësitë e tij lidhur me vlerësimin dhe planifikimin në

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

nevojat e vlerësuara të fëmijëve, objektivat dhe aktivitetet e përkujdesjes, krijimin e mundësive për të plotësuar këto nevoja nga personeli i shtëpisë-familje dhe mënyrën se si do të vlerësohet efektiviteti i përkujdesjes për çdo element (komponent) të planit.	plotësohen në mënyrë efektive dhe të plotë. Planet me shkrim paraqesin mënyrat, afatet se si do të plotësohen nevojat dhe si e kur do të zbatohen këto plane. Ato paraqesin edhe progresin e arritur në zbatimin e planit.	komponentët e shërbimit: shëndeti, arsimi, akomodimi afatgjatë, marrëdhëniet familjare, aktivitetet sociale. 2. Në rastet kur fëmijët kanë nevoja komplekse për trajtim në grupet multidisiplinare përfshihen edhe specialistë jashtë qendrës për të ndihmuar si në vlerësim ashtu edhe në planin e ndërhyrjes dhe trajtimit të tij.	fushën e përkujdesjes. Çdo pjesëtar i ekipit ka të qartë detyrën e tij dhe ka përgatitur e përditësuar rubrikën që ka nën përgjegjësi. 1.2 Ekipi multidisiplinar ngrihet në fillim viti nga drejtuesi me specialistët e fushës: punonjës social/psikolog/mjek edukator/kujdestar apo specialistë të tjerë përfshirë edhe PMF-në, sipas rastit.
		2. Ekipi ka kryer ose po kryen një vlerësim të nevojave për çdo fëmijë.	2.1 Për çdo fëmijë ka një dosje personale që përmban vlerësimin e kryer mbi nevojat e fëmijëve të dokumentuar.
		3. Është hartuar dhe po zbatohet një plan përkujdesjeje për çdo fëmijë ku synohet pjesëmarrja/përfshirja aktive e fëmijëve në hartimin dhe zbatimin e planit.	3.1 Është i disponueshëm për fëmijët, si vlerësimi, ashtu edhe plani lidhur me përkujdesjen. Në dosjen personale ka shënime mbi progresin e shënuar për zbatimin e planit. Plani është nënshkruar edhe nga përfituesi.
		4. Fëmijët janë pjesë e procesit të vlerësimit dhe planifikimit të përkujdesjes.	4.1 Ka dëshmi, (dok.) që vlerësimi i nevojave dhe plani janë diskutuar me fëmijët, prindërit/të afërmit e tyre, personin përgjegjës për fëmijët dhe që janë kuptuar prej tyre..
		5. Plani i përkujdesjes përfshin objektiva të qartë, mjetet për arritjen e objektivave, kontrollet periodike mbi progresin e bërë.	5.1 Janë përcaktuar objektiva të qartë për veprime dhe personi përgjegjës për realizimin e tyre, mjetet për arritjen e objektivave dhe sa do të përfshihet vetë fëmija.
		6. Është caktuar një person përgjegjës për zbatimin e planit dhe raportimin e progresit për çdo fëmijë.	6.1 Për çdo fëmijë ka një edukator/kujdestar, që kujdeset në bashkëpunim me fëmijët për zbatimin e planit. 6.2 Kujdestari/edukatorët në shtëpi-familje punojnë me fëmijët për të nxitur modelin e duhur të jetës dhe i drejtojnë ata në rrugën e duhur për të arritur besimin, zhvillimin e aftësive të jetës së përditshme dhe përmirësimin e aftësive dhe vlerave të tyre individuale.
		7. Për çdo fëmijë në këtë dosje përfshihet: i. dokumentacioni i duhur në përputhje me legjislacionin për pranimin e tij në shtëpi-familje; ii. historinë e tij personale; iii. vlerësimi i nevojave specifike të çdo fëmije, në	7.1 Personi përgjegjës për fëmijën mund të flasë me kompetencë për të, si edhe të dëshmojë për situatën e tij dhe të familjes së tij. Vlerësimi i nevojave të fëmijës dhe të familjes së tyre bëhet me qëllim që të përcaktohet ndihma e duhur dhe shërbimi

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

		lidhje me zhvillimin e tij psikosocial. Çdo fëmijë ka të drejtën të njihet me përmbajtjen e dosjes personale në çdo moment.	që i plotëson më mirë këto nevoja.
		8. Ekziston bashkëpunim me shërbimet e tjera (publike, private, OJF-të) për të siguruar që nevojat e identifikuar të fëmijëve të plotësohen, si edhe të ofrohet një mbështetje shtesë për fëmijët.	8.1 Ka dokumente që dëshmojnë se gjatë hartimit të planeve të përkujdesjes apo të rishikimit të tyre janë kërkuar informacione nga organizatat e tjera (shkollat, institucionet shëndetësore, OJF-të e tjera).
III. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç harton një plan përgatitor për fëmijët që largohen nga përkujdesja në institucion dhe lëvizin (transferohen) në forma të tjera të përkujdesjes (integrim në familjen biologjike, birësim, kujdestari).	Fëmijët mbështeten dhe përgatiten për t'u larguar nga qendra shtëpi-familje 6–15 vjeç drejt një jete në familjet e tyre, qoftë biologjike, birësuese, apo kujdestare.	1. Një ekip është përgjegjës për hartimin e planit përgatitor për largimin nga përkujdesja.	1.1 Ekipi është ngritur dhe funksionon. Duke filluar nga mosha, 16 vjeç (ose me parë (nëse fëmija largohet me shpejt nga institucioni) bëhen diskutime me fëmijët lidhur me të ardhmen e tyre, kur do të largohen nga shtëpia. Shqyrtohen me fëmijët mundësitë realiste që kanë të bëjnë me këtë të ardhme (edukimi, formimi profesional etj.).
			1.2 Me fëmijët bëhen diskutime lidhur me të ardhmen e tyre, kur do të largohen nga qendra rezidenciale me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç. Shqyrtohen me to opsionet realiste, që kanë të bëjnë me këtë të ardhme (edukimi, formimi profesional etj.).
			1.3 Për çdo fëmijë ka një plan për largimin nga Qendra shtëpi-familje 6–16 vjeç, drejt jetesës në familje. Puna për planin e largimit të fëmijëve duhet të fillojë një vit përpara.
		2. Personeli, fëmijët, prindërit dhe/ose të afërmit apo të interesuar të tjerë për fëmijën, punojnë së bashku për përgatitjen e një programi individual për të, sipas moshës, nevojave dhe mënyrës së re të jetesës së tij në të ardhmen. Në planin e largimit, rikthimit në familje përfshihet edhe vlerësimi i PMF-së (punonjësi për mbrojtjen e fëmijës) në bashkinë, aty ku fëmija ka familjen e vet.	2.1 Në dosjen e fëmijës ka dëshmi lidhur me diskutimet që janë bërë rreth rrezikut që ekziston për shfrytëzimin e tyre, shëndetin seksual, përdorimin e drogës, alkoolit etj. 2.2 Fëmijët konfirmojnë që ka pasur diskutime të tilla me ta. Plani i largimit bëhet me përfshirjen e fëmijës, prindërve apo kujdestarit të tij.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

			2.3 Në bashkëpunim me punonjësin përgjegjës, organizohen aktivitete dhe diskutime tematike që fëmijët të fitojnë aftësi në menaxhimin e jetës së tyre duke përfshirë vetëvlerësimin, aftësimin për pastërtinë, higjienën, rregullin dhe proceset edukuese.
IV. Fëmijëve u sigurohen dhe ofrohen ushqime dhe lëngje të shëndetshme, të sigurt, të shumëllojshme e në sasi të mjaftueshme, sipas normave ushqimore të miratuara për grup-moshën, si dhe që plotësojnë dëshirat e tyre.	Fëmijët marrin ushqime me vlera ushqyese që plotësojnë nevojat e tyre në përputhje me grup-moshën. Fëmijëve me nevoja të veçanta ushqimore u sigurohet ushqim i përshtatshëm. Sipas formave të zgjedhjes së shërbimit në IPSH mund të përdoret edhe shërbimi <i>catering</i> për vaktet të ndryshme.	1. Fëmijët marrin një dietë të shëndetshme, ushqyese dhe të ekuilibruar sipas nevojave të tyre të rritjes dhe zhvillimit dhe nevojave kulturore, fetare.	1.1 Ekziston një menu javore që u përshatet moshave të fëmijëve, nevojave të tyre për lëndë ushqyese dhe kalori. 1.2 Menuja hartohet nga një komision i përbërë nga mjeku, kuzhinieri, financier dhe fëmijët, si dhe u bëhet e ditur personave të tjerë të interesuar për fëmijët.
			1.2 Nga diskutimet me grupe të fëmijëve më të rritur konfirmohet se fëmijët janë përfshirë në hartimin e menysë dhe kanë shprehur mendimin e tyre në zgjedhje.
			1.3 Regjistrat ku janë shënuar porositë konfirmojnë se janë blerë rregullisht ushqime, fruta dhe perime të freskëta. Janë të disponueshme fruta dhe perime dhe ushqime të ndryshme të freskëta në ambientet e shtëpisë-familje. - Në përcaktimin e zgjedhjes së ushqimeve me procedurat të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi, merret paraprakisht mendimi dhe zgjedhja e fëmijëve. Ka dokumente, që verifikojnë dëshirat dhe zgjedhjet e fëmijëve, të marra parasysh në planifikim.
			1.4 Janë plotësuar kushtet lidhur me shëndetin, higjienën, përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimeve. Kampioni ushqimor ruhet 24 orë në kushtet e duhura.
			1.5 Ka evidenca që tregojnë se në raste të veçanta, siç janë ditëlindjet e fëmijëve përgatitet diçka e veçantë.
		2. Me mbështetjen e personelit, fëmijët kanë të	2.1 Sipas dëshirës fëmijë përgatisin vetë ushqimin e tyre

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

		drejtë për të përgatitur ushqime dhe lëngje për veten e tyre.	në fundjavë, si edhe vaktet e mëngjesit, darkës ose zemrës.
		3. Ambienti i e ngrënies dhe mobilitet u përshtaten numrit, nevojave dhe moshës së fëmijëve. - Magazina apo ambienti i ushqimeve është i ndarë nga detergjente apo solucioneve të tjera.	3.1 Në ambientin e kuzhinës në çdo shtëpi-familje (kuzhinë), fëmijët e përdorin si një vend ku bëjnë ushqimin e shpejtvetë, çaj, ëmbëlsira etj. dhe gatuajnë me ndihmën e stafit.
		4. Vaktet shërbehen në orare të rregullta, kështu që fëmijët e dinë kohën e ngrënies. Sipas nevojave fëmijët mund të përdorin në çdo kohë ushqimin, frutat apo lëngjet që pëlqejnë.	4.1 Bisedat me fëmijë konfirmojnë njohjen e të drejtave të tyre në këndvështrimin e ushqyerjes.
V. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç plotëson nevojat për veshje dhe gjëra personale të domosdoshme të fëmijëve.	Fëmijët vishen në mënyrë të rregullt. Ata zgjedhin vetë veshjet dhe gjërat e domosdoshme personale që plotësojnë nevojat e tyre.	1. Fëmijët janë në gjendje të zgjedhin kur bëhet fjalë për pamjen e tyre të jashtme (rrobat, prerja e flokëve) dhe gjërat e tyre personale, duke i blerë ato me mbështetjen e stafit.	1.1 Ka evidencë që tregon se fëmijët janë të përfshirë në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me paraqitjen e tyre të jashtme.
			1.2 Fëmijët nuk veshin rroba të përdorura të njëri- tjetrit.
		2. Fëmijët duhet të jenë në gjendje apo të kenë orëndi të përshtatshme, për të ruajtur gjërat e tyre personale. Dollap, komodinë raft për mbajtje të gjërave personale. Secili fëmijë ka në dollapin e vet pajisjeve hotelerike (çarçafë, jastëk, batanije, jorganë etj.) dhe përdor ato sa herë është e nevojshme.	2.1 Të kenë hapësira në dhomat e tyre të gjumit për të mbajtur rrobat. 2.2 Nuk ka rroba për përdorim të përbashkët. 2.3 Secili nga fëmijë ka një vend personal për të mbajtur rrobat, si edhe sende të tjera personale.
		3. Fëmijët duhet të inkurajohen dhe të ndihmohen, nëse është e nevojshme, për të administruar gjendjen e tyre financiare (paratë e tyre).	3.1 Dokumentacioni i regjistruar (listëpagesa) dëshmon se fëmijët kanë përfituar pagesën mujore, në masën e përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.
		4. Stafi këshillon fëmijët lidhur me përdorimin e tualetit, higjienën personale, si dhe përdorimin e prodhimeve kozmetike.	4.1 Ditarët ditorë që përdorin këto shtëpi ose dosjet personale për secilin fëmijë dëshmojnë se janë bërë diskutime me fëmijët mbi këto

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

		5. Sipas nevojave për çdo fëmijë sigurohen mjetet dhe detergjentet e higjienës personale. Ka evidenca të shkruara për marrjen e tyre në përdorim nga fëmijët.	tema.
VI. Shërbimet mjekësore, dentare dhe shërbime të tjera ofrohen sipas nevojave fizike, emocionale dhe shëndetësore të fëmijëve. Këto nevoja identifikohen dhe merren masat e duhura për t'i plotësuar ato. Fëmijët udhëzohen mbi çështjet që kanë të bëjnë me përkujdesjen personale dhe u ofrohet këshillim mbi çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin.	Fëmijët jetojnë në një mjedis të shëndetshëm. Nevojat e tyre shëndetësore janë identifikuar dhe ofrohen shërbime për t'i plotësuar ato. Te fëmijët nxiten mënyra të shëndetshme jetese.	1. Çdo fëmijë i nënshtrohet vlerësimit mjekësor, sipas nevojave të tij shëndetësore. - Sipas rrethanave të referimit në kushte emergjence, fëmijët i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimit mjekësor për vlerësimin e shëndetit të tyre. - Sipas protokollit shëndetësor në rastet e fëmijëve me problem të shëndetit merren masa për trajtimin e tij në ambient të ndarë për mos mbartur risk për fëmijët e tjerë.	1.1 Të dhëna të regjistruara në këto shtëpi, dëshmojnë se çdo fëmijë i është nënshtruar vlerësimit të parë mjekësor, vaksinat (kontrolleve mjekësore, të syve dhe të gojës) dhe këto kontrolle janë kryer në mënyrë periodike.
		2. Personeli nxit dhe inkurajon mirërritjen, ushqyerjen dhe një mënyrë jetese të shëndetshme (ushqime të shëndetshme, dietë e balancuar, ndërgjegjësim për rreziqet e kequshqyerjes).	2.1 Personeli ofron një shembull të mirë për jetesë të shëndetshme dhe ka zhvilluar seanca diskutimi me fëmijët, për njohjen e rreziqeve, që vijnë nga përdorimi i duhanit dhe i alkoolit dhe substancave narkotike, si dhe ndalimin e përdorimit të tyre në ambientet e institucionit.
		3. Çdo fëmijë, në përshtatje me moshën, ka kartelë shëndetësore të kujdesit për mirërritje dhe zhvillim, që njihet dhe zbatohet nga stafi i shtëpisë, ku përfshihen: i. historia personale e fëmijëve (lindja, shëndeti, familja e tij etj.); ii. historia dhe ecuria e sëmundjeve dhe e problemeve të kaluara; iii. historia e sëmundjes aktuale; iv. ndërhyrje dhe trajtime të veçanta mjekësore; v. alergji dhe reaksion ndaj ilaçeve; vi. shëndeti i gojës; vii. përfshirja e prindërve/të afërmeve të fëmijëve në çështje që kanë të bëjnë me	3.1 Kartelat shëndetësore menaxhohen nga mjeku/infermieri, dhe përmbajnë të gjitha vizitat, kontrollet peroidike të fëmijës. Në rastet e fëmijëve me nevoja të veçanta, ndiqen nga specialisti përkatës dhe ka të njëjta të drejta si gjithë fëmijët e tjerë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

		shëndetin.	3.2 Në kartelat që disponon qendra, ka dokumentacion, receta, rekomandime lidhur me marrëdhëniet midis shtëpisë në fjalë dhe profesionistëve të fushës së shëndetit, spitaleve etj., për kurimin e fëmijëve.
		4. Çdo fëmijë i nënshtrohet një kontrolli dentar dhe të përgjithshëm çdo 6 muaj.	4.1 Të dhënat e regjistruara individuale dëshmojnë se fëmijës i është siguruar mjekim për sëmundje të ndryshme kronike (p.sh. diabeti, epilepsia etj.), mjekimi i duhur dhe janë marrë parasysh rekomandimet nën mbikëqyrjen e mjekut. - Në shtëpi-familje ka një kuti emergjence me medikamentet dhe pajisjet e duhur.
VII. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ndjek një politikë edukimi që synon të nxisë dhe mbështesë edukimin dhe arsimimin e fëmijëve.	Edukimi i fëmijëve nxitet në mënyrë aktive, duke u konsideruar një proces i rëndësishëm për përgatitjen e fëmijëve për jetesë të pavarur.	1. Personi përgjegjës për fëmijën e mbështet atë gjatë gjithë periudhës së edukimit të tij shkollor.	1.1 Punonjësi përgjegjës edukatori bashkërisht me fëmijën përcaktojnë programin e vijueshmërisë në procesin mësimor, p.sh. ai realizon takime me mësuesit në shkollë dhe mbështet atë gjatë gjithë kohës.
		2. Çdo i ri ka një plan edukimi që përfshin: - objektivat; - raportet e rregullta të progresit. - për fëmijët të cilët kanë problematika të veçanta me ecurinë në shkollë, edukatori duhet të hartojë një plan individual, ku të jenë të përcaktuara të gjithë hapat që duhet të ndjekë fëmija. Në këto plane të pasqyrohen rezultatet e vlerësimit dhe të punës direkt për progresin e fëmijës.	2.1 Progresi i fëmijëve në aspektin edukativ është pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit dhe përmirësimit periodik të planit të përkujdesjes (shihni standardin 2). Progresi i fëmijë është i matshëm dhe i verifikueshëm nëpërmjet dokumenteve që disponon edukatori.
			2.2 Dosjet sipas rasteve individuale, si dhe intervistat me fëmijën tregojnë për diskutimet që janë zhvilluar me fëmijën lidhur me ecurinë e tij/të saj shkollore.
		3. Ka mjedise studimi ku fëmijët mund të mësojnë dhe të përgatisin detyrat e tyre të shtëpisë mjedise të cilat të jenë të përshtatura me mjete didaktike dhe lojëra të ndryshme që zhvillojnë zhvillimin	3.1 Qendra disponon bibliotekë me libra dhe revista, sipas moshës së fëmijëve.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

		intelektual të tyre.	
		4. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ofron në mënyrë të rregullt materiale shkollore për fëmijë. Personeli i ndihmon fëmijët gjatë përgatitjes së tyre.	4.1 Ka evidencë për ekzistencën e një buxheti të akorduar veçanërisht për këtë gjë.
VIII. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6-15 vjeç organizon dhe planifikon që çdo fëmijë të marrë pjesë në një sërë aktiviteteve të përshtatshme për të kaluar kohën e lirë, si dhe që të zhvillojnë nevojat fizike, emocionale e sociale të tyre. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç planifikon dhe siguron burime financiare për të mbështetur aktivitetet e kohës së lirë dhe mjediset e nevojshme për t'i realizuar ato.	Fëmijët janë në gjendje të ndjekin interesat e tyre të veçantë, të ndërtojnë marrëdhënie pozitive, të zhvillojnë vetëbesimin në aftësitë e tyre. Personeli mbështet dhe inkurajon fëmijët për t'u përfshirë në aktivitete në kohën e lirë.	1. Ekziston një program i strukturuar i aktiviteteve të kohës së lirë, i disponueshëm edhe për fëmijët. Fëmijët duhet të përfshihen në jetën kulturore dhe artistike, sociale edhe jashtë institucionit.	1.1 Janë të planifikuara dhe të dokumentuara programe për kalimin e kohës së lirë, të cilat përfshihen në informacionin që u jepet fëmijëve, prindërve/të afërmeve. Qendra disponon ambiente të përshtatura për kohën e lirë të fëmijëve, si brenda, ashtu dhe jashtë saj.
		2. Disa nga veprimtaritë e kohës së lirë janë të planifikuara sipas moshës, kulturës, fesë dhe nevojave të veçanta të fëmijëve.	2.1 Diskutimet me grupin e fëmijëve (qoftë në grup apo individualisht) tregojnë nëse fëmijëve u është krijuar mundësia për t'u marrë me aktivitetet për të cilat ato kanë vetë interes apo aktivitete të përshtatshme për nevojat e tyre.
		3. Fëmijët janë aktivë në organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve.	3.1 Ka të dhëna të dokumentuara për takime që tregojnë se janë zhvilluar diskutime me fëmijët lidhur me aktivitetet e tyre të kohës së lirë. Dokumentimi tregon se fëmijët janë përfshirë në organizimin e këtyre aktiviteteve.
		4. Drejtuesi i shtëpisë siguron burimet financiare, njerëzore dhe mjediset e duhura për të mbështetur aktivitete të kohës së lirë.	4.1 Pajisjet, mjetet dhe mjediset për realizimin e aktiviteteve sigurohen nga personeli dhe drejtuesi i shtëpisë.
		5. Fëmijët inkurajohen për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie korrekte me fëmijët e moshës së tyre në komunitet.	5.1 Në programin e kohës së lirë duhet të përfshihen në aktivitete që organizohen në komunitet, për të nxitur marrëdhëniet sociale.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

IX. Fëmijët kanë të drejtën për t'u ankuar nëse nuk janë të kënaqur me ndonjë aspekt të jetesës në shtëpinë-familje. Çdo ankesë trajtohet në mënyrë serioze, pa vonesë dhe i jepet një përgjigje e plotë brenda një maksimumi prej 10 ditësh. Fëmijët apo ankuesi, mbahen në dijeni për progresin lidhur me trajtimin e saj.	Çdo ankesë trajtohet në mënyrë serioze dhe pa vonesë. Ankuesi informohet lidhur me progresin e çështjes.	1. Ka procedurë ankimi, që bën të mundur bërjen e ankesave, e cila është shprehur qartë dhe e afishuar. Shqyrtimi i ankesës bëhet me përfshirjen e fëmijës.	1.1 Në shtëpi gjenden fletushka të thjeshta dhe të kuptueshme për fëmijët, ose mënyra të tjera të informacionit, që promovojnë procedurat e ankimit dhe afatet kohore. Ka një kuti ankimi në vend të dukshëm për fëmijët.
			1.2 Procedura përcakton pjesëtarët e grupit që shqyrton të gjitha ankesat, si edhe ka kompetencën për të filluar të gjitha veprimet e përshtatshme. Pjesë e grupit që shqyrton ankesat është edhe një përfaqësues nga fëmijët, i cili zëvendësohet me rotacion, p.sh. një herë në tre muaj.
		1. Në qendër ka një kuti ankesash e cila përdoret dhe hapet sipas procedurave të hartuara. 2. Fëmijëve, prindërve, të afërmeve të tyre, dhe stafit iu ofrohet një informacion lidhur me mënyrën se si bëhet ankesa. Ndërkohë ata duhet të kenë të drejtën ta përdorin këtë, pa u diskriminuar. Mënyra e ankimit verbal, me shkrim, e drejtpërdrejtë me stafin apo e shprehur në kutinë e ankesave përcaktohet në procedurat e ankimit, të cilat gjenden të shkruara në qendër dhe njihen nga fëmijët.	2.1 Kopje të fletushkës lidhur me ankimin janë përfshirë në informacionin që u ofrohet fëmijëve/prindërve përpara pranimit në institucion.
			2.2 Fëmijët dhe stafi kanë njohuri mbi procedurën e ankimit.
			2.3 I gjithë stafi ka dijeni të plotë dhe është i trajnuar lidhur me përdorimin e procedurave të ankimit.
			2.4 Ka të dhëna të regjistruara që tregojnë për ankesat që janë bërë, mënyrën e zgjidhjes, si edhe afatet për trajtimin e tyre.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

		3. Ankesat zgjidhen brenda periudhës së përcaktuar.	3.1 Ka të dhëna të regjistruara që tregojnë për afatet e trajtimit të tyre. 3.2 Në shtëpi organizohen takime me fëmijë për diskutime me fokus procedurën e ankimimit. Këto takime dokumentohen. 3. Dokumente të regjistruara, drejtuar personit që bën ankimimin për ta vënë në dijeni për rezultatet e arritura nga ky proces.
X. Ka procedura që nxisin sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve dhe që sigurojnë mbrojtjen e tyre nga abuzimet. Procedurat njihen dhe kuptohen nga i gjithë personeli (përfshirë personelin e ri, të vjetër, vullnetar si edhe personelin e përkohshëm)	Mirëqenia e fëmijëve nxitet dhe ata mbrohen nga abuzimet.	1. Personeli që punon me fëmijët ka dëshmi penaliteti të pastër.	1.1 Kontrollat lidhur me dëshmitë e penaltetit janë të paraqitura në dosjet individuale të personelit.
		2. Përkufizim i qartë i termit “abuzim” dhe “dhunë” kuptohet nga personeli dhe fëmijët. - Fëmijëve u ofrohet gjithë informacioni i nevojshëm, për t’u njohur me politikat e mbrojtjes ndaj dhunës apo ndaj abuzimit.	2.1 Informacioni i ofruar fëmijëve dhe personelit gjatë emërimit të tij, përfshin përkufizime të qarta lidhur me atë se çfarë do të thotë në këtë kontekst fjala “abuzim” dhe “dhunë”.
		3. Ka procedura lidhur me raportimin e rasteve të “abuzimit”. Po ashtu përgatitet një plan veprimesh që duhet të ndërmerren në rast abuzimesh.	3.1 Trajnimi për stafin përfshin diskutime lidhur me situatat abuzive dhe mënyrën se si janë trajtuar ato. Ka edhe udhëzues të disponueshëm për stafin. 3.2 Ekziston një plan i qartë për veprimet që duhet të ndërmerren në raste abuzimi dhe dhune. 3.3 Ka të dhëna të qarta e të regjistruara mbi incidentet e abuzimit, si edhe mënyrën se si janë zgjidhur këto raste.
		4. Hartohet dhe zbatohet një program terapie për të trajtuar traumat që ka përjetuar fëmija që është përfshirë në abuzim. Ky program duhet të përfshijë udhëzime për personelin, personin përgjegjës për fëmijët, si dhe personin abuzues apo dhunues.	4.1 Në rastet e një abuzimi të mundshëm, të dhënat e regjistruara tregojnë se këto janë trajtuar në mënyrën e duhur nga personeli dhe se (kur është e nevojshme me ndihmën e një specialisti) është ofruar terapia e përshtatshme për fëmijët. 4.2 Është caktuar një person

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

			për të vizituar fëmijët në mënyrë periodike dhe për të marrë pjesë në rishikimin e trajtimit të tij/saj.
		5. Njihet dhe zbatohen Kodi i Sjelljes dhe procedura e mbrojtjes së fëmijëve.	5.1 Ka dokumente që Kodi i Sjelljes dhe procedurat e mbrojtjes së fëmijëve njihen nga personeli dhe fëmijët.
XI. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç siguron mjedis fizik të përshtatshëm, mikpritës, si një shtëpi-familje 6–15 vjeç dhe të një cilësie të mirë për fëmijët, personelin, prindërit apo personat e tjerë të interesuar, në përputhje me qëllimin dhe funksionin e saj. Qendra shtëpi-familje 6–15 vjeç mbahet në rregull dhe e pastër.	Fëmijët jetojnë në një shtëpi me hapësira të nevojshme, të mobiluara dhe mirëmbajtur, sipas nevojave të fëmijëve. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ofron lehtësira, për përdorimin e mjediseve të saj dhe u mundëson fëmijëve të mbajnë kontakte me familjet e tyre.	1. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç zbukurohet dhe mobilohet për të krijuar një mjedis të këndshëm, shtëpi-familje për grup-moshën 6–15 vjeç të përshtatshëm për numrin, gjininë dhe moshën e fëmijëve që strehohen atje.	1.1 Tregohet kujdes që fëmijët të jetojnë në mjedise të pastra, të lyera këndshëm dhe në njësi të vogla tip shtëpi-familje.
		2. Qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç ku jetojnë fëmijët është një vend i sigurt.	2.1 Në shtëpi gjendet kutia e ndihmës së shpejtë, si dhe mjetet e nevojshme për fikjen e zjarrit, dalje emergjence, numra të afishuar, se kë duhet të njoftojnë në situata emergjencash shëndetësore, sigurie, rënie zjarri etj.
		3. Organizohen mbledhje javore me fëmijë ose nga vetë fëmijët për të diskutuar rreth funksionimit të tyre, problematikave që ata kanë në bashkëjetesë, çfarë duhet të ndryshojnë, përmirësojnë.	3.1 Mbledhjet dokumentohen dhe vërejtjet apo sugjerimet vlerësohen nga stafi.
		4. Në dhomë fëmijët kanë një shtrat dhe pajisje shtrati të përshtatshme, vend për të ndenjur (për t'u ulur), perde apo mbulesa të tjera, ndriçim të mjaftueshëm për të lexuar, tapet dhe mbulesa të tjera të përshtatshme dysHEMEJE, si edhe ngrohje. Fëmijët kanë dollapë për vendosjen e rrobave, që mund të mbyllet apo ndryshe vend të sigurt të depozitimit të gjërave të tyre personale.	4.1 Fëmijët gjenden në dhoma me jo më shumë se 4 fëmijë, dhe gëzojnë intimitet (jetë private) brenda dhomave të tyre të gjumit. 4.2 Fëmijët kanë krevat, çarçafë e mbulesa të përshtatshme. Këto të fundit janë të pastra

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

			dhe lahen rregullisht. 4.3 Ka një dollap që mbyllet me kyç ose e thënë ndryshe një vend i sigurt depozitimi për sendet personale.
		5. Në ndarjen e fëmijëve në dhomat e gjumit merret parasysh garantimi i sigurisë dhe i shmangies së mundësisë për sjellje abuzive.	5.1 Fëmijët janë nëpër dhoma me fëmijë të së njëjtës moshë dhe gjini.
		6. Fëmijë janë të aftë dhe inkurajohen të personalizojnë dhomat e tyre të gjumit.	6.1 Hapësira e tyre personale zbkurohet sipas dëshirës së fëmijëve, me një pikturë të veçantë të marrë nga librat, fotografitë etj.
		7. Ekziston një dallim midis hapësirës private dhe të përgjithshme të banimit në shtëpinë në fjalë.	7.1 Ka ndarje ndërmjet hapësirave që përdoren si dhoma gjumi, kuzhinës, dhomës së ngrënies, dhomës së studimit, lavanterisë, dhomës ku fëmijët qëndrojnë dhe kalojnë kohë së bashku, banjave etj.
		8. Ka dhoma ku fëmijët mund të takohen privatisht me familjarë, si edhe hapësira për aktivitete private, për të luajtur, për të pushuar, të cilat nuk prekin aktivitetet e tjera të tyre. Çdo vizitor duhet të nënshkruajë paraprakisht deklaratën e vizitorit, në lidhje me politikat e mbrojtjes së fëmijëve.	8.1 Nga diskutimi me fëmijët rezulton se ata janë në gjendje të takohen privatisht me vizitorët dhe punonjës të tjerë që kanë interes të takohen me to.
XII. Ekziston një dokument i cili përcakton strukturën, numrin, procesin e përzgjedhjes dhe të rekrutimit të punonjësve. Njëpërmjet programeve të trajnimit zhvillohen kompetencat e përgjithshme të personelit, si në grup, ashtu edhe individualisht, për realizimin e deklaratës së qëllimit. Programet janë të akredituara nga strukturat përkatëse përgjegjëse.	Ekziston një procedurë e rregullt dhe e përcaktuar nga ligji për përzgjedhjen e stafit në përputhje me shërbimin që ofron qendra me tipologji shtëpi-familje 6–15 vjeç dhe nevojat e fëmijëve. Sigurohet që fëmijët përfitojnë përkujdesje dhe shërbimet e nevojshme nga një staf kompetent. Çdo qendër ka një rregullore të brendshme, ku janë të përcaktuara rregullat e aktivitetit të përditshëm, detyrat dhe përgjegjësitë e stafit.	1. Dokumente të regjistruara ku paraqiten struktura e stafit dhe numri i tij, procesi i përzgjedhjes dhe rekrutimit, përshkrimi i vendit të punës, kualifikimet e nevojshme, si edhe aftësitë specifike që duhet të ketë personeli dhe vullnetarët në marrëdhëniet me fëmijë dhe të afërmit e tyre.	1.1 Ekzistojnë dokumente që tregojnë për strukturën e personelit dhe shpërndarjen e përgjegjësisë ndërmjet tyre.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

		2. I gjithë personeli, duke përfshirë edhe drejtorin e institucionit, kanë përshtatjet e vendit të punës, ku deklarohen qartë përgjegjësitë, detyrat, si dhe varësia hierarkike.	2.1 Gjatë diskutimit personeli demonstroi se një mirë dhe kupton udhëzuesin e sjelljes.
			2.2 Personeli i një mirë përshtatjet e punës, si edhe kupton se si përgjegjësitë që ka, kontribuojnë për mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve.
		3. Procedurat e punësimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi (Kodi i Punës)	3.1 Personeli emërohet sipas një procesi transparent. Kopje të lajmërimeve për vendin e punës si dhe të dhëna të regjistruara gjatë procesit të përzgjedhjes janë të disponueshme. Përzgjedhje e kujdesshme e personelit, jo vetëm kualifikim i duhur, por edhe balancë gjinore për t'iu përshtatur edhe numrit dhe gjinisë së fëmijëve.
			3.2 Çdo punonjës ka një kontratë pune të nënshkruar.
		4. Ofrohen programe trajnimi për personelin. Trajnimi i parë (trajnim induksioni) lidhur me vendin e punës ofrohet për personelin e ri brenda muajit të parë nga emërimi i tij.	4.1 Ekzistojnë paketa për trajnimin e induksionit për stafin e ri.
			4.2 Personeli ka dijeni për mundësitë për trajnim, si edhe inkurajohet që të marrë pjesë në këto trajnime.
			4.3 Për çdo person të personelit ka nga një vërtetim për çdo trajnim të kryer. Bëhet një identifikim periodik i nevojave për trajnim që ka secili.
		5. Sistemi i vlerësimit të performancës së stafit dhe i monitorimit të punës.	5.1 Ekzistojnë dhe zbatohen procedurat e vlerësimit të performancës dhe të monitorimit të punës së personelit.
			5.2 Ka dokumente që provojnë se vlerësimi dhe monitorimi kryhen sistematikisht.
			5.3 Personeli një të drejtat dhe detyrat funksionale, si dhe autoritetin që mbikëqyr cilësinë e punës.

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 335, datë 14.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR NDALIMIN E REKLAMIMIT TË USHQIMEVE TË PASHËNDETSHME NË MJEDISËT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË ARSIMIT BAZË”¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 46, të ligjit 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar; të gërme “d”, të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

URDHËROJNË:

1. Miratimin e rregullore “Për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet në varësi të tyre, strukturat rajonale, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Ogerta Manastirliu

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Evis Kushi

RREGULLORE

PËR NDALIMIN E REKLAMIMIT TË USHQIMEVE TË PASHËNDETSHME NË MJEDISËT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË ARSIMIT BAZË

Neni 1

Qëllimi dhe synimi i Rregullore

1. Rregullorja për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë, këtu e në vijim, referuar në këtë dokument si “Rregullorja”, ka për qëllim të përcaktojë rregullat e ndalimit të reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë, në kuadër të luftës kundër kequshqyerjes.

2. Rregullorja synon të realizojë mbrojtjen e shëndetit e të mirëqenies së fëmijës nga informacione e materiale që i dëmtojnë ato.

Neni 2

Qasja dhe parimet

1. Rregullorja bazohet në qasjen e sistemit të integruar të mbrojtjes së nxënësve nga mosha 6–15 vjeç, të cilët ndjekin arsimin bazë.

2. Parimet e përgjithshme të sigurimit të të drejtave të fëmijës dhe, në veçanti, parimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe interesit parësor të nxënësit, qëndrojnë në themel të Rregullore.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 165*. Tiranë 2021. f. 15092.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 3

Baza ligjore dhe përkufizimet

1. Rregullat e përcaktuara në Rregullore bazohen dhe kanë për qëllim të plotësojnë kuadrin ligjor në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës për sa i përket mbrojtjes së shëndetit, luftës kundër kequshqyerjes dhe realizimit të mbrojtjes së shëndetit e mirëqenies nga informacione e materiale që i dëmtojnë apo i vendosin në rrezik ata.

2. Kjo Rregullore synon të plotësojë dhe rregullimet e legjislacionit për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, si edhe legjislacionin për mediat audiovizuale, në lidhje me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare që shoqërojnë ose përfshihen në programet për të mitur, të ushqimeve e pijeve që përmbajnë substanca të dëmshme ose të padobishme për shëndetin fizik të fëmijëve, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, acidi yndyror, kripe, sode e sheqeri, që janë tej normave të lejuara për një dietë ushqimore të shëndetshme për fëmijët.

3. Termi “reklamë”, nënkupton çdo mesazh, përmbajtja e të cilit kontrollohet drejtpërdrejt ose jo nga reklamuesi, i shprehur në çdo gjuhë dhe i komunikuar në çdo formë, dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikon në zgjedhjen, mendimin e sjelljen e atyre të cilëve u drejtohet.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore zbatohet në të gjithë territorin dhe është e detyrueshme për të gjitha institucionet arsimore të arsimit bazë, publike e private.

2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha reklamat që reklamohen në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë.

Neni 5

Ushqimet e pashëndetshme

1. Konsiderohen ushqime të pashëndetshme ato me përmbajtje të lartë yndyre, acidi yndyror, kripe, natriumi e sheqeri që janë tej normave të lejuara, sipas përshkrimeve e normave të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.

2. Në zbatim të kësaj Rregulloreje, është e ndaluar që në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë të reklamohen ushqime që përfshihen në shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Masat për zbatimin e Rregullores

1. Njësia bazë zbatuese e kësaj Rregulloreje është institucioni arsimor, i cili ka përgjegjësinë kryesore për njohjen e zbatimit e saj.

2. Institucioni arsimor ka për detyrë të sigurojë që nxënësit që ndjekin arsimin bazë nuk janë të ekspozuar ndaj asnjë reklame ushqimesh të pashëndetshme përgjatë kohës së frekuentimit të institucionit arsimor.

3. Në rast të ekzistencës së një reklame ushqimesh të pashëndetshme, institucioni arsimor duhet të marrë menjëherë masa për heqjen e reklamës dhe njëkohësisht të njoftojnë menjëherë ministrinë përgjegjëse për arsimin, e cila vë në dijeni strukturat përgjegjëse.

4. Në rast të ekzistencës së një reklame ushqimesh për të cilën institucioni arsimor nuk është i sigurt nëse ushqimi që reklamohet është i pashëndetshëm, ai duhet të njoftojë menjëherë ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe të konsultohet me strukturat rajonale të shëndetit publik.

5. Në mbështetje të qëllimit të kësaj Rregulloreje, institucionet arsimore të arsimit bazë duhet të angazhohen vetë dhe/ose në bashkëpunim me institucionet e strukturat e tjera të zhvillojë e zbatojë veprimtari për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të prindërve për ushqyerjen e shëndetshme.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 7

Raportimi i rasteve të reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme

1. Reklamimi i ushqimeve të pashëndetshme nga ana e subjekteve tregtare që prodhojnë dhe/ose tregtojnë ato ushqime, si edhe nga ana e reklamuesve, nëse nuk është i njëjti subjekt, raportohet sipas legjislacionit përkatës.

2. Është përgjegjësi e ministrisë përgjegjëse për arsimin që të njoftojë menjëherë strukturat përkatëse në ministrinë përgjegjëse për ushqimin në rast të reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e shkollave, sipas informacionit të dërguar nga institucioni arsimor.

Shtojca 1

LISTA E USHQIMEVE TË PASHËNDETSHME

1. Ëmbëlsira:

- çokollatë dhe produkte çokollate (çokollatë e thjeshtë ose e bardhë, vezë të mbushura me çokollatë, çokokrem);
- produkte të veshura me çokollatë (p.sh.: biskota pjesërisht ose plotësisht të veshura, fruta ose arra të veshura me çokollatë, akullore dhe drithëra të veshura me çokollatë);
- ëmbëlsirë, përfshirë ëmbëlsirat “pa sheqer” (p.sh.: çamçakëz, xhelatina, likuiricia, karamele të çdo lloji përfshirë: menta, lëpirëse sheqeri, ëmbëlsira me sherbet, *marshmallows*, dhe ëmbëlsira të tjera);
- çokollatë, kos ose fruta të thata dhe arra të veshura me sheqer;
- bareta drithërash, ëmbëlsira me fruta të përpunuara.

2. Ushqime të skuqura

Ushqime të skuqura, përfshirë produktet e skuqura thellë në procesin e prodhimit. Kjo përfshin për shembull: patatina, salsicë të skuqura, kofshë pule të skuqura, petulla etj.

3. Ushqime të aromatizuara (*savory snacks*):

Ushqime të aromatizuara me përmbajtje yndyre, yndyre të ngopur, natriumi dhe sheqeri mbi kriteret e mëposhtme:

- madhësi paketimi të barabartë ose më të madhe se 25 g;
- 22 g ose më shumë yndyrë për 100 g;
- 2 g ose më shumë yndyrë të ngopur për 100 g;
- 0.6 g ose më shumë natrium për 100 g;
- 3 g sheqer ose më shumë në total për 100 g;

4. Pijet e mëposhtme:

- pijet freskuese (me ose pa gaz), duke përfshirë ujëra me aromë;
- pijet e cilësuar si “pa sheqer” (me ose pa gaz) përfshirë ujërat me aromë;
- pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar;
- lëngjet e frutave të ëmbëltuara me sheqer të shtuar;
- lëngjet e perimeve me sheqer ose kripë të shtuar;
- lëngjet e ëmbla të koncentruara, të bëra ose të aromatizuara me lëngje frutash, të cilat hollohen për të bërë një pije;
- qumësht i plotë;
- pijet energjike.

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 336, datë 14.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR STANDARDET E USHQIMIT NË MJEDISËT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE”¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 46, të ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar; të nenit 39, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 165*. Tiranë 2021. f. 15094.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

mbrojtjen e fëmijës”; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

URDHËROJNË:

1. Miratimin e rregullore “Për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, institucionet e tyre në varësi, strukturat rajonale, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

**MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Evis Kushi**

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ikononi**

RREGULLORE PËR STANDARDET E USHQIMIT NË MJEDISËT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe synimi i Rregullores

1. Rregullorja “Për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”, këtu e në vijim, referuar si “Rregullorja”, ka për qëllim të sigurojë standardet më të larta të shëndetit të fëmijës, duke përcaktuar standardet e ushqimit në institucionet arsimore dhe duke siguruar bashkëpunim efektiv të institucioneve të ngarkuara nga legjislativi në fuqi me detyra e përgjegjësi për zbatimin dhe kontrollin e përmbushjes së këtyre standardeve në mjediset e institucioneve arsimore.

2. Rregullorja synon të garantojë të drejtën e fëmijës për arsimim cilësor dhe kujdes shëndetësor, me anë të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme, në çdo rast apo mënyrë të ofrimit të ushqimit në institucionet e arsimit parauniversitar.

3. Kjo Rregullore synon të rregullojë në mënyrë të unifikuar standardet e ofrimit të ushqimit në institucionet arsimore dhe, për këtë arsye, përfshin edhe listën e ushqimeve të lejuara dhe atyre të ndaluara.

Neni 2

Qasja dhe parimet

1. Rregullorja bazohet në qasjen e sistemit të integruar të mbrojtjes së nxënësve të cilët ndjekin arsimin parauniversitar.

2. Në themel të Rregullores qëndrojnë parimet e përgjithshme të sigurimit të të drejtave të fëmijës dhe,

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

në veçanti, parimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe e drejta për të pasur zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral e social, parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe të ndarjes së përgjegjësisë ndërmjet prindit/kujdestarit dhe autoriteteve shtetërore.

Neni 3

Baza ligjore dhe përkufizimet

1. Rregullat e përcaktuara në Rregullore bazohen dhe kanë për qëllim të plotësojnë kuadrin ligjor në fushën e shëndetit publik, të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, mbrojtjes së shëndetit, të drejtës për arsimim, ushqimit, sigurisë ushqimore, kushteve të përgjithshme e të veçanta të higjienës, si dhe të etiketimit e informacionit ushqimor.

2. Termat e përdorur në këtë Rregullore përputhen me përkufizimet dhe përdorimet e tyre në legjislacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Termi “ushqim”, kudo ku përdoret në këtë Rregullore, është çdo substancë ose produkt i përpunuar, pjesërisht i përpunuar ose i papërpunuar, i përcaktuar të jetë ose, për ndonjë arsye, është i konsumueshëm për njerëz. Termi “ushqim” përfshin, gjithashtu, pijet, çamçakëzin, aditivët ushqimorë dhe çdo substancë tjetër që, në mënyrë të qëllimshme, bëhet pjesë e ushqimit gjatë përpunimit, përgatitjes ose trajtimit. Termi “ushqim” përfshin edhe ujin:

- a) të përdorur si ujë të pijshëm për furnizimin publik të popullsisë;
- b) të përdorur dhe/ose të bashkuar në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij;
- c) të paketuara si ujë tryeze, ujë mineral dhe ujë burimi.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore zbatohet në të gjithë territorin dhe është e detyrueshme për të gjitha institucionet arsimore të arsimit parauniversitar.

2. Kërkesat dhe rregullat e Rregullores do të zbatohen në çdo rast të ofrimit të ushqimit në institucionet arsimore, pavarësisht frekuencës e masës së ushqimit të ofruar ose mënyrës së realizimit, nëse përgatitet në mensën e institucionit arsimor parauniversitar.

3. Rregullat që lidhen me përshtatjen e mjediseve shkollore dhe me kushtet e higjienës, zbatohen në çdo rast të konsumimit të ushqimit në shkolla, edhe kur nxënësit e sjellin ushqimin me vete.

KREU II

ASPEKTET USHQIMORE DHE KËRKESAT PËR MJEDISËT E PËRCAKTUARA

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme

1. Fëmija duhet të ketë në dispozicion ujë të pijshëm përgjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucionin arsimor, mundësisht nëpërmjet furnizimit nga rrjeti.

2. Mjediset e përcaktuara për përgatitjen, shërbimin dhe/ose konsumimin e ushqimit në institucionin arsimor duhet të jenë të veçanta, të përshtatura për këtë qëllim e të përmbushin standardet e kërkesat higjieno-sanitare.

3. Pavarësisht formës e mënyrës së ofrimit të ushqimit në institucionin arsimor, produktet e ofruara duhet të përmbushin kërkesat ligjore, në lidhje me karakteristikat teknologjike, përbërësit, afatin e ruajtjes, gjendjen e ruajtjes, zinxhirin e furnizimit, paketimin dhe etiketimin.

4. Forma, mënyra dhe oraret e ofrimit të ushqimit në institucionet arsimore vendosen në bazë institucioni arsimor, në përputhje me kushtet infrastrukturore dhe mundësitë që ka secili institucion.

Neni 6

Ushqimet e lejuara dhe ato të ndaluara

1. Lista e ushqimeve të lejuara për t'u furnizuar e shërbyer në mjediset e institucioneve arsimore jepet në shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Në zbatim të kësaj Rregulloreje është e ndaluar që në mjediset e shkollave të furnizohen dhe/ose të ofrohen ushqime të cilat përfshihen në shtojcën 2, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Dieta

1. Standardet e ushqimit i referohen një diete të ekuilibruar, të shumëllojshme, korrekte, por edhe të këndshme e të pranueshme nga pikëpamja e shijes dhe e pamjes.

2. Dieta ushqimore u referohet sasive të rekomanduara për energji dhe vlera të përzgjedhura ushqyese që kanë nevojë fëmijët sipas grupmoshave, të përcaktuara në shtojcën 3, bashkëlidhur e pjesë e kësaj Rregulloreje.

3. Lidhur me menaxhimin e alergjive ose intolerancave ndaj ushqimit, institucionet arsimore dhe furnizuesit e ushqimit duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me prindërit/kujdestarët për të mbështetur fëmijët/nxënësit me alergji ose intolerancë, të konfirmuar nga mjeku.

Neni 8

Menyja

1. Menyja duhet të përpunohet sipas parimeve të një diete të ekuilibruar nga pikëpamja ushqyese, e cila duhet të përgatitet me ushqime tipike dhe të stinës, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe traditave të ushqimit.

2. Menytë duhet të jenë të veçanta për periudhat vjeshtë–dimër dhe pranverë–verë, me qëllim që t'u përshtaten ndryshimeve të nevojave fiziologjike sipas stinëve, por dhe për të përfutur nga disponueshmëria e frutave e perimeve të stinës.

3. Vlerësimi i energjisë dhe lëndëve ushqyese të menysë përlogaritet në bazë të njësisë javë.

4. Menytë duhet të rifreskohen me një frekuencë prej të paktën 2 (dy) javësh, në mënyrë që të përfshijnë larmi recetash dhe të shmangen përsëritjet e shpeshta të tyre.

5. Përgatitja e menysë, informimi paraprak me përmbajtjen e saj dhe përmbushja e saj janë përgjegjësi e stabilimentit ushqimor që është ngarkuar me përgatitjen e ushqimit në varësi të skemës së furnizimit të përzgjedhur për një institucion arsimor të caktuar.

KREU III

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

Neni 9

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Kjo Rregullore realizon bashkëveprimin efektiv ndërinstitucional, për ofrimin me standarde të ushqimit në institucionet arsimore, me qëllim ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve dhe promovimin e zakoneve dhe sjelljeve të shëndetshme të ushqyerjes përgjatë gjithë jetës.

2. Zbatimi i kësaj Rregulloreje ka në qendër fëmijën, bazohet në bashkëpunimin efektiv ndërinstitucional dhe kërkon mbështetjen e bashkëpunimin e aktorëve të tjerë të rëndësishëm, si: prindërit, komuniteti dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Njësia bazë zbatuese e kësaj Rregulloreje është institucioni arsimor, i cili ka përgjegjësinë kryesore për përmbushjen e standardeve të ushqimit në mjediset e shkollave, ndërsa ndërveprimi i institucioneve të tjera të përfshira mbështet, lehtëson dhe monitoron zbatimin në praktikë të këtyre standardeve.

Neni 10

Përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë

Në kuadër të mbrojtjes së shëndetit të fëmijës e të drejtës për të gëzuar standardet më të larta të mundshme për mbrojtjen e tij, si dhe të drejtës për kujdes shëndetësor dhe në zbatim të legjislacioni për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe legjislacioni për mbrojtjen e shëndetit publik, ministria përgjegjëse për shëndetësinë angazhohet:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) të bashkërendojë punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për ofrimin me standarde të ushqimit në shkolla, në kuadër të sigurimit të standardeve më të larta të mundshme të shëndetit të fëmijës;
- b) të angazhojë institucionin përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës që vetë ose nëpërmjet punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës, të zhvillojë e të zbatojë veprimtari për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve për ushqyerjen e shëndetshme, si dhe veprimtari edukimi e trajnimi për personelin e angazhuar me ofrimin e ushqimit në shkolla, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- c) të miratojë rregullore higjieno-sanitare për mjediset e ofrimit dhe/ose konsumimit të ushqimit në shkolla;
- ç) të angazhojë Institutin e Shëndetit Publik dhe strukturat rajonale të shëndetit publik për të ofruar asistencë dhe udhëzime për përgatitjen e menyre në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe për të organizuar fushata ndërgjegjëse për fëmijët e prindërit/kujdestarët;
- d) të angazhojë Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për monitorimin e vazhduar të përmbushjes së standardeve të ushqimit në institucionet arsimore.

Neni 11

Përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për arsimin

Në kuadër të drejtës së fëmijës për arsim cilësor dhe në zbatim të legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe legjislacionit për sistemin arsimor parauniversitar, ministria përgjegjëse për arsimin angazhohet:

- a) të rishikojë standardet e kriteret për infrastrukturën shkollore;
- b) të rishikojë rregulloren-tip për institucionet arsimore, në përputhje me kërkesat e rregullimet e kësaj Rregulloreje;
- c) të rishikojë kurrikulat, me qëllim zgjerimin e trajtimit të çështjeve që lidhen me ushqyerjen e shëndetshme dhe përfitimet prej saj;
- ç) të ngarkojë institucionet e varësisë me njohjen e zbatimit të këtyre standardeve, në rastet e ofrimit në institucionet arsimore të mallrave e shërbimeve që lidhen me ushqimin në mjediset e shkollave;
- d) të ngarkojë administratorë të menaxhimit të ofrimit të ushqimit në shkolla nga personeli ekzistues brenda institucioneve arsimore ose të planifikojë e të emërojnë personel të dedikuar për këtë qëllim;
- dh) të marrë masa për trajnimin e personelit arsimor e mbështetës për njohjen e përmbushjen e këtyre standardeve;
- e) të planifikojë dhe të propozojë buxhete të përshtatshme që marrin në konsideratë plotësimin e standardeve të ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore.

Neni 12

Përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për ushqimin

Në zbatim të legjislacionit për ushqimin dhe etiketimin e informacionin ushqimor, ministria përgjegjëse për ushqimin merr përsipër të angazhojë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe drejtoritë rajonale për të mbështetur institucionet përgjegjëse për përmbushjen e standardeve të ushqimit në institucionet arsimore dhe për të kryer kontrolle zyrtare për verifikimin e përmbushjes së këtyre standardeve.

Shtojca 1

LISTA E USHQIMEVE TË LEJUARA PËR T'U FURNIZUAR E OFRUAR NË MJEDISET E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

A. Ushqimet që mund të ofrohen në institucionet arsimore:

- fruta të freskëta (frut i plotë ose në pjesë);
- fruta të konservuara në lëng natyral;
- perime të papërpunuara.

B. Ushqime që mund të sigurohen vetëm nëse plotësohen kriteret specifike:

- Fruta të thata* (pa sheqer ose kripë të shtuar).

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

*Megjithëse frutat e thata (pa sheqer/kripë të shtuar) mund të ofrohen jashtë vaktit të drekës në shkollë, preferohet të kufizohet disponueshmëria e tyre në vaktet e ngrënies. Frutat e thata janë një burim i përqendruar i sheqerit. Ekspozimi i shpeshtë i sheqerit dëmton dhëmbët.

- Ushqime të aromatizuara që kanë sasi të reduktuar të disa elementeve ushqimore. Këtu përfshihen, për shembull: patatina e produkte të ngjashme me patatinat, kokoshka të kripura ose të ëmbëlsuara, krakers orizi, ëmbëlsira me tërshërë, grisini me ose pa fara.

Kriteret: Lejohen vetëm *snack*-e të parapaketuara:

- me madhësi paketimi jo më shumë se 25 g;
- jo më shumë se 22 g yndyrë për 100 g;
- jo më shumë se 2 g yndyrë për 100 g;
- jo më shumë se 0.6 g natrium për 100 g;
- jo më shumë se 3 g sheqer në total për 100 g.

C. Pijet që lejohen të ofrohen në institucionet arsimore janë:

1. Uji i pijshëm i rrjetit duhet të jetë i disponueshëm.

- Nxënësit duhet të kenë qasje të lehtë në çdo kohë në ujë të pijshëm falas dhe të freskët.

2. Pije të tjera që lejohen të ofrohen:

- ujë mineral (natyral ose i gazuar);
- qumësht i skremuar, gjysmë i skremuar ose qumësht tjetër me yndyrë të ulët.

Kriteret:

- jo më shumë se 1.8 g yndyrë totale për 100 ml;
- jo më shumë se 5 g sheqerna totale për 100 ml;
- jo më shumë se 10 g sheqerna totale për madhësinë e porcionit.

3. Pije të tjera që lejohen të sigurohen, nëse plotësohen kriteret specifike:

Pije me bazë qumështi dhe kosi të pijshëm, të ftohta ose të ngrohta, si çokollatë ose kakao e nxehtë, *milkshakes* dhe *smoothies* të bëra me kos ose qumësht.

Kriteret:

- jo më shumë se 1.8 g yndyrë totale për 100 ml;
- jo më shumë se 10 g sheqerna totale për 100 ml;
- jo më shumë se 20 g sheqerna totale për racion.

4. Pije të pasuruara me kalcium (p.sh., soje ose tërshërë), një alternativë për fëmijët me alergji nga qumështi i lopës.

Kriteret:

- jo më shumë se 1.8 g yndyrë totale për 100 ml;
- jo më shumë se 5 g sheqerna totale për 100 ml;
- jo më shumë se 10 g sheqerna totale për madhësinë e porcionit.

5. Çaj dhe kafe.

Kriteret:

- Çaji dhe kafja mund të zvogëlojnë sasinë e hekurit që absorbohet nga ushqimi. Prandaj këshillohet që këto pije të mos u shërbehen fëmijëve të vegjël, marrja e hekurit e të cilëve mund të jetë e ulët për shkak të mungesës së oreksit.

6. Lëngje frutash dhe lëngje perimesh, me kusht që madhësia e racionit të mos jetë më shumë se 200 ml.

Kriteret:

- çdo varietet i lëngut të frutave i pa ëmbëltuar;
- çdo varietet i lëngut të perimeve i pakriposur.

7. Një përzierje që përmban cilindo nga përbërësit e mëposhtëm, ose vetëm ose në kombinim, pa sheqer ose kripë të shtuar dhe një madhësi maksimale të racionit prej 200 ml:

- fruta;
- perime;
- lëngje frutash;
- lëngje perimesh.

8. Pije nga kombinimi i ujit me lëngje frutash dhe/ose lëngje perimesh.

Pije të bëra me një kombinim të ujit mineral, të pagazuar ose të gazuar, dhe lëng frutash dhe/ose perimesh.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Kriteret:

- pa sheqer të shtuar;
- jo më shumë se 20 g sheqer për madhësi të racionit;
- 50% ose më shumë lëng frutash ose perimesh;
- jo më shumë se 200 ml porcioni.

Shtojca 2

LISTA E USHQIMEVE TË NDALUARA PËR TË FURNIZUAR E OFRUAR NË MJEDISËT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Nuk lejohet të ofrohen ushqimet e mëposhtme:

1. Kripë tryeze dhe përbërës të tjerë:

- kripë shtesë nuk duhet të sigurohet në shkollë;
- nëse ka në dispozicion aromatizues, ato duhet të shpërndahen vetëm në porcione jo më shumë se 10 ml /pjesë (si p.sh.: *ketchup* domatesh, majonezë, mustardë etj.).

2. Ëmbëlsira të paketuara:

- Çokollatë dhe produkte çokollate (çokollatë e thjeshtë ose e bardhë, vezë të mbushura me çokollatë, çokokrem);
- Produkte të veshura me çokollatë (p.sh.: biskota pjesërisht ose plotësisht të veshura, fruta ose arra të veshura me çokollatë, akullore dhe drithëra të veshura me çokollatë);
- Ëmbëlsirë duke përfshirë ëmbëlsirat pa sheqer (p.sh.: çamçakëz, xhelatina, likuiricia, karamelle të çdo lloji përfshirë menta, lëpirëse sheqeri, ëmbëlsira me sherbet, *marshmallows*, dhe ëmbëlsira të tjera);
- Çokollatë, kos ose fruta të thata dhe arra të veshura me sheqer;
- Bareta drithërash, ëmbëlsira me fruta të përpunuara.

3. Ushqime të skuqura:

Ushqime të skuqura, përfshirë produktet e skuqura thellë në procesin e prodhimit. Kjo përfshin, për shembull: patatina, salsicë të skuqura, kofshë pule të skuqura, petulla, etj.

4. Ushqime të aromatizuara (*savory snacks*):*

Ushqime të aromatizuara me një përmbajtje yndyre, yndyre të ngopur, natriumi dhe sheqeri mbi kriteret e specifikuar në aneksin 1, dhe në një madhësi paketimi më të madhe se 25 g.

*Megjithatë *snacks* mund të përmbushin kriteret specifike të mësipërme, shkollat duhet të marrin në konsideratë të veçantë vendosjen dhe disponueshmërinë e ushqimeve të tilla, p.sh. në makinat e shitjes, pasi këto produkte nuk lejohen të ofrohen gjatë shërbimit të vaktit të drekës në shkollë.

Nuk lejohet të ofrohen pijet e mëposhtme:

- pijet freskuese (me ose pa gaz) duke përfshirë ujëra me aromë (përfshirë i vetëm janë pijet e kombinuara që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën C, të shtojcës 1);
- pijet e cilësuara si “pa sheqer” (me ose pa gaz) përfshirë ujërat me aromë;
- pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar;
- lëngjet e frutave të ëmbëltuara me sheqer të shtuar;
- lëngjet e perimeve me sheqer ose kripë të shtuar;
- lëngjet e ëmbla të koncentruara, të bëra ose të aromatizuara me lëngje frutash, të cilat hollohen për të bërë një pije;
- qumësht i plotë;
- pijet energjike.

Shtojca 3

SASI E REKOMANDUARA PËR ENERGJINË, LËNDËT USHQYESE DHE FIBRAT PËR NJË VAKT DREKE SIPAS GRUPMOSHAVE

Sasia e rekomanduar	Mosha (vjeç)	
	5–10	11–15
Energjia në kcal (35% e energjisë ditore)	520–810	700–830
Proteina (g) 10–15% e energjisë së vaktit	13–30	18–31
Raporti proteinë shtazore kundrejt bimore	0.66	

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Yndyrat (g) 30% e energjisë së vaktit	18–27	23–28
Yndyra të ngopura	6–9	8–9
Karbohidratet (g) (55-60% e energjisë së vaktit)	75–120	95–125
Sheqer i thjeshtë	13–30	18-31
Hekur (mg)	6	9
Kalcium (mg)	350	420
Fibra (g)	6	7.5

Pjesa e trete

DREJTËSIA PENALE PËR TË MITUR

LIGJ

Nr. 37/2017

KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR¹

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (në vijim Kodi) përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

2. Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta të tij.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij Kodi është:

1. Të garantojë një kuadër ligjor mbi drejtësinë penale për të mitur që është në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit.

2. Të promovojë riintegrimin e të miturit në konflikt me ligjin penal dhe që i mituri të luajë në shoqëri një rol sa më të dobishëm.

3. Të garantojë rishoqërimin dhe rehabilitimin e të miturit që ka kryer vepër penale.

4. Të mbrojë të drejtat e të miturit në rastet kur është dëshmitar dhe/ose viktimë e veprës penale.

5. Të parandalojë riviktimizimin dhe viktimizimin e dytë të të miturit, i cili më parë ka qenë viktimë e një veprë penale.

6. Të parandalojë përsëritjen e veprave penale prej të miturit.

7. Të mbrojë parimet e rendit publik në procesin e administrimit të drejtësisë penale për të mitur.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 92*. Tiranë 2017. f. 5210.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

8. Të rrisë përgjegjshmërinë dhe profesiona-lizmin e organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur.

9. Të garantojë masa edukative dhe parandaluese për të miturit që kryejnë vepra penale dhe të sigurojë ngritjen e mekanizmave mbikëqyrës për zbatimin e tyre.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Alternativë e dënimit me burgim” është masa që mund të vendoset ndaj të miturit nga organi kompetent i sistemit të drejtësisë penale në të gjitha fazat e tij, të cilat nuk konsistojnë në kufizimin/heqjen e lirisë.

2. “Drejtësi penale për të mitur” janë procedura që lidhen me veprat penale, duke përfshirë hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e dënimit, çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar të një vepre penale.

3. “I mitur” është çdo person nën moshën 18 vjeç.

4. “I mitur në konflikt me ligjin” është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

5. “I mitur viktimë” është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një vepre penale.

6. “I mitur dëshmitar” është çdo person nën 18 vjeç, i cili mund të ketë informacion lidhur me veprën penale.

7. “I ri” është çdo person nga mosha 18 deri në 21 vjeç që akuzohet për kryerjen e një vepre penale, kur ka qenë i mitur.

8. “I afërm” është personi që ka lidhje të afërt familjare, gjinie ose krushqie me të miturin.

9. “Interes më i lartë i fëmijës” nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

10. “Informacion” nënkupton çdo të dhënë që është e përshtatshme dhe e kuptueshme për moshën dhe arsyetimin e të miturit dhe që jepet për t’i mundësuar atij të ushtrojë plotësisht të drejtat, përveçse kur dhënia e këtij informacioni është në kundërshtim me interesin më të lartë të të miturit.

11. “Moshë minimale e përgjegjësisë penale” është mosha 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe mosha 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale të parashikuar nga Kodi Penal.

12. “Masë e drejtësisë restauruese” është çdo masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigjojë pasojat e një vepre penale, të kompensojë dëmet dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, ku i mituri që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e një vepre penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur.

13. “Ndërmjetësim” është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

14. “Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” është struktura për mbrojtjen e të miturit në nivel vendor, sipas ligjit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

15. “Organ kompetent/pjesëmarrës në administrimin e drejtësisë penale për të mitur” është, sipas rastit, gjyqtari, prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore, punonjësi i policisë së shtetit, avokati, psikologu, punonjësi social, ndërmjetësi, punonjësi i Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe të shërbimit të provës, punonjësi i institucionit të rehabilitimit të të miturve dhe paraburgimit e burgjeve, si dhe çdo struktura/zyrtar tjetër që përfshihet në këtë proces, të cilët ushtrojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e parashikuara në këtë Kod dhe që janë të trajnuar dhe specializuar në çështjet penale me të mitur dhe të rinj.

16. “Përfaqësues ligjor” është prindi, i afërmi ose kujdestari i të miturit, i cili merr pjesë në procedurën e drejtësisë penale për të mitur për të mbrojtur interesat e të miturit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

17. “Përfaqësues procedural” është personi në kuptimin e përcaktuar në ligjin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës që do të kryejë përfaqësimin procedural të të miturit, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

18. “Person i besuar” është personi madhor i kërkuar nga i mituri dhe i pranuar nga organi kompetent, i cili shoqëron të miturin në fazat e procedimit penal.

19. “Qendër/institucion për rehabilitimin e të miturit” është një strukturë ose program ku vendoset i mituri i dënuar ose jo, e cila është e pajisur me infrastrukturën dhe personelin e duhur për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturit dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

20. “Riviktimizim” është shkaktimi i dëmit të miturit viktimë e veprës penale, si pasojë e një veprë penale të re që ka lidhje me të parën.

21. “Rishoqërizimi/rehabilitimi” është inkura-jimi dhe zhvillimi, në kuptim të përgjegjësisë së të miturit, e ndjenjës së respektimit të të drejtave të të tjerëve, për të nxitur dhe mundësuar zhvillimin e shëndoshë fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të të miturit dhe për ta përgatitur atë që të rikthehet në shoqëri.

22. “Stimul” janë disa përfitime shtesë, përveç atyre që i mituri gëzon rregullisht, të cilat jepen për shkak të sjelljes së mirë dhe të respektimit të programit të rehabilitimit dhe riintegrit.

23. “Shmangie” është masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të këtij Kodi;

24. “Viktimizimi i dytë/i përsëritur” është gjendja kur një të mituri viktimë e veprës penale mund t’i shkaktohet dëm, si rezultat i pjesëmarrjes në procesin e drejtësisë penale.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Ky Kod zbatohet vetëm për procedurën e administrimit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, si dhe për të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë të veprave penale.

2. Në rastet e parashikuara në nenin 27, pika 5, të këtij Kodi, ky Kod zbatohet edhe për një person të moshës nga 18 deri në 21 vjeç, nëse ky është i pandehur për një veprë penale të kryer kur ka qenë i mitur.

3. Rregullimet e parashikuara në këtë Kod nuk përfshijnë të miturit që kryejnë vepra penale nën moshën e përgjegjësisë penale, ndaj të cilëve nuk fillon procedimi penal ose, nëse ka filluar, pushohet menjëherë. Në këtë rast vihen në lëvizje strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe zbatohen të gjitha masat e parashikuara nga ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, me qëllim që atyre t’u sigurohen të njëjtat garanci procedurale, ndihmë dhe shërbime si për të miturit në konflikt me ligjin/viktimë ose dëshmitar, për sa i përket procesit të marrjes në pyetje dhe kontaktit me organet e policisë dhe prokurorisë.

Neni 5

Raporti me ligjet e tjera

Dispozitat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjeve të tjera, zbatohen në procesin e drejtësisë penale për të mitur vetëm për çështje që nuk janë të rregulluara nga ky Kod ose nëse përmbajnë rregullime më të favorshme për të miturit.

Neni 6

Legjislacioni i zbatueshëm

1. Ky Kod bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe në parimet e njohura në nivel ndërkombëtar lidhur me drejtësinë penale për të miturit.

2. Dispozitat e këtij Kodi nuk mund të interpretohen ose zbatohen në mënyrë që të kufizojnë garancitë dhe Rregullat Standard Mini-mum lidhur me drejtësinë penale për të mitur, si dhe të drejtat e shprehura në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, Acquis të Bashkimit Europian dhe Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Neni 7

Mosha e të miturit

1. Për qëllime të përgjegjësisë penale për krimet, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën 14 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së krimit.

Përmbledhje legjislatoni për të miturit

2. Për qëllime të përgjegjësisë për kundërvajtjet penale, konsiderohet i mitur, personi i cili ka mbushur moshën 16 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së kundërvajtjes penale.

3. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se është i mitur, ai konsiderohet i tillë, në kuptim të këtij Kodi, derisa të përcaktohet mosha e tij.

4. Parashikimet e pikës 2, të këtij neni, zbatohen edhe për rastet e të miturve viktimë ose/dhe dëshmitarë të veprës penale.

KREU II

PARIME TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR

Neni 8

Shtrirja e parimeve të drejtësisë penale për të mitur

1. Parimet e këtij Kodi kanë efekt në të gjithë përmbajtjen e tij dhe zbatohen nga çdo person dhe organ kompetent në të gjitha veprimet dhe vendimet e tyre lidhur me të miturin në konflikt me ligjin, të miturin viktimë ose/dhe dëshmitar i veprës penale.

2. Parimet e këtij Kodi zbatohen edhe në veprimet administrative të policisë dhe të organeve të tjera që kryejnë veprimtari administrative në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur.

Neni 9

Prezumimi i pafajësisë

1. Çdo i mitur në konflikt me ligjin prezumohet i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2. Çdo dyshim për akuzën ndaj të miturit çmohet në favor të tij.

Neni 10

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij Kodi, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit.

2. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatesinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

d) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirëritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

3. Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.

Neni 11

Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi

1. Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatesia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatesia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 12

E drejta për zhvillim harmonik të të miturit

1. Në çdo vendim dhe procedurë lidhur me drejtësinë penale për të mitur mbahet në konsideratë e drejta e të miturit për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

2. Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një arsyetim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është vlerësuar e drejta e të miturit për këtë zhvillim dhe si do të realizohet zbatimi i pikës 1 të këtij neni.

Neni 13

Parimi i proporcionalitetit

Çdo masë e marrë ndaj të miturit në konflikt me ligjin duhet të jetë në raport me rrethanat e kryerjes së veprës penale, personalitetin e të miturit, në përputhje me nevojat që lidhen me moshën, edukimin, arsimimin kushtet personale, familjare, sociale dhe mjedisore, nevojat zhvillimore, si dhe nevoja të tjera të të miturit përfshirë, nëse është rasti, edhe nevojat e veçanta.

Neni 14

Përparësia e masave alternative të shmangies

1. Për arritjen e qëllimeve të këtij Kodi dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje me drejtësinë për të mitur, në procedurën e drejtësisë penale për të mitur përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal.

2. Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, nga çdo organ kompetent, në aktet respektive pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal.

3. Sa herë është e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, shmanget vënja në lëvizje e procedurës penale për të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e të miturit dhe mbrojtja e tij.

4. Çdo masë që përdoret ndaj të miturit si alternativë për shmangien nga procedimi penal, duhet t'i shërbejë qëllimit të mbrojtjes së të drejtave dhe garancive ligjore të të miturit.

Neni 15

Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit

1. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri nuk zbatohet nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë.

2. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri zbatohet në përputhje me parashikimet e këtij Kodi, si dhe në përputhje me legjislacionin procedural penal, për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë Kod.

3. Masat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përdoren vetëm si një masë e fundit, për një kohë sa më të shkurtër, si dhe janë objekt i rishikimit të rregullt periodik nga gjykata.

Neni 16

Pjesëmarrja e të miturit në proces

1. E drejta e pjesëmarrjes në proces përfshin të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij, të cilat mbahen parasysh në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit të të miturit. Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij pranohet, përveçse për arsye të rëndësishme, të cilat arsyetohen në vendimin përkatës. Nëse i mituri nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë, mund ta realizojë atë nëpërmjet prindit si përfaqësues ligjor.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. I mituri, drejtpërdrejt dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, ka të drejtë të marrë pjesë në çdo proces vendimmarrjeje lidhur me të.

3. I mituri nuk mund të detyrohet të marrë pjesë personalisht në proces. Mospjesëmarrja nuk mund të rëndojë pozitën e tij ose/dhe të përdoret në disfavor të tij.

4. Prokurori dhe gjykata krijojnë të gjitha kushtet dhe marrin çdo masë për të nxitur të miturin për të marrë pjesë në procedimin penal ndaj tij, nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit.

5. Çdo veprim i ndërmarrë nga organet kompetente gjatë procesit ku i mituri është pjesëmarrës, kryhet në mënyrë të përshtatur me moshën dhe/ose aftësitë e të miturit për të kuptuar.

6. Përshtatja dhe mbështetja e nevojshme sigurohet përmes mënyrave të parashikuara në aktet ndërkombëtare të ratifikuara lidhur me personat me aftësi të kufizuara, si dhe në ligjin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

7. Në rast se pretendimet e të miturit dhe të përfaqësuesit ligjor/procedural të tij janë kontradiktore, organi kompetent vlerëson pretendimin që i shërben interesit më të lartë të të miturit.

Neni 17

Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi

1. Të gjitha vendimet dhe veprimet e ndërmarra në bazë të këtij Kodi, që nga fillimi i procesit penal deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kryen në mënyrë të shpejtë, me përparësi, pa vonesa të pajustificuara mbi bazën e interesit më të lartë të të miturit dhe duke respektuar të drejtat e tij.

2. Çdo organ kompetent shqyrton në mënyrë të shpejtë, brenda afateve të caktuara në këtë Kod, dhe me përparësi çështjet e të miturve në konflikt me ligjin, si dhe të çështjeve me të mitur viktimë dhe dëshmitar, duke garantuar që procesi penal, në çdo fazë të tij, të mos përkeqësojë traumën e përjetuar nga i mituri dhe që sistemi i drejtësisë penale për të miturit të sigurojë, sipas rastit, gjithë ndihmën e duhur ndaj të miturit.

Neni 18

Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut

1. Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme.

2. Psikologu garanton, sipas rastit, mbështetjen psikologjike të të miturit dhe vlerëson thëniet e tij, në përputhje me zhvillimin mendor.

3. Prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi.

4. Organet kompetente, sipas rastit dhe nëse kjo është e mundur, kujdesen që të sigurojnë praninë e të njëjtit psikolog gjatë gjithë procesit të drejtësisë penale për mitur dhe vetëm nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit.

5. Psikologu, i cili kryen rolin e mbështetësit emocional të fëmijës gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit, nuk mund të caktohet nga gjykata për të marrë rolin e ekspertit, duke përgatitur vlerësim psikologjik për të njëjtin të mitur.

KREU III

TË DREJTAT DHE GARANCITË PROCEDURALE TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Neni 19

Të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin

1. I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në këtë Kod.

2. I mituri ka të drejtë për mbrojtje dhe procedura të veçanta në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale për të mitur.

3. Në çdo fazë të procedimit penal, i mituri gëzon të drejtat e mëposhtme:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- a) të drejtën për ndihmë ligjore dhe psikologjike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;
 - b) të drejtën të informohet menjëherë në formën që i përgjigjet zhvillimit individual të tij;
 - c) të drejtën për një përkthyes falas/ interpretues, në qoftë se nuk e kupton, nuk e flet gjuhën që përdoret ose përdor gjuhën e shenjave;
 - ç) të drejtën që të ketë prindin të pranishëm dhe/ose të drejtën të shoqërohet nga një person i besuar;
 - d) të drejtën të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajësinë;
 - dh) të drejtën që, në kushte të barabarta, të pyesë dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij;
 - e) të drejtën për ndihmë nga shërbimi konsullor;
 - ë) të drejtën për ankim, në çdo fazë të procedimit penal apo gjatë ekzekutimit të vendimit penal;
3. Në rastin e parashikuar nga pika 3, shkronja “ç”, të këtij neni, lidhur me personin e besuar, gjykata ka të drejtë të mos pranojë një person si të besuar në rast se prania e tij ndikon negativisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturit. Në këtë rast gjykata duhet të shprehet me vendim të arsyetuar për shkaqet e mospranimit.

Neni 20

Ndihma ligjore dhe psikologjike e të miturit

1. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur çdo i mitur në konflikt me ligjin ose viktimë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike, pa pagesë, të garantuar nga shteti, sipas legjislacioni përkatës.
2. Dëshmitarit të mitur i garantohet ndihma psikologjike falas kur për këtë të fundit është e nevojshme.

Neni 21

Mbrojtja e jetës private të të miturit

1. E drejta e të miturit për jetë private respektohet plotësisht në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur duke bërë kujdes që të shmangët dëmtimi i tij.
2. Nuk publikohet asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e të miturit në konflikt me ligjin, të të miturit viktimë ose dëshmitar i një veprë penale.
3. Të dhënat mbi dënimet e mëparshme të të miturit nuk bëhen publike.
4. Ndalohet identifikimi ose publikimi në çfarëdoq formë i të dhënave personale të të miturit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat personale për një veprë penale të kryer nën moshën 18 vjeç mund të identifikohen ose të publikohen vetëm me pëlqimin e tij.
6. Përpunimi i të dhënave të të miturve realizohet në përputhje me legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.
7. Shkelja e pikës 4, të këtij neni, përbën veprë penale, sipas parashikimeve të Kodit Penal.

Neni 22

Vlerësimi individual i të miturit

1. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, organi që administron procesin e trajton të miturin me kujdes dhe vëmendje të veçantë.
2. Në çdo vendimarrje në lidhje me të miturin, merren në konsideratë rrethanat individuale të tilla si: moshë, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual.
3. Gjykata/prokurori, përpara marrjes së ndonjë vendimi mbi të miturin, thërret, sipas rastit, një ekspert ose grup ekspertësh të disiplinave të ndryshme për vlerësimin e rrethanave individuale, shëndetësore, familjare, sociale dhe mjedisore të të miturit në mënyrë që të kuptojë personalitetin, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.
4. Në qoftë se gjykata/prokurori, pas përfundimit të vlerësimit individual konstaton se i mituri vuan nga çrregullime të shëndetit mendor, që e bën atë të papërgjegjshëm, i mituri përjashtohet nga përgjegjësia penale dhe, nëse është e nevojshme, vendoset në një institucion mjekësor të pavarur dhe të specializuar, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 23

Shërbimet pa pagesë për të miturit në sistemin e drejtësisë penale

1. Të miturit në konflikt me ligjin ose viktimë përfitojnë pa pagesë shërbimet që ofrohen sipas këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi.
2. Pagesat e këtyre shërbimeve mbulohen nga buxheti i institucioneve dhe ekzekutohen nga institucionet përkatëse, pranë të cilave realizohet shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Procedura e ofrimit të shërbimeve për të miturit në sistemin e drejtësisë penale rregullohet sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë Kod.

Neni 24

Të drejtat e të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale

I mituri viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale gëzon, për aq sa është e mundur, të njëjtat të drejta të parashikuara për të miturin në konflikt me ligjin, parashikuar sipas këtij kreu, si dhe të drejtat e parashikuara në kreun V të këtij Kodi.

KREU IV

TRAJNIMI DHE SPECIALIZIMI I ORGANEVE KOMPETENTE NË PROCESIN E DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR

Neni 25

Specializimi i personave që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur

1. Organet kompetente marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat, të cilët punojnë me të miturit, të kenë njohuritë e nevojshme, ndërgjegjësimin profesional më të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitarë, si dhe marrin të gjitha masat e duhura për qëndrueshmërinë e tyre në këto pozicione pune.
2. Organet kompetente, sipas këtij Kodi, garantojnë dhe sigurojnë që çdo person, i cili ka qenë i dënuar me një vendim të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje ndaj të miturit, ose vepra ndaj dhunës në familje, ndalohet të punojë dhe të ofrojë shërbim ndaj të miturit.
3. Organet kompetente dhe organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për të miturit marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që të sigurojnë që personat që janë dënuar për vepra penale ndaj të miturve të mos kenë asnjë kontakt me të miturin.
4. Personat që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Bëhet përjashtim vetëm në rastet kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhe në rastet e parashikuara lidhur me gjendjen e flagrancës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë rast, personi jo i specializuar, pas marrjes së masave paraprake, njofton menjëherë personin/strukturat e specializuara për të vazhduar këtë proces.
5. Në procedurat me të mitur, organet kompetente sigurojnë që punonjës të specializuar mund të asistojnë të miturin në procesin e drejtësisë penale.
6. Shkelja e pikës 3, të këtij neni, përbën vepër penale, sipas Kodit Penal.

Neni 26

Fushat e trajnimit

1. Çdo person i caktuar nga organi kompetent në administrimin e drejtësisë penale për të mitur trajnohet dhe merr njohuri të posaçme kryesisht lidhur me:
 - a) metodologjinë e komunikimit me miturin në konflikt me ligjin dhe komunikimin me të miturin viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale;
 - b) standardet dhe parimet që garantojnë të drejtat e të miturit;
 - c) parimet dhe detyrimet etike që lidhen me funksionet e tyre;
 - c) shenjat dhe simptomat që tregojnë se është kryer një vepër penale ndaj të miturit;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

d) aftësimin dhe teknikat lidhur me vlerësimin e situatave kritike, vlerësimin e riskut, referimin e rastit dhe garantimin e parimit të konfidencialitetit;

dh) aftësimin lidhur me teknikat e pyetjes së të miturve, psikologjinë e fëmijës dhe komunikimin me fëmijën në një gjuhë të përshtatshme për fëmijën;

e) dinamikën dhe natyrën e ushtrimit të dhunës ndaj të miturit, efektin dhe pasojat, përfshirë atë fizik, psikologjik dhe të nxitjes për kryerjen e veprave penale;

ë) teknikat dhe masat e veçanta për mbështetjen dhe mbrojtjen e të miturit viktimë dhe dëshmitar;

f) metodat e punës së detyrueshme për profesionistët që punojnë me të mitur; si dhe

g) fushat e tjera të ngjashme që lidhen me drejtësinë penale për të miturit.

2. Fushat e trajnimit specifikohen në varësi të detyrave të profesionistëve të organeve kompetente dhe pozitës së të miturit në drejtësinë penale për të mitur. Trajnimi i tyre është i detyrueshëm dhe vazhdues.

Neni 27

Kompetenca e gjyqimit të çështjeve të drejtësisë për të miturit

1. I mituri në konflikt me ligjin gjykohet nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

2. Seksionet janë kompetente edhe për gjykimin e të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë.

3. Gjyqtari i caktuar për gjykimin e të miturit në këto seksione duhet të jetë i specializuar dhe trajnuar për drejtësinë penale për të mitur.

4. Kur një i mitur ka kryer vepër penale së bashku me një të rritur, ai gjykohet në seksionet për të mitur të gjykatave të rretheve gjyqësore, duke zbatuar dispozitat e këtij Kodi, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 80, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale.

5. Personi mbi moshën 18 vjeç, por jo më shumë se 21 vjeç, i cili akuzohet se ka kryer një vepër penale kur ishte i mitur, gjykohet nga seksioni për të mitur.

6. Juridiksioni i seksionit për të mitur të gjykatave të rretheve gjyqësore mbaron kur i mituri arrin moshën 23 vjeç.

Neni 28

Shqyrtimi gjyqësor i rasteve me të mitur

1. Nëse viktimë është i mitur dhe gjykimi në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apelit bëhet me trup gjykues, të paktën një gjyqtar duhet të jetë i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.

2. Në gjykatat e rretheve gjyqësore, në të cilat, për shkak të numrit të gjyqtarëve nuk mund të ngrihet seksioni për të mitur, kur çështja gjykohet nga tri gjyqtarë, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë gjyqtarë i specializuar dhe trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.

Neni 29

Trajnimi dhe specializimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore

1. Ndjekja penale në çështjet e drejtësisë penale për të mitur bëhet nga prokurorë të trajnuar dhe specializuar në këtë fushë.

2. Punonjësit e policisë gjyqësore që trajtojnë çështjet e drejtësisë penale me të mitur trajnohen dhe specializohen në drejtësinë penale për të mitur.

Neni 30

Trajnimi dhe specializimi i punonjësve të Policisë së Shtetit

Veprimet e parashikuara nga ligji për Policinë e Shtetit lidhur me të miturit, kryen nga një punonjës i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 31

Mbrojtësi

1. I mituri në konflikt me ligjin ose viktimë mbrohet nga avokatë të specializuar në drejtësinë për të mitur, me përjashtim të rasteve kur i mituri ose përfaqësuesi i tij ligjor përzgjedh një avokat tjetër.

2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë vë në dispozicion të institucioneve të ndihmës juridike falas një listë të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur.

3. Institucioni që administron ndihmën juridike falas, në rastet e parashikuara me ligj, siguron menjëherë ndihmë ligjore me kërkesën e të miturit ose të çdo organi kompetent. Kur kërkesa bëhet nga i mituri, ajo mund të paraqitet në çdo lloj forme dhe përpara organit kompetent, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 32

Personat e tjerë të specializuar në drejtësinë për të mitur

1. Në sistemin e drejtësisë për të mitur përfshihet punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, psikologu, përfaqësuesi procedural, ndërmjetësi, punonjësi i shërbimit të provës, punonjësi i qendrës së rehabilitimit për të mitur dhe paraburgimit, i specializuar në drejtësinë për të mitur.

2. Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, Urdhri i Psikologut/Punonjësit Social, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Shërbimi i Provës dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe institucione të tjera marrin masa dhe hartojnë programet e trajnimit.

3. Organet kompetente, të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, hartojnë dhe përditësojnë regjistrin e të trajnuarve lidhur me drejtësinë penale për të mitur.

KREU V

I MITURI VIKTIMË DHE I MITURI DËSHMITAR I VEPRËS PENALE

Neni 33

Parime të përgjithshme

1. Organet kompetente, në çështjet me të mitur viktimë dhe/ose dëshmitarë, bëjnë kujdes të veçantë, me qëllim që:

a) i mituri viktimë ose dëshmitar i veprës penale të trajtohet me përkujdesje, në mënyrë miqësore dhe të ndjeshme, të tilla që respektojnë dinjitetin e tij gjatë gjithë procesit, duke marrë në konsideratë gjendjen e tij personale, nevojat e menjëhershme dhe të veçanta, moshën, gjininë, aftësitë e kufizuara, nëse ka, dhe nivelin e pjekurisë;

b) të mbrohet jeta private e të miturit viktimë ose dëshmitar. Ndërhyrja në jetën private të të miturit, nëse është e nevojshme, të jetë në nivelin më të ulët të mundshëm të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që të sigurohen provat e nevojshme të procesit penal;

c) të marrin të gjitha masat që çdo pjesëmarrës në administrimin e drejtësisë për të mitur, i cili ka të dhëna lidhur me të miturin viktimë ose dëshmitar, të jetë i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë për shkak të detyrës ose/dhe gjatë kryerjes së detyrës;

ç) bërja publike e informacionit lidhur me identitetin e të miturit dëshmitar ose viktimë bëhet vetëm me leje të gjykatës.

2. Rregullat lidhur me kontrollin intim dhe mjekësor për të miturin viktimë ose dëshmitar parashikohen në nenin 82, të këtij Kodi, dhe në Kodin e Procedurës Penale për atë që nuk bie në kundërshtim me këtë kod

3. Shkelja e pikës 1, shkronja “c”, të këtij neni, përbën vepër penale, sipas Kodit Penal.

Neni 34

E drejta e të miturit viktimë për t'u informuar

1. Për të parandaluar rrezikun e riviktimizimit dhe viktimizimit të dytë, në veprimet procedurale, në të cilat i mituri është viktimë, merr pjesë përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi dhe psikologu, si dhe, sipas rastit, nëse është e mundshme, edhe personi i besuar i të miturit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Organi kompetent informon menjëherë dhe gjatë gjithë procesit të miturin viktimë, përfaqësuesin e tij ligjor ose procedural dhe mbrojtësin lidhur me:

- a) procedurat e drejtësisë penale për të rritur e për të mitur, përfshirë rëndësinë dhe rolin e të miturit viktimë, kohën e dëshmisë, si dhe mënyrat në të cilat do të kryhet marrja në pyetje gjatë hetimit dhe gjykimit;
- b) mekanizmat mbështetëse për të miturin viktimë për bërjen e ankesës, merrjen pjesë në hetimet dhe procedurat gjyqësore, përfshirë vënien në dispozicion të mbrojtësit të të miturit;
- c) vendin dhe kohën e marrjes në pyetje;
- ç) masat mbrojtëse në dispozicion të të miturit;
- d) mjetet ligjore ekzistuese për rishikimin e vendimeve që sjellin pasoja për të miturin viktimë;
- dh) të drejtat e të miturit viktimë të zbatueshme në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;
- e) mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim nga autori i veprës penale, sipas legjislacionit përkatës;
- ë) programet e drejtësisë restauruese në dispozicion dhe funksionimin e tyre;
- f) mundësinë e shërbimeve përkatëse, të tilla si ato shëndetësore, psikologjike, sociale, financiare dhe ligjore, si dhe mënyrat e përfitimit të tyre.

3. Për rastet e parashikuara nga pika 2, e këtij neni, nëse informimi nuk i është bërë drejtpërdrejtë të miturit nga organi kompetent, ky detyrim përmbushet, sipas rastit, nga përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi procedural ose mbrojtësi i të miturit. Njoftimi i të miturit bëhet në mënyrë të tillë që informacioni të jetë i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për të.

4. Në çdo fazë të procesit, përfaqësuesi ligjor i një dëshmitari/viktimit të mitur ka të drejtë:

- a) të shprehë opinionin e tij lidhur me nevojat e të miturit përpara organit procedural;
- b) të informohet në lidhje me akuzat e ngritura ndaj të pandehurit;
- c) të informohet në lidhje me marrëdhëniet mes të miturit dhe të pandehurit;
- ç) të informohet lidhur me ecurinë e procesit dhe vendimet lidhur me masën e sigurisë që është vendosur ndaj të pandehurit, si dhe lidhur me lirin e të pandehurit ose të dënuarit nga mjediset e burgimit ose të paraburgimit, me përjashtim të rastit kur kjo vë përpara një rreziku real të pandehurit ose të dënuarit;
- d) të bëjë ankim në lidhje me vendimin e dhënë nga gjykata, pavarësisht nëse kjo e drejtë ushtrohet ose jo nga prokurori i çështjes.

5. Gjyqtari gjatë gjykimit dhe prokurori në fazën e hetimeve mund të ndalojnë përfaqësuesin ligjor të një dëshmitari/viktimit të mitur për të marrë pjesë në veprimet procedurale vetëm nëse kjo është e domosdoshme për interesin më të lartë të të miturit.

Neni 35

Detyrat e Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës lidhur me të miturin dëshmitar dhe viktimë

1. Përfaqësuesi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është personi mbështetës në rastet me të miturin dëshmitar dhe viktimë dhe, ndër të tjera, ka për detyrë:

- a) të mbështesë të miturin emocionalisht;
- b) të japë mbështetje gjatë gjithë procesit penal. Kjo ndihmë mund të përfshijë masa për minimizimin e pasojave negative të veprës penale, masa për të ndihmuar të miturin në veprimtarinë e përditshme dhe masa në raport me çështjet administrative që lidhen me rrethanat e rastit konkret;
- c) të këshillojë nëse ndjekja e një terapie ose këshillimi profesional është i nevojshëm;
- ç) të ruajë komunikimin me të afërmit, shokët dhe mbrojtësin e të miturit;
- d) të informojë të miturin lidhur me shërbimet shëndetësore, psikologjike ose sociale si dhe për mënyrat e mundshme të marrjes së këtyre shërbimeve;
- dh) të informojë të miturin për gjendjen e tij procedurale, rëndësinë e dhënies së dëshmisë, kohëzgjatjen, formën, si dhe për rregullat procedurale të pyetjes;
- e) të informojë të miturin për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje dhe zbatimin e veprimeve të tjera procedurale;
- ë) të informojë të miturin për të drejtën për ankim ndaj veprimeve procedurale të parashikuara me ligj;
- f) në bashkëpunim me mbrojtësin ose, në mungesë të tij, në bashkëpunim me të miturin dhe përfaqësuesin ligjor, të shmangë, sipas rastit, kontaktet e papërshtatshme dhe/ose të padëshirueshme për të miturin, mbajtjen në një sallë të veçantë ndërmjet seancave, ose të masave të tjera për mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

g) në bashkëpunim me mbrojtësin ose në mungesë të tij në bashkëpunim me të miturin dhe përfaqësuesin ligjor të kërkojë nga gjykata marrjen e masave mbrojtëse, nëse këto janë të nevojshme;

gj) të kërkojë marrjen e masave të veçanta nëse rrethanat në të cilat ndodhet i mituri këto masa janë të nevojshme.

2. Përfaqësuesi i Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, nëse është caktuar me cilësinë e përfaqësuesit procedural, në rastet e të miturve viktimë dhe dëshmitarë nën 14 vjeç, jep edhe pëlqimin për dhënien e dëshmisë nga ana e të miturit.

Neni 36

Ndihma juridike për të miturin viktimë

1. I mituri viktimë ka të drejtë të mbrohet pa pagesë gjatë gjithë procesit të drejtësisë nga një avokat, të cilin e zgjedh nga lista përkatëse e hartuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

2. Për të miturin shtetas i huaj viktimë dhe dëshmitar zbatohen parashikimet e nenit 51 të këtij Kodi.

Neni 37

Masat mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar

1. Në çdo fazë të procesit penal, kur siguria e të miturit viktimë ose dëshmitar është në rrezik, sipas rastit, prokurori, policia gjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës marrin masa mbrojtëse të tilla si:

a) shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë ose dëshmitar dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit;

b) bërjen e kërkesës për nxjerrjen e një “urdhër-kufizimi” në gjykatë. Në këtë rast kërkesa regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj. Në këtë rast zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e legjislacionit në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare;

c) bërjen e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg” ose “arrest në shtëpi” për të akuzuarin me kushtin e ndalimit të kontaktit me të miturin;

ç) bërjen e kërkesës për marrjen e masave mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar prej policisë ose strukturave të tjera dhe ruajtjen e sekretit të vendndodhjes së të miturit;

d) të marrë ose të kërkojë nga autoritetet kompetente masa të tjera mbrojtëse që konsiderohen të përshtatshme.

2. Gjikata, nëse konstaton rrezik për të miturin viktimë ose dëshmitar, mund të vendosë edhe kryesisht për marrjen e masave të mbrojtjes, të parashikuara në pikën 1, shkronjat “b”, “ç” dhe “ç”, të këtij neni.

Neni 38

Njoftimi i të miturit viktimë ose dëshmitar

1. Nëse i mituri është viktimë ose dëshmitar, organi procedues merr të gjitha masat, me qëllim që njoftimi i të miturit të bëhet:

a) në mënyrë të tillë që informacioni të jetë i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për të përfshirë edhe rastet e aftësisë së kufizuar të të miturit;

b) drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor/procedural.

2. Në rast konflikti interesi me përfaqësuesin ligjor ose kur, për shkak të moshës shumë të mitur, nuk mund të bëhet njoftimi drejtpërdrejtë i të miturit, njoftimi i tij bëhet nëpërmjet përfaqësuesit procedural, mbrojtësit ose psikologut.

3. Një kopje e njoftimit i dorëzohet ose, sipas rastit, i dërgohet mbrojtësit ose përfaqësuesit ligjor të të miturit.

Neni 39

Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar

1. Kur dhënia e dëshmisë mund ta vendosë viktimën ose dëshmitarin e mitur në rrezik serioz për jetën apo për shëndetin, gjyqtari, në përshtatje me moshën, gjatë gjykimit garanton:

a) pyetjen e dëshmitarit/viktimës të mitur duke përdorur pajisje që ndryshojnë pamjen dhe/ose zërin e dëshmitarit/viktimës, marrjen e tij në pyetje pas një ekrani jotransparent ose marrjen në pyetje në distancë;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) pyetjen e dëshmitarit/viktimë të mitur përpara fillimit të seancës gjyqësore me pjesëmarrjen e mbrojtësit të të miturit dhe video-regjistrimit të pyetjes së të miturit;

c) ndjekjen e procesit dhe pyetjen e të miturit dëshmitarit ose viktimë, kur është e mundur dhe e përshtatshme, nga të njëjtët persona dhe kufizimin sa më shumë të jetë e mundur të herëve të marrjes në pyetje.

2. Organet kompetente sigurojnë shmangien, në çdo rast, të përballjes së të miturit viktimë me të akuzuarin në të gjitha mjediset ku zhvillohet procesi.

3. Në rastet me të mitur viktimë ose dëshmitarë, zhvillimi i seancës gjyqësore bëhet vetëm me dyer të mbyllura.

4. Për të miturit viktimë ose dëshmitarë, përveç parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, gjykata garanton:

a) pyetjen në mjedisë miqësore për të miturit, si edhe jashtë mjedisit të gjykatës;

b) realizimin e sigurimit të provës në një kohë sa më të shkurtër pas fillimit të procedimit penal, për të shmangur efektet negative që vijnë nga tejzgjatja e procesit;

c) mosrimarrjen në pyetje në shkallët e tjera të gjykimit për të shmangur riviktimizimin e të miturit, me përjashtim të rasteve të caktuara në ligj;

ç) masa të tjera që i konsideron të përshtatshme.

5. Pyetja e të miturit viktimë dhe dëshmitar zhvillohen pa vonesë pas raportimit të fakteve tek organet përkatëse.

6. Të njëjtat rregulla zbatohen nga organet e tjera kompetente edhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë dhe dëshmitar.

Neni 40

Rregulla të posaçme për pyetjen e të miturit 14 vjeç-18 vjeç

1. Përveç rregullave të parashikuara në nenin 361/a të Kodit të Procedurës Penale për të miturin mbi 14 vjeç dhënia e dëshmisë bëhet pa praninë e të pandehurit. Në këtë rast gjyqtari urdhëron largimin e përkohshëm të të pandehurit nga salla e gjyqit, duke siguruar pjesëmarrjen e detyrueshme të mbrojtësit të të pandehurit në seancë gjyqësore.

2. Në rastin e zbatimit të pikës 1, të këtij neni, gjykata, sipas rastit, informon të miturin mbi të drejtën e tij për të kërkuar që i pandehuri të jetë i pranishëm. Nëse i mituri e kërkon këtë, gjykata e vlerëson menjëherë kërkesën, nisur nga rrethanat konkrete, pjekuria e të miturit, rreziku i riviktimizimit dhe viktimizimi dytësor dhe vendos mbi kërkesën.

Neni 41

Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale

1. Përveç rregullave të parashikuara në nenin 58/b, të Kodit të Procedurës Penale, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 40, të këtij Kodi, në pyetjen e të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar, të shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale. Për këta të mitur, regjistrimi audio dhe video gjatë pyetjes është i detyrueshëm.

2. Dëshmia në audio dhe video e dhënë nga i mituri mund të shfaqet gjatë seancës gjyqësore.

3. Dëshmia e të miturit viktimë e shfrytëzimit seksual dhe/ose abuzimit seksual mund të dëgjohet në sallën e gjyqit pa qenë i pranishëm vetë i mituri, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të nevojshme të komunikimit.

4. I mituri dëshmitar ose viktimë e dhunës në familje ndalohej të merret në pyetje në praninë e prindit ose të afërmit abuzues gjatë procedurës së vendosjes së urdhrit të mbrojtjes, urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

5. Në rastet me të mitur viktimë ose dëshmitarë të shfrytëzimit seksual dhe/ose abuzimit seksual, gjithë procesi i gjykimit zhvillohet me dyer të mbyllura.

Neni 42

Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë/dëshmitar nën 14 vjeç

1. Për të miturit viktimë dhe dëshmitarë nën 14 vjeç, përveç parashikimeve të këtij neni, zbatohen për aq sa është e mundur të gjitha garancitë dhe të drejtat e parashikuara nga ky Kod dhe në nenin 361/a, të Kodit të Procedurës Penale.

2. Pyetja e të miturit nën moshën 14 vjeç mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor/procedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij. Përfaqësuesi ligjor/procedural ka të drejtë të shprehë mendimin e tij për pyetjet që do t'i drejtohen të miturit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

3. Ndalohet pjesëmarrja e përfaqësuesit ligjor në rast se kjo është në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës dhe nëse ai dyshohet për kryerjen e veprimeve dhe/ose mosveprimeve të paligjshme.

4. Të miturit nën 14 vjeç i shpjegohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, si dhe përmes shembujve, rëndësia për të thënë të vërtetën dhe pasojat që mund të sjellë mosthënia e të vërtetës për personat e tretë. Të miturit i shpjegohet që nuk ka përgjegjësi penale për veprën penale, për refuzimin e dhënies së dëshmisë ose të dhënies së një dëshmie të rreme.

5. Organi procedues konsulton paraprakisht me psikologun përmbajtjen e pyetjeve që do t'i drejtohen të miturit, duke synuar që atij t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur, lehtësimi i dhënies së dëshmisë, eliminimi i frikësimit ose ndrojtjes nga procesi.

Neni 43

Masat për të mbrojtur jetën private dhe mirëqenien e të miturve viktima dhe dëshmitarë

Me kërkesë të të miturit viktimë ose dëshmitar, përfaqësuesit të tij ligjor ose procedural dhe/ose mbrojtësit të tij, ose kryesisht, gjykata, duke marrë parasysh interesin më të lartë të të miturit, urdhëron, sipas rastit, marrjen e një ose më shumë masave të duhura dhe të përshtatshme për të mbrojtur jetën private dhe mirëqenien fizike dhe mendore të të miturit dhe për të parandaluar vuajtjen dhe viktimizimin dytësor, të tilla si:

a) fshirjen nga të dhënat publike të emrave, adresave, vendeve të shkollimit dhe/ose të punës, profesioneve ose çdo informacioni tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të miturin;

b) ndalimin e mbrojtësit të të pandehurit dhe të të miturit viktimë/dëshmitar që të zbulojë identitetin e të miturit ose ndonjë material ose informacion që mund të ndikojë për të identifikuar të miturin;

c) urdhërimin për mosbërjen publike të shkresave që identifikojnë të miturin për aq sa gjykata e çmon të nevojshme;

ç) caktimin e një numri për të miturin për efekt të përgatitjes së mbrojtjes së të akuzuarit, data e lindjes dhe emri i plotë i të miturit, sipas rastit, do të zbulohen brenda një periudhe të arsyeshme;

d) marrjen e masave për mosidentifikimin e të miturit, të tilla si: ndryshimin e imazhit/pamjes/ figurës ose të zërit; vendosjen e një mburoje jo të tejdukshme; pyetjen në një mjedis tjetër dhe transmetimin në të njëjtën kohë në sallën e gjykimit me anë të televizionit me qark të mbyllur; filmimin (regjistrimit me zë dhe me figurë) të pyetjes së dëshmitarit të mitur përpara seancës, rast në të cilin mbrojtësi i të akuzuarit merr pjesë në shqyrtim dhe i jepet mundësia t'i bëjë pyetje të miturit dëshmitar ose viktimë; komunikimin me anë të një ndërmjetësi të kualifikuar dhe të përshtatshëm, përfshirë përkthyes/interpretues për të miturit me paafësi në dëgjim, shikim, të folur ose paafësi të tjera, por pa u kufizuar vetëm në to;

dh) zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura;

e) urdhërimin për të hequr përkohësisht të akuzuarin nga salla e gjykimit, nëse i mituri refuzon të dëshmojë në prani të të akuzuarit, ose nëse rrethanat tregojnë se i mituri mund të frenohet për thënien e të vërtetës në prani të atij personi. Në raste të tilla, mbrojtësi i të miturit qëndron në sallën e gjyqit dhe mund t'i bëjë pyetje të miturit, duke garantuar kështu të drejtën e të akuzuarit për debat gjyqësor;

ë) lejimin e ndërprerjes së seancave gjatë dëshmisë së të miturit;

f) marrjen e çdo mase tjetër që gjykata mund ta çmojë të nevojshme, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, anonimitetin, duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të të miturit dhe të drejtat e të akuzuarit.

Neni 44

Masat e drejtësisë restauruese

1. Organi kompetent informon të miturin në konflikt me ligjin dhe viktimën, përfaqësuesin ligjor ose procedural dhe, sipas rastit, mbrojtësin e të miturit, për programet e drejtësisë restauruese.

2. Organi kompetent informon të miturin në konflikt me ligjin, përfaqësuesin ligjor ose procedural dhe, sipas rastit, mbrojtësin e të miturit, për mundësinë për të kërkuar kthimin dhe kompensimin e dëmit në gjykatë në qoftë se zbatimi i programit të drejtësisë restauruese nuk realizohet.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

Neni 45

E drejta për kompensimin e dëmit

1. Të miturit viktimë të veprës penale, si edhe përfaqësuesit të tij ligjor i komunikohet dhe i shpjegohet vendimi i gjykatës lidhur me veprën penale përkatëse, në mënyrë sa më të përshtatshme për moshën dhe nivelin e kuptueshmërisë.

2. Gjykata, nëse është rasti, e informon të miturin viktimë të veprës penale dhe përfaqësuesin e tij ligjor lidhur me të drejtën për kompensimin e dëmit të shkaktuar.

KREU VI

RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS SË DREJTËSISË PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Neni 46

Përcaktimi i moshës së të miturit

1. Kur ka pasiguri në lidhje me moshën e të miturit, organi procedues, në çdo gjendje ose shkallë të procedimit, në bazë të kërkesës së palës ose kryesisht, menjëherë merr vendim për të përcaktuar moshën e të miturit.

2. Mosha përcaktohet në bazë të një vlerësimi të plotë të të gjithë informacionit të disponueshëm, duke i dhënë rëndësinë e duhur çdo dokumenti zyrtar, të tillë si certifikata e lindjes, të dhënat e shkollës, të dhënat shëndetësore, deklarata e prindit për moshën ose deklarata e vetë të miturit dhe një raport i bazuar në ekzaminimin mjekësor.

3. Nëse, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit mbeten dyshime për moshën, prezumohet se personi është i mitur.

4. Nëse mosha e të miturit është e përcaktuar me përafërsi, për marrjen e vendimit mbi përgjegjësinë penale do të konsiderohet mosha më e ulët.

Neni 47

Raporti i vlerësimit individual

1. Prokurori/gjykata në procesin e vlerësimit të të miturit mbështetet në nivelin e zhvillimit, mënyrën e jetesës, edukimin dhe kushtet e zhvillimit, arsimimin, gjendjen shëndetësore, mjedisin familjar dhe kushtet e tjera të të miturit, të cilat e lejojnë për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta.

2. Në raportin e vlerësimit individual pasqyrohen karakteristikat individuale të të miturit, të parashikuara në nenin 22 të këtij Kodi.

3. Raporti i vlerësimit individual përshkruan nevojat e veçanta të të miturit, rrezikun e kryerjes së veprës penale, si dhe elemente të tjera në varësi të rastit dhe rekomandon masat e duhura për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e tij në shoqëri.

4. Prokurori/gjykata kërkon në mënyrë të detyrueshme përgatitjen dhe mbajtjen parasysh të raportit të vlerësimit individual kur:

- a) përcaktohet masa alternative e shmangies;
- b) caktohet lloji i dënimit;
- c) ekzekutohet vendimi i dënimit; si dhe
- ç) shqyrtohet kërkesa për lirim me kusht.

5. Prokurori/gjykata bën kujdes që afati i përgatitjes së raportit të mos bëhet pengesë për ecurinë dhe afatet e çështjes penale konkrete.

6. Në fazat e parashikuara nga shkronja “a” dhe “b”, të pikës 4, të këtij neni, raporti i vlerësimit individual përgatitet nga eksperti/grupi i ekspertëve ose nga Shërbimi i Provës, sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij Kodi. Në rastet e parashikuara nga shkronja “c” dhe “ç”, të pikës 4, të këtij neni, ky raport përgatitet nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) për të miturit dhe/ose Shërbimi i Provës. Sipas rastit, organet e mësipërme, në përgatitjen e raportit të vlerësimit individual marrin edhe mendimin e Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

7. Gjatë kryerjes së vlerësimit individual të të miturit, ekspertit ose grupi i ekspertëve, përfaqësuesi i Shërbimit të Provës, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale ose, sipas rastit, Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, takohet lirisht me të pandehurin e mitur dhe merr të gjithë informacionin e nevojshëm nga çdo person fizik ose/dhe juridik publik ose/dhe privat që e konsideron si ndihmës në këtë proces.

8. Raporti i vlerësimit individual merret parasysh në çdo fazë të procedimit penal. Informacioni i dhënë në një raport të mëparshëm merret parasysh në procesin e përgatitjes së një raporti tjetër të vlerësimit individual në çdo fazë të mëtejshme të procedimit penal.

9. Metodologjia, rregullat dhe standardet e përgatitjes së raportit të vlerësimit individual, të parashikuara nga ky nen, përcaktohen sipas legjislacionit në fushat përkatëse.

Neni 48

Mbrojtja e të miturit

1. Përfaqësuesi ligjor i të miturit ka të drejtë të zgjedhë dhe të caktojë, në mënyrë të pavarur, një mbrojtës, duke marrë parasysh interesin më të lartë të të miturit.

2. Nëse një i mitur në konflikt me ligjin nuk ka zgjedhur mbrojtës, organi kompetent që kryen veprimin përkatës procedural, cakton menjëherë mbrojtësin sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe ligjeve të posaçme për ndihmën juridike, për aq sa nuk bien ndesh me këtë Kod.

3. Kërkesa për caktimin e mbrojtësit, marrja e dëgjimit të të miturit dhe dhënia e pëlqimit të të miturit dhe, në mungesë të këtij pëlqimi, të përfaqësuesit ligjor ose procedural të të miturit, shënohet në një procesverbal të veçantë. Sipas rastit, procesverbali nënshkruhet prej të miturit ose përfaqësuesit ligjor/procedural të të miturit dhe mbrojtësit.

4. Në çdo rast pjesëmarrja e mbrojtësit është e detyrueshme.

5. Thëniet e të miturit të dyshuar, të bëra jo në prani të mbrojtësit, nuk mund të përdoren si provë.

Neni 49

Prania e detyrueshme në veprimet procedurale me të miturit

1. Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut. Nga ky rregull bëhet përjashtim vetëm në rastet kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhe/ose në rastet e parashikuara lidhur me gjendjen e flagrancës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

2. Gjyqtari, gjatë gjykimit dhe prokurori në fazën e hetimit, mund të ndalojnë përfaqësuesin ligjor të të miturit në konflikt me ligjin të marrë pjesë në veprimin procedural vetëm nëse një gjë e tillë është në interesin më të lartë të të miturit.

Neni 50

E drejta e të miturit për të komunikuar në gjuhën që kupton

1. Nëse i mituri nuk e kupton, nuk e kupton pjesërisht ose plotësisht si duhet ose nuk mund të flasë gjuhën me të cilën procedohet, atij i caktohet një përkthyes pa pagesë, i cili duhet të jetë i pranishëm në çdo veprim procedural. Nga ky rregull bëhet përjashtim vetëm në rastet kur veprimet ose/dhe mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhe në rastet e parashikuara lidhur me flagrancën, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

2. Përkthyesi takohet me të miturin përpara gjykimit ose veprimit procedural për të verifikuar nëse ata e kuptojnë njëri-tjetrin.

3. I mituri me aftësi të kufizuara ka të drejtë për të përfutur pa pagesë nga të gjitha shërbimet, për të cilat ai ka nevojë për t'u informuar dhe komunikuar lidhur me rastin dhe për të marrë pjesë në procedim.

Neni 51

E drejta për ndihmë konsullore

1. I mituri shtetas i huaj në konflikt me ligjin ka të drejtë për ndihmë nga përfaqësuesi i institucionit diplomatik ose konsullor i vendit të tij në çdo fazë të procedimit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Nëse i mituri i arrestuar ose ndaluar është shtetas i huaj, ky fakt i njoftohet në kohën më të shkurtër dhe në çdo rast përpara marrjes në pyetje, ministrisë përgjegjëse për politikën e jashtme e cila njofton në lidhje me këtë përfaqësinë diplomatike ose institucionin konsullor të shtetit përkatës.

3. Nëse i mituri është shtetas i një vendi që nuk ka përfaqësi diplomatike ose shërbim konsullor në Shqipëri, është refugjat ose është një person pa shtetësi, atij i jepet mundësia për të komunikuar, nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për politikën e jashtme, me përfaqësinë diplomatike të vendit që merr përgjegjësinë për interesat e të miturit ose me ndonjë organizatë kombëtare ose ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, misioni i të cilës është mbrojtja e të miturve të tillë.

4. Parashikimet e këtij neni zbatohen edhe në rastin kur i mituri shtetas i huaj është viktimë e trafikimit, rrëmbimit ose marrjes së padrejtë.

Neni 52

Ndarja e çështjes së të miturit nga çështja e përbashkët me të rritur

1. Nëse i mituri është i akuzuar për një vepër penale, për kryerjen e të cilës është akuzuar edhe një i rritur, çështja gjykohet sipas nenit 27, pika 4, të këtij Kodi.

2. Nëse është e mundur, çështjet me të mitur gjykohen veçmas nga ato me të rritur, përveç kur cenohet shqyrtimi i plotë, objektiv dhe i shpejtë i çështjes.

3. Në çdo rast i mituri ka të drejtat dhe garancitë e parashikuara nga ky Kod dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 53

Njoftimi i të miturit

1. Njoftimi i të miturit në konflikt me ligjin bëhet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

2. Njoftimi i të miturit në konflikt me ligjin bëhet në mënyrë të tillë që informacioni të jetë i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për të, përfshirë edhe rastet e të miturve me nevoja të veçanta për shkak të aftësisë së kufizuar.

3. Njoftimi i të miturit në konflikt me ligjin bëhet, sipas rastit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor/procedural ose drejtuesit të institucionit ku i mituri është vendosur.

4. Një kopje e njoftimit të thirrjes së të pandehurit të mitur i dorëzohet ose i dërgohet mbrojtësit të të miturit ose përfaqësuesit të tij ligjor.

Neni 54

Ndalimi i përdorimit të forcës, mjeteve të tjera dhe armëve të zjarrit

1. Forca dhe mjetet e tjera shtrënguese nuk përdoren gjatë arrestimit, lëvizjes jashtë institucionit, zbatimit të masave të sigurimit ose dënimit të një të mituri, përveç rasteve përjashtimore/ të jashtëzakonshme, kur të gjitha mjetet e tjera për të arrestuar të miturin, për të parandaluar vetëdëmtimin ose dëmtimin e të tjerëve janë shteruar dhe nuk kanë sjellë rezultat dhe në qoftë se qëllimi i parashikuar në ligj nuk mund të realizohet me mjete të tjera më pak të dëmshme.

2. Forca dhe mjetet e tjera shtrënguese nuk mund të përdoren në asnjë rast për të miturën shtatzënë, përveç rastit kur ajo ka për qëllim të vetëdëmtohet.

3. Forma e vetme e lejuar e forcës dhe mjeteve të tjera, në rastin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, është përdorimi i forcës fizike, prangave dhe mjeteve të tjera detyruese. Për të parandaluar mosbindjen në grup dhe/ose çrregullimin në masë, për të kundërsulmuar dhe për të arrestuar një person të armatosur, mund të përdoren edhe mjete të tjera detyruese, të tilla si: shkop gome, rrjeta izoluese, gaz lotsjellës dhe/ose pompa uji.

4. Në çdo rast, forca fizike dhe mjetet e tjera:

a) përdoren për kohën më të shkurtër të mundshme;

b) shërbejnë për një qëllim të parashikuar në ligj dhe janë në proporcion me rrethanat përkatëse;

c) nuk zbatohen në mënyrë degraduese ose poshtëruese dhe nuk duhet të përbëjnë torturë ose keqtrajtim.

5. Ndalohet përdorimi i armëve të zjarrit ndaj të miturit, me përjashtim të rastit kur ai është i armatosur dhe përbën kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për jetën ose shëndetin e një personi të tretë dhe është e pamundur për ta parandaluar këtë kërcënim me mjete të tjera.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

6. Ndalohet përdorimi i armëve të zjarrit në rast se i mituri është duke u larguar nga vendi i paraburgimit ose burgimit.

7. Personi, i cili përdor forcën dhe/ose mjetet e tjera, sipas këtij neni, njofton menjëherë eprorin e tij dhe, nëse është e nevojshme, drejtuesin e institucionit në lidhje me këtë përdorim, duke argumentuar pse masat e tjera ishin të pamundura për tu përdorur.

8. Eprori direkt merr masa të menjëhershme për realizimin e kontrollit mjekësor të të miturit. Personi, i cili përdor forcën dhe/ose mjetet e tjera, përgatit për këtë një raport me shkrim. Raporti përmban informacion mbi përdorimin e forcës dhe/ose mjeteve të tjera, arsyet e përdorimit dhe të dhëna të tjera.

9. Çdo rast i përdorimit të forcës dhe mjeteve të tjera dokumentohet në regjistrin përkatës.

10. Regjistri dhe të dhënat e tij janë në dispozicion të të miturit, përfaqësuesit të tij ligjor dhe/ose avokatit, gjykatës dhe autoriteteve që, sipas legjislacioni në fuqi, inspektojnë dhe/ose mbikëqyrin këtë veprimtari.

11. Të drejtën e përdorimit të mjeteve, sipas pikës 3, të këtij neni, e kanë vetëm personat të cilët janë trajnuar posaçërisht për përdorimin e tyre, sipas rregullave në fuqi për ligjin mbi përdorimin e armëve të zjarrit.

KREU VII

SHMANGIA NGA NDJEKJA PENALE DHE NGA DËNIMI PËRMES MASAVE ALTERNATIVE

Neni 55

Kriteret dhe kushtet për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale

1. Organi kompetent në çdo rast vlerëson marrjen e masës së shmangies ndaj të miturit në konflikt me ligjin.

2. Organi kompetent, në marrjen e vendimit për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale vlerëson interesin më të lartë të të miturit, rëndësinë e veprës penale të kryer dhe dënimin e parashikuar për atë veprë, moshën e të miturit, shkallën e fajësisë, dëmin e shkaktuar, efektin frikësues të ndjekjes penale, sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale, si dhe raportin e vlerësimit individual, të hartuar sipas nenit 47 të këtij Kodi.

3. Në mënyrë të veçantë masa e shmangies nga organi kompetent zbatohet nëse:

a) ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një veprë penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë;

b) i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;

c) i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një veprë penale ose nuk është përsëritës;

d) i mituri dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural japin pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies;

e) i mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimit;

dh) dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korrigjimit të sjelljes së tij;

e) duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të të miturit, shihet nëse nuk ka një interes publik për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e ndjekjes penale të filluar.

4. Organi kompetent, para marrjes së vendimit për zbatimin e masës së shmangies, mund të kërkojë informacion nga prindërit, kujdestarët ligjorë, institucionet që kanë dijeni për veprimtarinë e të miturit, përfshirë, sipas rastit, edhe Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, si dhe mendimin e ekspertit, sipas nevojave të të miturit dhe të procesit.

Neni 56

Procedura për zbatimin e masës së shmangies nga prokurori

1. Prokurori mund të vendosë zbatimin e masës së shmangies deri në momentin para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes.

2. Masa e shmangies ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të merret me iniciativën e prokurorit ose me kërkesë të të miturit në konflikt me ligjin ose përfaqësuesit të tij.

3. Në rastet kur masa e shmangies merret me iniciativën e prokurorit, ai i propozon të miturit në konflikt me ligjin masën e shmangies nga ndjekja penale dhe në rast se i mituri jep pëlqimin, prokurori vendos përfundimisht zbatimin e saj.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

4. Në rast se kërkesa/propozimi i prokurorit për zbatimin e masës së shmangies nuk pranohet nga i mituri në konflikt me ligjin, mbahet një procesverbal, në të cilin pasqyrohen arsyet e mospranimit të saj nga i mituri. Procesverbali nënshkruhet nga prokurori dhe i mituri ose, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural.

5. I mituri në konflikt me ligjin ose përfaqësuesi i tij, me kërkesë të arsyetuar, i kërkon prokurorit zbatimin e masës së shmangies. Në këtë rast prokurori vendos për zbatimin ose jo të masës së shmangies me vendim të arsyetuar.

6. Në rast se prokurori refuzon kërkesën për zbatimin e masës së shmangies, i mituri në konflikt me ligjin ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë që të kërkojë zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale në gjykatë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e refuzimit.

Neni 57

Procedura dhe zbatimi i masës së shmangies nga gjykata

1. Zbatimi i masës së shmangies mund të vendoset, sipas rastit, edhe nga gjykata.

2. Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të palëve, punonjësit social ose psikologut, mund të vendosë kthimin e çështjes prokurorit për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies. Para marrjes së këtij vendimi, gjykata dëgjon të miturin dhe merr pëlqimin e tij.

3. Gjykata mund të zbatojë masën e shmangies në fazën e gjykimit deri para marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 58

Pasojat e zbatimit të masës së shmangies

1. Zbatimi i masës së shmangies nga prokurori është rrethanë për mosfillimin e procedimit penal, nëse procedimi penal nuk ka filluar, dhe pushimin e tij nëse procedimi penal ka filluar.

2. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë dhe viktimës, me qëllim që ky i fundit, sipas rastit, të ketë mundësi të kërkojë dëmshpërblim. Sipas rastit, ky vendim i njoftohet edhe mbrojtësit të të miturit, përfaqësuesit ligjor dhe/ose procedural të tij.

3. Në rastin e vendosjes së masës së shmangies prokurori merr vendimin për mosfillimin e çështjes penale ose pushimin e saj dhe lidh një marrëveshje me të miturin për llojin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin.

4. Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë përcaktohen elementet e marrëveshjes që lidhet midis palëve për masën e shmangies dhe/ose ndërmjetësimin, si dhe rregulla të zbatimit të programit përkatës, të parashikuar në këtë marrëveshje.

Neni 59

Pëlqimi për masën e shmangies

1. Marrja e masës së shmangies nga ndjekja penale bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim të të miturit dhe, kur është e përshtatshme, edhe nga përfaqësuesi i tij ligjor.

2. Në mungesë të përfaqësuesit ligjor të të miturit, ose kur ai nuk gjendet, ose kur i mituri nuk ka marrëdhënie me të ose përfaqësuesi ligjor ka konflikt interesi me të miturin, organi kompetent cakton një përfaqësues procedural, i cili mund të japë pëlqimin për masën e shmangies.

3. Para marrjes së pëlqimit, të miturit i sigurohet mundësia e këshillimit dhe ndihmës ligjore, me qëllim që të kuptojë masën e propozuar të shmangies dhe nëse ajo është e përshtatshme dhe e pranueshme prej tij.

4. Gjatë negociimit të marrëveshjes për marrjen e masës së shmangies, i mituri ndihmohet nga mbrojtësi.

5. Marrëveshja, sipas pikës 4, të këtij neni, nënshkruhet nga i mituri dhe mbrojtësi i tij.

Neni 60

Garancitë e të miturit për zbatimin e masës së shmangies

1. Para zbatimit të vendimit për masën e shmangies nga ndjekja penale, i mituri, mbrojtësi i tij dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor kanë të drejtë të kenë informacion të detajuar mbi thelbin e masës së shmangies nga ndjekja penale, kohëzgjatjen e saj, kushtet dhe mënyrën e zbatimit, si dhe pasojat për mospërmblidhjen e masave të shmangies.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Të miturit i shpjegohet gojarisht dhe me shkrim, ose në format e duhura të komunikimit, sipas aftësive të veçanta të të miturit, se pranimi i masës së shmangies nga ndjekja penale është vullnetar dhe se i mituri ka të drejtë të heqë dorë prej masës në çdo fazë.

3. Nëse i mituri nuk ka mbrojtës, ai dhe përfaqësuesi ligjor i tij informohen lidhur me të drejtën për të pasur një mbrojtës.

4. Pranimi i veprës penale nga i mituri dhe informacioni i mbledhur rreth tij gjatë procesit të shmangies nuk mund të përdoren në gjykatë kundër tij.

Neni 61

Kushtëzimi i vendimit të zbatimit të masës së shmangies

1. Prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimit, me qëllim zbatimin me kusht të masës së shmangies nëse i mituri në konflikt me ligjin kërkon dhe garanton përmbushjen e detyrimeve të tilla si:

- a) riparimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale, sipas aftësive të tij dhe sipas rastit;
- b) përfshirja në programe të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- c) përfshirja në punët e një organizate humanitare ose në veprimtaritë e komunitetit ose të mbrojtjes së mjedisit;
- c) trajtimi prej varësisë nga droga ose varësive të tjera.

2. Në rast se i mituri përmbush detyrimet, sipas pikës 1, të këtij neni, prokurori vendos përfundimisht për pushimin e procedimit penal ndaj tij.

Neni 62

Masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale

1. Masat alternative për shmangien nga ndjekja penale mund të përfshijnë:

- a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- b) këshillimin për të miturin dhe familjen;
- c) paralajmërimin me gojë;
- c) paralajmërimin me shkrim;
- d) masat detyruese;
- dh) vendosjen nën kujdes.

2. Ndaj të miturit mund të zbatohen në të njëjtën kohë disa masa nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këto masa përcaktohen mbështetur në raportin e vlerësimit individual të të miturit, sipas rregullave të parashikuara në nenin 47 të këtij Kodi.

3. Masat e shmangies duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me nevojat e të miturit në konflikt me ligjin dhe të viktimës. Asnjë detyrim nuk mund t'i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së masës së shmangies, e cila mund t'i shkaktojë poshtërim, degradim, përjashtim nga procesi normal edukativ dhe/ose punësimi kryesor, si dhe dëmtim të shëndetit fizik ose/dhe mendor.

4. Ndalohet vendosja e një mase shmangieje më të ashpër sesa sanksioni minimal ligjor i parashikuar për veprën penale të kryer.

5. Masat alternative të shmangies, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, jepen, sipas rastit, nga prokuroria ose gjykata.

Neni 63

Programet e drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimi

1. Organi procedues vendos për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese, në përputhje me legjislationin për ndërmjetësimin, me qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë.

2. Programi i drejtësisë restauruese, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të zbatohet nëse:

- a) i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë; dhe
- b) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme ose e përshtatshme.

3. Kur i mituri nuk ka prindër, ose ekziston një konflikt interesi midis prindërve dhe të miturit, pëlqimin, sipas pikës 2, shkronja "a", të këtij neni, mund ta japë një prej përfaqësuesve proceduralë, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 17, të këtij Kodi.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

4. Programi i drejtësisë restauruese, i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të parashikojë që të miturit t'i kërkohej:

a) të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës;

b) të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;

c) t'i kërkojë falje viktimës; dhe

ç) të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktimë ose/ dhe komuniteti.

5. Masat e drejtësisë restauruese, të marra në përputhje me parashikimet e këtij neni, mund të përfshijnë pjesëmarrjen në një program të shmangies dhe ndërmjetësimit, të punës në interes publik dhe/ose çdo program tjetër që çon në rehabilitimin e pasojave të veprës penale të kryer nga një i mitur.

6. Ndërmjetësimi familjar dhe në grup është një masë alternative për shmangien e ndjekjes penale, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë proces i akuzuari dhe familja e tij pritet të arrijnë një marrëveshje me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen.

Neni 64

Procedura e ndërmjetësimit

1. Ndërmjetësimi si procedurë jashtëgjyqësore zhvillohet nga ndërmjetësi sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjit në fuqi për ndërmjetësimin.

2. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimin i lirë për ndërmjetësim i shprehur si nga i të miturit i akuzuar i veprës penale dhe palës së dëmtuar. Dhënia e pëlqimit duhet të shënohet në procesverbalin e organit procedues.

3. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm me pjesëmarrjen personale të të miturit autor i veprës penale dhe palës së dëmtuar.

4. Në procesin e ndërmjetësimit, me pëlqimin e palëve, mund marrin pjesë gjithashtu përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij. Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit nëse ai e vlerëson.

5. Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, mund të zbatohet edhe si masë shmangieje por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale.

6. Prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit, sipas rastit, mund të propozojnë ndërmjetësimin nëse vlerësojnë se kjo alternativë është më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

7. Në rast se propozimi i prokurorit/gjyqtarit për ndërmjetësim pranohet nga palët, atëherë prokurori/gjyqtari vendos pezullimin e procesit penal për një afat jo më shumë se 45 ditë. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit arrihet prokurori/gjyqtari vendos pushimin e çështjes. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit nuk arrihet me kalimin e 45 ditëve, pezullimi bie dhe vazhdon hetimi/gjykimi i çështjes.

8. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit bëhen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 65

Këshillimi për të miturin dhe familjen

1. Këshillimi konsiston në informimin e të miturit dhe/ose familjes së tij, se ai ka kryer një vepër të dëmshme, të rrezikshme, e cila përbën vepër penale dhe me pasoja negative për viktimën dhe komunitetin.

2. Organi kompetent jep masën e këshillimit për të miturin dhe/ose familjen e tij kur kjo masë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes të të miturit dhe që do të ndikojë pozitivisht në sjelljen e tij.

3. Organi kompetent, sipas rastit, ngarkon Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ose shërbimet sociale dhe/ose psikologjike që të hartojnë një plan lidhur me mënyrën e realizimit të këshillimit dhe matjen e efekteve të tij hap pas hapi.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 66

Paralajmërimi me gojë

1. Paralajmërimi me gojë përfshin gjithë shpjegimet që i jepen të miturit nga organet kompetente, mbi dëmin e shkaktuar prej veprimeve të tij dhe pasojave që rrjedhin nëse vepra penale do të përsëritet.

2. Në këtë rast, paralajmërimi i dhënë me gojë të miturit mbahet shënim në një regjistër të posaçëm, forma e të cilit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 67

Paralajmërimi me shkrim

1. Paralajmërimi me shkrim përfshin pasqyrimin në një procesverbal të të gjitha shpjegimeve, sipas nenit 65, të këtij Kodi, që i jepen të miturit prej organeve kompetente.

2. Një kopje e këtij procesverbal i jepet të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor.

3. Format i paralajmërimit me shkrim dhe të dhënat që duhet të përfshihen në të përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 68

Masat detyruese

1. Ndaj të miturit, mund të caktohet si masë detyruese, që ai të ndalohet:

a) të kontaktojë/takojë një person të caktuar

b) të shkojë/vizitojë një vend të caktuar;

c) të ndryshojë vendin e banimit;

ç) të largohet nga shtëpia gjatë një periudhe/orari të caktuar;

d) të largohet pa leje nga një vend ose nga një rajon administrativ i përcaktuar;

dh) të kryejë ndonjë veprim tjetër që pengon rishoqërimin dhe rehabilitimin e tij.

2. Masat detyruese për të miturin janë:

a) të fillojë ose të rifillojë studimet në një institucion arsimor;

b) të fillojë të punojë, duke pasur parasysh dhe respektuar dispozitat e Kodit të Punës;

c) të kryejë një program edukativ, korrigjues dhe/ose mjekësor;

ç) të përmbushë detyrime të tjera që do të përforcojnë rishoqërimin e tij dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale.

3. Për masat eaktuara sipas pikës 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të këtij neni, njoftimi për masën detyruese, veç të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor dhe/ose procedural, i përcillet edhe autoritetit përgjegjës në fushën e arsimit dhe/ose të formimit profesional, të punësimit, shëndetësisë, Shërbimit të Provës dhe Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

4. Nëse jepen masat detyruese të parashikuara sipas këtij neni, organi kompetent, përcakton, sipas rastit, që realizimi dhe mbikëqyrja e tyre të bëhen nga Shërbimi i Provës ose Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Neni 69

Vendosja nën kujdes e të miturit

1. Nëse kujdesi i prindit ose kujdestarit të të miturit në konflikt me ligjin, në rritjen, sjelljen dhe zhvillimin e personalitetit të tij nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur qëllimin e masave detyruese dhe, kur është i nevojshëm kujdesi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme nga ana e një personi ose shërbimit të specializuar, i mituri mund të vendoset nën kujdes në një program edukativ dhe/ose korrigjues.

2. Programi edukativ dhe/ose korrigjues, realizohet sipas rastit, nga institucionet përgjegjëse që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Autoritetet përgjegjëse, sipas këtij legjislacioni, caktojnë persona të specializuar për zbatimin e kujdesit të vazhdueshëm. Këto të fundit, në bashkëpunim me të miturin, prindërit e tij, kujdestarin, institucionet e mirëqenies sociale dhe të arsimit, mjekë dhe profesionistë të tjerë, ushtrojnë ndikim të vazhdueshëm mbi personalitetin dhe sjelljen e të miturit, kujdesen për trajtimin e tij dhe mbikëqyrin përmbushjen e detyrimeve të tij, sipas një plani individual.

3. Vendimi për vendosjen nën kujdes jepet, sipas rastit, nga prokurori ose gjykata për një periudhë nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

4. Kujdesi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme mund të realizohen pa qenë e nevojshme ndarja e plotë dhe e

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

përherëshme e të miturit nga mjedisi i tij i mëparshëm. Në këtë mënyrë, i mituri mund të vendoset pranë shërbimit të specializuar përgjatë 24 orëve ose me kohëzgjatje të pjesshme që varion nga 4 deri në 8 orë.

5. Në vendimin për vendosjen nën kujdes, organi procedues mban parasysh që ekzekutimi i saj të mos e pengojë shkollimin e rregullt dhe punën e të miturit, si dhe përfshirjen e tij në aktivitete të dobishme. Aktivitetet përshtaten me moshën, zhvillimin, prirjet dhe interesat e të miturit, me qëllim zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë.

6. Prindërit e të miturit të vendosur nën kujdes, mund të përfshihen në procesin e zbatimit të kësaj mase, nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesat e të miturit. Me dhënien e masës, organi procedues i jep prindërve ose kujdestarit udhëzime të veçanta dhe i vendos ata nën detyrimin për të bashkëpunuar me personin e specializuar në lidhje me të gjitha çështjet që mund të lindin.

7. Organi procedues, nëse çmon se do të ishte e nevojshme për një zbatim më efektiv të masës së dhënë, mund të urdhërojë gjithashtu që i mituri të përmbushë një ose më shumë masa detyruese, të parashikuara nga neni 68 i këtij Kodi.

8. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, sipas këtij neni, shërbimi i specializuar për zbatimin e vendosjes nën kujdes, informon prokurorin.

9. Shërbimi i specializuar realizohet nga qendra disiplinore/edukuese të krijuara sipas legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

10. Në rastin e të miturit me aftësi të kufizuara, parashikimet e këtij neni zbatohen nga profesionistë të specializuar, sipas aftësisë së kufizuar dhe sipas legjislacionit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë.

Neni 70

Përmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

1. Nëse për të miturin që ka kryer një vepër penale, është dhënë një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale dhe kjo masë është përmbushur, ndaj tij nuk mund të ngrihet asnjë akuzë në lidhje me po këtë vepër penale.

2. Nëse i mituri i përmbush detyrimet, sipas marrëveshjes së shmangies, prokurori vendos menjëherë pushimin e çështjes.

3. I mituri që ka përmbushur një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale nuk do të konsiderohet si i dënuar për një vepër penale dhe nuk do të trajtohet si person me të kaluar kriminale.

4. Përmbushja e masës së shmangies nga ndjekja penale realizohet dhe mbikëqyret nga Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me shërbimin e ndërmjetësimit.

Neni 71

Mospërmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

1. Nëse i mituri, me qëllim, nuk e përmbush masën për shmangien e ndjekjes penale, për këtë, Shërbimi i Provës informon me shkrim prokurorin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërmbushjes dhe situatën personale të të miturit.

2. I mituri, prindërit ose, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, informohen nga Shërbimi i Provës lidhur me pasojat e moszbatimit të kushteve dhe detyrimeve të masës së shmangies dhe rregullat e shqyrtimit në rast mospërmbushjeje.

3. Mospërmbushja e kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës së shmangies nga ndjekja penale nuk përbën vepër penale dhe nuk sjell automatikisht kufizimin ose heqjen e lirisë së të miturit. Edhe në këtë rast, heqja e lirisë, konsiderohet nga organet kompetente si masa e fundit.

Neni 72

Procedura në rast mospërmbushjeje të masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

1. Në rastet e parashikuara nga neni 71, i këtij Kodi, prokurori mund të japë një vendim për ndryshimin ose revokimin e pjesshëm ose të plotë të masës së shmangies pasi ka bërë një shqyrtim të detajuar të fakteve të raportuara.

2. Prokurori, në çdo rast, cakton një seancë të veçantë dëgjimore, merr mendimin e të miturit, i cili paraqet arsye lidhur me mospërmbushjen e masës, duke zbatuar edhe parashikimet e nenit 59, të këtij Kodi, lidhur me pëlqimin e tij.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

3. Nëse do të jetë e nevojshme, prokurori, mund të kërkojë një vlerësim të ri psikologjik, psikiatrik ose të kërkojë mendim për raportet e mëparshme të ekspertëve.

4. Prokurori pasi e rishqyrton këtë masë, si edhe masa të tjera, kontakton të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor dhe dëgjon mendimin e punonjësit të Shërbimit të Provës mund të vendosë:

- a) revokimin ose lënien në fuqi të vendimit për shmangien nga ndjekja penale;
- b) ndryshimin e llojit të masës së shmangies;
- c) zgjatjen e kohës së marrëveshjes.

5. Nëse organi procedues vendos që të rifillojë procedimi kundër të miturit, merr parasysh pjesën e masës që është përmbushur tashmë nga i mituri gjatë zbatimit të masës alternative të shmangies.

6. Në rast të revokimit të vendimit për shmangien, prokurori, me vendim të arsyetuar, vendos të shfuqizojë vendimin për mosfillimin e hetimit ose të vendimit të pushimit të çështjes së filluar dhe të vendosë rifillimin e hetimit.

7. Në rastin e revokimit të vendimit për shmangien, veprimet e kryera nga i mituri për të përmbushur masën e shmangies nga ndjekja penale do të shqyrtohen gjatë gjykimit.

8. Pranimi i përgjegjësisë për një vepër penale, me qëllim që të zbatohet një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale, nuk mund të përdoret gjatë gjykimit kundër të miturit.

9. Nëse i mituri, nuk përmbush detyrimet e veçanta që i janë urdhëruar ose në qoftë se refuzon ose, në mënyrë të tjera, ndërhyr në zbatimin e masës së mbikëqyrjes së vazhdueshme, gjykata, nëse është e mundur, mund të vendosë që, për këtë arsye, i mituri të vendoset në një qendër/institucion disiplinor/edukues për qëndrim të pandërprerë për jo më shumë se një muaj.

10. Procedura që zbatohet nga ana e Shërbimit të Provës, në rastet kur çmon mospërmbushjen e masës së shmangies, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII

ELEMENTE TË PROCESIT TË HETIMIT TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Neni 73

Njoftimi për arrestimin ose ndalimin e të miturit

1. Organi procedues, që në momentin e arrestimit të të miturit, e informon atë lidhur me të drejtën për të njoftuar prindin dhe, në mungesë të tij, një person tjetër të rritur të treguar dhe pranuar prej tij.

2. Organi procedues menjëherë ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të realizuar njoftimin, sipas rastit, të përfaqësuesit ligjor ose procedural të të miturit, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

3. Organi procedues menjëherë sapo e sjell të miturin në mjediset e institucionit përkatës njofton përfaqësuesin ligjor të të miturit ose personin e rritur, të treguar dhe pranuar prej tij, lidhur me arrestimin e të miturit, vendndodhjen e mbajtjes në paraburgim dhe shpjegon arsyet e arrestimit dhe i vë në dispozicion një kopje të Letrës së të Drejtave.

Neni 74

Caktimi dhe njoftimi i përfaqësuesit ligjor/procedural

1. Organi procedues njofton menjëherë Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës nëse:

- a) përfaqësuesi ligjor nuk mund të gjendet;
- b) del dukshëm se përfaqësuesi ligjor i të miturit ka abuzuar me të miturin ose në rastin e një krimi në familje;
- c) ka dyshime lidhur me paanshmërinë e përfaqësuesit ligjor të të miturit për sa i përket natyrës së marrëdhënieve të tij me pjesëtarin e familjes, i cili është dëmtuar;
- c) ekziston një nga llojet e konfliktit të interesit.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, personave të përmendur u ndalohet të njihen me dokumentet që lidhen me të miturin.

3. Organi procedues cakton një person nga lista e dërguar nga Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës që do të kryejë përfaqësimin procedural, nëse:

- a) është e pamundur që brenda një ore nga sjellja e të miturit në mjediset e organit procedues të gjendet përfaqësuesi ligjor;
- b) i mituri nuk jeton me përfaqësuesin e tij ligjor dhe/ose refuzon ta kontaktojë atë;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- c) përfaqësuesi ligjor vepron në kundërshtim me interesat e të miturit;
 - ç) i mituri është viktimë ose dëshmitar i një vepre penale të kryer nga përfaqësuesi i tij ligjor;
 - d) përfaqësuesi ligjor akuzohet për të njëjtën vepër penale që akuzohet i mituri;
 - dh) përfaqësuesi ligjor nuk është i disponueshëm.
4. Për çdo rast, caktimi i përfaqësuesit procedural bëhet duke marrë parasysh mendimin e të miturit.
5. Dispozitat mbi përfaqësuesin ligjor zbatohen plotësisht, sipas rastit, edhe për përfaqësuesit proceduralë lidhur me procesin penal.

Neni 75

Kushtet e të miturit në mjediset e paraburgimit

1. I mituri në mjediset e paraburgimit gëzon të gjitha të drejtat që gëzon i dënuar me burgim.
2. I mituri në paraburgim vendoset në mjedise të veçanta nga të rriturit.
3. Të miturit vendosen në mjedise të ndara nga njëri-tjetri sipas gjinisë.
4. Gjatë kohës që i mituri mbahet në paraburgim, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike.

Neni 76

Pyetja e të miturit në konflikt me ligjin

1. Gjatë fazave të procedimit penal organi procedues garanton zbatimin e të drejtave të të miturit, duke synuar mbrojtjen e të miturit nga vetinkriminimi përmes garantimit të së drejtës për të heshtur dhe për të mos dhënë dëshmi.
2. Gjatë pyetjes së të miturit, nga ana e organit procedues garantohej trajtimi me dinjitet dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve.
3. Ndalohet çdo lloj keqtrajtimi fizik dhe/ose psikologjik i të miturit gjatë pyetjes ose me qëllim marrjen e ndonjë lloj informacioni prej tij.
4. Organi procedues konsulton paraprakisht me psikologun përmbajtjen e pyetjeve që do t'i drejtohen të miturit, duke synuar që atij t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur, lehtësimi i dhënies së dëshmisë, eliminimi i frikësimit ose ndrojtjes nga procesi.
5. Pyetja e të miturit bëhet në prani të mbrojtësit dhe psikologut. Nëse i mituri jep pëlqimin, gjatë pyetjes së tij mund të marrë pjesë edhe përfaqësuesi ligjor/procedural.
6. Gjuha e përdorur gjatë pyetjes së të miturit duhet të jetë sa më miqësore dhe komunikimi të jetë në formë sa më të kuptueshme për të.
7. Në pyetjen e të miturit në konflikt me ligjin, veç parashikimeve të këtij neni, sipas rastit, zbatohen edhe dispozitat e Kodit Procedurës Penale për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë Kod.

Neni 77

Garancitë procedurale të pyetjes së të miturit në konflikt me ligjin

1. I mituri, përfaqësuesi ligjor ose psikologu ka të drejtë të kërkojë pushim në çdo kohë gjatë pyetjes së të miturit.
2. Organi kompetent, gjatë pyetjes së të miturit, kujdeset për një kohë pushimi në përputhje me moshën, nivelin e zhvillimit dhe rrethana të tjera, në të cilat gjendet i mituri.
3. Ndalohet marrja në pyetje e të miturit gjatë natës, nga ora 2200 - 800.
4. Të miturit i garantohej ushqim të paktën një herë në 4 orë nga ora 800 - 2200 dhe ujë pa orar. Të miturit i garantohej e drejta e për të përdorur tualetin në çdo kohë.
5. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore gjatë hetimit kanë të drejtë të ndalojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesit ligjor gjatë veprimit procedural vetëm nëse kjo gjë është në interesin më të lartë të fëmijës.
6. Organet kompetente, gjatë pyetjes së të miturit gjatë procesit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, bëjnë kujdes në kufizimin sa më shumë të jetë e mundur të numrit të marrjes në pyetje.
7. Pyetja e të miturit nën 14 vjeç që ka kryer vepër penale, bëhet pasi i shpjegohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme se ai nuk ka përgjegjësi penale për shkak të moshës. Atij i shpjegohet, gjithashtu, se nuk ka përgjegjësi penale në rast se refuzon për të dëshmuar ose jep dëshmi të rreme.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

8. Rregullat e përfshira në këtë nen zbatohen edhe në veprimet administrative të policisë dhe të organeve të tjera që kryejnë veprimtari administrative në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur.

Neni 78

Kontrolli personal i të miturit

1. Gjatë kontrollit personal, organet e procedimit garantojnë mbrojtjen e jetës private dhe dinjitetit të të miturit.
2. Organet e procedimit në çdo rast i shpjegojnë të miturit me gjuhë të kuptueshme arsyet e kontrollit personal.
3. Oficeri i policisë gjyqësore informon të miturin mbi aktin, me të cilin është vendosur kontrolli personal.
4. Kontrolli personal realizohet nga persona të së njëjtës gjini me të miturin ose të gjinisë së zgjedhur nga vetë i mituri.
5. Në çdo rast të kontrollit personal të të miturit, është e detyrueshme prania e mbrojtësit të tij.

Neni 79

Kontrolli/ekzaminimi intim dhe mjekësor i të miturit

1. Kontroll intim përbëjnë veprimet që lidhen me kontrollin/ekzaminimin fizik në trup të të miturit, me përjashtim të kontrollit të gojës.
2. Kontrolli intim i të miturit mund të bëhet vetëm me vendim gjyqësor, përveç rasteve kur shëndeti dhe jeta e të miturit është në rrezik, në raste urgjente dhe kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni që do të merret mund të humbasë, mund të humbasë vlerë ose prova e marrë mund të shkatërrohet.
3. Në të gjitha rastet marrja e një objekti dhe/ose materiali nga trupi i të miturit bëhet në mjedise, të cilat kanë leje për ushtrimin e një veprimtarie mjekësore, me pjesëmarrjen e një mjeku të certifikuar dhe infermieri me të njëjtën gjini të të miturit, si dhe në prani të përfaqësuesit ligjor dhe mbrojtësit të tij.
4. Kontrolli dhe veprime të tjera procedurale, të cilat kanë të bëjnë me heqjen pjesërisht ose plotësisht të veshjeve të të miturit, ndërmerren vetëm bazuar në një vendim gjyqësor që merret pasi është marrë mendimi i të miturit dhe në praninë e përfaqësuesit ligjor dhe të mbrojtësit, përveç rasteve që rrezikojnë sigurinë publike dhe në rastet e parashikuara lidhur me flagrancën, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.
5. Kontrolli intim realizohet nga persona të së njëjtës gjini me të miturin ose të gjinisë së zgjedhur nga vetë i mituri.
6. Për rastet e parashikuara nga pikat 2 dhe 4, të këtij neni gjykata vendos, brenda 12 orëve nga paraqitja e kërkesës, pa pjesëmarrjen e palëve.
7. Nëse i mituri nuk është dakord për pjesëmarrjen e përfaqësuesit ligjor gjatë kontrollit të parashikuar në pikat 2 dhe 4, të këtij neni ose përfaqësuesi ligjor nuk mund të marrë pjesë, veprimet procedurale do të kryhen në prani të përfaqësuesit procedural të caktuar sipas dispozitave të këtij Kodi.
8. Në çdo rast të kontrollit/ekzaminimit intim dhe mjekësor të të miturit, është e detyrueshme prania e mbrojtësit të të miturit.
9. Marrja e detyrueshme e materialeve biologjike nga i mituri ose kryerja e procedurave mjekësore të detyruara bëhen sipas rregullave të parashikuara në nenin 201, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 80

Përmbajtja e vendimit të kontrollit intim dhe mjekësor

Vendimi i gjykatës lidhur me kërkesën për kontrollin intim dhe mjekësor, përveç parashikimeve të nenit 383, të Kodit të Procedurës Penale, përmban edhe:

- a) subjektin që ka sjellë kërkesën në gjykatë;
- b) identitetin e të miturit, ndaj të cilit do të ndërmerret veprimi;
- c) shkaqet e arsyeshme për të kryer veprimin procedural;
- d) objektin, sendin ose substancën dhe të dhëna lidhur me to, të cilat mund të gjenden gjatë kontrollit;
- dh) afatin e ekzekutimit të vendimit;
- dh) organin që do të ekzekutojë vendimin.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

KREU IX MASAT E SIGURIMIT

Neni 81 Caktimi i masës së sigurimit

1. Ndaj të miturit nuk mund të caktohet një masë sigurimi më e rëndë, nëse i njëjti qëllim mund të realizohet me një masë më të lehtë.

2. Kur kërkohet të caktohet masë sigurimi ndaj një të mituri, prokurori në kërkesë dhe gjykata në vendim mban parasysh dhe arsyeton interesin më të lartë të të miturit, nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të një të mituri.

3. Në caktimin e masës së sigurimit, gjyqtari dëgjon personalisht të miturin dhe jep vendimin menjëherë.

Neni 82 Masa sigurimi të veçanta për të miturit

Përveç masave të sigurimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të vendosen edhe këto masa:

- a) vendosja e të miturit në mbikëqyrje;
- b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar.

Neni 83 Vendosja e të miturit në mbikëqyrje

1. Vendosja e të miturit në mbikëqyrje synon garantimin e paraqitjes së të miturit, sa herë kërkohet, përpara oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit ose gjykatës. Kjo masë realizohet përmes marrjes përsipër nga ana e prindit, të afërmit, institucionit ose personit të specializuar që të garantojë sjelljen e të miturit dhe të mbikëqyrës nëse sjellja është e përshtatshme.

2. Vendosja në mbikëqyrje, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet vetëm me pëlqimin e të miturit dhe të personit që do ta mbikëqyrë atë.

3. Personi mbikëqyrës mund të tërhiqet nga ushtrimi i mbikëqyrjes së të miturit në çdo kohë, në rast se çmon se nuk mund të garantojë paraqitjen e të miturit sa herë kërkohet nga organi kompetent dhe nuk garanton sjelljen dinjitoze të të miturit. Personi mbikëqyrës, për këtë, njofton menjëherë gjykatën.

4. Personi mbikëqyrës mund të zëvendësohet në rastin e tërheqjes ose dështimit të mbikëqyrjes.

5. Në rast se mbikëqyrja e të miturit dështon për shkaqe objektive që nuk lidhen me personin mbikëqyrës, gjykata vendos zëvendësimin e tij.

6. Kur dështimi vjen nga veprime ose mosveprime të personit mbikëqyrës, gjykata urdhëron dënimin e tij me gjobë deri në 20 000 lekë.

7. Urdhri i gjykatës është i paankimueshëm.

8. Gjikata, sipas rastit, vendos zëvendësimin e personit mbikëqyrës ose të masës së sigurimit ndaj të miturit.

Neni 84 Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar

1. Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar bëhet ndaj të miturit, interesat e të cilit kërkojnë një vëmendje dhe mbikëqyrje të posaçme dhe që për rrethanat konkrete nuk mund të realizohet nga ana e prindit ose personave të afërm.

2. Shërbimi i specializuar mundësohet nga institucionet ose persona juridikë të licencuar edhe për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

3. Rregullat mbi mënyrën e organizimit, të funksionimit të shërbimit të specializuar, të programeve dhe mënyrës së financimit të tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 85

Afati dhe vleftësimi i arrestit ose ndalimit të të miturit

1. I mituri mund të arrestohet ose ndalohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të këtij Kodi.
2. Kur nuk urdhëron lirim të menjëhershëm, prokurori, pa vonesë, por, sidoqoftë brenda 48 orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e tyre në gjykatën kompetente.
3. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë dhe i mituri të lirohet menjëherë, përveç kur gjykata i vleftëson ato dhe cakton masë sigurimi.
4. Në shqyrtimin për vleftësimin e arrestit ose të ndalimit, gjyqtari dëgjon personalisht të miturin dhe jep vendimin menjëherë.

Neni 86

Kushtet për vendosjen e arrestit në burg për të miturit

Përveç parashikimeve të nenit 228, të Kodit të Procedurës Penale, masa e arrestit në burg mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm nëse ekziston edhe ndonjë nga kriteret e mëposhtme:

- a) sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet;
- b) masa është e domosdoshme, sepse i mituri:
 - i) përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të menjanohet me ndonjë mënyrë tjetër;
 - ii) përpiket t'i shmanget drejtësisë.

Neni 87

Zbatimi i masës së arrestit në burg për të miturit

1. Çdo muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit gjykata edhe kryesisht, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës.
2. Prokurori ka barrën e provës për të arsyetuar vazhdimin e arrestit në burg.
3. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale zbatohen për aq sa është e mundur për paraburgimin ndaj të miturit në konflikt me ligjin.
4. Pavarësisht nga parashikimi i bërë në pikën 3, të këtij neni, i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se gjysma e kohës së paraburgimit të caktuar për të rriturin, sipas Kodit të Procedurës Penale.

KREU X

ELEMENTE TË PROCESIT TË GJYKIMIT TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Neni 88

Gjykim i drejtë dhe i shpejtë

1. Gjykimi i të miturit në konflikt me ligjin bëhet duke mbajtur në konsideratë respektimin e parimit të parashikuar në nenin 17, të këtij Kodi, mbi shqyrtimin pa vonesë dhe me përparësi.
2. Çështja e një të mituri në konflikt me ligjin dërgohet në gjykatë jo më vonë se 3 muaj nga dita e regjistrimit të emrit në regjistër, me përjashtim të rasteve kur gjatë kësaj periudhe ai është akuzuar për një veprë tjetër penale ose në rastet e veprave penale që gjykohen nga Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në këto raste zbatohen afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.
3. Gjykata e shkallës së parë përfundon shqyrtimin e çështjes në një kohë sa më të shpejtë, por jo më vonë se 6 muaj nga data e depozitimit të akteve në gjykatë.
4. Gjykata e apelit përfundon shqyrtimin e çështjes në një kohë sa më të shpejtë, por jo më vonë se 2 muaj nga data e dërgimit të akteve në gjykatë.
5. Gjykata e Lartë shqyrton pranueshmërinë e rekursit, si dhe gjykon çështjen sa më shpejt të jetë e mundur.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 89

Gjykimi me dyer të mbyllura

Gjykimi i një të mituri në konflikt me ligjin zhvillohet në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura.

Neni 90

Pjesëmarrja në gjykim e të miturit

1. Gjykimi i të miturit nuk mund të zhvillohet në mungesë të tij.
2. Gjykata garanton pjesëmarrjen e të miturit në gjykim përmes:
 - a) zhvillimit të një procesi të pranueshëm për aftësinë e të kuptuarit të të miturit;
 - b) realizimit të pushimeve të herëpashershme dhe me kohë të arsyeshme, në përputhje me moshën, kushtet shëndetësore, nevojat e veçanta, përfshirë nevoja që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe rrethana të tjera të të miturit.

Neni 91

Gjykimi në prani të të miturit dhe kufizimet

1. Gjykimi zhvillohet vetëm në prani të të miturit.
2. Gjykata, me iniciativën e vet ose me kërkesë të palës, mund të marrë vendim lidhur me largimin e të miturit nga salla e gjyqit gjatë shqyrtimit vetëm të një ose disa provave, nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit.
3. Mungesa e të miturit gjatë procesit gjyqësor duhet të jetë për një periudhë sa më të shkurtër.
4. Gjyqtari gjatë gjykimit ka të drejtë të ndalojë pjesëmarrjen e përfaqësuesit ligjor gjatë veprimit procedural vetën, nëse kjo gjë është në interesin më të lartë të fëmijës.
5. Menjëherë pas miratimit të vendimit, sipas pikës 2, të këtij neni, gjykata i shpjegon palëve të drejtën për të kundërshtuar këtë vendim, brenda së njëjtës seancë, duke i dhënë gjykatës argumentet e tyre. Në rast kundërshtimi, gjykata, pezullon shqyrtimin e provës deri në marrjen e vendimit. Vendimi lidhur me pranimin ose jo të kundër-shtimit merret menjëherë.
6. Pasi i mituri kthehet në sallën e gjyqit, gjykata, i shpjegon të miturit, aq sa është e nevojshme dhe në mënyrë të kuptueshme, përmbajtjen e provave të shqyrtuara në mungesë të tij.
7. Në të gjitha rastet kur gjykata shqyrton provat në mungesë të të miturit, mbrojtësi ose përfaqë-suesi ligjor duhet të jenë të pranishëm.

Neni 92

Pranimi i fajësisë prej të miturit

1. Gjatë procedurës së hetimit dhe gjykimit i mituri i pandehur nuk mund të detyrohet të bëjë deklarime që tregojnë vetëpërgjegjësi penale.
2. Heshtja e të miturit gjatë procedurës së hetimit dhe gjykimit nuk mund të konsiderohet si pranim i fajësisë.
3. Në rast se i mituri pranon fajësinë, gjykata, në çdo rast, duhet të sigurohet që kjo nuk ndodh për shkak që lidhen me moshën, zhvillimin dhe aftësinë e të miturit për të perceptuar dhe kuptuar frikën e një dënimi të mundshëm ose frikën prej tejzgjatjes së kohës së marrjes në pyetje.

KREU XI

QËLLIMI DHE LLOJET E DËNIMIT PËR TË MITURIT

Neni 93

Qëllimi i dënimit

Qëllimi i dënimit të të miturit është rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 94

Parimet e përgjithshme të dënimit

1. Gjatë gjithë procesit të marrjes së vendimit, gjykata, mban në konsideratë se dënimi me burgim i të miturit është mjeti i fundit i mundshëm, i cili konsiderohet vetëm nëse masat e shmangies, të parashikuara në kreun VII, të këtij Kodi, janë të papërshtatshme.

2. Gjatë dhënies së vendimit gjykata merr në konsideratë në radhë të parë interesin më të lartë të të miturit dhe raportin e vlerësimit individual për të.

3. Gjatë marrjes së vendimit ndaj të miturit që është deklaruar fajtor për një vepër penale, gjykata mban në konsideratë gjithashtu:

- a) trajtimin e të miturit në mënyra të përshtatshme për garantimin e mirëqenies së tij;
- b) përshtatjen me rrethanat dhe rrezikshmërinë e veprës së kryer, si dhe me moshën, rrethanat individuale dhe nevojat e veçanta të të miturit;
- c) nxitjen e riintegritimit të të miturit dhe përfshirjen e tij në një rol sa më konstruktiv në shoqëri;
- d) parashikimin e një plani individual për sa më sipër;
- e) caktimin e një dënimi sa më të përshtatshëm për të korrigjuar sjelljen e të miturit.

4. Urdhri penal i parashikuar në nenin 406/a deri në nenin 406/f, të Kodit të Procedurës Penale, nuk zbatohet në rastin e të miturit në konflikt me ligjin.

5. Gjykimi me marrëveshje, parashikuar nga neni 406/d deri në nenin 406/f, të Kodit të Procedurës Penale, zbatohet në rastin e zbatimit të masës së shmangies për të miturin në konflikt me ligjin.

Neni 95

Llojet e dënimeve për të mitur

1. Dënimet për të miturit janë dënimet jo me burgim dhe dënimi me burgim.

2. Në dënimet jo me burgim përfshihen:

- a) kufizimi i lirisë;
- b) qëndrimi në shtëpi;
- c) gjoba;
- d) kryerja e një pune me interes publik;
- e) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;
- f) përmbushja e detyrimeve të caktuara.

Neni 96

Klasifikimi dhe caktimi i dënimeve për të mitur

1. Dënimet ndaj të miturit klasifikohen në dënime kryesore dhe plotësuese.

2. Janë dënime kryesore:

- a) burgimi;
- b) kufizimi i lirisë;
- c) gjoba.

3. Janë dënime plotësuese:

- a) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;
- b) kryerja e një pune me interes publik;
- c) përmbushja e detyrimeve të caktuara;
- d) qëndrimi në shtëpi.

4. Ndaj të miturit mund të jepet vetëm një dënim kryesor.

5. Dënim kryesor mund të jepet së bashku më jo më shumë se një dënim plotësues.

6. Bashkë me dënimin mund të jepen një ose disa masa të parashikuara nga kreu VII i këtij Kodi.

Neni 97

Burgimi

1. Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet.

3. Për përcaktimin e masës së dënimit për të miturin, gjykata merr parasysh dhe i kushton vëmendje të veçantë të gjitha rrethanave që lidhen me shkallën e pjekurisë së të miturit dhe kohën që nevojitet për edukimin dhe formimin profesional. Megjithatë, në varësi të shkallës së fajësisë, dënimi mund të jetë më i shkurtër, kur vlerësohet se është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e tij.

Neni 98

Kufizimi i lirisë

1. Kufizimi i lirisë është vendosja e të miturit në një institucion/qendër të caktuar nën mbikëqyrje pa u izoluar nga shoqëria dhe komuniteti, me qëllim edukimin dhe rehabilitimin përmes programeve të posaçme.

2. Në mjediset, në të cilat realizohet kufizimi i lirisë:

a) niveli i masave të sigurisë është i ulët;

b) numri i të miturve të vendosur në to është sa më i vogël, me qëllim që të mundësohet trajtimi individual i tyre;

c) përmasat e këtyre mjediseve janë të tilla që lehtësojnë aksesin dhe kontaktin e të miturit me familjarët.

3. Mjediset, në të cilat realizohet kufizimi i lirisë:

a) kanë shpërndarje gjeografike në të gjithë territorin e vendit, me qëllim që të miturve t'u garantohet kontakti me familjarët e tyre;

b) janë të integruara me mjedisin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të komunitetit.

4. Kufizimi i lirisë për të miturin nuk mund të jetë më shumë se tre vjet.

5. Rregullime të veçanta, lidhur me funksionimin e mjediseve dhe përcaktimin e nivelit të sigurisë të tyre, standardet e programeve të edukimit dhe të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 99

Gjoha

1. Masa e gjobës mund të zbatohet për një të mitur nëse ka të ardhura monetare nga një burim i ligjshëm.

2. Në rastet kur gjoha i vendoset një të mituri, masa e saj është sa gjysma e gjobës që do t'i jepej një të rrituri në të njëjtat kushte, sipas parashikimeve të Kodit Penal.

Neni 100

Ndalimi për kryerjen e një veprimtarie

1. I mituri mund të ndalohet të kryejë një veprimtari të caktuar për një periudhë kohore nga një deri në tre vjet, nëse kjo çmohet si e papërshtatshme nga gjykata për rehabilitimin e të miturit dhe parandalimin e kryerjes prej tij të veprave penale të tjera.

2. I mituri mund të ndalohet të kryejë një veprimtari të caktuar, sipas pikës 1, të këtij neni, deri në moshën 18 vjeç.

Neni 101

Kryerja e një pune me interes publik

1. Kryerja e një pune me interes publik për të miturit mund të jetë nga 40 deri në 300 orë. Kohëzgjatja ditore e punës me interes publik nuk mund të jetë më shumë se 4 orë në ditë.

2. Nëse burgimi është zëvendësuar me punë me interes publik, puna me interes publik mund të jetë më e gjatë në kohë. Në këtë rast bëhet konvertimi, sipas nenit 109 të këtij Kodi.

3. Në rastet e zbatimit të vendimit për kryerjen e një pune me interes publik, si një vendim plotësues, kryerja e kësaj pune, mund të vendoset për një kohë më të shkurtër se minimumi i orëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Puna me interes publik zbatohet në mënyrë të tillë që të mos pengojë procesin e edukimit dhe mund të shoqërohet me detyrimin për ndjekjen e një kursi profesional.

5. Në rastet e marrjes së vendimit për kryerjen e një pune me interes publik është e nevojshme që i mituri të vendoset në një vend pune ku përvoja i shërben të bëhet një njeri i denjë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

6. Puna me interes publik, si një vendim plotësues, mund të zbatohet ndaj një të mituri edhe në rastet kur neni përkatës i Kodit Penal nuk e parashikon atë si një lloj dënimi.

Neni 102

Përmbushja e detyrimeve të caktuara

1. Gjykata mund të urdhërojë që i mituri në konflikt me ligjin penal të përmbushë një ose më shumë detyrime të caktuara, të tilla si:

- a) të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose, sipas rastit, një program arsimimi;
- b) të ndjekë një program të formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional;
- c) të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës e siguruar nga programet sociale të punësimit;
- c) të riparojë dëmin civil të shkaktuar;
- d) të ndjekë një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës;
- dh) të mos frekuentojë vende të caktuara;
- e) të mos shoqërohet me persona të caktuar, të cilët mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe edukimin e tij.

2. Gjykata, sipas rastit, mund të urdhërojë, për aq sa janë të zbatueshme, edhe detyrimet e parashikuara nga neni 60, i Kodit Penal, ose edhe detyrime të tjera që çmohen prej saj se janë në interesin më të lartë të të miturit.

3. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen autoritetet kompetente dhe procedura që do të ndiqet nga ana e tyre në rastet e urdhërimeve të gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 103

Qëndrimi në shtëpi

1. Qëndrimi në shtëpi parashikon detyrimin e të miturit të mos largohet, për një periudhë të caktuar, nga banesa e tij e përhershme ose e përkohshme ose një vend i caktuar, ku ai qëndron ose kurohet përkohësisht.

2. Qëndrimi në shtëpi mund të jepet për një periudhë nga 6 muaj deri në 1 vit.

3. Qëndrimi në shtëpi zbatohet në rastin e veprave penale që dënohen jo më shumë se me 5 vjet burgim.

4. Qëndrimi në shtëpi zbatohet në mënyrë të tillë që të mos cenojë procesin arsimor dhe/ose të punësimit të të miturit.

5. Qëndrimi në shtëpi mund të mbikëqyret në mënyrë elektronike.

Neni 104

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim

1. Nëse gjykata jep dënim me burgim deri në pesë vjet dhe i mituri nuk është dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale me dashje, ajo mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të vihet në provë, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

2. Në rastet kur gjykata vendos, sipas pikës 1, të këtij neni, i referohet parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal.

Neni 105

Rregulla të dënimit jo me burgim

Kur jep dënimin jo me burgim, gjykata mundet që ndaj të miturit, të vendosë një ose disa prej masave detyruese, sipas parashikimeve të nenit 68 të këtij Kodi. Në këto raste ndaj të miturit nuk mund të vendosen masa detyruese, të cilat janë të pamundura të përmbushen prej tij ose tejkalojnë aftësitë mendore dhe fizike të të miturit.

Neni 106

Dënimi nën minimumin e parashikuar nga ligji

Gjykata, nisur nga rrezikshmëria e pakët e të miturit dhe e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, nga fakti se i mituri nuk ka qenë i dënuar më parë, nga prania e disa

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

rrethanave lehtësuese dhe mosprania e asnjë rrethane rënduese, mund të caktojë një dënim nën minimum ose një lloj dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita përkatëse.

KREU XII EKZEKUTIMI I VENDIMEVE

Neni 107

Ekzekutimi i vendimit të dënimit jo me burgim

1. Ekzekutimi i vendimit të dënimit jo me burgim, të parashikuar prej këtij Kodi, zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

2. I mituri vazhdon të vuajë dënimin jo me burgim ose me kusht të përcaktuar në vendimin e dënimit si i mitur edhe nëse ka mbushur moshën 18 vjeç para fillimit të ekzekutimit ose gjatë ekzekutimit të këtij vendimi. Në këtë rast, zbatohen dispozitat përkatëse të këtij Kodi.

3. Në rast të shkeljes së regjimit të përcaktuar për ekzekutimin e vendimit të dënimit jo me burgim nga një i mitur, Shërbimi i Provës harton një procesverbal paralajmërimi, i cili, sipas rastit, i dorëzohet ose i dërgohet me postë të dënuarit kundrejt vërtetimit të marrjes.

4. Nëse i mituri i shmanget vuajtjes së dënimit jo me burgim, dënimit me kusht ose kryerjes së një detyrimi, Shërbimi i Provës, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat, i raporton prokurorit dhe, sipas rastit, i propozon ndryshimin e vendimit.

5. Prokurori, sipas rastit, mund t'i kërkojë gjykatës ndryshimin e vendimit.

6. Gjykata, gjatë shqyrtimit të kërkesës, dëgjon prokurorin, të miturin, mbrojtësin e tij dhe merr mendimin e përfaqësuesit të Shërbimit të Provës dhe përfaqësuesit ligjor të të miturit.

7. Me kërkesë të palës/ve, gjykata mund të shqyrtojë edhe prova të tjera.

8. Në këtë rast gjykata shprehet brenda një jave nga paraqitja e kërkesës.

Neni 108

Kryerja e një vepre penale gjatë ekzekutimit të dënimit jo me burgim

1. Në qoftë se brenda periudhës së vuajtjes së dënimit jo me burgim ose dënimit me kusht i mituri kryen një vepër penale, Shërbimi i Provës njofton prokurorin, i cili, sipas rastit, i drejtohet gjykatës.

2. Në qoftë se brenda periudhës së vuajtjes së dënimit jo me burgim ose dënimit me kusht i mituri kryen një vepër penale më të lehtë ose një vepër penale nga pakujdesia, në rast të deklarimit fajtor, gjykata, sipas rastit, mund të vendosë ndryshimin ose jo të vendimit përkatës.

3. Në rast se i mituri kryen një krim me dashje ose krim, për të cilin parashikohet dënim mbi 8 vjet burgim, në rast të deklarimit fajtor, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të revokojë vendimin e dënimit jo me burgim dhe të marrë vendim për zbatimin e dënimit me burgim për pjesën e mbetur të dënimit, duke mbajtur në konsideratë që dënim i me burgim është alternativa e fundit.

Neni 109

Llogaritja për efekt konvertimi të dënimit

Gjykata, në rastet kur ndryshon vendimin e dënimit, llogaritja për efekt të konvertimit të dënimit konsideron të barabarta me njëra tjetrën si më poshtë:

- a) dhjetë orë punë me interes publik, me
- b) pesë mijë lekë gjobë, me
- c) tre ditë qëndrimi në shtëpi, me
- ç) dy ditë të kufizimit të lirisë, me
- d) një ditë burgim.

Neni 110

Vendosja e të miturit në mjediset e paraburgimit dhe të burgimit

1. I pandehuri i mitur, ndaj të cilit caktohet paraburgimi si masë sigurimi, duhet të vendoset vetëm në seksionin për të mitur në mjediset e paraburgimit, ndërsa i dënuar me burgim vendoset në institucion për ekzekutimin e vendimeve penale të posaçëm për të miturit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Shërbimet në institucionet e paraburgimit dhe burgimit ku vendosen të pandehurit/të dënuarit e mitur duhet të jenë në përputhje me kërkesat e respektimit të shëndetit dhe dinjitetit të të miturit dhe të jenë në funksion të rishoqërizimit, riintegritimit, rehabilitimit dhe parandalimit të rikryerjes së veprës penale ose të kryerjes së një veprë tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

3. Për garantimin e interesit më të lartë të të miturit, institucioni përkatës i paraburgimit ose i burgimit duhet të ketë personel të mjaftueshëm, të specializuar dhe të trajnuar në vazhdimësi.

4. Në personelin e institucioneve të paraburgimit dhe të burgimit për të mitur duhet të ketë të paktën një mjek, një infermier, një psikolog, një punonjës social. Sipas rastit, institucioni duhet të sigurojë mundësinë e një mjeku peditër, mjeku psikiatër ose çdo specialisti tjetër, sipas nevojave dhe sipas një regjimi kontrolli të përcaktuar.

5. Të miturit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur ose në seksionet për të miturit u garantohet mbikëqyrja dhe kontrolli vizual dhe/ose elektronik i të miturve. Rregulla të veçanta lidhur me mbikëqyrjen dhe kontrollin përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 111

Rregulla të posaçme të ekzekutimit të vendimit me burgim

1. Në funksion të interesave të posaçëm të mbrojtjes dhe kujdesit për të miturit merren masa të veçanta, me të cilat garantohen standardet e përcaktuara nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, si dhe nga dispozitat e këtij Kodi.

2. Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve parashikohen në mënyrë të veçantë rregulla për:

- a) strukturën dhe funksionimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur;
- b) planifikimin individual të ekzekutimit të dënimit për të mitur;
- c) zbatimin e formave të stimuljeve dhe masave të tjera për të dënuarit e mitur;
- ç) dhënien e masave disiplinore ndaj të dënuarve të mitur;
- d) procedurën për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të të dënuarve të mitur;
- dh) organizimin e procesit të rehabilitimit të të dënuarve të mitur;
- e) kushtet për zbatimin e masave të sigurisë dhe përdorimin e mjeteve të posaçme për të dënuarit e mitur;
- ë) funksionimin e regjistrave dhe fashikujve personalë të të dënuarve të mitur;
- f) mbikëqyrjen dhe kontrollin vizual dhe/ose elektronik të të dënuarve të mitur;
- g) kushtet më të detajuara për ekzekutimin e vendimit me burgim për të dënuarit e mitur.

Neni 112

Mbrojtësi i të miturit gjatë ekzekutimit

1. Për realizimin e të drejtave në procesin e ekzekutimit të vendimeve penale, të miturit i caktohet mbrojtës kryesisht sipas dispozitave të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi.

2. Me pëlqimin e të miturit dhe kur kjo është në interes të tij, ky mbrojtës mund të jetë i njëjti që e ka përfaqësuar atë në fazat e mëparshme të procesit.

KREU XIII

KUSHTET DHE RREGULLAT PËR TË MITURIT NË MJEDISËT E PARABURGIMIT DHE BURGIMIT

Neni 113

Vendet e veçanta për të pandehurit/të dënuarit e miturit

1. Të pandehurit/të dënuarit e mitur vendosen veçmas nga të paraburgosurit/të dënuarit e rritur.
2. Ndalohej vendosja, mbajtja ose lëvizja e të miturit jashtë institucionit së bashku me një të rritur.
3. Të paraburgosurat/të dënuarat e mitura vendosen veçmas nga të paraburgosurit/të dënuarit meshkuj të mitur.

4. Mund të bëhet përjashtim nga rregulli i pikave 2 dhe 3, të këtij neni, në rastet kur të miturit, pavarësisht përkatësisë gjinore, dhe të miturit me të rriturit marrin pjesë bashkërisht në veprimtaritë rehabilituese, arsimore, kulturore, sportive dhe veprimtari të tjera me natyrë kulturore dhe edukative.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

5. Në mënyrë që të sigurohet mjedis i sigurt për të miturit në institucionin/seksionin për ta, të miturit ndahen në bazë të grupmoshës, llojit dhe rëndësisë së veprës penale, zhvillimit fizik dhe mendor, si dhe karakteristikave të tjera duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të të miturit.

6. Rregulla më të detajuara për mjediset e paraburgimit dhe të burgimit të të miturve në konflikt me ligjin përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 114

Kontrolli mjekësor, psikologjik dhe vendosja e përshtatshme në mjedise

1. Menjëherë pas pranimit në mjediset e burgimit ose të paraburgimit çdo i mitur duhet të ekzaminohet nga një mjek, me qëllim identifikimin dhe regjistrimin e ndonjë shenje/të dhëne, e ndonjë keqtrajtimi të mëparshëm ose ndonjë dëmtimi fizik ose mendor që kërkon kujdes mjekësor. Pas ekzaminimit të të miturit, mjeku përgatit një raport, në të cilin përshkruan faktin nëse tek i mituri konstatohen ose jo shenjat/të dhënat, keqtrajtimet ose dëmtimet e përshkruara më sipër.

2. Çdo i mitur duhet të intervistohet jo më vonë se 24 orë nga momenti i pranimit, nga një psikolog ose punonjës social dhe të përgatitet një raport psikologjik dhe social, në të cilin të identifikohet dhe përshkruhet çdo faktor që lidhet me llojin dhe nivelin e kujdesit dhe programit që nevojitet për trajtimin e të miturit.

3. Raportet e përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, i jepen drejtuesit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur, me qëllim që të përcaktohet vendosja sa më e përshtatshme e të miturit brenda mjediseve dhe lloji e niveli i kujdesit dhe programit që duhet ndjekur. Kur është i nevojshëm trajtimi dhe rehabilitimi i posaçëm dhe kohëzgjatja e qëndrimit në mjedis e lejon, personeli i mjedisit, i trajnuar për këtë qëllim, përgatit një plan individual të trajtimit, duke specifikuar objektivat dhe kohën, mjetet, fazat dhe hapat me të cilat ato objektiva duhet të trajtohen.

Neni 115

Kujdesi dhe trajtimi shëndetësor i të miturve

1. Të miturit të paraburgosur/të dënuar i sigurohet kujdesi dhe trajtimi mjekësor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) shërbime shëndetësore psikiatrike/ psikologjike e mendore;
- b) shërbime rehabilituese nga droga e alkooli;
- c) kujdes të trajtimit dental dhe të syve (oftalmologjik);
- ç) shërbime shëndetësore të shëndetit seksual dhe riprodhimit;
- d) trajtim për HIV/AIDS;
- dh) shërbime lidhur me paralindjen në rastin e vajzave shtatzëna; dhe
- e) kontrole të rregullta mjekësore, përfshirë, sipas rastit, edhe kontrollin gjinekologjik;
- ë) kujdes për zbulimin e çdo gjendjeje tjetër që mund të pengojë integrimin e të miturit në shoqëri.

2. Çdo mjedis burgimi ose paraburgimi për të mitur duhet të ketë qasje/akses të menjëhershëm në objekte/mjedise të përshtatshme mjekësore dhe pajisje të përshtatshme në raport me numrin dhe kërkesat e të burgosurve dhe stafit të tij të trajnuar për kujdesin shëndetësor parandalues dhe trajtimin e emergjencave mjekësore.

3. Nëse kujdesi i kërkuar shëndetësor nuk mund të ofrohet brenda institucionit të paraburgimit/ burgimit, i mituri ka të drejtë të marrë leje dhe, në rast emergjence, t'i ofrohet leje për të kryer kontrollin mjekësor dhe për të marrë trajtimin e nevojshëm shëndetësor.

4. Çdo i mitur që është i sëmurë ose ankohet për sëmundje ose që tregon simptomat e vështirësive fizike ose mendore, duhet të ekzaminohet/vizitohet menjëherë nga mjeku.

5. Për çdo trajtim mjekësor duhet të merret pëlqimi i të miturit pas informimit të tij lidhur me të.

6. Kur jeta e të miturit mund të jetë në rrezik ose i mituri mund të pësojë një dëmtim të përhershëm të shëndetit dhe kur refuzon të japë pëlqimin për trajtim mjekësor, një pëlqim i tillë duhet të merret nga prindërit ose përfaqësuesi ligjor i të miturit dhe, në mungesë të tyre, nga gjykata.

7. Kur mjeku vendos se duhet trajtim i menjëhershëm për të mbrojtur shëndetin ose jetën e të miturit dhe/ose shëndetit të të tjerëve, trajtimi fillon pa marrë pëlqimin e prindit ose përfaqësuesit ligjor të të miturit.

8. I mituri kontrollohet e trajtohet nga një mjek i së njëjtës gjini ose i gjinisë së përzgjedhur prej tij.

9. Çdo periudhë e trajtimit mjekësor do të përlogaritet si pjesë e periudhës së dënimit të të miturit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

10. Kur nga kontrolli mjekësor konstatohet se i mituri ka pësuar abuzim fizik ose seksual përpara vendosjes ose gjatë qëndrimit të tij në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur, mjeku njofton menjëherë prokurorinë kompetente. Pas këtij njoftimi, prokuroria merr masa të menjëhershme që të miturit t'i ofrohet këshillim ligjor falas për ta mbështetur në çdo pretendim.

11. Raporti mjekësor dhe të dhënat e trajtimit regjistrohen dhe mbahen në fashikullin personal të të miturit. Të dhëna të tilla do të transferohen në çdo Institucion tjetër të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku mund të vendoset i mituri.

Neni 116

Kushtet e jetesës dhe të ushqimit për të mitur

1. Për kushtet e jetesës dhe të ushqimit për të pandehurit/të dënuarit e mitur tregohet një kujdes edhe më i veçantë në krahasim me kushtet e të pandehurve dhe të dënuarve të tjerë.

2. Kushtet e jetesës dhe të ushqimit duhet të jenë në përputhje me moshën, gjendjen dhe nevojat e veçanta të të miturit.

3. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur siguron që të dënuarit e mitur të lëvizin në mënyrë të pavarur në territorin e institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në programin ditor dhe në planin individual të ekzekutimit të dënimit.

4. I mituri i dënuar me burgim ka të drejtë për lehtësi dhe shërbime që plotësojnë të gjitha kushtet për shëndetin dhe dinjitetin njerëzor. Lehtësitë dhe shërbimet përfshijnë:

a) vendin e fjetjes, i cili përbëhet nga një shtrat individual në një dhomë të veçantë, përveç kur konsiderohet e nevojshme për të miturin për të ndarë të njëjtën dhomë fjetjeje, e cila mund të mbikëqyret pa krijuar shqetësim;

b) një shtrat individual të mjaftueshëm dhe të pastër, i cili është i përshtatshëm me klimën;

c) një dollap për vendosjen e sendeve personale; dhe

ç) mjedise të përshtatshme sanitare që janë higjienike dhe respektojnë nevojat e jetës private dhe të veçanta gjinore të të miturit.

5. I mituri i dënuar lejohet të veshë rrobat e veta, me kusht që ato të jenë të përshtatshme dhe në përputhje me rregulloret përkatëse. Nëse i mituri ka marrë leje për t'u larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit, nuk do të veshë asnjë veshje që e identifikon atë si një të dënuar.

6. I mituri i dënuar ka të drejtë për ujë dhe ushqim të mjaftueshëm me vlera ushqyese, sipas moshës dhe nevojave të veçanta.

Neni 117

Organizimi i programeve edukuese dhe rehabilituese

1. Të pandehurve/të dënuarve të mitur/të rinj u sigurohet arsimi bazë i detyrueshëm dhe, sipas rastit, edhe arsimi i mesëm ose i lartë.

2. Procesi arsimor në mjediset e paraburgimit dhe burgimit për të mitur duhet të jetë në përputhje me standardet e arsimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Gjatë paraburgimit dhe burgimit organizohet procesi mësimor dhe i rehabilitimit, me qëllim që të pandehurve/të dënuarve të mitur t'u sigurohet arsim i përgjithshëm dhe/ose arsim profesional mundësisht jashtë mjediseve të paraburgimit dhe burgimit. Vetëm në raste të veçanta, procesi mësimor duhet të sigurohet që i mituri të ndjekë arsimin profesional/trajnimin në mjediset e paraburgimit dhe burgimit.

4. Të burgosurve të mitur/të rinj u krijohen mundësi për trajnim profesional, sipas interesave dhe prirjeve të tyre dhe që do të ndihmojë në punësimin e tyre pas largimit nga institucioni.

5. Dokumentet që vërtetojnë shkollimin e realizuar nga të pandehurit/të dënuarit e mitur/të rinj në periudhën kur ata kanë qenë të pandehur ose kur vuanin dënimin nuk duhet të përmbajnë informacion që bën të mundur identifikimin e të miturit si një ish i dënuar ose identifikimin e një dënimi të mëparshëm.

6. Për të dënuarit e mitur që kanë vështirësi të të mësuarit ose të nxënies që lidhen me aftësinë e kufizuar, si dhe për të miturit që nuk kanë ndjekur shkollën organizohen programe të veçanta dhe individuale të arsimit.

7. Procesi arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur rregullohet me urdhër të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 118

Mundësitë për punë e banim

1. I mituri ka të drejtë të kryejë një punë që shpërblehet. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur nxit kryerjen e punës së shpërblyer. Kur është e mundur, i pandehuri/i dënuari i mitur mund të punojë edhe jashtë këtij institucioni, duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës lidhur me punësimin e të miturve.
2. I mituri punon jashtë kohës së studimit.
3. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, ndalohet punësimi i personave që vuajnë dënimin, që janë në paraburgim ose që kanë qenë të dënuar më parë.
4. I pandehuri/i dënuari i mitur mund të punojë vetëm nëse një gjë e tillë lehtëson edukimin profesional, punësimin e tij pas lirimit dhe në qoftë se nuk pengohet arsimimi i tij.
5. Kohëzgjatja e punës dhe e edukimit të të miturit nuk duhet të kalojë 8 orë në ditë.
6. Të miturit dhe të rinjtë e pastrehë përfitojnë nga programet sociale të parashikuara nga ligji për banesat sociale.

Neni 119

Sporti dhe ripërtëritja

1. Të miturit në konflikt me ligjin i krijohet mundësia për ecje, aktivitete sportive dhe ripërtëritëse të përditshme, me anë të përdorimit të pajisjeve të duhura sportive në një hapësirë të përshtatshme.
2. Të miturve, përfshirë dhe të miturit me aftësi të kufizuara, u sigurohen programe trajnuese fizike dhe ripërtëritëse.

Neni 120

Kontaktet me familjen dhe rrethin shoqëror

1. Me qëllim riintegrimin në shoqëri dhe zvogëlimin e pasojave negative sociale të kufizimit të lirisë, i mituri i dënuar me burgim dhe i mituri i paraburgosur, gëzon të njëjtat të drejta lidhur me garantimin e kontakteve me familjen dhe rrethin shoqëror.
2. Të miturit të dënuar me burgim dhe të paraburgosur i garantohet në mënyrë efektive e drejta për marrëdhënie të rregullta e të shpeshta me familjen e tij, me personin, sipas zgjedhjes së tij dhe rrethin shoqëror, si dhe e drejta për të marrë korrespondencë, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të të miturit.
3. I mituri ka të drejtë:
 - a) të ketë 8 vizita nga familjarë/rrethi shoqëror në muaj dhe si motivim nxitës 2 vizita shtesë në muaj. Në rast pamundësie të familjarëve dhe rrethit shoqëror për të kryer vizitat në orën e parashikuar, organi kompetent bën të mundur garantimin e së drejtës për takim në një kohë të përshtatshme për ta dhe të miturin;
 - b) të ketë 4 vizita në vit pranë familjes dhe si motivim vizita shtesë;
 - c) të ketë të paktën 1 vizitë në rastet e problemeve shëndetësore ose emocionale;
 - c) të kryejë jo më pak se 4 thirrje telefonike në javë, pa shpërblim, ku secila prej tyre nuk i kalon 15 minuta, dhe të ketë si motivim nxitës biseda telefonike pa limit me shpenzimet e veta. Në rast të mungesës së të ardhurave, të miturit i sigurohet kjo e drejtë falas nga organi kompetent, pranë të cilit i mituri ndodhet;
 - d) të kryejë 4 videokonferenca në muaj dhe si motivim nxitës 2 videokonferenca shtesë në muaj;
 - dh) të marrë letra dhe pako në numër të pa kufizuar;
 - e) të përdorë televizion dhe radio personale;
 - ë) të shpenzojë të holla nga llogaria e tij çdo muaj për të blerë ushqime, pajisje për përdorim personal dhe mallra të tjera, në një dyqan në territorin e mjedisit të rehabilitimit.
4. Të miturit që përfiton të drejtat e parashikuara nga ky nen i garantohet e drejta e privatësisë.
5. Mënyrat e përmbushjes së të drejtave, sipas këtij neni, parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgeve.

Neni 121

Leja për të miturin e dënuar me burgim

1. I mituri i dënuar me burgim ka të drejtë të marrë leje të shkurtër nga vendi i vuajtjes së dënimit tre herë në vit. Kohëzgjatja e kësaj lejeje nuk i kalon 15 ditë. Në këtë kohë përfshihet edhe koha e nevojshme për udhëtim në familjen e tij ose në destinacion.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. I mituri i dënuar me burgim ka të drejtë të marrë një leje të shkurtër nga vendi i vuajtjes së dënimit në rast se:

- a) ka kryer jo më pak se një të tretën e dënimit, nëse është dënuar me burgim deri në 3 vjet;
- b) ka kryer jo më pak se gjysmën e dënimit, nëse është dënuar me burgim deri në 8 vjet;
- c) ka kryer jo më pak se dy të tretat e dënimit, nëse është dënuar me burgim mbi 8 vjet.

Neni 122

Transferimi i përkohshëm i të miturit në një vend tjetër

1. I mituri i arrestuar/i dënuar mund të transferohet përkohësisht në një vend tjetër për të mitur në qoftë se një masë e tillë është e domosdoshme për sigurinë e tij ose për sigurinë e të miturve të tjerë. Në këtë rast, rregullat mbi transferimin parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

2. Menjëherë pas transferimit të të miturit në një vend tjetër:

- a) informohet përfaqësuesi ligjor për vendndodhjen e të miturit;
- b) i mituri i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor;
- c) i mituri ka të drejtën e një telefonate jo më shumë se 15 minuta.

Neni 123

Lënia e të dënuarit në vendin e rehabilitimit ose transferimi në vende të tjera të vuajtjes së dënimit

1. I mituri e kryen dënimin sipas një plani individual. Në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur funksionon një grup multidisiplinar i cili realizon vlerësimin fillestar, mbi bazën e të cilit hartohet plani individual. Një punonjësi social caktohet si menaxher rasti dhe është përgjegjës për zbatimin e Planit Individual. I mituri pyetet dhe jep pëlqimin për planin individual.

2. I dënuari që mbush moshën 18 vjeç nuk lejohet të qëndrojë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur dhe dërgohet në një vend të vuajtjes së dënimit për të rritur.

Neni 124

Format e motivimit nxitës për të miturin e dënuar

1. Kur i mituri tregon sjellje shembullore dhe të denjë, përfshirje në programet edukative dhe aktivitetet e zhvilluara në mjedisin e vuajtjes së dënimit për të mitur, organi kompetent zbaton format e mëposhtme të motivimit nxitës ndaj tij:

- a) dhënie e një deklaratë mirënjohjeje;
 - b) heqjen para kohe të një mase disiplinore;
 - c) dhënie e së drejtës për një vizitë shtesë;
 - d) dhënie e së drejtës për një bisedë me videokonferencë shtesë;
 - dh) pranimin e sendeve, të cilat nuk janë të ndaluara për t'u marrë nga të dënuarit në vendin e vuajtjes së dënimit për të mitur;
 - e) dhënie e së drejtës për të përdorur kompjuter;
 - ë) plotësimin e një dëshire që çmohet e mundshme dhe proporcionale.
2. Llojet dhe natyra e sendeve që kanë të drejtë të marrin të miturit në bazë të shkronjës "dh", të pikës 1, të këtij neni, të parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 125

Kufijtë e zbatimit të masave disiplinore

1. Administrata e institucionit të vuajtjes së dënimit për të mitur është e autorizuar të përdorë masa disiplinore ndaj të miturit në rastin e një shkeljeje disiplinore të kryer prej tij.

2. Masat disiplinore duhet të jenë zgjedhja e fundit që mund të merret për sjelljen e të miturit.

3. Puna nuk mund të jetë një masë disiplinore.

4. Masat disiplinore të marra nuk duhet të sjellin shkeljen apo cenimin e dinjitetit të të miturit, trajtimin e egër, çnjerëzor, degradues apo dëmtimin e shëndetit të tij fizik ose mendor. Ndalohet përdorimi si masë

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

disiplinore i veprimeve të mëposhtme, por pa u kufizuar në këto raste:

- a) dënim fizik ose trupor;
 - b) vendosje në një vend izolimi;
 - c) heqje ose kufizim i ushqimit;
 - ç) heqje ose kufizim i kujdesit shëndetësor;
 - d) ndalim ose kufizim i takimeve me familjarët ose kontakteve me ta.
5. Rregulla të posaçme për zbatimin e këtij neni parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 126

Llojet e masave disiplinore

1. Administrata e institucionit të vuajtjes së dënimit për të mitur është e autorizuar të përdorë masat e mëposhtme disiplinore:

- a) vërejtje në formë paralajmërimi;
 - b) kufizim deri në 1 muaj i së drejtës për të përdorur sende të lejuara, me përjashtim të ushqimeve dhe të mjekimit të dhënë nga mjeku;
 - c) kufizim i së drejtës për të përdorur dyqanin e ndodhur në mjedisin e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur deri në 1 muaj, me përjashtim të atyre artikujve që garantojnë të drejtat e parashikuara në nenin 116 të këtij Kodi;
 - ç) kufizim deri në një muaj i së drejtës për të marrë pako.
2. Ndalohet që i mituri gjatë vuajtjes së dënimit të vendoset në mjedise të veçuara/të izoluara.
3. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, nuk duhet të kalojnë kohën prej 3 muajsh brenda një viti.
4. Rregulla të posaçme për zbatimin e këtij neni parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 127

Procedurat për dhënien e masave disiplinore

1. Shkelja disiplinore e të miturit të arrestuar/të dënuar shqyrtohet në një seancë dëgjimore, me përjashtim të rastit kur i mituri prish rregullin ose pengon kryerjen e seancës, nuk merr pjesë ose refuzon të marrë pjesë në të. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin e mbajtur gjatë kësaj seance.

2. Gjatë seancës dëgjimore i mituri i arrestuar/i dënuar ka të drejtë të jetë i ulur, të marrë shënime e të japë shpjegime me gojë.

3. I mituri i arrestuar/i dënuar ka të drejtë për të pasur një mbrojtës në seancën dëgjimore të shqyrtimit të shkeljes disiplinore. Përpara se të fillojë seanca dëgjimore, i mituri informohet për të drejtën për të pasur një mbrojtës, gjë që ushtrohet brenda gjashtë orëve nga dhënia e informacionit, në rast se ka një pëlqim të lidhur me të. Në rast se mbrojtësi nuk paraqitet në kohën e përcaktuar, të miturit do t'i caktohet një mbrojtës kryesisht. I mituri jep pëlqimin lidhur me mbrojtësin kryesisht. Shpenzimet për mbrojtjen kryesisht mbulohen sipas parashikimeve të legjislacioni për ndihmën juridike.

4. Rregulla të posaçme lidhur me procedurat e masës disiplinore për të mitur dhe autoritetet përkatëse përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 128

Informimi për të drejtën e ankimit

1. I mituri i arrestuar/i dënuar ka të drejtë e ankimit për çdo vendim apo masë të dhënë ndaj tij nga autoritetet e administrimit të paraburgimit, të burgimit ose të dënimeve të tjera.

2. Administrata përkatëse e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur, në mjediset e të cilit qëndron i mituri i arrestuar/i dënuar jep atij menjëherë mundësinë për t'u informuar me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij, përfshirë edhe të drejtën për ankim dhe rregullat e ankimit të parashikuara nga ligji.

3. I mituri që nuk di të shkruajë dhe të lexojë e merr informacionin e mësipërm me gojë, në praninë e një personi që mban procesverbal, ku i mituri konfirmon me nënshkrimin e tij.

4. Informacioni i jepet të miturit në një formë që ai ta kuptojë atë. E njëjta vlen edhe për të miturin me aftësi të kufizuara.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Neni 129

Lirimi me kusht

1. I mituri i dënuar mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm nëse ka kryer:
 - a) jo më pak se një të tretën e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim deri në 3 vjet;
 - b) jo më pak se një të dytën e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim deri në 8 vjet;
 - c) jo më pak se dy të tretat e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim mbi 8 vjet.
2. Në rastet e parashikuara nga pika 1, e këtij neni, afati i burgimit i kryer nga i mituri nuk duhet të jetë më pak se tre muaj.
3. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të miturit, jo më vonë se tre muaj nga data më e afërt e lirimit me kusht, njofton Shërbimin e Provës mbi mundësinë e lirimit të të miturit. Shërbimi i Provës analizon sjelljen e të miturit gjatë kryerjes së dënimit, faktet e të dhënat kriminale të veprimeve të kryera në të kaluarën, personalitetin e të miturit, kushtet familjare, natyrën e krimit të kryer prej tij dhe rrethana të tjera, të cilat mund të ndikojnë në dhënien e vendimit për lirimin e parakohshëm.
4. Kur i mituri i dënuar është liruar me kusht nga kryerja e punës në shërbim të publikut, koha e dënimit e kryer aktualisht në formën e punës në shërbim të publikut do të përfshihet në kohën e parashikuar nga pika 1, e këtij neni, sipas përlogaritjes 10 orë punë në shërbim të publikut e barabartë me një ditë burgim.
5. Kur i mituri i dënuar është liruar me kusht nga kryerja e dënimit me kufizim të lirisë, koha e dënimit e kryer aktualisht në formën e dënimit me kufizim të lirisë do të përfshihet në kohën e parashikuar nga pika 1, e këtij neni, sipas përlogaritjes një ditë e kufizimit të lirisë e barabartë me një ditë burg.
6. Kur merret vendim për refuzimin e lirimit me kusht, gjykata duhet të tregojë masat që duhen marrë në të ardhmen nga i mituri dhe nga administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur për të përfituar në të ardhmen lirimin me kusht.

Neni 130

Vendimi për lirimin me kusht

1. Gjykata, me vendim të arsyetuar, vendos pranimin ose refuzimin të kërkesës për lirimin me kusht të të miturit. Vendimi përmban një vlerësim të plotë të ecurisë drejt rishoqërimit, rehabilitimit dhe gatishmërisë së të miturit për lirim, si dhe mendimet e shprehura të të miturit, administratës së Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të miturit dhe Shërbimit të Provës.
2. Vendimi për lirimin me kusht duhet të përmbajë kushtet që i vendosen të miturit, përmbushja e të cilave ka për qëllim mbështetjen e të miturit në procesin e riintegritimit dhe rishoqërimit të tij.
3. Të miturit duhet t'i krijohen kushte dhe të ndihmohet në përmbushjen e detyrimeve të vendosura në vendimin e lirimit.
4. Nëse i mituri shkel kushtet e vendosura në vendimin e lirimit, gjykata ka të drejtë të revokojë vendimin e lirimit.
5. Vendimi për rikthimin e të miturit në vendin e dënimit mund të jepet edhe në rastin kur i mituri përbën rrezik për veten ose për të tjerët, të tillë që nuk mund të shmanget në komunitet ose kur ai është dënuar për një vepër tjetër penale.
6. I mituri ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 131

Zëvendësimi i pjesës së pakryer të dënimit

- Pjesa e pakryer e dënimit me burgim mund të zëvendësohet me punë në shërbim të publikut ose me kufizimin e lirisë vetëm nëse i mituri ka kryer:
- a) jo më pak se një të katërtën e dënimit, në rast se është dënuar me burgim deri në 3 vjet;
 - b) jo më pak se një të tretën e dënimit, në rast se është dënuar me burgim deri në 8 vjet;
 - c) jo më pak se një të dytën e dënimit, në rast se është dënuar me burgim mbi 8 vjet.

Neni 132

Rishikimi periodik i lirimit me kusht

1. Rishikimi i mundësisë për lirim me kusht të të miturit shqyrtohet çdo tre muaj nga gjykata me kërkesë të të miturit të dënuar.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Rishikimi periodik:

- a) përfshin një vlerësim të plotë të procesit të rehabilitimit dhe se kur i mituri është gati për tu liruar;
- b) merr në konsideratë mendimin e të miturit dhe mundësitë për ta lënë nën mbikëqyrje;
- c) përfshin një rekomandim të shkruar lidhur me lirimin ose vazhdimin e vuajtjes së dënimit për të miturin.

KREU XIV PËRGATITJA PËR LIRIM NGA IEVP-JA, KUJDESI, REHABILITIMI DHE RISHOQËRIZIMI

Neni 133

Përgatitja për rikthim pas kryerjes së dënimit

1. Veprimtaria rehabilituese në vendin e vuajtjes së dënimit për të miturin ka për qëllim kryesor të përgatisë të miturin për lirimin e tij, me qëllim rehabilitimin e tij dhe kthimin në jetën shoqërore.

2. Për qëllimet e pikës 1, të këtij neni, administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur merr masa që, qysh në fillim dhe duke e përditësuar në mënyrë të vazhdueshme, të hartojë një plan të posaçëm së bashku me të miturin, familjen e tij dhe në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së të miturit.

3. Administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur siguron që i mituri të kuptojë përmbajtjen e planit.

4. Për realizimin e veprimtarisë rehabilituese, pranë Ministrisë së Drejtësisë krijohet “Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, e cila ka për qëllim mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit, sipas përcaktimeve të këtij neni. Rregullimet specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Pasi janë kryer dy të tretat e dënimit me burgim, por jo më pak se tre muaj para datës së mbarimit të dënimit, administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur:

a) informon për datën e mbarimit të dënimit të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor dhe Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve dhe Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;

b) i jep mbështetje psikologjike dhe arsimore të miturit për t’u përgatitur për lirimin;

c) i jep mundësi të miturit që të bëjë vizita të shkurtra në shtëpi;

d) përgatit një fashikull me të dhënat mbi situatën sociale të të miturit, me qëllim që të përforcojë rishoqërimin e mëvonshëm të të miturit;

e) i jep informacion të miturit në mënyrë të kuptueshme për të, me qëllim që ai të ketë aksesin e duhur për mbështetje dhe ndihmë pas kryerjes së dënimit;

dh) bashkëpunon me organin shëndetësor në vendin e banimit të të miturit në mënyrë që të zbatohet plani i riintegritetit për aspekte që mund të lidhen me anën shëndetësore të të miturit.

6. Përfaqësuesit e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës:

a) marrin të gjitha masat e nevojshme që i mituri të kuptojë kushtet dhe kërkesat e planit të rishoqërimin dhe rehabilitimit;

b) familjarizohen me fashikullin me të dhënat për përfshirjen sociale të të miturit në mjediset e ndalimit apo të burgimit;

c) takojnë të miturin në një mjedis të përshtatshëm;

d) miratojnë planin e rehabilitimit dhe rishoqërimin e tij jo më vonë se tre muaj nga paraqitja e kërkesës së tij, në rast se i mituri e kërkon këtë;

e) sigurojnë përmbushjen dhe rishqyrtimin e programeve në mjediset e burgimit, nëse kjo është e nevojshme.

7. Jo më parë se tre muaj para afatit ligjor për lirimin me kusht dhe jo më parë se tre muaj nga përmbushja e afatit të dënimit me burgim, administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur:

a) informon të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor dhe Shërbimin e Provës për datën e mbarimit të dënimit;

b) informon me shkrim Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Shërbimin e Provës, Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për rrezikun familjar dhe shoqëror/ mjedisor dhe për nevojat e të miturit jashtë IEVP-së.

8. Përfaqësuesi i Shërbimit të Provës:

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

a) kryen vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/mjedisor dhe për nevojat e të miturit jashtë IEVP-së;
b) lëshon dokumentet e nevojshme për lirim me kusht të të miturit, mbështetur në vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/mjedisor të të miturit jashtë IEVP-së.

9. Format dhe rregullat e përgatitjes së dokumentit për lirim me kusht dhe vlerësimin e rrezikut dhe nevojave familjare dhe shoqërore/mjedisore të parashikuara në këtë nen përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

10. Me qëllim përgatitjen e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit, në një periudhë deri në tre muaj nga lrimi i të miturit nga IEVP-ja, sipas rastit, Shërbimi i Provës dhe administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur, bashkëpunon me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Shërbimin e Provës, organet e qeverisjes vendore të njësisë administrative dhe Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ku i mituri banon apo ka planifikuar të banojë.

Neni 134

Mbështetja pas lirim

1. Pas lirim, i mituri mbështetet nga organet kompetente për të bërë të mundur një riintegrim të suksesshëm të tij.

2. Për të mbështetur procesin e riintegrit organet e qeverisjes vendore në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, bëjnë të mundur, sipas legjislacionit në fuqi, strehimin e përshtatshëm për të miturin që nuk ka strehim.

3. Organi kompetent për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve koordinon zbatimin e planit të integrit dhe të mbikëqyrjes së shërbimeve ndaj të miturit të paktën deri në 6 muaj pas lirim.

4. I mituri duhet të mbështetet për të pasur të paktën:

- a) veshje të përshtatshme;
- b) mbështetje psikologjike;
- c) shpenzimet e udhëtimit për në banesë;
- c) mundësimin e ndjekjes së kurseve të formimit profesional, përveç rasteve kur ai mbështetet nga familja.

Neni 135

Mbikëqyrja pas kryerjes së dënimit dhe dënimit me kusht

1. Pas lirim, i mituri, sipas rastit, rivendoset pranë prindit ose kujdestarit të tij dhe i garantohet mbrojtja, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

2. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e fëmijëve do të koordinojë dhe do të zbatojë planin e rehabilitimit dhe të rishoqërizimit për të paktën gjashtë muaj nga kryerja e dënimit ose e lirim me kusht dhe do të mbikëqyrë ecurinë e zbatimit të planit për rishoqërizimin e të miturit.

KREU XV

MBAJTJA DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR

Neni 136

Baza e të dhënave të drejtësisë penale për të mitur

1. Për mbajtjen e të dhënave të çështjeve penale që përfshijnë të miturit në konflikt me ligjin penal, të miturit viktimë dhe dëshmitarë të veprave penale, krijohet Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Në sistem mblidhet vetëm informacioni që është i nevojshëm për këtë qëllim.

3. Sistemi përfshin hedhjen dhe përditësimin e të dhënave të drejtësisë penale për të mitur dhe ka për qëllim:

- a) mbledhjen e të dhënave dhe sistemimin e tyre, si dhe ndjekjen e tyre në kohë reale;
- b) përmirësimin e aksesit në drejtësi të të miturve, subjekte të këtij Kodi, dhe miradmis-trimin e drejtësisë për të mitur;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

c) koordinimin e përpjekjeve ndërinstitucionale, në mënyrë që të mundësohet ofrimi i zgjidhjeve të menjëhershme për rastet kur të miturit i mohohet akses i drejtësi, është subjekt i abuzimeve ose shkeljeve të drejtave të të miturit, ose nuk zbatohen garancitë procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

ç) unifikimin dhe kompjuterizimin e mbledhjes së të dhënave, me qëllim krijimin e një baze statistikore që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave në lidhje me drejtësinë penale për të mitur.

4. Sistemi përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit penal për të mitur, subjekte të këtij Kodi.

Neni 137

Institucionet përgjegjëse

1. Sistemi administrohet nga Ministria e Drejtësisë.

2. Ministria e Drejtësisë, policia, prokuroritë, gjykatat, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe zyrat e shërbimit të provës hedhin dhe përditësojnë të dhëna në sistem, si dhe e aksesojnë këtë sistem sipas rregullave të përcaktuara nga institucionet përkatëse për përdorimin dhe përditësimin e të dhënave, si dhe nivelet e aksesimit.

3. Pas ngritjes dhe vënies në funksionim të plotë të sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve në sistemin e drejtësisë, Ministria e Drejtësisë bashkëpunon me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit të Sistemit të Drejtësisë për ndarjen elektronike të të dhënave lidhur me indeksimin e dosjeve të të miturve nga zyrat e prokurorisë dhe gjykatat, pas përfundimit të proceseve përkatëse.

4. Krijimi, organizimi, funksionimi dhe karakteristikat mbi përdorimin dhe aksesimin e sistemit të të dhënave, të dhënat parësore dhe dytësore dhe dhënësi i informacionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Institucionet përgjegjëse sipas këtij neni, sipas fushave të veprimtarisë, mbështetur në këtë ligj dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nxjerrin urdhra për miratimin e rregullave të detajuara për përdorimin e sistemit nga institucionet në varësi të tyre.

Neni 138

Njohja me fashikullin personal dhe asgjësimi i tij

1. Identiteti i të miturve dhe familjeve të tyre nuk duhet t'i komunikohet asnjërit që nuk është i autorizuar me ligj të jetë i informuar në lidhje me të.

2. Autorizimi ligjor për të marrë informacion duhet të jetë i kufizuar në mënyrë rigoroze për personat dhe institucionet që kërkojnë informacion të veçantë në lidhje me një rast të veçantë, duke shmangur bërjen publike të të gjitha të emrave të subjekteve, sipas këtij Kodi.

3. I mituri i dënuar mund të njihet me fashikullin e tij personal deri në momentin e asgjësimit të këtij fashikulli.

4. Pas lirimit të të miturit, për fashikullin e tij personal zbatohen rregullat për ruajtjen dhe asgjësimin e fashikujve, të parashikuara nga ligji të arkivave në Republikën e Shqipërisë.

Neni 139

Ruajtja e fashikullit për të dënuarit jo me burgim

Për fashikullin e plotë të ekzekutimit të vendimit ndaj një të mituri, i cili është dënuar jo me burgim ose me kusht, zbatohen rregullat për ruajtjen dhe asgjësimin e fashikujve, të parashikuara nga ligji të arkivave në Republikën e Shqipërisë.

KREU XVI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 140

Zbatimi i dispozitave të këtij Kodi dhe fuqia prapavepruese

1. Dispozitat e këtij Kodi fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2018 për çështjet që janë në fazën e hetimit, gjyqimit ose ekzekutimit.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

2. Dispozitat e këtij Kodi do të kenë fuqi prapavepruese vetëm nëse kjo përmirëson kushtet dhe pozitën e të miturit dhe është në interesin më të lartë të të miturit.

3. Dispozitat e këtij Kodi, zbatimi i të cilave kërkon krijimin e institucioneve ose ofrimin e shërbimeve të caktuara dhe të specializuara, fillojnë efektin e tyre në mënyrë progresive sipas parashikimeve të këtij neni.

4. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, Ministria e Drejtësisë dhe ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike realizojnë përshtatjen dhe pajisjen e mjediseve për marrjen në pyetje të të miturve, sipas parashikimeve të nenit 39 të këtij Kodi;

5. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, çdo organ kompetent, sipas këtij Kodi, përgatit listën e personave që do të specializohen në çështjet e drejtësisë për të miturit, miraton programet e trajnimeve dhe organizon trajnimet e tyre, sipas kreut IV të këtij Kodi.

6. Brenda datës 1 janar 2019 fillojnë të zbatohen dhe hyjnë në fuqi dispozitat që lidhen me veprimtarinë e institucioneve dhe autoriteteve kompetente që kryejnë funksione lidhur me vendosjen e të miturit në mbikëqyrje, sipas parashikimeve të neneve 83 dhe 84, të këtij Kodi; që ofrojnë shërbim të specializuar për zbatimin e vendosjes nën kujdes, sipas nenit 69, të këtij Kodi; që kujdesen për përmbushjen e detyrimeve nga të miturit, sipas nenit 102, pika 3, të këtij Kodi; për kufizimin e lirisë, sipas nenit 98 të këtij Kodi; që ofrojnë shërbimet që garantojnë sportin dhe ripërtëritjen e personave me aftësi të kufizuara, sipas parashikimeve të nenit 119 të këtij Kodi; si dhe krijohet Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 4, të këtij Kodi.

Neni 141

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, të nxjerrë aktet nënligjore të reja ose të ndryshojë ato ekzistuese, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenet 72, pika 10; 84, pika 3; 98, pika 5; 102, pika 3; 110, pika 5; 111, pika 2; 113, pika 6; 120, pika 5; 122, pika 1; 124, pika 2; 125, pika 5; 126, pika 4; 127, pika 4; 133, pika 4; 137, pika 4 dhe 137, pika 5.

2. Ngarkohen ministrat përkatës që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, të nxjerrin aktet nënligjore të reja, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenet 58, pika 4; 66, pika 2, 67, pika 3 dhe 117, pika 7.

Neni 142

Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohen të gjitha dispozitat e ndodhura në aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me parashikimet e këtij Kodi.

2. Aktet nënligjore lidhur me fushën e drejtësisë penale për të mitur do të zbatohen për sa nuk bien në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e këtij Kodi deri në daljen e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 143

Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi në datën 1 janar 2018.

Miraturar në datën 30.3.2017

Shpallur me dekretin nr.10215, datë 27.4.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 149, datë 20.3.2019

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, KARAKTERISTIKATE PËRDORIMIT E AKSESIMIT, TË DHËNAT PARËSORE E DYTËSORE DHE DHËNËSIN E INFORMACIONIT TË SISTEMIT TË INTEGRUAR TË TË DHËNAVE TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave lidhur me krijimin, organizimin, funksionimin dhe karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit penal, ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin penal, të mitur viktimë dhe dëshmitarë të veprave penale.

3. Përdorimi dhe aksesimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit mbështetet në:

- a) parimin e respektimit të jetës private, të dinjitetit dhe personalitetit të të miturit;
- b) parimin e konfidencialitetit, duke mos bërë publike asnjë të dhënë ose informacion të marrë për shkak të detyrës/gjatë kryerjes së detyrës dhe pas përfundimit të saj, që mund të lidhet me dënimet e mëparshme të të miturit, në respektim të legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- c) parimin e interesit më të lartë të të miturit.

4. Krijimi, funksionimi dhe administrimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur bëhet në formatin “web-based”.

5. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, si bazë të dhënash shtetërore, hostohet në serverët e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në vijim, “AKSHIP”).

6. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rubrika të posaçme për anonimizimin e të dhënave, që identifikojnë të miturin në konflikt me ligjin, të miturin viktimë ose dëshmitar të një veprë penale, të dhëna sensitive të lidhura me emrat, adresat, vendet e shkollimit dhe/ose të punës, të profesioneve ose çdo informacion tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të miturin.

7. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ka për qëllim, si më poshtë vijon:

- a) mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave të rasteve të drejtësisë penale për të mitur në kohë reale, nëpërmjet gjurmimit të të dhënave të ndjekjes penale e procedurave gjyqësore;
- b) përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga institucionet e parashikuara nga ky vendim;
- c) unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur, me qëllim krijimin e një baze statistikore, që ndihmon analizën e orientimin e përmirësimit të politikave lidhur me drejtësinë penale për të mitur;

ç) ofrimin e zgjidhjeve të menjëhershme për rastet kur i mituri është subjekt i abuzimeve ose shkeljeve të garancive procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

8. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur është një sistem unik digjital, që gjeneron tregues bazë në mënyrë sintetike, për:

- a) gjendjen e kriminalitetit për të miturit;
- b) numrin e përsëritësve nga grup-moshat e mitura;
- c) shkallën e riintegritetit apo rehabilitimit të të miturve pas kryerjes së dënimit me burgim ose në rastet kur nuk janë dënuar me burg;
- ç) numrin e të miturve në konflikt me ligjin të proceduar në gjendje lirë, të arrestuar, të ndaluar;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 41*. Tiranë 2019. f. 3489.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

d) numrin e të miturve në konflikt me ligjin, të trajtuar me procedurën e shmangies nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative;

dh) numrin e të miturve në konflikt me ligjin, të gjykuar e të dënuar;

e) llojin e veprave penale të kryera nga të mitur;

ë) numrin e viktimave të mitura dhe llojin e veprave penale të kryera ndaj tyre; si dhe

f) të dhëna të tjera që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin.

9. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përbëhet nga tërësia e të dhënave që burojnë nga fashikujt e dokumente të krijuara, të dërguara dhe të përpunuara gjatë veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose joshetërore, të personave juridikë e fizikë privatë, gjatë procedurave që ndiqen në hetimin ose gjykimin e çështjeve që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin, të miturin viktimë dhe/ose dëshmitar. Në të dhënat e detyrueshme, që organet kompetente duhet të hedhin në version elektronik, të jenë:

a) vendimet e gjykatave;

b) vendimi i prokurorit për fillimin, mosfillimin ose shmangien nga ndjekja penale;

c) marrëveshja e shmangies nga ndjekja penale;

ç) raportet e vlerësimit individual të të miturit;

d) vendimet për ekzekutimin e vendimeve penale;

dh) dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga i mituri me marrëveshje, si: dëftesa shkollore, vërtetime për ndjekjen e programeve, si dhe akte të tjera;

e) lloji i veprës penale të evidentuar, si dhe të dhëna për identitetin, gjininë, arsimin dhe vendbanimin për të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë;

10. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban të dhëna që ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e administruara nga institucioni përgjegjës dhe që kanë të bëjnë me:

i. të miturit autorë, viktimë apo dëshmitarë të një veprë penale; si dhe

ii. çdo të dhënë tjetër që lidhet me të miturit në konflikt me ligjin.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që kanë të bëjnë me:

i. veprat penale të evidentuara nga strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit për të miturit në konflikt me ligjin, duke përfshirë: llojin e veprës penale, datën e evidentimit, strukturën policore që e ka evidentuar dhe/ose trajtuar rastin, masën e marrë ndaj të miturit (gjendje e lirë, arrestuar, ndaluar, shpallur në kërkim);

ii. njoftimet dhe kallëzimet e kryera pranë organeve të ndjekjes penale për një veprë penale të dyshuar se është kryer nga një i mitur, duke përfshirë: datën e kallëzimit, prokurorinë ku bëhet kallëzimi, numrin e të miturve, veprën penale të dyshuar se është kryer nga i mituri, vendimin e prokurorisë;

iii. të dhënat që merren nga institucionet e ekzekutimit të vendimit, duke përfshirë: dënimin/ masën e dhënë, afatin për kryerjen e dënimit/ masës, institucionin/zyrën që do ta ndjekë, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me procesin;

iv. të dhënat referenciale të gjendjes civile, si: numri personal, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia/njësia administrative, adresa;

v. procesin gjyqësor të kryer nga gjykata, duke përfshirë: të dhënat mbi akuzën e ngritur nga prokuroria, datën e numrin e regjistrimit të çështjes, llojin e gjykimin, vendimin e gjykatës, numrin të miturve të dënuar, llojin e dënimit;

vi. të dhënat e marra nga baza të tjera të dhënash, ku ato janë të dhëna parësore.

11. Subjektet përgjegjëse të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur janë, si më poshtë vijon:

a) institucioni administruar i sistemit është Ministria e Drejtësisë;

b) institucionet përgjegjëse si dhënë për popullimin me të dhëna sipas fazave të procesit janë:

i. Ministria e Brendshme;

ii. Prokuroria e Përgjithshme;

iii. të gjitha gjykatat/seksionet në nivel rrethi dhe apeli, që gjykojnë çështje penale me të mitur;

iv. Gjykata e Lartë;

v. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;

vi. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

12. Përdoruesit e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur janë hedhësit e informacionit, si më poshtë vijon:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, drejtoritë vendore të policisë dhe/ose drejtoritë vendore për kufirin dhe migracionin;
- b) zyrat/seksionet e prokurorisë në nivel rrethi dhe apeli, që hetojnë çështje penale me të mitur;
- c) gjykatat/seksionet në nivel rrethi dhe apeli, që gjykojnë çështje penale me të mitur;
- ç) Gjykata e Lartë;
- d) Prokuroria e Përgjithshme;
- dh) institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku ndodhen të miturit e dënuar ose të paraburgosur;
- e) zyrat vendore të shërbimit të provës që trajtojnë rastet e të miturve me masë shmangieje ose masë alternative të dënimit me burgim.

13. Subjekte të interesuara janë:

- a) Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- b) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- c) Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- ç) ministria përgjegjëse për arsimin;
- d) çdo subjekt tjetër, që paraqet kërkesën e argumentuar pranë ministrit të Drejtësisë dhe i përcaktuar shprehimisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

14. Të dhënat lidhur me të miturin dhe procedurën që parashikon ky vendim mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

15. Pas lirimit të të miturit, për fashikullin e tij personal elektronik zbatohen rregullat për ruajtjen dhe asgjësimin e fashikujve, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

16. Niveli i aksesit në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur është, si më poshtë vijon:

- a) subjektet e përcaktuara në pikën 11, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi dhe gjenerimi të të dhënave të hedhura nga përdoruesit e tyre në sistem;
- b) subjektet e përcaktuara në pikën 12, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi, shkrimi e modifikimi mbi të dhënat e hedhura prej tyre;
- c) subjektet e përcaktuara në pikën 13, të këtij vendimi, kanë akses në nivelin “vizitor” mbi të dhënat që gjenerohen nga sistemi dhe dokumentet e prodhuara, që tregojnë ecurinë procedurale të çështjes, me përjashtim të të dhënave e dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale të të miturit të mbrojtura nga ligji;
- ç) Ministria e Drejtësisë ka të drejta të plota administrative në sistem në këto role:
 - i. administrator;
 - ii. raportues;
 - iii. auditues;
 - iv. zhvillues.

17. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ndërvepron me bazat e të dhënave ku ato ekzistojnë si të dhëna parësore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

18. Institucionet e varësisë dhe/ose drejtoritë rajonale të institucioneve, të cilat nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në sistem, sigurojnë që informacioni t'i dërgohet menjëherë organit epror, i cili ka llogari në sistem. Organi epror, nëpërmjet llogarisë së tij, plotëson sistemin në emër të institucionit që ka dërguar të dhënat. Institucionet e varësisë dhe/ose drejtoritë rajonale dhe institucionet eprore marrin të gjitha masat që komunikimi i të dhënave mes tyre dhe hedhja e të dhënave në sistem të përfundojë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, po jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga momenti i krijimit të informacionit nga institucioni dërgues. Për raste të veçanta, hedhja e informacionit nuk mund jetë përtej 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga momenti i krijimit.

19. Ministria e Drejtësisë kujdeset që të mundësohet grumbullimi i të dhënave, përpunimi i tyre statistikor, analiza dhe përgatitja e raporteve për përmirësimin dhe parandalimin e kriminalitetit, ofrimi i zgjidhjeve të menjëhershme për rastet kur të miturit i mohohet aksesit në drejtësi ose kur nuk zbatohen garancitë procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe:

- a) të vendosë në dispozicion të përdoruesve të sistemit programin për hedhjen e të dhënave në formatin “web-based”;
- b) të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë punën me AKSHI-n për hostimin e sistemit;
- c) të mbikëqyrë dhe të ofrojë asistencë teknike për përdorimin e sistemit;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ç) të vendosë në dispozicion të organeve shtetërore mundësinë e gjenimit automatik të statistikave nga sistemi për të dhënat e hedhura nga secili institucion;

d) të trajtojë përdoruesit e sistemit lidhur me raportimin, hedhjen e të dhënave dhe përditësimin e tyre, si dhe për administrimin e përshtatshëm të sistemit, sipas qëllimit të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi;

dh) të propozojë masa për rritjen e efikasitetit të sistemit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

20. Të gjithë përdoruesit janë përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura nëpërmjet llogarisë së tyre në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

21. Subjekti përgjegjës për administrimin e sistemit në cilësinë e “kontrolluesit”, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura e të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

22. AKSHI, si autoriteti rregullator koordinues i bazave të të dhënave shtetërore, regjistron, auditon dhe koordinon ndërveprimin me bazat e të dhënave shtetërore.

23. Përdorimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur fillon nga data e vënies në funksionim e tij.

24. Ngarkohen institucionet shtetërore, që hedhin të dhënat sipas fushave të veprimtarisë, për miratimin e rregullave të detajuara për përdorimin e sistemit nga institucionet e tyre të varësisë.

25. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 565, datë 29.9.2018

PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMTARISË NDËRMJET MEKANIZMAVE KËSHILLIMORË DHE KOORDINUES INSTITUCIONALË DHE STRUKTURAVE NË NIVEL QENDROR E VENDOR, PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, pika 5, e 38, pika 4, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton rregullat për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror e vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

2. Procesi i bashkërendimit të veprimtarisë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bazohet në:

a) Parimin e informimit, nëpërmjet njohimit dhe vënies në dispozicion të autoriteteve dhe mekanizmave shtetërorë të çdo informacioni, studimi, të dhënë apo iniciative në fushën e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

b) Parimin e konsultimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

c) Parimin e angazhimit të çdo organi shtetëror në nivel qendror e vendor të përfshirë sipas ligjit në çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

ç) Parimin e bashkëpunimit dhe të dialogut konstruktiv.

3. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës bashkëpunon me ministritë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, përmes:

a) Hartimit e koordinimit të politikave, të akteve ligjore dhe nënligjore, studimeve, vlerësimeve, raportimeve, si dhe realizimit të projekteve të përbashkëta për monitorimin e raportimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 143*. Tiranë 2018. f. 9600.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

b) Hartimit të udhëzimeve përkatëse lidhur me referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mënyrat e format e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve në nivel qendror dhe strukturave në nivel rajonal ose vendor me strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor; c) Ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

4. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës bashkëpunon me bashkitë, lidhur me:

a) Ngritjen e kapaciteteve për monitorimin dhe raportimin e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor, me pjesëmarrjen e organizatave jofitimprurëse dhe të fëmijëve;

b) Organizimin e aktiviteteve dhe të trajnimeve që synojnë rritjen e kapaciteteve lidhur me zbatimin, monitorimin dhe raportimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve;

c) Hartimin, buxhetimin dhe zbatimin e planeve lokale për mbrojtjen e fëmijëve si pjesë e planeve sociale vendore;

c) Vendosjen dhe formalizimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe organizatave jofitimprurëse me qëllim ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

d) Planifikimin, hartimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve.

5. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në bashki dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në nivel njësie administrative lidhur me:

a) Monitorimin e zbatimit të detyrave të këtyre strukturave, të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

b) Mbështetjen teknike lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe lehtësimin e koordinimit ndërinstitucional për zbatimin e planit individual të mbrojtjes;

c) Rritjen e kapaciteteve lidhur me zbatimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve;

c) Mbledhjen periodike të të dhënave statistikore për mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë/njësisë administrative, të përcaktuara në aktet nënligjore, si dhe informacionit lidhur me aktivitetin e tyre, procesin, mënyrën e menaxhimit të rasteve dhe problematikave të hasura.

6. Strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në nivel qendror e vendor bashkë-punojnë ndërmjet tyre për:

a) Identifikimin e adresimin institucional të problematikave lidhur me shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, ligjore, kulturore, regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile, si dhe çdo problematikë tjetër lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor;

b) Referimin, raportimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

c) Funksonimin efektiv të grupeve teknike ndërsektoriale në nivel bashkie/njësie administrative dhe përmbushjen e detyrimeve institucionale në kuadër të planit individual të mbrojtjes;

c) Kryerjen e trajnimeve dhe programeve të përbashkëta për kualifikimin e personave përgjegjës në këto struktura për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe, në veçanti, lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të tyre, për:

i. realizimin, monitorimin e raportimin e të drejtave të fëmijëve;

ii. funksionimin në mënyrë efektive të grupit teknik ndërsektorial;

iii. zbatimin e planeve individuale të mbrojtjes së fëmijëve në nevojë për mbrojtjen dhe realizimin efektiv të mbrojtjes së fëmijëve.

d) Shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve me qëllim monitorimin dhe raportimin e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor.

7. Vendimi nr. 266, datë 12.4.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për bashkërendimin e veprim-tarisë së mekanizmave në nivel qendror e vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në nivel qendror e vendor, të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, si edhe institucionet qendrore, që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështjet e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 207, datë 10.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE TË PROCEDURËS QË DO TË NDIQET PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË CAKTUARA NGA GJYKATA PËR TË MITURIN NË KONFLIKT ME LIGJIN¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 102, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Ky vendim përcakton autoritetet kompetente dhe procedurën që ndiqet prej tyre në rastet kur gjykata urdhëron të miturin në konflikt me ligjin të përmbushë një nga detyrimet e caktuara në përputhje me nenin 102, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Qëllimi i përmbushjes së detyrimeve të caktuara në pikën 1, të këtij kreu, është rishoqërimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose e kryerjes së një veprë tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

3. Autoritetet e caktuara në këtë vendim dhe procedura që do të ndiqet prej tyre janë të njëjta, pavarësisht nëse përmbushja e detyrimeve të caktuara jepet si dënim plotësues ose si dënim jo me burgim.

II. Autoritetet kompetente

1. Autoritet kompetent është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror dhe vendor, që brenda fushës së veprimtarisë, sipas vendimit të gjykatës, ndjek/in përmbushjen e detyrimeve të caktuara ndaj të miturit në konflikt me ligjin.

2. Autoriteti kompetent caktohet nga gjykata, në varësi të natyrës së detyrimit që duhet të përmbushë i mituri në konflikt me ligjin.

3. Autoritetet qendrore, përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, janë:

- a) Ministria e Drejtësisë;
- b) ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, arsimit dhe formimit profesional;
- ç) ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale;
- d) ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

4. Zbatimi i detyrimeve të caktuara nga gjykata ndaj të miturit në konflikt me ligjin kërkon sigurimin e një bashkëpunimi efektiv ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.

5. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe drejtuesi i njësive të mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore përgatit e përditëson listat e autoriteteve kompetente dhe të personave përgjegjës dhe ia dërgon ato strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe seksionit/gjykatës përkatës.

6. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së personave përgjegjës janë të njëjta me ato të përfaqësuesve proceduralë, të përcaktuar sipas legjislativi në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

III. Autoritetet kompetente në nivel vendor

1. Autoritete përgjegjëse, në rastin e vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose, sipas rastit, një program mësimor, janë:

- a) drejtuesi i njësive arsimore vendore, përgjegjës për arsimin parauniversitar;
- b) përfaqësuesi i njësive arsimore vendore, përgjegjës për arsimin parauniversitar, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së (shkollat publike profesionale);
- c) mësuesi i klasës apo mësuesi kujdestar.

2. Autoritetet përgjegjëse, në zbatim të vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të ndjekë një program të arsimit dhe formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional, janë:

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 53*. Tiranë 2019. f. 4092.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

a) drejtuesit e programeve mësimore të arsimit dhe të formimit profesional (AFP);

b) personeli mësimdhënës i institucionit, ofrues të AFP-së.

3. Autoriteti përgjegjës, në zbatim të vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, e siguruar nga programet sociale të nxitjes së punësimit, është drejtuesi i zyrës rajonale ose vendore të punësimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

4. Autoritetet përgjegjëse, në zbatim të vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të ndjekë një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës, janë:

a) shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe të rinjtë në nivel vendor ose qendror;

b) drejtoritë/institucionet e kujdesit të shëndetit (specialistët e shëndetit, mjekët e spitaleve, mjeku i familjes);

c) strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e vetëqeverisjes vendore;

ç) drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror;

d) Urdhri i Psikologut.

5. Autoritetet përgjegjëse, në zbatim të vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të mos frekuentojë vende të caktuara dhe të shoqërohet me persona të caktuar, janë:

a) shërbimi i provës;

b) strukturat vendore të Policisë së Shtetit;

c) ofruesit publikë e privatë të shërbimeve për fëmijët;

ç) mësuesit;

d) prindërit ose kujdestarët e të miturit.

IV. Bashkëpunimi i autoriteteve kompetente

1. Në rast se përmbushja e detyrimit të caktuar nga gjykata përfshin më shumë se dy autoritete kompetente, plani individual parashikon protokollet e komunikimit ndërmjet tyre dhe të bashkërendimit të veprimtarisë.

2. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime në fushën e të drejtave të të miturve.

3. Nëse vendimi i prokurorisë apo gjykatës parashikon detyrimin periodik për raportim, drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës lidhur me detyrimin e caktuar nga gjykata, përcakton në planin individual personin përgjegjës, që mban marrëdhëniet me gjykatën.

4. Në rastin e zbatimit të pikës 3, të këtij kreu, personi përgjegjës përgatit një raport me shkrim dhe, nëse çmohet e nevojshme nga prokuroria apo gjykata, mund të pyetet për ecurinë e përmbushjes së detyrimit të caktuar dhe marrjen e masave konkrete, rast pas rasti.

5. Raporti, sipas pikës 4, të këtij kreu, mbështetet në të dhënat e marra nga autoritetet e përcaktuara e të përfshira në realizimin e planit individual, në varësi të detyrimit të caktuar me vendim të prokurorisë apo gjykatës.

V. Procedura për zbatimin e vendimit të gjykatës për përmbushjen e një detyrimi të caktuar

1. Procedura për zbatimin e vendimit të gjykatës për përmbushjen e një detyrimi të caktuar përcaktohet në planin individual.

2. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor dhe autoritetet përgjegjëse, të caktuara në vendimin e gjykatës, janë kompetente dhe përgjegjëse për miratimin e planit individual për të miturit në konflikt me ligjin, për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin.

3. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor dhe autoritetet ose autoriteti kompetent, të caktuara nga gjykata për përmbushjen e detyrimit, në bashkëpunim me grupin teknik ndërsektorial, që funksion në nivel bashkie ose pranë njësisë administrative të bashkisë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë, nga marrja e këtij vendimi, marrin masa për të lehtësuar e mbështetur zbatimin e planit individual për të miturin konkret, për realizimin e vendimit të gjykatës për përmbushjen e detyrimit/eve të caktuara.

4. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek parimet, garancitë dhe të drejtat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat e fëmijëve.

5. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, për përmbushjen e detyrimit të caktuar, merren në konsideratë:

a) mosha e të miturit;

b) gjendja mendore dhe emocionale;

c) nevojat e veçanta;

ç) mënyra e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen;

- d) edukimi ose puna;
- dh) motivet e kryerjes së veprës penale;
- e) qëndrimi pas kryerjes së veprës penale;
- ë) rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, dhe mbikëqyrjen e tyre.

6. Për hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin merret mendimi i të miturit, sigurohet pjesëmarrja e tij, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe mendimi i prindit të të miturit në konflikt me ligjin.

7. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin mbahet në vëmendje kohëzgjatja e përmbushjes së detyrimit të caktuar në vendimin e gjykatës. Në asnjë rast, kjo kohëzgjatje nuk mund të kalojë kufijtë e caktuar në vendimin gjyqësor.

8. Format i planit individual për të miturin në konflikt me ligjin miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

VI. Parime mbi trajtimin e të miturit gjatë zbatimit të planit individual

1. Gjatë zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, sipas detyrimit të caktuar nga gjykata, i mituri trajtohet me dinjitet nga çdo individ e autoritet dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre.

2. Ndalohet çdo lloj dhune dhe ndëshkimi i të miturit si masë korrigjuese për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata.

3. Të gjitha autoritetet, sipas këtij vendimi, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Autoriteti kompetent dhe personi përgjegjës marrin masa për ruajtjen e konfidencialitetit të të miturit ndaj të tretëve.

5. Të miturit i garantohet ndihma ligjore e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e fëmijës.

VII. Monitorimi/inspektimi i zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin

1. Monitorimi/inspektimi i rregullt i punës së autoriteteve, sipas këtij vendimi, kryhet nga strukturat kompetente, sipas natyrës së masës së caktuar.

2. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor cakton punonjës in për mbrojtjen e fëmijës si përgjegjës për marrjen e masave për monitorimin e zbatimit të planit individual dhe të respektimit të të drejtave të të miturit.

3. Vëmendje e veçantë, gjatë monitorimit, i kushtohet përdorimit të forcës, kufizimeve, dënimeve disiplinore dhe formave të tjera të trajtimit të të miturit.

4. Në procesin e monitorimit mund të marrin pjesë edhe organizata që mbulojnë çështjet e drejtësisë për të miturit.

VIII. Njoftimi i planit individual për të miturin në konflikt me ligjin

1. I mituri, prindërit, përfaqësuesit ligjorë të të miturit marrin një kopje të planit individual brenda 24 (njëzet e katër) orëve, nga miratimi i tij.

2. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përmban pasojat, në rast të moszbatimit të tij, dhe mënyrat e njoftimit të të miturit, prindërve dhe autoriteteve, rast pas rasti.

3. Një kopje e planit individual depozitohet në gjykatë.

IX. Përmbajtja e përgjithshme e planit individual

1. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përmban, por jo vetëm:

1.1 njësinë e vetëqeverisjes vendore, pranë së cilës i mituri do të përmbushë detyrimin e caktuar nga gjykata, duke u kujdesur që kjo të jetë e njëjtë me vendbanimin e të miturit ose sa më pranë tij;

1.2 aktivitetet konkrete të të miturit për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata;

1.3 të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin, me qëllim përmbushjen e detyrimit të caktuar;

1.4 masa të tjera të veçanta, me qëllim përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata, të tilla si:

- a) këshillim psikologjik;
- b) kurse për menaxhimin e zemërimit;
- c) trajtim të shëndetit mendor;
- ç) mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile;
- d) mbështetje për përfshirje në skemën e ndihmës ekonomike;
- dh) mbështetje për përfshirje në shërbimet e punësimit;
- e) mbështetje për përfshirje në shërbimet shëndetësore;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ë) çdo ndërhyrje tjetër.

1.5 kohëzgjatjen e planit individual, duke caktuar datën e fillimit dhe të mbarimit;

1.6 komunikimin dhe njoftimet gjatë zbatimit të planit individual;

1.7 rregulla lidhur me ndryshimin e planit individual;

1.8 pasojat e moszbatimit ose të shmangies nga zbatimi i planit individual;

1.9 bashkëpunimin institucional dhe ndarjen e përgjegjësisë;

1.10 bashkëpunimin me shoqërinë civile;

1.11 të drejtën e ankimit;

1.12 përfundimin e përmbushjes së detyrimit të caktuar.

2. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin, sipas rastit, mund të përmbajë masa për mbështetjen e të miturit në çdo ndërhyrje që do të përmirësonte situatën familjare dhe rolin e familjes, dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.

3. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përfshin të dhënat dhe kontaktet e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tij, si dhe të drejtat e detyrat e tij.

4. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin hartohet në 3 kopje origjinale, të cilat i vihen në dispozicion të miturit/përfaqësuesit ligjor, organit kompetent dhe personit përgjegjës, duke shënuar datën e miratimit dhe të përfundimit të tij.

5. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin nënshkruhet nga i mituri dhe personi përgjegjës.

X. Masa të menjëhershme

1. Në rast se i mituri nuk përmbush detyrimin/et e caktuara nga gjykata në përputhje me planin individual për të miturin në konflikt me ligjin, personi përgjegjës, sipas pikës 3, të kreut IX, të këtij vendimi, njofton menjëherë të miturin, prindin, përfaqësuesin ligjor, me qëllim marrjen e masave konkrete dhe zgjidhjen e rastit.

2. Në rast se i mituri, me gjithë masat e marra sipas pikës 1, të këtij kreu, nuk përmbush detyrimin e caktuar nga gjykata, personi përgjegjës vë në dijeni drejtuesin e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore dhe punonjësin e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, të cilët marrin masa të menjëhershme, sipas legjislacioni në fuqi.

3. Në rast se i mituri nuk zbaton planin individual për të miturin në konflikt me ligjin, autoriteti kompetent, punonjësi i zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe punonjësi i Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve marrin masa për të njoftuar në mënyrë të menjëhershme gjykatën.

XI. Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm ose një program mësimor

1. Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme gjatë hartimit e zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, mban në vëmendje:

a) nevojat e veçanta/individuale për fëmijën që nuk arrin rezultatet e pritshme, që synon programi mësimor i një klase të caktuar, me qëllim integrimin e tij në sistemin e edukimit;

b) përfshirjen në programet mësimore, që do të ndiqen nga i mituri dhe prindërit, duke i zhvilluar këto në bashkëpunim me të miturin e prindin;

c) masat konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale dhe psikologjike brenda mjediseve të shkollës;

ç) masat me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;

d) masat e tjera, lidhur me ushqimin, pajisjen me libra dhe mjetet didaktike, transportin e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;

dh) personin përgjegjës që do të mbikëqyrë zbatimin e vendimit të gjykatës brenda mjediseve shkollore dhe, njëherazi, që do të kujdeset për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (*bulizmi*);

e) personin përgjegjës, që do të mbikëqyrë të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;

ë) detyrat e veçanta të mësuesve që japin mësim në këto klase, lidhur me mbajtjen e dokumentacionit, raportimin e mbarëvajtjes, institucionin/personin ku bëhet raportimi dhe periodicitetin raportimit;

f) rolin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë të të miturit.

2. Autoriteti kompetent mund të marrë masa të tjera për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata, duke u bazuar në ligjin për arsimin parauniversitar, legjislacioni për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës dhe aktet nënligjore në bazë dhe për zbatimin e tyre.

XII. Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e një programi të formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin mban në vëmendje:

- a) që programet e formimit profesional të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;
- b) pajisen e të miturit me certifikatën përkatëse pas përfundimit të kurseve/ programeve profesionale të ofruara nga këto institucione.

XIII. Veçoritë e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës e siguruar nga programet sociale të punësimit

1. Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, në zbatim të këtij detyrimi, mban në vëmendje se:

- a) ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Përjashtimisht, fëmijët nga mosha 15 deri në 16 vjeç mund të punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 99, të Kodit të Punës;
- b) fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës;
- c) i gjithë dokumentacioni në lidhje me marrëdhëniet e punës plotësohet me ndihmën dhe këshillimin ligjor përkatës.

2. Autoritetet përgjegjëse veprojnë në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës dhe të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

XIV. Veçoritë e riparimit të dëmit civil

Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, në zbatim të këtij detyrimi, mban në vëmendje:

- a) mundësitë ekonomike të të miturit e të prindërve të tij;
- b) mënyrën e reagimit të të miturit pas kryerjes së dëmit dhe marrjen e masave prej tij për të minimizuar pasojat e dëmit;
- c) gatishmërinë e të miturit për të kompensuar dëmin me dëmshpërblim në të holla ose në natyrë, nëpërmjet kryerjes së një shërbimi, veprimi, pune ose aktiviteteve të tjera kompensuese;
- ç) aftësitë për kryerjen e detyrave të veçanta;
- d) mënyrën dhe mjetet e riparimit të dëmit civil.

XV. Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e një programi rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës

Autoritetet përgjegjëse, në ndjekjen e një programi rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose i drogës, përfshijnë në veprimtarinë e tyre edhe planin individual për të miturin në konflikt me ligjin:

- a) përgatitjen e një raporti në lidhje me gjendjen e të miturit në momentin e mbërritjes në institucion, si edhe ecurinë e tij deri në përfundimin e programit rehabilitues;
- b) ndjekjen e një programi/plani rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës, të kombinuar me:
 - i) këshillim;
 - ii) punë grupi;
 - iii) terapi;
 - iv) kurset me natyrë psikologjike për menaxhimin e inatit, të nervozizmit dhe të gjendjeve të tjera agresive;
 - v) plan të aktiviteteve kulturore/sportive;
 - vi) plan të aktiviteteve integruese/formuese/argëtuese.

XVI. Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për të mos frekuentuar vende të caktuara dhe për të mos u shoqëruar me persona të caktuar, të cilët mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe edukimin e tij

Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, në përmbushjen e këtij detyrimi mban në vëmendje:

- a) që të përfshijë shpjegime dhe këshillim të herëpashershëm të të miturit lidhur me sjellje që ndikojnë negativisht në edukimin e tij;
- b) përcaktimin e vendeve që nuk duhet të frekuentohen nga i mituri;
- c) një listë të personave me të cilët i mituri nuk duhet të shoqërohet;
- ç) bashkëpunimin e ngushtë me familjen, shkollën dhe shoqërinë civile, veçanërisht në mbikëqyrjen nga ana

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

tyre të përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe informacionit të transmetuar në rrugë elektronike.

XVII. Dispozita të fundit

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit, ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale për fëmijët, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 233, datë 17.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLIMEVE TË VEÇANTA LIDHUR ME FUNKSIONIMIN E MJEDISEVE, TË NIVELIT TË SIGURISË SË TYRE DHE STANDARDET E PROGRAMEVE TË EDUKIMIT E TË REHABILITIMIT, NË RASTET E KUFIZIMIT TË LIRISË SË TË MITURVE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 98, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Kufizimi i lirisë për të miturin në konflikt me ligjin zbatohet vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur dhe në mënyrë që nuk e përkeqëson gjendjen e tij.

2. Të miturit me liri të kufizuar i garantohen aktivitete dhe programe me karakter edukues dhe riintegruues, në përputhje me shëndetin e tij fizik e mendor, respektin për veten dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj shoqërisë e komunitetit.

3. I mituri me liri të kufizuar duhet të mbështetet e nxitet për të marrë pjesë në këto aktivitete e programe dhe për të diskutuar çështje që lidhen me mënyrën e trajtimit dhe kushtet e institucionit.

4. Për të garantuar vazhdimësinë e kujdesit, të miturit duhet të ndiqen e mbështeten, me qëllim rehabilitimin e tyre.

5. Duke qenë se të miturit e privuar nga liria janë veçanërisht vulnerabël, drejtuesit dhe personeli i institucionit duhet të mbrojnë integritetin e tyre fizik e mendor dhe duhet të kujdesen për mirëqenien e tyre.

6. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për nevojat e të miturve që kanë përjetuar abuzime fizike, mendore apo seksuale.

II. RREGULLA PËR FUNKSIONIMIN E MJEDISEVE

1. Struktura institucionale

1.1 Institucioni i kufizimit të lirisë duhet të ofrojë lehtësitë dhe kushtet për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturve që vendosen në të.

1.2 Institucioni i kufizimit të lirisë siguron kushte dhe masa të një niveli të ulët sigurie e kontrolli të nevojshëm për mbrojtjen e të miturve nga dëmtime që mund t'i bëjnë vetes, të miturve të tjerë, personelit apo komunitetit jashtë institucionit.

1.3 Jetesa në institucion duhet të përafrojë, sa më shumë të jetë e mundur, me aspektet pozitive të jetesës në komunitet.

1.4 Numri i të miturve në një institucion të kufizimit të lirisë duhet të jetë i kufizuar, me qëllim që të bëhet i mundur kujdesi individual.

1.5 Institucioni i kufizimit të lirisë vendoset në vende që janë lehtësisht të aksesueshme dhe që lehtësojnë kontaktin ndërmjet të miturve dhe familjeve të tyre, duke u integruar në mjedisin social, ekonomik e kulturor të komunitetit.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr.57*. Tiranë 2019. f. 4530.

Përmbledhje legjislativi për të miturit

2. Vendosja në institucion

2.1 Vendosja e kategorive të ndryshme të të miturve në institucionin e kufizimit të lirisë udhëhiqet, në veçanti, nga dhënia e llojit të kujdesit më të përshtatshëm për nevojat e tyre të veçanta si dhe mbrojtja e integritetit e mirëqenies së tyre fizike e mendore.

2.2 Të miturit vajza dhe djem, zakonisht, mbahen në institucione të veçanta ose në njësi të veçanta brenda një institucioni. Pavarësisht ndarjes, atyre u lejohej të marrin pjesë bashkërisht në aktivitetet e organizuara në institucion.

2.3 Brenda institucioneve duhet të funksionojë një sistem i përshtatshëm vlerësimi për vendosjen e të miturve, sipas nevojave të tyre arsimore, zhvillimore dhe të sigurisë.

3. Pranimi në institucion

3.1 Menjëherë, me pranimin në institucionin e kufizimit të lirisë, kryhet regjistrimi për çdo të mitur, duke përfshirë:

- a) informacion lidhur me identitetin e të miturit dhe prindërit e tij ose kujdestarët ligjorë;
- b) arsyet e urdhrin zyrtar dhe autoritetin përgjegjës, që e ka dhënë;
- c) datën dhe kohën e pranimin;
- ç) një inventar të sendeve personale të të miturit, që do të mbahen në ruajtje;
- d) çdo dëmtim të dukshëm apo pretendim për keqtrajtim të mëparshëm;
- dh) çdo informacion dhe çdo raport mbi të kaluarën e të miturit, edukimin dhe nevojat për mirëqenie të tij/saj;
- e) çdo informacion në lidhje me rrezikun për vetëdëmtim të të miturit dhe/ose të gjendjes shëndetësore, që është i rëndësishëm për mirëqenien fizike e mendore të të miturit ose të të tjerëve, duke iu nënshtruar kërkesave të konfidencialitetit mjekësor.

3.2 Në pranim, rregullat e institucionit dhe të drejtat e detyrimit e të miturit shpjegohen në një gjuhë e mënyrë që i mituri i kupton dhe në prani edhe të psikologut.

3.3 Njoftimi për vendosjen e të miturit, informacioni për rregullat e institucionit dhe çdo informacion tjetër përkatës u jepet menjëherë prindërve të të miturit ose kujdestarëve ligjorë.

3.4 Brenda 5 (pesë) ditëve, nga pranimi, i mituri duhet të ekzaminohet nga pikëpamja mjekësore, t'i hapet një dosje mjekësore dhe të fillojë trajtimin e çdo sëmundjeje ose dëmtimi.

3.5 Brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga pranimi, i mituri duhet të:

- a) intervistohet dhe duhet të bëhet një raport i parë psikologjik, arsimor e social, që identifikon çdo faktor relevant për llojin dhe nivelin specifik të kujdesit e ndërhyrjes;
- b) informohet për planin e programeve arsimore e trajnuese, në përputhje me karakteristikat individuale të tij. Në çdo rast, për zhvillimin e programeve duhet të merret mendimi i të miturit.

4. Sistemimi në institucion

4.1 Sistemimi i miturit në institucionin e kufizimit të lirisë duhet të respektojë dinjitetin njerëzor e, për aq sa është e mundur, privatësinë, dhe të plotësojë kërkesat e shëndetit dhe të higjienës, duke i kushtuar vëmendje kushteve klimatike dhe, veçanërisht, hapësirës së katit, ajrit, ndriçimit, ngrohjes e ventilimit.

4.2 Të miturit, si rregull, vendosen gjatë natës në dhoma gjumi individuale, përveç rasteve kur është e preferueshme që ata të ndajnë hapësirën e fjetjes. Hapësira ndahet vetëm nëse është e përshtatshme dhe kërkohet nga i mituri.

4.3 Për të siguruar mbrojtjen e secilit të mitur, në institucionin e kufizimit të lirisë duhet të ketë mbikëqyrje të rregullt. Institucioni i kufizimit të lirisë duhet të ketë një sistem alarmi efektiv, që mund të përdoret në rast emergjence.

4.4 Kërkesat minimale, specifike, në lidhje me sistemimin e të miturit në institucionin e kufizimit të lirisë, përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit.

5. Higjiena

5.1 Të gjitha ambientet e institucionit të kufizimit të lirisë mbahen të pastra, në çdo kohë.

5.2 Të miturit duhet të kenë akses të menjëhershëm në objektet sanitare, që janë higjienike dhe që respektojnë jetën private.

5.3 Duhet të sigurohen lehtësira të përshtatshme, në mënyrë që të miturit të kenë mundësi të bëjnë dush çdo ditë.

5.4 Personeli i institucionit të kufizimit të lirisë kujdeset për sigurimin e higjienës personale të të miturit, veshjet dhe vendin e fjetjes, si dhe siguron mjetet e nevojshme për këtë qëllim.

6. Veshjet dhe shtrojat

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- 6.1 Të miturit duhet të lejohen të veshin rrobat e tyre, nëse është e përshtatshme.
- 6.2 Të miturit, të cilët nuk kanë veshje të përshtatshme e të mjaftueshme, duhet të pajisen me veshje nga institucioni.
- 6.3 Veshjet nuk duhet të jenë degraduese ose poshtëruese, duhet të jenë të përshtatshme për klimën dhe të mos paraqesin rrezik për sigurinë e mirëqenien.
- 6.4 Të miturit, që ka leje për të dalë jashtë institucionit, nuk duhet t'i kërkohej të mbajë rroba që e identifikojnë atë si person me liri të kufizuar.
- 6.5 I mituri pajiset me një shtrat dhe me shtroja të përshtatshme, të cilat mbahen në rregullta dhe ndryshohen shpesh, për të siguruar pastërtinë e tyre.
7. Ushqimi
- 7.1 Të miturit i sigurohet një dietë ushqyese që merr parasysh moshën, shëndetin, gjendjen fizike, fenë, kulturën dhe aktivitetet, në të cilat përfshihet në institucion.
- 7.2 Ushqimi duhet të përgatitet e të shërbehet në mënyrë higjienike, në tri vakte në ditë, me intervale të arsyeshme ndërmjet tyre.
- 7.3 Ujë i pijshëm e i pastër duhet të jetë i disponueshëm për të miturin në çdo kohë.
8. Shëndeti
- 8.1 Të miturit me liri të kufizuar i sigurohen standardet e duhura mjekësore dhe të aplikuara për të gjithë të miturit.
- 8.2 Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajtimit të rreziqeve shëndetësore, të lidhura me kufizimin e lirisë.
- 8.3 Të miturit me liri të kufizuar i jepet kujdes shëndetësor parandalues dhe edukim shëndetësor.
- 8.4 Ndërhyrjet mjekësore, përfshirë përdorimin e ilaçeve, duhet të bëhen vetëm me rekomandimin e mjekut të institucionit dhe jo për qëllime të ruajtjes së rendit ose si formë ndëshkimi. Ndërhyrjet mjekësore duhet të udhëhiqen nga të njëjtat parime etike si dhe parimi i pëlqimit, që aplikohen gjerësisht. Çdo trajtim mjekësor ose çdo lloj bari i administruar duhet të dokumentohet me nënshkrimin e mjekut të institucionit.
- 8.5 I mituri me liri të kufizuar nuk duhet t'i nënshtrohet përdorimit eksperimental të barnave ose trajtimit.
- 8.6 Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojave të të miturit:
- a) me moshë të vogël;
 - b) shtatzënë ose nënë me fëmijë të mitur;
 - c) me varësi nga drogat dhe alkooli;
 - ç) me probleme të shëndetit fizik e mendor;
 - d) me liri të kufizuar për periudhë të gjatë;
 - dh) që ka përjetuar abuzime fizike, mendore ose seksuale;
 - e) vulnerabël.
- 8.7 Shërbimet e kujdesit shëndetësor, të ofruara për të miturin, duhet të jenë pjesë përbërëse e një programi shumëdisiplinor përkujdesjeje.
- 8.8 Për të siguruar një mbështetje të pandërprerë të terapisë, pa paragjykim për konfidencialitetin profesional dhe rolin e secilit profesion, puna e mjekëve dhe infermierëve duhet të koordinohet ngushtë me punonjësit socialë, psikologët, mësuesit, profesionistët e tjerë dhe personelin, të cilët kanë kontakt të rregullt me shkelësit e mitur.
- 8.9 Kujdesi shëndetësor nuk duhet të kufizohet vetëm në trajtimin e pacientëve të sëmurë, por duhet të përfshijë edhe respektimin e normës së të ushqyerit.
9. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë
- 9.1 Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë së të miturit duhet të respektohet.
- 9.2 Regjimi institucional duhet të organizohet, për aq sa është e mundur, për të lejuar të miturin të praktikojë e të ndjekë besimin e vet, të marrë pjesë në shërbime ose takime të udhëhequra nga përfaqësues të miratuar të një feje ose besimi të tillë, të ketë vizita nga përfaqësues të fesë apo besimit dhe të ketë në posedim libra ose literaturë që kanë të bëjnë me fenë ose besimet e tij.
- 9.3 I mituri nuk mund të detyrohet të praktikojë një fe, të ndjekë një besim, të marrë pjesë në shërbesa fetare, takime, praktika fetare ose të pranojë vizita nga përfaqësues të çdo feje apo besimi.
10. Kontakti me shoqërinë dhe komunitetin
- 10.1 Të miturit i lejohet komunikimi pa kufizim nëpërmjet letrave dhe, sa më shpesh të jetë e mundur, me telefon ose forma të tjera të komunikimit me familjet e tyre, persona të tjerë, përfaqësues të organizatave të jashtme dhe për të marrë vizita të rregullta nga këta persona.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

10.2 Rregullimi i vizitave duhet të jetë i tillë që t'i lejojë të miturit të mbajë e të zhvillojë marrëdhëniet familjare në mënyrë sa më normale si dhe të ketë mundësi për riintegrim social.

10.3 Personeli i institucionit të kufizimit të lirisë duhet t'i ndihmojë të miturit në mbajtjen e kontakteve të përshtatshme me botën e jashtme dhe t'u sigurojë mjetet e duhura për ta bërë këtë.

10.4 Komunikimi dhe vizitat mund t'i nënshtrohen kufizimeve dhe monitorimit të domosdoshëm për kërkesat e hetimeve të vazhdueshme penale, të ruajtjes së rendit e sigurisë, parandalimit të veprave penale dhe mbrojtjes së viktimave të krimit, por kufizime të tilla, duke përfshirë edhe kufizime të urdhëruara nga gjykata, duhet të lejojnë një nivel minimal, të pranueshëm, kontakti.

10.5 Çdo informacion i marrë për vdekjen apo sëmundjen serioze të një të afërmi duhet t'i komunikohet menjëherë të miturit, në prani të psikologut ose punonjësit social.

10.6 Të miturit i lejojnë periudha të rregullta lejeje, qoftë të shoqëruar ose vetëm, dhe mund t'i lejohet të largohet nga institucioni për arsye të ligjshme. Kohëzgjatja e kësaj lejeje nuk i kalon 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Në këtë kohë përfshihet edhe koha e nevojshme për udhëtim në familjen e tij ose në destinacion.

11. Paraqitja e ankesave

11.1 I mituri, prindërit ose të afërmit e tij duhet të kenë mundësi të mjaftueshme për të bërë kërkesa ose ankesa te drejtuesi i institucionit.

11.2 Procedurat për të bërë kërkesa ose ankesa duhet të jenë të thjeshta dhe efektive. Vendimet për këto kërkesa ose ankesa duhet të merren në një kohë sa më të shpejtë.

11.3 Prioritet për zgjidhjen e kërkesave apo ankesave i jepet zgjidhjes me ndërmjetësim, si një mënyrë për zgjidhjen e konflikteve.

11.4 Nëse refuzohet një kërkesë ose ankesë, ajo duhet të shoqërohet me arsyet përkatëse, duhet t'i komunikohet të miturit dhe, atje ku është e mundur, prindit ose të afërmit të tij, i cili e ka bërë atë. I mituri ose, kur është e mundur, prindërit apo i afërmi i tij, kanë të drejtën të ankohen në një autoritet të pavarur e të paanshëm.

11.5 Nëse ankesa ose kërkesa është me shkrim, autoritetet duhet të sigurojnë mundësi për të miturin që të dëgjohet personalisht.

11.6 Ndalohet penalizimi i të miturit për shkak të një kërkesë ose ankese.

11.7 I mituri dhe prindi ose të afërmit e tij kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë ligjore lidhur me ankesat dhe procedurat e apelit.

12. Inspektimi dhe monitorimi

12.1 Veprimtaria e institucionit për kufizimin e lirisë inspektohet rregullisht, për të vlerësuar nëse detyrat e ushtruara janë në përputhje me ligjin dhe rregullimet e këtij vendimi.

12.2 Kushtet në institucion dhe trajtimi i të miturit me liri të kufizuar mund të monitorohen nga një institucion apo organizëm i pavarur.

12.3 Në monitorimet që kryhen nga institucioni apo organizmi i pavarur, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit të forcës, kufizimeve, dënimeve disiplinore dhe formave të tjera kufizuese të trajtimit.

12.4 Raportet e monitorimit i bëhen me dije strukturave drejtuese të sistemit penitenciar dhe Ministrisë së Drejtësisë.

13. Personeli i institucionit

13.1 Personeli i institucionit rekrutohet dhe përzgjidhet bazuar në procedurat që ndiqen për përzgjedhjen e personelit administrativ, sipas rregullave të Kodit të Punës.

13.2 Aftësitë profesionale të personelit duhet të forcohen e zhvillohen rregullisht, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme, mbikëqyrjes dhe rishikimeve të performancës dhe vlerësimeve.

13.3 Trajnimet duhet të përqendrohen në dhënien e njohurive lidhur me:

- a) etikën dhe vlerat themelore të profesionit në fjalë;
- b) mekanizmat mbrojtës kombëtarë dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe mbrojtjen e të miturve ndaj trajtimit të papranueshëm;
- c) ligjet për të miturit dhe të drejtën familjare, psikologjinë e zhvillimit, punën sociale e arsimore me të miturit;
- ç) udhëzimin e personelit se si të udhëheqin e motivojnë të miturit, të fitojnë respektin dhe të ofrojnë modele e perspektivë pozitive për të miturin;
- d) krijimin dhe mirëmbajtjen e një marrëdhënieje profesionale me të miturit dhe familjet e tyre;
- dh) metodat e provuara të ndërhyrjes dhe praktikave të mira;
- e) metodat e trajtimit të diversitetit të të miturve në fjalë;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

ë) mënyrat e bashkëpunimit në grupet shumëdisiplinare si dhe me institucionet e tjera të përfshira në trajtimin individual të të miturve.

III. RREGULLI DHE SIGURIA NË INSTITUCION

1. Rregulla të përgjithshme

1.1 Rregulli në institucion do të mbahet duke krijuar një mjedis të shëndetshëm e të sigurt, në të cilin të respektohen dinjiteti dhe integriteti fizik i të miturit me liri të kufizuar dhe përmbushen qëllimet kryesore të tyre zhvillimore.

1.2 Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së të miturve vulnerabël dhe parandalimit të viktimizimit.

1.3 Personeli duhet të zhvillojë aktivitete me qasje dinamike ndaj ruajtjes e sigurisë, duke u bazuar në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive me të miturin.

1.4 I mituri duhet të nxitet që të angazhohet individualisht e kolektivisht në mbajtjen e rregullit në institucion.

2. Kontrolli

2.1 Kontrolli i të miturit ushtrohet vetëm në rast nevojë dhe duhet të kryhet nga personeli i së njëjtës gjini. Ekzaminimet intime duhet të justifikohen mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, në një rast specifik, dhe duhet të kryhen vetëm nga një mjek i specializuar.

2.2 Vizitorët mund të kontrollohen vetëm nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm se ata mund të kenë diçka në posedim të tyre, që kërcënon mirëqenien dhe sigurinë e të miturit në institucionin e kufizimit të lirisë.

2.3 Procedurat e detajuara të ushtrimit të kontrollit përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit të kufizimit të lirisë.

3. Përdorimi i forcës, kufizimi fizik dhe armët

3.1 Ndalohet të përdoret forca kundër të miturit nga personeli i institucionit të kufizimit të lirisë, përveçse si mjet i fundit për vetëmbrojtje ose në rastet e rrezikut të drejtpërdrejtë të vetëdëmtimit apo dëmtimit të të tjerëve.

3.2 Niveli i forcës së përdorur duhet të jetë minimumi i nevojshëm dhe të zbatohet për kohën më të shkurtër të mundshme.

3.3 Personeli i institucionit duhet të trajnohet në përdorimin e teknikave që mundësojnë shmangien apo përdorimin minimal të forcës së rastet e shfaqjes së sjelljes agresive.

3.4 Ndalohet përdorimi i prangave, me përjashtim të rastit kur janë të domosdoshme, si një masë paraprake kundër sjelljes së dhunshme.

3.5 Ndalohet përdorimi i instrumenteve kufizuese, duke përfshirë zinxhirët, hekurat dhe mjete të tjera poshtëruese.

3.6 Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i armëve nga personeli i institucionit të kufizimit të lirisë, me përjashtim të rasteve kur një urgjencë operationale e dikton këtë.

4. Ndarja për arsye mbrojtjeje dhe sigurie

4.1 Një i mitur mund të ndahet nga të tjerët për arsye mbrojtjeje ose sigurie. Nevoja e ndarjes përcaktohet nga vlerësimi i punonjësit social, psikologu dhe mjeku i institucionit. Ndaj kësaj mase i mituri, prindi ose të afërmit kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë drejtuesit të institucionit dhe strukturave drejtuese të sistemit penitenciar.

4.2 Izolimi, si mjet për kufizim të përkohshëm, duhet të përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe vetëm për disa orë dhe, në çdo rast, nuk duhet të kalojë 24 (njëzet e katër) orë. Në rastet e izolimit duhet të njoftohet menjëherë mjeku, i cili duhet të mbikëqyrë gjendjen e të miturit gjatë kohëzgjatjes së izolimit.

5. Masat disiplinore

5.1 Aplikimi i masave disiplinore është mekanizmi i fundit i zgjidhjes së një situatë të shkeljes së rregullave të institucionit të kufizimit të lirisë. Në rast të shkeljes së rregullave i jepet përparësi zgjidhjes restauruese të konflikteve dhe ndërveprimit edukativ, me qëllim vlefshmërinë e normës, në vend të seancave dhe dënimeve formale disiplinore.

5.2 Llojet e masave disiplinore janë:

a) tërheqje vëmendjeje;

b) kufizim, deri në 10 ditë, të përdorimit të sende të lejuara, me përjashtim të ushqimeve, mjeteve mësimore dhe mjekimeve të lejuara nga mjeku;

c) veçimi/ndarje, deri në 15 ditë, nga shoqërimi me të miturit e institucionit.

5.3 Përbën shkelje disiplinore vetëm sjellja që cenon sigurinë e mirëqenies së të miturve të tjerë.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

5.4 I mituri që ka kryer një shkelje disiplinore duhet të informohet menjëherë, dhe me një mënyrë dhe gjuhë të qartë, që të kuptojnë natyrën e shkeljes së kryer. Ai ka të drejtë të dëgjohet dhe të mbrohet personalisht, vetë ose me ndihmën e prindërve apo të afërmeve të tij.

5.5 Masat disiplinore do të zgjidhen, për aq sa është e mundur, për qëllimin e tyre edukues.

5.6 Veçimi/ndarja, si masë disiplinore, do të vendoset vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kur i mituri shfaq sjellje të dhunshme. Ndarja duhet të jetë për një periudhë të shkurtër kohore, gjatë së cilës të miturit i garantohet komunikimi, aksesit në lexim dhe ushtrimi në natyrë për, të paktën, një orë çdo ditë.

5.7 Periudha e ekzekutimit të masës disiplinore mbikëqyret nga personeli psikolog dhe mjeku i institucionit.

5.8 Masa disiplinore nuk duhet të përfshijë kufizime në kontaktet familjare ose vizitat.

IV. STANDARDET E PROGRAMEVE TË EDUKIMIT E TË REHABILITIMIT

1. Programet e edukimit

1.1 Programet hartohen për të nxitur zhvillimin e të miturve dhe pjesëmarrjen e tyre në to në mënyrë aktive.

1.2 Programet hartohen në përputhje me nevojat individuale të të miturve, duke marrë në konsideratë moshën, gjininë, sfondin shoqëror e kulturor, fazën e zhvillimit, rrethanat dhe llojin e veprës së kryer. Programet duhet të bazohen në gjetjet dhe praktikën më të mira të fushës.

1.3 Programet, në institucionin e kufizimit të lirisë, duhet të synojnë arsimin, zhvillimin personal e shoqëror, trajnimin profesional, rehabilitimin dhe përgatitjen për lirim. Këto mund të përfshijnë:

- a) shkollimin;
- b) trajnimin profesional;
- c) punën dhe terapinë profesionale;
- ç) edukimin qytetar;
- d) aftësitë sociale dhe trajnimin e aftësive;
- dh) menaxhimin e zemërimit;
- e) trajtimin e varësive;
- ë) terapinë individuale dhe të grupit;
- f) edukimin fizik e sportiv;
- g) programet e drejtësisë restauruese dhe riparimin e dëmit të shkaktuar;
- gj) aktivitete krijuese, gjatë kohës së lirë;
- h) aktivitete jashtë institucionit, leje ditore dhe format të tjera lejeje;
- i) përgatitjen për lirim dhe kujdes pas lirim.

1.4 Për të miturin me liri të kufizuar hartohet dhe zbatohet një plan individual, ku renditen aktivitetet në të cilat ai do të marrë pjesë. Objektivi i planit individual është zhvillimi i aftësive të të miturit për të mundur riintegrimin në shoqëri dhe përfitimi i treguesve pozitivë të sjelljes së tij në komunitet, pas përfundimit të periudhës së kufizimit.

1.5 Plani individual zbatohet e përditësohet rregullisht, me pjesëmarrjen e të miturve dhe, për sa është e mundur, me prindërit ose të afërmit e tyre.

1.6 Programi duhet të përcaktojë zhvillimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete jashtë ambientit të institucionit dhe përfshirjen në shoqërinë e komunitetit. Drejtuesi i institucionit të kufizimit të lirisë merr masa që, në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve të pushteti vendor, të organizojnë aktivitete edukative, argëtuese e sociale, për nxitjen e angazhimit dhe të pjesëmarrjes së të miturve me kufizim lirie.

1.7 Të gjithë të miturit e privuar nga liria duhet të lejohen të ushtrohen rregullisht, për të paktën dy orë çdo ditë, nga të cilat, së paku, një orë duhet të jetë jashtë, nëse moti e lejon.

1.8 Institucioni i kufizimit të lirisë duhet të sigurojë punësim për të miturin dhe shpërblim të arsyeshëm për punën e kryer. Në këtë rast, të miturit i paguhen sigurimet shoqërore, sipas legjislacioni në fuqi.

2. Programet e rehabilitimit

2.1 Të miturit, pas përfundimit të periudhës së kufizimit, i ofrohet mbështetje për rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në komunitet.

2.2 Programet e rehabilitimit përfshihen në planin individual dhe zbatohen në kohën e duhur, para lirim.

2.3 Drejtuesit e institucionit të kufizimit të lirisë marrin masa për të siguruar kthimin gradual të të miturit në shoqërinë e lirë. Masat përfshijnë dhënien e lejeve shtesë dhe lirim të pjesshëm ose të kushtëzuar, të kombinuar me mbështetje sociale efektive.

2.4 Programet e rehabilitimit duhet të mundësojnë:

a) mbështetjen e të miturit për kthimin në familjen e tij ose në gjetjen e një familjeje kujdestare dhe lehtësimin në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore;

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- b) gjetjen e strehimit;
- c) vazhdimin e arsimimit e të trajnimit;
- ç) gjetjen e punësimit;
- d) referimin të shërbimet e duhura sociale e shëndetësore;
- dh) sigurimin e ndihmës dhe mbështetje ekonomike.

3. Programet e edukimit dhe të rehabilitimit për të miturit e grupeve të veçanta

3.1 Për të miturit me shtetësi të huaj:

a) zbatohen programe edukimi dhe rehabilitimi për përgatitjen e tyre për riintegrim në vendet e origjinës. Drejtuesi i institucionit merr masa që në bashkëpunim me institucionet kompetente të garantojnë mbështetjen e nevojshme të të miturit, deri në mbërritjen në vendin e tij të origjinës;

b) lejohen vizita të veçanta dhe forma të tjera komunikimi me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit të tij, për të shmangur izolimin e tyre social;

c) nëse nuk ka përfaqësim diplomatik ose konsullor duhet t'u lejohen lehtësira për të komunikuar me përfaqësuesin diplomatik të shtetit që merr përsipër interesat e tij ose autoritetin kombëtar apo ndërkombëtar, që ka mision për t'u shërbyer interesave të këtyre personave. Drejtuesi i institucionit siguron bashkëpunimin e duhur të drejtuesve të tjerë të institucioneve në nivel vendor me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë, që përfaqësojnë të miturin, me qëllim plotësimin e nevojave të veçanta të tij.

3.2 Për të miturit, pjesë e pakicave etnike dhe gjuhësore,;

a) zbatohen programe edukimi dhe rehabilitimi në gjuhën e tyre;

b) merren masa të posaçme për të ofruar kurse gjuhësore për ata që nuk zotërojnë mirë gjuhën zyrtare.

3.3 Për të miturit me aftësi të kufizuara:

a) sigurohen programe edukimi dhe rehabilitimi në përputhje me nevojat e tyre të veçanta;

b) merren masa për t'u vendosur në institucione të specializuara, ku këto nevoja mund të përmbushen.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të planifikojë në buxhetin e saj nevojat financiare për ngritjen dhe funksionimin e institucionit për kufizimin e lirisë për të miturit.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM
Nr. 314, datë 15.5.2019

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, SI DHE PËRCAKTIMIN E RREGULLIMEVE SPECIFIKE LIDHUR ME STRUKTURËN DHE ORGANIKËN E QENDRËS SË PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 133, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si person juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për drejtësinë, me seli në Tiranë.

2. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka si mision kryesor realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit.

3. Qendra financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

4. Qendra si fushë përgjegjësie ka parandalimin e krimeve të të miturve dhe të rinjve.

II. RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN DHE PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË QENDRËS

5. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit. Ajo organizohet në nivel qendror dhe ushtron këto funksione e përgjegjësi:

a) Bashkëpunon me Shërbimin e Provës dhe/ose me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur në :

i) përgatitjen e dokumentit për lirim me kusht, vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/mjedisor dhe të nevojave të të miturit jashtë IEVP-së;

ii) përgatitjen e planit individual të rishoqërizimit dhe të rehabilitimit, sipas programeve të shërbimeve;

iii) përgatitjen e planit të menaxhimit të riskut, në rast të identifikimit të rrezikut të mesëm apo të lartë për recidivizëm;

iv) ndjekjen, mbikëqyrjen dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike, arsimore, shëndetësore dhe situatën sociale të të miturit pas dënimit;

v) administrimin në dosje të posaçme të kopjes së dokumentacionit individual të të miturit, të lëshuara nga Shërbimi i Provës dhe administrata e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të miturin;

vii) administrimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit, me qëllim evidentimin e të dhënave që lidhen me datat e fillimit dhe të mbarimit të dënimit.

b) Bashkëpunon me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës, sipas përcaktimeve të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, për:

i) miratimin e planit të rehabilitimit dhe të rishoqërizimit të të miturit;

ii) koordinimin e masave që do të merren për zbatimin e planit të rehabilitimit dhe të rishoqërizimit;

iii) mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit të planit për rishoqërizimin e të miturit;

iv) organizimin dhe zhvillimin e takimeve me të miturit, familjen dhe institucionet e tjera që mundësojnë përfshirjen sociale të të miturit;

v) sigurimin e përmbushjes dhe të rishqyrtimit të programeve në mjediset e burgimit, nëse kjo është e nevojshme.

c) Bashkëpunon me organet e vetëqeverisjes vendore për:

i) nxitjen e marrjes së masave për strehimin e përshtatshëm për të miturin që nuk ka strehim;

ii) sigurimin për të miturin:

- të veshjeve të përshtatshme;

- të mbështetjes psikologjike;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 71*. Tiranë 2019. f. 5319.

Përmbledhje legjislacioni për të miturit

- të shpenzimeve të udhëtimit për në banesë;
- të mundësisë së ndjekjes së kurseve të formimit profesional, arsimit apo punësimit, pas lirim;
- të kujdesit të nevojshëm nga autoritetet shëndetësore, përfshirë edhe në rastet e aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga, të sëmundjeve mendore, si dhe në raste të tjera;
- iii) mbikëqyrjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit ndaj të miturit.

ç) Ndjek procesin e programimit dhe të koordinimit të trajnimit e të specializimit të profesionistëve për drejtësinë për të miturit, si dhe i propozon institucioneve kompetente tema dhe metodika të nevojshme për zhvillimin e specializimeve.

6. Struktura dhe organika e Qendrës miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislationin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

7. Qendra drejtohet nga drejtori, i cili është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

8. Marrëdhëniet e punës së drejtorit dhe të nëpunësve të Qendrës rregullohen në bazë të dispozitave të legjislationit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

9. Qendra ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

10. Vula e Qendrës ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislationin në fuqi.

11. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohet nga ministri përgjegjës për drejtësinë, me propozim të drejtorit.

III. DISPOZITË KALIMTARE DHE E FUNDIT

12. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra e Botimeve Zyrtare

Përmbledhje legjislacioni për të miturit / Qendra e Botimeve
Zyrtare. - Tiranë : Qendra e Botimeve Zyrtare, 2023.

... f. : cm.

ISBN 9789928011558

1.Të drejtat e njeriut

2.Fëmijë

3.Ligje

34(496.5) (094.5)

316.346.32 -053.2 (094.5)